INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE
KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
MEĐUNARODNA NAUČNA KONFERENCIJA

Në bashkëpunim me: / U saradnji sa: / In cooperation with:

INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESAEARCH AND DEVELOPMENT
ULCINJ-ULQIN
Registarski broj 80024813; Maticni broj 02910977
Montenegro-Ulcinj, Pinješ bb. mob. +382 69 265 707 & +382 69 079 785

P r o c e e d i n g s

Sot veprojmë – ruajmë të kaluarën dhe zhvillojmë të ardhmen
Djelujmo danas - prisjetimo se prošlosti i sačuvajmo budućnost
Today we act – to preserve the past and develop the future

Nr./Br. 1

Ulqin / Ulcinj
Mali i Zi / Crna Gora

Fondi për mbrojtjen dhe realizimin
e të drejtave të pakicave

KËSHILLI ORGANIZATIV
ORGANIZACIONI SAVJET

Mr. Vait Nikaj
Dr. Rovena Vata

KËSHILLI SHKENCOR
NAUČNI SAVJET

Prof as.dr. Elindë Dibra
Dr. Eranda Bilali
Mr. Rexhep Suma
Mr. Yllka Imeri

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Elez Osmani

Adresa e kontaktit:
Contact Address:
Bul. "Vëllezerit Frashëri" p.n. – Ulqin, Montenegro
Mob. +382 69 079 785

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-680-16-9
COBISS.CG-ID 34873104

Korrektoi dhe punoi në kompjuter : *Vait Nikaj*

E drejta e autorit :

Instituti per kërkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin

Adresa e redaksisë :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin +382 69 265 707

web.: www.ekonomskiinstitut.com

Mbështetur nga fondi për Mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave në Mal të Zi
Podržano od strane Fonda za zaštitu i ostvarivanje manjinskih prava u Crnoj Gori

PASQYRA E LËNDËS

Vebi BEXHETI
- *Esad Mekuli, Poeti dhe biri besnik i popullit të vet.....9*

Besim MUHADRI
- *Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe rilindja e Shtjefën Gjeçovit*.....19

Melihate ZEQIRI
- *Kontributi i akademik Idriz Ajetit në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës*..... 27

Fitim VELIU
- *Letërsia shqipe: Perspektiva sociale sipas Arshi Pipës*..... 35

Faton KRASNIQI
- *Neologjizmat e Pjetër Bogdanit*.....41

Lumturi BARDHI
- *Procesi dhe teknikat e të pyeturit*.....51

Elvis HUDHËRA
- *Një vështrim kronologjik mbi pasqyrimin e klasës leksiko-gramatikore të mbiemrit në disa gramatika të shqipes*.....61

Majlinda BUSHAJ-Marjan LULGJURAJ
- *Pamje panoramike mbi botimet shkencore-kulturore-letrare të shqiptarëve në Mal të Zi*.....69

Alva DANI
- *Të edukosh përmes Dantes; pedagogjia e një poeti*.....87

Ana SHAHINI
- *Vepra letrare e Jakov Xoxës në sytë e kritikës*.....95

Aida BOJDANI
- *Katalogimi Informatik në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore*.....103

Fahrush REXHEPI
- *Epitafet në gjuhën osmane, thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore*.....113

Fatlum HETEMI
- *Struktura didaktike e teksteve shkollore Leximi letrar VI* 117

Elida BEGAJ
- *Tekstet e hershme dygjuhëshe* 137

Kamber KAMBERI
- *Periudha e Skënderbeut dhe dy kohët tjera në veprën e Kadaresë*.....149

Irena PAPA (Sevdaraj)
- *Rrugëtimi i gjuhës Shqipe nga Shpallja e Pavarësisë e deri në vitet '90*.....157

Bahtijar KRYEZIU, Lumnije LATIFAJ
- *Shkallë e ulët e njohjes së gjuhës shqipe nga mësuesit tanë*.....165

Anita NEZITI
- *Postmodernizimi si humor i zi*..... 173

Luigj DEDVUKAJ
- *Analiza e teksteve shkollore, të lëndës identitare "kulturë muzikore", për nxënësit shqiptarë në Mal të Zi*.....*181*

Mustafë HAZIRI
- *Çamëria dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke*.....189

Florian BJANKU
- *Garancitë për t'u siguruar vetëqeverisja vendore*.....203

Edona ZENELI
- *Tregu i Pasurive të Paluajtshme dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë*.....213

Jusuf OSMANI
- *Vendosja e malazezëve në Vrrakë të Shqipërisë (1810) dhe kolonizimi i tyre në Kosovë*.....219

Ardita Hajdari – BUQINCA
- *Histori e religjionit të shqiptarëve në Shqipërinë e Sipërme 1912-1913*.....233

Ylber DYLI, Gerhard JAHAJ
- *Identiteti Etno-Kulturor i Rajonit Ana Malit*.....239

Rexhep SUMA
- *Identiteti nga perspektiva islame* 245

Emirjana FILI
- *Iluminizmi evropian në Pashallëkun e Janinës*.....259

Elida BOSHNJAKU, Elona BOSHNJAKU
- *Implikimet e ekoturizmit në turizmin e qëndrueshëm*.....265

Kosovar ALIJA, Artan RESHANI
- *Trashëgimia kulturore në Lug të Baranit*.....273

Alfred HALILAJ
- *"Kafja"* dhe komunikimi kompleks.....281

Besim MORINA
- *Kisha katolike në Tivar gjatë shekullit XIII-XV dhe roli i saj në ruajtjen e lidhjeve me Selinë e Shënjtë* 291

Olda CICO
- *Ekonomia globale dhe tregjet financiare në 2016*.....301

Eljon HILA
- *Koncepti i "përgjegjësisë" per administratorët e shoqërive tregtare sipas legjislacionit tregtar (2008-2015) te përafuar me direktivat e BE-së.* 307

Danja HOBDARI
- *Autorësia si trashëgimi: deri ku mbrohet përmes ligjit të ri* 315

Eriona VADINAJ, Drilona LULI
- *Një vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e sistemit fiscal nëShqipëri*.....325

Klementina NGJEÇI, Blerta AVDIA
- Trashëgimia kulturore në kurrikulën e gjimnazit 333

Riza FASLIU
- Vështrim mbi rrugët mesjetare të Kosovës Lindore.....339

Sadat AGUSHI
- Vëzhgime toponimike në fshatrat Rahovicë dhe Raincë të Preshevës.....345

Vait NIKAJ
- Ruajtja dhe avancimi i identitetit fetar.....361

Florimont GOJANI
- Struktura dhe rendi i gjymtyrëve në prozën e Migjenit dhe standardi i saj gjuhësor.....357

Shefqet DINAJ
- Trashëgimia tradicionale me vlera muzeale në Skivjan tëGjakovës.....365

Fridrik DULAJ
- Llojet e fjalive në gazetën "Koha ditore".....395

Eljana BRAHJA
- Adoleshentët dhe kujdesi ndaj librit si pjesë e trashëgimisë kulturore.....401

Driton TIKU, Ajet LECI
Kontributi i shoqërisë civile shqiptare gjatë luftës në Kosovë 1998-1999.....413

Shkëlqim SIRIKA
Migrimet humane, problematikat e proceseve urbanizuese në nivel lokal.Rast studimi: Hapësira periurbane paskuqan.....425

Yllka R.IMERI
Intonacioni në debatet politike të Kosovës dhe të Shqipërisë.....435

Samire BLLACA-BALAJ
Opinioni i mësimdhënësve mbi ndikimin e familjes dhe faktorëve familjarë për sjellje të dhunshme në shkollë.....445

Etjona HOXHA
Kujtesë/Tradita, si elemente thelbësore e formësuese të poetikës së Martin Camajt.....459

Oltsen GRIPSHI
Natyra përmes socializmit real të Zef Shoshit.....465

Prof. dr Vebi BEXHETI

ESAD MEKULI, POETI DHE BIRI BESNIK I POPULLIT TE VET

Bardi i poezisë shqipe në Kosovë, siç është bërë traditë të thuhet për këtë krijues, mësuesi i poetëve që erdhën pas tij, poeti që i këndoi këtij populli edhe kur i ishte e ndaluar, njeriu që një jetë punoi për te dhe fatin që e përcolli gjatë historisë, Esad Mekuli, në letërsinë shqipe erdhi me identitetin e vet, ashtu, siç edhe u kultivua, i vetmuar dhe ndryshe nga gjenerata e krijuesve të viteve të 30-ta, të cilës edhe i takon. Ky zë pak sa i vetmuar që mbeti specifik edhe sot, njihet edhe si themeluesi i poezisë shqipe i kësaj gjenerate krijuese, në trojet etnike, jashta Shqipërisë. Ky poet që u shkollua në gjuhë të huaj dhe një pjesë të jetës e kaloi në mjedise joshqiptare, veproi dhe krijoi në krahun e këndejshëm të shtetit shqiptar, një pjesë të veprës së tij poetike e ndërtoi mbi fatin e shqiptarit kosovar, mbi vuajtjet, dhembjen, sakrificën, luftën për mbijetesë, e herë-herë mbi gëzimin, dashurinë e lumturinë e përkohshme të tij, varësisht nga momentet historike, ku nuk munguan edhe periudha të një lirie të kufizuar. Edhe pse i shkolluar në gjuhë joamtare, në qytetet siç ishte edhe Beogradi e Zagrebi, pasi e kishte mbaruar shkollën e mesme në Pejë, po në gjuhën serbo-kroate, ai në shumicën e poezive nuk doli jashta kornizave të kombëtares, madje, edhe kur shkruante në gjuhë të huaj. Një numër të madh poezish ai i shkruajti dhe i botoi në serbokroatisht, në revista të ndryshme të Beogradit, Zagrebit, Sarajevës, Podgoricës, etj.Të gjitha poezitë e shkruara para Luftës së Dytë Botërore, gjatë saj dhe pasi mbaroi ajo, përfshirë adhe ato që i kishte botuar fillimisht në gjuhë të huaj, Mekuli i botoi në librin e parë, me titull ,, Për Ty'',më 1955, në Prishtinë. Para kësaj përmbledhjeje poetike, në Prishtinë ishin botuar edhe dy librat poetik: ,,Një fyell ndër male",më 1953 dhe,,Kanga e Vërrinit'',më 1954, të Martin Camajt, meqë për botimin e tyre në Shqipërinë e asaj kohe as që mund të mendohej. Me ndryshimet politike të jugosllavisë në dëm të shqiptarëve, sidomos kur plani për shpërnguljen në Turqi mori hov dhe kur po mbylleshin ato pak institucione kulturore e shkencore, poezia e Camajt largohej gjithmonë e më tepër nga lexuesit e vet, ndërsa kritika letrare, aq sa ekzistonte në atë kohë, pushoi së shkruari për këto vepra.

Vet titulli simbolik ,,Për Ty" ,i veprës së parë të Ead Mekulit, tregon mjaftueshëm përkushtimin e tij për popullin e vet, i bindur se ky angazhim, jo

vetëm krijues artistik, por edhe i veprimtarive tjera, do respektohet e vlerësohet nga brezat që do vinë, me gjithë lëshimet dhe dobësitë që mund të ketë kjo vepër e gjithanëshme, sepse sipas poetit, përveç vorreve dhe padijes, nga prindërit nuk trashëguan asgjë: (*Breznitë veprat i gjykojnë...-ka thanë nji Njeri i madh!) /- dhe nuk do na dënojnë, e dij,për bëlbëzimet/ tona,shtërzimet,/ për gabimet-t'vogla e të mëdha- për të mbërrimet tona…/ Pse-kush ka faj që prindët s'na lanëgadi kurgja/-pos vorreve dhe padijes;* (**Gjykimi,** Për Ty, 1955) Meqë disponimi antishqiptar, nga pushtetet serbe ishte i ndryshueshëm ,e që herë -herë zbutej deri në shkallë të një rehatie të përkohshme, e herë –herë egërsohej më shumë, Esad Mekuli, duke dashur që në poezinë e tij të jetë i pranishëm ky realitet që ndryshonte kohë pas kohe, përmbledhjen ,,Për Ty''e ribotoi disa herë nga botimi parë, me ndryshime dhe plotësime me poezi të reja, disa nga të cilat u gjendën edhe në përmbledhjet tjera të botuara më vonë. Ribotimet e para të kësaj vepre poetike, pas botimit fillestar, jorastësisht u bënë në vitin 1963 dhe 1967, vite këto kur në politikën jugosllave kemi ndryshime të theksuara, në raport me shqiptarët, siç janë edhe ndryshimet kadrovike të UDB-ës, në krye me Rankoviqin, pas të cilave u krijuan kushte për Kushtetutën e vitit 1974, që dukshëm e përmirësoi gjendjen e shqiptarëve, sidomos në ngritjen e instuticioneve kulturore, arsimore e shkencore. Edhe botimi i vitit 1963 shënon periudhën kohore kur shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi ishte zbehur në masë të madhe. Kjo koherencë e poezisë së Mekulit me rrjedhat historike dhe fatin e shqiptarëve, është e theksuar edhe në përmbledhjet tjera poetike, të tij, siç janë : ,,Vjersha" , ,,Brigjet'',, ,Drita që nuk shuhet", ,,Rini e kuqe"etj.

Si student në Beogradin e para Luftës së Dytë Botërore, ai e përjetoi keq jetën e vështirë të kurbetqarëve shqiptarë, në këtë qytet të madh, punën e rëndë fizike të tyre prej sharraxhiu e hamalli. Ishin të mjaftueshëm këto personazhë, bashkëkombës të tij, për t'u bërë heronjtë e poemës ,,Kush i pari bani",titull ky, i motivuar nga një këngë poullore e kurbetit. Këta hallexhinj, për poetin e ri që sapo kishte nisur ta shkruajë poezinë, ishin njëherit edhe nxitje e frymëzim për ta krijuar poezinë sociale, të ngjashme me atë të Migjenit, me dallimin se në këtë poemë heronjtë e Beogradit ishin shqiptarët punëtorë krahu, nga të cilët atje, ''pas 77 bjeshkëve 7 gojë presin''. Këtë afëri mes këryre dy poetëve të një gjenerate, me kohë e kishte vënë re edhe Rexhep Qosja, sidomos kur e bën krahasimin e dy poemave të tyre, ,,Poema e Mjerimit '' dhe ,,Kush i pat bani'', që i konsideron si dy kryeveprat e letërsisë sociale shqipe. Esad Mekuli, edhe pse krijimtarinë letrare e filloi në vitet e 30-ta, kur ishin afirmuar poetët si Lasgushi,Migjeni, dhe shumë të tjerë, nuk e kemi të njohur nëse e njihte apo jo këtë letërsi. Sidoqoftë përmes katër poezive të poemës ,,Kush i pari bani": **Nata**, **Mëngjesi,**

O vlla me sharrë në krah, E kam pa të çmendun dhe ndonjë tjetër,siç është edhe **Lypsat, Prej fëminisë, Të mjerët,** etj., vërehet një afëri me poezinë sociale të Migjenit, që dëshmon se jeta e vështirë e njeriut dhe varfëria janë të njëjta, pavarësisht se ku jeton ai. Ngjashmëri të vargut poetik të Esadit hasim edhe në shumë poezi tjera të poetëve shqiptarë, madje që nga koha e Rilindjes e deri në poezinë e sotme. Poezia e tij, **Kushtrimi**, e shkruar në fillimet e luftës, më 1942, kur i thërret bashkëkombasit e vet në luftë për liri, mbyllet me vargjet: *Shko në rrugën e gjakut: / ja vdekje, ja liri!,* ashtu si edhe poezia **Shqiptar** e Çajupit: *Të ngriemi e të dëftojmë/ trimëri,/ Ja të vdesim, ja të rrojmë/ për liri!* Poezia lirike peizazhiste, me titull **Mbramja**, e këtij poeti, ku në mënurë të mrekullueshme përshkruhet mbarimi i ditës dhe rënia e muzgut: *Si tufa mëndafshi t'artë n'mes dy duersh t'bardha, dy kodra nën borë-/ flakron perëndimi...retë mbi krye prorë ,* ngjason shumë me poezinë **Poradeci**,ku poashtu me ngjyrën artistike të fjalës, pikturohet mbrëmja mbi qytetin e bukur, venlindjes së Lasgushit. Vargjet: *cipa e natës shtrihet mbi fusha t'përhime, / malet heshtin n'errësi si me qenë të ngrime,/ si t'humbëte jeta-cdo gja u nxi, u zhduk.,* të poezisë së Esadit, a nuk përngjajnë me këto të Lasgushit: *Tërë fisi, ra...u dergj...e zuri gjumi...?Zotëroj më katër anë errësira...* Ngjashmëri të këtilla hasim edhe mes vargjesh tjera të Esad Mekulit me shumë poezi të poetëve tjerë ,siç janë: edhe Ismail Kadare,,Dritëro Agolli ,Ali Podrimja e shumë të tjërë, madje ku në ndonjë rast hasim edhe poezi me të njëjti titull, nga dy autorë.

Poezia e tij mbeti origjinale ,me gjthë afëritë me poezi të shumë autorëve, ajo në të shumtën e rasteve ndoqi një rrugë tjetërfare tematike, atë që e imponuan rrethanat historike e politike pas të ashtuquajturës LNÇ., kur edhe mëtutje Kosova mbeti jashta Shqipërisë shtetërore, me gjithë shpresën për një ribashkim, nga ndarja e Londrës e vitit 1913, meqë në atë luftë, krahas popujve tjerë të Jugosllavisë, luftuan edhe shqiptarët. Këto ishin momentet e ndarjes së madhe, ndarje kjo që sërish i detyroi shqiptarët e dy krahëve të kufirit të vazhdojnë, të jetojnë e të krijojnë ndaras. Kjo ndarje në letërsi dhe zhvillimet e saj nën trysninë e dy lloj ideologjive komuniste të dy shteteve, i kushtoi shumë letërsisë shqipe. Edhe poezia e Esad Mekulit, nuk e pati lehtë të mbijetojë nën trysninë e ideologjisë, nga njëra anë dhe shtypjes sistematike nga regjimi sllav. Kjo poezi, që megjithatë, e lidhi hallkën e shkëputjes nga kontinuiteti i zhvillimit historik të letërsisë shqipe edhe me këtë krah, u zhvillua bashkë me fatin e vuajtjet e bashkëkombasve të tij, dhe ndonjëherë, edhe me iluzionet për barazi me të tjerët, si rezultat i disa të drejtave në kulturë e arsim, që nuk ishin edhe të pakta, krahasuar me ato të Mbretërisë jugosllave. Gjatë kësaj periudhe ndryshimesh të shpeshta të klimës politike, Esadi i ndejti besnik vetëm popullit të vet, e assesi regjimit të

pushteteve të Jugosllavisë së atëhershme. Ky poet i qëndresës dhe i krenarisë së popullit të vet, në poezinë që i imponohej kjo temë trajtimi, i theksoi problemet e natyrave shoqërore, impulset, jehonën e tyre dhe karakteristikat më të dalluara të epokës, apo më drejt të pesë dekadave të fundit (shih te E.Mekuli,Poezi: 314), pavarësisht se kjo nuk i shkonte për shtati cilitdo sistemi të Jugosllavisë, nga ai mbretëror deri te ai komunist. Edhe poezia e tij, e pas luftës, nuk ngurronte të përballet me padrejtësitë që i bëheshin popullit të vet, ashtu sic edhe në shumë poezi ,dëshironte t'i lëvdëronte të arriturat dhe të drejtat që i gëzonin shqiptarët. Veprat letrare të autorëve të gjeneratës së tij, të asaj të viteve të 30-ta, që veprimtarinë krijuese e vazhduan edhe në Shqipërinë e ideologjisë komuniste, por edhe ata të gjeneratës më të re, duhej patjetër t'i nënshtroheshin frymës së Realizmit socialist. Ajo letërsi duhej të ishte në shërbim të një sistemi shoqëror, të udhëhequr nga ideologjia, dhe si e tillë e dhunonte shijen e lexuesit, i cili do duhej ta pranonte, si realiste, letërsinë e vetme, ku mbizotëronte ideja e pasqyrimit të luftës klasore (Shih te Floresha Dado: 90). Gjithsesi ky drejtim letrar, nëse mund ta quajmë kështu, ishte i importuar nga letërsia sovjetike, bashkë me artet tjera të kësaj fryme ideologjike që në Shqipërinë komuniste u kuptua si fenomen statik, e jo si dukuri që mund të pësonte ndryshime. Realizmi socialist në Shqipëri, si duket, nuk ishte kopje e letërsisë sovjetike, por një degradim më i thellë i parimeve që udhëhiqnin në letërsi, duke e refuzuar fenomenin e varianteve dhe të veçorive nacionale, që me siguri autorëve të kësaj periudhe do t'u mundësonin më tepër liri veprimi .(Shih te Floresha Dado, po aty, f.57) Këtë liri veprimi ,edhe pse të kufizuar në krimtarinë artistike e patën shkrimtaret e shumë vendeve të bllokut socialist, pa e përjashtuar edhe Jugosllavinë, ku jetonte dhe krijonte edhe Esad Mekuli, edhe pse pushteti serb kishte kontroll të shtuar për krijimtarinë artistike shqiptare, e vecmas në letërsi, ku hapat e parë i bënte ky poet dhe intelektual i një përmase të këtillë. Vepra poetike e Esad Mekulit, me gjithë vështirësitë që i pati kohë pas kohe, nuk përjetoi ndonjë ndalesë të rreptë nga censura e autoriteteve jugosllave.

Kosova, me ato pak institucione arsimore, shkencore e kulturore, që lirinë e veprimit në periudha të caktuara e kishin të kufizuar, apo edhe të ndaluar, i përkrahte krijuesit dhe veprat e tyre letrare, falë intelektualëve të vendosur dhe disa autotoriteteve shqiptare të atij pushteti ,edhe pse me kompetenca të kufizuara të një krahine, herë me autonomi më të plotë, herë të kufizuar e në disa periudha edhe të pezulluar tërësisht. Esadi, me respektin që kishte nga intelektualët shqiptarë, moshatarë të tij, nga ata më të rinjtë dhe autoritetin për veprimtarinë revolucionare antifashiste, në një të kaluar jo fortë të largët, ia doli të qëndrojë i palëkundur dhe ta japë kontributin me tërë qenien e vet në ndërtimin

e jetës së re të bashkëkombasve, që kishin vuajtur aq shumë. Revista letrare me emrin poashtu simbolik ,,Jeta e Re “, e themeluar më 1949, nga vet Esad Mekuli, luati rol vendimtar në afirmimin e emrave të rinj që sapo i hidhnin hapat e parë në krijimtarinë e tyre [1]. Kjo fletore letrare e kulturore, e vetmja e këtij lloji në Kosovë, njëherësh ishte edhe ogani i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që gjithashtu, e kishte themeluar dhe e udhëhiqte ky intelektual, që si kryeredaktor i saj e drejtoi për disa dekada. Ky personalitet i pakontestueshëm dhe luftëtar i pakomromis për të drejtat shpeshherë të nëpërkëmbura të shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë, fillimisht u mor edhe me veprimtari shkencore në fushë te Veterinës, profesion ky i fituar me mbarimin e studimeve dhe mbrojtjes së Doktoratës . Falë edhe kompetencës shkencore që e kishte dhe afirmimit në këtë lëmë si shkencëtarë i njohur edhe jashta Kosovës , ia doli ta themelojë edhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Nga kjo veprimtari shkencore që e kishte vetëm profesion e jo edhe pasion, do përcaktohej në veprimtarisë krijuese poetike, pa u largua nga krijimtaria publicistike dhe përkthimi i veprave letrare shqipe në atë sebokroate dhe anasjelltas.

Interesimin e tij me aq përkushtim edhe përmes poezisë, për rrugën jetësore të bashkëkombasve, bashkë me vuajtjet, madje edhe për ta mbrojtur dinjitetin e tij njerëzor e kombëtar, në momente kur nga qarqe të ndryshme, shqiptari ofendohej në mënyr, **O vlla me sharrë në krah**, që në fillimet e shkrimeve të tij poetike, të para Luftës së Dytë Botërore: *Po të shof prap- me duer të mërdhime nën sjetull,/ me sharrën e stërlashtë mbi krah dhe sopatën e mprehtë të rrasun në shokë(... bishti i saj ka dalë mbrapa setrës/ dhe duket…Vallë, mos për këtë na quejtën ,,njerëz me/ bishta”?!*). Në vargun e tij poetik zë vend edhe zhgënjimi i poetit, për gjoja lirinë e plotë që e solli e ashtuquajtura LNÇ, pjesë e së cilës ishin edhe shumë shqiptarë, të bindur se liria do vinte për të gjithë. Dhjetë vite pas mbarimit të asaj lufte, në poezinë **Dhjetë pranvera lirie** ,autori është i sinqertë kur beson se ajo liri është rezultat i asaj lufte të vështirë dhe i vuajtjeve të idealistëve nëpër burgjet fashiste: *Dhjetë pranvera lirie!/-A të kujtohet: sa kemi andrrue për te/ në ditët e kryengritjes-/ të ndjekun nëpër hapsane!*....Kjo liri që shqiptarëve ua hapi rrugën e shkollimit e dies në gjuhën amtare, herë- herë kufizohej e ndërpritej,

---

[1] Në një takim letrar në Prishtinë, mbajtur për nder të këtij poeti, atdhetari, shkrimtari dhe i dënuari më i njohur politikë ndër shqiptarë dhe jo vetëm, Adem Demaqi , në fjalën e vet për veprën e këtij përsonaliteti, ndër të tjera rrëfeu edhe për gjestin intelektual, kombëtar e human të tij, kur një ditë ai e takoi në rrugë, pasi kishte dalë nga burgu, ku kishte mbajtur njërin nga disa dënimet, dhe pa asnjëfarë komleksi apo droe se bisedon me një të dënuar politik, pas bisedës së ngrohtë vëllazërore, ia kishte kërkuar për botim në revistën ,,Jeta e Re”, romanin e ndaluar ,,Gjarinjtë e gjakut”,e që falë tij, u botua për herë të parë në vazhdime të disa numrave të revistës

varësisht vullnetit të atij pushteti që edhe ua kishte lejuar këtë të drejtë: - *Sa të këqija janë zhdukë, sa!... Shikoni dhe librat tanë,/shihni të parën Abetare-në të vjershën e parë/ që shkroi nji Shqiptar!* Me gjithë këto ndryshime me aromë lirie edhe për shqiptarët, qarqet shoviniste serbo-sllave, me veprimet antishqiptare edhe pse kohë pas kohe jo të zhurmëshëm, nuk pushuan asnjëherë. Esad Mekuli në cdo moment ishte me popullin, edhe atëherë kur i gëzohej lirisë, edhe atëherë kur kjo liri dukej sipërfaqsor, edhe atëherë kur shuhej fare dhe rrezikohej së bashku me qenien e kombit.

Ky poet dhe bir besnik i popullit, në kronikën e vet poetike me këtë temë, depërtonte edhe atje ku e kishte të ndaluar, ai nuk heshtte edhe atëherë kur u ngritën lugetërit dhe fantazmat e zeza që e donin tjetërsimin dhe shfarosjen me shpërngulje të shqiptarëve për në Turqi, që bashkë me emrin ,, turk'',të tretën në tokat e Anadollit. Këtë shpërngulje që herë-herë ndodhte edhe heshturazi, vargu poetik i Mekulit e ngriti në fenomenin më tragjik që u kishte ndodhur ndonjëherë shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të rajoneve të tjera të hapësirave jugosllave. Me temën e shpërnguljes me dhunë, të shqiptarëve, ai u mor që në vitin 1938, kur e njohu historinë e hidhur të planit të përpunuar mirë dhe me kohë, të Qeverisë jugosllave, sipas projektit të Çubrilloviqit, për dëbimin e 400.000 të ashtuquajtururve,, turq''prej ,,Serbisë Jugore'', në shkretirat e Anadollit. Pas jehonës që pati kjo marrëveshje dhe reagimeve të shumta nga njerëz që e kundërshtonin këtë dëbim masiv nga vatrat e tyre, reaguan fuqishëm edhe shumë studentë shqiptarë, nga Kosova, të përkrahur edhe nga ato serbë, malazias dhe turq, të cilët përmes një proklamate të nënshkruar i thanë JO këtij plani për spastrime etnike. Ky dokument i shkruar në shqip dhe serbokroatisht, iu shpërnda ilegalisht ambasadave të huaja në Beograd dhe pëpër Kosovë e Maqedoni.(shih te E.Mekuli, Poezi: 157) Për këtë rast, Mekuli e shkruajti poezinë ,,A asht fajtor shqiptari''. Çdo strofë, nga gjithsej tri, sa kishte poezia, fillon me fjalinë, ,,A asht fajror Shqiptari''? Këto pyetje me ngjyrim revolte e hidhërimi të poetit, ishin njëherit edhe mospajtim dhe refuzim i tezës shoveniste serbe, se shqiptari ishte fajtor për çdo gjë, madje edhe kur donte të jetojë në tokën e vet, edhe kur haptazi shprehte revoltë kundër pabarazisë, edhe atëherë kur sytë flakë i vetojnë, kur i huaji e dëbon nga shtëpia, edhe atëherë kur dëshiron të jetojë si të tjerët: *A asht fajtor Shqiptari pse, si të tjerët, po don/ të jetojë si Njeri në të vetat sot e përjetë?/ A asht fajtor pse përkundër dhunës qindron/ nën qiellin e Kosovës loke, në truallin e të parëve të vet!*. Këto plane që e synonin Kosovën pa shqiptarë, vazhduan edhe pas luftës, kur shqiptarët mendonin se edhe për to kishte ardhur liria. Sa e dhimbshme duket lutja e nënës, drejtuar djemve që mos ta lëshojnë tokën e Kosovës, për t'u nisur rrugës së pakthim për në tokat e Anadollit, edhe

në kohën kur ajo mendonte se kishte ardhur liria dhe zjarrin në vatër tanimë do e ndeznin pa frikë: *Për ke në dritë ju qita,/ o djem!/ Për ke ju rrita, / o bij'?/ Pse u gëzova unë në jetë?/-Nanën po e leni sot/ kur kryet/ me mburrje për ju e ngrita;…Në dheun e huaj po shkoni?/… atje ku vesh s'ju marrin/…ku dheu i zi/ randë t'ju peshoi mbi rrashta/ pa etnit tuaj për bri!*(**Porosia e nanës,** Për Ty, 1955) Kjo propagandë dhe dhunë e formave të ndryshme për spastrime etnike, përfshiu edhe një pjesë të intelektualëve, që gjithashtu morën rrugën e pakthim, atë të asimilimit të sigurtë. Poezia e shkurtër me titull **Dhimbje,** e përmledhjes ,,Vjersha"(1973), me ato pak vargje prekëse rrëfen një histori që dhemb edhe sot. Sipas sqarimit të poetit, poezia i kushtohet mësuesit Jusuf Jusufit nga Tetova, i cili i la nxënësit dhe u shpërngul në Turqi. E tërë kjo histori me aq dhembje përfshihet në të vetmen fjali ,,shpërngulë në Turqi'',e shënuar në një fletë, që bashkë me revistën,,Jeta e Re''u kthye në redaksi. Kjo listë e zezë e përmortshme për poetin, ishte më e rëndë se një nekrolog, ndërsa largimi i një mësuesi që i la nxënësit jetimë ,nuk ishte më pak se një tradhëti*: Pandeh-/ si mësojtore,/ o mësues, të cilën e ke tradhtue!*

Fenomenit të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, këtij projekti famëkeq, i paraprinë propagandat ndër më të ndryshmet, nga ato të mashtrimeve se shqiptarët e besimit islam në Turqi do jetojnë më mirë dhe do jenë më të sigurtë, e deri te shumë kurdisje e montime tjera politike, siç ishte edhe aksioni i mbledhjes së armëve, kur edhe u shtua dhuna fizike, deri te likuidimet masive. Kjo dhunë e paparë nga organet policore, e po atij shteti që deklarohej si shoqëri e ,,Vllaznim-bashkimit'', e që Mekuli i kushtoi gjithashtu poezi, por në periudha më të zbutura, sidomos pas rënies apo dobësimit të dhunës së Organeve policore të sigurimit shtetëror, theksohet edhe në poezinë **I Vruni i këndon lirisë**, të përmbledhjes ,,Për Ty",të botimit të dytë, më 1967, por të shkuar në 1954. Ky shqiptar që e var veten duke mos e duruar dhunën për dorëzimin e armës që s'e kishte, është personazhi fatkeq, dëshmitar për këto vuajtje dhe mjerimin që kurrë nuk iu ndanë bashkëkombasve të poetit: *A asht kjo, o v'lla, ahmarrja jote e vetme, e trueme,/ për vuajtjet tona-mjerimin që kurrë s'na u nda.* Pëmes poezisë **Turk elhamdulila**, i po të njëjtës përmbledhje, por të shkruar më 1954, poeti me gjuhën e vet të mprehtë poetike i qaset një realiteti të hidhur të tendencës së pushteteve të huaja, me histori që nga koha e Perandorisë Osmane, për asimilim të plotë të shqiptarëve, gjithsesi duke e keqpërdorur edhe fenë, që mëpastaj ky proces tjetërsimi të kryhet më lehtë. Kjo propagandë antishqiptare që lëshoi rrënjë të thella, që edhe sot vështirë se po çrrënjoset, e shpifi tezën më antinjerëzore e antikombëtare, se ai që nuk fliste turqisht, nuk mund të kishte fe, e as që mund të besonte në Zot. E gjithë kjo urrejtje për shqiptarët, bashkë me dëshirën që një ditë

t'i lënë shkretë tokat e veta, që më vonë të popullohen me kolonë serbë, e kishte edhe historinë e vet, që bazohej në armiqësinë tradicionale të pushteteve sllave, që për këto qëllime e shfrytëzuan edhe mentalitetin e deformimit të besimit të drejt fetar islam të tyre, të trashëguar që nga autoritetet e sundimit aq të gjatë të Perandorisë Osmane, të cilët të parët e kishin hedhur tezën, se të jesh me besim islam dhe të jetosh në hapësirat e kësaj perandorie, me doemos duhet të jesh turk: *-Je turk, je turk- kan shti/ Shqiptarin me shekuj, pa da,/ e nji ditë ndër ne u ndi:/- Jam turk, elhamdulila*. Poeti ynë i përjetonte keq këto politika antishqiptare, që vazhdimisht e goditnin dinjitetin e këtij populli që e donte lirinë dhe barazinë me të tjerët. Kjo urrejtje nuk u zbeh as edhe në periudha të asaj lirie të brishtë, që vazhdimisht e gërryente plagën, që sipas poetit kishte nisur të shërohet. Ky qëndrim aq primitiv antishqiptar e nënçmonte dhe e fyente ate, madje duke e thirrë me emra të huaj, si: arnaut, turk, apo edhe nënçmues e tallës, si: shiftar, shipci etj. : *Kur thue-shiftar/ më vjen/ rëndë-ftyrës flaka i bjen/ Shiftar!/ m'djeg me dhimbje si shufër kamxhiku,/ m'ther në plagë t'vjetra nisë me u shërue.* Poeti edhe në këtë atmosferë të kontaminuar me antishqiptarizëm, ka prirje dhe dëshirë për zgjidhje fatlume, sepse ende beson se liria duhet të vlejë edhe për shqiptarët. Ai mburret me kombin që i takon, me dëshirën e tij për një të ardhme të lumtur, me gjakun e tij të pastër: *Shqiptar jam- ta dijsh! dhe i njejti rod/ me mbarë shqiptarët-jemi gjak shqiptari./ Nën krahët e lirisë e të vllaznimit sod/ t'ardhmen tonë ndërtojmë me duer ndërtimtari.*(**Shiftar mos më thuaj**, po aty).

Esad Mekuli, edhe pse asnjëherë nuk kishte pranuar të jetë pjesë e udhëheqjes politike, jetonte brenda asaj politike, sepse ai në vazhdimësi e përcillte fatin e popullit të të vet si viktimë e atyre politikave, që gjithmonë gatuheshin në kuzhinat e Beogradit. Politika lokale e Prishtinës, një pjesë e së cilës krijohej edhe nga shqiptarë, ishte e pa fuqishme në kushtet e një qendre të një Krahine me të drejta shumë të kufizuara, sidomos të periudhës para Kushtetutës së vitit 1974, meqë me këtë Kushtetutë, Krahina e atëhershme e Kosovës, u bë pjesë konstituive e Jugosllavisë. Ashtu si në shumë poezi, disa nga të cilat i përmendëm, e që temë trajtimi i kishin përpjekjet për mbijetesë të shqiptarëve, edhe te poezia **Si në shtëpinë e vet**, që e shkruajti më 1969, e që i takon po asaj periudhe të shkallës së lartë të sundimit serb në Kosovë, por jo edhe të nënshtrimit të shqiptarëve, autori shpreh revoltën kundër politikanëne të lartë komunistë jugosllavë, që për interesa të tyre, shpesh e vizitonin edhe Kosovën. Një vizitë e këtillë ishte edhe ajo e funksionerit të lartë të Beogradit, Marko Nikeziq i cili me fjalimin e vet, mbajtur në Prishtinë, në vitin 1969 „i siguroi''shqiptarët e Kosovës se në këtë vend duhet të ndihen si në shtëpinë e vet. Poetin, si dhe të gjithë shqiptarët i lëndoi dhe i ofendoi fjalia „si në shtëpinë e vet''. Ky fjalim, në kohën kur shqiptarët ishin

të bindur se jetojnë në shtëpinë e vet, madje Kosovën e kishin shtëpi, prej kur ekzistonin në këto troje, sipas autorit, i ringjallte sërish përbindshat për të vjellë helm e vrer, prandaj ai duke mos e duruar këtë ,,përkujdesje'', ashtu i revoltuar, e mbyll pozinë me këto vargje: ,,Të huaj- kurrë më! Në shtëpinë tonë jem' prore, në vendin e përbashkët, në vatrën vëllazërore! (Brigjet,1981) Ai brengosej për të gjithë shqiptarët e Jugosllavisë,kur atyre u cënohej e drejta për arsim në gjuhën amtare dhe të drejta tjera në sferë të kulturës,historisë, të përdorimit të drejtë të toponimeve dhe shumë të drejtave tjera. Një fushatë e këtillë kundër gjuhës shqipe në procesin arsimor, madje që nga arsimi parashkollor, e deri në atë të lartin, që i shpalli luftë shkollës shqipe, deri në mbyllje të plotë, me sukses u realizua në Maqedoni, pas demonstratave të vitit 1981. Politika shtetërore e kohës, e Maqedonisë, si dorë e zgjatur e asaj serbe, fillimisht e ndaloi dygjuhësinë në administratën e shkollave shqipe e mëpastaj i mbylli edhe ato. Esad Mekuli nuk ndejti indiferent ndaj këtij fenomeni, prandaj në poezinë **Dygjuhësia,** të shkruar në vitin 1986, e të botuar në përmbledhjen ,,Drita që nuk shuhet'',në vitin 1989, ai këtë fenomen e trajtoi edhe poetikisht. Edhe në këtë poezi ,mes titullit dhe strofës së pare e jep këtë sqarim: ,,Nëpër shkolla shqipe-pashë në kllapi, u hoq dygjuhësia ,kurse vulave në dy gjuhë iu sos mereqepi''. Ndalesën me dekrete partiake e shtetërore, si ultimatum që doemos duhej realizuar fillimisht në Maqedoni, e më vonë edhe në Kosovë, por që asnjëherë nuk pati sukses, deri në ndalesën e plotë dhe përjashtimin e nxënësve e studentëve shqiptarënë nga institucionet shkollore publike ,në kohën e Millosheviqit. Fillimisht heqjen e gjuhës shqipe nga dokumentacioni dhe e ashtuquajtura administratë shkollore dygjuhësore që vlente vetëm për shqiptarët, e më vonë ndalimin e tërësishëm të mësimit në gjuhën shqipe, poeti e paraqet përmes narracionit poetik me vargje të ndërtuara edhe me nga një fjalë të vetme, te kjo poezi: *ia behu/ porosia:/,,Nga dokumentacioni/shkollor /dhe vulat e përbashkëta/ hiqet*/ dygjuhësia''/ pikë-Pikë/,,*Tash e tutje/ këto/ të shënohen/ në një/ gjuhë/u n i k e ''*. Edhe në vargjet e kësaj poezie vërehet zhgënjimi i madh i poetit dhe ashtu i habitur, e shtron dilemën se si ka mundësi të kufizohet shkollimi në gjuhën amtare, në një shoqëri ku sipas kushtetutës trumbetohej barazia: *Të kufizohet/ shkollimi në gjuhë amnore?!- Shtova:-E Revolucioni* ?/ *Kushtetuta?/ Barazia?*

Prirja e Esad Mekulit për të shikuar vetëm nga e ardhmja që do të sjellë liri për të gjithë, është edhe një dëshmi se poeti tërë talentin e pasur dhe energjinë krijuese që e kishte, i vuri në shërbim të vlimeve progresve të kohës dhe synimeve liridashëse të popullit në të gjitha fazat e luftës së tij të theksuar apo të heshtur, duke e lidhur veten tërësisht me perspektivat e hapura liridashëse të përgjithshme. (E.Mekuli, Poezi:318) Përvec poezisë së natyrës tribunale e retorike me temë

nga përditshëria e jetës së shqiptarit në luftën për mbijetesë, dhe asaj sociale, të periudhave që i përmendëm, Esad Mekuli njihet edhe si krijues i një spektri më të larmishëm temash e motivesh, ku dallohen edhe lirikat meditative e pejsazhiste, që me fjalën artistike i pikturoi bukuritë e vendit të vet dhe të shumë vendeve e qyteteve tjera të Jugosllavisë, Shqipërisë, e botës. Në fazën kulminante të krijimtarisë poetike, vargu i tij dëshmon pjekurinë e plotë artistike si për nga forma ashtu edhe për nga përmbajtja, duke e ngritur këtë poezi atje ku edhe e ka vendin, në majat e vlerave poetike të letërsisë sonë, përkrah poezive të poetëve më të mëdhënj, nga ato të viteve të 30-ta të shekullit të 20, deri në kohën kur pushoi me veprimtarinë krijuese. Poezitë e viteve të fundit gjuhësisht qëndrojnë më lartë se krijimet e mëhershme, dhe shpesh u afrohen edhe motiveve nga lashtësia, ku i kërkon rrënjët e të parëve, i bindur se e kaluara i ruan celësat e së ardhmes . (Esad Mekuli, I varuni i këndon lirisë: 14) Për këto dhe shumë cilësi tjera me vlerë, të kësaj poezie, që në këtë studim nuk mundëm t'i përmbledhim, Rexhep Qosja thekson se Mekuli edhe pse nuk ka shkruar shumë, fama e tij mund të matet me famën e Majakovskit, Apolinerit, Lorkës e Eseninit në vendet e tyre, duke e quajtur edhe Tribun popullor(http://www.forumishqiptar.com/threads/6819-Esad Mekuli).

Literatura:

- Esad Mekuli, Poezi, Prishtinë, 1955.
- Esad Mekuli, Për Ty, Tetovë, 1997.
- Esad Mekuli, I varuni i këndon lirisë, Tiranë, 2006.
- Floresha Dado, Letërsi e paintrpretuar, Tiranë, 2010.
- Roland Zisi, Letërsi bashkëkohore shqipe, Tiranë, 2008.
- Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Pejë, 2001.
- http://www.forumishqiptar.com/6819-Esad- Mekuli

Prof. as. dr. Besim MUHADRI

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT DHE RILINDJA E SHTJEFËN GJEÇOVIT

Abstrakt

Shtjefën Konstadin Gjeçovi (1874-1929) është padyshim një nga figurat më komplekse dhe më poliedrike e kulturës, letërsisë dhe shkencës sonë. I lindur në Janjevë të Kosovës në vitin 1874 dhe i shkolluar në Troshan të Lezhës, në Fojnicë e në Derventë të Banja Llukës (Bosnje dhe Hercegovinë) si dhe në Kreshevë të Dalmacisë, ai gjatë atyre viteve do të pajiset me një kulturë të gjerë intelektuale për kohën.

Edhe pse i veshur me petkun e fratit, që shërbeu në shumë vende të Shqipërisë dhe të Kosovës, ai me përkushtimin e tij në shumë fusha të dijes, shkencës, kulturës, letërsisë, të arsimit, trashëgimisë popullore dhe zakonore, arkeologjisë etj., ai, gjatë 53 viteve të jetës, arriti të krijojë një opus të gjerë, duke lënë pas vetes një veprimtari shumë të çmuar.

Por mbi të gjitha veprat e Gjecovit lartësohet dhe mbetet një përmendore e pavdekshme "Kanuni i Leke Dukagjinit", publikuar më parë në revistën "Hylli i Drites" dhe e botuar pas vdekjes më 1933, me një parathënie të gjatë të Fishtes mbi rëndësinë e folkloristkës sonë kombtare, të ligjeve dokesore dhe sidomos mbi vlerën juridike të Kanunit.

Kjo vepër, ashtu sikurse edhe tërë puna kolosale e Gjeçovit, do ta bëjnë autorin e tyre të pavdekshëm dhe një nga figurat më të respektuara të historisë dhe kulturës sonë kombëtare.

Temë e studimit tonë do të jetë jeta dhe veprimtaria e Gjeçovit, vrasja e tij në mënyrë tinëzare nga regjimi i mbretërisë jugosllave, jehona e kësaj vrasje tinëzare, reagimi shtetit shqiptar për këtë vrasje si dhe botimi dhe jehona e pakontestueshme e veprës monumentale "Kanuni i Lekë Dukagjinit, e cila edhe në këtë kohë vazhdon të zgjojë kërshërinë e studiuesve jo vetëm vendorë, por edhe atyre ndërkonbëtar dhe der më tani ka përjetuar disa botime edhe në gjuë të huaja.

Fjalët kyçe: *Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, trashëgimia popullore,*

e drejta zakonore.

Hyrje

I lindur në Janjevë të Kosovës në vitin 1874 dhe i shkolluar në Troshan të Lezhës, në Fojnicë dhe në Derventë të Banja Llukës (Bosnje dhe Hercegovinë) në Kreshevë të Dalmacisë, Shtjefën Konstandin Gjeçovi është padyshim një nga figurat më komplekse dhe poliedrike i kulturës dhe shkencës shqiptare. Edhe pse i veshur me petkun e fratit, ai me punën e tij përkushtuese në shumë fusha të dijes, gjatë 53 viteve të jetës së tij arriti të krijojë një opus të gjerë, duke lënë pas vetes një veprimtari shumë të çmuar. Madje në disa fusha, si në atë të arkeologjisë dhe të së drejtës sonë zakonore do të jetë edhe nismëtar.

Përkushtimi i tij në të gjitha këto fusha të dijes, që nënkupton edhe përkushtimin e tij të pamohueshëm dhe shumë të guximshëm intelektual dhe atdhetar, do të jetë fatal për të, sepse më 14 tetor të vitit 1929 do të vritet në pabesi nga xhandarmëria serbe. Vrasja e tij në një moshë kur mund të jepte një kontribut të rëndësishëm në fushat ku punonte, do të jetë një humbje e madhe për kulturën shqiptare në përgjithësi, sepse mbetën pa u realizuar shumë projekte të nisura nga ana e këtij kolosi, të cilat kanë vlera të pakontestueshme.

Por, vlerësimet për veprën madhore të Gjeçovit, do të jenë në fokus të përhershëm të studiuesve, qofshin ata shqiptarë apo të huaj. Një interesim të jashtëzakonshëm do të reflektojë vepra e tij "Kanuni i Lekë Dukagjinit", që është një mbledhje e të drejtës sonë zakonore, për të cilën Gjeçovi kishte punuar me vite, për të mos thënë në pjesën më të madhe të jetës së tij. Mirëpo nuk mbeten pas edhe vlerësimet për veprat e tjera të Gjeçovit, siç janë "Agimi i Qytetnisë" i botuar në Shkodër më 1910, por edhe për krijimet poetike, të cilat i botoi kryesisht në vitet 1900-1902 në revistën "Albania" që në atë kohë botohej në Bruksel, pastaj për krijimet tij në fushën e letërsisë popullore, atë të dramaturgjisë, përkthmit etj. etj.

Shtjefën Gjeçovi, ky studiues dhe "gërrmues i shpirtit të popullit", siç u cilësua nga kritika, me veprën e tij shumëdimensionale ishte dhe mbeti një nga Rilindësit më të përkushtuar, më të zëshëm dhe më të angazhuar, pothuajse në të gjitha fushat e jetës.

Gjeçovi midis besimit dhe Atdheut

Vepra dhe veprimtaria e Gjeçovit, pas vdekjes së autorit zgjoi kërshërinë e studiuesve të shumtë, qofshin ata shqiptarë, apo edhe të huaj. Lista e atyre që u

morën më analizën dhe vlerësimin e veprës së tij është e gjatë, në të cilën mund të hasim edhe këta emra, si: Aleks Buda, Syrja Popvci, Ndoc Kamsi, Vili Kamsi, Agnija V. Desnickaja, Rrok Zojzi, Andrea Varfi, Demush Shala, Ruzhdi Mata, Pashk Bardhi, Vinçenc Prenushi, Ugolini, Atanasio Gegaj, Hilë Mosi, Gjergj Fishta, Faik Konica, Nelo Dizdari, Gjuzepe Kastelleti, Salvatore Vilari, Kolë Ashta, Karl Gurakuqi, Idriz Ajeti, Zekeria Cana, Anton Çetta, Mark Krasniqi, Ismet Elezi, Vinçenc Malaj, Resmije Kryeziu, Jaho Brahaj, Thoma Murzaku, Frrok Kristaj, Skënder Zogaj e shumë e shumë të tjerë. Figura e Gjeçovit në dritën e vlerësimeve të këtyre studiuesve, historianëve, publicistëve, por edhe juristëve e politikologëve, na del mjaft e kompletuar dhe shumëdimensionale. Andaj, këto vlerësime janë një kontribut i rëndësishëm për njohjen dhe ndriçimin e figurës së këtij dijetari dhe veprimtari, në të cilat spikat roli dhe kontributi i tij dhënë shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi.

Për historianin e mirënjohur shqiptar, Aleks Buda Gjeçovi është një figurë e shquar e lëvizjes politike, e shkencës dhe e kulturës shqiptare, i cili edhe pas shumë viteve të kalimit në amshim, "u thotë brezave të rinj fjalën e vet me domethënie edhe për të sotmen e të nesërmen: fjalën e dashurisë për popullin e për vlerat madhore, që ai ka krijuar gjatë shekujve, fjalën e punës vetëmohuese për studimin e kësaj kulture"[1].

Nga ky citat shihet kontributi i Gjeçovit dhënë shkencës, kulturës, por edhe historisë gjithëkombëtare. Kjo që spikat historini Buda, është një fakt i pamohueshëm. Aleks Buda, kur flet për një nga veprat e spikatura të Gjeçovit siç është "Agimi i Qytetnisë", të botuar më 1910, na njeh me mendimet politike e filozofike-pedagogjike, me aspektet e tyre pozitive, por edhe me disa kufizime karakteristike të Gjeçovit. Sipas Budës, në problemet themelore Gjeçovi qëndron në pozicionet e Rilindjes sonë, pavarësisht se disiplina të cilës ai i nënshtrohet si klerik, ia bën atij shumë më të vështirë se rilindësve të tjerë të qëndrojë në pozicione të drejta. "Është e natyrshme që për arsye të disiplinës së jashtme, por edhe të parimeve që ai kishte përvetësuar nga gjithë edukata dhe përgatitja e tij shkollore, Gjeçovi si klerik, nuk mund të çlirohej nga parimet bazë të filozofisë e teologjisë së krishterë. Por, nga ana tjetër, si pjesëtar aktiv e i ndërgjegjshëm i një populli që luftonte për të drejtat elementare, për liri e përparim, ai nuk mund të pajtohej plotësisht me transcendentalizmin metafizik karakteristik për moralin e krishterë. Aleks Buda "zbulon", nëse mund ta qujamë kështu, se Gjeçovi që në mes dy këtyre dy poleve u përpoq të gjente një rrugë kompromisi: Atë të

[1] Aleks Buda, "Sh. K. Gjeçovi 1874-1929, jeta dhe veprimtaria", "Rilindja", Prishtinë, 1986, f, 9.

raportit midis Besimit dhe Atdheut, sepse ai pranonte dhe predikonte se besimi dhe atdhedashuria përbëjnë dy krahët që peshoren e mbajnë në drejtpeshim.

"Kanuni i Lekë Dukagjinit" vepra që e rilindi Gjeçovin

Gjeçovi pas vete la një vaprimtari të bujshme dhe të larmishme. Mirëpo ajo që e bëri të njohur, jo vetëm ndër shqiptarët, por edhe ndër studiuesit e huaj, është mbledhja, vepra që do ta rilind Gjeçovin, duke e radhitur atë në mesin e studimtarëve të parë shqiptarë të së drejtës zakonore, është kodifikimi i të drejtës sonë zakonore, që autori apop kodifikuesi i saj e quajti "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Veprën, pothuajse jetësore të tij Gjeçovi për të gjallë nuk arriti ta botojë si libër, ndonëse disa kapituj të saj ai i kishte botuar në revistën. Vepra në fjalë u botua katër vjet pas vrasjes së Gjeçovit, pra në vitin 1933. Ndonëse në kohën e botimit asaj nuk i bënë jehonë, jehona e saj, përkatësisht kërshëria për rëndësinë e saj do të zgjohet shumë vite më vonë, përkatësisht në vitet -70-të të shekullit të kaluar. Studiues të shumtë, qofshin ata shqiptarë, apo edhe të huaj do të merren me studimin e saj në shumë aspekte, e veçanërisht në aspektrin e fushës juridike. "Kanuni i Lekë Dukagjinit është një vepër unikale me frymë humaniste e periudhës së Rilindjes Evropiane në gjuhën shqipe. Kanuni është Bibla Shqiptare", do të shprehej në një shkrimi të tij **Luigj Shkodrani, kurse** autori i saj, Lekë Dukagjini, nga mikja dhe studiuesja e shqiptarëve Editt Durham është cilësuar "një personalitet imponues" apo nga Hahn si një "hero kombëtar i popullit të vet".

Ndërkaq, prof. dr. Syrja Pupovci, është padyshim një ndër studiuesit që bukur shumë është marrë me veprën jetësore të Gjeçovit, "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Vlerësimet e profesor për këtë vepër fundamentale janë vlerësime të një njohësi të thellë të kësaj vepre me përmasa të patejkalueshme për të gjitha kohët. Sipas Pupovcit përmbledhja e të drejtës sonë zakonore, "Kanuni i Lekë Dukagjinit" e Gjoçovit është një vepër njëkohësisht me materie juridike, ndërkaq autori i saj, pra Gjeçovi një nga "mbledhësit dhe studimtarët e parë shqiptarë të së drejtës zakonore"[2]. Pupovci kur flet për problematikën e literaturës mbi KLD, edhe pse pajtohet me mendimin e të tjerëve që janë marrë me këtë çështje se ajo është realativisht e varfër, megjithatë pohon se "materiali i mbledhur nga KLD, iu bën të mundshme shkencëtarëve shqiptarë dhe atyre të huaj që t'i kushtohen studimit dhe zgjidhjes së problemeve të shumëduershme që lindin nga kjo e

[2] Syrja Pupovci: "Burimet për studimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit", revista "Studime historike", Tiranë 1972, nr. 1, fq. 75-94.

drejtë zakonore".

Ndërkaq, studiuesja ruse, Agnia Desnickaja kur flet për "Disa mendime rreth problemeve linguistike të Kanunit", pohon se me këtë vepër "Gjeçovi ka kryer një punë të madhe duke kodifikuar normat ligjore, që kishin ekzistuar më parë vetëm në tradicionin gojor. Studiuesja në fjalë thotë që tekstin e krijuar nga Gjeçovi nuk duhet paraqitur si një pasqyrim automatik të zakoneve e të normave ligjore të popullit. Pa mohuar cilësinë shkencore të të dhënave të mbledhura nga Gjeçovi, saktësinë absolute të vëzhgimeve të tij, si nga ana etnografike, ashtu edhe nga ajo juridike, që është një nga cilësitë më të theksuara të kësaj vepre, autorja Desnickaja arrin në përfundim se "vepra e Gjeçovit i përket një zhanri letrar mjaft të rrallë, sidomos në letërsinë e kohëve moderne". Përveç rëndësisë së tij shkencore historike e juridike sipas Desnickajës ky tekst paraqet edhe mjaft probleme me një karakter hitoriko-letrar dhe linguisitik.

Ndërkq, studiuesi i letërsisë popullore, Demush Shala, duke u munduar të japë kontributin e tij në vlerësimin për Kanunin e Lekë Dukagjinit të Gjeçovit, duke cituar Ragip Halilin, këtë vepër e konsideron si themel të jurispodencës së Shqipërisë së Veriut, ndërsa për shqiptarët si gjënë më të shenjtë dhe si bazë e të gjitha ligjeve natyrore dhe njerëzore. Demusha Shala veprën "Kanuni i Lekë Dukagjinit" e cilëson si ligj mbi ligjet dhe shenjtëri mbi shenjtëri".

Vepra "Kanuni i Lekë Dukagjinit", përpos botimit shqip, ndër vite e periudha të ndryshme kohore të periudhës së dytë të shekullit të kaluar, pati përkthime edhe në gjuhë të ndryshme të botës. Interesimi për përkthimin e kësaj vepreje, apo më mira ta quajmë të këtij monumenti kulturor dhe dokësor të shqiptarëve vazhdon edhe gjatë këtyre viteve të këtij shekulli. Këtë e dëshmon edhe përkthmimet që vazhdojnë t'i bëhen, si në gjermanisht, italisht e së fundi edhe spanjisht. Ndërkaq vepra është botuar edhe në anglisht, suedish, serbokroatisht e shumë e shumë gjuhë të tjera. Përkthimi dhe studimi i kësaj vepreje, në vazhdimësi, tregon për një dokument të rëndësishëm të etnokulturës shqiptare, në kuadër të të cilës vepre ngërthehen aspekte jetike të popullit shqiptar, që flasin për një lashtësi të rregullimit familjar, shoqëror dhe shtetëror të shqiptarëve gjatë shekujve.

Gjeçovi arkeologu i parë shqiptar

Ndonëse punoi në kushte të vështira dhe pothuajse aspak të favorshme, një ndihmesë të rëndësishme Gjeçovi i ka dhënë edhe arkeologjisë shqiptare. Kudo që punoi dhe veproi ai u mundua të gjurmojë për të zbuluar dhe për të njohur lashtësinë e kombit dhe truallit të tij. Duke qenë mjaft i pasionuar dhe shumë i përkushtuar në këtë fushë, ai u shndërrua në një gërrmues i shpirtit

të popullit të tij. Në artikujt e ndryshëm të botuar nëpër revistat e kohës, ai vë në dukje rëndësinë e madhe arkeologjike që ka Shqipëria, por nuk pajtohet me koncesionet që u jepen të huajve për gërmime arkeologjike. Gjeçovi del haptas kundër të huajve që vijnë në Shqipëri dhe grabisin pasuritë arkeologjike, kundër tregtarëve matrapazë që tregojnë për vlerat e kulturës sonë[3]. Kërkesa e tij e vazhdueshme, qoftë në takime, qoftë në shkrime është për krijimin e një muzeu arkeologjik kombëtar.

"I pari shqiptar që filloi të interesohej për arkeologji qe Shtjefën Konstantin Gjeçovi prej Janjeve. At Shtjefni asht jo vetëm arkeologu i parë shqiptar, por edhe i pari që përpiqet të lëshojë sadopak dritë mbi historinë e ilirëve, me anën e zbulimit të dokumentave të jetës së tyre landore, tue plotësue kështu zbrazëtinat që kemi nga shkrimet e historianëve grekë e romakë", thotë Vili Kamsi në studimin e tij me titull "Fillimet arkeologjike shqiptare dhe kontributi i Shtjefën K. Gjeçov – Kryeziut"[4].

Vlerësimnet dhe epitetet për figurën e Gjeçovit janë të larta dhe nga më të ndryshmet. Ai u vlerësua dhe u quajt "Njeri i penës", "Gardian i dijes"[5], "Shkrimtar i vendosur dhe demokrat"[6], "Njeri i dashur, shkrimtar i vlertë"[78], etj., etj.

Përmbyllje

Kontributi i studiuesve në studimin dhe vlerësimin e veprës së Gjeçovit janë të mëdha. Gjatë këtyre viteve (pothuajse një shekull) është bërë bukur shumë në ndriçimin dhe kompletimin e figurës së këtij krijuesi dhe atdhetari tw shquar, mirëpo ka ende për t'u bërë, sepse veprimtaria e tij letrare, shkencore, arsimore, fetare dhe kulturore në përgjithësi është shumë më e gjerë se sa ajo që njohim ne sot. Shumë vepra të tij nuk janë botuar dhe ruhen nëpër arkiva të ndryshme, qoftë në Shqipëri, qoftë në vende të tjera, ndërsa shumë të tjera madje edhe janë

[3] Rrok Zojzi, Shtjefën Konstatin Gjeçovi / 12 korrik 1874-14 tetor 1929", "Zëri i popullit", Tiranë, 12 korrik 1974, nr 166 (8084), f. 3.

[4] Vili Kamsi " Fillimet arkeologjike shqiptare dhe kontributi i Shtjefën K. Gjeçov – Kryeziut", Buletini Shk. i Institutit Pedagogjik", Shkodër 1966, nr 15, f. 333-336.

[5] Frrok Kristaj - Skënder Zogaj: Njeri i penës dhe i armës, me rastin e takimeve të Gjeçovit 1980, KL "Sh. Gjeçovi", Zym, Prizren, 1980., f. 47.

[6] Andrea Varfi: Shtjefën Gjeçovi shkrimtar i vendosur demokrat dhe antiimperialist", "Drita", Tiranë 21 tetor 1979, f. 12.

[7] Ruzhdi Mata: "Shtjefën Gjeçovi- Jeta dhe vepra", Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1982, fq. 180.

zhdukur. Shpresojmë se një ditë shqiptarët do ta kenë në dorë tërë opusin krijues të këtij dijetari dhe atdhetari të madh.

Literatura

- Kanuni i Lekë Dukagjinit (disa nga botimet dhe ribotimet)
- Syrja Pupovci: "Burimet për studimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit", revista "Studime historike", Tiranë 1972.
- Rrok Zojzi, Shtjefën Konstatin Gjeçovi / 12 korrik 1874-14 tetor 1929", "Zëri i popullit", Tiranë, 12 korrik 1974.
- Vili Kamsi " Fillimet arkeologjike shqiptare dhe kontributi i Shtjefën K. Gjeçov – Kryeziut", Buletini Shk. i Institutit Pedagogjik", Shkodër 1966, nr 15, f Gjeçovi", Zym, Prizren, 1980, f. 47.
- Andrea Varfi: Shtjefën Gjeçovi shkrimtar i vendosur demokrat dhe antiimperialist", "Drita", Tiranë 21 tetor 1979, f. 12.
- Ruzhdi Mata: "Shtjefën Gjeçovi- Jeta dhe vepra", Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1982, fq. 180.
- Frrok Kristaj-Skënder Zogaj: Njeri i penës dhe i armës, me rastin e takimeve të Gjeçovit 1980, KL "Sh. Gjeçovi", Zym, Prizren, 1980., f. 47.

PhD Melihate ZEQIRI

KONTRIBUTI I AKADEMIK IDRIZ AJETIT NË KONSULTËN GJUHËSORE TË PRISHTINËS

Hyrje

Akademik Idriz Ajeti është njeri që ia kushtoj gjithë jetën e tij gjuhës shqipe dhe përkrahës i fuqishëm i gjuhës së njësuar. Ne do të trajtojmë çështjen e planifikimit të gjuhës, rëndësin e unifikimit të gjuhës letrare, mospajtimet e akademik I. Ajetit, vërejtjet lidhur me rregullat e parapara, sidomos lidhur me përdorimin e zanorës *ë*, njësimin e drejtshkrimit, afrimin e varianteve letarare të gjuhës sonë të shkruar dhe dallimet me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare. Qendrimet e tij, që nuk i mohonte ndikimet e mëdha të faktorit politik të një populli në zgjidhjen e gjuhës letrare.

Akademik Idriz Ajeti me vështrimet e tij pozitive e konvergjente në historinë e formimit e të zhvillimit të shqipes letrare shtroi rrugën për vendimin historik të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës 1968, *Një komb- një gjuhë letrare kombëtare!*

Formulimet themelore të paraqitura nga Ajeti në Konsultë ishin: *njësim i drejtshkrimit, afrim i varianteve letrare të gjuhës sonë të shkruar dhe dallimi eventual me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare.* Të themi se fjalinë e cituar më sipër nga referati i Ajetit nuk e gjejmë të riprodhuar në botimet e mëvona të referatit në fjalë. Natyrisht, ai është mbështetësi më i flaktë i shqipes së njësuar letrare.

Mospajtimet e Idriz Ajetit

"Ka te një kategori e vogël intelektualësh një grimë nostalgjie për faktin që në rrethanat e reja në njëfarë mënyre kanë qenë të shtrënguara të heqin dorë nga përdorimi letrar gegë. Edhe ne dhe shumëkush e ndiejmë një mallëngjim, por vetëm kaq! Do ta ketë ndier edhe vetë shkrimtari i madh kroat Miroslav Kërlezha, për çka poezitë më të fuqishme e më të bukura i shkroi në kajkavishte. Por, ndonjë hap në drejtim të tërheqjes nga rruga e gjuhës letrare kroate as që i shkoi ndonjëherë mendja." – Idriz Ajeti

I lindur në vitin e Komisisë Letrare Shqipe të Shkodrës (1917), një ngjarje për formimin e gjuhës së përbashkët letrare që radhitet me Kongresin e Manastirit,

profesor Idriz Ajeti vjen me një bagazh veprash me peshë të shënueshme shkencore në fushën e albanologjisë e të ballkanologjisë. Emri i tij është bërë sot klasik në degëzimet e shumta studimore albanistike si njëri nga studiuesit më të rëndësishëm të tyre, e sidomos në formimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe, ku ka dhënë kontribute të pallogaritshme.

Në artukullin "A ka gja ma punë n'ortografin e gjuhës shqipe?" I. Ajeti bënte vërejtje lidhur me rregullat e parapara të drejtshkrimit të propozuar, sidomos lidhur me përdorimin e zanores **ë** (Ajeti 1958: 471)

Ajeti nuk ia mohonte demokratizmin rrugës që është ndjekur këtu, por theksonte faktin se vendimet ishin marrë pa u pasë bërë paraprakisht studime gjuhësore e drejtshkrimore. "E në rasë se nuk kemi ndie nevojën e shqyrtimit të këtyne problemeve, atëherë duhej të hajshim arsye e të pranjoshim shkoqitjet e dhanuna prej tjetërkuj mbi këto çashtje" (Ajeti 1958: 473)

Vërejtja lidhur me Mbledhjen e vitit 1957 të Prishtinës shpjegohej si vijon: "Kam përshtypjen se vendimet e marruna, ma mirë rekomandimet e dhanuna në mbledhjen e mbrame në Prishtinë u nxorën mbasi u miratuen prej nji vargu të tanë pjesëmarrësash, shumica e të cilëvet atypëraty morën qëndrim mbi çështjet që po bisedoheshin, pa qenë të vaditun në probleme, orientimit të të cilavet i dilshin zot shpeshherë me gjithë shpirt e energji" (Ajeti 1958: 273). Pasi të ketë konstatuar se drejtshkrimi i shqipes mbështetet kryekreje në fonetikën e saj, se disa të folme gege "fonetikisht qëndrojnë sod bukur larg nga ortografimi zyrtar i shqipes", ai pohonte se "as kosovarishtja nuk mund të mirret për themel të gjuhës letrare zyrtare te na" (Ismajli 1998: 161)

Zgjidhja për I. Ajetin qëndronte tek e folmja "fytyra fonetike e së cilës asht, pak a shum ma e pastër e ma e përgjithshëme". I. Ajeti bënte vërejtjen për mungesën e mbështetjes shkencore të studimthit të botuar te "Përparimi" 1957/3 dhe 7-8, pa e treguar autorin e tij. Duke kundërshtuar shpjegimet për arsyen morfologjike e tjetër të shkrimit të propozuara në "studimthin" e S. Drinit, ai pranonte një mbështetje për të: "Na besojmë se për të përligjë drejtëshkrimin e derivateve *udhtim, udhtue, mir-si, mbarsi* e tanë kategorinë e tyne, do të mjaftonte të theksohej fakti tashma i njoftun se vokali i reduktuem i pjesëvet të parme *udhë, mirë, mbarë,* nuk ka ... kurrfarë zyre fonetike, prandaj, vetëm nga kjo anë mund të tolerohet ortografimi *mirsi, mbarsi, udhtim*, e kurgja tjetër."

Ortografia e Prishtinës e vitit 1964 në shumë elemente shkonte në hap me atë Ortografi, duke filluar nga mbarështrimi i lëndës, e deri te zgjidhjet e ndryshme konkrete. Fundja, diçka e tillë dhe kuptohej, po të kemi parasysh se jo më larg se më 1958 vetë kryetari i Komisionit për hartimin e kësaj ortografie kishte shënuar: "na besojmë se rrugën e përpilimit të ortografisë së gjuhës shqipe

te na, mund ta shkurtonte Ortografija e gjuhës shqipe e Institutit të Tiranës, pse një numër i madh problemesh drejtshkrimore do të pranohej prej nesh, atëherë do të mbetej për t'u bisedue vetëm mbi pikat e kontestueshme". Dhe këtë ai e thoshte madje në një kontekst mjaft kritik: "E në rasë se nuk kemi ndie nevojën e shyrtimit të këtyne problemeve, atëherë duhej ta hajshim arsye e të pranojshim shkoqitjet e dhanuna prej tjetërkuj mbi këto çashtje" (Ajeti 1958: 473). Është e qartë se ndërkohë mjaft gjëra kishin ndryshuar, kishin ardhur edhe njerëz të tjerë, vetë anëtarët e Komisionit me siguri tashmë "e kishin ndie nevojën e shqyrtimit të këtyne problemeve" dhe kishin arritur edhe përfundime të caktuara (Raka 1997: 201-209).

Dy Ortografitë, pas gjithë kësaj pune paraqesin mjaft ngjashmëri në vijat kryesore të gjetjes së zgjidhjeve. Dhe pikërisht ky element është shumë i rëndësishëm për zhvillimet e mëtejme në fushë e standardizimit të shqipes: në punën e normëzimit të gegërishtes nuk ndiqej më ndonjë vijë që nuk do ta merrte parasysh ekzistencën e edhe një varianti të shqipes, e as nevojën e gjetjes së zgjidhjeve sa më të afërta. Përkundrazi, gjithë duke i ruajtur dallimet themelore, theksohehsin në mënyrë tacite elementet e ngjashme, të afërta apo të njëjta. Në këtë kuptim kjo Ortografi i hapte rrugën të menduarit që do të vinte 4 vjet më vonë në këtë fushë: njësimit të drejtshkrimit të shqipes, çka u shoqërua edhe me një tjetër element – këmbënguljen e opinionit për të bërë njësimin e shqipes letrare në tërësi, pra jo vetëm të drejtshkrimit.

Konsulta gjuhësore 1968

Nga mesi i muajit prill të vitit 1968 "Rilindja" pa shumë zhurmë i njoftonte lexuesit e vet se së shpejti një temë e rëndësishme gjuhësore do të diskutohej në Prishtinë (Rrecaj, 1968). Me 18. 4. 1968 në faqen 10 nisi të botohej në vazhdime teksti i I. Ajetit "Rruga e njësmit të shqipes letrare". Këtij teksti, referat në mbledhjen ku do të diskutohet çështja e përmendur, i paraprinte një shënim i shkurtër i redaksisë, në të cilin lexuesi njoftohej lidhur me "Projektin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe" të hartuar nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Universitetit të Tiranës më 1967, për të cilin po bëhej diskutim publik; në këtë diskutim po merrte pjesë "Rilindja" me botimin e projektit në faqet e saj më parë dhe me botimin e ndihmesave të tjera për këtë çështje. Me këtë qëllim e në këtë frymë redaksia njoftonte se po e botonte referatin e I. Ajetit (Rilindja 21. 4, 15 dhe 22.4.8).

Ditën kur i filloj punimet Konsulta për gjuhën, "Rilindja" botonte referatin e I. Ajetit në faqen 8. Në fund të këtij vazhdimi të referatit të profesor Ajetit mund të lexohej: "Njësimi i drejtshkrimit në stadin e sotëm, paraqet pas

mendimit tonë hapin vendimtar për punën e afrimit të varianteve letrare të gjuhës sonë të shkrimit". Në qoftë se duem t'i ruejmë dy variantet e gjuhës sonë letrare, të gjuhës sonë të shkrimit, ato sot mund të na dalin të afrueme në një shkallë të madhe, sa të sillen në to dy tipare dalluese: nazalizmi i vokaleve i njenit, dhe rotacizmi i tjetrit". (Ismajli, 1998:177) Më tej ndër tipare të tilla ai përmendte çështjen e vokalit **ë**, dallimet e diftongjeve **ue/ua** dhe participin, që "toskënishtja e ka të plotë, ndërsa gegënishtja të cunguem". Dhe përfundonte: "Na menojmë që Kuvendimi ynë këtë çështje duhet ta shtrojë e t'u drejtohet letrarëve, gazëtarëve dhe të gjithë atyre që variantën e gjuhës së shkrimit ta shpien në përdorimin me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare" (Po aty, 178)

Formulimet kyçe të I. Ajetit në referatin e paraqitur në Konsultë ishin: *njësim i drejtshkrimit, afrim i varianteve letrare të gjuhës sonë të shkruar dhe dallim me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare*. Formulimi i fundit madje lente përshtypjen e një parregullsie që mund të jetë pasojë e ndërhyrjes apo shkurtimit kush e di për çfarë arsye. Për zhvillimin e ideve dhe të debateve në këtë fushë e vlen të theksohet se në rimarrjet e pastajme të këtij referati, fjalia e fundit që u citua këtu më nuk figuronte, ashtu siç nuk figurojnë dhe disa pika të tjera referimesh apo diskutimi. (Ajeti 1972: 105)

Nuk mund të mos hetohet po ashtu se, megjithë frikën me të cilën po e shtronte propozimin për afrimin sa më të madh të dy varinanteve të gjuhës letrare (të kemi parasysh përvojat e viteve '57-58), profesor Ajeti synonte njësimin e tyre në të gjitha fushat e tjera, pos në dallimet e prodhuara me kompleksin nazalizëm/rotacizëm. Mirëkuptimi dhe kërkesa që shtronte opinioni në Konsultë ia shtonin atij bindjen për nevojën e njësimit përtej vështirësive të realizimit të menjëhershëm, për të cilat ai ishte më i vetëdijshëm se të tjerët.

Me 24 prill 1968 "Rilindja" po në faqen e parë botonte artikullin "Shqipe letrare e ortografi unike", me mbititull "U dha fund punimeve Konsulta për njësimin dhe ortografinë e shqipes letrare" (Ismajli 1998: 181), dhe me nëntitull "Në projekt nuk ka divergjenca esenciale të dy dialekteve". Qysh në tituj dhe në mbitituj këmbëngulej në formulimin "Konsulta për njësimin dhe ortografinë e shqipes letrare", ndërsa në brendi i mëshohej më shumë shpjegimit se as në projektin e ortografisë të vitit 1967 dhe as në realitet nuk ka dallime shumë të mëdha dhe esenciale midis dialekteve të shqipes dhe varinateve letrare përkatëse, çka në fakt ishte çështja kryesor për specialistët e gjuhës të pranishëm aty apo kudo gjetiu. A. D. Jasiqi ndër të tjera raportonte: "... Kujdesi ma i madh në këtë tubim iu kushtue çashtjes së njësimit të gjuhës letrare si nevojë të domosdoshme dhe të kohës, për çka u shprehën pa rezervë të gjithë pjesëmarrësit tue vue në dukje se tashma janë pjekë të gjitha kushtet për marrjen e nji hapi të këtillë, pa

marrë parasysh vështirësitë që mund të dalin në këtë drejtim". (Po aty, 181)

Në vijim të raportit në faqen 5 të gazetës njoftohej se I. Ajeti kishte diskutuar në frymën që do të përkrahte vërejtjet konkrete për projektin e ortografisë, sepse vërejtjet nuk e cenojnë atë. Kështu raportimi në gazetën "Rilindja" lidhur me Konsultën gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968 na e bën të mundshme të nxjerrim disa përfundime.

1. Konsulta Gjuhësore e mbajtur më 1968 në Prishtinë ishte diskutimi i parë ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë për çështje të planifikimit të gjuhës që po mbahej vetëm nën përkujdesjen e institucioneve shkencore-kulturore.
2. Megjithatë, bie në sy se i tërë diskutimi po zhvillohej në frymën e trimërimit gjithnjë e më të hapur të bashkëpunimit kulturor (dhe tjetër) midis shqiptarëve të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, midis dy shteteve (në këtë kuadër edhe të Kosovës e të shqiptarëve).
3. Dyshimet dhe frikën e ekspertëve, po edhe të opinionit, që shihet në kujdesin me të cilin hapej tema nga gazeta, në formulimet e veçanta deri në ditën e fillimit të Konsultës, i rrafshonin referati i botuar paraprakisht i I. Ajetit dhe fjalimi i hapjes i F. Aganit...
4. Disa politikanë shqiptarë të Kosovës e shfrytëzuan rastin për t'i dhënë edhe një shtysë tendencës së përgjithshme drejt afrimit ndërshqiptar; F. Hoxha në këtë punë delte më shumë se një nga më të interesuarit, pavarësisht se nuk mund të ishte shumë në rrjedha me çështjet e gjuhës.
5. Konsulta gjuhësore e Prishtinës e mbajtur më 1968, vetëm dy vjet pas përfundimit të epokës së regjimit më të egër shtypës antishqiptar të Rankovic-it, theksonte fare natyrshëm nevojën që kishin shqiptarët e Kosovës dhe të Jugosllavisë për të treguar identitetin e tyre kombëtar shqiptar, njësinë kombëtareme shqiptarët përtej kufirit, prej të cilëve i kishin ndarë padrejtësisht dhe pa vullnetin e tyre.
6. Siç ka vërejtur Janet Byron, kjo Konsultë i detyroj zyrtarët dhe të tjerët në Shipëri që tash e tutje për çështje të gjuhës të mendonin jo vetëm në suaza të shtetit të tyre, po në suaza të kombit shqiptar.

Ndër intelektualë, veprimtarë të kulturës, studiues, po edhe politikanë të shquar në Kosovë, në saje të përvojës së deriatëhershme, ishte krijuar bindja se në fushë të gjuhës interes me rëndësi kombëtare ishte afrimi dhe njësimi me pjesën tjetër të kombit, duke i dhënë përparësi me këtë rast në radhë të parë asaj që ndyshe quhet "luftë për gjuhën" dhe duke lënë që "lufta në gjuhë", brenda gjuhës, të bëhej në kohë të tjera, apo dhe të mos bëhej fare. (Ismajli 1998:189)

Shënimet e para pak më të plota për zhvillimet në fushën e normimit të shqipes letrare te shqiptarët e ish-Jugosllavisë, sa kam parë, në Tiranë jepeshin publikisht në Kongresin e Drejtshkrimit të mbajtur më 20-25 nëntor 1972 në

Referatin e Idriz Ajetit (Ajeti 1973:109-118) Në referatin e Androkli Kostallarit në Kongresin e Drejtshkrimit theksohej në mënyrë të veçantë fakti se të shqiptarët e Jugosllavisë "në të gjithë veprimtarinë shoqërore, arsimore, kulturore e shkencore, ndër të tjera edhe në gjinitë e ndryshme të letërsisë artistike, përdoret pothuajse pa përjashtim gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë dhe drejtshkrimi i saj në bazë të vendimit të konsultës së gjerë shkencore të Prishtinës që u mblodh në prill të vitit 1968".

Gjurmues i shqipes

Akademik Idriz Ajeti i pasionuar për ta gjurmuar fjalën shqipe dhe i paepur kundruall furtunave antistandarde, ai vazhdon të japë kontribute të reja dhe të jetë një gjurmues i papërsëritshëm i shqipes në thellësinë e mendimit dhe akribinë shkencore.

Përkujdesja e vazhdueshme për shqipen standarde, rrahja e problemeve me të cilat përballet praktika jonë gjuhësore në zbatimin e normave në të gjitha sferat e komunikimit publik, dhe gjetja e zgjidhjeve të drejta përkatëse – këto kanë qenë fushat në të cilat prof. I. Ajeti ka punuar një shekull jete. (Murati 2015:15)

Gjykimet e tij largpamëse, me të cilat u jep udhë problemeve të shumta të koklavitura të gjuhës letrare, prof. I. Ajeti i ka thellësisht të argumentuara, sa që atyre është vështirë t'u heqësh apo t'u shtosh ndonjë presje edhe nga perspektiva e gjendjes së sotme.

Edhe metagjuha e veprës së I. Ajetit është një model sesi duhet të shkruhet shqipja standarde apo shqipja shqip. Ajo është e shkruar me një fjalës të përzgjedhur, me gramatikë në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale dhe me sintaksë model, që të tërheq për ta lexuar deri në fund. Askush nuk e ka shkruar shqipen më mirë se ai.

Literaturë

- Ajeti, I. *Rruga e njësimit të shqipes letrare*, Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj, I, 1972 Tiranë.
- Ajeti, I. *Rruga e njësimit të shqipes letrare në Kosovë*, Studime filologjike, I, 1978 Tiranë.
- Ajeti, I. *Çështje të gjuhës letrare shqipe*, Studime gjuhësore IV, Rilindja, 1989 Prishtinë.
- Ismajli, R. *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, 1991 Prishtinë.
- Ismajli, R. *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë",* 1998 Pejë.
- Ismajli, R. *Standarde dhe identitetet*, Dukagjini, Pejë 2003.
- *Ortografia e gjuhës shqipe*, 1964, (Komisioni: dr. I. Ajeti, kryetar; dr. P. Janura, S. Drini, H. Vokshi, M. Bardhi, I. Mulaku, M. Isaku, Xh. Gega dhe L. Lucaj), Beograd, 66.

PhD (cand) Fitim VELIU

LETËRSIA SHQIPE:
PERSPEKTIVA SOCIALE SIPAS ARSHI PIPES

Historia e letërsisë shqipe, në vijimësi është shkruar dhe provuar në diskursin e saj të argumentimit drejt një periodizimi të saj si *shpirt në kërkim të trupit të vet*. Kjo histori shkrimi dëshmon përpjekjen e studiuesve shqiptarë për të identifikuar autorë, vepra, tema, stile, metoda, mënyra dhe diskurse për të provuar se letërsia shqipe ka krijuar një identitet të saj përgjatë historisë së shkrimit nëpër periudha të ndryshme kohore.

Studiuesit e letërsisë shqipe kanë dhënë teskte të historisë letrare, të natyrës së kësaj letërsie, si temë, metodë historiko-letrare, stile individuale e diskurse letrare. Natyrisht, shkrimi i historisë së letërsisë shqipe është sprovuar edhe si histori e kritikës. Rugova, është autori themelor në shkrimin e historisë së kritikës shqipe me tesktin *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqipe* (1504-1984) e cila ka synuar të krijojë shkrimin e letërsisë së kritikës shqipe. Studiuesit e letërsisë shqipe, të cilët janë marrë me shkrimin historisë së letërsisë shqipe kanë provuar të krijojnë një pamje të letërsisë, qoftë si metodë letrare ose qark letrar. Shkrimi i historisë së letërsisë shqipe, deri më tani ka prodhuar variante nga më të ndryshmet. Eqrem Çabej, ka prodhuar një tip historie që njeh kriterin dallues të qarkut letrar, pra letërsie e shkruar sipas qarkut letrar; Arshi Pipa, i cili e provon shkrimin e historisë së letërsisë si perspektivë sociale. Ai mendon se shkrimi i letërsisë, si fillim e përfundim është *letërsi fshatarake*. Provën e shkrimit letrar në këtë domen e kanë dhënë edhe autorë të tjerë shqiptarë, si Justin Rrota me veprën *Letratyra Shqype* (1925); Dhimitër Shuteriqi *Historia e letërsisë shqiptare nga fillimi e deri të Lufta Antifashiste*; Rexhep Qosja me tekstin *Periodizimi i letërsisë shqipe* (1979) dhe Romantizmi I, II dhe III; Gaetano Petrota, studiues italian me veprën *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare* (1931). Të gjitha këta studiues këta studiues kanë si kriter përcaktues kohën, si periodizim e përcaktim të letërsisë, pastaj diku monografia, e cila nuk arrin të krijojë histori, por më tepër të dhëna, evidentime e më pak përkime letrare. Një sistematizmi të shkrimit të historisë së letërsisë shqipe që shkon drejt një poetike shqipe e ka shkruar Sabri Hamiti, i cili nëpërmjet një rrjeti tekstesh si sprova që i bën edhe prova arrtin të

krijojnë një pamje të historisë së letërsisë shqipe. Tekstet e e Hamitit ndjekin një rend që synon shkrimin e letërsisë si histori të një monumenti letrar, duke synuar paralelisht që letërsinë si histori ta krijijë aposteriori teorive letrare, strukturave drejt një poetike letrare shqiptare. Tekstet që e provojnë këtë diskurs janë: *Kodet e mëdha të letërsisë shqipe* (1979); *Monumentet e kulturës së identitetit* (2000); *Shkollat letrare shqipe* (2004); *Tematologjia* (2005); *Studime letare, Albanizma*, etj. Kritiku letrar Kujtim Shala, dy tekstet e studiuesit të letërsisë Sabri Hamiti *Albanizma dhe Tematologjia* "janë vepra që thurin Poetikën historike të shqipes si rezultat të kërkimit të shtrirë në disa dekada te *Sprovat për një poetikë*"[1]. Në këtë punim seminari, shenjë themelore e punës sime do të jetë teksti i studiuesit Arshi Pipa, *Letërsia Shqipe: Perspektiva Sociale (*2013). Libri është i shkruar dhe strukturuar në ese të ndryshme që synojnë krijimin e një trupi letrar brenda kërkimeve personale të ndara në tema të ndryshme. Ky tekst ka në brendi gjashtë ese që emërtojnë tituj kërkimi, kurse në brendi të secilit titull variojnë disa mikrotituj që bartin nëntema të temës kryesore. Libri hapet me gjashtë ese të ndryshme për nga tema dhe struktura e saj, kurse në vijim do të flasim në vija të përgjithshme:

1. Ethosi dhe Ethnosi në traditën letrare arbëreshe (origjina shqiptare e shpirtit helen në Italinë Jugore; kërkimet për origjinën e gjuhës, personazhet e veprave të De Radës; vështrime etnogjuhësore të poezisë shqiptaro-kalabreze).
2. Barinj dhe katundarë në letërsinë shqipe. Në këtë pjesë Pipa argumenton këtu ekzistencën e letërsisë fshatare përballë qytetit dhe letërsinë përballë folklorit; dervishët fshatarë dhe tradita bektashiane; bariu luftëtarë dhe tradita françeskane, etj.
3. Miti i perëndimit në poezinë e Migjenit (Shpirti sllav që flet shqip; poezia Dekadente; apoteoza e revolucionit; gramatika e huaj e poezisë *Kanga e Përndimit).*
4. Fshatari në Letërsinë bashkëkohore (Letërsia përballë politikës dhe politika e letërsisë; realizmi socialit; vendi dhe toka në poezinë e shkrimtarëve më të rinj; poezia e mërgimit).
5. Sociologjia e letërsisë shqipe.
6. Periodizimi i letërsisë shqiptare.

Letërsia amë dhe tradita arbëreshe

Ekzistencën, lindjen e letërsisë shqipe, Arshi Pipa e sheh në traditën e arbëreshve të Italisë, të cilët kishin emigruar në tokën e huaj, si pasojë e rrethanave

[1] Kujtim M. Shala, *Analepsa*, Fondacioni *Ibrahim Rugova*, Prishtinë, 2013, f. 612-613

politike në vendin e tyre. Pra, tradita letrare shqiptare, është traditë e arbëreshve të Italisë. Sipas Arshi Pipes, Letërsia e arbëreshve të Italisë e ka gjenezën tek *pasardhësit e shqiptaro-grekëve që emigruan nga Epiri dhe Morea në Italinë Jugore, gjatë gjysmës së dytë të shek. 15-të*[2]. Dhe, meqë letërsia arbëreshe është letërsi e shkrimtarëve arbërehsë bizantinë, madje të priftërinjve bizantinë, kjo teori e prodhon edhe një paradigmë të letërsisë shqiptare, që jep ekzistencën e fundit të shpirtit helen *sub specie albanensi*[3] në Itali. Letërsia e shkrimtarëve shqiptarë, nga tradita arbëreshe siçiliane, në artin e saj kishte ngjyrime të fetaritet bizantin, për ta lënë në plan të dytë elementin etnik. Nga këta shkrimtarë, siçilinaë, të cilët në shkrimet e tyre kishin përdorur qoftë alfabetin grek ose shkrimin përkushtues ndaj kësaj kulture, janë Nikollë Keta, i cili kishte shkruar një ode për Katerinën e Madhe, ishte shkarkuar për shkak të *simpatisë proruse të tij*[4]*;* Dhimitër Kamarda, në shkrimet e tij përdorte alfabetin grek, kurse autori Xh. Krispi, kishte shkruar një himn ndaj shpirtit grek. Vargjet e jepin një diskurs të përqafimit dhe dëshmimit të lashtësisë së grekëve, nëpërmjet diskursit mitologjik:

Edhe një herë këtu u dëgjua emri i ngulmimeve greke.

U dëgjoftë gjuha e zotave sërish

Në truallin e Trinakërisë së bukur.[5]

Kurse tradita e letërsisë së arbëreshve kalabrez, ndonëse ka një karakter më të pa ndikuar nga kleri, përsëri ruan një frymë helenike lidhur me origjinën e saj bizantine. Shkrimtarët arbëresh siç i quan Arshi Pipa të kontinentit, përfaqësojnënjë traditë letrare më etnike, shqiptare, duke pasur në brendi elementin e etnik, gjuhën, heroin e kulturën. De Rada kishte krijuar artin e tij në të cilën domojnë tri gjinitë letrare: lirika, epika e dramatika. Por, sipas A. Pipes, krijimi i tij më i mirë është vepra *Milosao (1836),* një krijim ku shihen ëndrrat e tij prej një të burgosuri në imagjinatën e vet. *Milosao*, është vepër ku shihen shenjat e tij autobiografike, vepër ku *ndjenjat erotike përzihen me kujtimet epike*[6]. Kurse vepra *Skënderbeu i pafan* me synimin që të ishte një epikë kombëtare rrëshqiti në shënime mbi fatin dhe fatalitetin e autorit, pra një vepër që flet për dështiemt e tj prej politikani e dashnori. Vepra *Autobiologjia,* në të cilën De Rada e sheh njeriun ideal, në të cilin bashkohen të gjitha virtytet, kurse A. Pipa, lidhur me këtë vepër thekson:

[2] Arshi Pipa: *Letërsia shqipe: Perspektiva Sociale*, Princi, Tiranë, 2013, f. 13.

[3] Po aty, f. 14

[4] Po aty, f. 16

[5] Po aty, f. 16

[6] Po aty, f. 20

Autobiologjia është më tepër një panagjerik se sa një apologji, një gjeni që bashkon poetin dhe studiuesin, një vepër poetike me qëllim që të "edukojë" kombin e tij me idealet e larta jetësore[7].

Letërsia shqipe si produkt i fshatarësisë

Letërsia shqipe, ndryshoi formën dhe mënyrën e konceptimit të saj pas rënies së Shqipërisë nën sundimin turk. Në këtë rast, jo vetëm gjuha, por edhe letërsia mori një ndikim evident nën ndikimin e strukturës së sistemit. Gjuha dhe letërsia, tani në këtë kohë u shkrua me tri alfabetet latin, grek dhe arab. Poezia orientale, *bejta*, filloi të përdorej në poemat epike dhe satirike, e paqenë më parë si prani në letërsinë tonë. Sipas Arshi Pipes, shumica e shkrimtarëve shqiptarë kanë prejardhje nga katundi. Pipa jep një renditje interesante të këtyre shkrimtarëve që nga shfaqja e tyre në letërsinë shqipe. Pipa, në vijim elementin e Fshatarësisë e nxjerr nëpërmjet kësaj ndarje: *Autorët katolikë të shek. XVI-XVII (Buzuku e Budi) ose studentët e Propagandes Fide (Bardhi e Bogradi), kurse poetët më të mëdhnj toskë Kamberi e Nezim Frakulla. I pari fshatar nga prejardhja, i dyti ruan mbiemrin nga fshati. Edhe arbëreshët, si: De Rada, Serembe, Figlia, Santori janë me prejardhje fshatare. Poashtu, letërsia toske e Rilindjes është brum nga shkrimtarët mërgimtarë të lindur nga familje timariotësh të rënë nga koha (vëllezërit Frashëri, Naimi dhe Samiu), Çajupi, Noli dhe Asdreni. Autorët gegë të së njëjtës periudhë ishin qytetarë (Pashko Vasa, Shiroka, Gurakuqi, Mjeda), por autori më i madh i kësaj kohe, Fishta kishte lindur si fshatar i thjeshtë*[8]. Letërsia e Mesluftës (1912-1944) sipas autorit është borgjeze dhe mikroborgjeze (Asllani, Koliqi, Poradeci, Kuteli, Haxhiademi, Kokona, Kokalari, Stërmilli), kurse pjesa e saj fshatarake është fare e vogël. Letërsia bashkëkohore, sipas A. Pipes është prodhim i shkrimtarëve qytetarë (Shuteriqi, Siliqi, Gjata, Kadare), kurse një pjesë është edhe nga fshati (Marko, Agolli, Shkreli). Letërsia shqipe është ndërtuar mbi traditën folklorike, qoftë në modelet e saj stilistike dhe ato të metrikës folklorike. Në këtë mes, Pipa i referohet dy autorëve shqiptarë, Fishtës dhe Naimit, të cilët i sheh si romantikë, ku poezia e tyre ka një mbindërtim të theksuar nga tradita e poezisë gojore. Folklori si model mbi të cilin është ndërtuar letërsia shqipe, është përdorur nga tabori i shkrimtarëve jo vetëm fshatar, por edhe ata qytetarë, sepse sipas Pipes "Në Shqipëri nuk ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë dallim mes fshatit dhe qytetit"[9]. Të gjithë shkrimtarëve shqiptarë folklori u ka shërbyer sikur

[7] Arshi Pipa: *Letërsia shqipe: Perspektiva Sociale*, Princi, Tiranë, 2013,, f. 22

[8] Po aty, f. 84

[9] Po aty, f. 85

një lloj lënde e parë për ndërtimin e veprave të tyre. Duke bërë një analizë të pranisë së personazhit fshatar në letërsinë shqipe, pra, përgjithësisht në veprat e tyre. Që nga De Rada, Santori dhe Variboba, ku në veprat e tyre i kemi të pranishëm këta tipa: *bujku gjysmatar dhe komiti*[10]. Vepra e Varibobës *Gjella e Shën Mërisë Virgjër* (1762), do t'i shërbej autorit për të parë lidhjet e saj me folklorin, por edhe temën edhe temën dhe personazhet rreth të cilave ngjizet kjo vepër. Kjo vepër ka në brendi plaçkitjet e katundarëve dhe barinjve në Kalabri. Pipa e sheh këtë vepëpër të parën në letërsinë shqipe sa i përket artistikes. Në brendi, kjo vepër ka poema fetare, të cilat zbulojnë hapur se autori ishte një partizan i hapur i kishës romane. Dhe qëllimi i kësaj vepre ishte konvertimi i grave ortodokse në katolicizëm, sepse vepra shpartallon çdo lloj nderimi për fenë ku fshatarët ngriten kundër kishes si mashtrim dhe që kjo kishë rrethohet me të pasurit dhe të fuqishmit. Sipas Pipajt, *Letërsia arbëreshe është krejtësisht fshatarake*[11], e ndërtuar mbi brumin folklorik të traditës. Kjo letërsi është e ndarë në shkrimtarë shqiptaro-kalabrezë (Variboba, De Rada, Santori, Serembe) dhe shqiptaro-siçilianët (G. Dara, Skiroi). Te parët i karakterizon romantizmi demokratik, të dytët ai aristokratik. Letërsia e romantizmit shqiptar është shkruar mbi domenin fshataresk. Përfaqësuesi i kësaj letërsie, Naim Frashëri shkroi poemën bukolike, baritore "Bagëti e Bujqësi (1886), në të cilën barnj dhe katundarë shfaqen në skenën letrare toske. Fshati, në këtë vepër përshkruhet në mënyrë idilike dhe sipas studiuesit Arshi Pipa, "kjo lloj idilike shfaqet midis Virgjilit dhe Arkadias"[12]. Pipa, bariun luftëtar e sheh edhe në traditën e shkrimit françeskan, kurse françeskanizmi erdhi në Shqipërinë e Veriut nga misionarë të huaj, të cilët ishin urdhër lypsarësh, kurse malësorëve u kryenin shërbesa fetare, por kjo strukturë do të ndërroj në fund të shek. XIX, ku pjesa më e madhe e françeskanëve do të jenë me prejardhje fshatarake shqiptare. Përfaqësuesin më të madh të kësaj tradite Pipa e sheh Fishtën, fshatar për nga origjina. Vepra e tij *Lahuta e Malcis* e mbështetur në traditën folklorike por që ka një lidhje me traditën folklorike kroate të modelit Mazhuraniq, si frymë. Fishta lexonte poetët kroatë, vepra e të cilëve mbështetej në frymën e këngëve folklorike. Vepra e Fishtës, *Lahuta e Malcis*, në meqenëse është shkruar në një periudhë të gjatë kohore, brenda nuk e ka të njëjtën frymë sipas këngëve. Nëse lexohen me kujdes këngët, nxjerrim shumë lehtë mendimin se këngët e veprës para shpalljes së pavarësisë kanë një frymë antisllave, pas pavarësisë edhe antiturke. Sipas Pipes, "elementi subjektiv i Fishtës është sllavofobia[13]:

[10] Arshi Pipa: *Letërsia shqipe: Perspektiva Sociale*, Princi, Tiranë, 2013, f. 87

[11] Po aty, f. 95

[12] Po aty, f. 99

[13] Po aty, 103-104

Un shqyptar, ata janë shkje

Ne na ndan nji gjak e i fe:

N'mni t'sho shoqit kemi le:

Kem ndërmejt i gjak e i dhe.

Kurse në vëllimin e tretë të veprës *Lahuta e Malcis*, armiq janë pos sllavëve edhe turqit. Kjo do të kishte qenë një përgjigje e kërkesave të zyrtaritetit nacionalist. Koha e krijimit të veprës së Fishtës nuk e ka të njëjtën fuqi dhe frymë shkrimit gjatë kohës së krijimit. Pas një pauze prej 14 vitesh, pas viteve 30 fryma epike në këtë ep nacional u la jashtë letërsisë së tij, këtë e dëshmon edhe kënga e XXVI "Kohë e re".

Rimendimi letrar si konstrukt subjektiv

Letërsia shqipe ka qenë fillim e mbarim një produkt e konstrukt politik, një lidhje varshmërie edhe si ndikim, por edhe si krijim, madje këtë konstatim mendimi e ka edhe Arshi Pipa, i cili thotë *se ka qenë e pandarë nga politika*[14] . Letërsia si krijim që italianët e quajnë *litterato*, nuk ka *ekzistuar asnjëherë në Shqipëri*[15], thotë Pipa. Edhe ata shkrimtarë që pretendojnë se kanë qenë ose janë larg ndikimit politik, prapë se prapë janë të zhytur në etnocentrizëm. Letërsia shqipe ka në bredi fryëm epike, qoftë si mungesë e saj ose si kërkesë për përthithje të këtij ilaçi jetik. Prania e elementit social, në letërsinë shqipe, është vënë më shumë si parim nga shkrimtarët ortodoskë, kjo nga efekti i të qenit dytësor në rendin shqiptar, pra si raja ose si shqiptarë të natyralizuar. Po ashtu, letërsia shqipe ka një lidhje të fortë me folklorin dhe kjo ka prodhuar një letërsi me ndikim të theksuar fshatarak. Duke përfunduar mendimin se shumica e shkrimtarëve shqiptarë veprat e tyre i përfundojnë në moshën rinore, dhe për këtë arsye kjo letërsi është naive. De Rada shkroi *Milosaon* në moshë të re; Fishta shkroi epin heroik nën ndikimin e rapsodive gege dhe traditës së poezisë serbo-kroate; Lasgushi, pas *Valles se yjeve* e humbi damarin e tij; Koliqi me vëllimin *Tregtar flamujsh* shënon një hov të frymës së tregimit, pas lidhjes me fashizmin ai shkroi vetëm *mediokritete*[16]. Poeti më i talentuar sipas A. Pipës është Camaj, i cili poemat më të mira i shkroi kur ishte student në Jugosllavi dhe Itali. Kadareja, i cili solli të reja në letërsinë bashkëkohore, por pasi u rreshtua filloi lodhja të bëhet element i destruktivitetit artistik.

---

[14] Arshi Pipa: *Letërsia shqipe: Perspektiva Sociale*, Princi, Tiranë, 2013, f. 177

[15] Po aty, f. 177

[16] Po aty, f. 180

Ph.D. Faton KRASNIQI

NEOLOGJIZMAT E PJETËR BOGDANIT

Abstrakt

"Çeta e profetëve" si një nga veprat më të vjetra të gjuhës shqipe, është pikë reference e trashëgimisë së shkrimit, kulturës, gjuhës dhe letërsisë shqipe. Ka rëndësi të madhe për t`u studiuar leksiku i Pjetër Bogdanit, sepse tregon gjendjen e shqipes në shekullin e XVII, dhe mundëson trajtimin diakronik të shqipes, si një pikë e lidhjes mes të sotmes dhe të shkuarës. Gjithashtu "Çeta e profetëve" është një vepër që fakton dhe dokumenton shkrimin dhe gjuhën shqipe të shekullit të XVII. Kjo natyrisht, duke pasur parasysh edhe ndryshimet tingullore kuptimore që mund t`i kenë pasur fjalët në më shumë se tre shekuj e gjysmë. Leksiku i Pjetër Bogdanit zë vendin më meritor në leksikografinë shqiptare. Historia e leksikografisë shqipe i kaluar tre shekuj e gjysmë, por me gjithë disa artikuj e shënime të shpërndara, ku vlerësohet trashëgimia, shoshiten arritjet dhe ndriçohet rruga e përshkuar, pamja e plotë ende nuk është dhënë, prandaj ne jemi marrë vetëm me studimin e neologjizmave që i krijoi Pjetër Bogdani në veprën "Çeta e profetëve", për shkak se gjuha shqipe e asaj kohe kishte shumë nevojë për fjalë të reja shqipe dhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe.

Fjalët kryesore: leksik, neologjizëm, fjalë, gjuhë, Pjetër Bogdani

Hyrje

Kontribut për ndriçimin e vlerave gjuhësore të veprës "Çeta e profetëve" kanë dhënë studiuesit duke filluar prej: Gjon Nikollë Kazazit (1750), i cili e njofton Romën me shkrimin se Pjetër Bogdani e ka shkruar një vepër «në nëntë gjuhë».[1] Ibrahim Rugova me një studim monografik prej studiuesi serioz teorik-letrar, vepra e Pjetër Bogdanit do të botohet dhe studiohet nga studiues më të shquar të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, siç janë: Kolë Ashta, Faik

[1] Bogdani, Pjetër "Çeta e profetëve"I, Prishtinë, fq 11.

Konica[2], Justin Rrota[3], Shtjefën Gjeçovi[4], Injac Zamputi[5],Vili Kampsi[6], Dhimitër Shuteriqi[7], Eqrem Çabej[8], Rexhep Ismajli[9], Sh. Hoxha[10], Shaban Demiraj[11], Z. Xholi[12], Ibrahim Rugova[13], Anton Berishaj, Mahmud Hysa[14], Çedomir Mijatoviç[15], Alberto Stratico[16], Gustav Weigand[17]. Studiuesit e gjuhësisë dhe letërsisë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm sa i përket ndriçimit të vlerave gjuhësore të veprës "Çeta e profetëve", pasi është një vepër e larmishme tema të rëndësishme, si: gjuhësore, filozofike, letrare prozë dhe poezi, fetare, gjithashtu vepra përmban në vete letra dhe shkresa të autorit. Në këtë vepër autori ka përdor një numër fjalësh të huaja, kurse ne për këtë punim jemi marrë vetëm me studimin e neologjizmave të veprës "Çeta e profetëve" I, II.

Për t`i plotësuar nevojat dhe kërkesat, në gjuhë lindin fjalë të reja, që quhen neologjizma. Lindja e fjalëve të reja bëhet dhe për shkak tjetër: nga leksiku i gjuhës dalin jashtë përdorimit, d.m.th. vjetrohen shumë fjalë, për t`i zëvendësuar duhet krijuar fjalë të reja. Fjalë të reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare. Fjalë të shpikura kot, pa një mbështetje, zakonisht nuk ka. Në fjalën e re kemi njësim të së vjetrës me të renë: të vjetra janë mjetet fjalëformuese që e përbëjnë atë; e re është vetë fjala; i ri është kuptimi i saj, në krahasim me kuptimin e pjesëve përbërëse; p.sh., deri në kohën e Rilindjes nuk njiheshin fjalët *dheshkronjë,*

---

[2] Konica, Faik "*Dy vjersha shqip të shekullit XVII", në Albania, Bruxelles, nr. 4. 1904.*

[3] Rrota, Justin "*Pjetër Bogdani dhe shkrimtarët shqiptarë", Tiranë, 1941*

[4] Gjeçovi, Shtjefën "*Gjurmimet e At Gjeçovit mbi vendlindjen e Bogdanit",* HD, 1930, nr. 12

[5] Zamputi, Injac "Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit", BUSH, Tiranë, 1963 (XVII), nr 3

[6] Kamsi, Vili "*Cuenus Prophetarum i Pjetër Bogdanit",* Shkodër, 1962.

[7] Shuteriqi, Dhimitër "*Autorë dhe tekste",* Tiranë, 1972.

[8] Çabej, Eqrem "*Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe", Tiranë, 1936.*

[9] Ismajli, Rexhep "*Gjuhë dhe etni",* Prishtinë, 1991.

[10] Hoxha, Shefqet "*Në gjurmat e trojeve të Bogdanit",* Buletin shkencor, nr, i posaçëm, Shkodër, 1962.

[11] Demiraj, Shaban " Gramatikë historike e gjuhës shqipe", Rilindja, Prishtinë, 1988.

[12] Xholi, Z."Pjetër Bogdani koha dhe vepra e tij", Tiranë, 1986.

[13] Rugova, Ibrahim "*Vepra e Bogdanit (1675-1685)", Prishtinë, 1982.*

[14] Hysa, Mahmud "*Bogdani si nuke njohim*", Prishtinë, 2008.

[15] Mijatović, Čedomir "Jedan potomak dušanovag Bogdana, Spomenik SAN", Beograd, 1891.

[16] Straticó, Albert "*Bogdanica II",* Bologna, 1965.

[17] Gustav, Weigand "*Cuenus prophetarum" von Peter Bogdani, Archiv, III Bad, Leipzig, 1927.*

përemër etj., por fjalët *dhe*, *shkronjë, për* dhe *emër* njiheshin. Neologjizmat kanë karakter historik; ata janë të tillë për një kohë të caktuar. Kur kalon njëfarë kohe dhe pasi fjalët e reja janë shtrirë në përdorim të gjerë, nuk mbetën neologjizma, humbasin karakterin "e ri" të tyre; p.sh., fjalët *mëmëdhe, ndërgjegje, sasi, cilësi, kryeqytet, mbledhje, fletore* etj. qenë neologjizma në periudhën e Rilindjes, kur u krijuan, kurse tashti nuk mund të trajtohen më si të tilla.[18]

Neologjizmat mund të kenë burim popullor dhe atëherë mbetën anonime. Por shumë herë fjalët e reja krijohen nga autorë, që përpiqen të pastrojnë dhe të pasurojnë leksikun e gjuhës. Shkrimet shqipe, që nga më të hershmet, na dëshmojnë se në gjuhën tonë janë krijuar e kanë hyrë në përdorim shumë fjalë të reja, që e kanë zgjeruar leksikun e saj dhe një nga të paër që u morën me krijimin e fjalëve të reja janë Gjon Buzuku dhe Pjetër Bogdani.

Edhe në ditët tona leksiku i shqipes është pasuruar me shumë fjalë e shprehje të reja si kërkesë e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor, si: *sulmues, mëngjesore, vetëqeverim, vetëvendosje, mbarëvajtje, bashkëjetesë, dhjetëgarësh, shumëgarësh, parësor, dytësor, parimorësi, përparësi, bashkëbisedim, rëndesë.*[19]

Neologjizmat mund t`i grupojmë duke i parë nga dy anë; nga përbërja, neologjizmat mund të jenë nelogjizma fjalësh, d.m.th. fjalë të reja si nga forma dhe nga përmbajtja; p.sh. *njësit, ballist, paritshmëri, cilësi, atdhetar, lejekalim, tejkalim* etj.; neologjizma kuptimesh, d.m.th fjalë të njohura që më parë, po që tashti kanë një kuptim të ri[20]. Kjo lidhet me poliseminë; p.sh. çerdhe fjalësh, brez gjeografik, shtresë shoqërore, vendos**,** (marr vendim), *mbresë* (përshtypje), *mbledhj**e*** (në aritmetikë) , *bosht* (i mësimdhënies) etj. Neologjizmat kuptimesh kemi edhe te disa fjalë të ligjërimit popullor, që me kohë u bënë fjalë kulture, duke u përgjithësuar e duke fituar një kuptim të ri, si: *amzë, arsim, doracak, këshilltar, mbledhës, shkronjë, shqipëroj, kllapë, pikë, presë, theks,gjedhe, kumtoj, hulumtoj, hulli* etj. Nga burimi, dallojmë neologjizmat që lindin për arsye stilistike, në stile të ndryshme a tek autorët të veçantë; p.sh., dallohen fjalët e reja që kanë një përdorim të përgjithshëm, si *brez toke, si tornim, paraprovim, shtresë shoqërore, gjithësi, mëngjesore, pavarësi* etj. Bogdani ka krijuar një numër të konsiderueshëm neologjizmash. Më poshtë do t`i parqesim neologjizmat e Bogdanit sipas radhës.

---

18 Thomai, Jani, "*Lekiskologjia e gjuhës shqipe", Tiranë, 2002, fq 240*

19 Po aty, fq 240

20 Po aty, fq 240

Neologjizmat e Pjetër Bogdanit

A

Amënia, em. Që është një përkthim pjesë- pjesë i lat maternitas.

Avani, em. Tiran, tradhtar, mashtrues.

Avoj, em. Fildish.

Anagogjisht, ndajf. Anagogjisht.

B

Baeja, em. Është një rryp që shërben për të hedhur gurin.

Binoshi, em. Binjak.

Burilla, em. Buljerë, vendi ku mbahet uji i vakët, në enë prej metali.

Bajëbukësi, em. Ai që banë bukën.

Bua, em. Fuçi e madhe.

C

Cmilunë, fol. Ec, udhëtoj.

Ç

Çminjënia, em. Përbuzje, fyemje, gjë e keqe.

D

Dekëtari, em. I vdekshmi, dekë, vdekje.

Dëshmitë, em. Dëshmitarët, dëshmitarë në gjyq.

Dëshminjënīa, em. Dëshmi, dëshmim.

Dijekëqia, em. Dinak, dinaku, mbrapshti.

Domënë fol. Dyshim, dyshoj, fajtor.

Dredhe/ja, em. Erë e fortë që fryen duke u sjellë rrotull.

Dritésë/a, em. Kandili, drita, llampë.

Dalës/i, em. Ai që del.

Dh

Dhymbënjënīa/a, em. Dhembshuri, dhembje, dhimbje.

F

Fatueshim/i, mb. Fatlum, fatbardh.

Fëdigë/a, em. Mund, mundim, lodhje, rraskapitje.

Fëjyem/i, em. Bëj, faj, fajtor.

Fjalëtari, em. Ai që flet, ai që flet mirë e bukur, orator.

Fjaluem, fol. Flas.

Frasqia, em. Erë e lehtë perëndimore.

G

Gërdiçim, em. I gërditshëm, i neveritshëm.

Giuhëtar/i, em. Gojëtar, ai që flet mirë e bukur.

Gulshim, em. Asma në mjekësi, sëmundje e gulçimit.

Gumëci/a, em. Tallje, lojë, tallem argëtohem.

H

Hanëplot/ja, em. Hënë e plotë, kur është mbushur hëna.

Helmth/i, em. Tanth, tëmthi.

K

Kallëmi, em. Kallam.

Këmbënjënia, em. Marrëzi, ligështi.

Këmill/i, em. Kërmilli.

Kjomshtë/itë, em. Të qenët, qenësi.

Kallëzuer/ori. Për dëftonjësin që ka libri ose ndonjë pasqyrë tjetër informuese për librin.

Kërçitunë/i mb. Term mjekësor për sëmundjen e artrits: të kërçitunë kambësh.

Kondisunë, fol. Përbuj.

Konopëz/itë, em. Konopi, litari.

Krahënoshe/ja, m. Trajstë e mbajtur ne krahë në sup, me një fjalë të huaj ruksak.

Kumët/itë, emër asnjënës. Lajm, çfarëdo lajmi, kumtin, lajm vdekjeje, kumton.

Kurtëtar/i, em. Oborrtar pallatesh.

Kurtjel/a, em. Thikë, thikë e mprehtë.

Kurraj, ndaj. Kurraj mangu nukë vjen.

Konfinjëtar/i, em. Kufiri.

L

Lavdëri/a, em. Mburrje, lëvdim, lavdërim, lavdëri.

Ligjëtar/i, em. Ai që vë ligjet, ligjtar.

Lumëbardha, em. Lumbardhë, lumi i bardhë.

Landetar/i, em. Ata që merren me përpunimin e drurit.

M

Madhi/a, em. I madh, madhëri, madhështor.

Mahanë/a, em. Shkak i kot, që nuk duhet përzier në punë të kota.

Manuem, fol. Vonoj, vonesë.

Mazi/a, em. Ugar, tokë e lëvruar.

Mbëlat/a, em. Flijoj, e qes para e flijoj.

Mbrytëtë/i, mb. I errët, i mbyllët, i errësuar.

Melekuq/ja, mb. Kompozitë e përbërë mal+a+kuq, që është një lloj bime me kokrriza si meli, bukë melekuqe.

Mizyrë/a, em. Mizori, tirani.

Mjacëzë/a, em. Bletë/a, bleta në zgjoin e saj.

Mjerëni/a, em. Mjerimi, skamja, varfëria.

Moritunë/a, em. Liget, paket, thahem në trup.

Mosvëtëtë, mosvajtaje.

Mundështim/i, em. Mundim.

N

Namënys/i, em. Gënjeshtar, ai që bënë be rrejshëm, berrebës.

Ndrecuemi/të, të mb. Foljor i emërzuar, reforma, reformim., e bëj të ri, rishtaz.

Ndënate/ja, em. Ag, agim. Koha prej kalimit të natës gjer te dalja e dritës thuhet ag.

Ndëpërdhe, ndaj. Mesdhe.

Ndëpërdhç, mb. Mesdhe, mesdheut.

Ndërshyem, fol. Mugullon.

Ndivënesë/ a, em. Enigmë ose fshehtësi.

Ndoruem, fol. N+dor+oj= vë mbarë, shkonë mbarë e mirë.

Ndritat/i, em. Emër i nyjshë, tritat.

Ngjëruem, fol. Rrethoj, sillem, sillem rreth e rrotull.

Ngjiq/i, em. Mjegull e hollë.

Njëmenduni, fol. Vërtetohet duke e përforcuar një gjë me anën e një tjetre ose krahasohet me një tjetër.

P

Pagëtyr/a, em. Shpërblim, shpërblimi, dhurata.

Parëbir/i, em. Djali i parë i një prindi.

Peshkësujë/a, em. Formohet nga peshk + (ë) sujë, enë që mbledh ujërat.

Përbálcas/i, em. Luftëtarë pa armë.

Përbim/i, mb. Përbindësh, "nukë guxonte kush me dal me dalë në mejdan me atë të përbim".

Përgjegjunë, fol. Përgjakem, përgjakun, gjaknohem, therrem.

Përhanunë/i, mb. Njeri fanatik, tekanjoz, i çuditshëm.

Përkorë/i, mb. Njeri i përmbajtur ne he (ushqime) e në pije.

Përmbiemënuem, fol. I emëruar nga dikush.

Përmbīnipë, em. I biri i nipit.

Përqellunë, fol. përqesh dike, tallem.

Përtoqārkë, ndajf. Rreth e qark.

Pjergullë/a, em. Katrani, zifti.

Pjetëposhtje/ja, em. Teposhtë, tatëpjetë.

Plasmë/a, mb. I emërzuar. Zemërplasur, të plasur zemre.

Pomenundunë, fol. Përmend, kujtoj.

Priskuem, fol. Stërpik, spërkas, lagu me ujë.

Q

Qartë/i, mb. Grindje, mosmarrëveshje.

Qutë/a, em. Kokëfortësi, kryeneçësi.

Quetë/a, ndaj. Barbar, po aq barbar.

R

Raskallë/a, em. Gemb hardhie gjethi.

Rr

Rrezm/i, em. Trashëgim, ajo që trashëgohet prej një brezi tek tjetri.

S

Sendërgjī/a, em. Zell, punë me kujdes, aftësi.

Skarrivoje/ja, em. Akrepi.

Skëdejm/i, mb. I dehur, pijanec.

Skunin/ni, em. Petk, veshje, rroba.

Sh

Shatërë/ i, em. Shërbëtor shtëpish.

Shërbëtyrëti/a, em. Shërbim.

Shkabaltë/a, em. Rob, skllav.

Shpërim/i, em. Frymëzim/i.

T

Tellosnë/a, em. Haraç, “u thoj me mos paguem tellosi o haraçi”.

Ter/i, em. Njëra nga shenjat e yjeve, dem, tarok, mëzat.

Teréqe/ja, em. Petk i gjatë, mallotë.

Tyhe, fol. Tutje.

Tëbanë/a, em. Shtëpi banimi.

Th

Thind/i, em. Thitmth/i, (mushkaja ka) thind që depërton lëkurën e një kau.

U

Usdatī/a, fol. Shpresë, të shpresuarit.

V

Velixuem, fol. Velëzon, lundron me vela hapur.

Vjet/a, em. Viç, “mishi i kingjave e vjetavet.

PËRFUNDIM

Pjetër Bogdani qe themelues i prozës shqipe dhe një njohës i shkëlqyer i shumë gjuhëve të huaja dhe mjeshtër i përpikët në trajtimin e gjuhëve të huaja. Pjetër Bogdani duke njohur disa gjuhë të huaja e pa si nevojë të domosdoshme krijimin fjalëve të reja. Përpjekje për krijimin e fjalëve të reja kishte pasur edhe Gjon Buzuku dhe këtë rrugë e vazhdoi Pjetër Bogdani. Kjo traditë e krijimit të fjalëve të reja u vazhdua nga poetët e Rilindjes Kombëtare. Leksikologjia është degë gjuhësisë së përgjithshme që studion tërësinë e fjalëve të një gjuhe, leksikun e saj; kuptimin parësor a dytësor (metaforik) të fjalës; vlerat e saj; kuptimet dhe përdorimet në kontekste të caktuara; kuptimin estetik-ekspresiv të tyre; përdorimin e fjalëve në zhanre të ndryshme të ligjërimit gojor si dialektizmat, arkaizmat, barbarizmat, profesionalizmat, neologjizmat dhe ne për këtë punim u morëm vetëm me studimin e neologjizmave të “Çetës së profetëve” si një nga veprat më madhështore dhe më e kompletuar e gjuhës shqipe. Kjo vepër madhështore e gjuhës shqipe zgjoi interesim të studiuesve të huaj, të cilët mbetën

të mahnitur me gjuhën e pasur dhe të pastër shqipe, me qartësinë, stilin, idetë dhe për vizionin e Pjetër Bogdanin për rëndësinë e gjuhës, për pastërtinë e saj dhe nevojën për të krijuar fjalë shqipe. Pjetër Bogdani ka krijuar gjithesej 114 fjalë të reja. Por për t`i kuptuar drejt dhe qartë fjalët e reja dhe jo vetëm, duhet të bëhen krahasime edhe me tekstin në italisht dhe latinisht, pasi teksti i Pjetër Bogdanit ka shenja grafike latine.

LITERATURA

- Ashta, Kolë "*Leksiku historik i gjuhës shqipe"* IV, Shkodër, 2002.
-Bogdani, Pjetër
Çeta e profetëve, I-II, Shtëpia Botuese "Drita", Prizren, 1997.
Cuenus prophetarum, Patavii, 1685.
Cuenus prophetarum, München, 1977.
Jeta e së Lumes Virgjin Mri, Shkodër, 1930.
- Çabej, Eqrem "*Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe",* Tiranë, 1936.
- Demiraj, Shaban " Gramatikë historike e gjuhës shqipe", Rilindja, Prishtinë, 1988.
- Gustav, Weigand "*Cuenus prophetarum"* von Peter Bogdani, Archiv, III Bad, Leipzig, 1927.
- Gjeçovi, Shtjefën "*Gjurmimet e At Gjeçovit mbi vendlindjen e Bogdanit",* HD, 1930, nr. 12.
- Hysa, Mahmud "*Bogdani si nuk e njohim*", Prishtinë, 2008.
- Ismajli, Rexhep "*Gjuhë dhe etni",* Prishtinë, 1991.
- Justin, Rota "*Pjetër Bogdani dhe shkrimtarët shqiptarë",* Tiranë, 1941.
- Konica, Faik "*Dy vjersha shqip të shekullit XVII",* në Albania, Bruxelles, nr. 4. 1904.
- Kamsi, Vili "*Cuenus Prophetarum i Pjetër Bogdanit",* Shkodër, 1962.
- Mijatović, Čedomir "Jedan potomak dušanovag Bogdana, Spomenik SAN", Beograd, 1891.
- Rugova, Ibrahim "*Vepra e Bogdanit (1675-1685)",* Prishtinë, 1982.
- Straticó, Albert "*Bogdanica II",* Bologna, 1965.
- Shuteriqi, Dhimitër "*Autorë dhe tekste",* Tiranë, 1972.
- Zamputi, Injac "Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit", BUSH, Tiranë, 1963 (XVII).
- Xholi, Z."Pjetër Bogdani koha dhe vepra e tij", Tiranë, 1986.

Lumturi BARDHI

PROCESI DHE TEKNIKAT E TË PYETURIT

Abstrakt

Të pyeturit është një teknikë e cila jep rezultate të larta, kur menaxhohet me sukses dhe me vëmendje nga mësuesit duke luajtur një rol të madh gjatë të nxënit të nxënësve. Duhet pranuar se të nxënit e nxënësve nis atëherë kur nxënësi pyet. Nxënesit duhet t'u pergjigjen pyetjeve të librit dhe të mësuesit. Të pyeturit qëndron në themel të komunikimit në përgjithësi, të atij mësues- nxënës në veçanti. Ai është një proces me të cilin mësuesit dhe nxënësit përballen çdo ditë. Procesi i artikulimit të pyetjeve nga ana e nxënësve në orën e mësimit sjell dukuri pozitive në klasat e orientuara drejt mësimdhënies ndërpvepruese, me qëllim të nxënit e nxënësve. Pyetjet që mësuesit u japin nxënësve mundësojnë të lidhin atë që dinë me atë që duhet të shqyrtojnë dhe të reflektojnë për të menduarit e fëmijëve.

Pyetjet përdoren për të përcaktuar përvojën dhe njohuritë e nxënësve për të drejtuar mësimin në dobi të tyre, për të sjellë larmi, stimul dhe kontroll të kuptuarit të nxënësve. Teknika e pyetjes është një teknikë që zë një vend të rëndësëshëm në zhvillimin e një ore mësimi.

Teknologjia e mësimdhenies vitet e fundit ka marë një zhvillim të vrullshëm, duke treguar edhe një herë, që kjo është një nga metodat.

Fjale kyçe: Menaxhim-administrim Artikulim-shqiptim Orientim-drejtim

Process and techniques of interrogation

Abstract

The interrogation is a technique which provides high results, when is managed successfully and carefully from teachers playing a major role during the pupils' learning. It must be admitted that pupils' learning starts when the pupil is interrogated. The pupil must answer the questions of the book and the teacher. The interrogation is fundamental to communication in general and especially for the teacher-pupil communication. It is a process by which teachers and pupils

face each day. The process of articulation of questions by pupils in classroom is a positive phenomena in the classrooms oriented towards interactive teaching in order to learn the pupils. The questions of the teacher give pupils the opportunity to connect what they know with what they need to review and reflect on the children's thinking. Questions are used to define the experience and knowledge of pupils to guide the teaching to their benefit, to bring diversity, stimulation and control to pupils' understanding. The technique of interrogation is a technique which occupies an important place in lessons. The technology of teaching in the recent years has taken on a rapid development, showing once again that this is one of the methods.

Key words: Management, articulation, orientation.

Te dish te besh pyetje si duhet,
do te thote te dish te japesh mesim
Arti i bukur i mesimdhenies
varet nga mjeshteria e
perdorimit te pyetjeve

"JOHN DEWEY"

Të pyeturit është një teknikë, e cila jep rezultate të larta, kur menaxhohet me sukses dhe me vemendje nga mësuesit duke luajtur një rol ë madh gjatë të nxënit të nxënësve. Duhet pranuar se *"të nxënit e nxënësve nis atëherë kur nxënësi pyet".* [21]Nxënësit duhet tu përgjigjen pyetjeve të librit dhe të mësuesit. Të pyeturit qëndron në themel të komimikimit në përgjithësi të atij mësues ~ nxënës në veçanti. Ai është një proces me të cilin mësuesit dhe nxënësit përballen çdo dite. Procesi i artikulimit të pyetjeve nga ana e nxënësve në orën e mësimit sjell dukuri pozitive në klasat e orientuara drejt mësimdhënies ndërvepruese, me qellim të nxënit e nxënësve. Pyetjet e mësuesit u japin nxënësve mundësinë të lidhin atë që dinë me ate që duhet të shqyrtojnë dhe të reflektojnë për të menduarit e fëmijeve. Pyetjet përdoren për të përcaktuar përvojen dhe njohuritë e nxënësit për të drejtuar mësimin në dobi të tyre, për të sjelle larni, stimul dhe kontroll të kuptuarit te nxënësve. Teknika e pyetjes është një teknikë që zë një vend të rëndësishem në zhvillimin e një ore mësimi megjithese teknologjia e mësimdhënies vitet e fundit ka marrë një zhvillim të vrullshem duke treguar dhe një herë që kjo është një nga metodat.

Didaktika e lëndës së leximit letrar ka për objekt studimi teorinë dhe praktikën e organizimit te procesit mësimor të . kësaj lënde, përsosjen e

[21] Mimoza Gjokurtaj, "Didaktika e gjuhes shqipe", Tirane 2009, fq. 315.

vazhdueshme të mësimdhënies dhe të përvetesimit të leximit letrar. Termi- "didaktike,, vjen nga greqishtja: didasko- mesoj dhe përcaktohet"... si pjese e pcdagogjisë që merret me problemet e përmbajtjes; me studimin e procesit te mësimdhënies, të përvetësimit dhe të zbatimit nga ana e nxënesve të njohurive, të aftesive dhe te shprehive; me parimet, format e organizmit te te mesuarit dhe metodat. Didaktika e leximit letrar është zhvilluar pa ndeërprerje, është pasuruar, dhe ka ndërruar pamje nën ndikimin e vazhdueshem të procesit të të mësuarit, te ndryshimeve që ka pësuar ky proces gjatë zhvillimit të arsimimit dhe të shkollës, në periudha të caktuara të shoqerisë njerezore.

Si degë e pedagogjisë dhe, në vçanti, si dege e didaktikës së përgjithshme, e lidhur ngusht me të, didaktika e leximit letrar studion:

- detyrat dhe qellimet e mësimit të leximit letrar ne shkolle, veçorite, parimet e organizimit të procesit mesimor- edukativ;
- përmbajtjen e mësimit të leximit letrar, vëllimin e njohurive dhe të shprehive e aftësive praktike që do tu jepen nxënësve në shkollën nëntëvjeçare;

Format e organizimit të procesit mësimor- edukativ, metodat, rrugët, strategjite mësimore për transmetimin e njohurive, rrugët e përvetësimit te tyre nga nxenesit, kthimin e tyre ne aftesi dhe shprehi praktike gjuhesore, ne perputhje me kërkesat e sotme të mësimit të leximit letrar dhe të dokumentacionit shkollore në zbatim.

Didaktika e leximit letrar nuk kufizohet vetem në përshkrimin e detyrave të procesit mësimor të kësaj lënde, por synon të zbulojë varësinë e rezultateve të të mësuarit të leximit nga qëllimi, përmbajtja e arsimimit dhe karakteri i procesit mësimor. Në këtë mënyre, didaktika e leximit letrar synon të sigurojë lidhje të ngushtë ëe mes; te synimeve e standardeve te lëndes, përmbajtjes së mësimit, formave dhe metodave të mësimdhënies dhe te pervetësimit të kësaj lënde nga nxënësit, dhe të ndihmoje keshtu studentet- mësues të ardhshem, dhe mesuesit. në përgjithësi për të realizuar qellimet arsimore dhe objektivat e përgjithshme, dhe specifike të kësaj lënde.

Detyrat e didaktikes lëndore

Detyrat e didaktikes lëndore janë të shumta, por ndër më kryesoret theksojmë se: didaktika, përcakton parimet, rrugët, mënyrat e zbatimit të programeve të kësaj lënde, format e punes me tekstin etj., të lidhura ngushte me tipat e orevë të mësimit, me gjendjen e klasës, me veçorite psikike të nxënësve, sipas grup- moshave. Në didaktikën e leximit letrar parashtrohen rrugët, format e punës dhe metodat më të mira, më të dobishme, më racionale për dhënien e mësimit të leximit letrar në shkollë; përcaktohen rrugët për përvetësimin sa me t qëndnrueshem e sistematik të njohurive letrare, për zotërimin e gjuhës shqipe nga

nxënësit dhe për përdorimin e drejte dhe të sakte të saj në përputhje me situatat ligjerimore dhe nevojat e komunikimit.

Koncepti didaktik i te pyeturit

Te pyeturit, ka si qellim thelbesor lidhjen e veprimtarise së mësuesit me nxenësin.

Në përgjithesi të pyeturit konsiderohet si kontroll i njohurive. Mjeshtëritë e te pyeturit janë qendra e repertorit të mësimdhenies se sukseshme. *Do ta quajme pyetje me shkrim ose me goje, çdo formulim që të nxit të menduarin, dhe kërkon nga nxenesi përgjigje* . Në disa raste nxënësit shfaqin vështirësi në dallimin e tipeve të pyetjeve madje, edhe kur u kerkohet qartë nga mësuesi përgjigja. Një burim i qartësisë dhe i paqartësisë është intonacioni i zerit. Pyetja i lidh nxënësit me argumeentin që shtrohet për diskutim gjatë bisedës, dhe nxit procesin mësimor te ece përpara. Pyetjet e suksesshme janë ato që nuk varen shumë në fjalët që përmbajnë.

Efekti dhe suksesi i pyetjeve varet nga:

Intonacioni i zerit, theksimi i fjalëve, përzgjedhja e fjalëve

Mësuesi nëpërmjet të pyeturit zgjon tek nxënësit dëshirën, për të zbuluar dhe për të ditur shumë më tepër, nga ajo që dinë.

Mësuesi pyet'

Për të zhvilluar imagjinatën e nxënësve

Për të kontrolluar njohuritë e nxënësve

Për të lexuar shprehjen e ndjenjave

Për të nxitur kujtesën e nxënësve

Për të nxitur të menduarin alternative

Për të lejuar shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave. Të pyeturit e ndihmon mësuesin të marrë një informacion mbi përsonalitetin e nxënësve që përgjigjen. Të pyeturit ka si qëllim thelbesor lidhjen e veprimtarisë së mësuesit me atë të nxënësit duke lejuar depertimin tek njeri -tjetri.Gjatë të pyeturit krijohen shumë situate të ndryshme. Të gjithë individet pa përjashtim reflektojnë në vetvete dhe shtrojne pyetje për atë që kanë berë, për që kanë mësuar e për atë që kanë për të bëre. Vënia e "unit" përpara pyetjeve është një veprim i shëndoshe nga pikepamja psikologjike, madje është kusht që të mos kalohet në shqetesim apo

ne ankth. Nxënësi qe nuk i shtron pyetjeve vetes, funksionon si robot, Ky është një qendrim aktiv ndaj vetes dhe problemeve vetjake.

Funksioni i te pyeturit ne klase

Në mjaft raste të pyeturit konsiderohet si verifikim apo kontroll i njohurive apo i punës së kryer. Kjo shprehet në bashkesine pyetje - përgjigje. Përmes pyetjesh mësuesi kupton nëse nxënesit e ndjekin e nuk mbeten pas. Pyetja i lidh nxënësit me argumentin që shtrohet për diskutim gjate bisedës dhe nxit procesin mësimor, që të ece përpara. Të pyeturit është një mjet që i lejon nxënësit të shprehen mbi një argument që po diskutohet, Shpesh janë të njejtit nxënes që flasin e përgjigjen në mësim.

Kur nxënësi pergjigjet, duhet te kihen kujdes edhe këto;

Të dëgjohet deri në fund përgjigjja, pa e ndërprerë e në menyrë të veçantë pa e fyer, ngacmuar, përqeshur e aq me pak kërcenuar as nga mësuesi, as nga nxënësit e tjerë. Nxënësi duhet të jëtë i lire, i qetë, i përqendruar, që të jetë i sigurtë, i bindur dhe i qarte në përgjigje.

Të tjerët duhet te aftësohen ta dëgjojnë me vemendje, të kuptojnë ate që thotë e si e shpreh, të nxjenin të mirat, te veçojnë atë që nuk u duket e qartë apo e gabuar, e mangët apo jo e plotë, të dinë të pyesin me maturi e të japin shpjegimet e verejtjet e duhura. Pa një marvesheje të tillë, mësimi mund të kthehet në një debat të çoroditur, pa asnjë përfitim.

Kur flasim për procesin e të pyeturit, jo rrallë ka një koncept të kufizuar, nënkuptohet vetem aspekti i përmbajtjes në raport me njohurite e marra në shkollë. Harrohet se ky proces i siguron mësuesit një informacion të gjerë mbi përsonalitetin e nxënësit që përgjigjet, ky aspekt nuk duhet të lihet mënjanë e të mos vleresohet. Mësuesi, madje edhe shokët e kuptojnë qartesinë e mendimit, reagimin siperfaqesor apo të thelluar, gjendjen emocionale, aftesinë për ta kontrolluar veten gjate kësaj gjendjeje. Jo rralle nxënesit, të emocionuar, hutohen, frikësohen, kanë një gjëndje ankthi e nuk shprehin të gjitha mundësite e veta, kuptohet niveli i marrëdhenieve mes përmbajtjes së përgjigjeve dhe jetës përsonale të nxënësve. Të përgjigjesh për një pyetje, si në çdo qendrim verbal, do të thotë të ekspozosh disa aspekte të përsonalitetit. Kjo është një arsye që vihet re tek adoleshentet që heshtin, struken e nuk flasin, sepse nuk duan te ekspozohen. Kjo ështe nje dukuri negative, që duhet përpunuar drejt aftësimit e mundesisë për tu shprehur lirisht mendimet. Shpesh mësuesit, duke patur kontakte të rralla me nxënësit, nuk i njohin ato. Këtu s'është fjala për nivelin e dijeve, por si

personalitet.
Të pyeturit konsiderohet si një nga çastet e marrëdhënieve jetësore mësues - nxënës, prandaj duhet ndërtuar me fines. Nuk mund të ketë proces të vërtetë të të pyeturit pa një komunikim të përshtatshëm nëpërmjet mësuesi dhe nxënësit. Klima e ngrohtë që duhet të krijohet në klasë, kur realizohet të pyeturt, është një kusht themelor për vlerën padagogjike të të pyeturit.
Gjatë procesit të të pyeturit përdoren lloje të shumta pyetjesh.

Po i rëndisim më poshtë:
Pyetje që kontrollojnë kujtesën. Është fjala për pyetje që kërkojnë: *data, të dhëna, emra njerezish, etj.*
Pyetje që vënë në provë aftesitë e nxenesit për të grupuar të dhëna, p.sh.: *Cilat janë disa nga ngjarjet që quan në Luftën e Parë Botërore ?*
Pyetje që synojnë të provojnë aftesinë e nxënësit për analize, p.sh.: A *është divorci dukuri që tregon civilizim të shoqerië?*
Pyetje që synojnë të kontrollojëe aftesinë e nxënësit për sintezë, p.sh.:*A ka tipare të përbashkëta midis ekonomisë industrial dhe pasindustriale ?*
Pyetje që synojnë të kontrollojnë aftesinë e nxënësit për interpretim, p.sh,; *Pse ka ndryshuar raporti mes popullsise rurale dhe urbane pas viteve 90-të në shoqerinë shqiptare ?*
Pyetje që e venë nxënësin para mundesive për hipoteza, p.sh.:*Aktualisht vendi yne më shumë importon se sa ekspozon mallra. Ç'fare do të ndodhë nëse do të ecim me këto ritme*?
Pyetje që nxisin mendimin kritik e krijues të nxënësit, p.sh.: *Ç'fare do të beje ti ndryshe?*
Pyetje që e aftesojnë nxënësin të ketë përgjegjësi besim, përfshirje aktive në mësim.
Pyetje që e aftësojnë nxënësin të shkëmbeje përvoje, të bejë gjykime, etj.

Pyetje që synojnë të nxisin gjëndjen emocionale të nxënësit, p.sh,:*E pranoni këtë opinion? Ç' ndjenja provoni në këtë situate ?*

Hartimi i pyetjeve përbën një art më vete. Në një orë mësimi pjesa me e madhe kalon pyetje përgjigje.

Pyetjet duhet te jene 22
Të sakta dhe të qarta

---

[22] Gjokutaj.M.Didaktika e gjuhës shqipe,Tiranë, 2009, fq 340.

Të kenë lidhje logjike mes tyre
Ti bejë ballë të papriturave që shfaqen gjatë orës së mësimit
Teknikat e hartimit të pyetjeve përfshijnë:
Ndërtimin e pyetjeve
Drejtimin e pyetjeve
Për ndërtimin e pyetjeve mësuesi ka parasysh*:*
Objektivat e orës së mësimit
Njohuritë dhe informacionin që kanë nxënësit pr qeshtjen ne fjale
Tema e mësimit që zhvillon
Nivelin e klasës
Përgjigjet që nxënësit mund të japin
Mënyra e formimit të pyetjeve ka një rëndësi të veçantë.
Pyetjet sipas ndërtimit duhet të jenë23
Të kuptueshme, të qarta logjike të shkuara,të përshtatshme me termologjinë, me një gjuhë të thjeshtë
Në drejtimin e pyetjes duhet të kemi parasysh:
Drejtimin dhe shpërndarjen, caktimin e nxënësve për tu pergjigjur pushimin dhe pritjen, dëgjimin e përgjigjes
Në lidhje me konceptin didaktik të të pyeturit, zbatimi dhe njohja sipas koncepteve të mësipërme i ndihmon mësuesit në realizimin e nje procesi mësimdhënës ndërveprues, dhe ofron për nxënësit një të nxënë të sukseshme.
Përdorimi i pauzave ka shumë rëndësi. Nxënësit të mendojnë përgjigjen e tyre. Mësuesit të lexojnë te nxënësit shenja joverbale (frikë, kënaqësi, ndrojtje etj).

Ka mundësi që të përfshihen në mësim edhe nxënësit e plogësht. Rritet cilësia e të arsyetuarit të nxënësve**.** Pakësohet numri i nxënësve që nuk përgjigjen.

Teknikat e te pyeturit në lëndën e letërsisë

Zbatimet e teknikave të të pyeturit duhen kuptuar si këshilla kryesisht për mësuesit po edhe për nxënësit. Si drejtues të procesit mësimor, mësuesit duhet të jenë më të kujdesshëm e me të vetëdijshëm jo vetëm për llojet e pyetjeve që ata ndërtojnë në klasë por edhe për llojet e përgjigjeve që mendojnë se mund të marrin nga këto pyetje. Në qoftë se mësuesi dëshiron një përgjigje në një nivel

[23] Grup autoresh,Mësimdhënia me në qendër nxënësin,Tiranë,2005,fq59

të zgjedhur të të menduarit, atëherë edhe pyetja *duhet të ndërtohet në një mënyrë të atillë që të jetë e përshtatshme për të nxjerrë nivelin e saktë të përgjigjes së nxënësit.*

Mbështetur në pyetjet që u ofrojnë tekstet, mësuesit e letërsisë kanë shumë punë për të bërë. Edhe pse të ribotuara disa herë, në këto tekste, kryesisht në pyetjet e vendosura në fund të pjesëve letrare apo fragmenteve të shkëputura nga veprat letrare, vihet re dukshëm nevoja e përpunimit të pyetjeve, me qëllim që të arrihet në nivelet e duhura të përgjigjeve nga nxënësit dhe përshtatja e"strategjisë" në organizimin e etapave të mësimit në lëndën e letërsisë.

Nëse mësuesin **e** intereson të zhvillojë në shkallë të lartë të menduarit duhet:

Të drejtojë në klasë pyetje të përgatitura në mënyrë të atillë që të kalojnë nivelin mesatar. Në mënyrë që të zgjojë tek nxënësit interesim për orën e mësimit, që të jetë i orientuar dhe të vleresojë informacionin e ri.

Të inkurajojë nxënësit të pyesin më shumë dhe të drejtojnë tek njëri - tjetri dhe tek mësuesit sa më shumë pyetje, duke bërë që gjatë orës së mësimit nxënësit të jenë sa më shumë të angazhuar rreth problemeve**.** Kështu ata japin idetë e veta dhe qartësohen rreth një problem të caktuar**.**

Mësuesi mund të përdorë pyetje

Për të diagnostikuar përparimin e nxënësve,
Për të dalluar nivelin fillestar të përgatitjes,
Për të parashikuar studimet plotësuese. Për të pasuruar dijet në fushën e letërsisë Gjithnjë në lidhje organike me shkencat e tjera që zhvillohen paralelisht në shkollë.
Lidhur me zbatimet e teknikave e të pyeturit dhe rëndësinë e tyre në organizimin e procesit mësimor, rezulton se:
Të pyeturit synon të jetë një strategji universale e mësimdhënies.
Synon të përmirësojë të mësuarin.
Të dallojë nivelin e njohjes.
Të dallojë nivelin fillestar të nxënësve.
Duke i klasifikuar pyetjet sipas një sistemi të caktuar mësuesi mund ***të kuptojë nivelin e njohjes të nxënësit apo atë emocional***, në të cilin klasa punon, duke krijuar kështu përparësitë për të bërë rregullime nga ana profesionale.

Me anë të të pyeturit sistematik, mësuesi mund të dallojë nivelin fillestarë të nxënësve për lëndë të veçanta, në rastin konkret në lëndën e letërsis dhe krijon vijimësin e punës duke njohur mirë kërkesat e programeve të klasave të kaluara

dhe te atyre pasardhëse. Mësuesit i rekomandohet të përdorë sa më shumë teknika të pyetjeve që nxisin pjesmarrje sa më masive të nxënësve në mësim. Strategjitë e teknikat e të pyeturit ndryshojnë sipas situatave të mësimdhënies, temave, ambienteve, përbërjes së klasës, materialeve në ndihmë të mësimit e të shumë faktorëve të tjerë objektivë e subjektive.

Teknika e të pyeturit ndërtohet nga pyetjet e formave të ndryshme të cilat përdoren sipas rastit, ajo gjithashtu gjatë procesit mësimor nuk gjendet e vetme por e mirëgërshetuar me teknikat e metodat e tjera mësimore.

Klima e ngrohtë që duhet të krijohet në klasë ku realizohet të pyeturit është një kusht themelor për vlerën padagogjike të të pyeturit.

Bibliografi

- Mimoza Gjokurtaj, "Didaktika e gjuhës shqipe", Tiranë, 2009.
- Grup autorësh, "Mësimdhënia me në qendër nxënësin",Tiranë,2005.

Dr. Evis HUDHËRA

NJË VËSHTRIM KRONOLOGJIK MBI PASQYRIMIN E KLASËS LEKSIKO - GRAMATIKORE TË MBIEMRIT NË DISA GRAMATIKA TË SHQIPES

Punimi ndalet në një vështrim shumë të përmbledhur të trajtimit historik të klasës së mbiemrave në disa gramatika: *"Shkronjëtore e gjuhës shqipe" e S. Frashërit; "Gramatika" e K. Kristoforidhit; "Gramatika" e I. D. Sheperit; "Gramatika" e O. Myderrizit; "Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore" e Át Justin Rrota; "Gramatika" e ASHSH (1976 / 2002)*. Përzgjedhja ka qenë subjektive, jemi ndalur në vepra të tilla para Luftës së Dytë Botërore dhe te Gramatika e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për periudhën e Pasluftës, si vepër kodifikuese e shqipes standarde.

1. **Mbiemrat te "Gramatika" e K. Kristoforidhit**

Kostandin Kristoforidhi hartoi në vitin 1882 *Gramatikë e gjuhës shqipe, sipas dialektit toskë*[1], e cila nën përkthimin e studiuesit Aristotel Spiro, ka ardhur në shqip në vitin 2001[2]. Mbiemrat në vepër nuk janë parë në një syth apo në një kapitull të veçantë. Informacioni gjendet i shpërndarë dhe më shumë mund ta qëmtosh nëpër informacione për pjesë të tjera të ligjëratës apo në informacione për kategoritë gramatikore në shqipe. Kështu mund të përmendim:

a. Pa dhënë asnjë përkufizim për mbiemrin, në faqen 87 të botimit të vitit 2001 jepet një pasqyrë e lakimit të mbiemrit *i bardhë* (në trajtën e shquar e të pashquar dhe në të tri gjinitë në numrin njëjës, numri mungon);

b. Në vazhdimësi jepen elemente të formimit të mbiemrave nga ndajfoljet, nga emrat, nga foljet, nga pjesoret, nga abstraktët, rreth mbiemrave pjesorë, përshtatja e mbiemrit me emrin, rreth karahasorëve dhe sipërorëve etj.[3]

2. Mbiemrat te "Shkronjëtore e gjuhësë shqipe"e S. Frashërit

"Gramatika" e Sami Frashërit ose e njohur ndryshe si *"Shkronjëtore e gjuhësë*

---

[1] K. Kristoforidhi, Vepra, 1, Silver, Elbasan 2001, f. 57

[2] K. Kristoforidhi, Vepra, 1, Silver, Elbasan 2001, f. 55-243

[3] Shih më gjerë K. Kristoforidhi, Vepra, 1, Silver, Elbasan 2001, f. 87-96

shqipe"[4]*,* botohet në vitin 1886, pra vetëm 4 vjet pas botimit të gramatikës së K. Kristoforidhit, e cila është një nga gramatikat më të mira të shqipes për ato kohëra, çka tregon se autori e njihte me themel shqipen, kishte koncepte teorike të qarta gramatikore (jo vetëm për shqipen), si dhe kishte aftësi e formim shkencor për të hartuar vepra të këtij niveli.

Në "Shkronjëtore e gjuhësë shqipe", kreu i tretë i përkushtohet tërësisht mbiemrit (rreth 10 faqe), duke dhënë përkufizimin dhe kategoritë gramatikore të tij. Sipas Sami Frashërit "miemërë thuhet një fjalë që tregon çfarjen' edhe qyshjen' e një emëri; kur themi *njeri i mirë, shtëpi e lartë, burrë trim, grua varfanjake, gjalpë të kripurë,* fjalëtë *i mirë, e lartë, trim, varfanjake, të kripurë* janë miemëra.

Çdo miemërë bëhetë *mashkullë, femërë* edhe *asjatërë*; bëhet' edhe *njëjës* e *shumës*, edhe përkthehetë nëpër të gjithë rënjet t'emërit; domethënë ka *gjindje, numur'* edhe *rënje.*

3. Mbiemrat te "Gramatika" e I. D. Sheperit

Një nga veprat gjuhësore që ka tërhequr vëmendjen vlerat dhe për cilësinë e hartimit, është dhe *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe sidomòs e toskënishtes* (për shkolla të mesme), e hartuar nga Ilia Dilo Sheperi.

I. D. Sheperi shkruan se "98. Mbiemëra (adjektive) quhen fjalët që vihen përanë emravet për të treguar se qysh janë (cilësìn e tyre). (mur) i lartë. (shkrim) i bukur. (mollë) e ëmbël[5].

169. *Mbiemërat numurorë* quhen:

a) *themelorë* kur dëftejnë vetëm numurin e emravet; një, dy etj.

b) *rrjeshtorë*, kur dëftejnë rrjeshtën (= radhën), të caktuarë sipas numrit. P.sh. i parë, i dytë, i tretë etj.

170. Rrjeshtorët bêhen nga themelorët me prapashtimin -t(ë), përvèç rrjeshtorit "i parë".[6]

Në veprën *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe sidomòs e toskënishtes* (për shkolla të mesme) është dhe informacioni për rolin e gjymtyrës që sot trajtohet si përcaktor kallëzues i kryefjalës dhe i kundrinorit.

Interesant është edhe trajtimi shkencor nga I. D. Sheperi i mbiemrit në rolin e përcaktorit të drejtpërdrejtë të emrit (ose të çilësorit, si e quan ai):

---

[4] S.H.F., *Shkronjëtore e gjuh*ësë *shqipe, shtypur në Shtypëtoret të Shoqërisë "Drita", Bukuresht, 1886 (Shih dhe S. Frashëri, Vepra 2, Tiranë, 1988, f. 94-221*

[5] I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe sidomòs e toskënishtes (për shkolla të mesme), Vlorë, 1927, f. 25-26.*

[6] Po aty, f. 50.

457. Çilësori ose mbiemëri që plotësòn njê emër, vjen zakonìsht pas emërit që plotësòn dhe êsht kurdoherë në formë të pashquarë. P.sh. njeriu *i madh*; udh' *e gjatë*.

Po dhe përpara emërit mund të shkojë mbiemëri si cilësòr, kur i jepet rëndësì çilësìs. P.sh. *të madhe* punë kam bêrë.

Shënìm 1. Shqipja vetëm në rast theksimi të cilësìs e përdòr mbiemërin si cilësòr para emërit; dhe i këtilli mbiemër quhet cilësòr vetëm kur êsht në formë të pashquarë. P.sh. i bukur njerì; e madhe punë.

Shënìm 2. Mbiemëri kur êsht në formë të shquarë përdoret si emër, dhe emëri që i vjen par êsht ndajshtìm i tij (§ 467-4). i bukuri njerì; i mjeri njerì.

Shënìm 3. Mbiemëri i pashquar përpara emërit të shquar êsht kallëzuës i tij; p.sh. i mjerë njeriu që nuk punòn (= i mjerë êsht njeriu që nuk punòn).

458. Çilësori kur êsht mbiemër i nyjëshëm dhe vjen sakaqë pas emërit që plotësòn, ka kurdoherë nyjën e lidhurë; djal' i urtë, djalin e urtë."[7]

4. Mbiemrat te "Gramatika" e O. Myderizit

Në vitin 1944 mësuesi dhe gjuhëtari i njohur Osman Myderrizi, boton *Gramatika e ré e shqipes* (për shkollat e mesme), vëllimi I, Fonologji e morfologji, në gramatikë shumë të mirë e të mirëpritur në shkolla, por edhe nga studiuesit e albanologjisë.

Ndër të tjera autori ndalet në Gramatikë edhe te mbiemri:

"MBIEMNI

Mbiemën quhet fjala që i shtohet emnit për të tregue cilsín a për të caktue mâ mirë kuptimin e tij.

Mbiemni që i shtohet emnit për të tregue cilsín e tij quhet mbiemën *cilsuer*: ushtar *trim*, djalë *punëtuer*, nxânës i *zellshëm*.

Mbiemni që i shtohet emnit për të caktue mâ mirë kuptimin e tij quhet mbiemën *caktuer*: *ky* nxânës, *çdo* nxânës, *nji* nxânës, nxânsi *im*."[8]

Në vazhdim "*Gramatika e ré e shqipes* (për shkollat e mesme)" ndalet te "Mbiemni cilsuer", i cili analizohet sipas strukturës dhe sipas formimit:

"Mbiemni cilsuer mund të jetë *i nyjëshëm* a *i panyjëshëm*.

Mbiemni cilsuer mund të jetë edhe *i parmë*, *i prejardhun* a *i përngjitun*.

I parmë quhet kur âsht fjlalë më vete dhe s'ka rriedhë nga ndonji fjalë tjetër: trim, bujar, shqip.

Mbiemnat e parmë në shqipe janë shumë të pakët.

[7] I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe sidomòs e toskënishtes (për shkolla të mesme),* Vlorë, 1927, f. 162.

[8] Osman Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes (për shkollat e mesme), vëllimi I, Fonologji e morfologji, Tiranë, 1944, f. 66*

I prejardhun quhet kur ka rriedhë nga nji fjalë tjetër tue marrë ndonji mbrapashtesë a nyjë të përparme, ase bashkë me mbrapashtesë edhe nyjë të përparme: punëtuer (punë-tuer), shqiptar (shqip-tar), dimnuer (dimën-uer), i mirë (i-mirë), i ndershëm (i-nder-shëm).

I përngjitun quhet kur âsht formue nga dy ase mâ shumë fjalë tue pasë rrallë edhe nyjë të përparme: fatkeq (fat-ikeq), derëmbyllët (derë-e mbyllët), i pafat (i-pa-fat), i përdyjavëshëm (për-dy-i javëshëm).”[9]

Një vend të posaçëm në tekstin shkollor (dhe jo vetëm) “*Gramatika e ré e shqipes* (për shkollat e mesme)” zënë “MBIEMNAT NUMRORË”

Sipas O. Myderrizit “Mbiemnat numrorë caktojnë kuptimin e emnavet tue tregue numrin e njerëzvet, të kafshëvet a të gjânavet për të cilët flasim: *dy burra, tre zogj, katër libra*....”[10]

5. Mbiemrat te “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore” e Atë Justin Rrotës

Një nga veprat gramatikore më të mira për shqipen është dhe “*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*” e hartuar prej Justin Rrotës.

Përsëri, vëmendja jonë edhe këtu do të përqendrohet te klasa leksiko-gramatikore e mbiemrave. Ndryshe nga veprat e para deri tani, që niset nga teoria te ilustrimi, te kjo gramatikë, fillimisht jepen një grup fjalish mandej jepet informacioni shkencor, duke kaluar nga përdorimi praktik në përgjithësmin teorik. Sipas këtij autori,

“1. MBI MBIEMRIN PËRGJITHSISHT

1. - *Ti ké një shkrim të bukur; unë e kam shkrimin të imët dhe gati të palexueshëm. Deka e kobëshme e Skanderbeut lëshoi një hie të zezë mbi të gjitha fiset e së shkretës mori Shqipni. Sandri duket shëndoshët e i kërpitun; por jo. Përse vjet ka qenë smundë. E veç njëtash ka fillue me u bâ diçka mâ i fortë. Burra besnikë e të drejtë po ké për ditë e mâ pakë mbi këtê shekull të shkretë. Roza, për dukë, njimend âshtë diçka si trashamane, por âshtë një vajzë puntore dhe e kujtueshme. Në fëmijë i mendëshëm e i shkathët si ai, a gjindet kun? Unë nuk jam i shpejtë; e shoh edhe vetë, se jam i kadalshëm; ti je i shkathët e i shtërvjellët*.

Në vargun e këtyne shembujve emnat dhe përemnat janë të cilsuem nga do fjalë, të cilat prandej, pse shkojn tue i përcaktue emnat, quhen: Mbiemna, si: *të bukur, e imët, të palexueshëm*, etj.

[9] Osman Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes (për shkollat e mesme), vëllimi I, Fonologji e morfologji,* Tiranë, 1944, f. 66

[10] O. Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes* (për shkollat e mesme), I, Fonologji e morfologji, Tiranë, 1944, f. 95

Ndër këta mbiemna, disa janë të nyejshëm (*i fortë, i drejtë, e kujtueshme*); disa s'kanë nye para vetes (*besnik, trashaman, puntuer*).

2. – *Shoq i dashun. Grueja e kthyeme, si qerrja e thyeme. Gjeka i ka fjalët e matuna dhe gjyqin e peshuem. – Këtheva në shtëpi, lodhë e këputë prej rruget. Kambët i kishe, njenen mbathë dhe tjetrën zbathë. U çuen prej gjumit, dhe duelnë jashtë, njashtu veshë e ngjeshë, si patnë qëllue*.

Edhe pjesoret e verbavet njehen si mbiemna; por vetëm në qoftë se janë të pajisuna me nejet përkatëse; si: *i dashtun, e kthyeme, e thyeme*. – Për ndryshe, këto do të mbahen si trajta verbore (participa): *lodhë e këputë, veshë e ngjeshë, lagë e ndragë*."[11]

Në vepër gjejmë informacion për përshtatjen e mbiemrit me emrin. Gjithmonë, duke ndjekur metodikën: shembuj – teori.

"Shembuj – *Moti i mirë; dora e djathtrë; fjalë popullore; toka e gjanë e qiella e naltë. Mushkës xanxare i a venë drûtë mâ të trasha. Parja e bardhë për ditë të zezë. Të shkojm te ndrikulla e hutueme, me hangrë voe të fërgueme. Ethe me të dridhuna të forta; ujët e freskët; morì e zeza nanë. "Të lumit Zot, trima, i qofshim falë!"; e bardha morì ditë; e para herë; i pêsti pushim; asnjë gabim; gjithë bota; pesëmbëdhjetë vjet. Pupla shumë e mish pakë*.

6. Mbiemrat te "Gramatika e gjuhës shqipe" e ASHSH

Pas Kongresit të Drejtshkrimit, 1972, nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë filloi hartimi i veprave kodifikuese normative. Një nga këto vepra, e hartuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, është dhe "Gramatika e gjuhës shqipe", 1 (Morfologjia), 2 (Sintaksa). Në Gramatika 1, përkufizohet në mënyrë të thukët e shkencore se: "*Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi"*[12]. Por duhet të themi se gramatika është produkt shkencor i një grupi shumë të gjerë gjuhëtarësh dhe përgjithësim i gjithë përvojës e produktit shkencor të mëparshëm a të njëkohshëm me çastin kur u hartua kjo vepër. Gjuhëtari Ali Dhrimo, një nga studiuesit që është marrë për shumë kohë me këtë kategori leksiko-gramatikore në gjuhën tonë, thekson se: *"Mbiemri, ashtu si edhe emri që përcaktohet prej tij, është një fjalë emërtuese dhe e kuptimshme, që mund të kryejë funksione të ndryshme si gjymtyrë e fjalisë dhe që ka po ato kategori gramatikore që ka edhe emri që ky përcakton"*[13]. Ai

[11] Át Justin Rrota, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, f. 250.

[12] *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 153

[13] A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, në* "Çështje të gramatikës së gjuhës shqipe", II, Tiranë, 1975, f. 141

është plotësisht i varur prej emrit ose përemrit që përcakton, dhe përshtatet me ta.

Në "*Gramatikën e gjuhës shqipe*", 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por edhe në dhjetëra punime të tjera të plota dhe të pjesshme[14] mbiemrat klasifikohem në bazë të dy kritereve: *sipas kuptimit të tyre leksikor* dhe *sipas veçorive të tyre morfologjike.*

1. *Klasifikimi sipas kuptimit leksikor:* Duke u nisur nga ajo se çfarë tipari ata emërtojnë, gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe ndahen në dy grupe të mëdha:

a. Në *mbiemra cilësorë* (mal *i lartë*), "që tregojnë cilësi" dhe që "emërtojnë veti a cilësi të cilat rroken drejtpërsëdrejti me shqisa ose që janë vetëm të mendueshme, të përfytyrueshme"[15].

b. Në *mbiemra marrëdhëniorë* (dashuri *atërore*), "që tregojnë marrëdhënie" dhe që "japin tiparin e sendit, emrin e të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërtimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim a me një numër"[16].

Profesor Shaban Demiraj shprehet se *"mbiemrat e shprehin përshtatjen e tyre me emrat në gjini, në numër dhe në rasë me anë të nyjave të përparme a me anë të mbaresave"*[17]. Ai dukurinë e dysisë strukturore të mbiemrave (të nyjshëm dhe të panyjshëm) e lidh me evolucionin e vetë gjuhës shqipe dhe thekson se *"Çështja e zanafillës së funksionit të nyjës së përparme të mbiemrit mund të sqarohet ose duke pranuar tezën sipas së cilës ajo ka pasur në fillim funksion caktues, ose duke e pranuar tezën, sipas së cilës paranyjëzimi i mbiemrave u përftua nga nevoja për të rishprehur gjuhësisht përshtatjen e tij me emrin, në një kohë kur mbaresat e tij nuk e kryenin më në mënyrë të plotë këtë funksion"*[18].

---

[14] Shih më gjerë bibliografinë shkencore të konsultuar, që pasqyrohet në fund të punimit.

[15] *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 155

[16] *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156

[17] Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f. 262

[18] *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 61

Si përfundim:

1. Mbiemrat janë një klasë leksiko - gramatikore nga më të studiuarit sistematikisht që prej 1882 e deri në ditët e sotme.
2. Trajtesat shkencore rreth mbiemrave tregojnë se e kaluara ruhet dhe në themelet e saj ngrihet e tashmja.
3. Këto gramatika na edukojnë me përdorimet e mbiemrave si një nga klasat me përdorimin më të shpeshtë në gjuhë.
4. Zhvillimet e konceptimit për mbiemrat deri te Gramatika e Akademisë dhe dhënia e shembujve të shumtë të mbiemrave të ndryshëm tregojnë se gjuha ruhet, zhvillohet e pasurohet në vazhdimësi.

Majlinda BUSHAJ-Marjan LULGJURAJ

PAMJE PANORAMIKE MBI BOTIMET SHKENCORE-KULTURORE-LETRARE TË SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI

Abstract

Panoramic overview on scientific – cultural-Literary publications of albanian in Montenegro.

Historical cultural tradition and unified language has been the main factor in the creation of the national cultural space of today's Albanian world, they give this space the force of life and its being as a natural reality and right of an identity-oriented people, regardless of the different state contexts in which he lives or survives. The subject of this study will be the writing tradition in Montenegro and how much the borrowings influence, will be the object of this study. The intellectual and scientific life of Albanians in Montenegro is very wide. A number of scholars who work and live there are authors of valuable monographs. The publications are of different fields, medicine, geography, but the main place is the publications dealing with the history and traditions of Albanian lands, with language, onomatics, folklore etc.

The ranks of Albanian creators and scholars in Montenegro have come to be strengthened and professionally strengthened. Also, cooperation with institutions of Tirana, Shkodra and Prishtina etc. This is also demonstrated by the holding of scientific conferences that are being held from time to time. The literary work of Albanian writers who create in Montenegro represents an important literary phenomenon for contemporary Albanian literature. Popular oral literature is rich in genres, gender and themes. The systematic collections of this creativity started late, while the Albanians of these sides started to be taken from the second half of the century XX. Literary, folklore publications are a great asset for enriching the standard Albanian language. They are of great importance also for the Albanian lexicon, historical dialectology and so on.

The language of recent editions is promising. If this language is studied over time, we see that are significant improvements over the years. Naturally, the

improvement of these publications has been influenced by many factors, such as the Albanian linguists who teach in these institutions, as well as the high school, teachers, writers, publicists, intellectuals and all other employees.

Key words and phrases: Montenegro, writing tradition, language features, novelty, neologisms, borrowings etc.

* * *

Shqiptarët jetojnë në shtete të ndryshme, por kanë pasur dhe duhet të kenë një shtet të përbashkët kulturor-kombëtar, që i ka themelet tek origjina e përbashkët dhe e stërlashtë, te kultura shpirtërore dhe materiale e përbashkët dhe e lashtë, te mendësia dhe vetëdija etnike e përbashkët dhe e lashtë, te përpjekjet qindravjeçare për të mos iu nënshtruar shpirtërisht sundimtarëve e qeveritarëve të huaj, te gjuha arbërore-shqipe e përbashkët dhe e stërlashtë dhe te gjuha letrare e sotme e përbashkët, e më në fund edhe te aspirata jonë evropiane e përbashkët.[1] Në Malin e Zi shqiptarët përbëjnë një pakicë kombëtare, që nuk jetojnë në një territor të njëjtë. Ata jetojnë në pesë komuna: në komunat e Ulqinit dhe të Tivarit, që janë fqinje e me vijimësi territoriale, në komunën e Podgoricës, të Plavës e të Rozhajës. Jetesa e tyre në ish- Republikën Jugosllave të Malit të Zi dhe më pas në Malin e Zi shtet i pavarur ka kaluar nëpër mjaft kthesa, por ata ia kanë dalë të mbeten pasardhës të denjë të të parëve, që kanë shkruar histori. Ata kanë mbijetuar. Mbijetesa është një çështje madhore për bashkësinë shqiptare.

Në kohën e sotme moderne mbijetesa kuptohet si ruajtje dhe zhvillim i mëtejshëm i kulturës kombëtare nëpërmjet mjeteve të infrastrukturës kulturore, kuptohet si ruajtje dhe zhvillim i mëtejshëm i arsimit në gjuhën amtare dhe i vetëdijes për përkatësinë kombëtare historike. Shtresa intelektuale shqiptare në Malin e Zi ka qenë një mbështetje e shëndoshë për ecurinë e arsimit, të kulturës dhe të shkencës te bashkësia shqiptare në Malin e Zi.

I. REVISTAT SHKENCORE-KULTURORE

Revista "KOHA"

Revista "Koha". (1978-1989). Kjo revistë nisi të botohej nga viti 1978 dhe vazhdoi deri më 1989. Redaktor i saj ishte Gjergj Gjokaj. Ajo doli çdo dy muaj, gjithsejt 54 numra në 11 vjet. Kjo revistë luajti një rol shumë pozitiv për kulturën e shqiptarëve në Malin e Zi, e sidomos për botimin e krijimeve të talenteve në fazat e para të punës në letërsi. Në këtë revistë u botuan edhe pjesë të

[1] Emil Lafe, *Revistat shkencore –kulturore të shqiptarëve në Malin e Zi –një ndihmesë e shquar në shkencën dhe kulturën kombëtare*, rev. "Dija", nr.12, 2014, Ulqin, f. 295.

veprave letrare të shkrimtarëve shqiptarë të këtyre anëve. Në numrat e ndryshëm gjejmë përkthime nga letërsia e huaj, sidomos nga ajo malazeze.

Revista "KRAJA"

Revista "Kraja" Një ndër përpjekjet e para të shqiptarëve, pas revistës "Koha" në Malin e Zi për të krijuar periodikun e vet shkencor është revista "Kraja" 1997, kjo revistë do të ishte një tribunë e mendimit të lirë e hapur për të gjithë, për punime e studime nga shkenca të ndryshme, për krijime letrare e artistike, për botimin e trashëgimisë kulturore popullore dhe me këtë mënyrë do t'i shërbente mbijetesës së shqiptarëve si të tillë në ato vise. Revista "Kraja" nuk mundi të mbijetonte, sepse u botua vetëm një numër, por mbijetoi ideja e saj, misioni i saj, që e vijojnë revistat sipas botimit: *Lemba* (1998), *"Buzuku*"(2001), "*Dija*" (2003), "*Malësia"* (2005) etj.

Revistat*: Lemba*, *Dija* dhe *Malësia* kanë një profil të qartë kërkimor-shkencor dhe kulturor. Në disa nga këto studime janë botuar një varg artikujsh që trajtojnë çështje të mëdha të historisë shqiptare që nga lashtësia e deri në ditët tona, të kulturës popullore materiale e shpirtërore, të letërsisë dhe të zhvillimeve letrare në përgjithësi, të gjuhës shqipe në vështrim të gjerë, që nga sjellja e visareve origjinale të atyre trevave deri te shqyrtimet shkencore për tema të rëndësishme të zhvillimit historik dhe të gjendjes së sotme të gjuhës letrare. Në Malin e Zi janë botuar një numër veprash të autorëve të ndryshëm dhe janë mbajtur një varg konferencash. Këto janë një pasuri e pazëvendësueshme informacionesh shkencore.

Revista "LEMBA"

Revista "LEMBA"(1998-2017=19numra). Në kohën e pluralizmit revista e parë në shqip është "Lemba", botuar në kuadër të shoqatës "ART CLUB" në Ulqin. Numri i parë është botuar me 10 gusht 1998, ndërsa deri tani janë botuar 19 numra. Revista nuk është e karakterit lokal, por në bazë të temave të trajtuara është e nivelit mbarëkombëtar. Duke shfletuar numrat e botuar deri tani del qartë se në këtë revistë janë paraqitur emra me autoritet profesional nga bota shqiptare dhe jashtë saj. Revista ka rubrikat e saj standarde: Studime dhe artikuj, ese, pikëpamje, letërsi dhe katalogu. Secila rubrikë u ofron lexuesve informacione interesante të reja dhe të panjohura për lexuesit.

Revista "BUZUKU"

Revista "Buzuku"(2001-2017=48 numra). Kjo revistë shoqërore-kulturore-informative dhe e ilustruar ka krijuar një profil shumë tërheqës për lexuesin, i cili gjen këtu një gamë të larmishme subjektesh e çështjesh. Një meritë e revistës është se u drejtohet gjerësisht mërgimtarëve: pasqyron veprimtaritë e tyre të shumta për ruajtjen e gjuhës shqipe e të traditave, u krijon lidhje me vendlindjen, i njeh me njerëzit e mendimit e të veprimit dhe me ngjarjet e shënuara të historisë sonë kombëtare.

Revista merret me tema nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e shqiptarëve. Në këtë revistë janë botuar mjaft këngë popullore, paraqiten shkrime për trashëgiminë kulturore, për traditën, për burrat e dheut, për burrëreshat, të bukrat e dheut, për gjenezën dhe fiset e shqiptarëve. Siç shprehet prof. dr. Simë Dobreci "*u përpoqëm të afirmojmë vlerat tona*"[2]

Në këtë revistë trajtohen tema nga të gjitha sferat e jetës. Në qendër të interesimeve janë problemet e shkollimit, papunësisë, alkolizmit, mërgimit dhe jetës kulturore-zbavitëse. Këtu trajtohen edhe shkrime për një jetë më të denjë njerëzore ku mbizotëron toleranca, harmonia e mirëkuptimi midis të gjithë shqiptarëve kudo që janë, në Malin e Zi dhe në Diasporë, pa dallim feje e bindjeje politike. Në këtë revistë paraqitet puna e të gjithë atyre që kanë prirje për art, letërsi, sport e fusha të tjera.

Revista "DIJA"

Revista "DIJA"(2003-2017=15 numra). Numri i parë i revistës "Dija" doli më 2003. Në rubrikat e kësaj reviste gjejmë studime dhe artikuj me karakter letrar, gjuhësor, historik, mjekësor, gjeografik, biologjik etj. Studimet e botuara në këtë revistë dallohen për nivelin e ngritur shkencor, për shfrytëzimin e një literature bashkëkohore dhe të traditës, në shqip dhe në gjuhë të tjera. Studiuesi Osmani shprehet: " Ky organ i shoqatës "Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë të Malit të Zi" përbën një ngjarje të rëndësishme në fushën e kulturës për trevën shqiptare në Mal të Zi. Është një revistë me përmasa të mëdha dhe me vlerë, që ia kalon paraardhësve të saj" dhe më poshtë ai nënvizon se : "Iniciatorët për botimin e revistës "Dija" duhet të përgëzohen për faktin se na dhanë një botim me vlera shkencore dhe kombëtare. Dhe është një tregues që flet se mendimi shkencor kërkon të ecë përpara, të tregojë se sa shumë forca krijuese të cilat me aftësitë e tyre intelektuale manifestojnë jo një dëshirë për të shkruar dhe për të botuar, por

[2] Simë Dobreci, *Për revistën "Buzuku*", botuar në rev. "Dija", nr.12, 2014, Ulqin, f. 302.

në realitet. Botimi i kësaj reviste shpreh aspiratat e gjithë komunitetit shqiptar në Mal të Zi dhe do të mirëpritet në Shqipëri, në Kosovë, te shqiptarët e Maqedonisë e në diasporë."[3]

Revista "MALËSIA"

Revista "MALËSIA" (2005-2017= 12 numra). Revista "Malësia" është revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore. Numri i parë i saj doli në janar të vitit 2005, në Podgoricë, Mali i Zi. Synimet e revistës, krejt shkurt na i jep kryeredaktori i saj, Nikë Gashaj, në parathënien e numrit të parë:

"*Qëllimi ynë parësor ynë parësor është që në faqet e revistës sonë të promovojmë çështje të rëndësishme nga thesari i vlerave kombëtare, historike dhe kulturore të popullit shqiptar dhe ta njoftojmë opinionin me sfidat themelore të kohës me të cilat po ndeshet shoqëria shqiptare. Gjithashtu, dëshirojmë të afirmojmë mendimin humanist, dijen dhe idetë, të cilat di t'i kontribuojnë prosperitetit të shqiptarëve në mal të Zi dhe Rajon, si dhe ardhmërisë së tyre më të lumtur, për të cilën të gjithë ne jemi përgjegjës dhe së cilës të gjithë i jemi të nevojshëm*."[4]

Qysh me numrin e parë kjo revistë përmban lëndë të zgjedhur me kujdes dhe që shkon pikërisht në vijimin dhe thellimin e asaj hullie të mbarë që jo vetëm e përfill dhe e konsideron praninë e shqiptarëve si pjesë e rëndësishme e mjedisit gjeopolitik dhe gjuhësor të vendit e të shtetit malazez ku ndodhen, po edhe synon t'u japë shtjellim problemeve më të rëndësishme historike dhe politike si: coptimi i trojeve shqiptare, identiteti shqiptar, mbi legjitimitetin e shtetit shqiptar gjatë luftës II botërore, mbi shpërnguljet e shqiptarëve etj.

Në numrat e revistës ka bashkëpunime dhe ndihmesa shkencore nga studiuesit kolosë të dijes shqiptare, deri te kërkues të rinj në formim e sipër, ka kontribute të dijetarëve nga e gjithë hapësira kulturore shqiptare, ka pranime artikujsh e studimesh nga shumica e universiteteve dhe qendrave kërkimore shqiptare; ka gjithashtu edhe prani të albanologëve të huaj, sidomos të Ballkanit qoftë në përbërjen e numrave qoftë në përbërjen e redaksisë, *që nënkupton edhe një rol nxitës të tyre për të bashkuar rreth saj edhe më shumë mendimtarë të*

---

[3] Tomor Osmani, *Një organ i arrirë i krijuesve shqiptarë të Malit të Zi, revista "Dija",* Kumtesë e mbajtur në promovimin e numrit të parë të revistës "Dija" dhe të pesë veprave të tjera - botime të krijuesve shqiptarë në Mal të Zi, organizuar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" dhe Muzeu Historik - Shkodër, më 29 maj 2004, botuar, në Dija, 2, 2004, f. 8.

[4] Nikë Gashaj, *Parathënie,* rev. Malësia, nr. 1, Podgoricë 2005, f.9.

tjerë.[5]

Spikasin emrat të njohur të albanologjisë si: Tomor Osmani, Gjovalin Shkurtaj, Kolec Topalli, David Luka, Shefkije Islamaj, Anton Nikë Berisha, Valter Memisha, Shaban Sinani, Josif Mita, Ali Jashari, Mustafa Ibrahimi, Emil Lafe, Fatbardha Hoxha, Shpresa Hoxha, Spiro Gjoni, Ruzhdi Ushaku, Anton Nikë Berisha, Mahmud Hysa etj.

II. KONFERENCA SHKENCORE

Radhët e krijuesve e të studiuesve shqiptarë në Malin e Zi kanë ardhur duke u shtuar e duke u forcuar profesionalisht. Po ashtu edhe bashkëpunimi me institucione të Tiranës, Shkodrës e Prishtinës etj. Këtë e tregon edhe mbajtja e konferencave shkencore që po zhvillohen herë pas here, përmendim këtu disa nga konferencat:

- *Meshari i Gjon Buzukut-Monument i kulturës shqiptare* (Material nga sesioni shkencor mbajtur më, 19, 20 maj 1995 në Ulqin) botuar Ulqin 1995.
- *Ulqini në rrjedhat e kohës*" (Simpozium shkencor), botim i ART CLUB i Ulqinit, Ulqin, 2000.
- *Ymer Prizreni, Personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (25-26 maj 2002), botuar Art Club, Ulqin 2002.
- *Shasi i lashtë-Monument i kulturës,* (Përmbledhje e kumtesave nga Sesioni shkencor i mbajtur më 16-17 maj 2008), Ulqin, 2009.
- *Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi*, Ulqin, 19.12. 2009, botuar ART CLUB, 2010.
- *Letërsia gojore dhe identiteti kombëtar shqiptar*" Ulqin 2011.
- *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve*" Ulqin, 2011.

III. VEPRA

Jeta intelektuale dhe shkencore e shqiptarëve në Malin e Zi është shumë më e gjerë sesa revistat që përmendëm. Një varg studiuesish që punojnë e jetojnë atje janë autorë të monografive me vlerë. Botimet janë të fushave të ndryshme, mjekësi, gjeografi, por vendin kryesor e zënë botimet që kanë të bëjnë me historinë dhe traditat e trevave shqiptare, me gjuhën, onomastikën, folklorin etj. Këtu do të

[5] Sh. Sinani, *Malësia*, 8, 2013, f.489.

përmendim studiuesit Ruzhdi Ushaku[6], Hajro Ulqinaku,[7] Bahri Brisku,[8] Maksut Haxhibrahimi[9], Basri Çapriqi[10], Haxhi Shabani[11], Gjokë Dabaj[12], Gjystina Shushka[13], Nail Draga[14], Mimoza Ahmeti etj. Gjithashtu dhe veprimtaria e krijuesve është mjaft e madhe. Përveç revistave dhe konferencave shkencore janë botuar një varg veprash ku spikasin: Ruzhdi Hasanaga, *Frazeologji dhe fjalë të urta të shqiptarëve në Malin e Zi*, Ulqin 2017; Hajro Ulqinaku, *Glosar, Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit*, Ulqin, 2011; Maksut Haxhibrahimi, *Toponimia e Ulqinit dhe e rrethinës*, Ulqin, 2001; Ruzhdi Ushaku, *Ndihmesa onomatologjike nga hapësira iliro-arbërore*, Prishtinë, 2006; Ruzhdi Ushaku, *Hulumtime etnolinguistike*, Prishtinë, 2006 etj.

Gjithashtu veprimtaria letrare është e gjerë dhe e larmishme, e cila është trajtuar nga prof. Arben Prendi në numrin e gjashtë të revistës "Malësia". Vepra letrare e shkrimtarëve shqiptarë që krijojnë në Malin e Zi, përfaqëson një

---

[6] Ruzhdi Ushaku- Jusuf Lika, *Ulqini nga dritaret e kohës*, Ulqin 2006; *Hulumtime et nolinguistike*, Prishtinë, 2006; *Ndihmesa onomatologjike nga hapësira iliro-arbërore*, Prishtinë, 2006; *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin 2010 etj.

[7] Hajro Ulqinaku, *Degë e drurit të urtë,* Ulqin, 2008; *Glosar, Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit*, Ulqin, 2011; *Libri për Tivarin*, Art Club (Krijime letrare për Masakrën e Tivarit, 1945) Shai "Art Club", Ulqin 2015etj.

[8] Bahri Brisku, *Deti dhe detarët në letërsinë popullore shqiptare*, Prishtinë, 2006; *Kusarët dhe detarët shqiptarë* (Kontributi i tyre në autoktoninë kombëtare), Ulqin, 2011; *Lirika popullore në trekëndëshin Ulqin - Shestan - Bregu i Bunës*, Ulqin, 2006; *Miguel Servantesi në Ballkan*, Ulqin, 2016; *Ndriçime hulumtimesh dhe kontribute për çështjen shqiptare*, Prishtinë, 2016; *Polemikë lidhur me falsifikimet shkencore kundra shqiptarëve të Kapllan Buroviqit*, Bashkimi i krijuesve, Ulqin 2006 etj.

[9] Maksut Haxhibrahimi, *Toponimia e Ulqinit dhe e rrethinës*, Ulqin, 2001 etj.

[10] Bahri Çapriqi, *Mikrostruktura e tekstit*, Rilindja, Prishtine, 1990; *Aksidenti i orës shqiptare*, 1993; *Përmasat e kontekstit,* Shoqata e Shkrimtareve te Kosoves, 1998; *Simboli dhe rivalët e tij*, PEN Qendra e Kosovës, 2005; *Paradigma Kadareane*, Onufri, Tiranë, 2006 etj.

[11] Haxhi Shabani, *Rrezikimi i gjuhës shqipe*, (*Për dygjuhësinë te Shqiptarët e Ulqinit*) Toena, Tiranë, 2007; *Shqiptarët në Malin e Zi, çështje e pazgjidhur*, Art Club, 2013.

[12] Gjokë Dabaj, *Shestani, Studim filologjik gjithëpërfshirës*, vëllimi 1, 2 Ulqin-Tiranë-Prishtinë, 2004.

[13] Gjystina Shushka, *Gjuha në veprën e Naum Veqilharxhit*, Prishtinë, 1999; *Gruaja në veprën e Atë Anton Harapit*, Prishtinë, 2002 etj.

[14] Nail Draga, *Shqiptarët në Mal të Zi,* Art Club,1994; *Gjurmë gjeografike*, Art Club,1997; *Shpalime gjeografike*, Art Club, 2001; *Meditime për identitetin*, Art Club, Ulqin, 2005; *Kultura dhe shoqëria civile*, Art Club, Ulqin 2005; *Intelektuali dhe paragjykimet*, Art Club, Ulqin, 2013 etj.

dukuri të rëndësishme letrare për letërsinë bashkëkohore shqiptare. Siç vlerëson studiuesi Anton Gojçaj mund të thuhet se letërsia shqipe që shkruhet në Malin e Zi e begaton qoftë edhe në përmasa minimale fondin e letërsisë (së përgjithshme) shqipe, e gjithashtu edhe spektrin e kulturave aktive ne shtetin e Malit të Zi. (Anton Gojçaj, Biblioteka e Hirushes, Ulqin, 2011). Studiuesi Arben Prendi shkruan se: "bota e tyre artistike përshkohet shpesh nga një vizion i përbashkët që ka të bëjë me njeriun si individ, por edhe si shqiptar, pjesë e një etnie të rrezikuar; pastaj me mjedisin si mjedis ekzistencial, por edhe si mjedis shqiptar, me të cilin janë të lidhura elementë esenciale të botës shqiptare."[15] Letërsia gojore popullore është e pasur me zhanre, në gjini, në tematikë. Mbledhja sistematike e kësaj krijimtarie ka filluar vonë, kurse vëtë shqiptarët e këtyre anëve kanë nisur të merren nga gjysma e dytë e shek. XX. Këtu dallohen: Viçens Malaj, Simon Filipaj, Ismail Doda, Ali Ahmeti[16], Zef Jankaj[17], Kolë Berishaj, Idriz Ulaj[18], Bahri Brisku[19], Hajro Ulqinaku[20], Gjergj Hasanaj[21], Mirash Gojçajt[22], Hasan Gjonpalaj[23] etj.

Tani ka mjaft autorë që paraqiten me botime të herëpashershshme si: Ali Llunji[24], Asllan Bisha[25], Esat Mekuli[26], Hajredin Kovaçi[27], Ibrahim Berjashi[28],

[15] Arben Prendi, *Shqyrtime mbi veprën letrare të disa shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë në Malin e Zi*, rev. "Malësia" nr.6, 2011, f. 262. Shiko edhe: Jovan Nikollaidisi, *Letërsia e shqiptarëve n*ë *Mal të Zi*, botuar, në rev. "Dija", 2, 2004, Ulqin, f. 205-208.

[16] Ali M. Ahmeti, *Vajtimet dhe gjëmat shqiptare në Plavë dhe Guci*, Podgoricë, 1986; *Letërsia gojore e Krahinës së Plavës dhe të Gucisë*, Prishtinë, 2004; *Kur dritat fiken,* Art Club, Ulqin, 1995 etj.

[17] Pater Zef Jankaj, *Krijimtari gojore*, Tuz, 2007.

[18] Idriz Ulaj, *Këngë popullore nga Gucia*, Prishtinë 1978.

[19] Bahri Brisku, *Deti dhe detarët në letërsinë popullore shqiptare*, Prishtinë, 2006.

[20] Hajro Ulqinaku, *Thesar popullor*, Ulqin, 2004.

[21] Gjergj Hasanaj, *Malësori këndon*, Cetinë, 1971.

[22] Mirash Gojçajt, *Thesari i Malësisë*, Tuz, 2006.

[23] Hasan I. Gjonbalaj, *Këngët historike në krahinën e Plavës dhe të Gucisë*, Plavë, 1996.

[24] Ali Llunji, *Lugu i Xhemiles*, Ulqin, 1998; *Harapët e Ulqinit*, Ulqin 2013.

[25] Asllan Bisha, *Ankthi i pritjes*, Ulqin 2009; *Dasma e peshqve*, Ulqin 1996; *Dashuri buzë Barbanës*, Ulqin, 2000; *Grimca jete dhe anekdoda*, Ulqin 2011; *Ufo në Barbanë*, Ulqin, 2013 etj.

[26] Esat Mekuli, *Liria e shpresuar*, Ulqin, 2011 etj.

[27] Hajredin Kovaçi, *Ecje pa mbarim*, Ulqin 2000, *Fundi është larg*, Ulqin 2007, *Vrasja e frikës*, Ulqin 2012, *Zhdukja e heshtur,* Ulqin 2014 etj.

[28] Ibrahim Berjashi, *Floçka e liqenit*, Ulqin 2006, *Gati u harruem,* Ulqin, 2013*, Ora e Rumisë*, Ulqin, 2009 etj.

Lumnije Hoxha[29], Shaban Osmanaj[30] etj.

GJUHA E BOTIMEVE

Shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në Malin e Zi, përdorin gjuhën letrare kombëtare dhe drejtshkrimin e saj të njësuar. Gjuha e botimeve të Malit të Zi është standarde pavarësisht se sa pasqyrohet standardi në këto revista. Kjo veprimtari vihet re në Mal të Zi në të gjitha veprimtaritë shoqërore, arsimore, kulturore e shkencore, gjuha e njësuar përdoret në të gjitha institucionet botuese në radiotelevizion, në organet administrative, në shkolla në teatër. Për shqiptarët e Malit të Zi si për të gjithë shqiptarët në përgjithësi, përdorimi i një gjuhe letrare të njësuar është një arritje shumë e madhe, si për njësimin e gjuhës letrare shqipe, ashtu edhe për zhvillimin kulturor e arsimor të vendeve tona, ajo është një shprehje e re e forcimit të mëtejshëm të unitetit të kombit shqiptar. Vihet re një reflektim pozitiv dhe i menjëhershëm nga ana e shkencës gjuhësore shqiptare në Mal të Zi, për të gjitha momentet kyçe të ndërmarra në Shqipëri për probleme të gjuhës letrare. Kështu në *Konferencat Shkencore* marrin pjesë edhe përfaqësues nga Mali i Zi.

Botimet letrare, folklorike janë një pasuri e madhe për pasurimin e gjuhës standarde shqipe. Ato kanë rëndësi të madhe edhe për leksikun e gjuhës shqipe, dialektologjinë historike etj. Me vlerë të madhe njohëse për traditat e Malësisë janë, ndër të tjera vëllimet me lëndë etnografike e folklorike të Atë Kolë Berishës "Malësia e Madhe" Etnografi 1,2, 3, 4, i cili gjithashtu qe lindur në Priftën të Grudës, i cili shërbeu si meshtar në Triesh e në vise të tjera të Malësisë. Mund të përmendim vetëm veprën Patër Zef Jankaj, Krijimtari gojore (Krajë -Malësi), përgatitur për botim nga Zef Anton Gjuravçaj-patër Mirash Marina, Malësi, 2007. Në të cilën gjenden nxjerr 650 fjalë të rralla, që paraqesin interes për studime gjuhësore. Në këtë vepër gjenden neologjizma a fjalë të reja që nuk dalin në *Fjalorin* 2006, që dëgjohen vetëm në këtë krahinë e që mund të shërbejnë për pasurimin e gjuhës shqipe, si dhe me kuptimet e reja a përdorimet që ata paraqesin, si: *bukulushë, bëlbzanë, blegazanë, unzë, pshtjedhcë, bukurishte, ftigë, dypërhjekës, barkazan/ë, bletishtë, breçkë, buz/ërr, çekique (me), çërmue (me), damue (me u), delmet, ërdhi,-a, fish-fish, ftigë, mërrlaçkë, mreskue, ngritë, pashanokë, perdredhak, përvenë, prozhmue, pshtjedhcë, rrëmue, sukulluo,*

---

29 Lumnije Hoxha, *Shtegu i vashës*, Ulqin, 2001, *Shpirt i rrebeluar*, Ulqin 2005 etj.

30 Shaban Osmanaj, *Këngë popullore nga Ulqini dhe Ana e Malit, Një Yll pranë detit, Ti Tahir a po vjen me gju*, Art CLUB, Ulqin, 2011 etj.

shqupí, tukitë, unz/ë, ~a, varzat, verdhç,~i, vêtasuo(me u) etj.[31]

Përveç fjalëve të rralla në vepër ndeshim edhe trajta të vjetra të dukurive gjuhësore që në disa raste përkojnë me gjuhën e përdorur nga Buzuku te "Meshari" dhe në anën tjetër takonin edhe me dialektin toskë.[32] Ndërkaq, përkimet me të folmet krahinore (khs. P.sh. trajtat foljore me *–nj* fundore të imprefektit *Ti i kishnje, A mos ishnje* që dëgjohen nga ana e Malësisë së Krajës; e po kështu edhe *tue i thashunë* me shënimin: kështu e kanë edhe sot Malësia e Mbishkodrës e Kraja… hedhin dritë kryesisht për vendin e lindjes së Buzukut, si edhe për mjedisin gjuhësor ku ai punoi e jetoi.

Në veprën e Nokë Sinishtajt, ndeshen dukuri të moçme të morfologjisë së shqipes veriperendimore, që janë mënjanuar prej të folmeve të tjera, qoftë edhe të gegërishtes. P.sh. gjejmë gjurmë të përemrave dëftorë të gjinisë asnjëanëse: *kta tlyn, kta sanë, kta kashtë* etj. Fjala *zjarm* dhe fjalë të prejardhura prej saj, që ruajnë formën e hershme të shqipes. Në vjershat e Nokë Sinishtaj ndeshim: **zjarrmi**: *Truri i kujtimit ka **zjarrmi*** (Spirale, f. 113).

Në fushën e fjalëformimit vihen re fjalë me interes të gurrës së lashtë popullore, që në Shqipëri njihen si dialektore ose fjalë që nuk gjenden në Shqipëri, fjalë që në Shqipëri njihen, por përdoren mjaft rrallë ose përdoren me një kuptim tjetër, ka edhe fjalë të përftuara sipas hudhive fjalëformuese të gjuhës shqipe. Këto fjalë që janë me qindra duhen studiuar dhe ato që nuk formojnë sinonime leksikore absolute duhet të gjejnë vend në fondin leksikor të gjuhës letrare kombëtare. P.sh. *grec-i, krahathadër, kunatazan/ë, kurrpikë, luskë* etj.

Me mjaft interes në numrat e revistës *Dija* është rubrika, *Fjalë e shprehje të rralla* ku mund të dallonim kontributin e Hajro Ulqinakut, me fjalë e shprehje nga fusha e detarisë në disa numra të saj. Glosari i Ulqinakut sjell një ndihmesë të vyer edhe për dialektologjinë historike e veçanërisht për kuptimet e reja të fjalëve, deri më tani të panjohura e të parreshtuara ndër fjalorë të shqipes. një dukuri të tillë e vë në dukje studiuesi D. Luka, i cili mendon se glosari i Ulqinakut "*do të na shërbejë në të ardhmen si lëndë bazë për punimin Elementet vendëse dhe të huaja në leksikun detar të së folmes së Ulqinit, për të cilin do të seleksionojmë materialin brut të fjalorit*".[33]

---

[31] D. Luka, *Studime gjuhësore*, XVI, Shkodër, 2014, f. 83-138.

[32] Shih: D. Luka, *Personaliteti gjuhësor i Justin Rrotës përmes shënimeve të veprës së Buzukut*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore " *Justin Rrota -studiues i shquar i letrave shqipe",* organizuar në Shkodër, më 19.12. 1994, botuar David Luka, Studime gjuhësore VII, Shkodër, 2002, f. 92 v.

[33] D. Luka*, Shënime për veprën "GLOSAR" (Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit) i Hajro Ulqinakut,* në revistën "DIJA", organ i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi (Ulqin), nr. 2, Ulqin, 2004, f. 188.

Fjalësi i tij nuk përfshin vetëm fjalë të rralla e shprehje të veçanta të terminologjisë detare, por edhe leksik më të përgjithësuar të kësaj fushe. Ndeshim leksik nga fusha e bimësisë, e shtazërisë, e kuzhinës, e traditës e zakoneve e të tjera. Fjalët e shprehjet e botuara këtu janë me interes nga ana leksiko-semantike. Shumica e njësive leksikore mund të konsiderohen fjalë të rralla e të panjohura, por ka nga ato që janë të njohura, por kanë nuanca kuptimore ose ngjyresa stilistike të tjera nga ato që i njohim. Fjalët janë emërtime të zgjedhura si nga struktura, ashtu edhe nga kuptimi, ato sjellin vlera edhe me ngjyrimet e veçanta semantike e emocionuese, si: *bukurinë*=lloj peshku, *brufull*=lloj peshku, *lemçe*=lloj gaforreje etj. Tipik për këtë të folme na del edhe ndërtimi fjalëformues popullor: *bullar*=lloj gjarpëri, *majuk*=qefull i vogël etj.

Njësitë frazeologjike janë janë një pasuri e madhe e kësaj të folmeje. Në vëllimin *Kërkime filologjike* (1981) Ruzhdi Ushaku[34] sjell "Kontribut për studimin e disa shprehjeve dhe frazeologjive detare në të folmen detare të Ulqinit" pasurinë frazeologjike të shprehjeve detare. Këtu autori sjell shprehje të shumta për llojet e detit (valëve), pasurimin e fjalës *det* me vlera të shumta semantike, krahasime të ndryshme të valëve të detit me figura të ndryshme, madje edhe mitike të cilat flasin në të mirë të shprehjeve në fjalë. Fjalët dhe frazeologjitë e shumta lidhur me mjetet e lundrimit dhe me mjete dhe vegla të ndryshme në anije, lidhur me termin-nocionin peshk dhe terma të tjerë që lidhen me jetën detare, flasin në favor të faktit se populli e ka kultivuar pareshtur pasurinë gjuhësore në frymën origjinale.

* * *

Me gjithë zhvillimin e madh të gjuhës letrare kombëtare shqipe që përdoret nga popullsia e Malit të Zi vihen re ndikime dialektore dhe ndikime nga gjuha malazeze serbishtja apo anglishtja.

Dukuritë dialektore që kanë shtrirje më të madhe takohen te një a disa autorë vepër a organ. Madje edhe artikujt të botuar në të njëjtën revistë dallohen nga njëri tjetri nga kjo pikëpamje. Më poshtë po radhisim disa dukuri më tipike, që vihen re në shumë vepra.

- *Udhëtimi të cilin e bën Jodie **zgjatë** sa një jetë e njeriut. Periudha 600 -vjeçare që na **ndanë** nga lindja e Skenderbeut dhe veçanërisht, periudha e robërisë shqiptare nën turq që erdhi pas vdekjes së tij, më 1468, mund të krahasohet vetëm me rrëzimin në humnerën historike së cilës nuk i shihej fundi*. (Lemba, nr. 9/2005, f. 75).
- *Murati e gjeti të arsyeshme të provonte me të mirë ta binte Skenderbeun përsëri, dhe shumë shkurt pas Varnës **i shkruajti** një letër*

[34] Ruzhdi Ushaku, *Kërkime filologjike*, Prishtinë, 1981.

atij, ku ai të numëronte të mirat që kishte bërë për të, e akuzonte për mungesë respekti dhe së fund ii dha atij premtime të mëdha, nëse ai do të përulej përsëri. (Lemba, nr. 9/2005, f. 13).

- *Ndër personalitetet e njohura që kanë dhënë ndihmesë të* ***konsiderushme*** *në fushën e arsimit në gjuhën shqipe në qytetin e Ulqinit vend të nderuar* ***zënë*** *shkodrani Jahja Domnori*. (Lemba, nr. 3-4, 2000, f.5).
- *Për jetën e tij flet dhe shkruan ai* ***vet*** *në një fletore sh****e****nimesh të titulluar "Jeta ime"*. (Lemba, nr. 3-4, 2000, f.5).
- *Zgj****ë****rimi territorial i Malit të Zi, detajisht u hartua gjatë sundimit të Mbretit Nikollë*…(Lemba, nr. 3-4, 2000, f.19).

Në gjuhën e botimeve në Mal të Zi vihen re ndikime jo të pakta të serbishtes. Shumë prej tyre takohen edhe sot. Në rrethanat e atjeshme të dygjuhësisë ndikimet janë relativisht të forta dhe kanë prekur të gjitha sferat e gjuhës. Ndikimet janë më të shpeshta në stilin publicistik, sidomos në shtypin e përditshëm, ku shpesh botohen artikuj e shkrime origjinale ose përkthime të bëra me shpejtësi, vende- vende fjalë për fjalë, e që botohen pa u korrektuar mirë. Ndikime ndihen në fushën e leksikut e më pak në strukturën sintaksore. Të dhënat janë nxjerrë nga organet "Lemba", "Dija", "Malësia" etj.

Nuk po ndalemi në fushën e fonetikës dhe të gramatikës, sepse gjuha e botimeve të Malit të Zi është trajtuar mjaft mirë nga studiuesja Mimoza Priku[35].

Një nënsistem ku ndikimet janë më të dukshme është ai leksikor, sidomos në rastet e të ashtuquajturave huazime leksikore. Duke u nisur nga fakti se shqipja është një gjuhë e hapur, ajo është në kontakt dhe nën trysninë e gjuhëve të tjera. Takohen mjaft fjalë të huaja të marra nëpërmjet serbokroatishtes, malazeze, anglishtes a nga gjuhë të tjera si: *dobësi* ***evidente*** (Malësia 2009: 286); *pozicionim* ***revelant*** (Malësia 2009: 286); *mundësia e* ***definimit*** *të kërkesave* (Malësia 2009: 287); *investimi më i mirë e më* ***rentabil*** (Malësia 2009: 288); ***qasje radikale*** *të* ***inovacionit*** *të cilësive dhe përmbajtjeve të saj* (Malësia 2009: 286); ***tendenca liberale*** (Malësia 2009: 286); ***konsekuencat*** *e mosbesimit* (Malësia 2009: 283); *vendosja e kritereve* ***ekzakte*** (Malësia 2009: 283); *dy* ***opcionet*** *e para* (Malësia 2009: 173); *fuqitë* ***okupuese*** *gjermane* (Malësia 2009: 168); ***konkludimet*** *e kësaj konference* (Malësia 2009: 168); *fryma* ***internacionalistike*** (Malësia 2009: 168); ***redefinimi*** *i përkufizimeve të bashkësive lokale* (Malësia 2005: 143); *shkenca i ka*

---

[35] Mimoza Priku, *Ndikimet e huaja në të folmet shqipe të përdorura në trevat e Malit të Zi,* botuar në Aktet e konferencës, *Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi*, botuar ART CLUB, 2010, f. 27-34.

glorifikuar *të mos themi* ***denigruar*** (Malësia II 2007: 249); *burimeve* ***revelante*** *të* ***proveniencës*** *malazeze* (Malësia II 2007: 250); *burimeve* ***sekondare –memoareve*** (Malësia II 2007: 250); *nxjerrja e* ***konkluzioneve*** *të drejta dhe të arsyeshme* (Malësia II 2007: 250); *vendin e* ***proklamuar*** *në Konferencën e Londrës* (Dija, 14, 2015:127); *faktorë* ***destabilizues*** (Dija, 14, 2015:126); ***deportimin*** *e tyre në Cetinë* (Dija, 14, 2015:141); *mashtrim* ***perfid*** *dhe gënjeshtër* ***transparente*** (Dija, 14, 2015:143); *profetizmi* ***eventual*** (Dija, 12, 2014:89); ***eventualisht*** *për të bërë një prerje sado pak të përfillshme* (Lemba 3-4, 2000:129); ***konstatim spekulativ*** (Dija, 12, 2014:89); *përurimi i librit është* ***moderuar*** *nga shkrimtari* (Dija, 12, 2014:102); *janë duke u përkthyer vepra të autorëve të huaj të cilët si* ***inspirim*** *dhe çështje* ***preokupuese*** *kanë pasur të kaluarën e shqiptarëve he të Shqipërisë* (Lemba 15, 2010:139); *në sajë të informacioneve që* ***disponojmë*** (Lemba 15, 2010:139); *mënyrë* ***transparente*** (Lemba 15, 2010:140); *materialin* ***e prezantuar*** (Lemba 15, 2010:140); *në sajë të* ***konsultimet*** *të një bibliografie* ***selektive*** (Lemba 15, 2010:140); ***qasjen*** *profesionale* (Lemba 15, 2010:150); ***eventualisht*** *për të bërë një prerje sado pak të përfillshme* (Lemba 15, 2000:129); *angazhim serioz* ***shumëdimensional*** (Lemba 13-14,2009:8); *duhet të gëzojmë* ***tretman*** *të barabartë* (Lemba 13-14,2009:9); *për të* ***evituar konfrontimin*** *midis masave dhe pushtetit* (Lemba 13-14,2009:8); *flet****ë*** ***(?)*** *në mënyrë* ***eksplicite*** *konsulli i Serbisë në Prishtinë* (Lemba 13-14,2009:13); *vazhduesi* ***konseguent*** *i veprës së Nexhipit* (Lemba 13-14,2009:42); *duke* ***akceptuar qasjen integrative*** *toksononimisë dhe përshkrimit etnografik në gjuhë* (Lemba 13-14,2009:124); ***ekspansioni*** *i medias* (Lemba 13-14,2009:133); *orientime* ***liberalodinastike*** (Lemba 13-14,2009:146); *nuk e kishte* ***disponimin*** *e mëparshëm* (Lemba 13-14,2009:201); *Shqiptarët duhet të* ***ridimensionojnë*** *dhe* ***ridefinojnë*** *interesat dhe përparësitë e tyre kombëtare* (Lemba 3-4,2000:77); *nga atlaret e shenjta predikojnë vetëm urrejtje,* ***revansh*** (Lemba 3-4,2000:83); *shqiptarët* ***konstituohen*** *si komb* (Lemba 3-4,2000:133); *pasojat e* ***dezintegrimit*** (Lemba 3-4,2000:133); ***frustimet*** *e panumërta* (Lemba 3-4,2000:133); *studim* ***ekstensiv*** (Lemba 3-4,2000:135); *raporte* ***reciproke*** (Lemba 3-4,2000:136); *komunikime* ***interpersonale*** (Lemba 3-4,2000:136); *për* ***të konkluduar*** *se proceset e migrimit janë faktorë të rëndësishëm* (Lemba 3-4,2000:137); ***impon*** *hartimin e një platforme* (Pozita, 2010:43); *përmirësime* ***eventuale*** (Pozita, 2010:47); *shenja* ***adekuate*** *pikësimi* (Pozita, 2010:54); ***avenimente*** *nga ngjarjet e spikatura* (Dija, 2, 2004:214); ***imlikimi*** *i një sërë ndjenjash përreth saj* (Dija, 2, 2004:214); *të lexohen këto fotografi duhet pasur edhe shpirt* ***subtil*** (Dija, 2, 2004:215); *na* ***okupon*** *me origjinalitet kuptimor dhe* ***revelant*** *edhe me kujtesën tonë kombëtare* (Dija, 2, 2004:216); ***fluid*** *të gjallë bashkimi* (Dija, 2, 2004:217); ***versifikim*** *modernist* (Dija, 2, 2004:206); *veprat*

i ***serviren*** *lexuesit shqiptar* (Dija, 8-9, 2011:5); *jetës* ***kontemplative*** (Dija, 8-9, 2011:9); *letra* ***dedikatore*** *e Martin Barletit*(Dija, 8-9, 2011:45) etj.

- *Vepra është në* ***kanavacë*** *dhe është punuar me ngjyra vaji*. (Lemba 9, 2005: 89).
- *Me këto* ***qasje*** *ndaj librit për lexuesin dhe të pranishmit e asaj nate,* ***panelistët*** *sollën Tiranën, Shkodrën dhe Ulqinin në Tuzin e Malësisë duke vërtetuar se kultura s'ka kufinj*. (Malësia 2016:336).
- *Sipas njohjeve empirike në fushën* ***kuadrovike*** *eliminohen të gjitha parimet e* ***proklamuara*** *publike, dhe si kuadër kalon a ii cili arrin që rrethanat konkrete t'i drejtoj në dobi dhe favor të vetë*. (Malësia 2009:282).
- *Filozofia e liberalizimit borgjez ka qenë e bindur se me sistemin shumëpartiak është gjetur* ***definitivisht*** *modeli* ***adekuat*** *dhe i drejtë i politikës kuadrovike*. (Malësia 2009:285).
- ***Implementimi*** *i tij krijon bazën* ***ekzakte*** *për promovimin e mëtejshëm* ***eventual****, ndërsa mos* ***implementimi*** *duhet të ketë* ***konsekuenca*** *me votimin e mosbesimit apo të mospërsëritjes së mandatit.* (Malësia 2009: 284).
- *Ndërsa kur kemi të bëjmë me vepra të autorëve të huaj dhe ajo i* ***prezantohet opinionit*** *e përkthyer në gjuhën shqipe kënaqësia është e dyfishtë****.*** (Lemba15, 2010, 139).
- *Jemi* ***tubuar*** *për të përkujtuar intelektualin dhe atdhetarin e shquar dom Simon Filipaj.* (Lemba3-4, 2000, 87).
- *Nuk jemi mjaftuar vetëm me* ***evidentimin*** *e këtyre fakteve, por* ***kemi evidentuar*** *se çfarë është bërë për ta mbajtur shqipen sa më larg këtyre ndikimeve dhe çfarë duhet bërë në të ardhmen.* (Pozita, 2010:127).

Me denduri të madhe paraqiten jo vetëm fjalë të shkëputura, por ato shoqërohen me çerdhe, si: *obligoj, obligim, i obliguar; okupoj, okupim, okupues; konkludoj, konkludim* që kanë një dendësi të madhe përdorimi së bashku me *definoj, definim.* (Priku, Pozita 2010:30).

- *Qëndrimi I tij na nxit të* ***konkludojmë*** *se gjithçka ndrohet në këtë botë, ndrohet e shndërrohet, shitet e blehet, por vetëm gjuha amtareqë është trashëgim it ë parëve, as nuk shitet as nuk blehet, ajo duhet të ruhet, të çmohet*. (Lemba3-4, 2000, 87).

Në stukturën sintaksore rastet më tipike i përbëjnë ato të rendit të përmbysur të gjymtyrëve. Në disa raste ndeshim ndërtimet veprore në vend të atyre pësore si: *diplomoj sivjet, nuk vjen në konsideratë* etj. Të bie në sy denduria

e madhe e ndërtimeve pësore në vend të atyre veprore etj. Po japim ndonjë shembull.

- *Kjo edhe ka ndodhur me anulimin e marrëveshjes të nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të PKSH dhe Ballistëve në Mukje në gusht të vitit 1943, duke* ***iu falenderuar intervenimit*** *të M. Popovicit…* (Malësia 2009: 168).

PËRFUNDIME

Gjuha e botimeve të viteve të fundit është premtuese. Nëse studiohet kjo gjuhë në rrjedhë kohore, shohim se ka përmirësime të dukshme gjatë viteve. Natyrisht për përmirësimin e këtyre botimeve kanë ndikuar shumë faktorë si: vetë gjuhëtarët shqiptarë që ligjërojnë në këto institucione, si dhe shkolla e lartë, arsimtarët, shkrimtarët, publicistët, intelektualët si dhe të gjithë punonjësit e tjerë.

Rol të madh luajnë veprat shkencore të botuara në Shqipëri e në disa raste u ribotuan në Mal të Zi si: *Leksikon i gjuhëtarëve të shquar shqiptarë,* botuar nga Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë Malazeze- Podgoricë në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"-Instituti i Studimeve Albanologjike[36] etj.

Ndihmesë të mirë në përhapjen e gjuhës letrare kombëtare shqipe në Mal të Zi ka dhënë edhe ribotimi i teksteve shkollore shqiptare si: *Bukuria e gjuhës për shkollat e mesme*[37] etj., kontaktet e ligjëratat e mbajtura nga pedagogët e Universitetit Luigj Gurakuqi, punonjësit shkencorë të Tiranës etj. Për përgatitjen e teksteve shkollore në gjuhën shqipe kanë dhënë ndihmesën e tyre mjaft autorë të njohur në këtë fushë në Shqipëri si: Bahri Beci, Rami Memushaj, Ardian Marashi, Artan Haxhi e Tefë Topalli të cilët kanë përgatitur e vënë në qarkullim serinë e plotë të librave shkollorë nga Cikli i Ulët deri në mbarim të shkollës së mesme, pa lënë mënjanë edhe ndihmesën e disa autorëve të trevave shqiptare të Malit të Zi, në përgjithësi mësues me përvojë të gjatë të formuar pedagogjisht e gjuhësisht në Universitetin e Prishtinës. Kjo ka bërë që të ngrihet cilësia shkencore, pasi

[36] Artan Haxhi-Tefë Topalli, *Leksikon i gjuhëtarëve të shquar shqiptarë,* botuar nga Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë Malazeze - Podgoricë në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" - Instituti i Studimeve Albanologjike, Podgoricë-Shkodër, 2013.

[37] Shih: Rami Memushaj, *Bukuria e gjuhës*, (Për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm), Podgoricë, 2007; Rami Memushaj, *Bukuria e gjuhës*, (Për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm), Podgoricë, 2008; Rami Memushaj, *Bukuria e gjuhës*, (Për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm), Podgoricë, 2009; Artan Haxhi – Tefë Topalli, *Bukuria e gjuhës*, (Për klasën e katërt të gjimnazit të përgjithshëm), Podgoricë, 2010.

kemi të bëjmë me autorë, njohës të mirë të gjuhës shqipe.

Një element që luan rol në zhvillimin e gjuhës shqipe në zonat me populsi shqiptare është dega e gjuhës shqipe për përgatitjen e mësuesve të shkollës fillore pranë Universitetit të Podgoricës. Këta studentë- mësues (të cilët dalin çdo vit) duke u përgatitur me kulturën e nevojshme në gjuhën shqipe, pasi ligjëruesit nga Shqipëria janë mbrojtës dhe përhapës të kësaj gjuhe.

T. Osmani shprehet se "*hapja e kufijve dhe afërsia gjeografike me Shqipërinë ka bërë që edhe një numër i konsiderueshëm studentësh të ndjekin Universitetin e Shkodrës. Studimet e larta në gjuhën shqipe në të dy universitetet ka sjellë një ngritje si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Ata janë njohur me tekste të reja universitare, larg strukturave të huaja gramatikore*".[38]

Një rol me rëndësi luan edhe gazeta e përjavshme "Koha Javore", revistat me peridiocitet të pacaktuar si: *Lemba, Malësia, Buzuku, Dija*. Këta do të ndihmojnë në ruajtjen e përhapjen e gjuhës amtare shqipe, si pasqyra të ligjërimit letrar shqip, me ngjyrat, veçantitë, pasuritë historike e kulturore të këtyre trevave. Këto revista janë pjesë e pandarë e kulturës sonë, e shkencës e komunikimit letrar e shpirtëror, aspekte të jetës të cilat kanë mbajtur gjallë në kohëra identitetin e kombit shqiptar.

Biblioteka e Ulqinit duke zhvilluar veprimtarinë bibliotekare ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Përveç grumbullimit, përpunimit, ruajtjes dhe dhënies në lexim të çdo materiali në gjuhën shqipe, ajo paraqet kulturën shqiptare përmes organizimeve të ndryshme shkencore-kulturore.

Shumicën e fondit libror në gjuhën shqipe e përbëjnë librat nga shkrimtarët shqiptarë, por ka mjaft edhe letërsi të huaj të përkthyer. Në këtë bibliotekë ka edhe libra të fushave të ndryshme shkencore, si dhe fjalorë, enciklopedi e leksikone. Ky fond është i rëndësishëm për studiuesit, për studentët që dëshirojnë të zgjerojnë kufijtë e dijes, të cilët rregullisht shfrytëzojnë sallën e leximit dhe të cilëve me një profesionalizëm të lartë i ndihmon personeli i bibliotekës. Kujdes të veçantë i kushtohet letërsisë për fëmijë. Fondi i librave është mjaft i pasur. Në bibliotekë edhe takime me shkrimtarë për fëmijë, përurime të librave për fëmijë, orë letrare etj.

Mbajtja e disa konferencave dhe simpoziumeve shkencore i ka dhënë shtytje studimit të gjuhës së sotme shqipe në trevat e Malit e Zi.

---

[38] Tomor Osmani, *Shqipja e Malit të Zi në sfidat e kohës*, kumtesë e mbajtur në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2010, vëllimi I, f. 332.

BIBLIOGRAFIA[39]

A. REVISTA

- Revista "*Lemba*" nr. 1- 19, Ulqin, 1998-2017.
- Revista "*Dija*" nr. 1-15, Ulqin 2003-2017.
- Revista "*Malësia"* nr. 1-12, Podgoricë, 2005-2017.

B. KONFERENCA

- *Meshari i Gjon Buzukut-Monument i kulturës* shqiptare (Material nga sesioni shkencor mbajtur më, 19, 20 maj 1995 në Ulqin) botuar, Ulqin, 1995.
- *Ulqini në rrjedhat e kohës*" (Simpozium shkencor 26-27 maj 2000),
- botim i ART CLUB i Ulqinit, Ulqin, 2000.
- *Ymer Prizreni, Personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (25-26 maj 2002), botuar Art Club, Ulqin, 2002.
- *Shasi i lashtë-Monument i kulturës* (Përmbledhje e kumtesave nga sesioni shkencor i mbajtur më 16-17 maj 2008), Ulqin, 2009.
- *Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi*, Ulqin, 19.12. 2009, botuar ART CLUB, 2010.
- *Letërsia gojore dhe identiteti kombëtar shqiptar*, Ulqin 2011.
- *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve*, Ulqin, 2011.

LITERATURË NDIHMËSE

- Arben Prendi, *Shqyrtime mbi veprën letrare të disa shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë në Malin e Zi*, rev. "Malësia" nr.6, 2011, f. 261-273.
- David Luka, *Shënime për veprën GLOSAR (Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit)* i Hajro Ulqinakut, *STUDIME GJUHËSORE IX***,** Shkodër, 2006, f. 152-156. *Shënime për veprën "GLOSAR" (Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit) i Hajro Ulqinakut,* në revistën "DIJA", organ i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi (Ulqin), nr. 2, Ulqin, 2004.
- Emil Lafe, *Revistat shkencore –kulturore të shqiptarëve në Malin e Zi –një ndihmesë e shquar në shkencën dhe kulturën kombëtare*, rev. "Dija", nr.12, 2014, Ulqin, f. 294-299.
- Gjovalin Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe,* Tiranë, 2009.
- Haxhi Shabani, *Domenet publike të shqipes në Malin e Zi*, kumtesë e mbajtur në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2015 (34/1), vëllimi I, f. 229-238.
-

[39] Këto janë disa nga literaturat kryesore të tjerat, veprat e autorëve, janë cituar gjatë punimit..

- Ismail Doda, *Zbatimi i gjuhës së njësuar letrare shqipe te shqiptarët në Malin e Zi*, Aktet e Konferencës Shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria standarde sot" Tiranë 2003, f.338-346.
- Mimoza Priku, *Ndikimet e huaja në të folmet shqipe të përdorura në trevat e Malit të Zi,* botuar në Aktet e konferencës, *Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi*, botuar ART CLUB, 2010, f. 27-34.
- Nail Draga, *Ndryshimet në strukturën kombëtare në Mal të Zi, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2003*, rev. "Malësia", nr.1, Podgoricë 2005, f.127-140.
- Nikë Gashaj, *Ardhmëria e Malit të Zi dhe pakicat*, rev. "Malësia", nr.1, Podgoricë 2005, f.171-174.
- Tomor Osmani, *Një organ i arrirë i krijuesve shqiptarë të Malit të Zi, revista "Dija",* botuar, në rev. "Dija", 2, 2004, Ulqin, f. 7-10.
- Tomor Osmani, *Shqipja e Malit të Zi në sfidat e kohës*, kumtesë e mbajtur në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2010, vëllimi I, f. 331-335.
- Mimoza Priku, *Arsimi në gjuhën shqipe në Mal të Zi sfidë e një bashkëpunimi ndërgjuhësor e ndëretnik, në konferencën ndërkombëtare "Komunikimi ndëretnik në Ballkan*", organizuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, departamenti i Gjuhës shqipe, 1 nëntor 2013, Tiranë 2013, f. 73-81.

Dr. Alva DANI

TË EDUKOSH PËRMES DANTES; PEDAGOGJIA E NJË POETI

Considerate la vostra semenza:
fatti non foste a viver come bruti,
ma per seguire virtute e conoscenza.

D.Alighieri

Të flasësh për *Komedinë Hyjnore*, të flasësh për Danten, ashtu si edhe për çdo vepër të madhe të njerëzimit, do të thotë të thotë të thellosh njohuritëpër veten dhe për historinë tënde, me fjalë të tjera të zbulosh dimensionin njerëzor. Librat klasike janë ata që"nuk kanë mbaruar ende së thëni atë që kanë për të thënë", na kanë rrëfyer, na rrëfejnë edhe sot e do të vazhdojnë ta bëjnë edhe në të ardhmen sepse ata janë pikësrisht vepra me përmasa të jashtëzakonshme. "Planeti ynë – shkruan Kadare –është tepër i vogël për ta bërë të shmangshëm Dante Aligierin. Dantes nuk mund t'i iket, ashtu siç nuk i iket dot ndërgjegjes. Asnjë vepër tjetër letrare nuk e ka ndërgjegjen njerëzore, më saktë, krusmën e saj, në qendër të vet"[1].

Dante Aligieri është poeti i madh i letërsisë italiane, është babai i gjuhës dhe historisë italiane, por mbi të gjitha është njeriu i dyshimeve të mëdha, pasigurive, vuajtjeve dhe pendimeve, optimizmit dhe frikës, njeriu që përshkoi"la selva oscura"(pyllin e errët) apo "La montagna illuminata dal sole" (malin e ndriçuar nga dielli),që jeton dramat dhe shpresat e tij njëlloj si të gjithë ne. *Ferri, Purgatori* dhe *Parajsa* janë "të tri gjendjet tona", që ne i përjetojmë njëherazi, gjithmonë e gjithkund. Personazhet e tyre realë, nuk janë gjë tjetër vetëm përshkrimi i vlerave më të mira që një qënie njerëzore mund të mbartë, në *Parajsë* dhe i veseve më të ulëta e krimeve më të tmerrshme në *Ferr*, mes të cilëve: hajdutë, gënjeshtarë, tradhëtarë, falsifikatorë, arrogantë etj.

Kur Konti Ugolino në rrethin e nëntë të*Ferrit* përshkruhet nga Dante duke copëtuar me dhëmbë dhe duke ngrënë kokën e kundërshtarit të tij arqipeshkvit

Ruxheri, pasi e kishte tradhëtuar, kërkon të thotë pikërisht këtë;

[1] Ismail Kadare, *Dantja i pashmangshëm*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 7.

se natyra njerëzore mund të bëjë të paimagjinueshmen, por Gjeniu shkroi në *Komedinë Hyjnore* se ka edhe rrugë për të dalë nga *Ferri* ku shumë jetojnë.

Prandaj lexuesi gjendet përballë këtij poeti të madh, me inteligjencë të jashtëzakonshme që trajton problematika të vërteta, që i përkasin njeriut të përhershëm, të çdokohshëm, njeriut që endet nëpër njemijë pyetjet e ekzistencës së tij dhe njëmijë përgjigjeve të lodhshme. *Komedia Hyjnore*, ashtu si edhe shumë vepra të tjera klasike të së shkuarës trajton koncepte dhe eksperienca që janë shumë të largëta me eksperiencat e kohëve tona, në një mënyrë tmerrësisht të ndërlikuar. Studiuesit pohojnë se është ndoshta vepra e vetme, e madhe letrare që nuk mund të lexohet pa një koment, apo pa një enciklopedi të mirë në dorë. Studiuesi Alfred Uçi do të shkruante: "Nuk bën që lexuesi të nisë leximin e saj me paragjykimin se është vepër shumë e vështirë, e errët, e ndërlikuar, hermetike, përkundrazi, aty ku ka përsosmëri të mirëfilltë, ka thjeshtësi të kuptueshme"[2].

Prandaj studentët e lexojnë me kënaqsi udhëtimin e Dantes, shtigjet, përmes të cilave kalon aventura dhe poezia e tij, deri aty sa asnjë tjetër më parë nuk kishte shkuar. Prandaj edhe ne së bashku me Danten hyjmë në këtë rrugëtim ekzistencial, duke përshkuar në të njejtën kohë edhe një rrugëtim edukativ thelbësor. Poeti i madh është edhe një edukator i madh. Pothuajse të gjitha takimet me personazhet e njohur të komedisë, me Konte Ugolino, Françeska da Rimini, Uliksin etj, të gjitha përvojat emocionale, intelektuale, të gjitha dialogjet me udhëheqësit e tij Virgjilin e pastaj Beatriçen, do të ndikojnë në edukimin e lexuesit dhe do t'i sugjerojnë atij karakteristikat e nevojshme për një edukim që do të na bëjë edhe më shumë njerëzor, edhe më të fortë për t'u përballur me ndërgjegjen e ekzistencës tonë të vdekshme. Përpunon poetikisht karaktere njerëzore, herë duke i psikologjizuar, herë duke i vënë në prova e veprime e herë të tjera ua tregon shpirtin përmes mendimeve e ndjenjave të tyre, duke i shndërruar kështu në figura të pashlyeshme që mbetën në kujtesën e lexuesit.

Personazhi Dante ka humbur në pyllin e errët të mëkatit, ndjen frikë, ankth dhe mbi të gjitha ndjehet i vetëm, ka harruar rrugën e vërtetë (la verace via), atë të virtytit dhe nuk arrin më të kuptojë thelbin e vetes dhe të realitetit.

"Nuk di të them si brenda pyllit mbeta se gjumi sytë fort m'i pat platitur, kur rrugën e vërtetë i mjeri treta". (Ferri, I, 10-12).

Dante duhet të gjejë veten tashmë, e prandaj ndjen nevojën e dikujt që ta drejtojë e ta mësojë me përvojën e jetës, ndjen nevojën e një mësuesi: kjo do të thotë se edukimi është i mundur ateherë kur vetë nxënësi e kërkon këtë dhe i nxitur nga dëshira për t'u rritur si njeri, së brendshmi, zgjedh mësuesin e tij. Dhe

[2] A.Uçi, *Universi i komedisë hyjnore*, Gazeta Shekulli, 29. 03. 2015.

jo rastësisht është Virgjili, poeti i madh latin i Mesjetës.

Në raportin mes Virgjilit e Dantes ne shohim modelin e raportit mësues - nxënës, duke theksuar edhe nevojën e një lidhjeje afektive që ekziston mes tyre, duke u mbështetur më shumë se në joshjen që ushtron figura e mësuesit, në besimin e njërit dhe në përgjegjësinë e tjetrit. Ka edhe nga ata që propozojnë një vizion sokratik të mësimdhënies, në të cilin mësuesi, përmes personalitetit të tij arrin të ndezë tek nxënësi dëshirën për dije. Por a është e mundur të varet suksesi i edukimit nga aftësia nxitëse apo karizma e mësuesit? Kjo do të ishte e tepër, sepse ajo që do të bashkonte thelbësisht mësuesin dhe nxënësin në këtë proces të edukimit do të ishte vetëm dashuria për dije, për njohuri epër kulturë. Kështu edhe Platoni nuk do të kishte qenë i tillë nëse nuk do kishte takuar Sokratin, po kështu edhe Dante, Virgjilin. E prandaj Virgjili, mësuesi i përjetshëm e di shumë mirë rolin e tij, që do të vijë edhe një moment kur ai duhet të bëjë mënjanë dhe t'i lërë nxënësit të tij Dantes, gjithë përgjegjësinë e të qënit mësues i vetes së tij.

Që në fillim, në tre këngët e para të Ferrit dalin në pah njohuritë pedagogjike të jashtëzakonshme të Dantes, realiteti fetar dhe njerëzor, që karakterizon mentalitetin e tij, pra atë të një njeriu mesjetar, krijon bindjen se njeriu mund të mësojë deri në momentin e fundit të jetës. Edukimi dhe të mësuarit nuk lidhet vetëm më fëmijët dhe adoleshentët, por edhe me njeriun e çfarëdo moshe, Dante vetë ishte 35 vjec, kur ndërmori këtë rrugëtim. Një instrument i nevojshëm për edukimin, për njohjen e vetes dhe të realitetit është *arsyeja* (racionalja) dhe jo rastësisht mësuesi që zgjedh Dante konsiderohet në Mesjetë si simboli i Arsyes. Para se të njohë eksperiencat e jetës, Dante duhet të rigjejë arsyen, kapacitetin për të perceptuar realitetin, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, edhe ato shpirtërorë. Virgjili, poeti dhe mësuesi i dashur, është burimi i sigurisë së tij, burimi i energjisë pozitive për të ecur përpara. Marrëdhënia mësues – nxënës është një marrëdhënie e fortë besimi, ku secili e do dhe e inkurajon tjetrin.

Në poemë gjejmë shembuj të kësaj sigurie dhe dashamirësie me të cilën Virgjili ushqen Danten. Kështu në këngën XXVII të Purgatorit, duke mbërritur në shkallën e fundit, atë të epshit, Dante duhet të kalojë përmes një perde zjarri, ose përndryshe nuk mund të vazhdojë rrugën. Qëndron në vend dhe nuk lëviz megjithë insistimin e Virgjilit: *"e io pur fermo e contra coscienza"*. Por vetëm atëherë kur Virgjili i thotë se në anën tjetër e pret Beatriçja (vajza që dashuronte që në rininë e hershme) ai vazhdon rrugën duke kaluar përmes zjarrit. Virgjili e kupton dhe e ngushëllon në këtë dhimbje të purifikimit:

"Lo dolce padre mio, per confortarmi,/ pur di Beatrice ragionando andava…" (vargu 52-53).

Nuk mund të edukosh përveçse një filtri afektiv, dhe aq më shumë nuk

mund të mësosh nëse nuk i jep nxënësit një lloj mirëkuptimi, një lloj sigurie që ai është i rëndësishëm për mësuesin dhe që ai do më të mirën e tij. Pasiguria e kësaj lloj lidhjeje mund të kompromet ojë raportin me realitetin, me librin që do të studiosh duke krijuar edhe një bllokim të arsyes, fakt me të cilin përballemi që në këngët e para të *Ferrit,* element ky pedagogjik që duhet mbajtur parasysh nga prindërit dhe mësuesit.

Virgjili e udhëheq Danten përmes *Ferrit* dhe *Purgatorit* sepse i duhet të mësojë gjithçka mbi ekzistencën, i duhet të mësojë dinjitetin e të qënit njeri, dinjitetin e arsyes; faktin se realiteti është më i madh se ne, se del jashtë përmasave tona, e se në fund ia vlen të jetosh qoftë edhe vetëm për të njohur misterin e jetës dhe arsyen e cila na ndihmon për ta kuptuar, e për këtë mjafton Virgjili, ose edhe thjesht të qënit poet.

"Asnjë të mos harrojë se asht njeri; ju lè nuk keni për t'gjallue si shtazë; po për të ndjekë virtyt e dituni" shkruan Dante në këngën XXVI të Ferrit (Ferri,XXVI,118-12).

Studiuesi i njohur Teodorov, në veprën "Letërsia në rrezik", që në fillim të librit shtron pyetjen "Përse e dua letërsinë? Sepse ajo më ndihmon të jetoj, larg të qënit një argëtim, një dëfrim i rrezervuar vetëm për personat e edukuar, ajo i mundëson secilit që t'i përgjigjet më mirë prirjes personale të të qënit njeri…". Ndaj edhe sot, ajo që kërkohet më shumë prej të gjithëve është pikërisht "të qënit njeri". Ashtu si edhe Dante në 1300-tën, edhe Teodorov vazhdon të ndajë të njëjtin mendim, se "letërsia mund të bëjë shumë gjë. Ajo mund të na shtrijë dorën atëherë kur jemi thellësisht të dëshpëruar, të na drejtojë nga qëniet e tjera njerëzore përreth nesh, të na bëjë të kuptojmë edhe më mirë botën dhe të na ndihmojë të jetojmë… ".

Kështu *Komedia Hyjnore* dhe në veçanti *Parajsa,* përbën për Danten një reflektim të thellë mbi kuptimin e poezisë. E gjithë letërsia italiana i ka borxh Dantes këtë ndërgjegje të thellë mbi rëndësinëe poezisë, si e vetmja rrugëe sigurt që të çon tek e vërteta. Poeti i madh mendon se streha e vërtetë e njeriut nuk është toka, por është *Parajsa*, raporti me pafundësinë, me Zotin, aty ku njeriu kthehet në origjinën e tij. Në këngën XVII Dante i kërkon Cacciaguidës, paraardhësit të tij, nëse duhet të tregojë të vërtetën kur të kthehet në tokë, apo duhet të heshtë për të evituar telashet. Cacciaguida përgjigjet:

"Ma nondimen, rimossa ogni menzogna, / tutta tua vision fa manifesta; / e lascia pur grattar dov'è la rogna» (XVII, 127-129), që do të thotë që poezia duhet të vihet vetëm në shërbim të së vërtetës. Nëse ka diçka përballë së cilës mund të përulet poezia, ajo është e vërteta, poezia duhet të vihet në shërbim të së vërtetës, madje duhet të jetë rruga që të çon tek e vërteta, e në fakt përmes *Komedisë*

Hyjnore, Dante dhe lexuesi i tij arrijnë të takohen me" il sommo bene"(të mirën), qëështë vetë qëllimi i jetës.

Dhe neve nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta ndjekim në këtë udhëtim drejt perfeksionit, drejt korrigjimit të gabimeve, drejt dritës së krijimit gjuhësor dhe narrativ, duke qenë të ndërgjegjshëm se më e bukura e mësimdhënies është kalimi i njohurive dhe *aftësive* nga mësuesi tek nxënësi, nga errësira e një pylli të errët në dritën e dijes dhe të dashurisë. *Komedia Hyjnore* është një mjet shumë i mirë didaktik për mësuesin: përmes leximit të pjesëve të ndryshme të Komedisë mund të arrihen jo vetëm objektivat thelbësore të të nxënit gjuhësor, të dëgjuari, të kuptuarit, por edhe kompetenca teknika dhe të motivimit, të përfshirjes dhe të qytetërimit.

Komedia Hyjnore nuk është thjesht një vepër që përfshihet me detyrim në kurrikulat e letërsisë, dhe Dante Aligieri nuk është autori që duhet të studiohet pa e diskutuar. Elioti shkruante se këngët e Dantes "duhen lexuar si zgjerime të hapësirës rreptësisht të kufizuar njerëzore"[3]. Ne mund të rendisim të paktën pesë arsye, të cilat motivojnë studentët të zgjedhin dhe të lexojnë me dëshirë dhe kureshtje Danten.

Dante na mëson të ëndërrojmë pa limite hapësire dhe kohe. Ai zgjedh mësues dhe drejtues të jashtëzakonshëm, të cilët përfaqësojnë përkatësisht edhe tre mitet e tij; miti i dijes që është Virgjili, miti i zemrës që është Beatriçja dhe miti i besimit që është Shën Bernardi. Ëndrra e tij është aq e madhe sa i lejon Dantes të gjejë përsëri dashuritë e humbura të jetës e madje edhe rrënjët e tij të hershme, duke takuar një stër stërgjysh të veçantë, Cacciaguida-n.

Dante na mëson të njohim kufizimet dhe frikërat tona: nuk është diçka e zakonshme të ndodhesh papritur përballë simboleve të difekteve tona, personifikimeve të llahtarshme të frikërave tona. Dante na mëson guximin për të parë tek vetja jonë dhe tek të tjerët, të gjitha mangësitë, ashtu siç na mëson edhe mirëkuptimin dhe forcën për t'i përmirësuar.

Edhe në këndvështrimin psikoanalitik është mjaft interesant fakti sesi udhëtimi i Dantes duhet të kalojë patjetër përmes *Ferrit*, për të mbërritur në fund në *Parajsë*. Në arkitekturën e tij perfekte, gjithçka është e studiuar në detaje. Të kalosh nëpër Ferr është pjesë e pashmangshme e udhëtimit. Madje, çdo gjë që mësohet në Ferr është e domosdoshme për të arritur qëllimin. Pa këto njohuri nuk mund të vazhdohet rruga drejt dhuratave të Parajsës: pastërtisë së shpirtit dhe jetës. Dante zbret vetë në ferr dhe në fund të udhëtimit zbulon parajsën, duke u treguar të gjithëve se pa kaluar vuajtje dhe mundime, askush nuk mund të arrijë qëllimin, Parajsën. Dhe kjo sigurisht vlen për çdo parajsë të kësaj bote.

---

3 I.Kadare, *Dantja i pashmangshwm*, Onufri, Tiranw, 2005, f.8.

Element tjetër motivues dhe përfshirës është edhe besimi i madh që poeti ka për mësuesin e tij të udhës. Kështu për shembull në këngën e tretë të Ferrit, Dante ndjehet i tmerruar në atë vend të frikshëm, ku janë dënuar njërëzit që nuk kanë bërë as mirë e as keq. Qielli i ka dëbuar se ia prishin bukurinë, Ferri po ashtu se nuk janë mëkatarë. Aty dëgjohen vajtime, ulërima, klithma, gjëma, aq sa edhe Dante fillon të qajë. Virgjili i thotë se duhet të bëhet i fortë dhe të hedhë çdo gjë pas krahëve, se duhet të ecë përpara e të kalojnë përmes një lumi të zi e të ftohtë si vdekja, me ndihmën e transportuesit plak Karonit.Po ashtu "para portave të Ditit, qytetit të hekurt të heretikëve, sa s'i bije të fikët kur mend rrëzohet mbi cfurqet e djajve ose kur e mbron me trupin e vet Virgjili dhe e ruan nga shikimi i Meduzës që të ngurëson"[4]. Megjithë tmerrin që e kaplon duke parë torturat e mundimet e shpirtrave në Ferr, Dante vendos të ndjekë Virgjilin dhe të besojë në rrëfimet e dhe vendimet e tij.

Dante na mëson të lexojmë në mënyrë të mençur realitetin e sotëm, realitetin e një kohe të pasigurtë, ku e ardhmja nuk është e qartë, madje është fare e turbullt, ku iluzioni dhe ëndrra shiten fare lirë e ku e vetmja zgjidhje e problemeve duket sikur është pandërshmëria dhe amoraliteti.

Përtej ndryshime të përgjithshme tepër të thella që ekzistojnë mes kohës tonë dhe asaj të poetit fiorentin, shkruan Faffaele Urraro[5], ka një karakteristikë që përbashkon këto dy periudha historike: janë dy botë në të cilat njeriu është i goditur fort nga një ndenjë e fortë pasigurie. Kur njeriu jeton dramën historike të një shoqërie në lëvizje, kur ai vetë nuk e di se cila do të jetë e ardhmja e tij dhe e shoqërisë në të cilën jeton, kur vlerat mbi të cilat është themeluar një shoqëri janë zhdukur, atëherë e ndjen në lëkurë atë ndjesinë e pasigurisë e brishtësisë, që e vendos në një dimension të paqëndrueshëm dhe tranzitor. Atëherë bëhet e nevojshme gjetja e pikave të referimit, të horizonteve të pastra e të spirancave të shpëtimit ku të mund të kacavirresh.

Në këtë kontekst, Dante të nxit të reflektosh se jeta është shumë më e rëndësishme dhe shumë më serioze, e prandaj të rinjtë duhet të gjejnë rrugë të tjera zgjidhjeje dhe duhet të përshkojnë, pikërisht ata rrugë që të çojnë drejt zgjidhjes (drejt diellit që ndriçon malin) dhe jo drejt shkatërrimit.Po kështu mendon edhe akademiku Alfred Uçi duke përçuar me bindje idenë se "Pavarësisht nga progresi i shumëanshëm i shoqërisë së sotme, kjo është përfshirë në një krizë të thellë morale, është në kërkim të rrugëdaljes e të kapërcimit të saj… Dantja është aktual sepse të ndihmon të kuptosh se në ç'situatë apokaliptike ndodhet njerëzimi i

[4] Alfred Uçi, *Ferr-Parajsa danteske*, Argeta-LMG, Tiranë, 1998, f.79.

[5] Raffaele Urraro, *La modernità di Dante*,

sotëm dhe ç'duhet të bëjë për ta shmangur katastrofën që e kërcënon"[6].

Prandaj Dante është aktual, sepse mesazhet që përçon janë përherë reale, pëtej bindjeve filozofike dhe fetare të gjithsecilit prej nesh; pra çdo njeri, gjatë gjithë rrugëtimit të tij ekzistencial, duhet të kërkojë modelin më pozitiv të realizimit të vetes dhe personalitetit të vet, duke ditur tashmë që mund të gjendet gjithmonë një rrugëzgjidhjeje, të cilën duhet ta përshkojmë me ndërgjegje të plotë. Një aristotelian si Dantja nuk mund të jepte një mesazh tjetër.

Për poetin e madh fiorentin është interesante të themi edhe se nuk ka qenë fare i padëgjuar emri i truallit tonë. Ai ndoshta do të kishte dashur ta shikonte me sytë e vet atë fushën, pranë Durrësit, që përmendet në histori, ku u përleshën Cezari dhe Pompeu në betejën e famshme, që në Këngën e VI-të të *Parajsës*, kujtohet duke i thurur lavde perandorit të Romës:

Solli pastaj ushtëritë kah Spanja fill,
pastaj kah Durrësi, e shkrepi mbi Farsalë,
sa dhimbja u ndi n'atë Nil të nxehtë nën diell.
(Inver la Spagna rivolse lo stuolo,
poi ver Durazzo, e Farsalia percosse
Si ch'al Nil caldo si senti del duolo.)
(Parajsa, VI, 64-66)

Në botën e sotme Danteja është universal, ai u përket të gjithëve, ashtu si edhe dantologjia, shkenca që merret me studimin e tij. Umberto Eco thotë se "poetë të tillë si Dantja, Homeri dhe Gëtja kanë krijuar libra globalë, vepra që lidhin qiellin e tokën, të kaluarën dhe të tashmën, historinë dhe eternitetin. Dantja, Homeri dhe Gëtja konsiderohen të përqendruar thellësisht në realitetin historik që i rrethonte dhe vetëm përmes tij mund t'i japin formë tërë Universit".

Me pak fjalë Dante duhet studiuar sepse është një burim i pakrahasueshëm dijesh dhe humanizmi, që nuk mund të lihet mënjanë, sot më shumë se kurrë, në një periudhë ku Shkencat Humane po vihen në diskutim. Po të studiojnë të gjithë Ekonomi apo Inxhinieri askush nuk do ta lexonte më Danten, dhe Dante do të vdiste. E ky do të ishte një mëkat i madh, sepse njeriu nuk është vetëm para, njeriu është edhe mendim, e prandaj të studiosh letërsi sot nuk është vetëm një guxim i madh, por është edhe një zgjedhje humane. Dante, më shumë se kurrë duhet të lexohet, sot.

---

[6] Alfred Uçi, *Ferr – Parajsa danteske*,Agerta – LMG, Tiranë, 1998, f. 18-22.

Bibliografi

1. Alfred Uçi, *Ferr – Parajsa danteske*, Argeta – LMG, Tiranë, 1998.
2. Dante Alighieri, Komedia Hyjnore, Argeta – LMG, Tiranë.
3. Ismail Kadare, *Dantja i pashmangshëm*, Onufri, Tiranë, 2005
4. Raffaele Urraro, *La modernita di Dante*, Periodik online, 30 dhjetor 2015
5. Teodor Teodorov, *Letërsia në rrezik*, Shtëpia botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë.
6. Alfred Uçi, *Universi i komedisë hyjnore*, Gazeta Shekulli, 29. 03. 2015.
7. Claudio Giunta, *Perche uno dovrebbe leggere Dante*, 15 mars 2015 në internazionale.it
8. Emilio Pasquini, *Dante e le porte del futuro*, GriseldaOnline, 15.11.2012.
9. Davide D'Alessandro, *In viaggio con Dante*, 26 nëntor, 2017, Ilfoglio.it

Ana SHAHINI

VEPRA LETRARE E JAKOV XOXËS NË SYTË E KRITIKËS

Jakov Xoxa lindi më 1923, në qytetin e Fierit, i brumosur në Luftën Antifashiste, pas Çlirimit të vendit vazhdoi studimet e larta për filologji dhe njëkohësisht bëri hapat e para në poezi dhe duke finalizuar veprën e parë në prozë "Novela" 1949, më tej botoi veprën e dytë, po me atë titull "Novela"1958. Botoi dhe dy drama "Buçet Osumi" dhe "Zemra". Vizionin përmes të cilit Jakov Xoxa e shihte dhe e projektonte artin, bënë që sa qe gjallë, të mos botohej vepra e tij e plotë; ajo u botua në Prishtinë pas vdekjes së tij, burime këto të marra nga arkiva e shtëpisë botuese Rilindja në vitin 1971.

Pjesën më të madhe të jetës krijuese Jakov Xoxa e kaloi në një fshat myzeqar afër Fierit, ku, në vetmi të plotë krijoi romanet: "Lumi i vdekur" (1965), "Juga e bardhë" (1971) dhe "Lulja e kripës" (1978), që hynë në rrethin e romaneve artistikisht më cilësorë, të letërsisë shqiptare. Ashtu siç më tej do të ravijëzojmë dhe vetë mendimet e Xoxës për mënyrën sesi ai është përballur me sistemin për botimin e veprës së tij shtojmë fjalët e Fisik Sinës se si Xoxa nuk iu përshtat modelit ideologjik të krijimit socialist: "I veçuar nga jeta letrare dhe shoqërore e kryeqytetit, ai kishte gjetur mënyrën më të mirë për të shpëtuar nga tutela dhe "përkujdesja" e Lidhjes së Shkrimtarëve, nga provokimet dhe thashethemet"1.

Xh. Shehu në artikullin e tij tek gazeta "Drita" konstaton se: "Në planin krijues të autorit përfshihej një cikël prej 5 romanesh ku do të jepej historia e vendit nga fondi i viteve '30 e më gjerë. Nga ky cikël u realizuan vetëm 3 romane: "Lumi i vdekur", "Lulja e kripës", "Juga e bardhë". Vdekja e parakohshme e pengoi autorin të vinte në jetë qëllimin e tij. Tregimi i gjatë "Tre pleqtë dhe Mihali katër" dhe më vonë dhe tre romanet e krijuara janë nderuar me çmime të larta në konkurset letraro-artistike. Për romanin "Lumi i vdekur" ka marrë çmimin e Republikës të Shkallës së Parë.'2

Xoxa shpalos botën shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore,

[1] Fisnik Sina, *Lumi i Vdekur – Pararendës i romanit modern shqiptar*, në gazetën: "Koha Jonë", nr.68, Tiranë, 13 mars 2006, f. 7.

[2] Xhevdet Shehu, *Shkrimtari Jakov Xoxa qytetar nderi,* në gazetën: "Drita", Tiranë, 20 prill 2003, f. 2.

me romanin "Lumi i vdekur" apo dhe periudhën gjatë luftës, si romani "Lulja e kripës", ku gjejmë një shtrirje të pakufishme të rrëfimit që mbulon plotësisht hapësirën e jetës dhe të ekzistencës së mjedisit shqiptar, po
vizioni i tij ka qenë më tepër se kaq.

Nëse në krijimtarinë e tij letrare ai individualizohet me parimin krijues realist: fati individual do të jetë ai që do të hedhë dritë mbi kontekstin tërësor të mjedisit dhe të kohës së fokusuar në rrëfime, këto do t'i referoheshin në kohëra të ndryshme për të pasqyruar si dramën jetësore të personazheve dhe të familjeve në sfond të një kolektiviteti, por duke u emancipuar së bashku me personazhet e tij, të një gjendjeje apo të një rrjedhe historike paralel me ato kushte që po kalonte populli ynë kundrejt afrimit të një lufte botërore.

"Sa më shumë që puna dhe profesioni në shoqërinë tonë socialiste të bëhen kënaqësi, frymëzim krijimi e pohimi dhe realizim i vetvetes dhe i shoqërisë socialiste përmes atij krijimi, aq më shumë dhe aq më bukur, mendoj, do të hyjë tema e punës në letërsinë dhe në artin tonë..."3 janë fjalët e vetë shkrimtarit Xoxa mbi lidhjen e tij me procesin krijues.

Ai është shkrimtari që krijoi një lidhje mes jetës së tij dhe veprës që sipas tij sigurohej me "Një njohje e thellë jo vetëm e njeriut, por edhe e ambientit e procesit të punës ku ai është vendosur e punon, p.sh: po të mos kisha njohur ambientet e kripores dhe procesin e nxjerrjes së kripës së gurit, që ndryshon kryekëput nga procesi i nxjerrjes së kripës së zezë, unë nuk mund të përfytyroja të realizoja një grevë të punëtorëve të kripës në të kaluarën në romanin "Lulja e kripës" që kam në dorë."4

"Jakov Xoxa ka maninë e "shkatërrimit të familjes". Për këtë gjë vlejnë motivet patriotike, kombëtarë, politike, morale. Ai ka aftësinë e jashtëzakonshme për të depërtuar në qelizën e shoqërisë shqiptare dhe të japë familjen me të gjitha problemet e saj, me aspektet e ndryshme të problemeve, me kontradiktat, me zhvillimet e saj. Nëpërmjet pasqyrimit të jetës së familjeve të romaneve të tij na jep që të gjithë jetën shqiptare të epokës."5 Shëmbëllyeshëm me romanet e shquara realiste, Jakov Xoxa do ta vendosë parashenjën më karakteristike të prozës së tij, i cili është stili. Gjuha e tij vërehet dhe veçohet si një individualitet i fuqishëm dhe të papërsëritshëm në letërsinë shqiptare: nga njëra anë është e pranishme fryma e urtisë popullore me tërë thellësinë e shpirtit kolektiv, frymë kjo, e cila mbart tisin e dashurisë së pastër shqiptare, virtytet më të mira të

---

[3] Jakov Xoxa, *Njohja e jetës – çelës i punës krijuese artistike*, në gazetën: "Drita", Tiranë, 1984, f. 3.

[4] Po aty, f. 3.

[5] Edmond Çali, *Romanet e Jakov Xoxës, Redona, Tiranë, 2003, f. 45.*

shqiptarit, galerinë komplekse të personazheve; nga ana tjetër, kemi një rrëfim të rrjedhës së qetë, të shtrirë në gjerësi, por edhe në thellësi, sepse autori rrëfimin e vet e ndien si një bashkëbisedim mes tregimtarit dhe lexuesit, qoftë ai një vajzë, e cila edhe qesh edhe qan për mentalitetin, naivitetin, guximin e Vitës; qoftë ai një Pilo, që s'di çfarë ka humbur e çfarë ka fituar nga jeta; qoftë një nënë, e cila na bën të qeshim me humorin popullor; qoftë një prift, që t'i vërë gishtin kokës për gabimet njerëzore dhe të ndjejë drejtësinë hyjnore atje ku duhet dhe vërtetë është; qoftë turpshëm një Be, i cili të varë veten për paudhësitë që i ka shkaktuar një komuniteti, e shumë e shumë të tjera. Prandaj edhe vetë Jakov Xoxa deklaron: "Desha të shkruaj një roman jo sikur lexuesin iks ose ipsilon ta kem larg, jo, desha ta shkruaj sikur lexuesin ta kem para meje, gjatë çdo radhe, sikur të hyj në bisedë me të, sikur t'ia tregoj jo letrës, por lexuesit me mend në kokë, që duke lexuar, do të kundërshtojë, të flasë, të thotë ki mendjen, mos gënje! E desha romanin tim që të jetë sa më realist, se realizmi në art për mua është gjithçka."6

> Edhe pse pa bujë siç jep mendimin e tij Fisnik Sina tek "Koha Jonë"në lidhje me mënyrën e përkujtimit në vite të Xoxës "Shumë përvjetorë të shkrimtarit të shquar Jakov Xoxa kanë kaluar, pa përkujtimore, pa shkrime në gazeta, pa emisione televizive për shkrimtarin e madh."7, nuk do të thotë se ky shkrimtar nuk e fitoi vendin e tij në olimpin e letërsisë shqiptare.

Mendimi për të shkruar një roman mbi jetën e mjeruar të fshatarësisë së varfër e të shtypur të Myzeqesë, e brente shkrimtarin, prandaj që në vitin 1945 shkroi rreth 80 faqe dorëshkrim të romanit "Legjenda e Lumit të vdekur", e madje siç vetë deklaron autori, sërish punoi për këtë roman, me shumë nerv dhe përkushtim artisit dhe e mbaroi në vitin 1957, siç e pohon dhe ai vetë"me një farë përgatitjeje ideologjike për të interpretuar në natyrë materialiste dhe marksiste materialin e gjerë dhe kompleks shoqëror e jetësor."8

Në lidhje me lëndën ai formësoi një fabul subjekt, të cilën e konsideronte romanin e tij "një ditar shahu."9

Jeta e gjallë e popullit, skalitja e fytyrat, të cilat ai i shikonte dhe i përshëndeste, përfytyrimet e nxjerra nga ajo jetë myzeqare, janë elemente të

---

6 Ali Aliu, *Prozatori me gjerësi epike*, në gazetën: "*55",*nr. 245, Tiranë, 16 shtator 2001, f. 3.

7 Fisnik Sina, *Lumi i Vdekur – Pararendës i romanit modern shqiptar,* vep. e cit., f. 7.

8 Jakov Xoxa, *Po të kërkosh, do të gjes*h, në revistën: "Nëntori", Tiranë, 1974, f. 223.

9 Po aty, f. 225.

domosdoshme, të cilat i dhanë dorë shkrimtarit në Pojan të Apollonisë, në“fshatrat anë e përqark kënetës së madhe të Hoxhës me një histori të begatë vuajtjesh dhe luftrash, gjithashtu edhe një kënd të qetë, ku mund të meditoje dhe të krijoje pa u trazuar nga askush”.10

> Madje edhe titulli “Qytetar nderi” për Jakov Xoxën u dha me motivacionin: “Pjesëmarrës aktiv në luftën për çlirimin e vendit. Anëtar dhe veprimtar i dalluar i rinisë antifashiste nacional-çlirimtare. Figura më e shquar e publicistikës dhe krijimtarisë letrare në trevën e Myzeqesë. Mendja dhe pena e tij ngritën në art traditën, zakonet, ritet dhe vlerat morale të popullit të Myzeqesë. Vepra dhe krijimtaria e tij janë e do të jenë pjesë e trashëgimisë së thesarit të kulturës tonë kombëtare”, e cila iu dorëzua Arben Xoxës, djalit të shkrimtarit, nga kyetari i bashkisë së Fierit Dr.Nikollaq Koshovari.

Janë të shumta vlerësimet për Jakov Xoxën, si për shembull ai i Kristaq Shtëmbarit kur shprehet se:“vepra madhore e shkrimtarit Jakov Xoxe në prozë, publicistikë, dramaturgji, poezi, veprat teorike univrsitare për teorinë e letërsisë etj, formojnë një univers të pasur letrar, veprën e një talenti të fuqishëm, të një sovrani të letërsisë shqipe, e cila do të bëjë pjesë në kurorën e veprave tona më të mira. Në mes të këtij prodhimi të begatë, të këtij korpusi, qëndron Jakov Xoxa si njeri e si qytetar, si bir i denjë i qytetit tonë, i Myzeqesë, me fytyrën e tij të hijshme, me sytë të drejtuar nga ne, ku buron urtësia, fisnikëria dhe mirësia e përtejme.”11

Plot respekt është dhe mendimi i vyer i Dritëro Agollit se Jakov Xoxa ishte mbi të gjithë shkrimtarët e tjerë bashkëkohës: “...ai mund të konsiderohet si “I fundmi i Mohikanëve” të shkrimtarëve shqiptarë në raportet që ai krijoi me këtë tokë, duke i ngritur një monument tokës si askush tjetër me romanin e tij të famshëm “Lumi i vdekur”. Kjo ndodhi, sepse Jakovi e ndjente aleancën e njeriut me tokën dhe toka është ajo që pjell pemët, njeriun, por edhe mendimet. Si e tillë, vepra “Lumi i vdekur” është një vepër e përjetshme, ndaj dhe kam bindjen se Jakovi do të përkujtohet me nderim edhe pas 800 vjetësh.12

Duke iu referuar fjalëve të Agollit duket se me të vërtetë zor se gjendet një vepër e tillë, me të tilla përmasa, e cila demostron atë eter që brenda nesh ka emrin shqiptarizëm. Një qasje krahasuese tepër të gjetur na transmeton studiuesi Moikom Zeqo se Jakov Xoxa vazhdoi veprën e Naim Frashërit, sikur ka dalë nga mënga e tij. Ai është naimjan, ndërsa “Lumi i vdekur” është vepra më aforistike në letrat

[10] Jakov Xoxa, *Po të kërkosh, do të gjes*h, në revistën: “Nëntori”, Tiranë, 1974, f. 228.

[11] Kristaq Shtëmbari, *Shkrimari Jakov Xoxe - qytetar nderi i Fierit*, në gazetën : “Zëri i popullit”, nr.2, Tiranë, 27 prill 2003, f. 2.

[12] Po aty, f. 3.

shqipe. Jakov Xoxa e meriton nderimin nga pasardhësit, por ky nderim duhet të shkojë edhe më tej.

Pikërisht për nderimin ndaj korpusit të veprës së Jakov Xoxës studiuesi Xh. Shehu jep vlerësimin e tij me vlerat më fisnike të një qytetari, shkrimtari universal: "Vepra madhore e shkrimtarit Jakov Xoxa në prozë, publicistikë, dramaturgji, poezi, veprat teorike universitare për teorinë e letërsisë etj, formojnë një univers të pasur letrar, veprën e një talenti të fuqishëm, të një sovrani të letersisë shqipe, e cila do të bëjë pjesë në kurorën e veprave tona më të mira. Në mes të këtij prodhimi të begatë, të këtij korpusi, qëndron Jakov Xoxa si njeri e si qytetar, si bir i denjë i qytetit, të Myzeqesë, me fytyrën e tij të hijshme, me sytë e drejtuar nga ne, ku buron urtësia, fisnikëria dhe mirësia e përjetshme".[13] Atij i pëlqente që t'i rikthehet veprave dhe t'i rishkruajë ato për t'i ndryshuar duke fituar të drejtën e komunikimit me lexuesin.

Në kujtesën popullore Jakov Xoxa kujtohet edhe për humorin e tij të hollë."Kur dikush e pyet për kompozicionin e romanit "Lumi i vdekur" ai përgjigjet se nuk është roman i tipit "Lum". Ndërsa, kur dikush e ka pyetur përse i bën romanet kaq të gjatë, ai përgjigjet "Është fatkeqësi familjare. Edhe dy djemtë që kam ashtu i kam bërë, të gjatë".[14]

Nëse do të flisnim për figurën e tij, në profesionin e lektorit, do të merrnim në konsideratë dhe mendime të studentëve të tij, dhe për të superlativat dhe lavdet janë gjithmonë në sipërore. Për të mund të shprehet vetëm në një mënyrë të tillë"Një kujtesë të pashlyeshme, Jakovi e ka lënë tek letrarët e rinj. Punën e tij si shkrimtar ai nuk e kuptonte pa një angazhim të vazhdueshëm e serioz, për të ndihmuar nga afër talentet e reja. Kujtesa artistike dhe studimore për Jakovin kap fushën e arteve figurative, kujtimeve, kumtesave në përvjetore, referimeve të shumta dhe monografitë. Deri tani atij i janë kushtuar 12 vepra arti, grafika, piktura e skulptura, punuar nga autorë të ndryshëm." Në tekstin e letërsisë shqipe të vitit 1974, "Lumi i vdekur" cilësohet "Një ndër veprat themelore të prozës sonë, ku Llazar Siliqi dhe Jorgo Bulo e kanë quajtur atë "Biograf i Myzeqesë". Dalan Shapllo është shprehur se Jakov Xoxa zë një vend të nderuar në letërsinë tonë dhe se emri e vepra e tij do të mbeten të paharruara. Ndërsa, studiuesi Kosovar Shuaip Beqiri e quan veprën letrare të Jakov Xoxës "Një lumë i gjallë që prore rrjedh nën ne".[15]

Tashmë vetëdija e një receptimi mbarëkombëtar i emancipuar

[13] Xhevdet Shehu, *Shkrimtari Jakov Xoxa qytetar nderi,* në gazetën: "Drita",Tiranë, 20 prill 2003, f. 2.

[14] Nuri Plaku, *Jakov Xoxa në tre kujtesa* (me rastin e 30 vjetorit të vdekjes), në gazetën: "Ndryshe", nr.851, Tiranë, 24 shkurt 2009, f. 15.

[15] Po aty, f. 16.

në lidhje me veprën, pasurinë e patjetërsueshme të romanit të tij si një shqiptarizëm fund e krye me emrin e tij krenohet arti dhe kultura shqiptare, kështu me emrin e tij është pagëzuar shkolla muzikës "Jakov Xoxa" dhe bulevardi "Jakov Xoxa" në Fier, në Lipjanë është krijuar klubi letrar "Jakov Xoxa", ku fotografia e tij mbahet e ekspozuar në të gjitha katedrat e institucioneve letrare midis figurave më të shquara të kulturës shqiptare. Edhe pse virtualiteti kompjuterik është një kozmos i pafund një vend ka dhe vepra e Jakov Xoxës, e cila gjithnjë e më tepër shkëlqen si një emblemë origjinale e romanit modern shqiptar.

Duke pasur parasysh që romani i Xoxës është një univers që i jep dorë kritikës për ta trajtuar në shumë qasje, shumë emra nga kritika e kohës kanë bërë vlerësimin e tyre për veprën që nga Ali Aliu, me artikullin e tij "Shtrirje të gjithëpushtetshme e rrëfimit"16, Lumira Berati në lidhje me idetë dhe personazhet e veprës17, si dhe një artikull mbi poetikën dhe stilin e romanit, duke shtuar më tej në një vështrim të thukët madje edhe mbi poetikën dhe stilin e romanit "Juga e Bardhë". Vështrime të tjera ka pasur nga studiuesi Koço Bihiku, i cili i është qasur veprës në lidhje me fjalën artistike, "Lumi i vdekur" si një sukses i asaj kohe" ku me superlavde vlerëson veprën e Xoxës.

Nuk mund të lëmë pa përmendur artikujt e Razi Brahimit, Ilir Buzalit, Sefedin Fetiut, Edor Gjergos, Fehmi Gjokaj,18 Rifat Ismailit si dhe Adriatik Kallullit, Dalan Shapllos, Kundret Velçës19 apo Nazif Zejfullahut20, të cilët po aq mirë kanë kontribuar në një mendim teorik sa letrar, aq edhe gjuhësor, estetik, etnopsikologjik të botës shqiptare nëpërmjet veprës së Xoxës.

Në lidhje me krijimtarinë e Xoxës Aleko Haxhi e zgjeron vlerësimin për romanin e tij duke e metaforizuar në kontekstin e një oqeani unik. Sipas tij "Thonë se nga një pikë uji mund të njohësh gjithë oqeanin. Kjo është e vërtetë, por është e vërtetë vetëm për oqeanin, sepse kudo që të marrësh pikën e ujit, në breg ose në zemër të oqeanit, në cektinë ose në thellomë, ajo është e njëjtë, me të njëjtën përbërje kimike, ndërkohë nuk ndodh kështu me "oqeanin" e shoqërisë."21

[16] Ali Aliu, *Shtrirje e gjithëpushtetshme e rrëfimit*, Kërkime, Tiranë, 1990, f. 344.

[17] Lumira Berati, *Poetika dhe stili i romanit "Juga e Bardhë"*, në revistën: "Studime filologjike", nr.4, Tiranë, 1989, f.31.

[18] Fehmi Gjokaj*, Lumi i Vdekur*, në revistën: "Shkodra", nr.1, Shkodër, 1966, f. 333.

[19] Kundret Velça*, Psikologjia dhe brendia shoqërore e personazheve në veprën e Jakov Xoxës*, në revistën: "Nëntori", nr.8, Tiranë, 1984, f. 35.

[20] Nazif Zejnullahu, *Një shfaqje në harkun e qiellit , mbi romanin "Lumi i vdekur", në: "Seminari Ndërkombëtar", nr.24, Shkup, 1986, f. 55.*

[21] Jakov Xoxa, *Njohja e jetës – çelës i punës krijuese artistike,* vep. e cit., f. 3.

Sipas studiuesit Jorgo Bulo (seleksiono per te gjithe profesoret), thekson "Dhe me të vërtetë ashtu si shumë shkrimtarë botërorë, të cilët kanë shtruar themelet e letërsisë, ashtu edhe Xoxa është kontribuesi më në zë i romanit shqiptar i viteve '60. Dallohet për unikalitetin si shkrimtar klasik, i papërsëritshëm në letrat shqipe, me një pasuri leksikore dhe frazeologjike të jashtëzakonshme dhe padyshim një nga figurat më të shquara të panteonit të kulturës shqiptare.22

Në rrafshin estetik Rifat Ismajli komenton se veprat e Xoxës kanë rëndësi të shumfishtë për kulturën tonë, me një qasje specifike të realitetit, me një art të pasur dhe të figurshëm, duke trajtuar jetën tonë në shumë plane. Romanet e tij me procedurën e veçantë kanë thelluar edhe më tej realizmin tonë, duke pasuruar në shumë rrafshe prozën edhe kulturën tonë me: "strukturat estetike të krijuesve të tillë që duken aq të përbëra dhe të pasura sa që janë në gjendje të kënaqin ndieshmërinë e shekujve të njëpasnjëshëm."23

Akademiku Ali Aliu konstaton rëndësinë e rrëfimit xoxian duke i mëshuar faktit të rrëfimit të një dimensioni kolektiv: "Një dimension tjetër që romanin e J.Xoxës e bën tërheqës është ndjenja se tërësinë e fabulës e rrëfen një dëshmitar i vërtetë i ngjarjeve dhe se ky tregimtar thotë të vërtetën, di të zgjedhë fjalë e shprehje të vërteta, t'i shqiptojë qetë ato, të nxisë kërshërinë për të dëgjuar e për të ditur "ç'ndodhi më vonë"; të zgjojë interesim për personazhet. Kështu, Jakov Xoxa në mbështetje të përvojës krijuese realiste dhe të filozofisë jetësore të shpirtit kolektiv, ka artikuluar stilin, shkollën e vet në zhanrin e romanit shqiptar në përgjithësi…"24

Jakov Xoxe krijon jo në ajër njeriun e qëndresës, por duke e parë të qenësishëm njeriun e revoltës sociale dhe të krenarisë sociale e kombëtare, njeriun i cili tani e tutje nuk është dhe nuk mbetet ai që "pajtohet me fatin", kryengritës duke emancipuar veten dhe të tjerët kundër dhunës dhe padrejtësisë ekonomike dhe sociale, që sipas Hasan Mekulit: "është kundër jetës në të cilën dukej si në atmosferën e romanit të tij të parë, se horizonti është i mbyllur, pa shpresë dhe pa shtegdalje për vegjëlinë. Jakov Xoxa në një farë mënyre ndërlidhet në atë që ka dhënë në këtë drejtim, proza e viteve pesëdhjetë. Vepra e Jakov Xoxës, sidomos "Lumi i vdekur", edhe si roman epope edhe si dramë shumëkatëshe e fshatarësisë shqiptare, zë një vend nderi në radhën e këtyre realizimeve dhe sukseseve."25

[22] Jorgo Bulo, *Shkrimari Jakov Xoxe - qytetar nderi i Fierit, në gazetën: "*Zëri i popullit", nr.2, Tiranë, 27 prill 2003, f. 2

[23] Po aty, f. 3.

[24] Ali Aliu, *Prozatori me gjerësi epike,* vep. e cit., f. 3.

[25] Hasan Mekuli, *Një roman epope dhe dramë*,në: "Studime filologjike", nr.1, Tiranë, 1983, f. 94.

Parë nga poetika e tij, ajo e realizmit të pasuruar me rezultatet e romanit bashkëkohës, origjinaliteti krijues me plotësinë të natyrshme pa lajlet e pathosit të stisur në mënyrë që të jetë vepër e pavarur dhe të funksionojë sipas të gjitha ligjësive të saj duke bërë të mundshme të krijojë një vepër të bindshme artistike, të bindshme me artin e vet".26

Sipas Nuri Plakut"...nga Xoxa burojnë nga tre kujtesa kryesore, ajo letrare, popullore e artistike figurative dhe studimore. Të treja këto forma janë të "ngopura" me imazhin e këtij prozatori të jashtëzakonshëm dhe tash më rrezatojnë vazhdimisht vlerat e tij të shquara dhe të pashtershme."27

Vizionin përmes të cilit Jakov Xoxa projektoi veprën e tij edhe pa yllin e tij pentagonik të planifikuar, realizoi një roman, i cili në dukje afër ideologjisë krijonte një truk vizionar, sepse ai krijoi, çfarë deshi të krijonte, për këtë formësonte si portrete në mënyrë guximtare dhe ua paraqiti mediokërve të ideologjisë me kurmin joshës të Vitës dhe Adilit, të cilëve askush nuk i reziston dot, dhe gjithçka që ai krijoi bënë që sa qe gjallë, të mos botohej vepra e tij e plotë; ajo u botua në Prishtinë në "Rilindja" në vitin 1971.28

Ndëkohë, vitin e kaluar në 2016, djali i Jakovit, Arben Xoxa solli për lexuesit një ribotim të romanit "Juga e Bardhë", të cilin e promovoi në Tiranë dhe Kosovë, ku u fol për vendin që Xoxa zë në letërsinë shqipe dhe historinë e saj, si edhe për vëmendjen që duhet të tregoj mëtepër syri i kritikës dhe i studiuesve lidhur me romanet e tij. Madje, promovimi u bë edhe në disa emisione mediatike televizive, ku në diskutimet e të ftuarve u theksua për faktin se kritika dhe fusha studimore e jona duhet ta kthejë vështrimin nga autorët si Xoxa, të cilët nuk janë pjesë e programeve shkollore, çka sjell edhe mosnjohjen e veprës nga brezi i ri pasardhës, në një kohë kur përmes romaneve të Xoxës të rinjtë kanë mundësinë për ta njohur atë kohë.

---

[26] brahim Rugova, *Strategjia e kuptimit*, në revistën: "Fjala", nr.6, Prishtinë, 15 mars 1979, f. 34

[27] Nuri Plaku, *Jakov Xoxa në tre kujtesa*, vep. e cit., f. 15.

[28] Pa autor, *Jakov Xoxa dhe realizmi*, në gazetën: "Republika", nr. 4028, Tiranë, 21 Nëntor 2004, f. 14.

Aida BOJDANI

KATALOGIMI INFORMATIK NË QENDRËN KOMBËTARE TË INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

1. Ç'është katalogimi informatik

Katalogimi[1] është procesi i identifikimit me detaje përshkruese i një objekti dhe caktimi i një kodi unik për këtë objekt. Të gjithë objektet e koleksioneve të përhershme duhet të katalogohen. Informacioni duhet të përfshijë detaje përshkruese, klasifikimin, dimensionet fizike, prejardhjen (origjinën dhe historikun e objektit përsa i përket vendgjetjes, pronësisë së mëparshme dhe mënyrës së përvetësimit të objektit)[2]. Katalogimi është një punë që bëhet për të përshkruar se çfarë është ky objekt, nga kush është prodhuar, prej çfarë materiali është bërë, mënyra se si është bërë. Për ta bërë katalogimin të plotë, duhet një apo më shumë foto të një objekti, për të dhënë një përshkrim sa më të saktë të tij, si dhe ndonjë detaj të mundshëm. Katalogimi informatik i objekteve të trashëgimisë kulturore është një regjistrim në një bazë të dhënash i objekteve. Në këtë bazë të dhënash bëhet përshkrimi, dokumentimi dhe identifikimi përmes imazheve të objektit. Katalogimi përfshin objekte të fushave të ndryshme, si të fushës së Arkeologjisë, Etnografisë, Arteve Figurative dhe Arkitekturës. Katalogimi informatik i trashëgimisë sonë kulturore, që përfshin si atë të luajtshme dhe të paluajtshme, ashtu edhe atë shpirtërore, është një nga qëllimet kryesore të çdo shteti. Pasuritë kulturore ruhen dhe mbrohen me ligj nga shteti.

Dokumentimi dhe regjistrimi i objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, pasi ata janë unikalë dhe të pazëvendësueshëm për historinë e njerëzimit. Pas dokumentimit dhe regjistrimit vjen analizimi dhe studimi shkencor i këtyre të dhënave të dokumentuara, gjë që na bën të kuptojmë më mirë të shkuarën.

2. Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe procedura e regjistrimit të objekteve

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore është një institucion kombëtar, shkencor, në varësi të Ministrisë së Kulturës, që ka lindur si

[1] Practical handbook of UNESCO, fq.21.

[2] *Po aty*.

domosdoshmëri për krijimin e një baze të dhënash kompjuterike të rëndësishme të objekteve të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Është krijuar në Maj të vitit 1995 me ndihmën e Bankës Botërore.3 Qëllimi kryesor i qendrës është të inventarizojë dhe të katalogojë të gjithë vlerat e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale,4 të luajtshëm dhe të paluajtshëm, objektet arkeologjike e numizmatike, objektet etnografike, objektet arte pamore, arkitekturore, sitet e ndryshëm arkeologjikë në një bazë të dhënash. Këto objekte mund të jenë të ekspozuar apo në fondet e muzeumeve historikë, etnografikë, arkeologjikë dhe galeritë e arteve shtetërore, apo mund të jenë objekte që posedohen nga persona apo koleksionistë privatë, apo u përkasin institucioneve fetare.

QKIPK zbaton politikën e Ministrisë së Kulturës, duke bashkëpunuar edhe me organet e njësive të qeverisjes vendore, si dhe me institucionet shkencore, kulturore dhe fetare. Objektivi i QKIPK është krijimi i rrjetit kombëtar informatik të trashëgimisë kulturore, me qëllim ruajtjen e të dhënave për objektet e trashëgimisë kulturore në pronësi shtetërore apo private; informimin e institucioneve të administratës shtetërore në një kohë sa më të shpejtë mbi gjendjen e objekteve të trashëgimisë kulturore; kontrollin me lehtësi të lëvizjes së objekteve brenda dhe jashtë territorit të vendit. QKIPK ka të drejtën e lëshimit të pasaportës për objektin që përbën trashëgimi kulturore (pasaporta e verdhë)(fig. 1) dhe pasaportën që nuk përbën trashëgimi kulturore, pasaporta bojëqielli (fig.2)

Fig. 1 - pasaporta e verdhë (për objektet trashëgimi kulturore)

Fig. 2 - pasaporta bojëqielli (për objektet jo- trashëgimi kulturore)

[3] VKM nr.142, dt.27.03.1995, "Për krijimin e QKIPK".

[4] Ligji nr.9048, dt.07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, si dhe Ligji nr.9386, dt.04.05.2005 "Për Muzetë".

QKIPK ka të drejtën e ushtrimit të kontrollit mbi dokumentacionin dhe gjendjen fizike të objekteve të trashëgimisë kulturore të të gjithë personave juridikë e fizikë, të cilët janë pronarë të këtyre objekteve. Ajo kryen administrimin informatik të dokumentacionit mbi ndryshimet e pronësisë, gjendjen e tyre, lëvizjen brenda e jashtë vendit për restaurim apo ekspozita dhe lëshon vërtetimet përkatëse. QKIPK ka të drejtën e dhënies së lejes për objektet që lëvizin brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në rastin e vjedhjeve apo humbjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore, Qendra ndihmon organet përkatëse me informacionin që disponon për gjetjen dhe identifikimin e tyre.

Në bazën e të dhënave regjistrohet objekti i pajisur me foton përkatëse, bazuar në pasaportën e plotësuar të depozituar në qendër. Kjo pasaportë e cila identifikon objektin është e shkruar në shqip dhe në anglisht.

Ajo përmban imazhin (6 x 9 cm) e objektit, fushën përkatëse, kategorinë së cilës i përket, tipin e objektit, materialin nga i cili përbëhet, teknikën sipas së cilës është krijuar, kulturën, periudhën e krijimit, dimensionet, peshën, vlerën, të dhëna të tjera, përshkrimin mbi objektin, historikun, lëvizjet e objektit brenda apo jashtë vendit, restaurime nëse janë kryer mbi objektin, adresën e pronarit të objektit, adresën e pronarit të ri dhe një numër telefoni, skeduesin (ai që plotëson pasaportën) dhe datën e skedimit. Këto fusha domosdoshmërisht duhet të plotësohen me të dhëna të sakta, për të mundësuar identifikimin e objektit të trashëgimisë kulturore. Pasaporta fizike plotësohet nga Muzetë dhe Galeritë e vendit, apo nga personat privatë. Personi privat që plotëson një pasaportë për një objekt të caktuar, që përbën trashëgimi kulturore apo që nuk përbën trashëgimi kulturore, duhet të paraqesë kartën e identitetit, si dhe një dëshmi ligjore që ai ka mbi këtë objekt si pronar i tij i ligjshëm, apo edhe një akt noterial. Ai duhet të vërtetojë me anë të aktit noterial prejardhjen e objektit që ai ka në zotërim, në rastin kur e ka të trashëguar, apo kur e ka blerë nga një person tjetër. Të dhënat hidhen në bazën e të dhënave sipas kritereve të caktuara për plotësimin e saj dhe dokumentet ligjore i bashkangjiten pasaportës elektronike të programit. Më pas kryhen transaksionet mbi këtë objekt. Aty shënohet leja e dhënë mbi objektin, e cila mund të jetë nga QKIPK, nga Ministria e Kulturës apo nga Këshilli i Ministrave. Vetëm pas këtij procesi ajo vuloset dhe vendoset kodi i programit dhe kodi i poseduesit të objektit. Pasi ka përfunduar procesi i regjistrimit të pasaportës, ajo i kthehet pronarit. Objektet që dalin nga territori i vendit për arsye të ndryshme, shoqërohen vetëm me pasaportën e koduar dhe të vulosur në QKIPK. Kjo shënon dhe mbylljen e procedurës së regjistrimit të objektit në bazën e të dhënave.

3. Katalogu “Onufri” dhe fjalori i përdorur në program

Katalogu informatik i QKIPK është i ndarë në 4 katalogë të veçantë:

1. Katalogu *Onufri*
2. Katalogu *Maro Kondi*
3. Katalogu *Sotiri*
4. Katalogu i *Objekteve të Humbura*



fig. 3

Katalogu “*Onufri*”. Ky katalog shërben për regjistrimin e të gjithë objekteve që kanë statusin trashëgimi kulturore, ku bëjnë pjesë objekte arkeologjike, numizmatike, etnografike, arte pamore, monumente kulturore të kategorive të ndryshme, etj. Objekti nr.kod 12094 Urnë është një objekt me kategori “Objekt A. Kulti” dhe tipologji “Objekt rituali fetar” (fig. 3). Të gjithë objektet e muzeve dhe galerive në pronësi të shtetit katalogohen në Katalogun “Onufri”. Çdo muze apo galeri ka një kod të caktuar poseduesi. Në rastin e Muzeut Historik Kombëtar kodi i tij është *012*. Për lehtësi kërkimi në bazën e të dhënave mjafton të vendosim kodin *012* në fushën e kërkimit “Posedues” dhe do të listohen të gjithë objektet e këtij muzeu sipas raportit të kërkuar. Të gjithë institucionet, private dhe shtetërore, bashkëpunojnë me QKIPK për Fig. 3 - 12094, Urnë, nr.regj.1133, MHK.
regjistrimin e objekteve të tyre muzeale dhe pasi tërheqin pasaportat pranë kësaj qendre, ata i plotësojnë ato me të dhënat e kërkuara dhe sipas kritereve të caktuara. Pasaporta duhet të jetë e plotë me informacionin e duhur, në mënyrë që të dhënat që do të hidhen në sistem të jenë të sakta.
Katalogu “*Maro Kondi*”. Katalogu i dytë shërben për regjistrimin e objekteve në pronësi private, të cilët përbëjnë dhe nuk përbëjnë trashëgimi kulturore, por që me kalimin e kohës do ta marrin këtë status.
Katalogu “*Sotiri*”. Katalogu i tretë shërben për regjistrimin e fototekës “Sotiri”, negativët e të cilit përbëjnë pasurinë kulturore të këtij katalogu.
Katalogu “*Objektet e Humbura*”. Ky katalog është ndërtuar për të regjistruar dhe kataloguar të gjithë objektet e humbura apo të vjedhura ndër vite në të gjithë muzetë dhe galeritë e vendit tonë që nga vitet 1990-1991. Katalogu i vjedhjeve ka shumë pak informacion mbi objektet e regjistruara si të humbura apo të vjedhura nga muzetë e vendit. Në rastin kur objektet gjehen dhe kthehen në vendin e origjinës nga janë vjedhur, bëhet shënimi “kthyer” për këto objekte. Kemi rastin e objekteve të Muzeut Arkeologjik Butrint, ku disa objekte janë kthyer përsëri

në Muze.



Përmendim “Dea e Butrintit” (Koka e Apollonit) si një objekt të rikthyer, që ndodhet në MHK (fig. 4).

Fig.4

Pra, detyra kryesore e QKIPK është inventarizimi, regjistrimi, katalogimi dhe mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. Programi “Onufri” i plotëson të gjitha kriteret shkencore për një katalogim sa më të saktë të objekteve, si dhe për shfrytëzimin e tyre për qëllime administrimi, studimi dhe mbrojtjeje. Një bazë të dhënash ndërtohet për të patur një informacion të dokumentuar dhe për të plotësuar të gjitha kërkesat që dalin. Kjo bazë të dhënash ka rëndësi të veçantë, pasi kërkimin nga një palë Fig. 4 - 12333 Koka e Apolonit apo tjetër e mundëson shumë shpejt. Ajo ofron në një kohë reale “Hyjnesha e Butrintit”, shek. IV p.e.s. informacion mbi çdo objekt.

Baza e të dhënave ruhet në një server shumë të fuqishëm, i cili është i lidhur në intranet me disa kompjutera të tjerë. Kjo mundëson hedhjen e të dhënave në server nga disa përdorues të fushave të ndryshme njëkohësisht. Katalogimi i objekteve në bazën e të dhënave mbështetet në Udhëzuesin Metodik të qendrës, krijuar me ndihmën e specialistëve dhe gjuhëtarëve, ku janë përcaktuar Fushat, Kategoria dhe Tipi, Materialet, Teknika, Kultura, Periudha, si dhe mënyra e plotësimit të pasaportës për të dhënat e tjera Në udhëzues janë përcaktuar kriteret e klasifikimit të terminologjisë për objektet. Fjalori i përdorur në bazën e të dhënave të QKIPK bazohet në këtë Udhëzues. Ai është shumë i dobishëm

për të bërë klasifikimin e objekteve sipas fushave, kategorive dhe tipologjive të ndryshme. Vazhdimisht, ky Udhëzues duhet të rishikohet dhe të përsoset akoma më shumë nga gjuhëtarët dhe specialistët e fushave përkatëse.

Fushat janë klasifikuar si: Arkeologji, Arkitekturë, Artet Aplikative, Artet Pamore, Dokument Historik, Etnografi, Kinematografi, Numizmatikë, Objekte Natyrore, Vepra Muzikore. Bazuar në fushat përkatëse objekti kategorizohet sipas disa kategorive: Ansambël Historik, Dokument Zyrtar, Filateli, Monedhë, etj. Tipologjia gjithashtu ndahet në: Ambjenti, Amforë, Film, Terrakotë, etj. Fjalori i programit "Onufri" është krijuar në mënyrë të tillë që të plotësojë të gjitha kriteret për plotësimin e një pasaporte në sistem. Programi është ndërtuar mbi bazën e një faqe Web-i, i cili është lehtësisht i kërkueshëm nëpërmjet raporteve që kryhen në bazën e të dhënave. Raporti i objekteve të një Muzeu kryhet mbi disa kritere kërkimi, me nr.regjistri, me nr.kodi, sipas fushës, kategorisë, kulturës, tipit, periudhës, poseduesit, vendndodhjes, vendgjetjes, etj. Raportet krijohen nga programi sipas kritereve të përcaktuara nga përdoruesi. Mund të listojmë objekte të cilët i përkasin vetëm fushës "Arkeologji", apo objekte të një kategorie të caktuar "Mjete dhe vegla pune", etj. Objektet mund t'i rendisim sipas kodit apo sipas numrit të regjistrit të objekteve. Pasi përzgjidhen këto kritere, afishohen raportet. Pra mundësia për të bërë kërkime në bazën e të dhënave është e shumëllojshme dhe shumë efikase, duke dhënë rezultatin në një kohë shumë të shpejtë. Raporti mund të ruhet në një dokument në formatin Pdf, Word apo Excel dhe të printohet më pas.

Faqja e parë e Katalogut "Onufri" mban logon e Ministrisë së Kulturës. Në secilin katalog të bazës së të dhënave shfaqet një fjalëkalim për çdo përdorues. Për të hyrë në program, vendoset "Emri i përdoruesit" dhe "Fjalëkalimi".

Ka shumë rëndësi që klasifikimi i objekteve në katalogim të bëhet i saktë. Nëse objekti është një skulpturë e kohëve moderne do të zgjedhim fushën "Artet Pamore". Por nëse është një skulpturë e periudhës romake p.sh., do të zgjedhim fushën "Arkeologji". Pra klasifikimi i këtyre dy objekteve është i ndryshëm, bazuar në periudhën së cilës i përkasin.

Një katalogues i mirë duhet të jetë një njohës i mirë i gjuhës së programit. Gjuha e programit duhet të njihet mirë, në mënyrë që objektet që do të regjistrohen, të klasifikohen saktësisht. Njëkohësisht duhet të njihen mirë ndarjet e periudhave historike, në mënyrë që të mos ngatërrohet klasifikimi i objekteve në përzgjedhjen e fushave të ndryshme në pasaportë. Pasi në të kundërt humbet komplet klasifikimi i objektit dhe

pasaporta elektronike nuk plotësohet në mënyrën e duhur në bazën e të dhënave.

Klasifikimi i objekteve muzeale arkeologjike në program, bazuar në pasaportat e Muzeve përkatës, bëhet sipas funksionit të objekteve, të cilët mund të jenë objekte të përdorimit të përditshëm, armë e armatim, mjete e vegla pune, objekte zbukurimi, etj.

4. Katalogimi informatik si ndihmë kundër trafikimit të paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore

Dukuria e vjedhjeve të trashëgimisë kulturore në vendin tonë është shfaqur pas viteve ’90, kryesisht në vitin 1991- 1993 dhe 1997 dhe pas vitit 2000. Janë grabitur shumë muze kombëtarë dhe vendorë të vendit.
Përdorimi i një pasaporte të unifikuar për të gjithë objektet e trashëgimisë kulturore është një arritje e madhe e QKIPK, pasi ajo ndihmon në luftën kundër trafikut të paligjshëm të këtyre objekteve. Kjo ka qenë një përpjekje e madhe që në vitet e para të krijimit të saj si qendër. QKIPK punon në ndihmë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, duke bashkëpunuar me Sektorin Antitrafik në Ministrinë e Brendshme, ku ndodhet zyra e INTERPOL për Shqipërinë. INTERPOL në çdo rast bën njoftim mbi objekte të gjetura në një shtet të caktuar dhe kërkon informacion bashkëpunimi nëse ka të dhëna mbi atë objekt, nëse i përket këtij shteti. Në rastin e vjedhjeve apo humbjeve të objekteve, bëhet denoncimi duke dhënë të gjithë informacionin e mundshëm themelor mbi objektin e shoqëruar me foto cilësore dhe të dallueshme qartësisht. Këto humbje regjistrohen në bazën e të dhënave të INTERPOL.

Katalogu i Objekteve të Humbura shërben për të dhënë informacion mbi objektet e humbura ndër vite. Me anë të informacionit të një pasaporte objekti, informacioni gjenerohet në mënyrë të shpejtë në pikat doganore. Transaksionet që kryhen mbi një objekt janë të domosdoshme që të tregojnë dhe të kontrollohen lëvizjet e këtij objekti jashtë vendit. Objektet me vlera të veçanta unikale në bazë të ligjit lëvizin vetëm me lejen e Ministrit të MTRKRS dhe të Këshillit të Ministrave. Kjo leje regjistrohet në QKIPK, bashkëngjitur pasaportave të objekteve që do të lëvizin. Lëvizja në çdo rast regjistrohet në fushën *Transaksionet*. Aty vendoset personi shoqërues, data e lëvizjes dhe data e kthimit të objektit, si dhe numri i lejes që autorizon lëvizjen e objektit. Kjo lëvizje është e kontrollueshme online nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kjo drejtori kontrollon të gjithë objektet trashëgimi kulturore në rastin kur dalin me/pa dokumentacionin

përkatës ligjor, që do të thotë pasaportën e objektit të vulosur dhe firmosur në QKIPK si dhe lejen e Ministrit të MTKRS. Çdo dokumentacion tjetër është i pavlefshëm dhe nuk është i ligjshëm.

Një përparësi tjetër e katalogimit të objekteve arkeologjike është ruajtja dhe mbrojtja e tyre. Duke e kataloguar pasurinë shtetërore e private, QKIPK u vjen në ndihmë institucioneve shtetërore, koleksionistëve, poseduesve e pronarëve, të cilët përmes dokumentacionit të ruajtur ne bazën e të dhënave, sigurohen ndaj humbjeve te mundshme, grabitjeve dhe dëmtimeve. Në këtë mënyrë u vijmë në ndihmë Interpolit dhe sektorit të Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme.

Kjo arrihet nëpërmjet lidhjes së QKIPK me zyrën qendrore të doganave. Lidhja direkt me serverin e QKIPK i mundëson kësaj zyre të jetë në kontakt të vazhdueshëm me të rejat e përditësuara në programin kompjuterik. Kjo është një mundësi për të kontrolluar lëvizjet dhe ndryshimet që ndodhin mbi objekte të caktuar.

Regjistrimi dhe katalogimi i pasurisë kulturore është i rëndësishëm dhe i vjen në ndihmë Interpolit me informacionin mbi objektet.

QKIPK ka faqen e saj zyrtare në Web (fig. 5) si të gjithë institucionet e tjerë shtetërore. Me anë të kësaj faqeje jepet informacion dhe ndihmë për publikun, si dhe bëhen njoftime të ndryshme. Formulari i aplikimit për regjistrimin e objekteve mund të shkarkohet direkt online. Formulari plotësohet pranë zyrave të QKIKP në funksion të tërheqjes së një apo më shumë pasaportave të nevojshme, të cilat pasi plotësohen me të dhënat mbi objektin, depozitohen për regjistrim. QKIKP ka mundësuar shkarkimin e këtij formulari për të lehtësuar procedurën e regjistrimit të objekteve.

Baza e të dhënave mundëson regjistrimin e një numri të pakufizuar të pasurive kulturore, si dhe regjistrimin e të dhënave mbi lëvizjet e objekteve. Përdorimi i bazës së të dhënave është i kontrolluar nga administratori. Ai administron disa të drejta dhe leje për përdoruesit e QKIPK-së, që të kenë mundësi të shtojnë informacion shkencor në pasaportën elektronike. Përdoruesit online do të kenë të drejta të kufizuara, të drejtë vetëm për t'i parë këto të dhëna. Nuk do të kenë të drejta për modifikimin e të dhënave që shfaqen mbi një objekt të caktuar. Informacioni dhe imazhet e objekteve në këtë bazë të dhënash nuk duhet të përdoren për qëllime personale, por vetëm nga institucionet shkencore. QKIPK është institucioni më i rëndësishëm i cili inventarizon, regjistron, katalogon, lëshon pasaportën e objektit, monitoron lëvizjet dhe jep ndihmën e saj në luftën kundër trafikimit të paligjshmë të objekteve kulturore.

Fig. 5 - faqja zyrtare e QKIKP



Referencat

Arkiva e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Legjislacioni shqiptar Ligji nr. 9048, dt.07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar.
Ligji nr. 9386, dt.04.05.2005 "Për Muzetë".

Running a Museum: A Practical handbook, 2004, UNESCO

Prof. as. dr. Fahrush REXHEPI

EPITAFET NË GJUHËN OSMANE, THESAR I ÇMUAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Abstrakt

Me depërtimin e Perandorisë Osmane në trojet shqiptare nga gjysma e shek.V e deri në fillim të shek.XX, krahas shtrirjes së administratës së tyre është përhapur edhe kultura islame, pastaj mejtepet, medresetë dhe arsimi islam. Padyshim që gjatë kësaj periudhe, populli shqiptar dhe popujt tjerë nën administratën osmane kanë lënë gjurmë të pashlyera tek njëri-tjetri, gjurmë të cilat edhe sot kanë vlerën e vet në jetën kulturore të këtyre popujve.

Popullata e cila jetonte në territoret shqiptare, që nga fillimi i administrimit osman, pjesa dërmuese e saj për fe kishte zgjedhur islamin. Pas kalimit në islam, ata u kujdesën që përpara vetës të lënë edhe dëshmitë për ekzistencën e tyre në këto troje arbërore, siç është rasti i nishaneve nëpër varreza, xhami, teqe, tyrbe, qezma, ura, etj. Kjo trashëgimi kulturore e lënë nga paraardhësit tonë, janë vlera të patejkalueshme për studiuesit e historisë dhe kulturës fetare qoftë në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi apo edhe më gjerë.

Mirëpo, kumtesën me titull: "Epitafet në gjuhën osmane, thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore", që do t'a prezentojmë në këtë konferencë, synojmë të shtjellojmë vlerën dhe rëndësinë historike të epitafeve me mbishkrime në gjuhën osmane në Kosovë si dhe ruajtjen e tyre si thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore.

Fjalë kyçe: epitafe, kulturë, trashëgimi, islam

1. Depërtimi i osmanëve në Ballkan dhe në trojet shqiptare, nga gjysma e shek.XV dhe qëndrimi i tyre përplotë 500 vite në këto troje pati ndikim të madh në shumë sfera të jetës edhe ndër popullin shqiptar. Bashkjetesa aq e gjatë me turqit osman, vendosja dhe përforcimi i administratës turke, kontaktet e dendura të popullit shqiptar me shërbimet administrative të kohës, emërtimi në pozita të larta i shqiptarëve në qeverinë e Stambollit, hapja e institucioneve të ndryshme arsimore, fetare si dhe faktor të tjerë politik, ekonomik e shoqëror, ndikuan drejtpërdrejt edhe në pranimin e islamit nga shqiptarët dhe nga popujt tjerë në Ballkan.

2. Është e vërtetë e pakontestueshme se me kalimin në islam të shqiptarëve gjatë periudhës së perandorisë osmane, ata përfituan në shumë aspekte dhe fusha jetësore. Kalimi ne islam ishte si alternative, e cila mori primatin e ruajtjes së identitetit nacional shqiptar nga aspiratat anti shqiptare të popujve përreth. Duke pranuar islamin, shqiptari jo vetëm që nuk mohoi dobitë dhe të mirat e kulturës së tij të deridjeshme, por i integroi ato fuqishëm në besimin e ri duke krijuar impakte të shumta në vetëdijën kolektive të historisë, letërsisë dhe kulturës. 3. Zhvillimi i gjithë këtyre ngjarjeve bëri që tashigimia historike, kulturore, fetare dhe politike osmane ndër shqiptarët ashtu si edhe në të gjithë vendet e tjera të Ballkanit të jetë shumë evidente dhe amniprezente. Kjo reflektohet edhe në ditët e sotme në kulturën fetare, në gjuhë, në mënyrën e jetës, me rregullat e sjelljes etj.

Gjatë qëndrimit nën sundimin osman nga gjysma e shek. XV, e deri në fillim të shek. XX, populli shqiptarë dhe popujt e tjerë nën administratën osmane lanë gjurmë të pa shlyer tek njeri-tjetri, gjurmë të cilat edhe sot kanë vlerën e vet në jetën kulturore të këtyre popujve.

Popullata, e cila jetonte në territorin e Kosovës së sotme si dhe paraardhësit tanë nga besimi islam që nga fillimi i administrimit osman u kujdesën që prapa vetës të lënë edhe dëshmitë për ekzistencën e tyre në këto troje(arbërore), siç është rasti i nishaneve nëpër varreza, xhamive, teqeve, tyrbeve, çezmave, urave etj.

Ne mendojmë se rëndësi të vaçant në ruajtjen e të kaluarës historike dhe trashigimisë kulturore është ruajtja e Epitafeve apo gurëve varrezor me mbishkrime në gjuhën osmane.

Duke njohur vlerën dhe rëndësinë dokumentare të teksteve mbivarrezore, nismat për fotografimin, deshifrimin dhe përkthimin e tyre janë tejet të rëndësishme, sepse studiuesve, lexuesve dhe gjeneratave të ardhshme u ofrojmë edhe një argument më shumë për trashigiminë tonë kulturore dhe historike.

Epitafet janë objekte të shkruara, të cilat janë dëshmi mbi vazhdimsinë e kulturës dhe arkitekturës së një populli, ato japin informacion për të kaluarën, historinë dhe krijojnë ura lidhëse në mes të kaluarës dhe të sotmes.

Veçantia e gurëve varrezor të periudhës osmane është se ata dallojnë njëri nga tjetri, përkatësisht duke filluar nga forma e gurit mund të kuptosh se i vdekuri vinte nga paria e dijetarëve, apo ishte nga ushtarakët. Dhe pikrisht këto informata me rëndësi për etërit tonë vinë përmes këtyre gurëve që në dukje duken shumë pasiv, por që në fakt ata në vete përmbajn informata të gjalla për të kaluarën tonë.

Ruajtja e gurëve varrezor (Epitafet)

Profesor Beshir Ajvazogllu në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së gurëve varrezor me mbishkrime në gjuhën osmane, pra ruajtjen e këtyre dokumenteve

të shkruara thotë: "Të lejosh zhdukjen e gurëve varrezor është sikur të lejosh zhdukjen e regjistrimeve të popullatës, njëherit lejimi i një gjëje të tillë është barbarizmi më i madh që mund ti bësh të dashurëve të Allahut (evlijave) dhe gjithë personaliteteve të ndjerë".

Fatkeqsisht sot po jetojmë në një botë ku po lejohet zhdukja apo rrënimi i këti inventari dokumentar të trashëguar nga parardhësit tanë. Një gjë e tillë po ndodhë edhe nëpër qytetet e Kosovës dhe nëpër vendbanimet tjera ku gurët varror të vjetër janë të rrëzuar për tokë apo të mbuluar nga dheu ose janë të dëmtuar krejtësisht.

Mbrojtja dhe ruajtja e këtij thesari kulturor mund të bëhet përmes ndërmarrjes së iniciativave nga ekspert profesionist të fushës, të cilët do të bënin identifikimin, fotografimin dhe përkthimin e këtyre dokumenteve mbi varrezore. Besoj se ky mund të jetë ndër indikatorët kryesor që në të ardhmen të ruhet kjo pasuri kulturore e popullit.

Sa për informim dhe për të marr si model vlenë të përmendet iniciativa e FSI-së në Prishtinë, i cili para pak muajsh ka botuar monografinë me titull: "Epitafet në gjuhën osmane-deshifrimi dhe përkthimi i tyre" (për regjionin e Prishtinës). Kjo monografi përfshinë 88 gur varrezor me mbishkrime në gjuhën osmane të deshifruar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Monografia bpërfshinë 10 vendbanime të regjionit të Prishtinës dhe jep informacione për personalitete të ndryshme që jetuan në këto treva gjatë periudhës së sundimit osman. Në këto mbishkrime gjejmë emra e të ndjerëve, baballarëve dhe nënave të tyre, sikur edhe emrat e vendbanimeve dhe vitet e vdekjes. Në mesin e gurëve varrezor më të vjetër në regjionin e Prishtiës është ai i vitit 1522 sipas kalendarit gregorian, sipas kalendarit hënor ky gurë varrezor është i vitit 928.

FSI, duke e pasë parasyshë vlerën dhe rëndësinë kulturore të Epitafeve ka në projekt realizimin e monografive të epitafeve në të gjitha regjionet dhe vendbanimet e Kosovës. Me këtë rast po e paraqesim në përkthim mbishkrimin e një guri varrezor, i cili daton nga viti 1796, në tekstin e të cilit shkruan: "I mëshiruari Ahmet Agaja, I biri i Tatar Mustafës nga Novipazari, viti i vdekjes 1796", apo teksti tjetër të vitit 1903 në të cilin shkruan: "Nga muhaxhirët e Nishit, i mëshiruari dhe i faluri Mahmuti, i biri i Tahirit, për shpirtin e tij këndo fatihan, viti 1321" (mars 1903).

Pra siç shihet në shembujt e cekur, kto mbishkrime në një mënyrë janë leternjoftime të të parëve tanë, të cilat na japin informacione edhe për prejardhjen e pronarit të varrit.

Fatlum HETEMI

STRUKTURA DIDAKTIKE E TEKSTEVE SHKOLLORE *LEXIMI LETRAR VI* DHE

Abstrakti

I vetëdijshëm plotësisht për specifikën e temës, dhe bashkë me të edhe për rëndësinë e kësaj teme, do të përpiqem që në këtë studim hulumtues të sjell një reflektim mbi tekstet shkollore të Leximit letrar VI dhe të Leximit letrar VII. Sigurisht, vetë përkufizimi i titullit të temës, në njëfarë mënyre, përcakton edhe rrugën e hulumtimit. Prandaj, përmbajtjet didaktike në këto tekste të shkollave të mesme të ulëta, nga botues të ndryshëm, do të jenë elemente mbarështuese të studimit, si dhe qasja krahasimtare e tyre.

Si fillim, në këtë trajtim, paraqiten ide teorike mbi kulturën letrare që sjell teksti letrar. Pastaj, pasqyra e strukturës didaktike përmes grafikoneve është paraqitur për secilin tekst në kapituj të ndarë. Në këta kapituj përfshihen: tekstet bazë dhe aparatura didaktike. Ndërkohë, kapitull i veçantë i kushtohet aspektit krahasimtar të këtyre dy teksteve nga autorë e botues të ndryshëm.

Pra, duke u bazuar në strukturën e tyre didaktike, po edhe në aspektin krahasimtar të këtyre dy teksteve shkollore, dalin edhe pikëdallime që përkthehen si rekomandime për plotësimin e njërit apo tjetrit tekst. Qasja krahasimtare në këtë punim jep elemente të rëndësishme se si mund të plotësohen tekstet e leximit letrar, sepse pikëdallimet janë të pranishme edhe për shkak të botuesve e hartuesve të ndryshëm.

Shprehje kyçe: Tekst shkollor, lexim letrar, strukturë didaktike, qasje krahasimtare

Hyrje

Ballafaqimi i ditëpërditshëm me tekstet mësimore e bëri të pashmangshëm edhe thellimin mbi to. Vetë puna e përditshme me libra, e që në njëfarë forme është bekim, ngjalli një kureshtje për mënyrën se si hartohen këto tekste, përmbajtjen didaktike dhe krahasimin me tekste të tjera qoftë brenda Kosovës, qoftë në rajon.

Në anën tjetër mungesa e hulumtimeve**,** anipse kohëve të fundit janë në rritje, në kriteret e hartimit të teksteve shkollore dhe, njëkohësisht, paraqitja e shumë problemeve në këto tekste e bën të nevojshëm interesimin e secilit që sadopak ka mundësi. Ndërkaq, rëndësia e teksteve cilësore për nxënësit e klasave përkatëse është përcaktuese edhe për të ardhmen e shoqërisë. Prandaj, gërvishtja sado e vogël që mund të bëhet nga secili, është një kontribut i rëndësishëm për brezat e rinj.

Cilësia e teksteve mësimore është reflektim i një arsimi cilësor në vend. Ndërkohë, çdo hulumtim me idenë e krijimit të alternativave për përmirësimin dhe pasurimin e teksteve mësimore, është e barasvlershme me ngritjen e kësaj cilësie në arsim. Në këto kohë, ndoshta teksti mësimor nuk e ka rolin e mëparshëm, por megjithatë, ai është njëri ndër burimet e pazëvendësueshëm të informacioneve. Andaj, si i tillë nuk guxon të jetë jocilësor.

1.**Letërsia në shkolla**

(Vështrim i përgjithshëm)

Do të ishte e pakuptimtë nëse sadopak nuk do të bënim përpjekje për një qasje teorike, e cila në vetvete përmban sjelljen e një pasqyrimi të koncepteve bazë. Kuptohet, në vijim, gjatë këtij vështrimi të përgjithshëm do të mundohemi të eksplorojmë brenda kornizave të vëna nga studiues të fushave përkatëse. Paraqitja e mendimeve të tyre në shërbim të qartësimit sa më të madh të studimit tonë, do të jetë qëllimi kryesor në këtë kapitull. Sigurisht, edhe kjo përpjekje për t'i paraqitur mendimet e studiuesve nuk do të jetë e lehtë, pasi që në literaturën tonë e, sidomos në atë të huaj, studimet për rolin e letërsisë në shkolla kanë të përbashkëtat e veta dhe nuancat e dallueshme.

Nga vështrimi kronologjiko-historik është parë se ndërlidhja e këtyre komponentëve në mes vete është domosdoshmëri. Dhe, si e tillë, qasja gjithnjë e më shumë është bërë si mundësi e pafundme për përsosjen e tekstit mësimor me elementet e domosdoshme didaktike. Hapësira në mes mësimdhënies dhe mësimnxënies është hapësirë, ku teksti mësimor me përsosje të aparaturës didaktike, qëndron si urëlidhje e padukshme.

Letërsia në shkolla

Letërsia në jetën e secilit popull, pra në jetën edhe të popullit shqiptar, është veprimtari qenësore krijuese, e cila krijohet nga shkrimtarët përmes veprave të tyre dhe që vlerësohet e lexohet nga populli. Sipas Safete Statovcit e tillë është edhe për shkak se përmes letërsisë shënohet historia shpirtërore e popullit. "Pra meqenëse se nëpërmes letërsisë shënohet historia shpirtërore e popullit, me të

gjitha veçoritë, tiparet, virtytet e veset e tij, me gëzimet e hidhërimet, festimet e zhgënjimet, fitoret e dështimet, pra me përjetimet e tij në të gjitha planet, atëherë vetëkuptohet sesa peshë ka kjo veprimtari në jetën e një populli, e po kështu edhe te populli ynë", (Statovci, S., 2013, f.25.).

Në historinë e shkollave tona shqipe mësimi i letërsisë ndërlidhej pashmangshëm edhe me formimin atdhetar, kulturor, psikologjik, moral e shoqëror. Sigurisht, jo në mënyrën që mësohet sot, sepse rrethanat ekstrapolitike e, si rrjedhojë, ekstraletrare kanë qenë në fillim pamundësi për shkak të vonesës si popull në hapjen e shkollave shqipe dhe më pastaj shpeshherë në kundërshtim me misionin fisnik të letërsisë. Rast më i freskët ka qenë sistemi totalitar në Shqipërinë shtetërore, ku letërsia brenda dhe jashtë shkollës ka qenë në shërbim të ideologjisë partiake. Situatë më e mirë nuk ka qenë as në Kosovën e ndodhur brenda ish-Jugosllavisë.

Megjithëkëtë, letërsia shqipe e ajo botërore, në shkollat shqipe, pavarësisht rënieve të kohëpaskohshme, suksesshëm është ngritur mbi çdo furtunë që ka mundur t'i sjellë ndonjë periudhë e caktuar. Kjo suksesshmëri përballë furtunave të llojllojshme kundrejt letërsisë vjen më shumë edhe për shkak të kompleksitetit që mbart po vetë letërsia. Një kompleksitet pozitiv të letërsisë e shpjegon profesor Riza Brada, sipas të cilit, me artin letrar, jeta paraqitet dhe interpretohet në kompleksivitetin e vet sociologjik, psikologjik, etik, filozofik e gjuhësor. "Në artin letrar, kjo jetë, me aftësitë e fjalës së bukur dhe të imagjinatës krijuese, paraqitet dhe interpretohet me kompleksivitetin e saj sociologjik, psikologjik, etik, filozofik dhe gjuhësor të materializuar estetikisht përmes përshtypjeve shqisore, emocionale dhe të argumentuar me forcën e të menduarit krijues, imagjinativ, me të cilën, duke e portretuar artistikisht, begaton shpirtin e lexuesit me emocione fisnike dhe e armatosë intelektin e tij me fakte dhe bindje që ta ndryshojë për të mirën e njeriut", (Brada, R., 2005, f. 367.).

Në shumë shtete të ndryshme statusi i letërsisë në shkolla trajtohet në mënyra të ndryshme, por megjithatë, qëllimi përfundimtar është i njëjtë. Përmes mësimit të letërsisë në shkolla, nxënësve i krijohen kushtet në përputhshmëri me kërkesat psiko-intelektuale të aftësohen në mënyrë të përshtatshme që të kontaktojnë, të pranojnë, të përjetojnë, të kuptojnë dhe të interpretojnë veprën e lexuar letrare. Në shkollat e Kosovës letërsia trajtohet në mënyrë të integruar si një nga fushat e veçanta të gjuhës amtare, pra të gjuhës shqipe.

Përfaqësimi i letërsisë në shkolla

Meqenëse teksti mësimor është njëri nga burimet thelbësore ku nxënësi merr mësimet për kulturën letrare, atëherë edhe përpilimi i tekstit letrar duhet

të bëhet në përputhshmëri me moshën e nxënësve. Strukturimi i dijeve letrare duhet të bëhet në simetri me rrethanat historike, politike e shoqërore, në të cilat është zhvilluar letërsia jonë dhe ajo botërore. Të gjitha këto paraqiten në fakte si dije themelore dhe pastaj jepen të thelluara në varësi me nivelet e larta shkollore. Për rëndësinë e kësaj pjese, pra në veçanti për përmbajtjet mësimore, me theks të veçantë flet edhe studiuesja Safete Statovci. Ajo ndër të tjerat thotë se përmbajtjet letrare ne tekstet e letërsisë duhet të konsiderohen si më të rëndësishmet. "Çështjen e interpretimit të këtyre përmbajtjeve letrare në një tekst të letërsisë duhet konsideruar si një moment nga më të rëndësishmit, andaj puna e mësimdhënësitme tekst duhet të ketë qasje metodike dhe profesionale të gjithanshme, që t'u mundësojë nxënësve t'i kuptojnë përmbajtjet letrare, ta marrin informacion e nevojshëm për këtë nivel arsimi", (Statovci, S., 2005, f.27.).

Ndërkaq, po e njëjta studiuese, vë në pah disa kritere të cilat duhet t'i përmbahet hartuesi në sistematizimin e përmbajtjeve mësimore. Këto kritere sipas studiueses Statovci janë: "*vënia në qendër të përmbajtjes të thelbit njohës të njësisë mësimore; ruajtja e koherencës së përmbajtjeve mësimore në mënyrë të integruar; radhitja suksesive e përmbajtjeve mësimore; renditja koncentrike e niveleve përmbajtjesore të njësisë mësimore dhe parimi i koncentruar i përmbajtjes së njësisë mësimore"*, (Statovci, S., 2005, f.28.). Përpos këtyre kritereve studiuesja thekson edhe kriterin kronologjik, ku datat historike duhet të merren parasysh. Ky kriter shton peshën pedagogjike dhe njëkohësisht i bën përshtypje nxënësve. Respektimi i kritereve të lartcekura, po veçmas edhe atij kronologjik, pa dyshim, njësinë mësimore e bën më të kapshme për nxënësin dhe më tërheqëse. Sidomos, kriteri kronologjik ka peshë të madhe pedagogjike, sepse duke u aktualizuar një kontekst historik, shtohet pesha pedagogjike për një datë historike qoftë për historinë tonë kombëtare, qoftë për historinë botërore.

Formimi i kulturës së leximit në shkolla

Me gjithë kërkesat që i vë vetes shkolla është edhe kërkesa për përvetësimin e njohurive, zhvillimin e aftësive dhe formimin e shprehive për të lexuar nxënësi. Rol të rëndësishëm në krijimin e këtyre shprehive e aftësive te nxënësit ka edhe mësimdhënësi i letërsisë. Ky i fundit këto shprehi e aftësi, para së gjithash, duhet t'i ketë për vete dhe me modelin e tij të reflektojë pastaj edhe te nxënësit. Sepse, në vetvete, edhe vetë lënda e letërsisë ka këtë mision. "S'ka dyshim se misioni i vetë lëndës së letërsisë është që gjatë leximit të krijojë te nxënësit përshtypjet artistike njohëse, ndjeshmërinë intelektuale dhe të prekë gjendjen emocionale shpirtërore të tyre, krahas peshës së madhe që ka për nxitjen për lexime të reja, duke ngjallur ndjenjën e së bukurës, pra kriterin estetik si një

nga funksionet kryesore të letërsisë", (Statovci, S., 2013, f. 37.).

Ndërkohë, profesor Riza Brada, flet në veçanti vetëm për kulturën e leximit, të cilën e sheh bazament edhe për kulturën letrare në përgjithësi. "Kultura e leximit është nocion i gjerë. Kjo kulturë ka të bëjë me përvetësimin e njohurive, me zhvillimin e aftësive dhe me formimin e shprehive psiko-intelektuale për shfrytëzimin aktiv dhe të vetëdijshëm të fjalës së shkruar dhe të shtypur si burim dhe mjet i njohurive, në kuadër të fjalës së bukur si krijimtari letrare artistike", (Brada, R., 2005, f. 374.).

Po ashtu, profesor Brada (2005), paraqet edhe pikat më të rëndësishme që përfshihen brenda kulturës së leximit. Sipas tij, kultura e leximit përfshin: *përvetësimin e njohurive, zhvillimin e interesimeve, zhvillimin e qëndrimit kritik dhe zhvillimin e nevojës për të krijuar*. Këto pika janë të rëndësishme edhe për natyrën e studimit tonë, pasi që tekstet letrare në veçanti, duhet të jenë të hartuara dhe të përshtatura në vijë të drejtpërdrejtë edhe me formimin e kulturës së leximit te nxënësit.

Pra, shikuar në përgjithësi, hartuesit e teksteve të letërsisë, gjithmonë duhet ta kenë parasysh ndikimin që kanë këto tekste në formimin e kulturës së leximit te nxënësit. Kur kemi krijuar kushtet për formimin e kulturës së leximit te nxënësit në veçanti, kemi krijuar kushtet edhe të formimit intelektual te nxënësit në përgjithësi. Rol përcaktues ka edhe mësimdhënësi, i cili duhet të ketë kulturë letrare dhe të jetë i përgatitur profesionalisht. Kjo gjë bëhet e domosdoshme edhe për faktin se çdo mësimnxënie mbështet mbi të lexuarit.

Formimi kulturës letrare në shkolla

Formimi i kulturës së leximit është parakusht për formimin e kulturës letrare. Meqë letërsia në shkolla mësohet në të gjitha nivelet shkollore e përshtatur me kërkesat psiko-intelektuale të nxënësve, afërmendsh është se formimi i kulturës së leximit dhe formimi i kulturës letrare është qëllim në vete.

Në çdo shoqëri të botës letërsia është bërë pjesë e plan-programeve shkollore, sepse, sipas Hysen Matoshit, edhe për shkak se letërsia është veprimtari që quhet plotëni e botës njerëzore. "Letërsia është veprimtari njerëzore që unifikon si asnjë tjetër në një mendje dhe zemrën e njeriut, arsyen dhe ndjenjën, përkatësisht letërsia përbën atë që mund të quhet plotëni e botës njerëzore. Nëpërmjet saj pasurohet mendja, por fisnikërohet edhe shpirti i njeriut", (Matoshi, H., 2008, f. 105.).

Edhe pse interpretimet letrare krahas fenomeneve të botës nuk janë shkencore, ato prapëseprapë krijojnë njohuri më të gjëra për çështje a dukuri në

një fazë të caktuar jete. Një përmbajtje e mirë letrare në cilindo gjini e paraqitur në tekstet letrare apo qoftë edhe si krijim i shkëputur e i përshtatur për nxënësit, është motivuese për të formuar kulturën e leximit (gjë shumë me rëndësi në procesin edukativo-arsimor) dhe për të formuar kulturën letrare në përgjithësi.

Ajo çka vlen të përmendet këtu është përfshirja e dimensionit didaktik sipas profesorit Riza Brada. Ky dimension, sipas tij, përfshin: "njohjen dhe zotërimin e nocioneve nga historia e letërsisë, nga teoria e letërsisë dhe nga kritika letrare; zhvillimin e aftësive, të shkathtësive dhe të shprehive për lexim dhe shfrytëzim permanent të letërsisë si ushqim të mendjes dhe të shpirtit të njeriut dhe zhvillimin e aftësive për kultivimin e fjalës së bukur në të folur dhe në të shkruar deri në nivel krijimtarie", (Brada, R., 2005, f. 375.). Nga ky kuptim didaktik i formimit të kulturës letrare nuk nënkuptohet vetëm të lexuarit mekanik, por edhe të lexuarit logjik dhe të lexuarit kritik.

Brenda kulturës së gjithmbarshme njerëzore janë edhe kultura e leximit dhe kultura letrare, prandaj edhe përkushtimi i formimit të këtyre kulturave brenda veprimtarisë shkollore duhet të jetë me theks të veçantë. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet teksteve letrare gjatë hartimit, si dhe rolit përkushtues të mësimdhënësit gjatë gjithë këtij procesi brendashkollor. Në këtë pjesë rol të rëndësishëm kanë lektyrat shkollore dhe pashmangshmërisht përkushtimi që tregojmë për letërsinë popullore. Faktorë të tjerë në krijimin e kulturës së leximit në veçanti dhe kulturës letrare në përgjithësi, janë edhe familja, shtëpitë botuese e institucionet që botojnë për fëmijë, bibliotekat e qytetit e bibliotekat brenda shkollës, si dhe moshatarët.

Struktura didaktike në *Leximin letrar VI*
(Vështrim përshkrues)

2.1. Qasje hyrëse

Meqenëse teksti mësimor është burim themelor i diturisë për nxënësit, pashmangshëm kriteri didaktiko-shkencor na del më i rëndësishëm në hartimin e tyre. Nëse në historinë e zhvillimit të arsimit dikur ka qenë arsimtari si burim i vetëm i diturisë, tani tërthorazi, së bashku me tekstin mësimor, janë edhe burime të tjera të diturisë. Pra, në një mënyrë kemi më shumë arsimtarë, më shumë ekspertë e më shumë dritare ku nxënësve u mundësohet kërkimi i diturisë.

Kriteri didaktik në tekstet mësimore ka për qëllim kuptimin sa më të lehtë të përmbajtjeve mësimore nga nxënësit. Ky qëllim realizohet me anë të aparaturës didaktike. Cilësia e aparaturës didaktike në tekstin mësimor është parakusht për kuptimin dhe aftësimin e nxënësve që të kenë mendim

kritik, të punojnë të pavarur, të debatojnë për gjëra të ndryshme, të kërkojnë dhe t'i praktikojnë njohuritë e dhëna në tekst. Kështu, sa më i përsosur cilësisht teksti me kriterin didaktik, aq më i kuptueshëm për nxënësit dhe, njëkohësisht, aq më pak cytje për mësim përmendsh.

Libër leximi VI është i miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë dhe përdoret në të gjitha shkollat shqipe. Autorët e këtij libri janë: Rita Petro dhe Xhevat Syla. Kurse, këtë libër e ka botuar Shtëpia Botuese *Albas*.

Libri i leximit në këtë klasë është i ndarë në katër rubrika (sipas autorëve të tekstit) dhe secila ka ndërlidhje me njëra-tjetrën. Rubrikat janë: *Miqtë tanë, përralla dhe histori të vërteta, udhëtime e kuriozitete dhe faqja e vjershave*. Por, për ta bërë më të qartë këtë pjesë për lexuesin, ne do të paraqesim një grafikon përmbledhës që përfshin në përqindje aparaturën didaktike në këtë tekst.

Grafikoni 1:

Leximin letrar VI përmban: 52 njësi mësimore (15%), 37 fjalorë (10%), 64 ilustrime (18%), 26 biografi (7%), 53 kuptojmë tekstin (15%), 30 vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin (8%), 49 studiojmë gjuhën e tekstit (14%) dhe 47 detyra (13%). Grafiku i mëposhtëm është paraqitur në përqindje.



Përgjigjet janë në %

Struktura didaktike në *Leximin letrar VII*
(Vështrim përshkrues)

3.1. Qasje hyrëse

Si rezultat i vështrimit përshkrues, ne do të paraqesim njw grafikon përmbledhës dhe, me anë të cilit, do të tregojmë në përqindje për secilën pjesë të aparaturës didaktike në këtë libër.

Libër leximi VII është i miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë dhe përdoret në të gjitha shkollat shqipe. Autorët e këtij libri janë: Mazllom Kumnova dhe Munish Hyseni. Botues i këtij libri është Shtëpia Botuese Libri Shkollor.

Libri i leximit në këtë klasë është i ndarë në pesë pjesë me tematika të ndryshme. Secila pjesë ka lloje të ndryshme të shkrimit. Pjesa e parë nuk ka ndonjë emërtim, por është e gjitha me autorë shqiptarë dhe tematika kryesisht është me motive patriotike. Kjo pjesë fillon menjëherë me poezinë Gjuhës shqipe të autorit Mitrush Kuteli. Katër pjesë të tjera janë: *Përjetësia*, *Dhuratë* njerëzimit, *Kush jam unë* dhe *Bota e fshehtë*. Te secila pjesë, përjashto pjesën e parë, kemi pjesë letrare nga autorë shqiptarë dhe autorë botërorë. Mirëpo, vlen të theksohet se poezi nga autorë të huaj nuk kemi të përfaqësuara në këtë libër.

Megjithatë, ne do tw paraqesim grafikonin përmbledhës që përfshin në përqindje aparaturën didaktike në këtë tekst.

Grafikoni 2:



Grafiku i përgjithshëm i aparaturës didaktike për Leximin letrar VII përmban: 40 njësi mësimore (14%), 30 fjalorë (10%), 92 ilustrime bashkë me

foto (32%), 29 biografi (10%), 36 punë e pavarur (12%), 22 mësojmë më shumë (8%), 39 bisedojmë për tekstin (13%), 2 detyra (1%) dhe 2 provo këtë (1%). Përgjigjet janë në %

Qasja krahasimtare për të dy tekstet

4.1. Parantezë

Krahasimi i strukturës përmbajtjesore e didaktike në mes këtyre dy teksteve shkollore me autorë e botues të ndryshëm, nuk është vetën përpjekje për të nxjerrë elementet pikëtakuese e pikëdalluese, por edhe përpjekje për rekomandimin e një modeli për tekstet në të ardhmen. Sigurisht, ky rekomandim del natyrshëm, sepse vetë nxjerrja e elementeve takuese e dalluese mundëson krijimin e një pasqyre për një model më të pasur në hartimin e teksteve shkollore.

Meqë tekstet në fjalë kanë autorë e botues të ndryshëm, krahasimi i tyre, para së gjithash, është krahasim vlerash. Ky krahasim, saktësisht, krahasimi i strukturës përmbajtjesore e didaktike, është mundësi e mirë për të nxjerrë elementet cilësore dhe, si rezultat, për t'i përvetësuar ato në të ardhmen.

Në vijim të këtij kapitulli do të paraqesim përmes një skeme në mënyrë përmbledhëse pikëtakimet dhe pikëdallimet. Paraqitja e elementeve takuese e dalluese do të bëhet sipas kritereve didaktike. Pas kësaj paraqitjeje përmbledhëse do të komentojmë secilën pikë dalluese në mënyrë të veçantë. Vlen të theksohet se disa pika përfshihen edhe si pika takuese, edhe si pika dalluese. Ngase, ato në parim mund të duken të ngjashme e, ndërkohë, në thelb janë të ndryshme.

Paraqitja skematike e pikëtakimeve

Leximi letrar VI:

1.Fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve
2.Ilustrimet
3.Biografi autorësh
4. Kuptojmë tekstin

Leximi letrar VII:

1.Fjalorë shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve
2. Ilustrime
3. Biografi autorësh
4. Bisedojmë për tekstin

Paraqitja skematike e pikëdallimeve

Leximi letrar VI:
1. Mënyra e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore
2. Referencat
3. Ilustrimet
4. Kriteri hartues
5. Udhëzimet për përdorimin e tekstit
6. Ndarja në rubrikë apo pjesë
7. Vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin
8. Studiojmë gjuhën e tekstit
9. Detyrat

Leximi letrar VII:
1. Mënyra e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore
2. Referencat
3. Ilustrimet
4. Ndarja në rubrikë apo pjesë
5. Punë e pavarur
6. Mësojmë më shumë
7. Detyra

Komentimi i pikëdallimeve

Mënyra e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore: Pavarësisht se tekstet në fjalë dedikohen për klasa të ndryshme, përzgjedhja e përmbajtjeve mësimore, sipas disa parimeve didaktike, dallon shumë. Meqë janë të klasave të ndryshme, normalisht që në parim të përgjithshëm njësitë mësimore edhe nuk duhet të jenë të njëjta. Mirëpo, respektimi i parimeve didaktike, si ai i shtjellimit sistematike gradual, i përshtatshmërisë, i aplikueshmërisë së diturive dhe i interesit duhet të kenë ndërlidhje të theksueshme të kapërcimit të njërës klasë në tjetrën. Ky mosrespektim i këtyre parimeve vërehet në mes Leximit letrar VI dhe atij VII. Shembull: te Leximi letrar VI kemi të përzgjedhura poezi të letërsisë botërore, kurse te Leximi letrar VII nuk kemi asnjë. Në këtë pikë parimi i shtjellimit sistematik e gradual nuk respektohet. Njëjtë edhe parimi i përshtatshmërisë nuk respektohet, sepse te Leximi letrar VII kemi njësi si "Bota e Sofisë", e cila për moshat përkatëse është vështirë e kuptueshme. Gjithashtu kemi mosrespektim edhe të aplikeushmërisë së diturive, sepse në të dy librat kemi përsëritje të njësive mësimore. Shembull: Hymni i flamurit nga Noli është në të dy tekstet dhe në vend që të kemi poezi të ngjashme nga autorë të tjerë shqiptarë, ne kemi përsëritje të vazhdueshme të së njëjtës poezi pothuajse në secilën klasë. Në qoftë

se nuk përcaktohen parimet didaktike, siç shprehet edhe studiuesi Abdyl Ramaj, as që mund të merret me mend formësimi didaktik i përmbajtjeve mësimore.

Referencat: Në këtë aspekt dallimi është i theksueshëm në tekstet përkatëse të leximit letrar. Leximi letrar VI ka referencat për secilin njësi mësimore nga ku është shkëputur e përderisa Leximi Letrar VII nuk i ka të gjitha. Ka shumë njësi mësimore që janë paraqitur e nuk kanë referencë në këtë Lexim letrar, si p.sh.: Njësia mësimore "Lëndina e miqësisë" nga Majn Rid, "*Stuhia e dëborës"* nga Roland Gjoza etj. Domosdoshmërinë e referencave dhe udhëzimeve shtesë në tekstin e leximit letrar e kemi të qartësuar edhe në doracakun *Standardet për tekstet shkollore* të miratuar nga MASHT. Nga ky doracak dalin kërkesa të qarta gjatë hartimit të teksteve shkollore, ku referencat dhe udhëzimet shtesë për nxënësit kanë rëndësi të veçantë. "Përmes zgjedhjes së teksteve dhe përmes udhëzimeve dhe sugjerimeve të mëtejshme, libri i leximit krijon mun - dësi që nxënësit/et të mësohen në mënyrë autentike me funksione, modalitete dhe mënyra të ndryshme të leximit (leximi informativ, leximi zbavitës, leximi interpre - tues, leximi kritik etj.), (MASHT, 2011, f. 31).

Ilustrimet: Në këtë pikë, përpos pikëtakimeve të lartpërmendura, kemi edhe dallime të theksueshme në përzgjedhjen e ilustrimeve. Edhe pse kërkesat për hartimin e teksteve shkollore nga MASHT janë të qarta, shpeshherë në brendësi të librave këto kërkesa nuk i gjejmë. Në vend që ilustrimet të kenë lidhje krijuese e shpjeguese në raport me njësinë mësimore, ato në disa njësi mësimore paraqiten pa ndonjë lidhje kuptimore me përmbajtjen në fjalë. Kjo asimetri shfaqet më shumë te Leximi letrar VII, ku ilustrimet shpeshherë paraqiten në vijë të kundërt me njësinë mësimore. Ja një shembull i tillë: Fotografia e paraqitur në poezinë e Dritëro Agollit "Nusja nga Kosova*"* nuk paraqet qartësisht asnjërën veshje të ndonjë regjioni në Kosovë. Njëjtë është edhe fotografia e Skënderbeut në vargjet e shkëputura me titull "Skënderbeu" të De Radës Fotografia është e deformuar dhe nuk përfaqëson përmbajtjen e njësisë mësimore. Shembulli përmes fotografive:

(Foto 1: Nusja nga Kosova)

(Foto 2: Skënderbeu)

Kriteri hartues: Këtë pjesë e gjejmë vetëm te Leximi letrar VI. Kjo pjesë është në fillim të librit dhe ne vlerësojmë se është pjesë e rëndësishme e tekstit shkollor.

Sipas nesh, po edhe sipas kritereve hartuese, secili tekst duhet ta posedojë këtë pjesë, pasi që është një vlerë e shtuar për nxënësin, mësuesin e prindërit. Gjithashtu, kjo pjesë është një orientim i qartë për tematikat dhe llojet e shkrimit brenda tekstit. Leximi letrar VI në mënyrë të qartë ka edhe seleksionimin e pjesëve sipas llojeve të shkrimit. Ndërkaq, fatkeqësisht, Leximit letrar VII i mungojnë këto.

Udhëzime për përdorimin e tekstit: Edhe te kjo pjesë kemi dallime. Madje, në fakt, dallimi është i madh, sepse udhëzuesi për tekstin është vetëm te Leximi letrar VI, e jo edhe te Leximi letrar VII. Këto udhëzime, sipas vlerësimit tonë, janë të rëndësishme për përdorimin e tekstit dhe prania e këtyre udhëzimeve shton vlerën e tekstit shkollor. Këtë element duhet ta kenë parasysh të gjithë tekstshkruesit, sepse përpos që shtë pasurim i tekstit, është edhe qartësim për ata që punojnë me tekstin.

Ndarja në rubrika apo pjesë: Ndarja në rubrika, sipas tekstshkruesve të Leximit letrar VI, apo ndarja në pjesë, sipas tekstshkruesve të Leximit letrar VII, dallon shumë. Ky dallim është si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Për shembull ndarja në rubrika te Leximi letrar VI ka shpjegimet e veta dhe emërtimet e rubrikave janë përkitazi me kërkesat psiko-intelektuale të nxënësve. Ndërkaq, ndarja në pjesë e Leximit letrar VII nuk ka ndonjë shpjegim se në çfarë kriteresh bazohet. Kjo ndarje përpos që nuk përputhet me moshat përkatëse, është ndarje që më shumë anon nga shkenca e filozofisë. Ky dallim, e që ne vlerësojmë është dallim i panevojshëm, para së gjithash, duhet të shërbejë në të ardhmen për reflektim te tekstshkruesit dhe përvojat e mira t'i shkëmbejnë me njëri-tjetrin.

***Vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin/punë e pavarur*:** Edhe sa i përket punës me tekstin kemi dallime. Këto dallime i vërejmë jo vetëm në emërtim të niveleve të pyetjeve, por edhe vetë në përmbajtjen e qëllimin e tyre. Për shembull: vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin e kemi të Leximit letrar VI dhe përmes këtij niveli nxënësi ftohet që të formojë gjykim të pavarur, të zgjidhë ushtrime përmes alternativave, të ushtrojë arsyetimin, të diskutojë, të analizojë dhe të kuptojë mesazhin. Ndërsa, niveli punë e pavarur te Leximi letrar VII, përpos që nuk është i pranishëm në të gjitha njësitë mësimore, ai është edhe më i paqartë edhe me më pak pyetje për ushtrime. Te kjo pikë dallimet janë të theksueshme dhe qartësia e cilësia janë elementet kryesore në këtë dallim. Më poshtë po sjellim nga një shembull për ilustrim.

Shembull:
Leximi letrar VI, njësia mësimore *Tomi shpëton Bekin*

Te kjo njësi mësimore puna me tekstin, saktësisht niveli vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, ka gjithsej pesë pyetje të hapura e alternative. Ne po krahasojmë vetëm pyetja e parë: *Ç'të përbashkëta dhe ç'të veçanta kanë zoti Dobins me Mësuesin te tregimi "Nuk është e lehtë të harrosh"?*

Leximi letrar VII, njësia mësimore *Klara në mal*

Te kjo njësi mësimore kemi vetëm një pyetje te puna e pavarur. Kjo pyetje është: *Çfarë përshtypje ke për Klarën dhe Hajdin pasi lexove tekstin?*

***Koment**: Nga këta shembuj kuptojmë se përpos shumëllojshmërisë së pyetjeve që kemi te ky nivel, në Leximin letrar VI dhe kryesisht pyetjeve të njëjta në Leximin letrar VII, kemi edhe qasje krejtësisht ndryshe në formulimin e pyetjeve. Ne vlerësojmë se qasja e hartimit të pyetjeve te Leximi letrar VI është më afër kërkesave që parashtron Taksionomia e Blumit, sepse përmes kësaj qasjeje nxënësi arrin të futet thellë në kuptimin e tekstit.*

***Studiojmë gjuhën e tekstit/ Mësojmë më shumë*:** Edhe këto pika shquhen për dallimin në mes këtyre dy teksteve. Realisht, në këto pika, qasja dhe qëllimi janë krejtësisht të ndryshme dhe, si rrjedhojë, dallimi del i natyrshëm. Nëse në *studiojmë gjuhën e tekstit* pyetjet për ushtrime kanë për qëllim ndërlidhjen e njohurive gjuhësore me lëndën e leximit letrar, me nivelin *mësojmë më shumë* kemi shpjegime shtesë për elementet e ndryshme letrare e joletrare. Shpjegimet shtesë për elementet letrare e joletrare i gjejmë edhe te Leximi letrar VI, mirëpo jo në formën që janë paraqitur te Leximi letrar VII. Kurse, ndërlidhjen e njohurive gjuhësore me lëndën e leximit letrar përmes pyetjeve të ndara në nivele nuk e gjejmë te Leximi letrar VII, gjë që pamundësohet interesimi shtesë për integrimin e njohurive gjuhësore me ato letrare te nxënësit. Këtë funksion, studiuesi Abdyl Ramaj e sheh shumë me rëndësi, sepse provokohet interesimi për njohje. 'Me pyetjet në tekstin mësimor provokohet interesimi për njohje, provokohet kërshëria njohëse (kognitive), nxënësi vihet në pozitë që të mendojë, të diskutojë, të debatojë, të punojë, të kërkojë që të jepet ndonjë gjykim, ndonjë vlerësim, arsyetim, transformim etj", (Ramaj. A,2001, fq. 69).

Detyrat: Për dallim nga Leximi letrar VI, teksti shkollor Leximi letrar VII përmban shumë pak detyra. Nëse te leximi i klasës gjashtë kemi 47 detyra, te leximi i klasës shtate kemi veç 2 detyra. Edhe pse pothuajse secila pyetje për ushtrime brenda vetes mund të ketë edhe ndonjë detyrë, prapëseprapë ky dallim i madh është i pakuptueshëm. Ndonëse kohëve të fundit në vendet me arsim të zhvilluar (Finlanda) numri i detyrave për nxënësit dita-ditës po zvogëlohet (në mos edhe po hiqen fare), prapë ne nuk kemi ndonjë matës të sigurt që ndikimi i tyre në formimin edukativo-arsimor te nxënësit po zbehet. Shto këtu edhe qëndrimin gjysmëditor në shkollat tona publike në Kosovë. Prandaj, ky dallim i madh bie

ndesh edhe me parimin e shtjellimit sistematik dhe gradual të lëndës mësimore që parashihet edhe me përpilimin e planeve dhe programeve mësimore.

Përmbledhje

Nga qasja krahasimtare del se tekstet e leximit letrar, të hartuesve e botuesve të ndryshëm, përpos pikëtakimeve, kanë edhe pikëdallime të theksueshme. Në fakt, pikëtakimet janë të kuptueshme, sepse të gjitha tekstet shkollore, pra edhe të leximit letrar, i nënshtrohen një procedure të njëjtë të miratimit nga ana e MASHT. Mirëpo, pikëdallimet e, veçanërisht, pjesët që mungojnë te njëri apo tjetrit tekst janë të pashpjegueshme.

Për ta sqaruar më qartë psenë e pashpjegueshmërisë është mungesa në tërësi e disa pjesëve të aparaturës didaktike te njëri tekst, e jo mënyra e qasjes së këtyre pjesëve të secili tekst. Pra, në rast se te njëri tekst kemi detyra, te tjetri tekst nuk kemi pothuajse fare. Po ashtu, në rast se te teksti i Leximit letrar VI e kemi punën me tekstin të ndarë në nivele e të sqaruar qartësisht, te Leximi letrar VII nuk e kemi këtë gjë. Sikundër që kemi pjesë krejtësisht të ndryshme, si p.sh.: respektimi i parimeve didaktike në mënyrën e përzgjedhjes së njësive mësimore apo në përzgjedhjen e ilustrimeve. Gjithashtu, struktura didaktike në këto tekste dallon kryekëput edhe në pjesën që shpjegon mbi cilat kritere është hartuar teksti apo udhëzime për përdorimin e tekstit.

Sidoqoftë, dallimet e gjetura në këto tekste, veçmas ato të pjesës përmbajtjesore e didaktike, duhet të orientohen drejt frymës bashkëpunuese të hartuesve dhe të botuesve. Praktikat e mira duhet të pranohen nga të gjithë. Në këtë drejtim rol vendimtar kanë edhe ekspertët e angazhuar nga MASHT-i, të cilët assesi nuk duhet të lejojnë dallime të theksueshme në gjërat thelbësore mbi kriteret e hartimit të teksteve shkollore. Në rast se këto kritere nuk plotësohen, lejimi për përdorim nuk duhet të jepet.

Përfundime

Nga mendimet e studiuesve të shumtë, nga gjetjet në tekste dhe nga krahasimi i këtyre gjetjeve, dalin elemente të rëndësishme pikëtakuese e pikëdalluese që kontribuojnë drejtpërdrejt në pasurimin e tekstit mësimor. Saktësisht, këto mendime, gjetjeve krahasime për tekstet letrare duhet të bëhen si udhërrëfyese për tekstet në të ardhmen.

Mendimet e studiuesve për rolin e letërsisë në shkolla, janë mendime dritëdhënëse që para çdo hartuesi duhet të bëhen abc-ja e përpilimit të një teksti. Kur ke kuptuar rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstin mësimor, si dhe kur ke kuptuar rolin e letërsisë në shkolla, pa dyshim që, ke kuptuar teknikën

përmbajtjesore për hartimin e një teksti shkollor. Një udhërrëfyes të qartë e nxjerrim nga kapitulli i parë, ku vështrimi teorik mbi lëndën kryesore të këtij punimi, nënkupton lëndën kryesore për hartimin e një teksti të mirëfilltë shkollor.

Gjetjet në tekstet e Leximit letrar VI dhe VII janë bërë përmes metodës përshkruese, ku brendësia e aparaturës didaktike është paraqitur përmes grafikoneve. Nga këto gjetje del se përpos cilësive që mund t'i hasim brenda këtyre dy teksteve, kemi edhe zbrazëtira që patjetër duhet të përmbushen. Këto zbrazëtira i gjejmë që nga mënyra e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore e gjer të shtrimi i pyetjeve për ushtrime. Zbrazëtirat e gjetura brenda këtyre teksteve marrin kuptim më thelbësor kur krahasohen në mes vete. Nga krahasimi i këtyre gjetjeve dalin pikëtakime e pikëdallime.

Ajo që vlen të theksohet, e që i japin specifikë punimit, janë pikëdallimet e gjetura përmes metodës krahasimtare. Këto dallime janë të theksueshme jo vetëm për shkak të autorëve e botuesve të ndryshëm, por edhe për shkak të respektimi apo mosrespektimit të standardeve bashkëkohore për hartimin e një teksti. Në rast se te njëri tekst kemi një pjesë të rëndësishme të aparaturës didaktike, te tjetri tekst nuk kemi pothuajse fare. Sidokudo, gjetja e dallimeve në këto tekste nuk është bërë për ta kritikuar njërin apo tjetrin tekst, por është bërë që me anë të këtyre gjetjeve të ndihmojmë drejt orientimit bashkëpunues të tekstshkruesve dhe respektimin e standardeve bashkëkohore për hartimin e një teksti.

Në këto tekste shkollore përfshirja e gjinive, llojeve dhe zhanreve letrare si lloje të zhvilluara është në nivel të kënaqshëm dhe përgjithësisht në përputhshmëri me moshat përkatëse. Po ashtu, edhe tekstet joletrare janë mjaftueshëm të pranishme, anipse pjesërisht shpjegimet, referencat e ilustrimet nuk përkojnë me përmbajtjet e tyre.

Këto tekstet që përdoren në shkolla janë të hartuara në bazë të Kurrikulës së bazuar në objektiva dhe plan-programeve të vitit 2001/2003. Kurse, edhe pse këtë vit Kurrikula e re (e rishikuar) është bërë obligative, akoma nuk kemi të botuar ndonjë tekst shkollor sipas udhëzimeve të doracakut *Standartet për tekste shkollore (2011)* dhe *Kurrikulës së re*.

Në fund, vetë pasqyra reale e paraqitur përmes graikoneve brenda këtyre dy teksteve shkollore, si dhe aspekti krahasimtar, duke u bazuar edhe në mendimet bashkëkohore të studiuesve, nxjerrin boshllëqe që pa pikë problemi mund të mbushen me elemente cilësore. Sikundërqë, pashmangshëm dalin edhe pikëtakimet në mes këtyre dy tekste, e që për ne është krejtësisht normale, sidomos në pjesën e aparaturës didaktike, e cila duhet t'i përmbahet kritereve të njëjta që parashtron Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Rekomandime modeste

Gjatë punës së deritashme nuk është shumë e vështirë të ofrojmë disa rekomandime, të cilat mund të jenë të vlefshme për rritjen e cilësisë së teksteve mësimore të lartpërmendura në veçanti dhe të të gjithave në përgjithësi. Prandaj, si rezultat i kësaj pune, rekomandimet janë si në vijim:

1.Tekstet ekzistuese të *Leximit letrar VI* dhe të *Leximit letrar VII*, pavarësisht se kriterin shkencor e kanë në nivel të kënaqshëm, prapëseprapë ka elemente lëshimi në mënyrën e përzgjedhjes së njësive mësimore duke mos respektuar parimet didaktike. Në të ardhmen shpresojmë që respektimi i parimeve didaktike, ai i shtjellimit sistematik e gradual, i përshtatshmërisë, i aplikueshmërisë së diturive dhe interesit, të respektohen në pajtueshmëri të plotë me rastin e përzgjedhjes së njësive mësimore.

2. Tekstet në fjalë kriterin didaktik, për dallim nga ai shkencor, e kanë respektuar pak më pak. Ky kriter është tejet i rëndësishëm dhe brenda vetes ngërthen elementet të shumta. Për shembull elementi i informacioneve shtesë apo i referencave se nga janë shkëputur njësitë mësimore në disa pjesë mungon. Kjo gjë, sidomos te Leximi letrar VII, në të ardhmen duhet të rishikohet me shumë kujdes, sepse informacionet e referencat shtesë ndihmojnë mesimnxënien e pavarur. Referenca për shifra, definicione e teori duhet t'i ketë secili libër si shënime dhe bibliografinë me kritere shkencore e jo nga adresa si Vikipedia.

3. Edhe pse kërkesat për hartimin e teksteve shkollore nga MASHT janë të qarta, shpeshherë në brendësi të librave këto kërkesa nuk i gjejmë. Në vend që ilustrimet të kenë lidhje krijuese e shpjeguese në raport me njësinë mësimore, ato në disa njësi mësimore paraqiten pa ndonjë lidhje kuptimore me përmbajtjen në fjalë. Në të ardhmen, kjo pjesë mund të shmanget vetëm duke respektuar kërkesat e qarta që dalin nga libërthi i miratuar nga MASHT. Ky libërth përcakton qartë standardet bashkëkohore të hartimi të një teksti. Megjithatë, këto kërkesa nuk janë respektuar edhe për shkak se librat në fjalë janë të hartuara me plan-program të vitit 2003. Kështu, Kurrikula e vitit 2011 dhe standardet për tekstet shkollore të vitit 2011, kuptueshëm nuk përputhen me këto tekste.

4. Ne kemi vërejtur se tekstet në fjalë nuk përcillen me materiale plotësuese si fletore pune e doracakë/udhëzues për mësimdhënës. Edhe nëse ndonjëri tekst ka fletore pune si material plotësues, ai askund nuk përputhet me tekstin bazë, sepse librat kanë botues tjetër e fletore pune botues tjetër. Prandaj, kësaj pjese, në hartimin e teksteve të reja duhet t'i kushtojnë vëmendje. Teksti bazë përpos fletore punës duhet ta ketë edhe librin për arsimtar të shtypur e në formë elektronike.

5. Si rezultat i kësaj pune dhe ndjekjen e praktikave më të avancuara nga

shtetet e zhvilluara në sektorin e arsimit, si nevojë imediate del edhe digjitalizimi në formë platforme. Ky digjitalizim përmban në vete përmbajtjet e zakonshme të njësive mësimore, materiale mësimore audio-vizuale, aparaturë didaktike interaktive, mundësi vlerësimi nga mësimdhënësit, mundësi vetë-vlerësimi nga vetë nxënësit dhe mundësi qasje nga pajisjet teknologjike në klasë e shtëpi për nxënësit. Në këtë pikë duhet të ketë koordinim të plotë edhe me prindërit, sepse udhëzimet për përdorimin e platformës lehtësojnë procesin në tërësi. Sigurisht, ky është një proces me sfida të shumta, por përpjekjet në këtë drejtim patjetër që duhet të fillojnë.

Literatura

Tekstet bazë si objekt studimi:

1. *Petro, R. & Syla, Xh. (2016). Leximi letrar VI, Albas, Tiranë.*
2. *Kumnova, M. & Hyseni, M. (2006). Lexim letrar VI, Libri shkollor, Prishtinë.*
3. ASHK, ASHSH. (2010). *Historia e letërsisë shqipe*, Prishtinë.
4. Azemi, B. & Morina, B. (2013). *Aparatura didaktike në tekstet shkollore*, Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
5. Bishqemi, A. (2004). *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*, Elbasan: *Sejko*.
6. Brada, R. (2005). Metodika e gjuhës shqipe për shkolla fillore, Pejë: Biblioteka Pedagogjike.
7. Devataku, Hajrije. (2012). *Tekstet e Letërsisë në shkolla*, Prishtinë: Instituti Pedagogjik.
8. Grup autorësh. (1984-1987). *Historia e letërsisë botërore 1-7*, Prishtinë: *Rilindja*.
9. MASHT. (2011). *Standardet për tekstet shkollore*, Prishtinë.
10. Ramaj, A. (2001). Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor, Prishtinë: *Libri Shkollor*.
11. Rexhepi, N. (2002). Letërsia në tekstet shkollore, Prishtinë: Fakultetit Filologjik.
12. Rrahmani, Z. (2008). Teoria e Letërsisë, Prishtinë: Faik Konica.
13. Statovci, S. (2013). *Letërsia në tekstet shkollore të Gjimnazit në Kosovë*, Prishtinë: *MASHT*.
14. MASHT. Ligji Nr. 02/L-67. (29.6.2006). Për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik: https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/8-lbtmldp-2008-03-l048.pdf.
15. MASHT. Udhëzim administrativ. (31.8.2011). Zbatimi i standardeve për

te kstetshkollore:(https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e teksteve.pdf.
16. MASHT, (2011). Korniza e Kurikulës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë.
17. MASHT. (2012). *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës*, Prishtinë.
18. MASHT. Planet dhe programet mësimore 6 dhe 7: http://masht.rks-gov.net/planet-7

(PhDc)Elida BEGAJ

TEKSTET E HERSHME DYGJUHËSHE

Në fokus të kësaj kumtese janë dorëshkrimet e para dygjuhëshe të dokumentuara prej periudhës sumero babilonase e deri në periudhën e mesjetës. Punimi synon të bejë një renditje kronologjike të dorëshkrimeve të hershme dygjuhëshe dhe përzierjes së kodeve gjuhësore.

Fjalë kyçe: dygjuhësi, tekste dygjuhëshe, përzierja e kodeve, dygjuhësia elite dhe jo elite.

Shkrimi dygjuhësh është dokumentuar herët. Periudha sumero babilonase sjell termin e parë për të përkufizuar një term dygjuhësh.

Aloglotografia përkufizohet si fenomeni i shkrimit të një teksti në një gjuhë të ndryshme nga gjuha në të cilën pretendohet të lexohet. Në të dyja rastet në Lindjen e Largët, nuk është një fenomen i rrallë, ndërkulturor. Për më tepër, tradita e të shkruarit në gjuhë të ndryshme, nga tradita e gjuhës së folur përshtatet mjaft mirë me traditën e të shkruarit të shkrimeve të vjetra në atë periudhë Autori citon, se termi *Aloglotografi* u përdor për herë të parë nga Ilia Gershevitch. Në mbishkrimin e Dariusit në Bisitum (me vizë sipër i dhe u), versioni në gjuhën Elamite ishte gdhendur i pari, i dyti në gjuhën Babilonase dhe së fundi, në Persishten e Vjetër. Lind pyetja: Nëse mbreti Pers përdorte Persishten e Vjetër si gjuhën e tij pse shkronjat elamite janë kaq të dukshme në shkëmb? Sipas Gershevitch, versioni në gjuhën Elamite është tërësisht origjinal dhe përfaqëson me besnikëri fjalët e Dariusit, ndërsa, mbishkrimi në Persishten e Vjetër është ripërkthim apo përkthim mbrapsht. Kështu, Mbreti i Madh do të ketë përdorur në fjalimet e tij Persishten e Vjetër, ndërsa shkruesit i hidhnin fjalët e shqiptuara prej tij në gjuhën Elamite dhe ia lexonin përsëri (siç shkruhet në mbishkrim) në Persishten e Vjetër.

Duhet të qartësohet koncepti i *aloglotografisë së pjesshme* dhe *alogotografisë së plotë.* Përkufizimi, nuk ka thjesht kriter sasior por cilësor. Pa marrë parasysh numrin e fjalëve të shkruara në këtë stil, aloglotorafia e vërtet do të thotë: një diskutim që mund të lexohet dhe kuptohet gramatikisht në *gjuhë* të tjera.

Së bashku me gjithë shenjat, gjuha letrare dhe liturgjike sumere i jepte shumë rëndësi trajnimit të shkruesëve. Ka shumë mundësi që gjuha sumere të jetë konsideruar elitare dhe të jetë përdorur në mesin e shkruesëve dhe të mësimdhënësve. Është e njëjta situatë si me gjuhën latine e cila u përdor nga disa qarqe akademike dhe klerike deri në shekullin e njëzetë. Në një proverb sumerian shprehet qartë, rëndësia e gjuhës:

"dub-sar eme-gir 15 nu-un- zu-a-a na- am3 dub-sar e-ne (Alster 1997/1: 54)
A scribe who does not known sumerian, what kind of scribe is he? (SP 2:47)
Çfarë lloj shkruesi është ai që nuk njeh gjuhën sumere?)"

Leichity në vitin 1993 shkruan se – "Tradita kërkonte që shkruesi të zotëronte paralelisht dy cilësi; të njihte saktë një program të qartë të shkrimit të një gjuhe të vjetër, por dhe të trashëgonte aftësi shumë të mira të të interpretuarit me gojë, të traditës së të shkruarit. Kjo situatë duket si *aloglotografi* e ndarë në dy pjesë, në të cilën kompetenca e *të folurit* (e folura, gjuha e përditshme) është tërësisht e ndarë nga spiranca e *të shkruarit* (gjuha, në të cilën teksti është shkruar). Gjatë gjithë historisë së Mesopotamisë, shkruesit mësonin përpikmërisht një gjuhë tashmë të vdekur (gjuha sumere) dhe e përshtatnin, e kopjonin në një nga dialektet e vjetra të gjuhës amtare. Pjesa më të madhe e dialekteve të mëvonshme Akkadiane (Neo- Assyrian, Neo – Babylonian, Late- Babylonian) nuk përdoreshin si gjuhë e folur, por më shumë si përpjekje për të prodhuar dhe ruajtur si relike gjuhësore, dialekte të folura kohë më parë. Në fjalitë e shkruara prej shkruesve vihet re, luhatje e zanoreve të shkurtra, fundore. Kjo tregonte, se gjuha që shkruesit përdornin në atë periudhë, nuk i kishte më të nevojshme këto zanore, dhe bëhet shumë e dukshme gjatë tranzicionit e dialektit Neo-Babylionan (Babilonishtja e re) në dialektin Late Babylonian (Babilonishten e vonë), ku hasen, dukshëm, luhatjet e zanoreve të larta në fund të fjalisë

Në fakt, shtirja nga Babilonishtja e re në Babilonishten e vonë është ruajtur në dokumente të shkruara, dhe lehtshëm të pranueshme . Variantet gramatikore të Neo Assyrian (gjuhës së re asere) janë konsideruar si reflektim i varianteve të të folurit. Në leksik dhe morfologji mund të gjejnë përgjigje në variantet gjeografike (diatopik), diakronike madje dhe diakronik dhe variante të idiolektit po më shumë, veçanërisht, variacionet si shqiptohet tregojnë karakterisitikat e një statusi pikëllues në problemet gramatiko gramatikore dhe kompetencave gjuhësore të munguara të shkruesve (Hammen Antila 2000; f. 32- 33).

Në lidhje me zanoret e shkurtra është e vërtetë se, zanoret Neo Assyriane shfaqin shumë më rregullsi se zanoret e Babilonishtes së re dhe asaj së vonë. Megjithatë, gjuha Neo -Assyriane përcjell disa trajta të pagabueshme gjuhësore

të cilat lidhen dhe me një mjedis gjuhësor, sidomos rasteve të shumta të pavarura "me zanore fundore të gabuara". Studiuesi mendon se, disa gramaticienë ende i shkruajnë në të tillë mënyrë dhe i përsërisin, herë pas herë i quajnë "forma të shkurtra" (në disa folje dhe emra mungojnë foljet e shkurtra). Sipas tij, është një fenomen i përgjithshëm në gjuhën Akkadiane dhe në gjuhët e tjera Semitike.

Përfundimisht, prezenca Aramaike si në gjuhën assyriane dhe në atë Babilonase ka lënë shenja të thella duke pasur parasysh se një numër i madh shkruesish kishin gjuhën Aramaike si gjuhë amtare. Gazeta "Aramic and Amaracan Prezence" hedh idenë, se para aloglotografisë (Persishte e Vjetër dhe Elamite, shumë më herët mund të ketë ekzistuar aloglotografia; Akkadiane-Sumerianë) mund të ketë qenë mjaft e natyrshme (on the Aramic and Amaracan prezence (Tadmor:1982). Mund të mos jetë thjesht e rastësishme shprehja "Assyrian Letters" (ose shkronjat) të cilat u përdorën nga disa autorë grekë (titulli greqisht) dhe u quajt "Demotic Chronicle" kronikë popullore (sh me vizë poshtë sr) ose në Rabbinical text "tekste të përdorura nga ligjvënësit apo nga mësuesit i referohen shkrimit aramaik. (Schimitt 1992,a).

Në përfundim autori shkruan se, mekanizmat të tilla që ndikojnë tek njëri – tjetri u përhapën gradualisht në formën e rrokëzimit dhe u bënë pjesë e alfabetit kuneiform në mijëvjeçarin e parë në Mesopotami (Strek 2001). Ambienti i shkruesve të cilët shkëpusnin plotësisht procesin e të shkruarit nga ai i të folurit (duke përfshirë dhe çrregullimet e mundshme mendore) në fund të fundit do të ndikonin në ideologjitë e vjetra që mbretërit mësonin gjatë shkollimit. Aloglotografia e interpretuar hap pas hapi mëshiron fenomenin e shkëputjes shqetësuese nga procesi i të folurit në procesin e të shkruarit dhe shkëputjes së të shkruarit në procesin e të folurit në një vend që banohej nga gjuhë të ndryshme.

Dygjuhësia në Antikitet

Në studimin "Aspekte të dygjuhësisë në historinë e greqishtes së vjetër" Mark Janse hedh idenë e kontakteve gjuhësore në antikitet. Jansen konstaton se: kur folësit e gjuhëve të ndryshme takohen atëherë kemi një kontakt gjuhësor dhe nëse ky kontakt është i rregullt zgjat në kohë dhe folësit edhe pse në gjuhë të ndryshme prodhojnë komunikim me njëri tjetrin atëherë, kemi të bëjmë me dygjuhësi. Gjuha si element thelbësor ka komunikimin. Jo vetëm njëgjuhësia por praktika paraqitet normale. Njëgjuhësia është rënia e kufijve ndërkulturorë nga shumëgjuhësia. Së fundmi, dygjuhësia paraqitet si një lloj loje (Ludi 1996a: 234) Ai ripërsërit faktet se kontaktet gjuhësore ishin një fakt i njohur që prej antikitetit dhe referencat më të hershme i sjell prej "Odiseut" që i rrëfen Penelopës për "gjuhët e përziera" në Kretë. *"Gjuhët e të tjerëve janë të përziera; këtej akejtë,*

andej eteokritët zemërgjerë, këtej kidonët, andej dorët e ndarë në tre fise, dhe pellazgët e fismë."(shqipëroi, s.ç (OD. 19.175.ff)

Kjo pjesë u quajt "Oligarkët e vjetër" që përfshin dhe athinjotët të cilët flisnin gjuhë të përzier. ([XEN.] ath. 2.8.):

2. Duke dëgjuar shumë gjuhë, përzgjodhën prej çdonjërës prej tyre; helenët e kanë të njëjtë gjuhën, jetesën dhe mënyrën e veshjes, kurse athinasit përdorin një përzierje të huazuar nga helenët dhe barbarët.


(4) φωνὴν πᾶσαν ἀκούοντες ἐξελέξαντο τοῦτο μὲν ἐκ τῆς, τοῦτο
οἱ μὲν Ἕλληνες ἰδίᾳ μᾶλλον καὶ φωνῇ καὶ διαίτῃ καὶ σχή
Ἀθηναῖοι δὲ κεκραμένῃ ἐξ ἁπάντων τῶν Ἑλλήνων καὶ βαρβά

Dygjuhësia në periudhën Romake. Dygjuhësia Elitë

Në parathënien e studimit "Dygjuhësia dhe gjuha latine" (Bilingualism and the Latin Language), James Noel Adams citon studimin e Milroy and Muysken (1995; 2-3): ata hedhin hipotezën "se dygjuhësia është shumë më e zakonshme se njëgjuhësia, dhe tashmë gjuhëtarët tradicionalistë, e rishohin konceptimin ndaj njëgjuhëshve, nëse janë apo jo, folës normalë. Nuk mund të përcaktohet numri i dygjuhëshve gjatë periudhës romake, por një numër i konsiderueshëm gjuhësh kanë mbijetuar nga dokumentacionet e shkruara (zakonisht janë fragmente nga dokumentet zyrtare) ose të dëshmuara nga kontaktet me Latinishten. (Gaulish, formë të gjuhës Hispanike, Oscane, Umbria, Veneciane, Etruske, Hebreje, Aramaike, Egjiptianet Demotik dhe hiroglifet, Coptikët, Punikët, Libianët, Thrakët, formë e gjermanishtes, si dhe Grekët) dhe gjuhë të tjera të cilat janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë. Të marrësh përsipër të studiosh Dygjuhësinë gjatë gjithë periudhës antike duket një punë e pafund, por domeni Roman veçanërisht, periudha e Perandorisë Romake, ofron të dhëna të menaxhueshme. Në vitin 1995 Romaine (Romaine;1995:-19) sjell një nocion të ri në dygjuhësi të emërtuar "dygjuhësi e balancuar". Është nocion i idealizuar, kryesisht, produkt i nisur nga perspektiva teorike dhe si pikë referimi merr një individ njëgjuhësh. Por, për Adamas, deri sa ekzistojë si shqetësim emërtimi "dygjuhësia jo e balancuar" nuk është e vështirë, që në mbishkrime apo tjetërkund të gjenden mostra të Latinishtes të shkruar prej grekërve të cilët nuk i zotëronin mirë kompetencat në këtë gjuhë dhe e anasjellta.

Ndër klasikët, dygjuhëshit që tërhoqën më shumë vëmendjen dhe që më e pakta fshehurazi në zhargon quheshin "Elita dygjuhëshe" ishin anëtarët e klasës së edukuar të cilët me dëshirë vendosën të ishin të tillë. Adams e përcakton si "zgjedhje e lirë" sepse të tjerë dygjuhësh nuk e kishin të tillë mundësi. Klasa e lartë romake zgjidhte të mësonte greqishten dhe disa prej tyre kishin arritur kompetenca mjaft të mira në këtë gjuhë të dytë. Quntiliani pohonte që fëmijët (dhe mendoheshin fëmijët e shtresës së lartë) duhej të fillonin me Greqishten 11.122. Në një përballje në senatin e Sirakuzës, Cicero foli greqisht dhe ishte kritikuar nga një kundërshtar se ishte e papërshtatshme të flisje dhe të mbroje në gjuhën greke përballë një publiku dëgjues i gjithi grek Verr. 4. 147 "*Ait indignum facinus esse quod ego in senatu Graeco uerba feccisem*; *quod, quidem apud Graeceos, Graece locutus esse, id ferri nullo modo posse"* (Pluto, cice 4.4-5 also Rochette Kundërshtari thotë: *"ajo është një fjalë greke, turp i madh për mua në senat; që, në gjykatë, dhe Graeceius, foli greqisht, nuk ka mundur asnjëherë të ndodh" (Plutoni, Ciceron 4,4-5; Rochette 1997: 70-1*). Ambasadori Rhodian Apollonius Molo u lejua të flasë greqisht në senat pa përkthyes (Val.Max. 2.2.3). Attikus rrëfente se Ambasadori e fliste Greqishten si të ishte vendas në Athinë. Nepos Att 4.I *"Sic enim Graece sic loquebatur ut Athenis natus uideretur"*.

Adams mendon, se Romanët në një anë aspironin të flisnin rrjedhshëm Greqisht por nga ana tjetër, mund të ishte dhe poshtëruese për shtetin Roman e folura greke në publik.

Edhe pse rastet e mësipërme vijnë në formë gojëdhënash, Adams arrin në përfundimin se Dygjuhësia Elitë është e vështirë të interpretohet, sepse ka gjithmonë pohime më tendencioze. Është e pamundur të jesh objektiv në të tilla raste për deklaratë gjuhësore. Nuk ka dyshim se dygjuhësia ka ekzistuar në shkallë të ndryshme të kompetencave gjuhësore, por, se në çfarë mase, është e vështirë të përcaktohet.

Dygjuhësia jo-elitë

Adams pranon se dygjuhësia e cila përfshin latinishtfolësit dhe greqishtfolësit apo të parët(latinishtfolësit)dhe të një gjuhe tjetër nuk kanë marrë të njëjtën vëmendje si, folësit dygjuhësh të folësit e Latinishtes klasave të larta. Termi "dygjuhësi jo – elite" ka një paqartësi nënvizon ai. Në këtë kategori përshihen gjithë folësit e Latinishtes (dhe të një gjuhe tjetër) për të cilët kanë arsye të besohet që nuk i përkasin atyre klasave të vogla të cilat kanë pasur mirëedukim. Ky term, pothuajse, përfshin një shumëllojshmëri të niveleve arsimore e sociale. Masa e dygjuhëshve dhe në veçanti ata të mirëedukuarit nuk ishte homogjene. Nga njëra anë janë skllevërit dygjuhësh (mes tyre mund të ketë dhe skllevër që

kanë pasur një arsimim cilësor) dhe në krahun tjetër, vlerat lokale të provincave. Si ilustrim, në punim citohet një mbishkrim Kristian:



"Përzierja e gjuhëve ishte punë e një dygjuhëshi i cili shkruante një latinishte të rëndomtë dhe për nuk kishte një edukim mirëfilli letrar në gjuhën greke".

Dygjuhësia në Mesjetë

Cila është domethënia e fjalës dygjuhësi në Mesjetë? A merr të njëjtin kuptim si në Antikitet? A janë shkrues të shtresave të larta dygjuhëshit, apo kanë një status tjetër?

Linda Ersham Voigits në studimin "Dygjuhësia në Mesjetën e vonë" rendit së pari, disa koncepte gjuhësore që vlerësojnë shkrirjen dhe përzierjen e gjuhëve mjekësore dhe shkencore të shkruara në mesjetën e vonë në Angli. Një prej tyre është koncepti i "fushës" i cili përfshin ndarjen e "gjuhës së lartë" dhe "gjuhës së ulët". Citojmë "*Gjuha e lartë* ka koncept krejt tjetër prej gjuhës së ulët, pasi e para është mësuar në formë të rregullt. Sipas pikëvështrimit të Romaine, zbërthimi i konceptit të diglosisë dhe i fushës ndihmon të zbulojë rrugët e ndryshme në të cilat burimet gjuhësore janë të organizuara në komunitetet shumëgjuhëshe. (Romaine 30- 38, 77). Megjithëse përdorimi i termit "diglosi" duke iu referuar letërsisë latino-angleze lidhet me përzierjen e kodeve (i referohet studimit të Piers Plowman), ajo risjell konceptin e Romaine se: *Kodet e përziera gjuhësore* mund të përdoren për të ndërtuar një pozicion neutral ndërmjet dy apo më shumë fushave. (Romaine,166). Voigits hedh idenë se përzierja e kodeve mund të jete ajo çfarë shihet tek antologjia e "doreshkrimev" te "Sloane Group" në lidhjet mes Latinishtes dhe Anglishtes.

Ka një premisë në të cilën dygjuhëshit janë të ndarë nga njëgjuhëshit duke u nisur prej *përdorimit të kufijve gjuhësorë* dhe atëherë, përzierja e kodeve është një mënyrë e të shfaqurit të dygjuhësisë që i lejon ata (dygjuhëshit) të shfaqin tërësinë e kompetencave gjuhësore gjatë komunikimit (Romaine; 173). Në qoftë se do të marrim një tekst mjekësor me kode të përziera, shihet qartë se dygjuhësia është gjerësisht e kultivuar të paktën, për një shekull dhe nuk vihet në diskutim.

Vite më parë, ajo kishte përzgjedhur 178 dorëshkrime të cilat përfaqësonin kodin gjuhësor dhe i përkisnin vitit 1375- 1500. Prej tyre, 52 ishin tërësisht të shkruara në gjuhën latine, 40 në gjuhën angleze, 86 (pothuajse 50%) ishin të shkruara në më shumë se në një gjuhë. 75 prej dorëshkrime, ishin të shkruara në gjuhën Latine dhe Anglishten e mesjetës, 11 prej kodikëve ishin trigjuhësh, Latinisht, Anglisht, Frëngjisht ose Anglo-Normane. (Voigit's "Scientific").

Në këtë studim ajo konstaton se prej vitit 1375-1500, tekstet dygjuhëshe janë shumë të prekshme tek tekstet mjekësore. Ekzaktësisht, në gjuhën Latine dhe atë Angleze duhet konsideruar teksti, në tërësi dhe jo vetëm fragmenti në të cilin është identifikuar përzierja e gjuhëve. Shembujt që ajo citon janë përzgjedhur arbitrarisht (rastësisht) duke pasur parasysh që gjatë gjithë tekstit, mund të ishin identifikuar me dhjetëra shembuj të tillë. Jo në të gjitha rastet është i mundur shpjegimi i përzierjes së kodeve. Voigits shkruan: "nuk e di pse RECEPTARIUM në Sloane 135 fillon në gjuhën latine dhe pas 64 recetave, komunikimi vazhdon në gjuhën angleze. A mund të quhet e qëllimshme përzierja e kodeve?"

Nga ana tjetër, pothuaj kanë përdorur natyrshëm dhe pa u detyruar të japin shpjegime, fjalët latine për të siguruar rimën në një poemë alkimie. Citimi i mëposhtëm:

Poezia titullohet "Sapienta Partris" vargjet e para:

' *'I'm Mercury thë mighty flos florum/*

_ *I'm most royal and richest of singolorum*

Marrë nga [Brown and Robbins; (Robbins and Cutler 1276, cited henceforth as/ IMEV/S)]

Ajo (Voigit's) pranon që përzierja e kodeve mund të të hutojë ose të të ngatërrojë gjatë leximit. Mund të jetë dhe e panjohur, si në rastin tekstit të mëparshëm, ku përkthyesi apo shkruesi në mënyrë të pashpjegueshme u gjend në mes të ndërrimit të fjalisë nga gjuha angleze në gjuhën latine (e nënvizuar *florum*, *singolorum*). Shembuj të tërë të paqëllimtë në një kuptim përfshijnë klasa të caktuara fjalësh ose fraza që kalojnë nga një gjuhë, në një gjuhë tjetër, ose nga një kontekst, në një kontekst tjetër natyrshëm; të ilustruara më poshtë, të nënvizuara:

1-From a uroscopy treatise in Sloane 135, fol, 37□; "blake colors, subblak colors significant mortem;grene colour,cyanos colour, yonopos colour significant brennyng and hard- nesse...".

2-From a zodiacal calendar in Wellcome 404, fol.29.v□ "Januare the xiiii kalends regnat aquarius; feverer the xv kalends regnant pisses..."

Interpretimi i Voigts shkon tek shembujt si pirije për të shkruar në të tillë mënyrë për të siguruar një burim leksikor (fjalësh) të gatshëm ose si bazë, për të përforcuar kuptimin me një gjuhë tjetër, por shumëllojshmëria e këtyre shembujve tregon se, qëllimi është të krijojë një rezervuar shumë të madh fjalësh sa mund ta ngatërrosh me përzierje të kodeve gjuhësore, nëse do të merreshin parasysh shembujt e mëposhtëm:

Nga një tekst tjetër Latinisht i John Bordeaux, për sëmundjet epidemike një nga rubrikat e *Sloane 7, fols 85v-87r* një tekst që e ka shumë të dukshëm ndërrimin e kodeve dhe përforcimin e leksikut, fjalët në gjuhën angleze janë ndërfutur si sinonime të gjuhës latine dhe janë nënvizuar me *ngjyrë të kuqe* ndërsa fjalët në gjuhën latine me *ngjyrë të zeze* "*Eper"* në ngjyrë të zezë është ndjekur nga *"lyver"* me të kuqe (fol.86.r), ose "*cavilla pedis at calcem"* ndiqet me ngjyrë të zezë "*anglice per ancle of pe fot e and pe hele"* në ngjyrë të kuqe (fol.86.v).

Duke ndjekur shembujt dhe duke thirrur në ndihmë përvojën, Voigits, mendon se koncepti "fushë" i përdorur në diglosi apo në *diagrafi* mund të përdoret dhe në një tekst dygjuhësh. Ajo sjell shembuj të dallueshëm që shtrihen plotësisht në përdorimin e Latinishtes në Anglishten mesjetare në shumë receta. Gjithashtu në vitet e fundit të shekullit të katërmbëdhjetë, në një nga recetat mjekësore në një hajmali (Ellis FM.175) fillon të shkruhet në anglisht dhe vazhdon strukturën e procedurës së shërimit në gjuhën frënge. Hajmalia ka sharmin francez dhe lutjen latine dhe mbi të është shkruar një tekst: tri lutje për uljen e temperaturës në latinisht, ndiqen nga tri lutje për temperaturën në anglisht. (fol. 82 r-v)

Kjo lloj përzierje gjuhësore në mjekësi dhe në shkencë ka më shumë *funksione retorike.*

Dygjuhësia vjen natyrshëm dhe në fusha të tjera të jetës. Një shembull të qartë dhe jo nga fusha e mjekësisë, ajo e sjell nga shekulli i XV, kur një student i dërgonte letër prindërve për të kërkuar para për HARVARD LAW, Library 43. Në letrën dërguar prindërve, ai shton një pjesë të shkruar të ndryshme nga gjuha angleze si p.sh. "*Ecce Salutatio"* apo "*Ecce Exordium*" edhe kur ka pasur fraza alternative në anglisht janë të pajisura dhe të ndara nga 'Vel' edhe pse të shkruara me shkrime të ndryshme (Voigits, "Aw letter").

Dygjuhësia në Mesjetë

Cila është domethënia e fjalës dygjuhësi në Mesjetë? A merr të njëjtin kuptim si në Antikitet? A janë shkrues të shtresave të larta dygjuhëshit, apo kanë një status tjetër?

Linda Ersham Voigits në studimin "Dygjuhësia në Mesjetën e vonë" rendit së pari, disa koncepte gjuhësore që vlerësojnë shkrirjen dhe përzierjen e gjuhëve mjekësore dhe shkencore të shkruara në mesjetën e vonë në Angli.

Një prej tyre është koncepti i "fushës" i cili përfshin ndarjen e "gjuhës së lartë" dhe "gjuhës së ulët". Citojmë "*Gjuha e lartë* ka koncept krejt tjetër prej gjuhës së ulët, pasi e para është mësuar në formë të rregullt. Sipas pikëvështrimit të Romaine, zbërthimi i konceptit të diglosisë dhe i fushës ndihmon të zbulojë rrugët e ndryshme në të cilat burimet gjuhësore janë të organizuara në komunitetet shumëgjuhëshe. (Romaine 30- 38, 77). Megjithëse përdorimi i termit "diglosi" duke iu referuar letërsisë latino-angleze lidhet me përzierjen e kodeve (i referohet studimit të Piers Plowman), ajo risjell konceptin e Romaine se: *Kodet e përziera gjuhësore* mund të përdoren për të ndërtuar një pozicion neutral ndërmjet dy apo më shumë fushave. (Romaine,166). Voigits hedh idenë se përzierja e kodeve mund të jete ajo çfarë shihet tek antologjia e "doreshkrimev" te "Sloane Group" në lidhjet mes Latinishtes dhe Anglishtes.

Ka një premisë në të cilën dygjuhëshit janë të ndarë nga njëgjuhëshit duke u nisur prej *përdorimit të kufijve gjuhësorë* dhe atëherë, përzierja e kodeve është një mënyrë e të shfaqurit të dygjuhësisë që i lejon ata (dygjuhëshit) të shfaqin tërësinë e kompetencave gjuhësore gjatë komunikimit (Romaine; 173). Në qoftë se do të marrim një tekst mjekësor me kode të përziera, shihet qartë se dygjuhësia është gjerës Ka një premisë në të cilën dygjuhëshit janë të ndarë nga njëgjuhëshit duke u nisur prej *përdorimit të kufijve gjuhësorë* dhe atëherë, përzierja e kodeve është një mënyrë e të shfaqurit të dygjuhësisë që i lejon ata (dygjuhëshit) të shfaqin tërësinë e kompetencave gjuhësore gjatë komunikimit (Romaine; 173). Në qoftë se do të marrim një tekst mjekësor me kode të përziera, shihet qartë se dygjuhësia është gjerësisht e kultivuar të paktën, për një shekull dhe nuk vihet në diskutim. Vite më parë, ajo kishte përzgjedhur 178 doreshkrime të cilat përfaqësonin kodin gjuhësor dhe i përkisnin vitit 1375- 1500. Prej tyre, 52 ishin tërësisht të shkruara në gjuhën latine, 40 në gjuhën angleze, 86 (pothuajse 50%) ishin të shkruara në më shumë se në një gjuhë. 75 prej doreshkrime, ishin të shkruara në gjuhën Latine dhe Anglishten e mesjetës, 11 prej kodikëve ishin trigjuhësh, Latinisht, Anglisht, Frëngjisht ose Anglo-Normane.

Në këtë studim ajo konstaton se prej vitit 1375-1500, tekstet dygjuhëshe janë shumë të prekshme tek tekstet mjekësore. në të cilin është identifikuar përzierja e gjuhëve. Shembujt që ajo citon janë përzgjedhur arbitrarisht (rastësisht). Jo në të gjitha rastet është i mundur shpjegimi i përzierjes së kodeve. Voigits shkruan: "nuk e di pse RECEPTARIUM në Sloane 135 fillon në gjuhën latine dhe pas 64 recetave, komunikimi vazhdon në gjuhën angleze. A mund të quhet e qëllimshme përzierja e kodeve?"

Dygjuhësia vjen natyrshëm dhe në fusha të tjera të jetës. Një shembull të qartë dhe jo nga fusha e mjekësisë, ajo e sjell nga shekulli i XV, kur një student

i dërgonte letër prindërve për të kërkuar para për HARVARD LAW, Library 43. Në letrën dërguar prindërve, ai shton një pjesë të shkruar të ndryshme nga gjuha angleze si p.sh. "*Ecce Salutatio"* apo "*Ecce Exordium*" edhe kur ka pasur fraza alternative në anglisht janë të pajisura dhe të ndara nga 'Vel' edhe pse të shkruara me shkrime të ndryshme (Voigits, "Aw letter").

Përzierje të qëllimta të kodeve gjuhësore mund të shihen në shekullin e XIV Dominican Henry Daniel përktheu në anglisht një libër "uricrisiarum". Në Sloane 1100 si dhe një numër dëshmish të tjera në këtë tekst ka hyrjen në latinisht duke e shpjeguar më pas përdorimin në gjuhën angleze (fol. 3r-v). Ai ndiqet nga një tekst anglisht i cili në përmbajtje ka rubrika mjekësore në latinisht që ndërfutin dhe variantin latinisht të Giles dhe Corbei (TK 422) nga i cili rrjedh tradita e uroskopisë (fols. 3v-118r;) gjithashtu e ilustruar dhe në Sloane 1721)

Ky prezantim i teksteve të jep idenë e një rrethi lexuesish dygjuhësh si në rastin e receptaria që përzien latinishten me anglishten pa bërë asnjë dallim.

Është gjithashtu e mundur të citosh midis rreshtave shkrirjen e Latinishtes me Anglishten. Pashmangshmërisht në një poemë alkimike janë shkruar e alternuar në Ahmole 1452 në linja të alternuara*. "Gemma Salutaris qui nascitur orbicularis / A precius ston helpful round wyche ys borne / Est lapis occultus secreto fonte sepultus / An hyd ston he ys in secrete elle ybyrid" (fols. 35r-42v;) TK 580*

I veçantë në studim, mbetet dhe shembulli i një poeme latine kur vargëzimi në Anglisht dukshëm e ka origjinën nga latinishtja. (Bodley 591, fol. 39r-v). Kanë përmbajtje të ngjashme në të dy variantet gjuhësore në një format ku tekstet ndërthuren për çdo parashikim apo çdo adresë mujore, por asnjë prej këtyre poemave nuk shfaqet si variant i përkthyer i poemës tjetër; *"Quando natus est in Aquario necgligenes erit / If it thonder in Jenyuere and be gret wynde it betocnetheke plente of frute..." (TK 1170; not in IMEV/S; see* also Longleat House 174). Gjithkush, mund të citojë nga dorëshkrimi të dyja gjuhët në formë barasvlere. Në fund të studimit, Voigits mendon se: Ky grup tekstesh në Latinisht dhe Anglisht që qarkullojnë lidhur me dorëshkrimet Sloane demonstrojnë mjaft mirë pranëvënien e këtyre teksteve në gjuhë të ndryshme. Si rezultatet negative dhe ato pozitive përligjin përzierjen e gjuhëve shkencore e mjekësore dhe dorëshkrimet e prodhuara në Angli prej 1375- 1500. Kodet e përziera, nuk do të thonë që shkruesit ishin injorantë, të paaftë apo të ngathët. Ngjashmëria e shembujve të shumtë nuk do të thotë që mbijetesa e tyre vjen nga ndotja e Latinishtes, nga Anglishtja apo e kundërta. Ne, nuk mund të sjellim një supozim të ri ku të shkruajmë mënyrën sesi është integruar gjuha në fundin e shekullit të katërmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të pesëmbëdhjetë.

Referenca

1. Ilia Gershevitch *The alloglotograpy of old Persian* pg.120 november. 1979. Transaction of the Philogical society. Volume. 77. issue.1 version. record on line 25 .2008

2. **Leichity,** 1997 f. 27,

3. **Reiner** 1966; 66. Mayer 19/1 **Gronenberg** 1981: 78- 79;

4. **Stein** 2000, 31-34, **Hammen Antila** 2000; 32- 33, 50; 77; **Luuko** 20004; 109- 15.

5. **Woodingtoon** 1982 fq 11-12

6. **Mark Janse** *Aspekte të dygjuhësise në historinë e greqishtes së vjetër.*

7. Nicht die Einspracghkeit, sonderen Mehrsprachigkeit stelt den Normalfall dar Einsprachigkeit ist ein kulturbedingte Grenzfall von Mehrsprachigkeit und Zëeisprachigkeit eine Spileart der letzeteren (Lüdi 1996a:234) "Non – elite bilingualism".

8. Linda Ersham Voigits1997 "*What's the word? Bilingualism in the Late Mediaval in England "*Speculum /Volume 71/Issue04/ 1997 / pp.813-826

9. The Sloane Group:1990 "Related Scientific and Medical Manuscripts from the Fifteenth Century n the Sloane Collection" British Library journal 16,f. 26- 57

10. Sloane 135, fol 37

11. Wellcome 404, fol 29

James Noel Adams 2008 *Bilingualism and the Latin Society* Cambrige University Press 2003 Jame. Noel Adams and All the Souls College, Ox ford. Bilingualism and the Latin Language. Cambrige University Press. fq 1

12. **Hoffman** 1991; *Non – elite bilingualis*. Po aty f. 1415-

13. Linda Ersham Voigits "*What's the word? Bilingualism in the Late Media val in England "*Speculum /Volume 71/Issue04/ 1996/ pp.813-826

14. The Sloane Group: "Related Scientific and Medical Manuscripts from the Fifteenth Century n the Sloane Collection" British Library journal 16 (1990) f. 26- 57, saktësim i autores

Prof. as. dr. Kamber KAMBERI

PERIUDHA E SKËNDERBEUT DHE DY KOHËT TJERA NË VEPRËN E KADARESË

Hyrje

Ismail Kadare në veprën e tij letrare, por edhe jashtletrare me temën e periudhës së Perandorisë Osmane e ka të trajtuar mjaft gjerë dhe nga aspekte të ndryshme. Kjo periudhë vështruar si të tërësishme, temë bosht e ka epokën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Kjo periudhë e lavdishme ndërlidhet edhe me dy kohët tjera që janë të kushtëzuara nga njëra tjetra. Kështu në lidhshmëri, duke trajtuar periudhën e këtyre tri kohëve, mund të quhen edhe si: periudha *paraskënderbejane, skënderbejane* dhe *passkënderbejane*.

Kësaj teme në tri kohë, Ismail Kadare, rreth gjysmë shekulli, krijimtarie artistike i është kthyer e rikthyer në vazhdimësi, duke e trajtuar nga aspekte të ndryshme në veprat e tij letrare. Këto tema i qasen problematikës turko-shqiptare-ballkanase, por edhe europiane kur faktor dominues për një kohë të gjatë ishte Gjergj Kastrioti, i cili pa mëdyshje përcaktoi fate për shqiptarët e fate popujsh europianë, duke ndërruar kështu rrjedha historie.

Veprat e Kadaresë që i përkasin kësaj periudhe, janë shkruar në kohë të ndryshme, por të cilat në këtë rast nuk duhet analizuar në vijë të drejtë sipas viteve kur janë shkruar. Ato, duhet vështruar në plan krahasimtar me kronologjinë historike. Prandaj, ky punim do t'i qaset temës nga datimi historik trajtuar në vepër artistike.

Historia e përgjithshme e shqiptarëve është njëra nga historitë më specifike e më të dhimbshme, mbase edhe më interesante krahasuar me historitë e popujve tjerë europian, por edhe më gjerë. Duke pasur parasysh pozicionin e shtrirjes së gjerë gjeografike, tokën dhe detet ku jetonin arbërorët, mund të thuhet se ky territor kishte rëndësi të madhe gjeostrategjike e ekonomike në të gjitha kohërat. Prandaj në vazhdimësi kishte përjetuar tragjedi të mëdha, luftëra të shumta, me pushtime të ndryshme, me humbje të popullsisë e të territoreve gjithashtu. Nga gjitha këto periudha të ndryshme, ajo e Perandorisë Osmane është më e gjata, më e tmerrshmja, më e veçanta për gjurmët e lëna dhe kthesat që shkaktoi në gjithë rrjedhën e historisë së mëvonshme të shqiptarëve. Ky hark kohor, në trojet arbërore përfshinë më se gjashtë shekuj radhazi, duke filluar që

nga pjesa e parë e shekullit XIV kur shfaqen shenjat e para të gjëmës së madhe. Kjo gjëmë do të shfaqet rëndshëm në këto vende që nga gjysma e dytë e shekullit XIV, kur inkursionet e Perandorisë Osmane po shpeshtoheshin gjithandej për një depërtim pushtues dhe shtrirje të gjerë hapësinore jo vetëm te shqiptarët.[1]

Kjo periudhë pushtuese, rrënuese dhe robëruese njëkohësisht, konsiderohet e stërzgjatur për shumë vende e popuj të ndryshëm. Pas ngritjes së gjatë, kjo perandori merr edhe teposhtën e gjatë dhe si rrokullimë e skëterrshme vjen me hijen e saj deri vonë për të prekur me përfundimin e saj pjesën e parë të shekullit XX, kohë kur shkërmoqet kjo ngrehinë shumëshekullore. Kështu fundi i dekadës së dytë të këtij shekulli shënon rrënimin përfundimtar të perandorisë dhe sulltanëve.[2]

Të gjitha ngjarjet e ndodhura brenda periudhës së Perandorisë Osmane, janë të ndërlidhura me kohën e Skënderbeut, por edhe me kohët e pasvdekjes së tij. Ngjarjet e këtyre kohëve sigurisht që ndërruan kahe historie, por edhe shkaktuan ndryshime të shumanshme. Lidhur me këto dy kohë të ndryshimeve të mëdha, këtë e paraprinë edhe periudha para kohës së Skënderbeut që sigurisht ka ndikim dhe lidhshmëri në dy periudhat tjera.

Mesjeta e hershme, paraskënderbejada

Në Mesjetën e hershme, Shqipëria është rrezatuese e një kombi të civilizuar, me zhvillime e mendësi moderne për kohën, mendësi europiane-

---

[1] Së pari, Perandoria Osmane përfaqëson një formacion politik, për një periudhë më shumë se 500 vjeçare, përfshiu në gjirin e saj të gjitha viset shqiptare. Së dyti, Perandoria Osmane ishte formacioni ushtarak që e kër cënoi vazhdimisht dhe seriozisht Europën Perëndimore. Ajo arriti që me fuqinë e saj politike dhe ushtarake, të bëhej një faktor shumë i rëndësishëm në ekuilibrin politik të forcave në Europë në shekullin VI - XVII dhe një faktor shumë i rëndësishëm në formësimin politik të Europës së Sotme. Së treti, kjo perandori me një shtrirje trekontinentale përbën një pjesë shumë të rëndësishme të historisë botërore, pasi ajo përjetoi Mesjetën e Vonë, Kohërat e Reja dhe ato Moderne dhe, falë pozicionit gjeopolitik që gëzonte, kontrolloi rrugët kryesore tregtare të botës.
Robert Mantran, Historia e Perandorisë Osmane, Dituria, Tiranë, 2004, f. 15.

[2] Dei në sundimin e Sylejmanit I (1520-1566) sukseset ushtarake të vazhdueshme në një trevë që shtrihej nga Evropa Qendrore deri në Indinë Oqeanike, i kishin dhënë Perandorisë Osmane statusin e një fuqie botërore, por në luftrat e gjata të shekullit XVII ekuilibri u kthye në të mirë të Evropës. Pushteti osman shënoi rënie, kurse me njohjen e superioritetit perëndimor në shek. XVIII, Perandoria u bë politikisht dhe ekonomikisht e varur nga Evropa. Më në fund, ekzistenca e vazhdueshme dhe shkatërrimi i mundshëm i Perandorisë u bë problem i politikës së Evropës, e aq "Çështja e Lindjes". Jeta politike osmane vazhdoi deri më 1920 nën tutelën evropiane.
Halil Ilanxhik, Perandoria Osmane, LOGOS-A, Tiranë, 2010, f. 13.

perëndimore, larg prapambetjes e vonesës aziatike-bizantine. Ishte një urë lidhëse e Perëndimit me Lindjen, edhe në kulturë edhe në infrastrukturë. Rruga Via Egnatia, si rrugë kryesore, por edhe udhë tjera, bartnin natë e ditë karvanë nga Perëndimi në Lindje e anasjelltas, karvanë tregtarësh, historianë, rapsodë, piktorë, gjeografë etj. Bujtina e hane gjithandej, në të cilat këndoheshin këngë e shkëmbeheshin kultura, jepej informacion për kohë e vende të largëta, krijoheshin epose e legjenda, merreshin e jepeshin këngë e melodi, eposet qarkullonin pastaj jo vetëm në hapësirat ballkanike, por të tri kontinenteve.

Principatat arbërore, kishin një organizim të shkëlqyer, me qytetërim perëndimor. Mbi të gjitha këto, qëndron shpirti i lirë i arbërorëve, krenaria legjendare, vetëqeverisja, mosnënshtrimi e miqësia, bujaria e besa si fenomen unik europian, dinjiteti e liria njerëzore, femrat e qytetëruara e respekti ndaj tyre, kështu këto dalin në kontrast të plotë me botën e largët aziatike. E gjithë kjo pamje plot dritë, jepet në një numër veprash të Kadaresë, ndër të cilat veçohen *"Ura me tri harqe"* dhe *"Kush e solli Doruntinën"*.

Natyrës së kësaj jete shumëshekullore, organizimit shoqëror, pamjes së këtij dritësimi, një gjëmë e madhe do t'i vinte shumë shpejt. Perandoria e stërmadhe turke ishte në horizont. Ajo do të vinte e do të shkërmoqtë tërë këtë dritësim. Ishte kjo gjëmë që do të sillte më vonë një epokë. Një epokë që nis me thyerjet e mëdha, që shfaqet te *"Ura me tri harqe"*.

Parandjenja e zymtë dhe nata aziatike që do të mbulonte e pllakoste botën e Arbrit dhe krejt Ballkanin, jepet në një sërë veprash të Kadaresë. Me një simbolikë dhe alegori të shkëlqyer, Kështu, Kadareja e jep parandjenjën e zymtë, tek novela *"Sjellësi i fatkeqësisë"*.

Mijëra ferexhe të zeza, shtegtojnë nga kryeqendra e perandorisë aziatike, drejt trojeve të Arbrit dhe gjithandej drejt Evropës. Ato nuk janë thjesht një cohë e zezë që do të mbulojë fytyrat e bukura të femrave arbërore. Simbolika është e qartë: nata aziatike që do të mbulojë gjithçka, është zhbërja e gjithë atij dritësimi europian me përhënjen e horizontit aziatik. Është agresioni kulturor, ndërrimi i mendësive që i paraprin agresionit, dhunës e gjakut. Dhe s'vonon shumë e parandjenja shfaqet, tashmë në formën e gjakut të derdhur. Është qershori i vitit 1389. Është *Fushë-Kosova*. Ajo, çka do të ndodhte atë ditë të nxehtë qershori të vitit 1389, do të kishte pasoja fatale pesëqind vjeçare për ballkanasit prandaj edhe për shqiptarët. Dhe jo vetëm kaq, në këtë përkufizim, ky fatalitet është i tejkohshëm. Epose në dy kahe të kundërta, do të krijoheshin rreth asaj dite qershori. Në njërën anë shqiptarët që flisnin për mynxyrën që ndodhi, në tjetrën anë të tjerët, që do të krijonin një epos të zi. Do të krijonin një mit hegjemonist rreth kësaj beteje humbëse.

Në vitin 1976, në librin poetik *"Koha*", Kadare shkruan poezinë *"Mundja e ballkanasve në Fushën e Kosovës më 1389".* Në mënyrë mjeshtërore, ai, jep tablonë rrëqethëse të asaj dite qershori, duke dhënë mesazhe gati profetike. Beteja ka mbaruar, fusha është plot me të vrarë, dhe bie mbrëmja që do të përcaktonte fatin e pesë shekujve në vijim. *"Pastaj doli gjysmëhëna dhe mori në dorëzim gjithçka"*, thotë Kadareja në poezinë e përmendur. Simbolika është e qartë: s'është fjala për hënën e netëve kosovare, fjala është për gjysmëhënën, simbol i Perandorisë Osmane, që do të sundonte tashmë gjithçka në hapësirat ballkanike. Si gjethet në vjeshtë, në tokat e Arbrit, do të binin një nga një titujt e fisnikërisë, kodet e zakonet, përshëndetjet e shumëçka tjetër, që do të zëvendësoheshin me tituj, fjalë e kode aziatike. Fytyrat dritësore perëndimore, do të erreshin nga nata aziatike, nga çallmat e ferexhetë. Gjuhët ballkanase, prandaj edhe shqipja e bukur do të asfiksoheshin. Si bisht gjarpri, do t'u ngjitej prapashtesa "llëk". Edhe si gjëmë edhe si profeci të Kadaresë e jep vargu i kësaj vjershe*: "Medet, ç'gjak do të derdhet për të ndrequr atë çka u prish këtu!"*[3]

Dhe përveç varreve që mbushin Ballkanin për pesë shekuj, edhe pas largimit të perandorisë turke, gjaku u derdh gurrë. Kësaj ngjarjeje si nyje e historisë, në vitet e fundit, Kadare i kushton edhe një vepër në prozë *"Tri këngë zie për Kosovën".* Vepër që transmeton kumte e mesazhe plotësisht kohore, si bie fjala e raporteve midis popujve të Ballkanit dhe Europës Perëndimore. Kemi lahutarë shqiptarë e rapsodë ballkanas që në mbarim të betejës shkojnë te Zonja e Vjetër me paraqitjet e tyre aq interesante. Është mesazhi i (mos)marrjes vesh midis ballkanasve, mesazhi i fateve të përbashkëta historike, mesazhi i shuarjes së urrejtjeve ndëretnike, të cilat për fat të keq ende sjellin erë të asaj periudhe mesjetare.

Skënderbejada, (Epoka e Skënderbeut)

Veprat që lidhen direkt me figurën e Skënderbeut e me epokën e tij, e cila quhet edhe *"Skënderbejada",* Kadare i ka shkruar në poezi e në prozë dhe përfshijnë një hark kohor rreth gjysmëshekulli. Datimi i shkrimit të parë serioz është viti 1957, kur ishte ende i ri, vetëm 21 vjeç, shkruan një poezi nga më cilësoret e kohës për *zhvarrimin* e Skënderbeut. Kjo poezi e titulluar së pari *"Zhvarrimi i Skënderbeut",* për shkak të temës që trajton, autori i rikthehet përsëri në librin *"Motive me diell",* botuar në Tiranë më 1968. Këtë poezi, me ndonjë ndreqje të vogël e gjejmë nën titullin *"Balada e zhvarrimit".* Siç shihet nga titulli, autori merret me pasvdekjen e Heroit. Kështjellat shqiptare bien, turqit pushtojnë Shqipërinë, zhvarrosin Heroin nga kisha e Shën Kollit në Lezhë. Dy

[3]Ismail Kadare, Vepra, vëllimi i shtatë, Vjersha dhe poema, Onufri, Tiranë 2008, f. 271.

vjet më vonë, më 1970, ai boton romanin e tij të njohur "*Kështjella"*, një nga veprat më të arrira të autorit e të krejt letërsisë shqipe. Në të trajtohet tema e njërës prej 24 betejave të Heroit dhe bashkëluftëtarëve të tij në një mënyrë sintetike e përgjithësuese, me mjete e mjeshtëri brilante. Duke u shmangur nga realizmi klasik, figura e heroit vizatohet në një formë të re. Më tepër se sa vizatimi klasik, ai shfaqet si *"frymë"*. Portreti i tij është i copëzuar, i shpërndarë tek qindra njerëz.

Duke ndjekur kronologjinë kohore të shkruarjes së veprave duhet të përmendim këtu poezinë tjetër të tij, *"Vdekja e Skënderbeut"*. Edhe kjo poezi bën pjesë në fondin më të mirë të autorit. Jashtë përshkrimit narrativ klasik, autori e sheh figurën e heroit të njëjtësuar me atdheun, edhe në shtratin e vdekjes. Më tepër se individ, Heroi është hartë e atdheut, gjymtyrët e tij që po kaplohen nga vdekja, janë pjesët e kësaj harte. Po në këtë libër boton poezinë *"Portreti i Skënderbeut"*, një poezi koncize e brilante. Poezia, ka gjithsejtë katër strofa katërshe dhe ngërthen në vete dy kohë: jetën dhe pasjetën e Skënderbeut. Përveç portretizimit të përkryer të Heroit, në dy vargjet e kësaj poezie i rikthehet edhe njëherë motivit të zhvarrimit të përmendur më 1957, /"*Pas vdekjes eshtrat iu shpërndanë,/ Në mijëra varre ato u shtrinë..."*[4]

Në tri poezitë e lartpërmendura autori krijon një trini të mrekullueshme artistike, të rralla për nga vlerat dhe arrin ta kompletojë figurën legjendare të legjendës shqiptaro-evropiane, Gjergj Kastriotit. Ndonëse fragmentar, portreti i Skënderbeut jepet edhe në shumë poezi të Kadaresë. Me sa duket figura e Heroit është në vetëdijen e shkrimtarit dhe i shfaqet atij herë pas here, edhe në udhëtimet që bën nëpër botë. Edhe në ngjarjet dramatike që përjeton kombi.

Kështu në vëllimin poetik Motive me diell botuar më 1968, autori ka një poezi me titull Në Romën e mesnatës. Poezia është shkruar me sa duket gjatë një udhëtimi të autorit në Romë, që ishte diçka e rrallë për kohën. Nën shiun e mesnatës së Romës, shi herë i zverdhur herë i zverdhur e herë i përflakur nga reklamat, autori kërkon një bujtinë mesjetare ku bujti Skënderbeu pesë shekuj më parë. Troku I kalit të Skënderbeut tingëllon ende nën shiun pesë shekujve më vonë. /*"Në Romën e mesnatës, nën shiun e butë, /Herë të zverdhur, herë bleruar, herë të përflakur nga reklamat /Kërkojmë në labirintin e qendrës një bujtinë mesjetare /Ku erdhi me shërbim pesë shekuj më parë Kastrioti"*[5]

Fjala shërbim i jep një ngarkesë kuptimore e emocionale të posaçme poezisë. Heroi ndryshe nga princat tjerë mesjetarë, shkon në Evropë, jo si turist, por për hallet e mëdha të Atdheut të tij. *Ja rruga, Bujtina e errët...*- thotë autori. Gjithçka e thjeshtë s'kishte si të ndodhte ndryshe kur kështjellat arbërore

---

[4] Ismail Kadare, Vepra, vëllimi i shtatë , Onufri, Tiranë, f. 288.

[5] Ismail Kadare, *Motive me diell, Rilindja, Prishtinë 1978, f. 137.*

bombardoheshin ditë e natë nga topat e perandorisë turke. Përfshirë këtë poezi dhe poezinë e përmendur *"Terrori në Kosovë",* ku presupozohet një ringjallje e heroit, pasi e ka thirrur koha, këto janë disa nga krijimet kryesore të Ismail Kadaresë që lidhen direkt me *"Skënderbejadën"*.

Në veprat tjera ku nuk përmendet direkt kjo epokë, koha është e nënkuptuar. Drama e madhe që i ndodhi Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut, e çon mendjen e shqiptarëve vit për vit e shekull pas shekulli te *Moti i Madh,* siç e quajtën poetët arbëreshë epokën e Skënderbeut. Këtë dramë të mëvonshme, na jep I. Kadare në një numër veprash.

Epoka passkënderbejane

Gjëma e madhe tashmë kishte ndodhur me vdekjen e Gjergj Kastriotit. Jo vetëm për Arbërinë, horizonti është më i gjerë, për qytetërimin europian. *Shpata dhe mburoja e krishterimit,* kishte vdekur. Dielli dhe hëna në dy emrat e Skënderbeut, të përmendur në poezinë e Kadaresë, do të shuheshin dalëngadalë dhe nata aziatike do t'i shuante këto dy dritësime. */ Një emër Gjergj e kish si diellin/, /Tjetrin si hënën, Skënderbe/.*[6]

Pra, dielli që lind jetën dhe mbulonte dritën arbërore, kishte perënduar. Hëna që dritësonte natët arbërore dhe e bënte ditë, gjithashtu kishte perënduar. Por, megjithatë Skënderbeu, do të bënte një jetë të dytë në shekujt vijues. Emblema e tij do të shfaqet gjithandej në kullat arbërore. Burrat arbërorë, që s'dinin të mbanin zi, tashmë e parandiejnë zezonën dhe modifikuan veshjet e tyre. Në shenjë zie për Skënderbeun, kombi ndërroi veshjet, përgjithnjë deri tash së voni. Ai ishte në krenaritë e tyre, në ëndrrat dhe shpresat e tyre. Tashmë zezona kishte ndodhur. Gjysmëhëna e paralajmëruar në Fushë Kosovë, nata aziatike, po ashtu e paralajmëruar, e përballur me 24 luftëra në 25 vjet nga Skënderbeu, kishte mbërritur në Arbëri dhe sundonte gjithçka. Shumë do të merrnin *detin në sy* e do të iknin larg përtejdetit, duke jetuar vetëm me kujtimet e *Motit të Madh.* Të tjerët do të mbylleshin maleve duke rezistuar heroikisht. Në *t'banët* e tyre e në kullat alpine, do të vinte herë pas here *fryma e hija e Skënderbegut.* Kësaj zezone I. Kadare i kushton një ansambël të tërë veprash letrare, të cilat përcjellin mesazhe madhore të lirisë.

Perandoria e stërmadhe, që la dy sulltanët e mundur në dyert e kështjellave arbërore, tash vepron lirisht. Në qendër të Perandorisë është Pallati i ëndrrave,*(Pallati i ëndrrave, I. Kadare)* pallat që survejon edhe gjumin dhe ëndrrat e njerëzve, pra edhe të bashkëkombësve të Skënderbeut. Dalin ligje e fermane të ndryshme, të çuditshme, që janë të detyruar dhunshëm të zbatohen

[6] I. Kadare, Vepra, vëllimi i shtatë (Poezi dhe poema), Onufri, Tiranë, f. 288.

edhe në Arbëri *(Te Qorrfermani, I. K.)*. Po hija e Skënderbeut shfaqet gjithandej. Pashallarë me fate të njëjta si Skënderbeun, tentojnë ta bëjnë Shqipërinë, po i pret i njëjti fat. Jo me vdekje natyrale si te Kastrioti, por me shpatë. Ali pashë Tepelena, që tentoi të plotësonte çka la mangut Skënderbeu, por së fundi e pësoi tragjikisht, trupi i tij u nda në dy varre./*Koka në Stamboll, trupi në Janinë/*. Poezia *Ali pashë Tepelena.*

Te vepra në prozë, *"Kamarja e turpit"*, që ka të bëjë po ashtu me Ali Pashë Tepelenën, ka një qasje krejt të dukshme me Skënderbeun, figurën kryesore të *Motit të Madh*, por vepër që i kushtohet epokës postskënderbejane. Kështu me gjithë peshën e rëndë të dhunës dhe shtypjes shumëshekullore, liria ende s'ka vdekur. Ajo, gjallon në male ku s'shkel dot këmba e pushtuesit. Prijës të rinj kanë dalë dhe kryengritjet s'kanë të rreshtur. *"Treqind kryengritje në katërqind vjet"*, thotë Kadare në një poezi. Kujtimi dhe krenaria rrojnë. Për të zhdukur çdo kujtim a shëmbëlltyrë të Skënderbeut, për të shfarosur të gjithë ata që tentojnë të plotësojnë çka mbeti pa kryer nga heroi, Perandoria osmane organizon një nga masakrat më të përgjakshme, *Masakrën e Manastirit.* Në këtë masakër, tradhtisht e mizorisht vriten 500 krerë shqiptarë. Kësaj ngjarjeje i kushtohet, novela dinjitoze *"Komisioni i festës*", në të cilën parashtrohet qartë edhe një tipar i errët i perandorisë, dredhia, prerja në besë, pabesia që ishte antiteza e kodit moral të shqiptarëve.

Kujtimi për Skënderbeun dhe shëmbëlltyrën e tij rrojnë edhe pas katër shekujsh nga vdekja e tij. Perandoria Osmane do t'i kujtonte e do t'i numëronte shpeshherë plagët e pashërueshme, që u kishte shkaktuar Skënderbeu. Këtë përshkrim, autori e jep përmes një nëpunësi perandorak edhe në tregimin "*Lamtumira e së keqes"*. Jashtë vëmendjes sonë s'mund të mbetet edhe një vepër tjetër "*Viti i mbrapshtë",* me të cilën autori pothuaj mbyll ciklin e temës perandorake dhe jep mesazhe madhore për kohën, çka u dëshmua edhe në vitet në vijim. Perandoria është larguar, një pjesë e ëndrrës së Skënderbeut është plotësuar me Shpalljen e Pavarësisë më 1912, por pasojat e trysnisë pesëqind vjeçare, kanë mbetur. Njerëz të konvertuar edhe në shpirt e nostalgjikë të kohëve të vdekura, duan t'i ringjallin ato kohë, ta përsërisin historinë. Rreziku i tentimit të përsëritjes është i përhershëm. Ky kumt i shkrimtarit, dhënë tek *"Viti i mbrapshtë",* u vërtetua u justifikua në mënyrë dramatike dhe të shëmtuar në vitin e mbrapshtë 1997, në Shqipëri.

Ky vështrim panoramik, na çon tek ideja se epoka do të ishte e mangët pa Skënderbeun dhe anasjelltas. Qëllimi i Kadaresë në këtë qasje është i shumëfishtë dhe këto ndërthuren në veprën e tij që shquhet për dy cilësi të letërsisë së madhe: shumëkuptimësia dhe shumëkohësia.

Literatura

1. Aliu, Ali, Miti ballkanik te Kadareja, Onufri, Tiranë 2006.
2. Baçi, Agim, Përse e sollën Doruntinën, Onufri, Tiranë, 2013.
3. Gjoka, Behar, Kadare i rilexuar, Princi, Tiranë 2008.
4. Kadare, Ismail, Ftesë në Studio, Naim Frashëri, Tiranë 1990.
5. Kadare Ismail, Vepra vëllimi i shtatë, Onufri, Tiranë, 2008.
6. Kadare, Ismail, Dialog me Alain Bosquet, Onufri, Tiranë 2004.
7. Kadare, Ismail, Vepra 10, (kush e solli Doruntinën) Onufri, Tiranë, 2008
8. Mandala, Matteo Mandala, Ismailand-i dhe urat kronotopike kadareane, Hylli i dritës, nr.1. Shkodër 2009.
9. Sinani, Shaban, Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, 2009.

Dr. Irena PAPA (Sevdaraj)

RRUGËTIMI I GJUHËS SHQIPE NGA SHPALLJA E PAVARËSISË E DERI NË VITET ‘90

The journey of Albanian language from the Declaration of Albanian Independence to the 1990s

Fillesat zyrtare të mësimit të gjuhës shqipe datojnë me hapjen e shkollës së parë shqipe më 7 mars 1887 me “Mësonjëtoren e parë”. Deri në momentin e shpalljes së pavarësisë gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha turke, madje edhe dokumentacioni i mbledhjeve të mbajtura nga vetë qeveria e parë shqiptare është në këtë gjuhë. Në fillimin e viteve 1908, kemi shkolla shqipe pothuaj në të gjithë vendin, por në kushtet e ilegalitetit, pa një program të konsoliduar dhe jo të qëndrueshëm. Po të flasim me gjuhën e sotme, kanë qenë më shumë kurse se shkolla, por që sigurisht për atë periudhë kanë qenë ndër arritjet më të mëdha, përpos sakrificave që kërkonte hapja e tyre pasi ishte gjithmonë rreziku i dënimit. Mbas vitit 1908, me shpalljen e “Hyrietit” ose “Lirisë”, nga Abdyl Hamiti II, situata lehtësohet disi. Gjuha shqipe fillon të mësohet si gjuhë e dytë pothuaj në të gjitha shkollat qytetëse.

Edhe pse fillesat e mësimit të gjuhës shqipe i gjejmë qysh në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë siç e përmendëm edhe më lartë, mësimi i saj me programe të posaçme për një orë mësimi sa më të organizuar dhe të orientuar fillon vetëm në vitet ’20, i dëshmuar edhe nga programet përkatëse të gjuhës shqipe nga viti 1921 e në vazhdim.

Ajo çka do të vërejmë në këto programe me kalimin e viteve është ndryshimi i qëllimit dhe orientimit të nxënësve. Duke qenë se Shqipëria dhe shqiptarët vinin nga një luftë e gjatë dhe e mundimshme për mësimin e gjuhës së tyre, në programin e vitit 1921 për mësimin e gjuhës shqipe vërejmë se fokusi është tek nxitja e nxënësve për ta mësuar gjuhën e tyre amtare me dashuri si dhe për ta vlerësuar lart atë, duke mbështetur më shumë mësimin e gjuhës së folur e të shkruar sesa rregullat gramatikorë: “Detyra e mësuesit të gjuhës shqipe është t’u ushqejë nxënësve dashuri për gjuhën... t’u jepet më shumë rëndësi mësimeve të gjuhës se sa gramatikës.” Por gjithashtu edhe mësimi i gramatikës për një shqipe

sa më të saktë e të pasur është në fokus të librit "Grammatikë e gjuhës shqipe" e vitit 1921, ku në parathënien e tij, autori Kiço Konomi pohon: "... Përmbi nevojën e grammatikës me rast do bëjmë fjalë gjer' e gjatë, këtu mjaftojmë të njoftojmë se shkruam këtë grammatikë tuke u bazuar mbi kufizimin pedhagoxhik që gjuha formon grammatikën edhe jo grammatika gjuhën. Pra jemi munduar ta shkruajmë tuke marrë parasysh rregullat dhe idhiotismat që mprojnë pej gjuhës kur e flet populli tuke jashtuar do-e-mos ato të gabushmet. "

Me kalimin e viteve vërejmë se edhe synimet e mësimit të gjuhës shqipe ndryshojnë. Qëllimi nuk ishte më vetëm të folurit dhe të shkruarit të saktë të gjuhës, por është zgjeruar më tej duke synuar atë që në ditët e sotme e quajmë aftësi komunikative. Pra, nxënësit duhet të ishin në gjendje të komunikonin në mënyrë korrekte me bashkëbiseduesit e tyre, duke kuptuar mesazhin e bashkëbiseduesit, por njëkohësisht edhe ta bënin veten të kuptoheshin prej të tjerëve. Kështu, në vitet '30 Sotir Papahristo në librin e tij "Ushtrimet gjuhore dhe hartimet në shkollat fillore dhe të mesme" rendit si të parin qëllim për mësimin e gjuhës shqipe: " ... të bëhet i zoti nxënësi që ta përdorë mirë gjuhën si në të folurit, ashtu edhe në të shkrojturit. Me fjalë të tjera, nxënësi duhet ta mësojë gjuhën që të mund të kuptojë fjalët dhe kuptimet e të tjerëve, të mund t'i komunikojë tjetrit bukur e mirë mentimet dhe ndjenjat e tij, të mund të këndojë dhe kuptojë një libër. Të aftësohen nxënësit që të kuptojnë qartë mendimet e të tjerëve dhe të tregojnë mendimet e veta drejt dhe qartë... Me anën e ushtrimeve të gjuhës të mësohen nxënësit që të flasin e të shkruajnë drejt gjuhën. " Kjo aftësi përforcohet më tej në programin e vitit 1946 ku theksohet se "Gjuha është mjet komunikimi dhe marrëdhënie shoqërore. Ajo nuk mund të shkëputet nga jeta, prandaj edhe mësimi i saj duhet të lidhet me botën reale që e rrethon nxënësin ".

Në librin e tij "Libri i gjuhës shqipe për klasën e tretë fillore" të vitit 1942, Aleksandër Xhuvani përpiqet të sjellë një formë të re të trajtimit të gramatikës siç e pohon edhe ai vetë në parathënien e librit, duke u bazuar në botimet më të reja të gramatikave gjermane. Vërejmë kështu përpjekje për të sjellë një frymë të re në mësimin e gjuhës shqipe duke e përmirësuar e duke e lehtësuar mësimin e saj: "... Në të ndryshuemin e saj kam marrë mbrapa metodën e nj'a dy gramatikave të reja gjermane e ma fortë t'asaj të Tumlirz – it ". Përveç rëndësisë që autori i kushton mësimit dhe përvetësimit sa më të mirë të gramatikës nga fëmijët, ai i ka kushtuar rëndësi edhe aftësive të të lexuarit, të shkruarit dhe në fund edhe të të folurit siç shprehet ai: "... e veç kësaj edhe nga nji copë të posaçme këndimi. [...] Në fund i shtova edhe nji pjesë të vogël për hartime. [...] Në punën e t'endunit dhe të lidhunit të ideve i rashë mbrapa njij stili krejt shqip e vojta ma fort pas të folunit t'Elbasanit... "

Në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, në programin e vitit shkollor 1957 – 1958 shohim që një vëmendje e veçantë i kushtohet njohurive gramatikore duke vënë theksin në rëndësinë e përvetësimit nga ana e nxënësve të njohurive morfologjike, por pa lënë pas dore ato sintaksore: "Është e papranueshme që një nxënës i klasës së VI apo VII të mos dijë të bëjë një analizë të plotë morfologjike. " Në këtë program rëndësi i kushtohet edhe aftësisë së të shprehurit me gojë e me shkrim të nxënësve duke vendosur theksin tek rëndësia e punimeve me shkrim. Ajo që vihet re në këtë program është kërkesa për t'u larguar nga të mësuarit përmendësh i rregullave gramatikorë: "Por është një fakt se mësonjësit e gjuhës shqipe i kanë dhënë më shumë rëndësi të mësuarit përmendësh të rregullave sesa zbatimit të tyre në ushtrime në shkrim e me gojë. [...] Me programin e ri kërkohet që t'u bëhet më shumë vend ushtrimeve, natyrisht pa rënë në një prakticizëm të thjeshtë.

Ka raste kur disa rregulla e sidomos përkufizimet, duhen mësuar përmendësh nga nxënësit, por ësht' e domosdoshme nga ana tjetër që mësonjësi të bindet në se nxënësi që e thotë atë rregull apo atë përkufizim e kupton plotësisht dhe mund ta zbatojë në praktikë apo jo. Sidoqoftë duhet hedhur poshtë të mësuarit e gramatikës formalisht sikurse ndodh me disa mësues që ngulin këmbë në të mbajturin përmendësh të rregullave, të përjashtimeve të formave model."
Në programin e shkollës tetëvjeçare të vitit 1965 vërejmë frymën patriotike që përpiqet t'u transmetohet nxënësve, dashuria për gjuhën, dhe një risi është edhe zhvillimi i logjikës dhe i një forme të të menduarit kritik. "Mësimet e gjuhës i bëjnë nxënësit të aftë të kuptojnë pasurinë dhe varietetin e madh të mjeteve për të çfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ata kuptojnë ëmbëlsinë, forcën dhe ekspresivitetin e gjuhës, gjë që ndihmon edukimin e patriotizmit. Në procesin e mësimeve të gjuhës duhet t'u ngulitet nxënësve dashuria për gjuhën, të ngjallet në ta ndjenja e përgjegjësisë për fjalën dhe dëshira që të përpiqen për kulturën e të folurit. Nxënësit duhet të kuptojnë se zotërimi i lirë i gjuhës është një kusht i domosdoshëm për të marrë pjesë aktive në ndërtimin e shoqërisë së re.

Studimi i gjuhës luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e të menduarit të nxënësve, mbasi shoqërohet me punë të vazhdueshme analitiko – sintetike, në proçesin e së cilës kryhen operacione të tilla mendore, siç është krahasimi, ndarja e tipareve esenciale të fenomeneve të studjuara, përgjithësimi, dhe sistematizimi i materialit. Në këtë program theksi vihet edhe në zhvillimin e aftësive të të folurit dhe përmirësimi i shprehive të të shkruarit dhe të folurit: "Studimi i gjuhës nënkupton një punë të madhe për zhvillimin e të folurit të nxënësve (zgjerimi i fjalorit të tyre, perfeksionim i shprehive të leximit, shqiptim i drejtë dhe ekspresiv i të folurit të lidhur dhe përvehtësim i ortografisë dhe

pikësimit).

Por gjuha nuk duhet studjuar në mënyrë të shkëputur prej zhvillimit të shprehive, ngritjes së kulturës së të folurit të nxënësve.

Vëmendje veçanërisht e madhe i kushtohet në program zhvillimit të të folurit. Për çdo pjesë janë formuluar kërkesa në lidhje me zhvillimin në nxënësit të aftësive për të përdorur me gojë e me shkrim pjesët e ligjëratës e të fjalisë.
Në çdo mësim duhet treguar kujdes për kulturën e përgjigjeve të nxënësve me gojë, për logjikën dhe lidhjen e mendimeve në të folurit e tyre e të kërkohet prej nxënësve lexim ekspresiv i shembujve.

Qysh në vitet ’30 Aleksandër Xhuvani i kushtonte shumë rëndësi rolit dhe përzgjedhjes së metodës në mësimdhënie: “Së pari, metoda ndryshon sipas natyrës së objektivave të mësimit. Gjeografia, p.sh., do të mësohet ndryshe prej gramatikës, matematika ndryshe prej historisë së natyrës. Së dyti, metoda ndryshon sipas moshës së fëmijës, nuk mundet t’u mësohet nxënësve të fillores po në atë mënyrë, me të cilën u mësohet nxënësve të shkollës së mesme. Së treti, mësuesi i zoti di të përdorë si duhet metodën në rrethanat e ndryshme, ai do t’i japë metodës vragën e veprimit të tij të vetëdijshëm. Metoda më e kulluar i mungon qëllimit të vet nën drejtimin e një mësuesi pa inteligjencë e pa kujdes, sikurse një vegël e mirë bëhet e padobishme në duart e një punëtori që nuk di ta përdorë. ”

Metoda, ishte një çështje që preokuponte edhe studiues të tjerë pothuaj gjysmë dekade më pas në fillimin e vitet ‘80. Kështu, Virgjini Lafe në librin e saj “Për përsosjen e mësimdhënies së gjuhës shqipe” shprehet se “Edhe në lëndën e gjuhës, ashtu si në lëndët e tjera problemi i metodave duhet parë në mënyrë të dyanshme: nga njëra anë metodat që përdor mësuesi në dhënien e njohurive të reja dhe nga ana tjetër metodat që përdor nxënësi në përvetësimin e këtyre njohurive dhe këtu roli kryesor për përzgjedhjen e metodave sa më të efektshme i takon mësuesit ”

Ajo që vërehet tek vëzhgimi i bërë nga Lafe, është se edhe pse mesi i viteve ’80 kur Shqipëria ishte ende e izoluar nga perëndimi dhe nga qasjet e metodat e reja të aplikuara në fushën e mësimdhënies në vendet përtej detit, sërish bëheshin përpjekje për një ndërthurje mes metodave të ndryshme për të shkuar tej asaj tradicionale. “Në përgjithësi është hequr dorë nga kërkesa për të mësuar në mënyrë mekanike rregullat .... dhe duke u dhënë vendin e duhur ushtrimeve me karakter krijues... Shpjegimin e lëndës së re duhet ta paraprijë një bisedë hyrëse e ndërtuar drejt. Biseda hyrëse shërben për të bërë lidhjen midis temës së re dhe njohurive të mëparshme, ajo organizohet pikërisht duke u mbështetur mbi këto njohuri. Kjo ndihmon për aktivizim e nxënësve, për

rritjen e shkallës së vëmendjes në mësim. ” Gjithashtu autorja vijon më tej duke theksuar se mënyra se si mund të përmirësojmë mësimdhënien e njohurive të reja në lëndën e gjuhës shqipe është si në mënyrën induktive ashtu dhe në atë deduktive. Rruga induktive, argumenton ajo, gjen zbatim zakonisht në mësimet ku mësuesi me anën e pyetjeve të ndërtuara drejt dhe duke u mbështetur në njohuritë e mëparshme, i çon nxënësit në nxjerrjen e rregullës a të përfundimit në mënyrë të pavarur. Kjo rrugë, sipas saj, përdoret më shpesh në klasën V. Por Lafe gjithashtu nxit kreativitetin tek mësuesit duke inkurajuar ata të mos mbesin “të kapur” vetëm pas një mënyrë të caktuar, por të eksperimentojnë me ndërthurjen e disa mënyrave të ndryshme përgjatë së njëjtës orë mësimi: “Mësuesi duhet të jetë krijues në punën e tij. Për shpjegimin e lëndës së re, pra për dhënien e njohurive të reja rreth një teme të caktuar, mund të përdoren rrugë e forma të ndryshme në përshtatje me gjendjen e klasës, me njohuritë dhe shprehitë gjuhësore që kanë fituar nxënësit nga e kaluara, me dobësitë dhe zbrazëtitë që kanë ata.

Përvoja tregon se në një orë mësimi nuk mund të përdoret nga fillimi deri në fund vetëm një rrugë, p.sh. vetëm rruga induktive, apo vetëm rruga deduktive. Këto dy rrugë mund të përdoren fare mirë në të njëjtën orë. ”

Në programin për gjuhën shqipe për shkollën 8 – vjeçare të vitit 1984, vërejmë sërish theksin që vihej tek edukimi i nxënësve me dashuri dhe krenari për gjuhën, por nuk mungojnë edhe ndikimet ideologjike të kohës: “Gjuha shqipe është një lëndë me vlera të mëdha edukative. Nëpërmjet saj nxënësit edukohen me dashurinë dhe krenarinë për gjuhën tonë të bukur dhe të lashtë...” Por ndërsa vazhdon më tej me objektivat e mësimit të gjuhës, ata nuk mbeten më në përvetësimin e thjeshtë të gramatikës së shqipes, por gjuha shikohet tanimë si një urë lidhëse mes njerëzve dhe si një mjet për t’u zhvilluar e përparuar: “Në përshtatje me fuqitë përvetësuese të moshës, nxënësit pajisen me njohuri të thjeshta për gjuhën si mjet marrëveshjeje ndërmjet njerëzve dhe si mjet zhvillimi e përparimi; njihen me rrugën e formimit dhe të zhvillimit të pandërprerë të gjuhës letrare shqipe gjatë periudhave të ndryshme historike, edukohen me qëndrimin aktiv ndaj dukurive gjuhësore, përgatiten për të përdorur një gjuhë sa më të pasur si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. ”

Shohim se mësimdhënësit janë të angazhuar në zhvillimin e aftësive të të lexuarit, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, pasurimi i fjalorit me fjalë dhe shprehje të reja dhe ky program synon largimin nga të mësuarit teorik dhe orientimit drejt praktikës së njohurive të përvetësuara: “Programi i shkollës 8 – vjeçare përmban njohuri të mjaftueshme teorike për strukturën e gjuhës shqipe, por përvetësimi i tyre nuk duhet të kthehet në asnjë mënyrë në qëllim në vetvete, përkundrazi, përparësi t’i jepet përvetësimit praktik, aftësimit të nxënësve për t’i

përdorur drejt ato në të folur e në të shkruar, natyrisht duke u mbështetur në një bazë të shëndoshë e të mjaftueshme teorike në përshtatje me moshën e nxënësve. [...] Njohuritë gramatikore ... të mos riprodhohen në mënyrë mekanike, por të përvetësohen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të mbahen parasysh në realizimin e ushtrimeve, të cilat të shërbejnë për përforcimin, verifikimin dhe sistemimin e njohurive të reja. ”

Lënda e gjuhës shqipe në klasat e dytë, të tretë dhe të katërt zhvillohet në rubrikat: gramatikë, drejtshkrim, zhvillim i gjuhës së folur dhe të shkruar. Ndarja e orëve sipas këtyre rubrikave bëhet si më poshtë:

Tabela 1.1 Pasqyrimi i orëve të gjuhës shqipe për klasat II, III dhe IV

Klasa	Orë/ Gramatikë	Orë/ Drejtshkrim	Orë/ Gjuhë e shkruar dhe e folur	Orë total/ Javë	Orë total/ Vit
II	1	2	2	5	170
III	1	2	2	5	170
IV	2	2	2	6	204

Në këtë program vërejmë gjithashtu shtysën që u jepet mësuesëve për ta ndërthurur lëndën e gjuhës shqipe me atë të leximit letrar, duke ruajtur individualitetin e secilës por duke bërë që të shkëputen nga tradicionalizmi. “Dihet se letërsia si mjet shprehjeje, si lëndë të parë ka gjuhën, theksohet aty, prandaj këto dy lëndë të konceptohen në unitetin e tyre të natyrshëm. ”

“Kështu, në lëndën e gjuhës, në përshtatje me temën e mësimit dhe me klasën, fjalë me vlera të caktuara shprehëse, mjete a ndërtime të caktuara gjuhësore, të mos shihen vetëm duke u kufizuar në analizën e tyre morfologjike a sintaksore, të mos trajtohen si diçka e shkëputur, por të vlerësohen si mjete shprehëse të ligjërimit. Në këtë mënyrë, mësuesi mund t’u bëjë një koment të shkurtër vlerave gjuhësore, shprehëse, duke sjellë, ku është e mundur edhe shembuj të thjeshtë nga veprat e shkrimtarëve tanë, nga stilet e ndryshme të gjuhës për të parë konkretisht se ç’rol luajnë mjetet gjuhësore kur përdoren me mjeshtëri...

Gjithashtu edhe teksti i leximit mund të shfrytëzohet më shumë në lëndën e gjuhës, në raste të tilla kur nxënësve u kërkohet, p.sh. të gjejnë mjete të caktuara gjuhësore (mbiemra në shkallën sipërore, gjymtyrë të veçuara etj.), për ilustrime të dukurive gjuhësore, ose fragmente të bukura të leximit mund të shërbejnë për

të hartuar tekste të thjeshta të lidhura me kërkesa të caktuara gjuhësore.”

Ajo që vumë rë në këtë përmbledhje rreth mësimit të shqipes përpara viteve ’90, është një përpjekje për përmirësim e perfeksionim të mënyrave të të mësuarit të gjuhës shqipe, duke filluar me qëllimin për ta bërë nxënësin ta dojë e ta vlerësojë gjuhën e tij amtare, duke nxitur përvetësimin sa më të mirë të gramatikës me qëllim përftimin e shprehive të të folurit e të shkruarit, për të arritur në fundin e viteve ’80 ku shohim një përmirësim të ndjeshëm të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së pritshmërive prej mësuesëve dhe zhvendosjen e synimit të mësimit të gjuhës drejt aftësive komunikative.

Bibliografi

- Konomi, Ath, Kiço, (1921) Grammatikë e gjuhës shqipe për Shkollat fillore edhe më shumë për rendin të IIIin edhe të IVin, Korçë.
- Lafe, V. (1986) Për përsosjen e mësimdhënies së gjuhës shqipe – Në shkollën 8 – vjeçare, ISP.
- Nathanaili, V. (2016) Shkolla shqipe një rrugë e mundimshme marrë nga www. mapo.al
- Papahristo, S. (1938) Ushtrimet gjuhore dhe hartimet në shkollat fillore dhe të mesme, Tiranë.
- Programi i shkollës shtatë vjeçare, Gjuhë shqipe – Lexim letrar, 1957.
- Programi i shkollës tetëvjeçare, Gjuhë shqipe – lexim letrar, Klasat V-VIII 1965, ISBSH, Tiranë.
- Programi i gjuhës shqipe, i leximit dhe i leximit letrar, për shkollën 8 – vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1984.
- Programi i gjuhës shqipe, 1921 në Mësimdhënia e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor, nga Besnik Rama, Tiranë, 2013.
- Programi i gjuhës shqipe, 1946 në Mësimdhënia e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor, nga Besnik Rama, Tiranë, 2013.
- Xhuvani, A. (1937) Didaktika.
- Xhuvani, A. (1942) Libri i gjuhës shqipe për klasën e tretë fillore, Shtëpia Botuese “Kristo Luarasi”.

Prof. dr.Bahtijar KRYEZIU, Lumnije LATIFAJ

SHKALLË E ULËT E NJOHJES SË GJUHËS SHQIPE NGA MËSUESIT TANË

Qëllimi ynë në këtë punim është që të vëmë në spikamë shkallën e njohjes së gjuhës amtare të 16 pedagogëve, të testuar në provimin përfundimtar në këtë lëndë, nga 32 kandidatë (pedagogë – mësues klase), sa ka pasur grupi IV, mbase 16 të tjerë, qoftë nga fakti se nuk kanë qenë të përgatitur mirë, qoftë nga motivi për të fituar notë më të lartë në këtë lëndë, nuk kanë hyrë në provim fare. Testi ka pasur 20 pyetje/detyra, i mbështetur kryesisht në tekstet që i kanë në përdorim këta mësues me nxënësit e tyre.

Për perfeksionimin - (ri)kualifikimin e mësimdhënëseve për mësues klase (klasa I – V) dhe edukatore të institucioneve parashkollore, që më parë kishin mbaruar shkollat e larta pedagogjike, dy- dhe trevjeçare, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Universiteti i Prishtinës dhe Fakulteti i Edukimit i UP-së (i ndihmuar dikur edhe nga KEDP-ja[7*)], për plot 10 vjet (që nga viti akademik 2007 – 2017), edukatoreve dhe mësimdhënësve të tillë, ua mundësuan që të ngritin shkallën e studimeve në 4 vjet. Një projekt i tillë i realizuar, me gjithë sfidat eventuale që e përcollën gjatë kësaj periudhe kohore, mbetet një projekt i qëlluar dhe me shumë rëndësi për kohën në të cilën jetojmë. Nevoja e të nxënit gjatë tërë jetës, me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, mundësia e lëvizjes, e me këtë nënkuptohet edhe mundësia e punësimit të kuadrove tona edhe në shtetet fqinje, të cilat që më herët shkollat e larta dyvjeçare i kanë shndërruar në studime katërvjeçare, vetëm sa e justifikojnë edhe më këtë projekt, me të cilin, aproksimativisht, mbi 7.000 mësimdhënës të Kosovës u (ri)kualifikuan ose janë në fazën përfundimtare të mbarimit të studimeve 4-vjeçare këtë vit (2017) dhe

[7 *] KEDP-ja është organizatë joqeveritare kanadeze (CID-a), e cila për 5 vjet të plota, që nga themelimi i FE-së, 1.11.2002 e deri në vitin 2007, e ndihmoi profesionalisht këtë institucion të lartë arsimor. Ndihmë të veçantë KEDP-ja ofroi edhe në trajnimin e mësimdhënësve për të mbajtur ligjërata në PAPSh (AKM), duke certifikuar dhe përzgjedhur kuadrin përkatës, e jo siç u veprua më vonë, që me mësimdhënësit e ShLP-ve, me një përvojë të lakmueshme pedagogjike, të punojnë edhe ligjërues pa asnjë ditë përvojë pune në arsim ose edhe ata të cilët karrierën e tyre profesionale e kanë ushtruar ose e ushtrojnë në institute shkencore, ku fare nuk zhvillohet procesi edukativo - arsimor. Kishim raste edhe kur një mësuese, e angazhuar me direktivë, e cila paradite punonte tok me shoqet e veta ne shkolle, pasdreke ju mbante ligjërata atyre?!

kanë marrë ose do të marrin gradën bachelor i edukimit ata të cilët së shpejti duhet të diplomohen. Me këtë rast, kemi bindjen se përveç rritjes së cilësisë në punë, kuadrot me shkallë të këtillë të kualifikimit kanë siguruar ose do t'i sigurojnë edhe më lehtë vendet e tyre të punës, kur dihet se në Kosovë ka kandidatë me SHLP që presin edhe mbi 25 vjet për t'u punësuar.

Mirëpo, nuk ishte ky i vetmi projekt që kishin para vete këto subjekte arsimore të theksuara më sipër. Arsimi parauniversitar dhe ai universitar përbëjnë më vete një konglomerat çështjesh që kërkojnë zgjidhje, e të cilave MASHT-i, në koordinim me institucionet e arsimit të lartë në Kosovë: me Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës dhe Fakultetin e Edukimit, po përpiqen për t'ju ndihmuar kuadrove tona për mësimdhënie, për të ecur përpara në të gjitha drejtimet ku ndihet nevoja. Në kuadër të kësaj veprimtarie e synimi, në këtë vit akademik, që nga fillimi i semestrit veror të vitit 2017, në Fakultetin e Edukimit, mbi 800 mësimdhënës (pedagogë), që më parë kishin mbaruar degën e Pedagogjisë në Fakultetin e Filozofisë, e të cilat kuadro aktualisht janë duke udhëhequr grup-mosha fëmijësh në institucionet parashkollore te ne ose udhëheqin klasë mësimi, që nga klasa I – V, po vazhdojnë ose do të vazhdojnë (ri)kualifikimin e tyre në thellimin e njohurive e të dijes në disa lëndë (plotësuese) të cilat nuk i kanë pasur në programet e degës së Pedagogjisë, si p.sh.: Gjuha shqipe, Matematikë, Informatikë, po do të kishte qenë mirë të ishin përfshirë në këtë projekt edhe Edukatë muzikore dhe ajo e Artit figurativ (para se të parashiheshin disa lëndë thjesht pedagogjike).

Një ndër lëndët që zë vend në këtë projekt (për aftësimin e kuadrove për mësues klase dhe për edukatore të institucioneve parashkollore), është edhe gjuha amtare (edhe pse me vetëm 3 orë mësimi në javë gjatë një semestri e dihet se, p.sh. në programin Fillor, te studentët e rregullt të FE-së, janë të parapara afro 20 orë, përfshirë këtu edhe metodologjinë e gjuhës).

Shkalla e njohjes teorike dhe e zbatimit të kësaj lënde në praktikë, madje jo vetëm te nxënësit e shkollave tona e mësimdhënësit tanë, është bërë çështje e diskutueshme, jo vetëm në gazeta e revista, në emisionet, jo edhe aq të shpeshta të radios e të televizionit, por edhe në tryeza, sesione e konferenca të shumta shkencore të organizuara nga filologë por edhe studiues profilesh të tjera. I tërë ky zotim, shqyrtim dhe studim i çështjeve gjuhësore është rezultat i shqetësimeve dhe i preokupimeve të të gjithë atyre që gjuhën amtare e konsiderojnë si mjetin më të përshtatshëm për komunikim, si lëndë mësimi dhe lëndë mësimore, po dhe si një çështje të shenjtë e pse jo edhe shenjë kombëtare, e cila, për fat të keq sot nuk e ka statusin që duhet ta ketë. E kur një shkallë mjaft e ulët e zotërimit të gjuhës vërehet edhe te nivelet (pak a shumë) më të larta të shkollimit tonë, te

mësimdhënësit që për çdo ditë marrin ditarin në dorë dhe dalin para nxënësve - fëmijëve tanë, për t'ua mësuar gjuhën amtare, problemi vetëm sa bëhet edhe më shqetësues. Se është kështu, mund të shërbejnë edhe testet për vlerësimin e njohurive të mësimdhënësve të programit të PAP-së në këtë lëndë (Programi për Avancimin e Pedagogëve). Për ta ilustruar këtë konstatim tonin, kësaj radhe kemi marrë në shqyrtim 16 teste të mësimdhënësve – të studentëve të PAP-it, nga 32 kandidatë që ka grupi IV, ngase 16 të tjerë, qoftë nga fakti se nuk kanë qenë të përgatitur mirë, qoftë nga motivi për të fituar notë më të lartë në këtë lëndë, nuk kanë hyrë në provim fare.

Pa kaluar në shqyrtimin dhe vlerësimin e një numri pyetjesh e detyrash të testit të fundit, në pjesën I të gramatikës – kryesisht në morfologji (afati i qershorit 2017), po theksojmë se pyetjet e paraqitura në test janë pyetje të mbështetura kryesisht në planprogramin mësimor të gjuhës amtare të paraparë që nga klasa I - V të shkollës fillore, ku ata janë vetë përgjegjësit dhe bartësit kryesorë për realizimin e kësaj lënde. Detyrat e dhëna janë pyetje të cilave mund t'u përgjigjen edhe njerëz me përgatitje jo të lartë shkollore, gjë që këta mësimdhënës i vë para një përgjegjësie edhe më të madhe. Po themi kështu ngase kuadrot e tilla paraprakisht kanë mbaruar shkollën tetëvjeçare ku gjuha shqipe është e përfaqësuar me një fond relativisht të madh orësh, kanë mbaruar shkollat e mesme të profileve të ndryshme, me lëndën e gjuhës shqipe si lëndë mësimore, mbajnë mësim në klasat e ciklit të ulët të shkollës fillore, kush më gjatë e kush për një kohë më të shkurtër, ku gjuha amtare ka qenë dhe është e përfaqësuar me një fond të lakmueshëm orësh. Pos kësaj, ata janë në kontakt të përditshëm edhe me masmediat elektronike ose ato të shkruara (pavarësisht nga shkalla e tyre jo edhe aq e mirë e zbatimit të standardit të gjuhës), kanë biblioteka në çdo qytet, po edhe në shumë fshatra ku ata jetojnë e punojnë (edhe pse me fonde jo të pasura librash, si për nga zgjedhja dhe sasia, ashtu edhe për nga cilësia), kanë bibliotekat e tyre edhe në shtëpi etj., të cilat mund të jenë burim dhe ndihmesë e mirë leximi për ngritjen e shkallës të kulturës së tyre gjuhësore.

Për ta ilustruar këtë shkallë të njohurive për gjuhën nga kjo kategori mësimdhënësish, si dhe shqetësimin tonë për nivelin e ulët të njohjes së gjuhës nga këta mësimdhënës, po sjellim disa nga pyetjet dhe detyrat e paraqitura në testin e mbajtur më 8 korrik 2017 në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë – me studentët e PAP-it[8*].

Testi ka pasur 20 pyetje/detyra, ku çdo mësimdhënës i cili do të kishte dhënë përgjigje të sakta në të gjitha pyetjet/detyrat e dhëna, ka mund të fitojë 100 pikë. Testi, sa i përket llojit, ka qenë i kombinuar. Përgjigjet është kërkuar

[8*] Për shkak të natyrës së kumtesës në këtë Konferencë, nuk janë dhënë të gjitha pyetjet/detyrat e shtruara në test.

të jepen kryesisht me fjalë e jo duke rrumbullakuar shkronjat para pyetjeve, me qëllim që t'i iket rastësisë. Kohëzgjatja e plotësimit të testit ka qenë 60 minuta. Pyetjet/detyrat kanë qenë kryesisht nga njësitë dhe temat e parapara me programin mësimor që është i paraparë të realizohet në shkollën fillore (klasa I – V), si: nënvizimi i emrave në fjalinë: *Institucionet e fëmijëve parashkollorë të ndërtuara në Kosovë pas luftës së fundit nuk janë të pakta, me ç'rast çdo emër i nënvizuar drejt në këtë detyr*ë është vlerësuar me 1 pikë (raporti: 18,75 përgjigje pozitive, ndaj 81,25% përgjigje negative); përcaktimi i i llojit të lidhëzës *tek n*ë fjalinë: "*Tek ngjitej në shkëmb, iu vra gjuri" (raporti i* përgjigje pozitive ndaj atyre negative ishte 12,50% : 87,50%); qarkimi (në detyrën vijuese) se cila prej fjalëve të dhëna nuk është mbiemër? a) përrallore; b) ligjore; c) fqinjësore; ç) shkritore, kemi pasur këtë raport: 31,25% përgjigje pozitive, ndaj 68,75% negative; përcaktimi i fjalës nxënës se ç'gjymtyrë fjalie është si te shembulli: **"***Ju, nxënës, duhet të jeni shembull për të tjerët", - është?:* **a) kryefjalë; b) kundrinë; c) ndajshtim;** ç) rrethanor, ku nga 16 studentë, të cilët kanë marrë pjesë në provim, vetëm 3 ose 18,75% e kanë rrumbullakuar shkronjën **c, si përgjigje të saktë, kurse si kryefjalë e kanë menduar 6 studentë ose 37,50%, 4 ose 25% - si kundrinë; 1 ose 6,25% - si rrethanor dhe 2 studentë ose 12,50% nuk kanë dhënë përgjigje fare, q**ë del se proporcioni i përgjigjeve pozitive ndaj atyre negative është 18,75% : 81,85% e shembuj të tjerë të ngjashëm si këta.

Nga këta shembuj të paraqitur nuk ka përse të dallojë edhe detyra e parë, ku nga kandidatët është kërkuar të bëjnë korrigjimin e shkronjave të këtyre pak fjalive, madje jo edhe të shenjave të pikësimit. Sa për ilustrim ja shembulli – detyra e parë:

1. Korrigjoni 10 gabime drejtshkrimore të lëshuara qëllimisht në fjalitë: *Marrzia ideoloxhike vajti deri atje, sa Fishta u hoç edhe nga një foto e Pikasos, në të cilën ai shihej bashk me dy deputetët e Asambles Kombëtare të Shqiprisë me 1923, Ndre Mjedën dhe Luixh Gurakuçin. Një shembull që, fatkeqësishtë, sishte i vetmi...*

Kemi shtruar këtë detyrë për të parë nivelin e kulturës së tyre gjuhësore. Çdo korrigjim është vlerësuar me +1 pikë, - 1 pikë (për ata që shtojnë gabime, vetëm në këtë detyrë). Kemi vepruar edhe me zbritje pikësh në mënyrë që të mos ndodhë rastësi korrigjimesh, sepse po të "korrigjonte" kandidati, bie fjala, 100 gabime, 10 gabime që duheshin korrigjuar, do të ishin korrigjuar edhe rastësisht.

Nga 16 mësimdhënës të testuar, 2 mësimdhënës ose 12,50% nuk kanë korrigjuar asnjë gabim; 1 ose 6,25% ka korrigjuar 2 gabime; 3 ose 18,75% kanë korrigjuar nga 3 gabime; 1 ose 6,25 % ka korrigjuar 4 gabime; 3 ose 18,75% kanë korrigjuar nga 5 gabime; 2 ose 12,50% kanë korrigjuar nga 6 gabime; 2 të tjerë

ose 12,50% kanë korrigjuar po ashtu nga 7 gabime; 1 ose 6,25% ka korrigjuar 9 gabime dhe 1 – 6,25% ka korrigjuar të gjitha gabimet – 10 gabimet e lëshuara me qëllim në fjalitë e mësipërme.

Nga kjo rezulton se 10 mësimdhënës ose 62,50 kanë korrigjuar 5 e më pak gabime dhe 6 mësimdhënës ose 37,50 kanë korrigjuar mbi 5 gabime që kanë pasur fjalitë. Raporti: 37,50% : 62,50%.

Për të parë shkallën e njohjes së analizës gramatikore: morfologjike – sintaksore, po e paraqesim edhe detyrën e fundit. Në detyrën e njëzet, të fundit në këtë test, mësimdhënësit kanë pasur për detyrë të tregojnë vetëm ç'pjesë ligjërate dhe ç'gjymtyrë fjalie janë fjalët në fjalinë: *Ai u zgjua herët, u vesh ngadalë, hodhi shallin krahëve dhe doli jashtë:*

Në sintaksë II.	Në morfologji I.	Në sintaksë II.	Në morfologji
Ai _____	_____		
u zgjua _____	_____	shallin _____	_____
herët _____	_____	krahëve _____	_____
u vesh _____	_____	dhe _____	_____
ngadalë _____	_____	doli_____	_____
hodhi _____	_____	jashtë _____	_____

Në sintaksë, për fjalën ai, përgjigje të sakta kanë dhënë 9 mësimdhënës ose 56,25; 5 ose 31,25% nuk kanë dhënë përgjigje të saktë dhe 2 ose 12,50% nuk janë përgjigjur fare (raporti 56,25 : 43,75%). Ndërkaq në morfologji, përemrin vetor ai, e kanë ditur 10 mësimdhënës ose 62,50%; 4 ose 25% kanë dhënë përgjigje të gabuar dhe 2 ose 12,50% nuk janë përgjigjur fare (raporti: 62,50%:37,50%)

Për fjalën e dytë – u zgjua, në sintaksë, përgjigje të saktë kanë dhënë 8 mësimdhënës ose 50%; 6 ose 37,50% nuk kanë dhënë përgjigje të saktë dhe 2 ose 12,50% nuk janë përgjigjur fare (raporti: 50% : 50%). Ndërkaq në morfologji, për këtë fjalë, kemi ndeshur këto rezultate: 9 ose 56,25% e kanë ditur se fjala u zgjua është folje; 4 ose 25% nuk e kanë ditur dhe 3 ose 18,75 nuk janë përgjigjur (raporti: 56,25% : 43,75)

Se fjala herët në sintaksë është rrethanor kohe e kanë ditur 8 mësimdhënës ose 50%; nuk kanë ditur 5 ose 31,25% dhe 3 ose 18,75% nuk kanë dhënë përgjigje fare (raporti 50% : 50%). Ndërkaq në morfologji kemi këto të dhëna: 5 ose 31,25 kanë treguar se kjo fjalë është ndajfolje kohe; 6 ose 37,50 nuk e kanë ditur dhe 5

ose 31,25% nuk kanë dhënë përgjigje (raporti: 31,25% : 68,75%).

Fjalën u vesh 6 mësimdhënës ose 37,50 e kanë ditur se është kallëzues; 6 ose 37,50% nuk e kanë ditur dhe 4 ose 25% nuk janë përgjigjur (raporti: 37,50% : 62,50%). Në morfologji gjendja del e këtillë: 8 ose 50% e kanë ditur se fjala u vesh është folje; 2 ose 12,50% nuk e kanë ditur dhe 6 ose 37,50% nuk janë përgjigjur (raporti: 50% : 50%).

5 mësimdhënës ose 31,25% nga 16 mësimdhënës e kanë ditur se fjala ngadalë, në sintaksë, është rrethanor mënyre; 7 ose 43,75% nuk kanë dhënë përgjigje të saktë dhe 4 ose 25% nuk janë deklaruar fare (raporti: 31,25% : 68,75%). Në morfologji: 4 ose 25% kanë shkruar se kjo fjalë është ndajfolje mënyre; 8 ose 50% nuk e kanë ditur ç'pjesë ligjërate është dhe 2 ose 12,50% nuk janë përgjigjur fare (raporti 25% : 75%).

Përgjigje të saktë, në sintaksë, për fjalën hodhi kanë dhënë: 5 mësimdhënës ose 31,25%; 4 ose 25% nuk janë përgjigjur drejt dhe 6 ose 37,50% nuk janë përgjigjur (raporti 31,25% : 68,75%). Se ç'pjesë ligjërate (në morfologji) është fjala e këtillë, përgjigje pozitive kanë dhënë 7 mësimdhënës ose 43,75%; 6 ose 37,50% nuk kanë dhënë përgjigje të saktë dhe 3 ose 18,75% nuk janë përcaktuar fare për asnjë pjesë ligjërate (raporti 43,75% : 56,25%).

Si kundrinë e drejtë për fjalën shallin (në sintaksë), janë shprehur 4 mësimdhënës ose 25%; 8 ose 50 nuk kanë dhënë përgjigje të saktë dhe 4 ose 25% nuk kanë dhënë përgjigje fare (raporti: 25% : 75%). Kurse fjalën shallin si emër e kanë ditur 9 mësimdhënës ose 56,25%; nuk e kanë ditur 3 ose 18,75% dhe 4 ose 25% nuk kanë dhënë përgjigje fare (raporti 56,25% : 43,75%.

Fjalën krahëve si rrethanor vendi e kanë ditur vetëm 2 mësimdhënës ose 12,50%; 6 ose 37,50 nuk e kanë ditur se ç'gjymtyrë fjalie është dhe 8 ose 50% nuk kanë dhënë përgjigje fare (raporti: 12,50 : 87,50). Në morfologji dalin këto rezultatet: përgjigje të saktë kanë dhënë 6 ose 37,50%; përgjigje jo gabuar kanë dhënë 4 ose 25% dhe 6 ose 37,50% nuk janë shprehur se ç'pjesë ligjërate është fjala krahëve (raporti 37,50% : 62,50%).

Lidhëzën dhe (si fjalë shërbyese në rastin tonë) e kanë paraqitur 6 mësimdhënës ose 37,50%; po aq mësimdhënës nuk e kanë ditur dhe 4 ose 25% nuk kanë dhënë përgjigje fare (raporti: 37,50% : 62,50%).

Për fjalën doli (si kallëzues foljor - në sintaksë) përgjigje të saktë kanë dhënë 4 mësimdhënës ose 25%; 6 ose 37,50% kanë dhënë përgjigje jo të saktë dhe 6 ose 37,50% nuk janë përgjigjur (raporti: 25% : 75%). Ndërkaq, për si pjesë ligjërate për këtë fjalë janë shprehur drejt 8 mësimdhënës ose 50%; 2 ose 12,50 kanë dhënë përgjigje negative dhe 6 ose 37,50 nuk janë përgjigjur fare (raporti 50% : 50 50%).

Fjala e fundit jashtë, në fjalinë e dhënë, që në sintaksë kishte funksionin e rrethanorit të vendit, drejt është analizuar nga 4 mësimdhënës ose 25%; jo drejt nga 7 ose 43,75% dhe 5 ose 31,25% nuk janë përgjigjur (raporti 25% : 75%). Si ndajfolje vendi (në morfologji) këtë fjalë e kanë analizuar drejt 2 mësimdhënës ose 12,50%; 8 ose 50% ganë dhënë përgjigje të gabuar dhe 6 ose 37,50 nuk janë përgjigjur fare (raporti 12,50% : 87,50%).

Gjatë analizës së kësaj fjalie del se kandidatët kanë pasur këto përqindje: në analizë sintaksore: 31,25% përgjigje të sakta dhe 68.75% përgjigje të gabuara, ndërkaq në analizë morfologjike kanë treguar sukses më të mirë: 42,06% kanë pasur përgjigje të sakta dhe 57,94% kanë dhënë përgjigje negative ose nuk janë përgjigjur fare. Në total, në përpjesëtueshmëri, te pyetja e 20-të del ky raport: 36,65% përgjigje të sakta dhe 63,35% përgjigje të gabuara.

Po të bëhet një *përmbyllje - sintezë e gjithë asaj që u tha më sipër, del se njohuritë gjuhësore, qofshin ato teorike ose praktike, në morfologji, në sintaksë apo në drejtshkrim, ato janë në një shkallë jo të lakmueshme, që nuk garantojnë sukses të mirë të këtyre kuadrove në punë me nxënësit e nivelit të ulët të shkollës fillore. Kjo (te rasti konkret) mund të ilustrohet përmes një matematike të thjeshtë, ku përqindja e përgjigjeve të sakta në këto 20 pyetje/detyra mesatarisht është vet*ëm 30,58%, kurse e përgjigjeve negative dhe e mosdhënies së përgjigjeve 69,42%. Andaj, me këtë gjendje dhe nivel të njohurive gjuhësore nuk duhet të jenë të kënaqur, jo vetëm mësimdhënësit që udhëheqin klasat e tyre, ku gjuha shqipe është një ndër lëndët kryesore, por as vetë nxënësit e këtij niveli të shkollimit.

Ne kujtojmë se edhe në një gjendje të këtillë, çfarë na paraqitet në këtë analizë, rrugëdalja duhet të gjendet. Në më të paktën dorë konsiderojmë se do të duhej një angazhim dhe përgjegjësi më e madhe e mësimdhënësve të tillë; një punë më me përkushtim dhe mbikëqyrje më e madhe e drejtorive të shkollave përkatëse dhe e këshilltarëve – inspektorëve komunalë të arsimit; organizimi më i shpeshtë i trajnimeve të mësimdhënësve në këtë lëndë; rritja e fondit javor të orëve në shkollat fillore e të mesme të Kosovës, ashtu siç është në shumë vende të perëndimit (12-14 orë në javë, si në Angli, SHBA, Kanada e gjetiu); të stabilizohen planprogramet e gjuhës shqipe e jo të veprohet si deri tashti në stilin: Programet e reja u kryen! Të fillojmë me(njëherë) përgatitjen e programeve të reja (!); të botohen tekste cilësore – origjinale të gjuhës dhe të leximit letrar për shkolla fillore dhe të mesme, i gramatikave diferenciale (gramatikat e gabimeve); ekipe ekspertësh të enteve dhe të institucioneve të larta arsimore: gjuhëtarë, metodistë, pedagogë, psikologë, sociologë dhe të tjerë, të ulen edhe njëherë në bankat e shkollave që të vrojtojnë shkallën e kulturës së gjuhës të nxënësve tanë dhe të japin ndihmesën e tyre në këtë fushë – përmes vërejtjeve,

këshillave e studimeve profesionale – shkencore e praktike; të gjithë ose gati të gjithë fëmijëve t'u mundësohet edukimi parashkollor, në mënyrë që të mos ngecin pas moshatarëve të tyre që kanë qenë në institucionet parashkollore; në nivel të Republikës së Kosovës të ngritët një organ a komision i specializuar për t`u kujdesur dhe për të përcjellë zhvillimin "e përgjithshëm të kulturës gjuhësore dhe mbarëvajtjen e kulturës kombëtare, me të drejta të plota urdhëruese (sipas modelit francez)"- siç është vepruar në shumë vende evropiane.

Përmendëm këto masa, ngase, të jepet përgjigje e saktë nga mësimdhënësit, me mbi 50% vetëm në një pyetje (pyetja/detyra 10) nga të gjitha ato pyetje e detyra të shtruara, nuk është në rregull. Pra, kështu çfarë është gjendja tani, nuk bën. Për këtë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe përgjegjësinë ta marrin, para se gjithash, bartësit e procesit edukativo-arsimor në ShMU e ato të ShML, pra mësuesit tanë, gjë që para 1 viti kjo u pa edhe në vlerësimin e PISA-s.

Anita NEZIRI

PASMODERNIZMI SI HUMORI I ZI

Pasmodernizmi, qoftë si term, qoftë si bashkësi idesh, paraqitet tepër i ndërlikuar. Përkufizimi i tij është i vështirë, sepse haset në shumë disiplina dhe fusha studimore, duke përfshirë artet, arkitekturën, muzikën, kinemanë, letërsinë, sociologjinë, komunikimin, modën dhe teknologjinë. Edhe përcaktimi i vendit që zënë kohë është i vështirë, sepse fillesat e modernizmit nuk dihen me saktësi.

Pasmodernizmi u përmbahet shumë prej parimeve të modernizmit, duke mos pranuar kufijtë ndërmjet formave të larta dhe të ulëta të artit, duke mos pranuar dallimet e ngurosura të gjinive, duke i mëshuar potpurisë, parodisë, befasisë së tërthortë, ironisë dhe shpotisë. Arti dhe mendimi pasmodern mbështesin vetëpasqyrimin, fragmentimin dhe ndërprerjen, sidomos në strukturat rrëfimtare, dykuptimësinë, njëkohësinë dhe daljen në pah të subjektit të dekonstrukturuar, të shqendërzuar dhe të çnjerëzuar.

Por, nëse pasmodernizmi, nga pikëpamja e këtyre parimeve, ngjan shumë me modernizmin, ai dallohet nga ai prej qëndrimit që mban ndaj këtyre prirjeve. Modernizmi priret kah paraqitja e një pamjeje të fragmentuar të subjektivitetit dhe të historisë njerëzore, për shembull si te "Toka e shkretë" e Tomas Stërns Eliotit dhe "Për te fari" e Virxhinia Ulfit, vetëm se ky fragmentim paraqitet si diçka tragjike, si diçka për të cilën duhet vajtuar dhe mbajtur zi, njëlloj sikur të ishte humbje. Shumë vepra moderniste përpiqen të mbështesin idenë se veprat letrare apo artistike mund të japin unitetin, koherencën dhe kuptimin që ka humbur në pjesën më të madhe të jetës moderne, se arti do të bëjë atë që nuk arrijnë ta bëjnë institucionet e tjera njerëzore. Mirëpo, pasmodernizmi nuk i vajton dukuritë e fragmentimit, të përkohshmërisë ose të jokoherencës.Përkundrazi, ai i ngre lart ato. Bota është pa kuptim? Atëherë, të mos mëtojmë se arti dhe letërsia mund të kenë kuptim, prandaj le të luajmë me marrëzinë.Vështrimi i marrëdhënies midis modernizmit dhe pasmodernizmit në mënyrë tjetër ndihmon për të qartësuar disa nga këto dallime. Sipas Frederik Xhejmsonit[1], modernizmi dhe pasmodernizmi janë formacione kulturore, të cilat shoqërojnë faza të veçanta të kapitalizmit. Ai skicon tri faza kryesore të kapitalizmit, të cilat diktojnë praktika të caktuara kulturore, duke përfshirë llojin e artit dhe të letërsisë që prodhohet.

1

Faza e parë është ajo e kapitalizmit të tregut që u zhvillua nga shekulli XVII deri në fundin e shekullit XIX në Evropën Perëndimore, në Angli dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo fazë u shoqërua me zhvillime teknologjike të caktuara, si për shembull, me motorin me avull dhe me një lëvizje të caktuar estetike, siç qe realizmi.

Faza e dytë u zhvillua nga fundi i shekullit XIX deri në mesin e shekullit XX, aty rreth Luftës së Dytë Botërore. Kjo fazë, pra, kapitalizmi monopolist, u shoqërua me motorët elektrikë, me motorët me djegie të brendshme dhe me modernizmin.

Faza e tretë në të cilën ndodhemi tani, domethënë, kapitalizmi i shumëkombësheve ose kapitalizmi i konsumit, ku theksi vihet te marketingu dhe shitja e mallrave të konsumit, por jo te prodhimi i tyre, shoqërohet me teknologjinë bërthamore, me teknologjinë elektronike, si dhe lidhet me pasmodernizmin[2].

Shumë pyetje mund të bëhen për pasmodernizmin, por një nga më të rëndësishmet është: Kjo lëvizje në drejtim të fragmentimit, përkohshmërisë performancës dhe paqëndrueshmërisë është diçka e mirë apo e keqe? Në shoqërinë bashkëkohore, dëshira për t'u kthyer në erën parapasmoderne (mendimi iluminist/modern/humanist) priret kah lidhja me grupe konservatore politike, fetare, dhe filozofike. Në të vërtetë, një nga rrjedhojat e pasmodernizmit duket se është lindja e fundamentalizmit fetar si formë e qëndresës kundrejt vënies në pikëpyetje të "rrëfimeve të madhërishme" për të vërtetat fetare. Kjo ndoshta duket më se qartë në fundamentalizmin mysliman në Lindjen e Mesme, i cili i ndalon librat pasmodernë si, për shembull, "Vargjet satanike" (*The Satanic Verses*) të Selman Rushdisë, sepse ata i dekonstruktojnë këto rrëfime të madhërishme.

"Humori i zi" përfton një bazë teorike në monografitë e studiuesve amerikanë të letërsisë Robert Skoullz, MaksShulc, Brus Xhej Fridman, Petrik O.Nill etj.Si një drejtim letrar i viteve '60-'70 në SHBA, që lidhte idenë e "absurdes" me një formë të veçantë letrare humori i zi ballafaqon elemente të kobshme me elemente komike për të nxjerrë në pah pakuptimësinë apo kotësinë e jetës. Ai e quan vuajtjen njerëzore kryekëput absurde dhe assesi dukuri për të cilën duhet vajtuar. E ironizon ekzistencën e njeriut, madje edhe e vë në lojë deri diku. Përdor farsën dhe anekdotën gazmore për të shpjeguar se individi është viktimë e pambrojtur e fatit dhe e karakterit vetjak. Hedh poshtë vlerat dhe bindjet perëndimore si pjesë tepër e vogël e përvojës njerëzore. Ai parapëlqen shtjellimin imazhit të jashtëm, duke shmangur kështu domethëniet e nënkuptuara të lidhura me brendësinë e objekteve dhe të ngjarjeve.

---

[2] Frederic Jameson, *Postmodernism, Or, The Cultural Logic Of Late Capitalism, Duke University Press, Durham, North Carolina, 1991, p.111.*

Ai e sheh përvojën njerëzore të paqëndrueshme, të mbarsur me kundërshti të brendshme, të dykuptimshme, jobindëse, jopërfundimtare, të paqartë, të papërfunduar, të copëzuar, pa vijimësi dhe pa kurrfarë realiteti të veçantë të mundshëm. Ky këndvështrim endihmon shkrimtarin për të krijuar një vepër të hapur ku lexuesit i duhet të shfrytëzojë dhe të sjellë ndërmend përvojat e veta, të përpunojë kuptime alternative, si dhe të interpretojë në mënyrë të pavarur, domethënë, pa udhërrëfyes.

Në një vështrim historik, humori i zi duket se lidhet me mendësinë e një periudhe revolte,me ngadhënjimin mbi frikën dhe të metat që ka karakterizuar kulturën perëndimore veçanërisht në vitet 1960. Komeditë e Aristofanit, rrëfimet me përmbajtje alegorikemesjetare, rrëfimet me nota optimizmi të Rilindjes, poezitë metafizike dhe letërsia satirike e periudhës së iluminizmit janë parë prej studiuesve si pararendëse të humorit të zi.

Megjithatë, duhet përmendur fakti se fillesat e humorit të zi lidhen me romanin dhe se shumica e romanëve të humoristëve të zinj u ndikuan nga figura të shquara si Suifti apo Volteri. Shumë studiues theksojnë rëndësinë e origjinës për të pasqyruar humorin e zi në tërësinë e tij. Humoristët e zinj e kthejnë materialin satirik dhe protestën e tyre ndaj realitetit të shëmtuar në komedi.

Humori i zi është një rrymë që fillimisht është lidhur me një grup romancierësh të viteve ‘60 dhe ’70 siç u përmend më lart. Romanet e tyre ngërthejnë elemente komike, të shkrira me një ndjesi të thellë dëshpërimi dhe shkatërrimi. Romancierët tipikë të humorit të zi përfshijnë Xhozef Hellerin, Brus Xhej Fridmanin, Xhon Barthin, Tomas Pinçonin, Kurt Vonegutin etj.

Patrik O. Nilli e përkufizon humorin e zi si gjini letrare. Ai citon studime të rëndësishme mbi këtë temë me argumentin se humori i errët “na lejon të përfytyrojmë pafytyrësinë e zbrazëtisë”. Megjithatë, ne mund të qeshim e jo të zhytemi në dëshpërim. Humori i zi, i cili shihet si një përforcim i dinamikave në të gjitha llojet e humorit, vjen në disa forma emënyra. E qeshura jonë mbart nota hidhërimi e zbrazëtie, zymtësi, parodi e dhimbje, por në fund të fundit, ne qeshim dhe për sa kohë qeshim, ka ende shpresë[3].

Edhe pse “humori i zi” është një shprehje që sot bëhet pjesë e bisedave të përditshme po aq sa e kritikës letrare, nuk ka një marrëveshje të plotë se çfarë është saktësisht. Kjo sigurisht nuk është aspak e habitshme, pasi një marrëveshje e tillë nuk ekziston as për humorin në përgjithësi. Që në kohën e Platonit, por pa dyshim edhe më parë, ka pasur teori të ndryshme mbi humorin, të qeshurën dhe komiken nga poetë, filozofë, në fillim të shekullit XX edhe nga sociologë,

[3] Patrick O’Neill. The Comedy of Entropy: *The Contexts of Black Humour. Cana dian Review of Comparative Literature,*New York: Bloom’s Literary Criticism, 1983, pp.145–166.

psikologë, neurofiziologë etj.

Koncepti i humorit të zi ka ngjallur shumë interes veçanërisht në Amerikën e Veriut. Studiues të ndryshëm e përdorin këtë term për të përcaktuar një humor që është grotesk, makabër, i sëmurë, pornografik, i ndyrë, kozmik, ironik, satirik, absurd ose kombinime të këtyre që u përmendën. Ka nga ata që do ta kufizonin përdorimin e tij në kornizat e një termi letrar në një dekadë ose vend të caktuar; ka njerëz që do ta përdornin tipologjikisht si tipar të natyrës njerëzore; ka të tjerë që do të deklaronin se ky nuk është aspak një lloj humori; siç ka dhe disa që sugjerojnë se në thellësinë e vet çdo humor është i zi.

Fjalorët dhe enciklopeditë standarde ofrojnë shumë pak ndihmë: pjesa më e madhe e tyre as nuk e përmbajnë termin "humor i zi". "Enciklopedia e re e Kolumbias" (*New Colombia Encyclopedia,1975) e përkufizon atë si "humor grotesk ose i zymtë për të shprehur absurditetin, pandjeshmërinë, paradoksin dhe mizorinë e botës moderne*[4]" dhe u referohet si shembuj veprave të Stenli Kubrikut, Kurt Vonegutit, Tomas Pinçonit, Xhon Barthit, Xhozef Hellerit dhe Filip Rothit. Në Francë shprehja "humour noir"ka një histori më të gjatë, dhe tek "Fjalori i madh i gjuhës franceze"gjejmë se "humori i zi" është ajo formë e humorit, e cila, duke përdorur mizorinë, të hidhurën dhe ndonjëherë dëshpërimin, nënvizon absurditetin e botës që nuk është domosdoshmërisht as moderne, as amerikane. "Fjalori i ri i gjuhës standarde angleze dhe franceze" *(New Standard French and English Dictionary, 1972) i Shtëpisë botuese* "Harap", e shpjegon "humorin e zi" më shkurt, duke e dhënë në kuptimin e parë si "humor i sëmurë" dhe vetëm në kuptimin e dytë si "humor i hidhur, cinik".

Asnjë nga botimet standarde spanjolle, italiane apo gjermane nuk arritën ndonjë përcaktim më vendimtar, me përjashtim të botimit "Një punim i shkurtuar i letërsisë" (*Sachworterbuch der Literatur,1969) nga Gero von Yilpert. Ai e quan" humorin e zi" (schwarzer humor) një formë tërësisht tradicionale, një shaka pa humor (humorloser Scherz),e karakterizuar nga "tmerri absurd, tmerri komik, një e qeshur makabre, errësirë groteske dhe cinizëm kokëfortë, duke arritur efektin e tij komik (por jo humoristik) së pari nëpërmjet stërmadhimit."*[5]

Nga këto katër përkufizime, ai amerikan është më i përcaktuari në kohë dhe vend. Francezi dhe gjermani nga ana tjetër i referohen dukurisë si tipologjike, edhe pse përkufizimi gjerman ndryshon në mohimin e përmbajtjes humoristike. Në Amerikën e Veriut humori i zi si koncept letrar fillimisht tërhoqi vëmendjen e masës së gjerë si rrjedhojë e botimit më 1965 të një libërthi të titulluar thjesht: "*Humori i zi". Ky vëllim përmbante 13 pjesë të ndryshme letrare të autorëve si*

[4] *New Columbia Encyclopedia. Columbia, Columbia University Press, 1975,*p. 1052.

[5] Gero von Wilpert. *Sachworterbuch der Literatur, Kroner Press, 2001, p. 25.*

Xh. P. Donlivi (J. P. Donleavy), Eduard Ollbi (Edward Albee), Xhozef Helleri (Joseph Heller), Vladimir Nabokovi, Brus Xhej Fridmani, i cili ishte edhe redaktori i përmbledhjes.

Fridmani shkruan se ajo që e bashkon vëllimin është "ndjesia e pasigurisë", e një "vije të hollë mes fantazisë dhe realitetit", një ndjesi "izolimi dhe vetmie të çuditshme" dhe mbi të gjitha, ai karakterizohet nga satira "në një botë që është çmendur". Sipas këtij studimi, vitet '60 "u goditën nga një valë e re absurdizmi" dhe u karakterizuan nga "një stil i ri i qëndrimit ndryshe, me të cilin mund të përballesh vetëm nëpërmjet një stili të ri proze me një këmbë në çmendinë."[6]

Në një studim të vitit 1973, "Proza e humorit të zi në vitet '60", Maks Shulci ngul këmbë në idenë se humori i zi, si një term letrar, duhet të kufizohet vetëm me prozën e Amerikës së Veriut, në vitet '60. Shulci e drejton vëmendjen te shkrimtarët e këtyre viteve, të cilët për arsye të ndryshme janë etiketuar si humoristë të zinj. Ai nuk është i mendimit se këta shkrimtarë "kanë njëfarë vizioni të kufizuar, të aftë vetëm për lajthitje të veçanta të komedisë, dhe jo për vetë gjendjen universale të tragjedisë."[7]

Sipas Shulcit, humoristi i zi është një pasekzistencialist, për të cilin gjendja e absurdes universale s'ka pse të shfaqet më. Sipas tij, të gjitha versionet e realitetit janë thjesht struktura mendore, "s'ka asnjë parim që të jetë më i vërtetë se tjetri, as moralisht e as intelektualisht dhe asgjë s'ka një vlerë të brendshme."[8] Sidoqoftë, Fridmani lë të kuptohet se fakti që ekziston një lëvizje e humoristëve të zinj në letërsinë bashkëkohore vjen për shkak se ngjarjet në botë ishin aq absurde sa përgjigjja e humoristëve të zinj është më e përshtatshmja e mundshme. Ai gjithashtu nënkupton se ata s'i përkasin vetëm epokës moderne, por kanë edhe një traditë vazhdimësie."[9]Siç vërehet, studiuesit amerikanë e shohin humorin e zi si një dukuri kryesisht të etapës së parë të pasmodernizmit në letërsinë amerikane.

Të dy autorët amerikanë Shulci dhe Fridmani i referohen humorit të zi në thelb si pasekzistencialist, pasmodernist dhe thuajse një dukuri tipike amerikane. Një qasje shumë më të ndryshme kanë dy antologë evropianë, të ndarë nga tri dekada, një francez dhe një gjerman: Andre Bretoni me "Antologjia e humorit të zi" (*Anthologie de l'humour noir*) më 1939dhe Gerd Heningeri me "Libër lutjesh

---

[6] Bruce Jay Friedman, ed. *Black Humor,* New York: Bantam 1965, pp. 7-8.

[7] Max F. Schulz, *Black Humor Fiction of the Sixties, Athens: Ohio University Press, 1973, p. 11.*

[8] Ibid. p.11

[9] Max F. Schulz. *Black Humor Fiction of the Sixties* , Athens: Ohio University Press 1973,p.11

të humorit te zi" (*Brevier des schwarzen Humors*) më 1966.[10]

Në një parathënie te botimit të ri (gjithashtu më 1966) të antologjisë së tij prej 600faqesh, Bretoni deklaron të ketë qenë i pari që e vuri në përdorim termin "humor i zi". Ai hedh vështrimin mbi tërë letërsinë evropiane që nga 1700 dhe përfshin 45 autorë gjithsej, ndër të tjerë Suiftin, Markezin de Sade, Ponë, Bodlerin, Luis Kerollin, Niçen, Salvador Dalin etj. Kjo listë, shton ai, mund të ishte shumë më e gjatë. Rëndësia e dukurisë së humorit të zi, vazhdon Bretoni, është rritur që nga 1800. Duke njohur ndjeshmërinë moderne, është e dyshimtë nëse ndonjë vepër bashkëkohore në poezi ose art, shkencë, filozofi ose teori sociale, të jetë tërësisht e vlefshme pa iu referuar pakëz atij,[11] humorit që është thuajse në çdo rast shkatërrues, një "revoltë e epërme e shpirtit', siç e quan ai.

Ky lloj humori në disa situata do të sillte të qeshura të hidhura, ironike ose cinike, por në të tjera raste situatat janë të llojit më të skajshëm,duke sjellë më pak kënaqësi e më shumë frikë e neveri. Një shembull i mirë është "Propozimi modest" (*Modest Proposal*, 1729) i Suiftit, të cilin Bretoni e quan baba të humorit të zi. Propozimifillon si një ese mbi lehtësimin e stresit të të varfërve irlandezë katolikë, dhe pa asnjë ndryshim toni shndërrohet në sugjerimin e tmerrshëm racional për t'i shërbyer fëmijët të marinuar e të gatuar mirë, në tryezat e borgjezëve. Kanibalizmi i fëmijëve është mizor. Fuqia e pakrahasueshme e këtyre shtatë apo tetë faqeve, gjithsesi, nuk varet në thelb nga morali satirik, por nga paqëndrueshmëria e përzierjes së racionalitetit të satirës me nënvlerësimin e ironisë nga njëra anë dhe irracionalitetitme stërmadhimin e groteskes nga ana tjetër. Perversitetet seksuale ose stërmadhimet e çmendura janë pjesë të një energjie groteske me tone gati të papërshkrueshme.

Humori i zi, sipas Bretonit, shtrihet në shumë rrafshe. Ai e shikon atë si një përmbysje të realitetit[12]. Bretoni tek "Antologjia" do të kërkojë tek Frojdi përmasat psikologjike të humorit të zi. Veçanërisht duke përdorur veprën e tij "Humori dhe lidhjet e tij me të pandërgjegjshmen", konstaton se: "Humori nuk ka vetëm atë pjesë çliruese dhe elementin komik, por diçka më madhështore dhe të epërme. Madhështia synon sigurisht në ngadhënjimin e vetëpëlqimit..."[13]. Përmasa satirike e funksionit të humorit të zi është e dukshme. Dhe pikërisht perceptimi satirik i veprave (letrare dhe artistike) është maksimalja e mundësive

[10] A.J. Chapman and H.C. Foot, eds., *It's a Funny Thing, Humour,* Oxford: Pergamon 1911, p.15.

[11] Andre Breton, *Anthologie de l'humour noir,* Paris: J.J. Pauvert 1939; 3rd ed. 1966, p.12.

[12] Ibid., p. 151.

[13] Z. I. Siafklekis, Nga nata e vetëtimave tek poezia fakt, Botimet Epikairotita,1993. Athinë, f. 196.

të humorit të zi.

Një nga elementet e humorit të zi është edhe surrealizmi. Ashtu si Frojdi që thekson natyrën e ëndrrës në përballje me realitetin, Bretoni e pranon këtë proces të mendjes, i cili përzien imagjinatën me karakteristikën surreale të realitetit. Sipas studiuesit Kliford Brauder, një nga kategoritë më të veçanta të surreales është edhe "çmenduria".

Frojdi e shihte humorin e zi si inteligjent dhe komik në të njëjtën kohë. Natyra e tij lind pikërisht nga egoja apo refuzimi i unit për të vuajtur në një realitet mizor, kërcënimet e të cilit mundohet t'i kthejë në burim kënaqësie. Shembulli më i goditur që jep Frojdi është i një njeriu, i cili bën humor ditën që po varej. Ky lloj humori shpreh paradoksin e ngadhënjimit të kënaqësisë ndaj realitetit edhe pse një realitet makabër. Frojdi këtë lloj humori e quan"humor trekëmbëshi", që, sipas tij, është humor i Evropës dhe evropianëve të shtresës së mesme. Janë njerëzit që qeshin në mes të pafuqisë politike. Humori i trekëmbëshit kishte të bënte me popujt që jetonin nën Perandorinë Austro-hungareze. Ishin hebrenj, serbë, kroatë, gjithë këto grupe të vogla të bëra bashkë në një lloj perandorie të pashpresë. Ata ishin njerëz të pafuqishëm, të pashpresë, kështu që bënin shaka. Kjo ishte e vetmja gjë që mund të bënin përballë zhgënjimit. Humori i trekëndëshit që identifikon Frojdi është ai që ne e quajmë humor hebre. Është humor i njerëzve të dobët dhe inteligjentë në gjendje të pashpresë.

Sipas tij, "humori i trekëmbëshit" është një proces ku "egoja e një njeriu që po vuan nuk pranon të dorëzohet nga realiteti i zymtë dhe mizor. Ai thekson se s'trembet nga vuajtja, se edhe nga dhimbjet në jetë merret kënaqësi"[14]. Kështu, humori i trekëndëshit është një nga mënyrat për të shmangur dhimbjen dhe Frojdi thekson se mënyra të tjera mund të përfshijnë "helmimin, vetëshkatërrimin dhe kënaqësinë"[15]. Nëse Suifti është babai i humorit të zi, Entëni Eshli Kuper bashkëkohësi i tij,[16]ka deklaruar të jetë babai i humorit të butë. Humori i zi dhe humori i butë u shfaqën njëherazi. Humori i zi duhej të priste dhe dy shekuj që Bretoni ta përfshinte në spektrin e njohur me një emërtim të posaçëm. Në qoftë se lexuesi do të pranonte për një moment disa përzierje të dukshme në nivel terminologjik, mund të themi se llojet kryesore të shprehjes së humorit te zi janë pesë dhe mund të emërtohen satirë, ironi, grotesk, absurd dhe parodi. Romani "Vat" (*Watt, 1*953) i Samuel Beketit përmban një përkufizim të saktë të ndërveprimit të tyre. Sapo Vati hyn në shtëpinë e z.Not, ai takon në të ikur

---

[14] Paul Lewis, *Comic Effects: Interdisciplinary Approaches to Humor in Literature,* State University of New York Press, Albany, 1989, p. 130.

[15] Ibid. p.130

[16] Ibid.,pp.77-79.

Arsenën, e cila komenton:“Të qeshurat nuk janë të qeshura, por lloj kuje…Dua të them të shtirura, të zbrazëta, tallëse.”[17]

[17] Samuel Beckett, *Watt* .New York: Grove Press 1959, p. 48.

Luigj DEDVUKAJ

ANALIZA E TEKSTEVE SHKOLLORE, TË LËNDËS IDENTITARE "KULTURË MUZIKORE", PËR NXËNËSIT SHQIPTARË NË MAL TË ZI

Hyrje

Në këtë trajtesë kemi bërë analizën e teksteve shkollore të lëndës së identitetit "***Kulturë muzikore***" për nxënësit shqiptarë në Mal të Zi, duke nxjerrë disa rezultate me qëllim që të përmirësojmë gjendjen e teksteve aktuale, si dhe të japim një vizion me disa propozime për ndryshim të programeve dhe për mënyrën e përdorimit të autonomisë së arsimtarit përmes trashëgimisë e kulturës popullore - artistike shqiptare.

Kemi bërë analizën e teksteve të botuara nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore në Podgoricë për secilën klasë veç e veç, duke filluar nga klasa e parë e shkollës fillore deri në klasë të nëntë, si dhe tekstet e gjimnazit nga viti i parë deri në vitin e katërt.

Analiza përfshinë: përkthimet e teksteve (përkthimi i këngëve është problemi kryesor), pastaj lëshime të fjalëve të papërkthyera - gabimet teknike (vendosja e rrokjeve nën nota dhe ndarja e fjalëve në rrokje etj.) arsyetimet dhe zgjidhjet. Për shkaqe objektive nuk i paraqitem të gjitha problemet që i kemi vërejtur në tekste, por paraqitëm disa nga ato më kryesoret, duke dhënë zgjidhjen e tyre.

Për programe sugjeruam që të përdoret minimum një hapësirë e lirë prej 30%, ndërsa për autonomi të arsimtarit të shfrytëzohet maksimalisht 20%-shi i paraparë për bashkësinë lokale, duke përfshirë këngët, instrumentet, kompozitorët dhe njohuritë e tjera të kulturës popullore e artistike shqiptare si zgjidhje e shpejtë e problematikës.

Mendojmë se këto përfundime të arritura do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes aktuale dhe afrimin e nxënësve më pranë lëndës së muzikës.[1]

Është e domosdoshme që nxënësit shqiptarë të mësojnë lëndën e muzikës përmes këngëve shqipe dhe jo përmes këngëve të përkthyera nga gjuha malazeze,

[1] Këto vërejtje dhe sugjerime i kemi dërguar Ministrisë së Arsimit të Malit të Zi dhe Entit për Shkollim. Ende s'kemi përgjigje a do të pranohen a jo! Programet e reja për gj. malazeze kanë dalë, ndërsa tekstet për gj. shqipe jo!

serbe, kroate, boshnjake etj. Po ashtu është e nevojshme të njihen me njohuri të tjera të kulturës sonë popullore dhe artistike shqiptare, krahas disa njohurive malazeze e të popujve fqinj. Nëse ndonjë këngë duhet të përkthehet, në fakt ato do të duhej të përshtaten, ai që bën përshtatjen e tyre duhet të ketë njohuri për muzikën dhe poezinë, pra duhet të jetë muzikant dhe tekstshkrues, në mënyrë që këngët të dalin sa më melodike dhe poetike. Nuk mjafton vetëm ana poetike (vendosja e drejtë e rimave) ose muzikore.

MREKULLIA E MUZIKËS 1

Emrat që tregojnë ngjarjet nëpër libra si p.sh.: *Ivoja* dhe *Ena*[2] mendojmë se është dashur të përshtaten me emrat shqip ashtu siç janë përshtatur në klasën e tretë *Gjoni* dhe *Ena*. Ose emri *Jole* (Libri i klasës së dytë, f. 22). Ndarja e disa fjalëve nuk është bërë në mënyrë të duhur. Për shembull: fjala *verdhë* në fund të faqes (f. 20), te kënga: "NË FUND TË FSHATIT". Është dashur të ndahet: *ver-dhë.* Këso lloj rastesh gjejmë edhe në libra të tjerë. Te kënga f. 44 mungojnë vijat ndarëse ndërmjet fjalëve.

MREKULLIA E MUZIKËS 2

Mendojmë se ka qenë e panevojshme të vendoset pranë tekstit shqip edhe teksti në gjuhën zyrtare me shkronja cirilike. Kjo për shkak se shkakton konfuzion te nxënësit, të cilët fillojnë t'i mësojnë shkronjat latine të gjuhës malazeze në klasë të tretë, kurse ato cirilike në klasë të katërt. Këto i gjejmë edhe te këngët në librin e klasës së dytë (f. 8, 12, 15, 16, 23, 33, 36).

MREKULLIA E MUZIKËS 3

Mendojmë se nuk ka qenë e nevojshme t'u vendoset apostrofi disa fjalëve, si p.sh.: në f. 7, *muzik'* ose në f. 7, 10, 27, 30, 39, 43, 46. Në f. 28, në foto kemi rosën, mendojmë se është dashur të jetë pata. Zgjidhja është pauzë (Pa+u+zë).

BANESA E NOTAVE 4

Në f. 8, 9, 10 dhe 12 kemi emërtime specifike të pjesëve të notës. Në vend të fjalës *këmba,* mendojmë se është dashur të përdoret: *bishti*. Kurse për *bishtin* e notës tetëshe është dashur: *kërrabë* apo *grremç*. Kështu i gjejmë në shumë libra autorësh shqiptarë. Kurse në shumicën e librave të autorëve nga Kosova vërejmë ndikimin e përkthimeve që janë bërë nga gjuha serbe. P.sh.: për bishtin përdorin *qafa*, për kërrabën përdorin *flamuri*. Sepse qafa në gjuhën serbe është *vrat*, kurse

[2] J elena Martinoviq - Bogojeviq, Milena Papiq, Bilana Durkoviq, ***MREKULLIA E MUZIKËS 1,*** Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2012, f. 4.

flamuri *barjačić*. Kur ndeshemi te këngët që janë të njohura ndërkombëtarisht si "Jingle bells" e James Pierpont-it, mendojmë se është mirë t'iu përshtatemi teksteve që janë të njohura ndër nxënës që herët. Pra, fjala është për përkthimin e të njëjtës këngë që e ka bërë dikush më herët. Sepse ajo ka qarkulluar përmes librave, radios, televizionit ose internetit, dhe është më pranë nxënësve. Fjalët e këngës *Zilja tring* janë më të përshtatshme, sesa ç'është përkthyer si "Kambanat", f. 23. Ndërsa në f. 70 fjala *Oda,* është dashur të shkruhet *Odja.*

KULTURA MUZIKORE 5

Në f. 76. dhe f. 82. vërejmë gabime në ndarje të fjalëve. Në f. 95 fjala **arëza** është dashur të jetë e shkruar: **arza**.

KULTURA MUZIKORE 6

Në f. 5 kemi: *Grupet orkestrale.* Është përkthyer gabimisht nga gjuha malazeze (Камерни састави). Është dashur të jetë: **Përbërjet kamertale** ose **Formacionet kamertale** ose **Përbërja e dhomës.** Po ashtu edhe në f. 23. Në f. 32 të librit në gjuhën malazeze e kemi titullin origjinal **Апсолутна музика** që është përkthyer: *Muzika serioze.* Sikur të kishte qenë në gjuhën malazeze: Озбиљна музика, atëherë do të kishte qenë në rregull. Mendojmë se është dashur: **Muzika absolute.** Në f. 6. është lënë pa u përkthyer fjala **музичка култура 6** (kultura muzikore 6).

Në f. 8 kemi tekstin e këngës "Urim për ditëlindje" që është dashur të jetë: *G'zuar dit'-lind-jen...*

Kënga në f. 17 *Këmborët*, mendojmë se është dashur: **Kambanat tubore.** Në f. 18 te *Këmborëzat* ndeshemi me fjalën *klaviatura,* është dashur: **tastiera.** Po ashtu në f. 22. Në f. 26 janë përkthyer gabim disa instrumente. Kemi *trombat*, është dashur **trumbetat**. Për *kornoetat* – **kornat**, *bastuba* - **tuba**. Varianti i tekstit në CD në f. 28 është dashur të përshtatet njëjtë edhe në libër. Në f. 51, në taktet 14 dhe 15 janë të shënuara gabimisht dy pauza të plota. Fjala **ступањ** në f. 58 është përkthyer gabim *lartësi*, është dashur: **gradë**. Titulli i këngës në f. 59 është dashur të jetë në d-mol.

KULTURA MUZIKORE 7

F. 3, 15, 16. Në përmbajtje kemi nëntitullin *pslate.* Mendojmë se është dashur të jetë: **pasioni.**

F. 13. Nën foton e parë është dashur të shënohet **Aulosi** dhe **qestja**. E jo *kitara* siç është në libër.

F. f. 18. Vërejmë se viti i vdekjes së *Guido de Areco* është i dyshimtë (995-1005). I bie që ka jetuar 10 vjet. Në disa ueb faqe e gjejmë se ka vdekur në vitin 1050.[3] Fjalia *orgulet* në f. 29 është përkthyer gabim. Është dashur *preludet*. Ndërsa, në f. 47 te kënga **Muzika të rrojë** kryesisht janë të vendosura gabim rrokjet e fjalëve nën nota. Mendojmë se është dashur të merret përkthimi nga libri i S. Spahiut.[4]

KULTURA MUZIKORE 8

Në f. 24 kemi dy vite që janë shkruar gabim, 1929 dhe 1935, e që do të duhej: 1829 dhe 1835. Në f. 54 nuk janë ndarë mirë disa fjalët. Është dashur të merret kënga nga libri i S. Spahiut.[5] Përmirëso fjalët Rekuem dhe Valcer në f. 74. Është dashur: **Rekuiem** dhe **Valsi.**

KULTURA MUZIKORE 9

F. 7. Viti i lindjes së Borodinit është gabim. Është dashur të jetë: 1833.

ARTI MUZIKOR I – II

F. 14. Vërejmë se mungon veçoria e katërt e tingullit që është **gjatësia** (kohëzgjatja). *Jovan Kukuzeli* (f. 37)*,* shkruhet në gjuhët sllave, kurse shqip shkruhet dhe njihet si **Jan Kukuzeli**. Viti i lindjes dhe i vdekjes është i dyshimtë, sepse kemi të dhëna të ndryshme nga studiues të ndryshëm, pra për lindjen e vdekjen e tij kemi mjaft mëdyshje. Për këtë kompozitor edhe studiuesi shqiptar Ramadan Sokoli ka nxjerrë mjaft dëshmi të sakta. Ndër të tjera argumenton se, Jan Kukuzeli ka lindur rreth 1078-1088[6] e jo siç është në libër (shek. XIV – XV).

MUZIKA – GJUHA IME III - IV

Fjala *frëngj. accord* (f. 20) është dashur të jetë: *akord* e jo *harmoni.* Në f. 38 - 39 zërat e korit të përzier janë shkruar: *soprani*, *alti, tenori, baritoni* dhe *basi*. Është dashur: **sopranoja, altoja, baritoni dhe basi,** pra në të shquar.

---

[3] http://www.longwood.edu/staff/swansoncl/Sightsinging/GUIDO%20AREZZO.htm dhe http://www.britannica.com/biography/Guido-dArezzo-Italian-musician

[4] Seniha Spahiu, EDUKATA MUZIKORE 7, Libri shkollor, Prishtinë, 2004, f. 13.

[5] Po aty, f. 6-7.

[6] Për më shumë shih: Ramadan Sokoli *"16 SHEKUJ",* EURO-LINDJA, Tiranë, 1994, f. 49-63.

PËRFUNDIMET E NXJERRA NGA ANALIZA E TEKSTEVE TË MUZIKËS

1. ***Përkthimet***. Ajo që vërehet dhe bie në sy në shumicën e përkthimeve (mekanike/bukualisht) të këngëve janë fjalët e papërshtatshme me vijën melodike të këngës. Vetëm disa këngë të përkthyera janë të përshtatshme me melodinë, gjë që është e mundur. Dihet se shumë fjalë në gjuhën malazeze, serbe etj. nuk i kanë të njëjta zanoret si në gjuhën shqipe. Po ashtu ndryshon theksi dhe diksioni. Pra, mënyra e shqiptimit të fjalëve, të rrokjeve e të tingujve kur këndojmë nuk është e njëjtë në të dy gjuhët. Për t'u përshtatur mirë është dashur t'i shmangemi përkthimit origjinal, sepse është e pamundur të ruhet origjinaliteti 100%. Vërejmë se, aty ku është tentuar të vihet ana poetike, në anën tjetër është humbur ajo melodike dhe e kundërta. Kështu që, për përkthime në të ardhmen të kërkohet personi përgjegjës që i njeh të dy anët, si anën poetike dhe atë melodike, sepse pa njërën anë përkthimi është i mangët. Këta persona nëse nuk gjenden këtu (Mal të Zi), t'i kërkojmë në Shqipëri (Shkodër, Tiranë etj.).
2. ***Gabimet teknike.*** Vërehen lëshime të ndryshme si në terminologji, drejtshkrim të fjalëve, ndarje të fjalës me vijë, fjalë të cilat nuk kanë vijë në mes, rrokje që nuk janë të shënuara nën notat e duhura të vijës melodike, fjalë të shkruara gabim, fjalë të lëna pa u përkthyer etj. Këto gabime shpesh mbesin të paqarta dhe ngatërrojnë mësimin e tekstit të këngës. Të vihet vëmendje më e madhe në renditjen e fjalëve nën notat e vijës melodike. Për transkriptimin e fjalëve dhe notave muzikore nga gj. malazeze në gj. shqipe është i domosdoshëm njeriu që njeh gjuhën shqipe dhe njëkohësisht të konsultojë fjalorët drejtshkrimor për mënyrën e drejtë të ndarjes së fjalës në rrokje.
3. ***Rrokjet me apostrof.*** Vërehet se, për t'iu përshtatur melodisë me rrokje, në vend të tyre është vënë apostrofi, p.sh.: ësht', shum', g'zohen etj. Kjo nga njëra anë është në rregull kur fjalët shënohen nën nota muzikore. Nga ana tjetër, kur nuk kemi melodinë e shënuar me nota muzikore mendojmë se nuk ka qenë nevoja, pasi cenohet pakëz drejtshkrimi dhe nxënësit e mësojnë gabimisht drejtshkrimin.
4. ***Terminologjia***. Në përkthimet e teksteve mësimore hasim në disa fjalë e terma që përdorën ndryshe nga disa autorë. Të marrim disa shembuj: **Hendl – Hendël**; **Lili – Lyli; dur** apo **maxhore**; **mol** apo **minore**; **shenjat e shartimit** apo **parashenjat**; **dinamika** apo **ngjyrimi**; **ngjyra** apo **timbri** etj. Kjo problematikë e terminologjisë së përkthyer nga gjuhët e huaja ende vazhdon dhe nuk është zgjidhur përfundimisht nga studiuesit

e autorët e ndryshëm shqiptarë qoftë nga Shqipëria, Kosova etj. Sigurisht se në të ardhmen studiues shkencorë, gjuhëtarë e muzikologë do të përcaktojnë përdorimin e fjalëve e termave të duhur muzikor, duke unifikuar qëndrimet bazuar në fjalorin drejtshkrimor.

5. ***Konsulenti profesional***. Për botimet në gjuhën shqipe është i domosdoshëm të jetë konsulenti profesional, në rast se nuk është vet ai përkthyes i librit. Ama, gjithsesi për këngë të jetë njeriu i veçantë për përshtatjen e tyre.

PËRSHTATJA E MUZIKËS SHQIPTARE NË PROGRAMET DHE TEKSTET E KULTURËS MUZIKORE PËR NXËNËSIT QË MËSOJNË NË GJUHËN SHQIPE

1. Të përshtaten me këngë shqiptare programet dhe tekstet e muzikës për lëndën Kultura muzikore sipas objektivave dhe niveleve të parapara (kl. I – IX dhe Viti I – IV). P.sh.: fillojmë me lojërat muzikore (këngët e numërimit): *Hapa dollapa; Roza – rozina; Kosa* etj. Pastaj përmes këngëve të tjera për fëmijë, këngë artistike dhe popullore si: *Zilja po na fton* (L. Deda); *Gëzimi i shkollës* (M. Basha); *Loja e shqiponjave* (Z. Çoba); *Tik - tak* (A. Xhunga); *Ja na erdhi Viti i Ri* (B. Kongoli); *Qingji i vogël* (Z. Leka); *Moj bubrrec* (L. Deda); *Festa e Abetares* (B. Dani); *Fjala Nënë* (F. Ibrahimi); *Kur bie fyelli e çiftelia* (P. Gaci) e të tjera këngë popullore dhe artistike shqiptare. Të bëhet përzgjedhja e këngëve në mënyrë që t'i përshtaten mësimit didaktik. Të njihen me Himnet e Shteteve të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian. Përveç këngëve homofonike të mësojnë edhe këngët polifonike shqiptare. Përveç këndimit të një solisti apo grup këngëtarësh të njihen edhe me korin, me këngën korale përmes këndimit dhe dëgjimit të tyre.

2. Të njihen me muzikën popullore/folklorike (këngë me lahutë, vajtimet, këngët lirike, epike, liriko-epike, këngë meshkujsh, femrash, të përbashkëta, këngë me shoqërim dhe pa shoqërim instrumental, këngë djepi, këngë baritore, këngë dashurie, këngë dasmash, këngë pune, këngë kurbeti, këngë të traditës së fshatit dhe qytetit etj.). Të njihen me instrumentet popullore përmes dëgjimit të tyre, përmes ilustrimeve me fotografi, të njihen me kostumet popullore shqiptare të krahinave të ndryshme. Po përmendim disa këngë popullore: Këngët e Mujit e Halilit; Vaj si kënka ba dynjaja; Rrush i kuq i bukur o; Oj lulija jonë; Mirë mbrama; Vajta n'Elbasan; Mori lulja e frashnit t'bardhë; Këngë për Dedë Gjon Lulin; Ti je krejt si një gonxhe; Po vijnë krushqit; M'kashku menja me u feju; Moj zoge; Moj zambaku i bardhë;

Shkapërceva dy tri male etj.

3. Të njihen me vallet e krahinave të ndryshme (Vallja e Shotës, Vallja e Rugovës, Vallja e Tiranës, Vallja e Dumsharavelit etj.), si dhe kërcime shqiptare (Kërcim malësorçe, Kërcim me shpata etj.).
4. Të njihen me disa kompozitorë shqiptarë dhe me disa forma të muzikës artistike (serioze) si Opera "Mrika" – Prenk Jakova; Baleti "Halili dhe Hajria" – Tish Daija; Opereta "Agimi" – Kristo Kono; Oratorio "Kënga e maleve" – Tonin Harapi; Simfonia nr. 1, Çesk Zadeja etj.
5. Të njihen me muzikën e lehtë shqiptare, me kompozitor, me vepra, me interpretues të zhanreve të ndryshme muzikore, me festivale të ndryshme, me këngëtarë etj. Veçojmë: Vaçe Zela, Kastriot Tusha, Ardit Gjebrea, Aurela Gaçe, Aleksandër Gjoka, Elvana Gjata, Elhaida Dani, Hana Cakulli, Alma Bektashi etj. Ndër kompozitorë: Agim Kraja, Avni Mula, Aleksandër Lalo, Shefqet Hoxha, Shpëtim Saraçi, Ardian Hila, Alfred Kaçinari etj. Ndër festivale: Festivali i këngës në RTVSH, Top Fest, Kënga magjike, Festivali folklorik në Gjirokastër, si dhe konkurse muzikore, emisione etj.
6. Të njihen me historinë dhe zhvillimin e muzikës jo vetëm ndërkombëtare, por edhe me atë kombëtare shqiptare që nga ajo Iliro – Arbëreshe si paraardhëse e muzikës shqiptare, për muzikën arbëresho – shqiptare të Mesjetës dhe Renesancës, për jetën muzikore gjatë sundimit osman, për Rilindjen kombëtare, fillet e muzikës së kultivuar artistike shqiptare, për muzikën shqiptare nga pavarësia e shtetit shqiptar (gjysma e parë dhe e dytë e shek. XX) e deri sot. Po përmendim disa emra kompozitorësh si: Niket Dardani, Jan Kukuzeli, Kolë Durrsaku, Filip Drishti, Kristofor Ulqini, Palok Kurti, Frano Ndoja, Martin Gjoka, Thoma Nasi, Kristo Kono, Prenk Jakova, Lorenc Antoni etj.
7. Të njihen me muzikën e disa filmave shqiptarë, si p. sh.: "Flaka e maleve" – Çesk Zadeja, "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër" – Limos Dizdari, "Skënderbeu" – J. Sviridov dhe Ç. Zadeja etj.
8. Të përgatiten pllakate me shenja, fotografi e terma muzikorë, CD dhe DVD për librat e muzikës, këngë popullore e të kultivuara të muzikës shqiptare, fragmente nga veprat e ndryshme muzikore e skenike, tinguj instrumentesh muzikore shqiptare, pamje nga festivale, koncerte etj.
9. Të pajisen shkollat me mjete muzikore për zhvillim të orës mësimore; me nga një instrument muzikor me tastierë, me tela apo frymorë, me instrumente të Orfit dhe me një CD-*player*, sepse pa këto mjete lënda e muzikës nuk mund të zhvillohet. Gjithsesi nevojiten edhe televizorë, kompjuterë, internet e projektorë që janë mjete standarde të kohës.
10. Të ruhet ***Autonomia e arsimtarit***. Aktualisht është 20%. Nga 34 orë në vit,

shtatë orë mund t'i dedikohen bashkësisë lokale. Në këtë mënyrë arsimtari do të duhej të kishte hapësirë kreativiteti në mënyrë që fëmijët ta kenë më lehtë të përvetësojnë njohuri për komunitetin lokal dhe më gjerë. Do t'iu jepej rasti të njohin këngët, interpretuesit, vallet, kërcimet, veshjet etj. shqiptare. Përmes tyre do të njohin, ushtrojnë dhe mësojnë, duke e trashëguar kulturën dhe traditën e tyre muzikore përmes gjuhës amtare shqipe. Kjo është një mënyrë bashkëkohore e integrimit në shoqërinë euro-atlantike pa u asimiluar. Për shqiptarët që jetojnë në Mal të Zi duhet pasur parasysh qytetet e afërta, siç është Shkodra, Peja, Tirana etj. Pra, të kultivojmë edhe më gjerë njohuritë për muzikën shqiptare.

11. Vërejmë një nevojë shumë të madhe për të pasur tekstet në gjuhën shqipe për shkollën e ulët të muzikës, në Ulqin dhe në Tuz,[7] si dhe regjistrat e dokumentet përkatëse në dy gjuhësi.
12. Të organizohen seminare për mësuesit të cilët e japin këtë lëndë, në mënyrë që t'u dalim në ndihmë për ta mbajtur orën sa më mirë.

KONKLUZION: Të gjitha këto që i cekëm më lart së bashku me disa njohuri (këngë, valle, instrumente, kompozitorë etj.) të muzikës së popujve fqinj, si dhe muzikës evropiane-botërore janë të nevojshme për t'u përshtatur në një tekst për nxënësit shqiptarë që mësojnë shqip në Mal të Zi. Pra, të krijohet një tekst i veçantë sikur se është ai për lëndën Gjuhë dhe letërsi shqipe. Nëse kjo nuk është e mundur, së paku t'u mundësohet një zgjidhje alternative, duke përdorur tekstet e muzikës nga Shqipëria e Kosova në minimum prej 30% të hapësirës së fondit vjetor (krahas programeve aktuale të miratuara nga *KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR ARSIM* i Ministrisë së Arsimit të Malit të Zi), së bashku me 20% të autonomisë së arsimtarit. Pra, të gjitha këto këngë shqiptare, valle, kompozitorë, vepra muzikore të zhanrit klasik, popullor e të muzikës së lehtë, me interpretues, instrumente muzikore, kostume popullore shqiptare etj. të përshtaten për secilën klasë bazuar mbi objektivat, arritjet dhe nivelet e parapara nga Ministria në fjalë, në mënyrë që të krijohen programet dhe librat e veçantë të Kulturës muzikore për pakicën shqiptare që jetojnë në Mal të Zi.

[7] Shkolla e ulët e muzikës dhe baletit "Vasa Paviq" nga Podgorica ka hapur paralelen këtë vit në Tuz dhe Gollubovc.

Referenca

- Dhrimo, A., Memushaj, R., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe,* Infobotues, Tiranë, 2015
- Lucellshvab, Dijana, Stefanoviq, Aleksandra, *BANESA E NOTAVE 4,* Kultura muzikore për klasën e katërt të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008.
- Markoviq, Vedrana, Perunoviq, Ranka, *Muzika – gjuha ime*, Tekst mësimor, Për klasën III dhe IV të gjimnazit, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2013.
- Martinoviq-Bogojeviq, Jelena, Papiq, Milena, Durkoviq, Bilana, *MREKULLIA E MUZIKËS 1,* Kultura muzikore, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2012.
- Martinoviq-Bogojeviq, Jelena, Papiq, Milena, Durkoviq, Bilana, *MREKULLIA E MUZIKËS 2,* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2012.
- Martinoviq-Bogojeviq, Jelena, Papiq, Milena, Durkoviq, Bilana, *MREKULLIA E MUZIKËS 3,* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2013.
- Perunoviq, R., Ivanoviq, M., *ARTI MUZIKOR*, TEKST MËSIMOR PËR KLASËN E PARË OSE TË DYTË TË GJIMNAZIT, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2012.
- Popoviq, Dobrilla, Petriçeviq, Dijana, *KULTURA MUZIKORE 7,* Për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2007.
- Popoviq, D., Zatkallik, M., Todiq, D., *KULTURA MUZIKORE 9,* Tekst mësimor për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2009.
- Qetkoviq, Gordana, Vojnov, Tatjana, *KULTURA MUZIKORE 8,* Për klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008.
- Sokoli, Ramadan *"16 SHEKUJ",* EURO-LINDJA, Tiranë, 1994.
- Spahiu, Seniha, *EDUKATA MUZIKORE 7*, LIBRI SHKOLLOR, Prishtinë, 2004.
- Spahiu, Seniha, *MUZIKA DHE EDUKIMI,* LIBRI SHKOLLOR, Prishtinë, 2012.
- Stefanoviq, Aleksandar, Lucellshvab, Dijana, Ivanoviq, Nada, *KULTURA MUZIKORE 5,* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2009.
- Shmaku, Violeta, Hala, Majlinda, *LIBËR MËSUESI EDUKIM MUZIKOR*

1-2-3-4-5, Shtëpia Botuese MEDIAPRINT, Tiranë, 2011.
- Vujiçiq, Branka, Tmushiq, Sërgjan, *KULTURA MUZIKORE 6,* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2006.
- ZAVOD ZA ŠKOLSTVO, Predmetni program *„MUZIČKA KULTURA I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII i IX razreda osnovne škole"* Podgorica, 2011.

Të dhënat nga interneti
- http://www.britannica.com/biography/Guido-dArezzo-Italian-musician (10.11.2017)
- http://www.longwood.edu/staff/swansoncl/Sightsinging/GUIDO%20AREZZO.htm (09.11.2017)

Mustafë HAZIRI

ÇAMËRIA DHE MARRËDHËNIET SHQIPTARO-GREKE

ABSTRAKT

Çështja çame dhe ndikimi i saj në marrëdhiet shqiptaro-greke, është një temë e cila është trajtuar në historiografinë shqiptare por nuk është trajtuar në masë nevojshme. Në historiografinë shqipëtare në përgjithësi çështja çame si çështje e ndjeshme është trajtuar pak duke marrë parasyshë rëndësinë e saj historike, por duke kuptuar se çështja çame ka lindur pas vitit 1913, me vendimet e konferencës së Ambasadoreve në Londër ku fatkeqësisht kufinjët e Shqipërisë u vendosen në dëm të interesave të saj dhe në favor të shtetëve të Aleancës Ballkanike .

Historiografia shqiptare fillet e secilës i hasim në mes të dy luftrave botërore, gjegjësisht ka vitet e 30-ta, të shekullit XX, për shkak të rrethanave të vështira që u krijuan në Shqiperi, nuk pati mundësi të merrej me këtë çështje të rëndesishme për ne .

Edhe pse fillet e mirëfillta të historiografisë sonë filluan pas luftës së dytë botërore, prapë se prapë sistemi komunist këtë plagë të rëndë të Shqipërisë e la në harresë .

Vetëm pas vendosjes së demokracisë në Shqipëri, kjo çështje filloi të trajtohet në aspektin shkencor, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë por jo edhe të duhur .

Masakrat ndaj çamëve filluan që nga viti 1913, dhe vazhduan gjatë luftës së pare dhe të dytë botërore.

Periudha e shekullit XX, është një periudhë e historisë që pergjithësisht tregon për masakrat ndaj popullsisë së pafajshme çame. Këto ngjarje kanë ndikuar në ftohjen e marrëdhënieve shqiptaro-greke.Ajo çka më së shumti është për t'u mburrur është ndërgjegjësimi i një grupi intelektualesh shqiptarë të cilët në Qershor të vitit 2004 themeluan "**Institutin e Studimeve për Çamerinë"**. Me 27 Qershori 1944 ,u bënë 72 vjet nga gjenocidi grek ndajçamëve

Fjalë kyçe : Historiografi, Shqiperi, Çameri, Gjenocidi, Shek. XX, Greqi.

Hyrje

Duke u nisur nga fakti dhe rëndesia e zgjidhjes se çështjës çame,Greqia ka bërë disa here zotime dhe premtime zyrtare por ato asnjehere nuk u ralizuan ne praktikë.

Kjo lenë te kuptojmi se"Revulicioni grek është lëvizja e pare qe identifikon veteveten me vdekjen dhe dëbimin e (çamëve M.H),te besimit islamë nga vendi i tyre.

Çështja çame, është një nga çështjët më të ndjeshme jo vetëm të raporteve shqiptaro-greke, por edhe të kujtesës sonë historike.

Historiografija shqiptare. çështja çame e konsideron si të pashkëputur në kauzën tone kombëtare .Ajo është një fenomen historik jo vetë përmasa kombëtare por edhe ndërkombëtare.

Ne kushtetuten Grekë vrehet nje ngarkës e plotë për të drejtat e njriut. Gëte shkruan:politika prish karakterin.

Historia e shqipëtarëve etnik në çamëri është mbushur me një varg ngjarjesh tragjike , të ruajtura në kujtesen historike si akte të dhimbëshme kombëtare, prandaj e konsiderojmë si të interesit të veçantë trajtimin e kësaj problematike .

Vështrim historiografik

Çështja çame është një problem politik qe kerkon zgjidhje ne diskutimet ne mëse të Greçisë dhe Shqipërisë,por deri me tani ketij problem të dy vendet i kanë dhenë
pergjigjeje të ndryshëme.

Çamëria përbën pjesën më jugore të trojeve të banuara historikisht nga shqipëtarët.[1] Spastrimi etnik i camerise nga banorët e saj autokton është një vepër e politikës kombëtare dhe fetare të shtetit Grek që e ka zanafillën që nga viti 1844 kur në platformën politike "Megali idea " e cila filloi të realizoj hap pas hapi ndaj Shqipërisë .[2]

Spastrimi etnik i çamëris, krijoi procedantin më të rrëzikshëm të spastrimit etnik në ballkan . Ne komuniteti intelektual shqipëtar duhet të reagojmë jo vetëm ndaj atyre që dhunuan por edhe ndaj atyre që heshtën. Edhe presidenti i SHBA-së Wilson në një letër të hapur ndaj kësaj mizorie shkruante : " Hidhërimet e tmerrëshme dhe mizoritë për nënat shqipëtare, grate dhe bijat që duruan gjakun e

[1] Selman Sheme , Dokumente natyrore dhe kulturore të çamërisë, botoi, "West Print", Tiranë 2012,fq 19.

[2] Selman , Shema , Çamëria , Vështrim Gjeopopullativ dhe etnokulturor , shb "Dea Print " , Tiranë 2016 , fq 184.

derdhur etj.[3]

Neve na mbetet që të vazhdojmë të gjrurmojmë materiale të pasura historike në hapsirat shqipëtare të çamërisë .Nëse i hedhim një sy të kaluarës historike të kësaj krahine shqipëtare, kuptojmë se qka kërkon populli shqipëtar sot në çamëri [4]

Çështja kombëtare shqipëtare në këtë kuadër edhe çështja çame ka një histori të gjatë, duke filluar nga viti 1880 kur filloi presioni grek për braktisjen e popullësis vendase nga trevat e tyre në çamëri e deri në vitin 1913 kur u aneksua Janina dhe çamëria në vendimet e conferences së ambasadorëve në Londër , duke vazhduar më vonë edhe gjatë luftës së pare dhe së dytë botërore [5]

Zbatimi i kriterit etnik cilësohet edhe si një kushtë për sigurimin e paqës dhe stabilitetit në Ballkan [6]

Wadhan Peackok[7] me të drejt në një artikull të botuar në gazeten "Koha Ditore" shkruan; "Shqipëtarët janë te mbijetuarit e vetem te races me te lashte ne Evrope. Ata kishin rrenje te thella ne Ballkan para sllaveve, bulgareve" etj.[8]

Profesori i nderuar Selman Sheme , rrjedha të shperngulje së dhunëshme të shqipëtarëve të çamëris i periodizon në tri etapa : etapa e pare : Spastrimi etnik gjatë luftës së pare botërore duke i elaboruar rrethanat gjatë luftrave ballkanike , kur pushtohet çamëria, ku filloi etapa e pare e shpërnguljes massive të popullësis çame . Për pasojë vetëm gjatë luftës së pare botërore u dëbuan nga trojet e tyre stërgjyshore reth 10 mijë shqipëtarë të çamërisë në drejtime të ndryshme, ku gjatë shprenguljes pati shumë të vrarë dhe të masakruar [9]

Gjatë vitit 1913 – 14, duke kaluar kufinjët e përcaktuar të Shqipërisë nge konferenca e ambasadorëve në Londër, Grekët vranë dogjën dhe shkatrruan 190

---

[3] Resmie (Mane) Beqiri, Lot'i brengosur , shb "Triptik",Vlorë 2015,fq 135.

[4] Sylejman, Abazi , "Çamëria rikthim tek lavsdia e etërve të dikurshëm , shb " Dajti 2000" Tiranë 2007 , fq 14.

[5] Arben.p . Llalla , Kolaboracionistët Grek projektuesit dhe udhëheqësit e genocidit në Çamëri , shb "Tringa design "Tetovë 16 ,fq 101 .

[6] Lush Culaj, Shqipëria dhe çështja e Çamërisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2006 , fq 51.

[7] Ka qenë ligjerues i historisë në Universitetin e Cambridge gjatë vitit 1878-1880, Sekretar privat i konsullit të përgjithëshëm britanik në Shkodër, Sir William Greene, si dhe autor i librit Shqipëria shtet jetim i Evropës.

[8] Wadham Peacock, "Shqiperia shtet jetim i Evropes", Fejton, Koha Ditore 16.04.2017, fq.20.

[9] Historia e popullit Shqipëtar , Grup autorësh , Prishtinë , 2016, fq 407.

fshatra dhe 2 qytete , u dogjën 6831 shtëpi dhe mbetë pa strehë 43.296 banorë .[10]

Për tragjedinë çame ka shkruar edhe .Edit Durham , i cili shkoi tiu jape ndihmë mjeksore dhe ushqim .Thotë se brenda dhe jashtë Vlorës ishin rreth 70 mij frymë përveç që kishin zërë vendë në mes Beratit dhe Vlorës në viset malore .[11]

Vlen të theksohet se gjat luftës së parë botërore shqipëtarët e çamërisë mbështeten programin e lëvizjes kombëtare për krijimin e shqipërisë në kufinjët e saj etnik .

Megjithatë shpresat qe i ushqenin shqipëtarët në konferencen e paqës së versajës nuk u realizuan, pasi kjo conference nuk sollin asnjë ndryshim në gjendjen e popullësisë çame në çamëri, pasi që numri i popullësis shqipëtare vinte gjithnjë duke rënë .

Në vitin 1921, memorandumi i përfaqësuesve të komitetit mbrojtja kombëtare shqipëtare, ju drejtuan Bonin Longerit , ambasadorit të Italisë dhe njëherit antarit të conferences së paqës , me një kërkesë nga proff Bedri Pejani , përkthimin e çamërisë Shqipërisë .

Gjithashtu mirren refugjatët në jug të Shqipërisë që u detyruan me dhunë të shprengulen nga vendlindja e tyre si rezultat i veprimeve të bandave " Verioepirote" u vëndosën në ullishtat e vlorës ku numri i tyre u arrit në 20 mijë shqipëtar të Janinës , veshternjarë, e konicarë etj . [12]

Komiteti mbrojtja kombëtare e Kosovës dhe përfaqesuesi i sajë Bedri Pejani i bëri 4 kërkesa për konferencën e paqës së Versajës :

- Bashkimi i popullit shqipëtar dhe krijimi i barazpeshës në Ballkan .
- Se Çamëria është ngjitur me shtetin Shqipëtar dhe bashkimi i saj me Shqipërinë nuk do të hasë në asnjë vështirësi të natyres teknike .
- Dhe në fund zgjedhja e drejtë e çështjës së Shqipërisë së jugut do ti jape fund konflikit shqiptaro - grek i cili kishte lindur nga konferenca e ambasadorëve në Londër në vitin 1913, dhe do të ndikonte në forcimin e paqës në ballkan.[13]

Popullësia çame sipas dokumenteve të vitit 1921 , pa popullësin e prevezës , Lorasit , Artës , Voshtinës , Konicës , Kosturit dhe Fillorinës

---

[10] Selman Shema , çamëria – vendi , popullësia dhe jeta ekonomike , Tiranë 2005 , fq 96 .

[11] Edit , Durham Njëzet vjet ngatrresa ballkanike , Tiranë 1944 , fq 274.

[12] Historia e popullit Shqipëtar III , Tiranë, 2007 , fq 496.

[13] AQSH, Fondi 251, viti 1921 , Dosja 44 , fq 82-85, dokumenti për Çamërinë 1912-1939, Tiranë 1999, fq 69

Rajoni	Shqipëtarë	Grekë
Filat	22348	5125
Gumenicë	10126	---
Ajdonatë	13780	2575
Margellicë	15723	---
Pargë	800	500
Gjithsej	**62.777 shqipëtarë**	**8200 Grekë**

Pavarsishtë koheficienti të lartë të shtimit natyror të popullësis së çamërisë , si rrjedhim i shpërnguljeve massive të popullësisë , numri i popullësisë ka ardhë duke rënë .

Faza e dytë e spastrimit etnik në çamëri filloi pas traktatit të llozanës 1923 -26 .

Nën monitorimin e fuqive të mëdha e të lidhjes së kombëve me 30 janar 1923 u nënshkrua traktati i llozanës në një nga nenet e tij përcaktojë shkëmbimi i popullësis turke në greqi me atë greke në Turqi .

Aty u vendos që të krijohet një komision për zbatimin e dispozitave të shkëmbimit të popullësis me disa nënkomisione .

Komisioni MIKES i formuar nga lidhja e kombeve përjashtonte popullësin shqipëtare të besimit muslimanë të çamërisë .

Edhe kryeministri i Greqisë E.Venizellos në letrën derguar sekretarit të lidhjës së kombeve shkruan se i kamë telefonuar qeverisë sime për ti tërheqë vëmendjen për gjendjen e shtetasëve Grek muslimanë të races Shqipëtare të cilët nuk duhet njesuar me Turqit sa i përket caktimit të konventës për këmbimin e popullësisë .[14]

Në takimet me komisionin e lidhjës së kombëve përfaqësuesit e çamërisë mbrojtën me vendosshmëri identitetin e tyre shqipëtarë, ata u deklaruan në mënyrë kategorike se jemi shqipëtarë dhe se nuk na lidhë asgjë me turqinë . Musa Demi , perfaqësues i filatit , Gumënicës dhe Margellecit në një letër dërguar më 13 Maj 1924 komisionit Miks në Athinë shkruan : "Muslimanët e çamërisë janë shqipëtar të njohur nga historianët e ndryshëm , çamët dhe suliotët janë shqipëtar

[14] Selmam , Shema , vep e cituar , Tiranë 2016 , fq 158.

nga raca gjaku dhe zakoni [15]

Për çështjen çame ka shkruar edhe Mit'hat Frashëri ku thotë: Politika helene për debimin e elementit musliman nga epiri dhe Maqedonia kishte filluar që të nesërmen e luftës ballkanike " ajo filloi të zbatohet nga qetat e hajdutëve dhe sjelljet të autoriteteve civile dhe militare, pavarsishtë kontributit të arvanitasëve për historinë e Greqisë që ishte i madhë .[16]

Nga marrveshja e Lozanës e deri në fundë të luftës së dytë botërore u shprengulën nga epiri i jugut (Çamëri M.H) dhe pjesët tjera të Greqisë për në drejtim të Turqisë , SHBA-së dhe Shqipërisë rreth 200 mijë shqipëtar të besimit Islam .[17]

Politika diskriminuese e qeverisë greke ndaj popullësis shqipëtare të çamërisë vrehet qartë edhe në fushën e arsimit .Edhe pse me nenin 7 të traktatit të sevrës nënshkruar nga Qeveria Greke me 19 gusht 1920, lidhur me mbrojtjen e pakicave në Greqi parashikonte "Ruajtjen e disa të drejtave dhe posaqërisht mësimin e gjuhës antare kjo nuk u lejua .[18]

Në korrik të vitit 1942 u formua edhe këshilli i përgjithëshëm e mbrojtjes organizim politico-administrativ e ushtarak me qendër në gumnicëdhe me degët në shumë rrethe , në Filatë, Margelicë, Paronthi, e Paragë. Ky këshill u ngrit në bazën e komitetit këshillues të çamëris të ngritur në qershor të vitit 1941 .[19]

Emigrimi i detyrar i popullësis çame drejtë shqipërisë kishte vazhduar edhe gjatë vitit 1944 deri në mares të vitit 1945 . Shumica e popullësis came në shqipëri merrëshin me punë krahi , kurse vetëm 5 % merrëshin me aktivitete tregtare . Kjo ishte gjendja e mjerueshme e çamëve në Shqipëri ku ata përballëshin edhe me mungesë të strehimit dhe kushteve tjera të jetës .[20]

Sipas regjistrimit të vitit 1991 të bëra nga shoqata patriotike "çamëria, popullësia me origjinë çame e vendosur në republikën e Shqipërisë arrinë në 204.255 banorë, kurse në bazë të shtimit natyrorë të popullësisë në 25 vitet e fundit llogaritet se numri i përgjithëshëm i popullësis çame arrinë në 300 mijë banorë ose 11% e popullësisë së regjistruar në vitin 2011 .[21]

---

[15] Po aty , fq 159 .

[16] ASHSH . Fjalori enciklopedik shqipëtar , Tiranë 2009 , fq 1924-1925 .

[17] SH. Maliqi , Nacionalizmima treba voditi kovatradni kopen , Thema nr.7 , Prishtinë 1986 , fq 44.

[18] Selmon Shema, çamëria , vep e cituar , fq 174.

[19] Arben ,p, Llalla , Kolaboracionistët grek porjektuesit dhe udhëheqësit e gjenocidit në çamëri , shb :Tringa Dising , Tetovë 2016 , fq 91.

[20] Historia e popullit shqipëtar , Grup Autorësh , Prishtinë , 2009 , fq 407.

[21] Selmon , Shema , vep e cituar , fq 194.

Sipas dokumenteve të departamentit të SHBA-ve nr 84/3 të misionit të Tiranës 1945-46 shkruhet : se në bazë të disa informative që kemi mundur ti mbledhim mbi çështjen çame nga viti 1944 deri në muajt e pare 1945 , autoritetet në Greqinë perendimore, kryen masakra brutale duke dëbuar me dhunë më shumë se 25 mijë came , banorë të çamërisë nga shtëpit e tyre ku jetonin me shekuj .Edhe sot e asaj dite në trevat e çamërisë vërehen gjurmët e krimit , pronat që i presin pronarët që të kthehen në tokat e gjakosura me gjakun e fëmijëve , grave shtatëzëna, e pleqëve që më shekuj mbijetuan robërinë .[22]

Janë me dhjetra mijra njerzë që kanë lindur në çamëri dhe afër 100 mijë nipa dhe mbesa që jetojnë sot në shqipëri dhe nuk ju lejohet të shkojnë në vendlindjet e tyre dhe në pronat e ligjëshme .[23]

Toponimi "çamëri" emri tipik i autoktonisë shqipëtare , emri "Epir" dhe "Epirot" ndeshet veçanarit në literaturën greke , kurse në literaturën shqipëtare përdorët emri populli i çamërisë për banorët e sajë .

Në lashtësi epiri banohej prej 14 fisësh , ndër të cilët kryesorët ishin thesprotët , kaonët dhe molosët , të cilët ishin etnikishtë të një trungu me ilirët .Deri më sot lidhur me prejardhjen e emrit çamëri janë marrur shumë studiues të huaj të shekullit XIX .

Studiuesi Anglez , William Leake , në fillim të shekullit XIX , fjalën came e nxjer me emrin e vjetër të kalamajtë , të emrit Thjamis , duke paraqitur një vazhdimësi jo greke.

Studiuesi Grek, Nikoleos Georgios Nikokles , mbështet tezën se fjala "came" do të thotë "Pisha" , ose vendi i banorëve të pyjeve me bredha, por këtë mendim e kundërshton studiuesi gjerman I. PH. Fallmenayer .

Duke mbrojtur mendimin se "Ndoshta emri i provinces bregdetare shqipëtare çamëri , nuk është i prejardhur as nga greqishtja as nga Turqishtja , por nga emri i stërlashtë i lumit "Thiamis" (sot lumi Kalama) [24]

Edhe prof Çabeja , vazhdimësin e këtyre dy termeve (Thiamis – Çam) shpjegohet në bazë të ligjëve të zhvillimit fonetik të shqipës , prandaj emrin çamëri e paraqet si emer tipik që vertetojnë autoktonin e shqipëtare në vendbanimet e tyre të sotme .[25]

Në reformat administrative të perandorit dioklecian në shekullin e III-të , epirin e quajtën si dy provincat e Ilirikut : Epiri i ri në trevat midis Vjosës e Matit

---

[22] Tahir, Veliu , Platforma për shqipëri të bashkuar, Tiranë, 2016, fq 88.

[23] Namik , Selmani, Biri i shquar i çamërisë , Ademzerteme , shb,"Mirgeeralb",Tiranë , 2016,fq 46.

[24] Grup autorësh , Epiri i jugut , Çamëria , shb, "UETE PRESS" Tiranë 2014 , fq 9-10.

[25] Çabej . E, Studime etimologjike në fushë të Shqipës , vepra III , Tiranë , 1987, fq 83.

, dhe epiri i vjetër që përfshin tokat nga Vjosa deri në Akarnani .[26]

As në kohën e sundimit romak, e as në mesjetë Epiri(çamëria) nuk konsiderohej si pjesë e Greqisë, edhe gjatë sundimit osman 5 shekuj me radhë bënte pjesë në vilajetin e janinës [27]

Në konferencën e ambasadorëve në Londër në vitin 1913 ,çamëria ju aneksua Shqipërisë , kurse kufinjët politik ndikuan në jetën ekonomike , në tregun unik-kombëtar por në përbërjen demografike të sajë . Por megjithatë emri"Epir" u shua nga përdorimi i popullësis shqipëfolëse dhe mbeti vetëm në literaturen Greke .

"Çamëria", shkruan shkrimtari Ismajl Kadare , - Nuk është fantazmë që ngrihët për të errësuar miqësinë midis Grekëve dhe Shqipëtarëve përkundrazi , kur popujt lehtësojn ndërgjegjjen e tyre nga peshat e vjetra ata afrohën më shumë dhe e duan më shumë njëri tjetrin .[28]

Çështja çame në përfundim të luftës së dytë botërore kaloi si rrjedhojë e një problemi refugjatësh që kërkohej ndihmë materiale , të nevojshme për mbijetesë dhe sistemim , siq është shembulli UNRRA-së dhe ndihma ekonomike prej 1.2 milionë dollarësh dhënë në vitin 1946 .

Qeverija komuniste në Shqipëri gjatë vitit 1944-45 kishte qëndrim kryesisht ideologjik , duke e zënë vendin e pare mbi interesin kombëtar shqipëtar .Ka arsyeje të besojmë se çamët me përkrahjen e Qeverisë komuniste të Tiranës do të kishin shtruar "Problemin e çamërisë" si një problem politik duke kërkuar kthiminm e menjëherëshem të çamëve në trojet e tyre .

Një trajtim i këtill i çamëve në Shqipërinë komuniste të Enver Hoxhës dha mundësin për interpretimet greke antishqipëtare .Kështu një autor Grekë shkruan se regjimi komunistë "Problemin e çamëve u lah në harresë".Regjimi komunistë e priti në mosbesim të madhë të gjithë ata came që u arratisën nga Greqia në Shqipëri në vitin 1944.Në shqipëri duke i pare si bashkëpunëtor të fashizmit Italian dhe një pjesë u transferua në veri të vendit .[29]

Në vitin 1947, qeveria komuniste morri të gjitha masat e nevojshme për të u hequr çamëve nënshtetësinë Greke (Pro.49343 E/2/10.1947, Ministria e brendëshme) duke u bazuar në akuzat për bashkëpunim dhe veprim kundër interesave të popullit grekë .

Kështu në vitin 1953 , refugjatët came në Shqipëri u detyruan të marrin

---

[26] ASHSH , Ilirët dhe Ilira të autorëve anticë , Tiranë, 1969, fq 357-376.

[27] Sheme, Selman , Hyseni, Adem , Çështja Çame dhe integrimi Evropian, shb"Alberia" 2005, fq 27.

[28] Grup autorësh , Epiri i Jugut , çamëria , veper e cit , fq 12 .

[29] Grup autorësh , Epiri i Jugit , Çamëria , shb "UETpress"Tiranë 2014 ,fq 89.

nënshtetësin Shqipëtare , një aktë që veshtërsoi shumë problemin e kthimit të tyre në çamëri , kurse prania çame në jetë publike Shqipëtare mori një karakter margjinal , që u shpejtua në procesin e asimilimit të tyre në shoqërinë Shqipëtare .

Si rjedhim i qëndrimit antikombëtar të qeverisë komuniste Shqipëtare 1944-1991 , zhvillimet e problemit came mbasë vitit 1945, kanë të bëjnë me dëshirën për ruajtjen e identitet came në Shqipëri , dhe më pak me përpjekjet për të drejtat e tyre të kthimit në vendet e tyre të grabitura .

Me themelimin e shoqatës patriotike "**Çamëria"** , mbas vitit 1991, dhe me programin e sajë krijohet mundësia që të punohet për "mbrojtjen dhe njohjen e të drejtave të çamëve"

Sot,"Problemi came shikohet si një rastë flagrantë i shkeljes massive të të drejtave të njeriut , kësaj populllësi të shprengulur me dhunë nga ana e qeverisë Greke .[30]

Mundësi për zgjedhjen e çështjes çame, sipas professor Sabri Godo është : Çamëve , që jetojnë në Shqipëri , t'u rukthehet nënshtetësia Greke.

Që shteti Grek tu njohë dhe tua kthej çamëve tokat .

Që komitetit came në Greqi ti njihet e drejta e pakicave etnike , sipas standardeve të demokracisë. Kjo është me rëndësi që të formohet një platëformë e qartë, si bazë për veprimtarinë studimore e politike të sajë[31]

KONKLUZIONE

Nga kjo paraqitje dhe analizë e shkurtë për çështjë çame, kemi arritur në përfundim se kjo çështje meriton një trajtim të veçantë , duke filluar nga lindja e problemit came, në konferencen e ambasadorëve të Londrës 1912-13, të luftës së pare dhe të dytë botërore dhe të periudhës së sistemit komunal, e cila përkundër disa përpjekjeve nuk bënin ndonje veprim konkret për çështjen çame.

Të mbroshë sot çështjen çame Shqipëtare është një detyrim moral dhe kombëtar, në historinë retrospective të Shqipërisë çështja çame ze një vend të rëndësishëm, nga vet fakti që si një vlerë në historiografinë shqipëtare mbetet idea e bashkimit kombëtar që nga lidhja e Prizerenit, ide që mundë rikonstruktohet nga mendimi shkencoro shqipëtar, sepse faktori Shqipëtar në ballkan nuk ka pse të jetë derivate i kombeve të tjera edhe në të ardhmen, Prandaj çështja çame kerkon jo vetëm vemendje politike por edhe shkencore dhe historiografike jo vetem morale por edhe juridike dhe te drejtësisë nderkombëtare.

---

[30] Po aty, fq, 90.

[31] Godo, Sabri , Mundësia për zgjedhje e çështjes çame , shb"Arbëria " Tiranë , fq 109 Konferenca shkencore e 26 Qershorit 2004 .

Por si rezultat i paraqitjes se pluralizmit politik në shqipëri dhe të krijimit të shoqëris politike- atëdhetare Çamëria në vitin 1991, filloi sensibilizimi i çështjes çame, dhe sot shumica e partive politike në shqipëri, e kanë në programin e tyre çështjen çame për të cilën duhet ta kenë të gjitha partite shqipëtare pavarsisht ku veprojnë.

Sot veprimëtaret e çështjes kombëtare, në Evropë para forumeve ndërkombëtare politike dhe diplomatike nuk duhet trajtuar këtë çështje vetëm në dimensionin human, por edhe në atë politik dhe diplomatik.

Çështja çame duhët të shikohet në këndëvështrimin shumë dimensional, jo vetëm si çështje politike por edhe si çështje kombëtare, historiografike dhe shkencore.

Dërgimi i dosjes çame në gjykaten ndërkombëtare të drejtësisë në Hagë, dhe zënia vend ne agjenden nderkombetare të çështjes çame është hapë i guximshëm i qeverisë shqiptare dhe veprimtarëve tjerë në shqipëri dhe diasporë .

BURIME DHE LITERATURA

1. ASHSH , Ilirët dhe Ilira të autorëve anticë , Tiranë, 1969.
2. Abazi, Sylejman "Çamëria rikthim tek lavdia e etërve të dikurshëm" , shb " Dajti 2000" Tiranë 2007 .
3.ASHSH . Fjalori enciklopedik shqipëtar , Tiranë 2009 ,
4.AQSH , Fondi 251 , viti 1921 , Dosja 44 , fq 82-85 ,dokumenti për çamërin 1912-1939,Tiranë 1999.
5. Beqiri,M. Resmie "Lot'i brengosur" , shb "Triptik",Vlorë 2015.
6. Culaj, Lush Shqipëria dhe çështja e çamërisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2006 .
7.Durham, Edit," Njëzet vjet ngatrresa ballkanike" , Tiranë 1944 .
8.Godo, Sabri , Mundësia për zgjedhje e çështjes çame , shb"Arbëria " Tiranë Konferenca shkencore e 26 Qershorit 2004
9. Grup autorësh , "Epiri i Jugit , Çamëria" , shb "UETpress"Tiranë 2014.
10.Çabej . E, Studime etimologjike në fushë të Shqipës , vepra III , Tiranë , 1987.
11.Grup autorësh , Epiri i jugut , Çamëria , shb, "UETE PRESS" Tiranë 2014 .
12.Historia e popullit Shqipëtar , Grup autorësh , Prishtinë , 2016
13.Historia e popullit shqipëtar , Grup Autorësh , Prishtinë , 2009 .
14.Historia e popullit Shqipëtar III , Tiranë 2007.
15.Llalla, P.Arben. "Kolaboracionistët Grek projektuesit dhe udhëheqësit e genocidit në çamëri" , shb "Tringa design "Tetovë 2016 .
16.Peacock, Wadhan "Shqiperia shtet jetim i Evropes", Fejton, Koha Ditore 16.04.2017

, Selmani, Namik “Biri i shquar i çamërisë”, Ademzerteme , shb,” Mirgeeralb”,Tiranë , 2016.
17. Selman, Sheme, Hyseni, Adem , Çështja Çame dhe integrimi Evropian, shb”Alberia” 2005.
18. SH. Maliqi , Nacionalizmima treba voditi kovatradni kopen , Thema nr.7 , Prishtinë 1986
19. Sheme,Selman. “Dokumente natyrore dhe kulturore të çamërisë”, botoi, “West Print”, Tiranë 2012.
20. Shema, Selman. “Çamëria , Vështrim Gjeopopullativ dhe etnokulturor” , shb “Dea Print “ , Tiranë 2016.
21. Shema, Selman “Çamëria – vendi , populësia dhe jeta ekonomike” , Tiranë 2005 .
22. Veliu, Tahir “Platforma për shqipëri të bashkuar”, Tiranë, 2016.

Prof.as.dr. Florian BJANKU

GARANCITË PËR T'U SIGURUAR VETËQEVERISJA VENDORE

Abstrakt

Aktualisht, Shqipëria është në një fazë të thellë reformash në sfidën për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore nëpërmjet përparimit të procesit të decentralizimit sipas standardeve evropiane. Në këtë punim qeverisja vendore nuk trajtohet vetëm si ndarje administrative vertikale të pushtetit apo si një mënyrë e organizimit të administratës publike. Më shumë theksi vihet tek vetëqeverisja si shprehje të shkallëzimit të demokracisë, si një pjesë përbërëse dhe formuese e shtetit demokratik. Në funksion të këtij koncepti, vetëqeverisja nuk është një e drejtë themelore, por një parim kushtetues që përmban garanci institucionale. Këto garanci lidhen me ekzistencën e organeve të qeverisjes vendore dhe me ushtrimin e kompetencave të tyre brenda juridiksionit që u është dhënë. Elementet e vetëqeverisjes të këyre organeve janë të lidhura jo vetëm me ekzistencën e tyre si institucione, por edhe me kompetencat që ushtrojnë.

Guarantees to ensure local self-government

Abstract

Currently, Albania is in a deeper stage of reform in the challenge of strengthening local government and democracy through the progress of the decentralization process according to European standards. In this paper, local government is not only treated as vertical administrative division of power or as a way of organizing public administration. Mostly, emphasis is placed on self-government as an expression of the escalation of democracy as an integral and forming part of a democratic state. In terms of this concept, self-government is not a fundamental right, but a constitutional principle that contains institutional guarantees. These guarantees relate to the existence of local government bodies and the exercise of their competences within the jurisdiction granted to them. Elements of self-government of these bodies are linked not only to their existence as institutions but also to the competencies they exercise.

I. Hyrje

Koncepti i vetëqeverisjes së pushtetit lokal është një ide relativisht moderne, i cili lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e qeverisjes në tërësi dhe me shërbimin sa më të mirë kundrejt shtetasve në veçanti. Ajo ka si kusht kryesor ekzistencën e njësive administrative me qëllim realizimin e funksioneve të veta.

Fjalori i Oxfordit qeverisjen vendore e sheh si: "*Institucion qeverisës që ushtron autoritetin në një zonë territorialisht të përcaktuar të vendit*".[1] Sipas këtij përkufizimi, mund të konstatohet që qeverisja vendore ka të bëjë me një qeverisje të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokal e që aktivitetin dhe pushtetin e vet e shtrinë në një hapësirë të ngushtë, të përcaktuar brenda një shteti. Kështu, me të drejtë mund të konstatohet që "qeverisja territoriale, përkatësisht qeverisja me njësitë territoriale, është një proces shumë i përbërë dhe mund të thuhet se përbëhet nga shumë funksione, përkatësisht veprimtari".[2] Vetëqeverisja lokale paraqet formë të udhëheqjes së bashkësive lokale ku qytetarët, direkt ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale.

Këto njësi nuk duhen parë vetëm si ndarje administrative vertikale të pushtetit apo si një mënyrë e organizimit të administratës publike. Më shumë ato duhen konceptuar si shprehje të shkallëzimit të demokracisë, si një pjesë përbërëse dhe formuese e shtetit demokratik[3]. Ideja ku u mbështet si fillim koncepti i vetëqeverisjes lokale, ishte përfshirja më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje që lidhen me interesat e tyre, duke realizuar kështu edhe demokracinë funksionale nga poshtë lart. Në funksion të këtij koncepti, vetëqeverisja nuk është një e drejtë themelore, por një parim kushtetues që përmban një garanci institucionale[4]. Kjo garanci lidhet me ekzistencën e NJQV-ve si të tilla dhe me ushtrimin e kompetencave të tyre brenda juridiksionit që u është dhënë.

Përtej zgjidhjeve tranzitore pas rënies së regjimit monist, organizimi dhe funksionimi aktual i organeve te qeverisjes vendore dhe reforma e decentralizimit në Shqipëri është paraprirë nga plotësimi gradual i infrastrukturës ligjore dhe nënligjore në fushat përkatëse, sipas kërkesave dhe parimeve të:

---

[1] Iain Mc Lean. Fjalor Politik. Tiranë, 2001, faqe 479

[2] Esat Stavileci: Hyrje në Shkencat Administrative. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës. Prishtinë, 1997, Fq. 247

[3] Shih: Vendim i GJKF-së gjermane BverfGE 52, 95 (111). Burim i cituar, Vendimi nr. 19 datë 15.04.2015 i Gykata Kushtetuese.

[4] Horst Dreier, Grundgesetzkommentar – Komentar i Ligjit Themelor Gjerman (1998) fq.523. Burim i cituar, Vendimi nr. 19 datë 15.04.2015 i Gykata Kushtetuese.

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 1998;
- Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore (1985), ratifikuar në vitin 2000;
- Konventës kuadër Europiane mbi bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet bashkësive vendore dhe autoriteteve territoriale, (1980), ratifikuar në vitin 2002[5].
- Konventës "Për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal (1992), ratifikuar në vitin 2005;
- Strategjive Kombëtare të Decentralizimit[6]

I. DIMENSIONET KUSHTETUESE TË AUTONOMISË VENDORE

Në përmbushje të standardeve dhe parimeve të organizimit të qeverisjes vendore në hapësirën e vendeve europiane me demokraci të zhvilluar, ku themeli i autonomisë vendore duhet të njihet në legjislacionin e brendshëm dhe, po të jetë e mundur, nga ligji themelor i shtetit[7], Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ka dedikuar vëmendjen e duhur kësaj kërkese dhe ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të ***decentralizimit të pushtetit*** dhe ushtrohet sipas parimit të ***autonomisë vendore***[8]. Përkatësisht në nenin 13 të Kushtetutës përcaktohet se: "*Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Ndarjen e kompetencave, shperndarjen dhe perdorimin e financimeve*". Megjithatë duhet të theksojmë që në fillim se autonomia nuk do të thotë pavarësi e plotë e njësive të qeverisjes vendore, sepse do të binte ndesh me parimin tjetër kushtetues, atë të unitetit. Gjithashtu, autonomia nuk nënkupton qeverisje pa kontroll, i cili natyrisht duhet të jetë i mbështetur në ligj dhe në proporcion me interesat e publikut. Në këtë kuptim vetë Kushtetuta përcakton se Shqipëria është një shtet unitar, pavarësisht se ka parashikuar dy nivele të pushtetit vendor:

---

[5] Protokolli shtesë i Konventës Europiane kuadër mbi bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet bashkësive vendore dhe autoriteteve territoriale (9.11.1995), i ratifikuar me 12 mars 2002.

[6] Në periudhën e reformave decentralizuese pas miratimit të Kushtetutës bëhet fjalë për Strategjinë Kombëtare të Decentralizimit, e miratuar më 1999-n. Aktualisht procesi strategjik i qeverisë në kuadër të decentralizimit drejtohet sipas VKM Nr. 691, datë 29. 7. 2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020".

[7] Shih nenin 2 të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore (1985), ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000;

[8] Neni 13, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr.8417, datë 21/10/1998)

bashkia, si nivel i parë, dhe qarku si niveli i dytë për bashkërendimin e njësive të qeverisjes vendore nëpërmjet politikave rajonale. Kushtetuta garanton autonominë politike, administrative, normative dhe financiare të organeve vendore. Pra, ajo demonstron në nivelin evropian vullnetin politik për t'i dhënë jetë në të gjitha nivelet e administrimit territorial parimeve të mbrojtura edhe nga Këshilli i Evropës nëpërmjet Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, e cila e konsideron se niveli i vetëqeverisjes që gëzohet nga të gjitha organet vendore mund të konsiderohet si gur prove i demokracisë së vërtetë.

Në Kushtetutë dhe në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore ndeshemi me këto dimensione kryesore të autonomisë:

- ***Autonomia politiko-administrative,*** pasqyrohet në faktin se organet e njësive vendore janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Te zgjedhura drejtpërdrejt (ose jo drejtperdrejt, si në rastin e qarkut) nga populli, ato nuk ***kanë asnjë varësi*** politike nga ndonjë organ tjeter shteteror.
- ***Autonomia normative:*** Autonomia normativeshprehet pikësëpari në faktin se, që në Kushtetetutë parashikohet që organet e të dy niveleve njesive të qeverisjes vendore nxjerrin vendime, urdhra dhe urdhëresa.
- ***Autonomia Financiare*** është një nga aspektet më thelbësore të autonomisë vendore, por njëkohësisht edhe një nga aspektet më problematike dhe delikate në zbatimin në praktikë. Kjo përbën një garanci, jo vetem për realizimin e asaj vetë, por edhe për arritjen e autonomisë politike, normative dhe administrative**.** Kjo formë e autonomisë nënkupton ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113/b,c,ç të Kushtetutës);

Megjithëse në kohën kur u hartua dhe u miratua Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ishte ratifikuar akoma Karta e Autonomisë Vendore, teksti i Kushtetutës së vitit 1998 ka ecur në të njëtën linjë me parimet e saj, e cila do të ratifikohej pak kohë më pas[9].

Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, në nenin 3 thekson se: "*1.Me autonomi vendore kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsive të tyre, një pjese të mirë të çështjeve publike. 2. Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asambletë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre. Kjo dispozitë nuk i pengon qytetarët të mblidhen në kuvende, referendume apo çdo formë tjetër të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të*

[9] Bjanku, Florian "Vetëqeverisja vendore" (cikël leksionesh; ISBN 978-9928-178-70-1, ILAR, Tiranë 2016)..

tyre aty ku lejohet nga ligji".

Në bazë të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, e cila që nga momenti i ratifikimit është bërë pjesë e sistemit tonë të brendshëm juridik, autonomia vendore varet nga rëndësia që i kushtohet respektimit të këtyre kushteve[10]:

- Kompetencat bazë të bashkësisë vendore caktohen nga Kushtetuta ose nga ligji. Megjithatë kjo dispozitë nuk i pengon njësitë vendore të marrin kompetenca me qëllime të posaçme, në përputhje me ligjin. Në rastin e Shqipërisë kompetencat bazë të njësive të qeverisjes vendore parashikohen direkt nga Kushtetuta dhe ligji organik i vetëqeverisjes vendore i detajon ato më tepër.
- Njësitë vendore gëzojnë, brenda ligjit, liri të plotë për të ushtruar iniciativën e tyre për çdo çështje që nuk është jashtë kompetencës së tyre apo që mund t'i ketë kaluar një autoriteti tjetër.
- Ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke patur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë e të ekonomisë. Ato mund të diskutohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qëndror apo rajonal vetëm brenda ligjit.
- Në rast se kompetencat i kalojnë një autoriteti qendror apo rajonal, bashkësitë vendore duhet të gëzojnë, brenda mundësisë, lirinë që ushtrimin e tyre t'ia përshtasin kushteve vendore.
- Njësive vendore duhet t'u kërkohet mendimi brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatëshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti.
- Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t'u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji.
- Duke ruajtur dispozitat më të përgjithshme, të krijuara nga ligji,
- bashkësitë vendore mund të përcaktojnë vetë strukturat e brendshme administrative me të cilat duhet të pajisen, me synimin që t'ia përshtasin ato nevojave të tyre specifike dhe të sigurojnë një drejtim efikas.
- Statuti i personelit të bashkësive vendore duhet të mundësojë një rekrutim cilësor njerëzish, bazuar në parimet e meritës e të aftësisë; për këtë qëllim ai duhet të përmbledhë kushtet e duhura të formimit, të shpërblimit dhe të perspektivave të profesionit.

Në të njëjtën logjikë me parimet e Kartës, Nenet 108-115 tek pjesa e

[10] Shih nenet 4 e vijim të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore (1985), ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000;

gjashtë e Kreut IV të Kushtetutës përcaktojnë nivelet e autoriteteve të qeverisjes vendore, ngritjen dhe funksionimin e tyre si dhe të drejtat dhe funksionet kushtetuese.

Në përputhje me autonominë e tyre ato ushtrojnë funksionet e tyre, të cilat janë fushat e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të saj, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore. Funksionet mund të jenë ekslusivisht të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe në disa raste mund të jenë të deleguara nga pushteti qendror. Në këtë aspekt një rëndësi të veçantë merr konsultimi si proces institucional, këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinioneve për politikat, legjislacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.

II. GARANCITË QË OFRON LIGJI ORGANIK I VETËQEVERISJES VENDORE

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Autonomia vendore është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe ligjit organik, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore[11].

Vetëqeverisja sipas ligjit organik të vetëqeverisjes vendore siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

d) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

[11] Kreu ii Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton dispozitat e përgjithshme që përfshijnë objektin dhe misionin e ligjit, përkufizimet dhe parimet themelore.

e) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
f) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
g) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Sa më sipër konstatojmë se Kushtetuta dhe ligji organik nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" kanë sanksionuar parimet e autonomisë vendore në të njëjtën linjë me përshkrimin që i gjejmë edhe tek Karta Europiane e Autonomisë Vendore sa i takon: Themelit kushtetues e ligjor të autonomisë vendore; konceptit tëautonomisë vendore, misionit të qeverisë vendore; rëndësisë së autonomisë vendore; mbrojtjes së kufijve territorialë të bashkësive vendore; përshtatjes sëstrukturave dhe mjeteve administrative,kushteve tëushtrimit të përgjegjësive në nivel vendor; kontrollit administrativ të veprimeve të bashkësive vendore; burimeve financiare të bashkësive vendore; të drejtës për asosiacion të bashkësive vendore dhe mbrojtjes ligjore të autonomisë vendore[12].

II. STRATEGJIA DHE PRESPEKTIVAT E DECENTRALIZIMIT

Përveç parashikimeve dhe parime kushtetuese në Shqipëri decentralizimi është trajtuar si një strategji kombëtare. Në periudhën e reformave decentralizuese pas miratimit të Kushtetutës bëhet fjalë për Strategjinë Kombëtare të Decentralizimit, të miratuar më 1999-n. Aktualisht procesi strategjik i qeverisë në kuadër të decentralizimit drejtohet Strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020, miratuar me VKM Nr. 691, datë 29.7.2015. Vizioni i kësaj strategjie të qeverisëështë: *"Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe i procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet një efikasitet më i lartë i vetë qeverisë vendore dhe rritje e autonomisë financiare dhe funksionale"* që ndjek parimet dhe standardet e përcaktuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe parimet e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore.

Për të arritur këtë vizion gjatë periudhës 2015 – 2020 qeveria zotohet se:

- Përmirësimin e procesit të decentralizimit të financimit publik;
- Rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimeve publike të siguruara nga

[12] Bjanku, Florian "Vetëqeverisja vendore" (cikël leksionesh; ISBN 978-9928-178-70-1, ILAR, Tiranë 2016).

qeveria vendore, në bazë të standardeve evropiane, duke iu përgjigjur të drejtave dhe nevojave të qytetarëve;

- Rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë e qeverisë vendore;
- Rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, në veçanti, të grave dhe do të sigurojë një përfaqësim adekuat të interesave të tyre, si dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e vendimmarrjes së qeverisjes vendore. Qëllimet strategjike kryesore të reformës së ardhshme të decentralizimit dhe qeverisjes vendore, si edhe të përparësive të politikave do të jenë si më poshtë. Çdo qëllim strategjik do të arrihet nëpërmjet plotësimit të objektiva strategjikë dhe objektivave specifikë.

Kjo strategji synon një përqasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, si edhe me ato të Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal. Për më tepër, në këndvështrimin e aksesit progresiv në BE, strategjia përfshin elemente thelbësore të Kartës Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Veprimtarinë Lokale[13].

Përgatitja e SKNDQV 2015–2020 u bë në të njëjtën periudhë kur po hartoheshin disa strategji dhe dokumente politike të reja për të njëjtën periudhë 2015–2020. Një qasje e tillë programimi është bërë në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar, me qëllim harmonizimin më të mirë të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të artikuluar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020. Procesi i hartimit të njëkohshëm të disa strategjive dhe reformave të politikave të ndryshme sektoriale dhe ndërsektoriale, kontribuon në harmonizimin më të mirë dhe vijimësinë e tyre, përfshirë këtu edhe reformat për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, duke i kushtuar vëmendje lidhjes së kësaj strategjie ndërsektoriale me ato të sektorëve përkatës, përkatësisht me strategjitë sektoriale në fushën e menaxhimit të financave publike, strategjinë e reformës në administratën publike, strategjinë e mjedisit, strategjinë e shërbimeve sociale, planin kombëtar për rininë 2015–2020, planin kombëtar operacional për mbrojtjen civile, strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe një sërë dokumentesh të tjera strategjike në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, transportit, turizmit, barazinë gjinore, zhvillimit ekonomik etj. Strategjia merr parasysh kuadrin ekzistues ligjor dhe politik, arritjet dhe mangësitë e politikave strategjike të mëparshme, kërkesat e vendosura për rritjen e eficiencës së shërbimeve publike, fuqizimin e qeverisjes vendore, si dhe procesi i integrimit evropian dhe parimet e praktikave më të mira në BE. Në të njëjtën kohë, strategjia merr parasysh edhe statusin

[13] Cit. Council of European Municipalities and Regions (2006). The European Charter for Equality of women and men in local life. A Charter for Europe's local and regional governments to commit themselves to use their powers and partnerships.

aktual dhe veçoritë specifike të zhvillimit të qeverisjes vendore në Shqipëri[14]. Gjithsesi, pavarësisht se misioni dhe parimet e vetëqeverisjes vendore tashmë janë të qarta dhe të mbrojtura nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, strategjitë kombëtare dhe ligji organik, zbërthimi i tyre legjislativ dhe praktik nuk paraqitet aspak i lehtë.

II. ***KONKLUZIONE***

Elementet e vetëqeverisjes së NJQV-ve janë të lidhura jo vetëm me ekzistencën e tyre si institucione, por edhe me kompetencat që ushtrojnë. Në përmbledhje të garancive të trajtuara në këtë punim, të ofruara nga Kushtetuta; Karta Europiane e Autonomisë Vendore; ligji organik i vetëqeverisjes vendore; strategjisë kombëtare të decentralizimit, si dhe nga autori i së drejtës gjermane Horst Dreier, referuar edhe në Vendimin nr. 19 datë 15.04.2015 të Gykata Kushtetuese, mund të konkludojme se koncepti i vetëqeverisjes lidhet me 3 garanci:

a) ***Garancia institucionale***– NJQV-të kanë të drejtë të ekzistojnë si subjekte të së drejtës publike, të cilat krijohen dhe organizohen me ligj. Ligjvënësi ka të drejtë në këtë aspekt të respektojë autonominë gjatë krijimit të tyre, do të thotë se ligjvënësi nuk ka të drejtë t'i suprimojë të gjitha njësitë vendore në atë shkallë sa të bëjë të pamundur realizimin e qeverisjes vendore në thelb, por as edhe t'i prekë kompetencat e tyre deri në atë pikë sa t'i bëjë ato të pamundura për t'u ushtruar. Mbrojtja institucionale e organeve të qeverisjes vendore nuk është individuale, por institucionale, gjë e cila do të thotë se nga kjo garanci nuk rrjedh detyrimisht ekzistenca dhe statusi i njësive vendore të veçanta, por i të gjitha njësive vendore, si bashkësi njësish që realizojnë vetëqeverisjen në shkallë vendi. Rrjedhimisht, ndryshimi i kufijve të NJQV-ve është i mundur, por gjatë këtij ndryshimi duhen respektuar kriteret formale dhe materiale.

b) ***Garancitë objektive***– NJQV kanë të drejtë të ushtrojnë kompetencat e tyre të dhëna me ligj pa u penguar nga pushteti qendror. Ushtrimi i tyre lidhet si me anën formale ashtu edhe me atë materiale, me qëllim realizimin e funksioneve të tyre brenda konceptit të vetëqeverisjes. Ligjvënësi në çdo rast ka detyrimin të respektojë autonominë e NJQV-ve me qëllim mospengimin e tyre në realizimin e funksionit për të cilin ato janë krijuar.

c) ***Garancitë subjektive***– NJQV-të kanë të drejtë të përdorin mjete juridike të krijuara, me qëllim mbrojtjen e tyre nga ndërhyrjet e pajustifikuara të ligjvënë-

[14] Shih: VKM Nr. 691, datë 29.7.2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020"

sit, kur ato kanë bindjen se autonomia e tyre është cenuar në thelb. Pretendimet e NJQV-ve mund të lidhen me: konsultimin e tyre nga qeveria/ligjvënësi për ndërmarrjen e reformave të çdo lloji që prekin edhe NJQV-të; bashkëpunimin gjatë proceseve të planifikimit urban, etj. Procesi i konsultimit, p.sh mund të realizohet nëpërmjet dëgjimit, këshillimit apo bashkëpunimit nga ana e NJQV-ve deri në procesin vendimmarrës.

BIBLIOGRAFIA

- Bjanku, Florian "Vetëqeverisja vendore" (cikël leksionesh; ISBN 978-9928-178-70-1, ILAR, Tiranë 2016).
- *Charte européenne de l'autonomie locale et rapport explicatif*. Botim i Këshillit të Evropës ; F-67075 Strasbourg Cedex; ISBN 92-871-0860-9 © Këshilli i Evropës, 1986. Karta Evropiane të Autonomisë Vendore (1985), ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000.
- Esat Stavileci: Hyrje në Shkencat Administrative. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës. Prishtinë, 1997.
- Horst Dreier, Grundgesetz; kommentar (Komentar i Ligjit Themelor Gjerman)/ Grundgesetz-Kommentar, Bd. 1 (Art. 1–19), Tübingen 1996, 2. Aufl. 2004, 3. Aufl. 2013; Bd. 2 (Art. 20–82), Tübingen 1998, 2. Aufl. 2006, 3. Aufl. 2015; Supplementum zu Bd. 2, Tübingen 2007; Bd. 3 (Art. 83–146), Tübingen 2000, 2. Aufl. 2008; Supplementum zur 2. Aufl., Tübingen 2010 (als Herausgeber und Mitautor).
- Iain Mc Lean. Fjalor Politik. Tiranë, 2001.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr.8417, datë 21/10/1998)
- Protokolli shtesë i Konventës Europiane kuadër mbi bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet bashkësive vendore dhe autoriteteve territoriale (9.11.1995), i ratifikuar me 12 mars 2002.
- The European Charter for Equality of women and men in local life. A Charter for Europe's local and regional governments to commit themselves to use their powers and partnerships.
- Vendimi nr. 19 datë 15.04.2015 i Gykata Kushtetuese
- VKM Nr. 691, datë 29.7.2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020"

PhD Edona ZENELI

"TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE NDIKIMI I TIJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË SHQIPËRISË"

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohet një temë mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Do të njiheni me tregun e pasurive të paluajtshme, me zhvillimin e tij gjatë viteve të fundit si dhe me ndikimin që ky treg ka mbi ekonominë e vendit.

Lexuesit do të njihen me situatën aktuale të tregut të pasurive të paluajtshme në Shqipëri, me prespektivën që ka ky treg për vitet e ardhshme, me problematikat e zhvillimit të tij si dhe me rolin e tij në rritjen e të ardhurave dhe investimeve në vend.

Të dhënat kryesore për realizimin e këtij punimi janë marrë nga dhoma kombëtare e noterisë mbi aktet noteriale të kryera gjatë vitit të fundit në kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme si dhe të akteve të dhënies me qera.

Analizimi i këtyre të dhënave do të jetë mjaft i detajuar duke u bazuar në transaksione faktike të kryera gjatë viteve të fundit. Konkluzionet dhe përfundimet e këtij punimi do të jenë të bazuara në analizën e informacionit të grumbulluar.

Fjalët kyçe: Treg, pasuri e paluajtshme, zhvillim ekonomik, pronësi.

Hyrje

Tregu i pasurive të paluajtshme është një faktor tepër i rëndësishëm i cili ndikon ndjeshëm në zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Në vendin tonë ka shumë autorë që kanë studiuar tregun e pasurive të paluajtshme apo aktivitete të tjera lidhur me pasuritë e paluajtshme. Pasuria e paluajtshme, toka dhe ndërtesa përbëjnë një nga pasuritë më me vlerë për çdo shtet dhe çdo individ.

Tregu i pasurive të paluajtshme në Shqipëri e ka zanafillën e tij pas viteve 1990. Gjatë periudhës 1990-2017 ky treg ka pësuar ndryshime të mëdha. Pas vitit 1991 në vendin tonë u krijuan dhe u përpiluan ligje dhe reforma për privatizimin e

ekonomisë, intitucione përgjegjëse për trajtimin e pronave si dhe legjislacioni përkatës për trajtimin e çështjeve të pronësisë.

Ajo çka ndodhi në Shqipëri ishte, që tregu i banesave, u privatizua pothuajse në masën 90%, dicka pak a shumë e ngjashme me tregun amerikan të banesave, ku vetëm 2% e fondit të banesave është pronë publike.

Privatizimi krijoi mundësi pronarëve të rinj, të shesin banesat tashmë pronë e tyre private dhe përdorimin e fondeve, si pagesa të plota ose të pjesshme për banesa të reja, duke krijuar kështu premisat për krijimin e tregut primar dhe atij sekondar të banesave.

Pasuritë e paluajtshme janë investime afatgjata dhe për këtë arsye janë një nga objektet më të rëndësishme si dhe më të synuara nga sipërmarrësit dhe nga individët. Zhvillimi i ekonomisë së një vendi është element mjaft jetësor për mbarëvajtjen dhe ekzistencën e një shteti dhe si i tillë faktori kyç që ndikon në zhvillimin e saj është tregu i pasurive të paluajtshme, për këtë arsye analizimi i këtij faktori dhe evidentimi i efektit të tij në ekonomi, do të trajtohen në këtë punim shkencor.

Synimi kryesor i këtij punimi është të pasqyrojë tablonë reale të tregut të pasurive të paluajtshme si dhe të vërtetojë si ka ndikuar ky treg në zhvillimin ekonomik të vendit. Për shkak të eksperiencës sime në fushën e pasurive të paluajtshme si dhe për shkak të interestit të vazhdueshëm në këtë fushë, jus jell punimin tim me fakte dhe analiza të cilat vërtetojnë rolin e rëndësishëm që ky treg ka në zhvillimin ekonomik.

Për realizimin e këtij punimi do të kryhet një studim i kontratave të kalimit të pronësisë gjatë tre vjeçarit të fundit pra përkatësisht për vitet 2015-2017. Gjithashtu do të përdoren edhe statistikat nga instituti i statistikave (INSTAT) lidhur me lejet e ndërtimit të dhëna gjatë po kësaj periudhe.

1.1 Pasuritë e Paluajtshme, llojet dhe vlerësimi i tyre

Pasuritë e paluajtshme janë të shumëllojshme, elementët dhe karakteristikat që e bëjnë një pasuri të paluajtshme unike janë përmasat, vendndodhja, gjendja fizike, lloji, etj. Dy kategoritë kryesore të përdorura për të klasifikuar pasuritë e paluajtshme janë: **Pronat Rezidenciale** dhe **Pronat jorezidenciale**.

Prona rezidenciale quhen të gjitha ato prona që plotësojnë kushtet për të qenë rezidente ose të banueshme nga individë ose familje. Pronat rezidenciale mund të jenë për një familje të vetme (shtëpi, vila), ose mund të jenë për disa familje (apartamente).

Pronat jorezidenciale janë ato prona që nuk shërbejnë për banim por në varësi të qëllimit që ato përdoren klasifikohen në disa kategori:

➢ ***Pronat Komerciale*** janë pronat që përfshijnë ambjentet që përdoren për shitje me pakicë. Por nuk mungon edhe kombinimi i të dy llojeve të pronave atyre rezidenciale dhe jorezidenciale ku mund të përmendim qendrat e ndryshme të biznesit të cilat katet e para i përdorin kryesisht si njësi komerciae dhe pjesën e sipërme të ndërtesave e përdorin si njësi banimi. Kjo është karakteristikë e ndërtimeve të pas viteve 90' në Shqipëri.

➢ ***Pronat Industriale*** janë prona të ndërtuara për përdorime specifike si industria e lehtë, industria e rëndë, përdoren edhe për magazine. Karakteristika e këtyre pronave është fakti që nuk përshtaten lehte për përdorime të tjera.

➢ ***Hotelet dhe motelet*** janë prona të cilat ndryshojnë nga madhësia si dhe nga pozicioni ose vendndodhja e cila përcakton dhe lehtësirat që ofron prona.

➢ ***Pronat për shplodhje dhe argëtim*** janë ajo kategori pronash ku bëjnë pjesë komplekset sportive, shtëpitë e pushimit, etj.

➢ ***Pronat Institucionale*** kryesisht janë prona në pronësi të shtetit. Janë ndërtuar për qëllime specifikime dhe nuk përshtaten për qëllime të tjera. Të tilla klasifiokohen, agjencitë, shtetërore, spitalet, shkollat, etj.

Vlerësimi i pasurive të paluajtshme është një proces që kryhet nga persona të licensuar të quajtur vlerësues të pasurive të paluajtshme. Të vlerësosh një pronë do të thotë ti japësh asaj një vlerë. Lloji dhe tipi i vlerës përcaktohet në varësi të qëllimit për të cilin do të kryhet vlerësimi.

Vlerësuesit tanë në punën e tyre të përditshme i referohen Standardeve Europiane (EVS) dhe Standardeve Ndërkombëtare (IVS) të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme. Vlera me të cilë vlerësuesit vlerësojnë një pasuri të paluajtshme nënkupton ose përkufizohet si: "shuma e vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehej në datën e vlerësimit, midis një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm, në një transaksion normal, pas një marketing të përshtatshëm ku palët kanë vepruar seicili në mënyrë të mirëinformuar, të kujdesshme dhe pa detyrim".

Metodat e vlerësimit të pasurive të paluajtshme janë disa:

➢ Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë e cila përdoret për vlerësimin e të gjitha pronave që kanë treg shitje ose treg dhënie me qera.

➢ Metoda e investimit e cila përdoret për vlerësimin e pronave që japin të ardhura të vazhdueshme dhe të cilat blerësi i blen duke i pare si investim.

➢ Metoda e fitimit e cila përdoret për vlerësimin e pronave në brendësi të së cilave ushtrohet një biznes i caktuar dhe që nuk mund të vlerësohet me metoda të tjera.

➢ Metoda e zhvillimit e cila përdoret në vlerësimin e pronave të cilat kanë potencial zhvillimi ose rizhvillimi.

1.2 Tregu i pasurive të Paluajtshme

Tregu i pasurive të paluajtshme në Shqipëri ka nisur të zhvillohet pas viteve 90'. Janë pikërisht këto vite kur u hartua dhe legjislacioni përkatës për trajtimin e pasurive të paluajtshme si dhe ku ju dha e drejta e pronësisë individëve të cilët nëpërmjet procesit të privatizimit prona shtetërore u kthye në prone private. Pas hyrjes në treg të pronës private nisi dhe tregu i pasurive të paluajtshme në Shqipëri, ku pronat mund të shiteshin, të bliheshin ose të jepeshin me qera.

Kërkesat për strehim në qytetet e mëdha si: Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë etj, prurjet demografike akoma dhe sot janë të larta, që nënkupton kërkesa të mëdha për strehim. Duke krahasuar shifrat e vitit 1990 me ato të vitit 2005 vërehet që popullsia që jeton në fshat përbën 64% të popullsisë totale të vendit dhe në vitin 2011 ajo përbën 56.3% të saj. Mesatarisht në vit kanë migruar drejt zonave urbane 20300 persona. Një përqindje e madhe e këtyre individëve kanë shitur pronat që posedonin në zonat rurale dhe kanë blerë prona në zonat urbane ku janë vendosur. Kjo ka bërë që tregu i pasurive të paluajtshme të zhvillohet dhe të rritet kërkesa për prona duke u rritur numri i kërkesave rrjedhimisht rritet edhe numri i lejeve të ndërtimit për të ndërtuar objekte të reja të cilat të përmbajnë prona rezidenciale si dhe komerciale. Emigracioni është gjithashtu faktor që ka ndikuar dukshëm në tregun e banesave. Ndikimi i emigracionit në tregun e banesave kryesisht ka qenë pozitiv, pasi shumica e emigrantëve kanë më tepër mundësi për të blerë pasuri të paluajtshme për shkak të të ardhurave të larta që fitojnë nga emigracioni.

Ky treg ka pësuar një zhvillim të ndjeshëm gjatë 10 (dhjetë) vjeçarit të fundit si dhe është profesionalizuar më tepër me hyrjen në treg të agjencive imobiliare të cilat operojnë në të gjithë vendin. Veprimi i tyre në shitjen/blerjen e pasurive të paluajtshme ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm duke bërë të mundur shitjen/blerjen e tyre në një kohë më të shkurtër si dhe duke rritur kënaqësinë e shitësave dhe blerësave potencial që përfitojnë nga ky shërbim.

Edhe pse çmimet e pasurive të paluajtshme janë të larta në raport me të ardhurat për familje në vendin tone, kjo nuk ka penguar investitorët për të vazhduar me ndërtimin e resorteve të shumta si dhe në shitjen e pjesës më të madhe të tyre.

1.3 Statistikë dhe analizë të dhënash

Nga të dhënat e Institutit të Statistikave në Shqipëri (INSTAT) rezulton se numri i lejeve të ndërtimit të dhëna për vitin 2015 është 170 leje ndërtimi, për

vitin 2016 është 455 leje ndërtimi dhe për vitin 2017 deri në momentin që është kryer studimi rezultojnë 248 leje ndërtimi. Poseduesit e këtyre lejeve të ndërtimit janë më së shumti klientë privatë me një numër prej 63936 sipërmarrësish dhe 21086 janë klientët shtetërore pra institucionet apo agjencitë shtetërore në vend. E përkthyer në përqindje 75% e poseduesve të ndërtimeve të reja janë sipërmarrës dhe vetëm 25% e tyre janë pronarë shtetërorë. Ky është një tregues mjaft i dukshëm se si ka ndikuar ky treg në rritjen e investimeve.

Të dhëna të tjera treguese janë edhe numri i kontratave të regjistruara pranë zyrave të regjistrimit i cili tregon se sa përqind e këtyre objekteve janë finalizuar me shitje për periudhën e viteve 2015-2017. Sipas të dhënave zyrtare të marra nga zyra qëndrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për vitin 2015 rezultojnë 28075 kontrata të regjistruara, për vitin 2016 26415 kontrata dhe për vitin 2017 deri në momentin që është kryer studimi rezultojnë 24461 kontrata të regjistruara pranë zrpp-ve përkatëse. Regjistrimi i kontratave pranë instiucionit kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme tregon kryerjen e të gjitha procedurave zyrtare të kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme që kanë qenë objekt shitje/blerje gjatë kësaj periudhe që është marrë në studim.

Vazhdimësia e këtij fenomeni do të çojë drejt zhdukjes së tregut të zi dhe jo formal të pasurive të paluajtshme, uljen e problemeve të pronësisë nga poseduesit e tyre, si dhe rritjen e buxhetit të shtetit nëpërmjet përfitimit të tatimit mbi fitimin dhe taksës së kalimit të pronësisë.

PËRFUNDIME

Sipas opinionit tim duke u bazuar në të dhënat dhe statistikat e mbledhura tregu i pasurive të paluajtshme është në zhvillim e sipër si dhe premton dhe ka prespektivë për të ardhmen. Numri i ndërtimeve të reja që është duke u zhvilluar si dhe të dhënat e lejeve të ndërtimit të dhëna gjatë trevjeçarit të fundit premtojnë një larmishmëri dhe zhvillim edhe më efektiv të tregut të pasurive të paluajtshme në vitet në vazhdim.

Investimet në fushën e pasurive të paluajtshme vazhdojnë të mbeten një nga investimet më të preferuara si edhe më fitimprurëse pasi shitja e tyre sjell të ardhura të konsiderueshme për sipërmarrësit por edhe për shtetin.

Studimi i kryer për periudhën 2015-2017 lidhur me kontratat e kalimit të pronësisë të regjistruara pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme është një tregues mjaft pozitiv dhe dëshmitar i përparimit dhe zhvillimit të procedurave sipas legjislacionit në fuqi dhe jo nëpërmjet rrugëve jo-zyrtare sikundër ka funksionuar më parë. Kjo procedurë ligjore e zbatuar sipas rregullave

të vendosura ka bërë të mundur që tatimi mbi fitimin dhe taksa e kalimit të pronësisë ti kalojnë si të ardhura shtetit shqiptar.

Duke u bazuar në rolin e rëndësishëm që ky treg ka do të sugjeroja që të përmiresoheshin politikat e trajtimit të ketij tregu nga ana e shtetit, krijimin e një organizate funksionale për përpilimin e politikave më të mira të marketingut të pasurive të paluajtshme si dhe përfshirjen në ciklet e larta të edukimit njohuri më të specializuara për këtë treg.

Rekomandohet që të kryhen sa më tepër studime të kësaj fushe në mënyrë që palët e interesuara të marrin informacionet e duhura për zhvillimin e këtij tregu si dhe të marrin iniciativën për tu përfshirë në këtë lloj biznesi i cili rezulton të jetë mjaft fitimprurës si dhe mund të them që vijon të jetë ende në fillimet e veta.

LISTA E REFERENCAVE DHE BIBLIOGRAFIA

Url: http://www.zrpp.gov.al/new/
Url: http://www.notariati.al/
Url: http://www.instat.gov.al
Libri: "Bazat e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme" me autor Dr.Elfrida Alliu, shtëpia botuese "Maluka".
Url: http://www.qbz.gov.al/botime/PasuritePaluajtshme.pdf
Url:http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/09/Doktoratura-Luciana-Koprencka-Fakulteti-Ekonomik-Departamenti-i-Finances.pdf
Url:http://www.upt.al/images/stories/phd/E_Shehu_Alliu_fakt_tekn_paluajtshme.pdf

Prof. Dr. Jusuf OSMANI

VENDOSJA E MALAZEZËVE NË VRRAKË TË SHQIPËRISË(1810) DHE KOLONIZIMI I TYRE NË KOSOVË

Shumë rrallë në botë ka raste që një popull ka arritur që në 150 vitet e fundit të zgjeroi territorin e vet dhe të dëbojë popujtë jo serbë, siç e kanë arritur këtë serbët. Është interesant të theksohet se ai sukses nuk bazohet në fitoret në luftë, por në truezat e bisedave, me përkrahjen e aleatëve të tyre të luftës. Serbia e ngushtë, e cila ka përfshirë Pashallëkun e Beogradit, pas Luftërave ballkanike në vitet 1912 dhe 1913 është zgjëruar në territoret e Kosovës, pjesëve të Sanxhakut dhe të ashtuqujturës Maqedonisë jugosllave. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike njësitë serbe në ato treva kanë bërë krime të gjenocidit në Shqiptarët, Boshjakët dhe Maqedonët. Kanë djegur fshatra të tërë duke i vrarë banorët civilë në mënyrë më primitive, me thika, sëpata dhe me mjete tjera të durit. Ky krim nuk është shënuar në Europë që nga shpërnguljet e popujve. Ndjekja e popullatës jo serbe ka vazhduar dhe pas vendosjes së pushtetit serb, kështu që ka ardhur deri të shpërngulja masovike, që ka kushtëzuar në ndryshimin e srukturës demografike dhe zbatimin e kolonizimit serb në pronat e plaqkitura e të dëbuarve.[15] Pra, me ripushtimin e Kosovës, në vjeshtë të vitit 1918 dhe vendosjen e pushtetit serbo-malazez e vënien në funksion të aparatit të veçantë administrativo-politik, administrata shtetërore e ushtarake, krahas organizimit të operacioneve ndëshkimore, të dhunës, terrorit, vrasjeve, dënimeve të mëdha etj., në të njëjtën kohë filloi një presion politik për shkombëtarizimin e popullatës shqiptare me metoda të ndryshme. Qarqet drejtuese të Beogradit rifilluan politikën e vjetër shoveniste.[16]

Zgjerimi kinse i parë i zgjerimit të territoreve serbe, në të cilat është zbatuar kolonizimi paraqet fillimi i realizimit të programit politik, i cili është definuar në "Naqertanijen" e vitit 1844 të Ilija Garashaninit. Programi serb i Naqetanisë së vitit 1944 është bazuar në rimkëmbjen e Perandorisë së Car Dushanit të shek.

[15] http:www.hic.hr/books/jugoistocna-europa/semiz.htm Medjunarodni znanstven skup "Jugoistocna Europa 1918-1995", Prof. dr. Dzenana Efendic Semiz, Srpska Agrarna Reforma i Kolonizacija 1918. godine.

[16] Më gjërësisht: Dr. Jusuf Osmani, Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1996.

XIV.

Një ndër metodat e spastrimit etnik, shkombëtarizimit dhe sllavizimit të Kosovës, ishte edhe kolonizimi i Kosovës me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nga vendlindja e tyre që kishte filluar që nga viti 1912, kur Kosova u pushtua nga serbët dhe malazezët. Ky kolonizimi u ndërpre gjatë Luftës së Parë Botërore dhe vazhdoi menjëherë pas mbarimit të saj. Për realizimin e e tij, filloi menjëherë dhuna e terrori ndaj popullatës shqiptare. Konsulli frances në Shkup raportoi në Qershor 1919 për 9 masakra me 30-40.000 viktima, për mbylljen e shkollave fillore shqiptare dhe zëvendësimin me shkolla serbe. "Në emrin e organizatave kombëtare shteti serbo-kroato-slloven ka organizuar banda të armatosura, të cilat terrorizojnë zonat shqiptare dhe vrasin fshatarët pasi i plaçkisnin dhe u djegnin shtëpit. Nën preteksin e shtypjes së kryengritësve, forcat e organizuara ushtarake serbe kanë shkatërruar shumë fshatra në rrethet e Prishtinës, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Pejës. Ato kanë vrarë me mijëra banorë të këtyre zonave pa kursyer as gra, fëmijë e pleq. Pas çdo goditje kundër shqiptarëv vendoset një kamp… kolonistësh serbë, të cilët pastaj terrorizojnë sistematikisht fshatrat fqinjë për të detyruar banorët e tyre të braktisin tokat, që pastaj sekuestrohen dhe gjithashtu kolonizohen. … Fshatarëve dhe qytetarëve shqiptarë, të cilët ishin të gjithë bujqë, u merret toka në preteksin e zbatimit të Ligjit agrar.

Kolonizimi si metodë përfide mistifikohej dhe të kamuflohej me zbatimin e njërës nga metodat borgjeze me reformë agrare, e cila propagandohej si masë përparimtare e që në të vërtetë fsheh qëllimin e borgjezisë serbomadhe - kolonizimin e Kosovës dhe shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare, e cila ishte në shumicë absolute. Pra, borgjezia bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare, sidomos në ato treva ku shqiptarët jetonin në numër të madh dhe Kosova ishte rajoni me popullsi më të dendur në tërë Jugosllavinë. Ekzistonte një program i gjerë i kolonizimit, i vendosjes së folësve të sllavishtes në viset e banuara me shqiptarë. Me këtë është besuar se asimilimi i shqiptarëve mund të realizohet, prandaj edhe kolonizimi i Kosovës është bërë në mënyrë disperzive…. Pastaj është bërë ndarja regjionale e bashkësisë të pakicës shqiptare në tri banovina. Për qeverinë e Millan Stojadinoviqit, në mungesë të pergjegjësië historike, nuk është realizuar por është parafiruar marrëveshja me qeverin turke për shpërnguljen e mbi 200.000 shqiptarëve (400.000 J.O), që ka qenë më tepër se gjysma e popullatës së atëhershme të Kosovës.[17]

Kolonizimi dhe reforma agrare në Kosovë kanë pasur qëllim kryesisht nacional-politik dhe karakter eksploatues. Qëllimi kryesor i kolonizimit ishte

[17] NIN, 2511, februar 11 1999, Intervju: Branislav Krstic.

thyerja e kompaktësisë nacionale të popullsisë shqiptare dhe ndërrimi i strukturës nacionale në dëm të shqiptarëve. Veçanërisht, synimi ishte që të kolonizohej dhe të forcohej elementi kolonist në pjesët rreth kufirit me Shqipërinë, sepse mendonin se me atë kufiri do të jetë më i sigurtë dhe do të ndërpritet vazhdimësia e popullatës autoktone shqiptare nga territori i Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, siç thuhej në dokumente me qëllim sigurimi dhe në përputhje me planin e tyre strategjik. Përveç kësaj, ajo politikë bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare dhe në ato treva homogjene dhe vendbanime të banuara plotësisht me popullatë shqiptare të vendoste kolonë, pra në ato krahina, ku shqiptarët jetonin në numër të madh, si dhe synohej të kolonizohen ato treva të pastra etnike shqiptare siç ishin: Drenica, Llapi, Llapusha, pjesë të Rrafshit të Dukagjinit, të Kosovës etj, dhe të thyhej homogjeniteti nacional i atyre vendbanimeve e trevave në fjalë.[18]

Kolonët të ashtuquajtur vullnetarë, çetnikë, optantë, etj., kishin ardhur gati nga të gjitha viset e Jugosllavisë borgjeze, si nga Mali i Zi, Hercegovina, Bosna, Dalmacia, Lika, Korduni, Bania, Serbia Jugore, Vojvodina, etj. Mirëpo, kishte kolonë të ardhur edhe nga disa shtete të jashtme si nga Rusia, Italia, Hungaria, Shqipëria, Amerika, etj. Atyre pushteti u jepte prona të mëdha të tokës, sipërfaqja më e madhe e marrë nga pronarët shqiptarë, duke i detyruar ata që të shpërngulen ose të bëhen shërbëtorë "të agallarëve" të rinj, duke ua punuar tokën dhe duke e paguar edhe tatimin për atë tokë. Pushteti, kolonët i vendoste edhe në shtëpitë e fshatarëve vendas shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës se dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte edhe shtëpitë, si dhe u jepte ndihmë në material ndërtimor, vegla pune, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore për 10 vjet dhe nga ato komunale për 5 vjet, kurse të drejtën e plotë si pronarë - me të drejtë për të shitur atë - do ta merrni pas dhjetë vjetësh, transportin falas të tyre, të materialit ndërtimor, veglave të punës, bagëtive etj. deri të vendi i vendosjes etj. U formuan Kooperativat agrare nga të cilat kolonët merrnin kredi pa kamatë, material ndërtimor dhe ndihma të tjera.

Në mesin e kolonëve të ardhur, që shteti u kishte dhënë tokë, përveç fshatarëve bujq kishte edhe tregtarë, pensionistë, oficerë, xhandarë, nëpunës, etj. Për t'i nxitur dhe për t'i tërhequr kolonët që të vijnë dhe të vendosen në Kosovë, makineria propoganduese serbe përdorte në forma të ndryshme propogandën se në Kosovë ka tokë më bollëk, shtëpi të lira etj.

Kolonëve të ardhur sllavë, pushteti, përveç tokës "utrinë", kullota e të tjerë, u ndante posaçërisht tokë të punueshme pjellore të marrë nga pronarët shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të shpërngulen jashtë vendit ose të marrin

[18] Më gjërësisht shih: dr. Jusuf Osmani, Kolonizimi serb i Kosovës, Prishtinë, 2000.

nga kolonët e të punojnë tokën e vet përgjysmë ose me qesim dhe për të edhe të paguajnë më tutje tatimin. Tokën pronarëve shqiptarë pushteti ua merrte edhe me motivacion se është përfshirë në kompleksin agrar dhe për atë shpesh nuk jepte kurrfarë kompensimi, ose nëse jepte atë tokë e jepte të cilsisë së dobët.

Në zbatimin e kolonizimit ishin të angazhuara të gjitha organet e pushtetit, duke filluar nga ato më të ulëtat lokale e deri tek ato më të lartat shtetërore. Pra, ishte angazhuar tërë makineria shtetërore. Ata kurrnjëherë nuk kishin marrë parasysh pozitën e fshatarit shqiptar. Përkundrazi, në aksionet e marrjes së tokës, përdoreshin metoda të llojllojshme, kështu që kishte raste kur toka iu ishte marrë deri në prag të shtëpisë, e që për të hyrë shqiptarë në shtëpi do të detyrohej të kalojë tani nëpër "pronën" e kolonit.

Në veprimtarinë e organizuar për nxitjen e vazhdueshme të shpërnguljes shqiptare dhe të kolonizimit me kolonë sllavë, në vend të tyre, administrata shtetërore i kishte lënë vend të veçantë propogandës, sidomos shtypit, i cili duhej të kontribuonte në përgatitjen psikologjike të opinionit brenda vendit për ta përkrahur shpërnguljen dhe për ta justifikuar këtë para opinionit të huaj. Ndërsa, nga kolonët, nga tërë shteti dhe jashtë t'i nxitë dhe t'i tërheqë të vendosen në Kosovë, duke u premtuar tokë më bollëk, shtëpi, vegla bujqësore, lehtësi tatimore, kredi etj. Me këtë shtypi borgjez synonte që në radhët e popullsisë shqiptare të krijojë një gjendje tensioni të vazhdueshëm, i cili duhej të ndikonte në shtimin e mëtejshëm të shpërnguljes. Në shumicën e gazetave, sidomos në ato beogradase, botoheshin artikuj shpifës, tendenciozë, duke e paraqitur shpërnguljen si "dëshirë" të popullatës "myslimane", ndërsa kolonizimi arsyetohej për tokën e lirë dhe interesat që kishte shteti për t'i kolonizuar këto treva me elementin e krishterë nga aspekti i mbrojtjes.

Shpronësimi në masë i fshatarsisë shqiptare pati për rrjedhojë varfërimin e saj. Ndërsa si rrjedhojë e spastrimeve etnike dhe e kolonizimit të tokave shqiptare u bë ndryshim i ndjeshëm i strukturës etnike të popullsisë. Duke u ballafaquar me pozitën e rëndë të tyre, të shkaktuar nga presionet e llojllojshme, që ushtronte pushteti policor ushtarak i Jugosllavisë borgjeze, dhe, duke mos gjetur mbrojtje elementare juridike për pronat dhe jetën e tyre, e po ashtu të ndihmuar me lehtësi të mëdha rreth përgatitjes së dokumentacionit të udhëtimit, që i ofronte po ai pushtet, një pjesë e popullit shqiptar emigroi në Turqi, e një pjesë edhe në Shqipëri. Shpërngulja e shqiptarëve nga vendlindja e tyre ka qenë e motivuar nga politika antishqiptare e diskriminuese. Ky proces i prirur nga qëndrimet negative dhe nga paragjykimet e qarqeve sunduese ndaj shqiptarëve dhe vendeve të tyre kishte filluar edhe gjatë periudhave më të hershme historike. Për ta nxitur shpërnguljen, pushteti borgjez i ngacmonte shqiptarët edhe në

ndjenjat e tyre kombëtare e fetare, si në rrënimin e xhamive, varrezave, etj.

Sipas shënimeve statistikore Kosova në krahasim me viset tjera si Vojvodina, Sllavonia, Serbia etj., ishte shumë më e dendur me popullsi bujqësore. Kështu që nuk ka pasur kurrfarë arsye ekonomike e sociale, siç mundohet të arsyetohet nga disa "shkencëtarë" që të plotësohet me popullsi nga viset tjera.

Të bazuar në shënimet statistikore, qeveria arriti që në Kosovë, në periudhën midis dy luftërave, siç thuhej për nevoja të reformës agrare t'i kufizojë rreth 129.212,94 ha tokë.[19] Ndërsa, gjatë kësaj periudhe janë vendosur 13.482 familje me rreth 67.410 anëtarë në 594 vendbanime.[20] Mirëpo, numri i kolonëve të vendosur në Kosovë është më i madh, sesa e jep statistika zyrtare serbe, sepse ky numër ka të bëjë vetëm për familjet, të cilëve zyrtarisht u është ndarë toka. Kanë mbetur anash familjet, që e kanë rrëmbyer tokën në forma të ndryshme, ato në qytet - të ardhur si nëpunës, xhandarë, tregtarë dhe të profesioneve të tjera. Secila familje mesatarisht i kishte marrë nga 8,45 ha tokë, por kishte shumë raste kur një familje kishte marrë edhe deri 45 ha tokë. Ndërsa, familjeve shqiptare kishte raste kur toka i merrej në tërësi deri në prag të shtëpisë, kështu që nuk zbatohej edhe ai dekretligj famëkeq, i cili parashihte se familjeve shqiptare t'i mbetej 0,40 ha tokë për një anëtar të familjes.

Në mesin e kolonëve të vendosur në Kosovë në periudhën ndërmjet dy luftërave botëror kishte edhe Vrraka e Shqipërisë. Vrraka është trevë në Shqipëri, në veri të Shkodrës, ndërmjet masiveve malore të Bjeshkëve të Nemura dhe Liqenit të Shkodrës. Nëpër te rrjedh lumi Vraka, i cili derdhet në Liqenin e Shkodrës.

Banorët sllavë në Vrrakë ishin vendosur këty nga trevat e Malit të Zi, përkatësisht nga Zeta. Arsyeja e shpërnguljes së popullatës malazeze dhe vendosja në trevën e Vrrakës ishte kryesisht për shkak të gjakmarrjes. Shumë prej tyre me vendosjen në Vrrakë e kanë ndërruar edhe mbiemrin. Vendosja në Vrrakë kishte filluar në vitin 1810, atëherë kur ndërmjet verizit të Shkodrës dhe vlladikës së Malit të Zi, Petar Petroviq Njegoshit ishte vendosur një paqë e brishtë, për shkak të depërtimit të ushtrisë franceze në Ballkan dhe Evropën Lindore. Me këtë rast veziri i Shkodrës ka lejuar vendosjen e malazëve të fushës së Zetës, të cilët kanë kaluar në Shkodër dhe kanë kolonizuar Vrrakën. Ky proces ka zgjatur rreth 60 vjet. Familjet e para janë vendosur në fshati Rash (Vujaqiqët, Peleviqt, pastaj Cekliqët, Martinoviqet dhe Seniqët) dhe Gril (Gjurqeviqi). Të fundit ishin vendosur Brajeviqët, ndërsa diçka para tyre (1861) Reshterët. Familjet janë shtuar dhe janë ngritur në fise dhe vëllazëri në farefisni të afërt. Ndërmjet viteve

---

19 AJ B, Ministarstvo Agrarne Reforme Kraljevine Jugoslavije, 96-15-51; 96-15-55.

20 AJ B, MAR, 96-21-69, Regjistri i kolonive më 8.IV.1940.

1900 dhe 1933 në Vrrakë dhe në Kamenicën e afërt dhe diçka në Dergnjatin e largët janë shënuar 59 farefisni.[21]

Në trevën e Vrrakës u vendosën këto familje malazeze: Martinoviqët, Prelleviqët, Krstoviqët, Brajeviqët, Mikuliqët, Bashanoviqet, Roganoviqët, Ajkoviqët, Reshterët, Cekliqët, Seniqët, Gjurqeviqët, Gjinoviqët, Vuqiqët, Kërtotiqët, Zllatiqanët, Peshoviqët, Mrenoviqët, Popoviqët (Dambariqët), Lambulliqët, Kraqkoviqët, Kvariqët, Pejoviqët, Rackoviqët, Gjuretiqët, Banjoviqët, Vukçeviqët, Zhariqët, Majiqët, Nikiqët, Peshukiqët, Pelçiqët, Radinoviqët, Raiçeviqët, Radusinoviqët, Stajkiqët, Shabanoviqët, Stankoviqët, Uskonoviqët, Shunjeviqët, Babiqët, Markoviqët-Bjellanoviqët, Markoviqët, Andrijeviqët, Gashoviqët, Goroviqët, Dragoviqët, Kontiqët, Milogoriqët, Radiçkoviqët, Radoviqët, Ulishiqët, Sekuliqët, Camniqët, Shoqët, Llukarqeviqët-Kosoviqët, Qoroviqët dhe Vujaçiqët.

Sipas disa burimeve, para shpërnguljes së tyre të pjesëshme nga Vrraka, kishës së Vrakës i kanë takuar 95 shtëpi, në fshatrat: Boriq, Gril, Omar dhe Rash. Vëllazëritë vrrakase në kuadrin e tyre kishin 1 deri në 20 familje. Për numrin e banorëve të trevës së Vrrakës nuk ka shënime të sigurta dhe manipulohej me numrin e tyre.

Pushteti jugosllavë në kohën e Mbretërisë jugosllave bënte propagandë jo vetëm brenda shtetit por edhe jashtë tij që popullata kryesisht me prejardhje sllave të kolonizohet në Kosovë. Në mesin e asaj popullate ishte edhe ajo sllave që jetonte në trevën e Vrrakës në Shqipërinë etnike. Pushteti në terminologjinë zyrtare dhe ligjeslacionin agrar i quante me emrin optantë.

Pushteti jugosllavë me propagandën e tij arrijti që të ndikojë të popullata e trevës së Vrrakës që të shpërngulet dhe të vendosët në Kosovë. Para shpërnguljes një delegacion i tyre në vitin 1933 kishte shkuar në Beograd dhe ishte pritur nga kryetari i Qeverisë, Bogolub Jeftiqi. Ata kishin marrë këshilla dhe kinse kishin bërë marrëveshje për shpërnguljen e tyre në Kosovë, përkatësisht të kolonizojnë rrafshin e Dukagjinit.[22]

Pushteti serb është munduar që arsyeja e shpërnguljes ishte, kinse mbreti Zog i kishte urdhëruar që fëmijet t'i pagëzojnë me emra në gjuhën shqipe, kurorizimi dhe varrimi të bëhet në gjuhën shqipe, vuarjen e mësimit në shkollat e vrrakasve në gjuhën shqipe, largimin e priftit ortodoks serb, etj. Përveç kësaj ata deklaronin se pushteti kishte marrë masa represve ndaj parisë së kësaj popullate,

[21] Branko Boskovic, Naseljevanje Vracana u Metohiji, njihov progon i rastur. "Stanovnistvo slovenskog porijekla u Albaniji", Zbornik radova sa medjunarodnog naucnog skupa odrzanog u Cetinji 21, 22, I 23 juna 1990. godine.

[22] http://search.msn.com/results.arspx?q=Vraka+o+vracani&FORUM=Q BRE3. Albanija. Grecic Lapusina, "Svi srbi sveta".

kishte bërë internimin e tyre etj. Mirëpo, Misis E. Durham përkitazi me këtë shkruan: Vrraka kishte njëmijë banorë, të cilët vijnë të gjithë nga malazezët, hercegovasit, boshnjakët e ndyshëm, që në kohë të vona kanë ikur për arsye gjakmarrje dhe janë strehuar në territorin e shqiptarë që në atë kohë ishte nën pushtetin e Perandorisë Osmane. Jo vetëm që nuk ishin mirënjohës për strehimin që gjetën, por edhe janë burim i pashterrshëm turbullirash. Ata përdoren nga serbët "pikëmbështetje" për ankesa dhe ndonëse kanë kishën dhe priftërinjtë e tyre, të cilëve nuk iu ka ndërhyrë kush ndonjëherë, qeveria jugosllave është munduar të vendosë një peshkop serb në Shkodër në emër të tyre.[23]

Kolonizimi i kolonëve-optantë nga Shqipëria në Kosovë kishte filluar në vitin 1933 dhe kishte vazhduar deri në vitin 1936.[24] Ata e kishin lëshuar Shqipërinë dhe ishin vendosur në Podgoricë – Mal të Zi. Shpërngulja masovike është bërë në vitin 1934 dhe me një ramje ka vazhduar në dy vitët e ardhshëm. Në vitin 1933 janë shpërnguljur 10 familje, në vitin 1934 -146 familje, 30 familje në vitin 1935 dhe 8 familje në vitin 1936 (48). Famijet e shpërngulura nga Shkodra kanë kaluar në Podgoricë, ku disa grupe kanë qëndruar edhe deri në 6 muaj. Shpenzimet e qëndrimit në Podgoricë dhe të transportit në Kosovë, dhe pastaj edhe një kohë të gjatë të qëndrimit në Kosovë i ka paguar shteti. Sipas një dokumenti arkivor, shihet se më datën 3.VII 1935 – 24 familje me 170 anëtarë të ikur nga Shqipëra me telegram i drejtohet mbretit P, Karagjorgjeviqit në Beograd, ku i ankohet se që 6 muaj janë në Podgricë dhe kërkojë që të vendosen diku. Përkitazi me këtë Drejtorati i Lartë i Reformës Agrare në Shkup me shkresën nr. 25236 të datës 15.VII 1935 e njoftoi Ministrinë e Bujqësisë se nga Prefektura e rrethit në Podgoricë e ka kërkuar regjisrtin e emigrantëve, të cilin edhe e ka marrë, ku pastaj ia ka dërugar të hollat për pagesë nga 1,50 din. në ditë si ndihmë deri sa të jenë ata atje. Sa i përket kolonizimit theksohet në dokument, në rrethin e Anadrinisë kanë mbetur 12 shtëpi të lira, kështu që Drejtoratit Agrar në Gjakovë i është urdhëruar që t'i ftojë 12 familje dhe t'i vendosë atje. Prej vitit të kaluar nga 180 shtëpitë e parapara kanë mbetur të pandërtuara 13 shtëpi në rrethin e Anadrinisë. Menjëherë ka filluar ndërtimi i 7 shtëpive, ndërsa për 6 të mbetura vendi nuk është caktuar. Në to do të vendosen vrrakjanët.[25]

Sipas shënimeve statistikore që i udhëheqte shërbimi statistikor pranë Ministrisë së Reformës Agrare, përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë së Mbretërisë jugosllave në Beograd, në rrethin e Anadrinisë deri më datën 31.XII 1937 ishin

---

[23] Mis Edith Durham, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Tiranë, 1991, fq. 443.

[24] Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, fq. 29-33.

[25] AJ, Beograd, Fond: "Dvor", 74, k.56, gr. 77.

vendosur 169 familje optante në 1.526,16 ha,[26] deri me 1. janar 1939 në rrethin e Gjakovës 9 familje në 56,05 ha, ndërsa deri në vitin 1941 në Rrethin e Graçanicës ishin vendosur 14 famile optante në 53,91 ha, kurse në Rrethin e Gjilanit 9 familje në 68,68 ha.[27] Optantët ishin vendosur edhe në rrethet të tjera, si p.sh. në Rrethin e Drenicës (në Çikatovë të Re) ishin vendosur 7 familje, në atë të Istogut 4 familje, të Pejës 8 familje, të Podgurit 1 familje, etj.

Në Kosovë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore ishin vendosur 156 optantë,[28] të cilëve shteti iu kishte dhënë mesatarisht nga 13,11 ha tokë.[29] Duhet theksuar se shënimet e gjetura statistikore, që paraqesin numrin e optantëve dhe të kolonëve të tjerë në tabela të ndryshme, janë mjaft kontradiktore.

Pushteti me qëllim të caktuar kolonët vrrakas nga Shqpëria i kishte vendosur në Rrafshin e Dukagjinit, afër Drinit të Bardhë dhe lumit Mirusha, kryesisht në rrethin e Anadrinisë dhe në pak në viset tjera të afërta, siç janë:

*Rrethi i Anadrinis*ë: Ratkoc 8 familje të vrrakasve, Qifllak -10, Mrasor 3, Denjë 6, Dobërdol 15, Kramovik 3 , Bubavec 12, Panorc (Garaqevë) 19, Bubël 16, Sarosh 11, Vranjakë 7, Radostë 12 , Gexhë 8, Xerxë 4, Malishevë 3, Domanek 9, Lubizhdë 9, Bubavec 16, Llashkadrenoc 1, Turjakë 6, Llazicë 1.

Rrethi i Sharrit: Rogovë 1.

*Rrethi i Gjakov*ës: Drenoci 8.

Rrethi i Pejës: Zllopeku 4, Vitomirica 4, Bellopoja 2, Lubeniq 2 familje,

Rrethi i Istogut: Bainca 6 familje.

Nga një familje e vrrakasve është vendosur në Rogovë të Hasit dhe në Fushë-Kosovë afër Prishtinës.

Numri i kolonëve të vendosur prej një vendbanimi, të bazuar në burimet arkivore ndryshon, kjo është si rezultat i lëvizjes së tyre prej një vendbanimi në tjetrin.

Kolonëve nga Vrraka iu është dhënë toka utrinë ajo e kullosave, pronë e shtetit dhe e komunës, tokë pjellore afër Drinit dhe rreth 18 ha tokë kaqake në fshatrat Kramovik dhe Qifllak, tokë kaçake në Bajicë të komunës së Istogut, etj.

Sipas Ligjit për kolonizimin e viseve jugore, Vrrakasit janë konsideruar në subjekte agrare të grupit të optantëve, kolonist të popujve jugosllav të cilët kanë ardhur nga shtetet fqinje. I kanë gëzuar të drejtat sikurse

---

[26] AJ, MAR, 96-15-55.

[27] Arkivi i Maqedonisë – Shkup, Fondi: Drejtorati Suprem i Reformës Agrare në Shkup, lib. II.

[28] AJ, MAR, 96-15-56; Dr. M. Obradovic, Agrarna reforma i kolonizacija .., fq. 221.

[29] AJ, MAR, 96-15-56; Dr. M. Obradovic, Agrarna reforma i kolonizacija, fq. 221.

kolonistët. I kanë marrë nga 5 ha tokë për kokë të kolonit dhe nga 1-3 ha në anëtarë tjerë të familjes. Mirëpo, disa familje kanë marrë shumë më tepër tokë se sa ishte e paraparë me dispozita ligjore. Atë tokë në shumë raste iu kanë dhënë popullatës vendore shqiptarëve, ish pranarëve që t'ua punojnë përgjysmë.

Kolonët vrrakas kanë marrë shtëpitë e ndërtuara nga shteti ndërsa ata të vendosur në vitin 1936 kanë marrë ndihmë në të holla për ndërtimin e tyre. Të gjitha familjet kanë marrë nga një penë qe, pllugun dhe shpenzimet e ushqimit deri të korra e parë dhe për çdo hektarë të tokës së hapur nga 1000 dinarë ndihmë. Kolonëve optantë të vendosur në Kosovë, përveç tokës pushteti iu kishte ndihmuar edhe në dhënien e ndihmve – benificioneve të tjera, si p.sh. lirimin nga tatimet shtetërore për 10 vjet, ndërsa ato komunale për 5 vjet, dhënia e kredive nëpërmjet kooperativave bujqësore, pastaj ndihma në vegla bujqësore, material ndërtimor, e posaçërisht në ndërtimin e shtëpive. Kështu, sipas një burimi arkivor, deri më datën 10.VII 1935, vetëm në Rrethin e Anadrinisë shteti në 21 vendbanime i kishte ndërtuar 203 shtëpi.[30]

Me kolonizim janë përfshirë 104 familje. Ato me rastin e ndarjës së tokave në vendin e shpërnguljes janë ndarë në më shumë subjekte agrare, përkatësist në më shumë koka të familjeve me qëllim të marrjës së sasisë më të madhe të tokës. Kështu me rastin e kolonizimit të familjeve vrrakase janë paraqitur si subjekte agrare 205 familje të cilat janë vendosur në Dukagjin dhe një në rrafshin e Kosovës.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, vrrakasit në vitin 1941 largohen nga lokalitetet e kolonizuara dhe disa vendosën në Gjakovë, ndërsa shumica vendosën në Pejë. Vrrakasit gjatë larigimit janë percjellë nga banorët shqiptarë dhe asgjë nuk iu kishte ndodhur. Disa vrrakasë janë vendosur në Mitrovicë dhe në rrethinë të Kralevës, Kragujevcit dhe Krushevcit. Disa familje, rreth 50 sosh kanë shkuar nga Peja në Podgoricë. Disa vrrakas janë kthyer nga Mali i Zi në Vrrakë. Ata janë vendosur të miqët, fqinjët dhe të afërmi.

Pas mbarimit të Luftës vrrakasit kthehen në Dukagjin. Një kohë kanë ndejtur në Rahovec dhe në Pejë, deri sa pushteti dhe popullata vendëse me punë "angarie" ua ndërton shtëpitë.

Kolonët e vendosur në vendbanimet shqiptare, pas qëndrimit disavjeçarë filluan që ato prona me çmime të majme t'ua shesin ish pronarëve shqiptarë dhe të tjerëve. Ato kalonin në qendrat urbane, shkollonin fëmijtë, punësoheshin, merrin banesa shtetërore dhe me parët e marra blenin prona edhe jashtë Kosovës dhe kalonin një jetë luksoze. Kështu që pothuajse deri në vitet e shtatëdhjeta të shek. XX, gadi në shumicën e vendbanimeve të theksuara popullata kolone malazeze e

[30] AJ, MAR, 96-15.

ardhur nga treva e Vrrakës u shpërngulë.

Me ndryshimet kushtetutare në Kosovë, pas marrjes së autonomisë me dhunë nga pushteti serb në vitin 1989, në vitet e nëntëdhjeta filloi një fushatë e madhe e qeverisë serbe për kthimin e tyre në Kosovë e sidomos për vendosjen e asaj pjese të mbetur të pupullatës sllave në Shqipërinë etnike. Pushteti këtë e realizoi kah mesi viteve të nëntëdhjeta të shek. XX.

Diplomacia serbe në shërbim të saj edhe shkenca janë munduar që përveç Kosovës që edhe në Shqipëri të paraqesin një numër të madh të popullatës sllave. Gjë që fare nuk ekziston. Në Shqipëri sipas burimeve serbe në atë kohë jetonin 1542 banorë.

Pra, krahas planeve të Jugosllavisë së atëhershme, të inicuara nga Serbia, edhe ajo kishte hartuar plane dhe projekte për rikolonizimin e Kosovës. Në një plan operativ parashihej ndërtimi i 30 lagjeve, ndërtimi i banesave në Gjakovë, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Novobërdë, Shterrpcë, Lypian, Zubin-Potok dhe në Kamenicë. Më 12 dhjetor të vitit 1991 me qëllim të kolonizimit të ri të Kosovës, në lokalet e pushimores të fëmijëve dhe të rinisë në Deçan u vendosën 100 familje me prejardhje serbe e malazeze të ikur nga Shqipëria.[31] Më vonë aty dhe gjetiu u vendosën edhe shumë familje të tjera.

Për kolonët serbë e malazezë pushteti aktual ndërtoi shtëpi, por edhe koloni vendbanimi. Kështu ndërtoi rreth 119 shtëpi afër Junikut, mbi 180 shtëpi (1996) afër fshatit Baballoq dhe fillimi i ndërtimit të vendbanimit të ri në anën tjetër të rrugës, ndërtimi i 76 shtëpi në Lum të Madh të Vushtrrisë, në Kodrën e Diellit në Prishtinë 160 shtëpi, kompleksi banesor në lagjet "Ulpianë", "Dardani" etj., në Shirokë të Suharekës, në Miradi të Epërme 80 banesa për kolonë etj. Kishte ndryshuar planin urbanistik të shumë qyteteve dhe fshatrave si dhe të zonave industriale për ndërtimin e vendbanimeve kolone, si në Gjilan, Prishtinë, Prizren, Klinë, Suharekë, Vushtrri, Istog, Deçan, Zveçan etj.[32] Mirëpo, kishte raste kur kishin dështuar planet serbe për kolonizimin e Kosovës. Këtë e dëshmon rasti në komunën e Istogut, kur tri blloqesh banesash, të cilat ishin ndërtuar për kolonët, përkatësisht për malazezët nga Vrraka e Shqipërisë, i ndanë mes tyre serbët dhe malazezët që jetonin në këtë komunë.

Individë të shumtë nga Shqipëria ishin punësuar edhe në instucionet arsimore, kulturore, informative, shkencore etj. në Kosovë, në vend të ponëtorëve shqiptarë të dëbuar nga puna, siç ishte rasti edhe me spikeret e njohura në RTP, në Radio Prishtinën, etj.

---

[31] Cen Mazreku, Përpjekje per kolonizimin e ri të Kosovës, "Fjala", dhjetor 1991; Kosova në vështrim enciklopedik, v. e c., fq. 51.

[32] Shif: "Sl. List RS" nr. 68/91; 61/93; 4/92; 47/92; 35/94; 68/94.

Serbizimin e Kosovës pushteti aktul serb e ka zbatuar edhe me ndërtimin e kishave në qendrat urbane, ndërrimin e emrave të shkollave, rrugëve, shesheve, organizatave të ndryshme dhe emërimi me emra mitologjikë serb. Shkrimi i çirilicës dominonte kudo.

Një ndër aktet juridike sistemore më ekstreme është "*Ligji për Organizimin Territorial të Serbisë*".[33] Sipas nenit 7 të këtij ligji "*Qeveria e Serbisë mund t'ua ndryshojë emërtimin (toponimin) vendbanimeve ekzistuese sipas përcaktimeve me atë ligj, pas mendimit paraprak të marrë nga kuvendi i komunës"*. Me dispozitat e nenit 72, paragrafi 1, të Ligjit të sipërshënuar, "*Organet e Komunës së Malishevës pushojnë se punuari ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji*". Në anën tjetër, formohen komunat e reja si Zubin Potoku, Zveçani, Shterrpca dhe Gora. Me dispozitat e nenit 73 të Ligjit në fjalë, kuvendet komunale detyrohen t'i "*rishqyrtojnë emërtimet ekzistuese të vendbanimeve dhe të caktojnë emërtime të reja në afat prej një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi"*. Kjo do të thotë se së pari përmes akteve juridike fillohet me sllavizimin e toponomisë autoktone shqiptare.

Përiktazi me qëllimet e politikës kolonizuese e diskiminuese të pushtetit serb në Kosovë po i paraqesim disa thënie të Vojisllav Sheshelit, në atë kohë zëvendësministër i Qeverisë së Serbisë:

"…. Duhet të promolgohet një ligj special, në bazë të të cilit të gjitha tokat dhe pasuritë e tjera të shqiptarëve do t'u kthehen serbëve dhe Kishës Ortodokse Serbe të Kosovës dhe Metohisë… Duke zgjeruar tokat dhe pasuritë e tyre, manastiret do të realizojnë në një mënyrë të shkëlyer misionin e tyre fetar, kulturor dhe kombëtar …… Gjatë ngjarjeve që ndodhen në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, vetëm priftërinjtë serbë qenë ata që nuk lëvizën nga Kosova. Kështu që, në saje të patriotizmit të tyre dhe të drejtës së tyre të tashëgimisë, ata meritojnë të kenë prona të mëdha…. Tokat që u janë shitur shqiptarëve ose që në një mënyhrë apo në një tjerër kanë rënë në duart e tyre, duhet t;u kthehen ish pronarëve serbë ose trashëgimtarëve të tyre…. Ka plotë toka të shtetit që mund t' jepen apo shiten serbëve që do të vijnë nga jashtë Kosovës dhe Metohisë … Shtojmë se tokat e kooperativave bujqësore janë të mjafa për të vendosur një numër të madh kolonistësh… Është fare lehtë që të përqendrohen në këto toka serbë, të cilët do të bashkëpunojnë ngusht me qendra të tjera të këtij lloji për të dhënë ndihmë në zhvillim. Vendosja e një zinxhiri qendrash të tilla është e mundshme në zonat e Deçanit, Prizrenit dhe Suharekës, ku, pasi të dëbohen shqiptarët, një barrikadë e fortë mbrojtëse kundër Shqipërisë do të jetë sigurtë… (Pra kështu u veprua me kolonët nga Shqipëria të cilët u vendosën në qendrat e njohura në Baballoq,

[33]"Sl. Glasnik RS", nr. 47/94.

Deçan, Junik e gjetiu. J.O.).. *"Kolonizimi i Kosovës dhe i Metohisë duhet të realizohet shpejt dhe përfundimisht. Nëpërmet propagandës politike, kolonistët do të paraqiten si serb që popullojnë tokën serbe dhe nuk ka rëndësi në ç'pjesë të vendi ata jetojnë, përsa kohë që jetojë në vendin e tyre. Këta serbë do të pajisen me vegla dhe hua afatgjata, kështu që mund të kultivojnë tokën që u është falur, e cila do t'i bëjë të mos ikin ... Duke marrë parasysh shpërndorjen e tanishme etnike (vetëm pak enklava rurale serbe dhe mbi 700 qendra thjesht shqiptare) ... ne mendojmë se kolonizimimi duhet të realizohet në në ënyrë të organizuar, nëprmjet krijimit të fshatrave, qendrave dhe qyteteve të vogla të rija ose të lagjeve të reja në qytett ekzistuese. .. Në këtë mënyrë populli mund të ndahet sipas linjës etnike, ndërsa popullsia serbe në minoritetet në lagjet e përzjera nëpër qytete do të kalojnë gradualisht në enklavat e porsakrijuara, ide kjo që kërkon si mështetje, ashtu edhe motivim. Me qëllim që enklavat serbe të jen të mbrojtura, një popullsi shqiptare prej 5 deri 10 % do të instalohet atje (një përzgjedhje familjesh të shquara dhe me autoritet). .. Enklavat serbe do të varen kryesisht nga furnizimet e shtetit, ndërsa zonat shqiptare kryesisht nga firmat private ... furnizimi me energjit elektrike dhe ujë për enklavat shqiptare mund të ndërpritet për ta bërë jetën e tyre të padurueshme.... Por në qoftë se serbët i gjejnë tërheqëse enklavat shqitpare fqinje (me dyqane private, vende dëfrimi etj.), kjo mund të eleminohet duke provokuar incidente në këto enklava, si rrahje dhe dhunë..."*.[34]

Me fillimin e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, shumë banorë të ardhur nga Vrraka ishin inkuadruar në radhët e ushtrisë, policisë, paramilitarëve serbë në luftë kundër UÇK-së dhe në krime të shumta kundër popullatës civile shqiptare. Me mbarimin e luftës ata u larguan dhe u vendosën në vise të ndryshme të Serbisë.

[34] http://www.cezarkurti.com/sshesheli.html - Projektplani serb për pastrimin etnik të Kosovës- Dekrarat e zëvendskryeministrit të Serbisë Visllav Sheshel, Botuar në gazetën "Illyria, New York, 8 prill 1999 - Marrë nga "A statement by Serb Deputy Prime Minister Voislav Seselj in Velika Srbija, The Greater Seria Journal, Bel grade, Oct. 14, 1995).

Hartë e kolonizimit të Kosovës me elementin serb në periudhën

e viteve 1918-1941 (me te zeza, vendet ku jane kolonizuar serbet në Kosovë).

Phd.Ardita Hajdari - BUQINCA

HISTORI E RELIGJIONIT TË SHQIPTARËVE NË SHQIPËRINË E SIPËRME 1912-1913

Për ngjarjet e ndodhura gjatë kësaj periudhe që shoqëroheshin me dhunën që ushtronin forcat malazeze mbi bazën e përkatësisë fetare, ofrohen të dhëna të dokumentuara për procesin e asimilimit të popullatës shqiptare. Si fillim, debuton letra e myftiut të Gucisë të dërguar kryemyftiut të Malit të Zi, Murteza Efendiut. Në letrën e dërguar, myftiu i Kazasë së Gucisë, Shabani do njoftonte kryemyftiun për pushtimin e Plavës nga forcat ushtarake malazeze në dhjetor të vitit 1912, përkundër rezistencës së vazhdueshme. Po ashtu, gjenerali malazez Janko Vukotiq e rrethoi Gucinë duke propozuar që të dorëzohet pa rezistencë. Njëkohësisht premtoi sigurinë e popullsisë se nuk do të i'u cenoheshin të drejtat njerëzore. Në ditën e katërt gjeneral Janko Vukotiç me ushtrinë e tij u nis në drejtim të Pejës dhe të Gjakovës. Mirëpo, me braktisjen e vendit nga gjenaral Vukotiqi, në vend të tij filluan të udhëheqnin Kajmekami (prefekti) i Kazasë së Gucisë, Millutini dhe kryetari i Komunës së Gucisë Miliqi. Millutini dhe Miliqi me babain e tij Gjonin, filluan me tortura ndaj popullsisë. Sipas një kumtese të pushtetit malazias të lëshuar më 2 mars të vitit 1913, urdhëroheshin të gjithë banorët e Plavës dhe Gucisë që ta braktisin fenë islame. Mirëpo, me refuzimin e kësaj urdhërese pushteti malazias filloi përdorimin e metodave më të egra, duke bërë seleksionimin e popullsisë për t'i pushkatuar dhe masakruar. Përveq kësaj, filluan me dhunë kryqëzimin e popullatës së kësaj krahine e cila në dokumentet e kohës përshkruhet në këtë mënyrë: "Ju bëjmë me dije se edhe pse gjatë muajit dhjetor 1912 lufta kishte vazhduar kundër pushtuesit (për t'i mbrojtur tokat shqiptare), por përsëri Plava është pushtuar me forca ushtarake". Në të njëjtën kohë Gjeneral Janko Vukotiq, kryekomandant i ushtrisë së Malit të Zi me dhjetëra mijëra ushtarë e kishte rrethuar nga të gjitha anët e Gucinë, duke propozuar dorëzimin pa rezistencë, me premtimin e sigurisë së popullsisë, mbrojtjen e pasurisë, familjeve, moralit, besimit dhe të drejtat njerëzore. Si rrjedhojë, popullsia, ulemaja (dijetarë të fesë) dhe paria e Gucisë mbajtën një tubim gjithëpopullor duke ia bërë me dije gjeneralit Vukotiq, vendimin dhe kushtet e marrjes në konsideratë të kërkesave shqiptare për ta dorëzuar qytezën. Gjenerali i lartëpërmendur i kishte pranuar të gjitha kërkesat e tyre, edhe në emër të princ Nikollës i kishte garantuar sigurinë e plotë gjatë hyrjes së ushtrisë së

tij në qytezë. Realisht, kërkesat ishin që të garantohej siguria e plotë me ligjet ndërkombëtare, gjë që kishte ndodhur për vetëm tri ditë: "gjatë tri ditëve e tri netëve (të ushtrisë së tij) nuk i ndodhi asnjë e keqe asnjë personi, as në aspektin moral as në atë të torturës fizike, dhe nuk pati viktima në njerëz".1

Në këtë kohë Qeveria e përkohshme e Malit të Zi kishte filluar formimin e garnizoneve të ushtrisë së rregullt, ndërsa në ditën e katërt, gjeneral Janko Vukotiq me ushtrinë e tij ishte nisur në drejtim të Pejës dhe të Gjakovës.: "Mirëpo, meqenëse general Vukotiqi e braktisi vendin tonë, në vend të tij tani filluan të udhëheqin Kajmekami (prefekt)i i Kazasë së Gucisë, Millutini dhe kryetari i Komunës së Gucisë Miliqi, të cilët menjëherë filluan me llojlloj torturash ta mundojnë popullsinë tonë. Këta dy qeveritarë lokalë Millutini dhe Miliqi me babain e tij Gjorgjin, për çdo ditë, nga njëzet herë në ditë e bënin kontrollimin në qytezën tonë, nevojtarët dhe kalimtarët e përditshëm, banorët e pafajshëm si dhe parinë dhe tregtarët i maltretonin, dhe i torturonin. Gjithashtu parinë dhe ulemanë, që kalonin nëpër qytezë i shanin dhe i poshtëronin, bile edhe pleqtë 80-vjeçar që memzi qoheshin në këmbë midis tregut (çarshisë) i rrihnin dajak dhe i shqelmonin. Popullsia e mjerë dhe e pafajshme, e pambrojtur është duke përjetuar maltretime dhe tortura që as penda nuk mund t'i përshkruajë. Ju informojmë duke qajtur, zemra ime e shkatërruar dhe e lënduar, mendja dhe shpirti im të shkatërruar, se çfarë rrugëdalje duhet gjetur për këtë gjendje tragjke, vendosa ta informojë Hirësinë Tuaj fisnike që sa më parë të shkoni dhe të intervenoni te princ Nikolla i Malit të Zi".2

Më datën 2 mars të vitit 1913 ishte lëshuar një kumtesë ku ftohej e gjithë popullsia e Krahinës që menjëherë ta braktisin fenë aktuale.: "Në kumtesë thuhet: Të gjithë ju banorët (e Plavës dhe të Gucisë) jeni të detyruar të vini në qendër të Pushtetit". Mirëpo, kjo urdhëresë e pushtetit malazias ishte refuzuar në mënyrë kategorike. Menjëherë të nesërmen pushteti malazias kishte vepruar me metoda të egra dhe masakruese. Pushtuesit bënin seleksionimin, duke i marrë më të aftët nga popullsia shqiptare: Tetë personalitete më të njohura nga Ulemaja, shtatë haxhi, dy profesorë, tridhjetë personalitete nga Paria dhe pesëdhjetë e dy burra-trima, së bashku me njëqind meshkuj të tjerë i kishin mbledhur nga Krahina e Gucisë dhe e Plavës dhe të gjithë këta njerëz të pafajshëm, ishin pushkatuar dhe masakruar.3: "Nga dhjetëra mijë njerëz që i kishin marrë me dhunë për t'i konvertuar (për t'i kthyer në fenë ortodokse–pravosllave), katërqind veta duke

---

[1] Dokumente të publikuara nga Zekeria Cana në revistën D.I., Nr. 63, Nëntor-dhjetor 1994, f. 24.

[2] Po aty, f. 24.

[3] Po aty.

ikur në mal kanë shpëtuar, ndërsa dymbëdhjetëmijë veta që i kishin tubuar për konvertim, burra dhe gra, së pari i zgjodhën treqind veta duke i poshtëruar me dhunë i sollën në kishën ortodokse dhe familjet tona përnjëherë u nxorën me dhunë të xhandarmërisë së armatosur, dhe u sollën në kishë për t'i kthyer në fenë ortodokse. Me të vërtetë për tjera ngjarje nuk kam çka të shtoj, vetëm se tani mbeta i pamend. Zoti qoftë me ne!".

Myftiu i Kazasës së Gucisë, Shabani"[4]

Nuk ishin vetëm shqiptarët e besimit islam që detyroheshin me dhunë të ndërronin fenë por edhe ata të besimit katolik. Një konvertim i tillë më i theksuar ishte në Gjakovë e rrethinë. Udhëheqës të shumtë të pushetit malazez ishin marrë në pyetje, për përgjegjësitë që kishin në krimet e bëra ndaj popullatës shqiptare, për shkak të vrasjeve, burgosjeve, arrestimeve, djegieve të shtëpive, grabitjeve, plaçkitjeve, bastisjes të shtëpive etj. Për këto vepra mbaheshin edhe procesverbalet. Në një procesverbal të mbajtur në Guci, më 9 qershor 1913, i akuzuari Millutin Radonjiq i emëruar si ushtrues detyre i zyrtarit krahinor deklaron se gjatë kohës sa ishte i shkarkuar nga detyra kishte marrë informata se kishte patur kryqëzime, vrasje, djegie shtëpish dhe se sipas disa myslimanëve për shkak të kësaj dhune dhe dhunave të tjera të pushtetit dhe ushtrisë malazeze shumë njerëz dolën kaçak. Mirëpo, sa i përket konvertimit në fenë ortodokse në këtë procesverbal sipas të akuzuarit, me dëshirë pranonin që të kalonin në ortodoksisëm. Siç, ishte rasti me paraqitjen e dy vëllezërve nga Rzhanica dhe një qytetari nga qyteza e Gucisë: "Ata u paraqitën me lutjet e shkruara, duke kërkuar të kalojnë në ortodoksizëm. Në mbështetje të deklaratave të tyre e thirra myftinë e këtushëm Zoti Shabo Musiq dhe duke qenë ai i pranishëm, të përmendurit i mora në pyetje me procesverbal: nëse këtë e bëjnë me dëshirë të plotë apo me detyrim. Ata deklaruan se dëshironin të kryqëzohen me vullnet të plotë dhe me miratimin e myftisë, kështu që lejova të kryqëzohen. Ata janë edhe sot ortodoksë, nuk do të kthehen kurrë në fenë muhamedane, sepse kaluan në ortodoksizëm me gjithë qejf".5

Gjatë gjithë këtyre torturave që iu bënë popullsisë shqiptare përveç këtyre ishte dhe imponimi me dhunë i bartjes së kapicës malazeze. Për ngjarje të ndodhura dhe të zhvilluara gjatë kësaj kohe ekzistojnë procesverbale se gjatë kësaj lufte janë bërë dhe dëme në xhami dhe në varreza. Në procesverbalet e kohës dëshmohet marrja në pyetje e të pandehurit Sulo Radoniçit i cili kishte akuzën e cila në procesverbal është dokumentuar si vijon:"Sulejman Radonçiq ju akuzon se keni urdhëruar ta rrahin, se e keni mbyllur dhe e keni ndaluar ta thërras

[4] Po aty.

[5] Po aty, f. 28.

ezanin në xhami? Ndërsa përgjigja e tij ishte: Sulo Radoniçin nuk e kam rrahur kurrë, por e kam mbyllur dhe ia kam vu prangat për veprimin e tij, për çfarë ekzistojnë shkresat në Drejtoratin krahinor."6

Masat terrorizuese të pushtuesve malazias, detyruan një pjesë të popullatës shqiptare kryesisht, gra, fëmijë dhe pleq të merrnin arratinë dhe të largohen nga vendi, meshkujt merreshin peng dhe dërgoheshin në Nikshiq. Me largimin e tyre, komandant Sava Llazareviq u dogji kullat për tu siguruar në moskthimin e tyre. Një dëshmi e gjendjes së shtëpive pas lirimit të robërve citohet: "Nga koha kur ushtria malazeze i pushtoi këto vise, unë së bashku me njerëzit tjerë pengjë u dërgova në Nikshiq. Kur u ktheva me urdhërin e Mbretit, gjeta vetëm shkretëtirë. Në kulla m'u dogjën 10 bludë drithë, u zhduk sahati, 53 groshë dhe njëmijë e pesëqënidë groshë në vërtetime''.7

Sipas një ankese dërguar komisionit për hetimin e keqëpërdorimit në Pejë, ish komandanti i xhandarmërisë Sava Llazareviq kishte urdhëruar që në fshatin Baran i Poshtëm (komuna e Gorazhdecit) që të pushkatohen Hazir Alia dhe Hazhi Haziri, vetëm për shkakun se nuk pranuan të kryqëzoheshin. Po ashtu, me rastin e bastisjeve, në kërkim të armëve, të fshehura komandant Sava Llazareviq me ushtrinë e tij shkoi në fshatin Novosellë, edhe pse me rastin e mos gjetjes së armëve dhe mos pranimit të kryqëzoheshin i vrau dy vëllezërit Osmanin dhe Sylën.

Ekzistojnë procesverbale të shumta lidhur me akuzat e ngritura ndaj udhëheqësve të shumtë të pushtetit malazez, të paraqitura para Komisionit hetues. Në një procesverbal të mbajtur në Pejë, më 24 qershor 1913, para Komisionit hetues, për të marrë në pyetje komandant Sava Llazareviqin lidhur me akuzat e ngritura kundër tij për vrasje - pushkatime – jo ligjore, të cilat i kreu Llazareviqi si shef i policisë në rajonin e Pejës, janë 37 padi të paraqitura nga anëtarët e familjeve të të vrarëve, i cili së bashku me Tomo Joksimoviqin kishin vrarë 60 njerëz, qoftë edhe pa hetimin më të vogël ose pa çfarëdo procedure gjyqësore apo procedure të ngjashme, (të vrarët) janë nga: Novosella, Dubova, Turjaka, Grabovci, Vranovci, Poçesta, Sfërka, Llutogllava, Kosuriqi dhe Nobërgjani.

E njejta metodë vazhdoi dhe në Gjakovë. Sipas një procesverbali të mbajtur para komisionit hetues i datës 4 korrik 1913, për marrjen në pyetje të Savo Memedoviqit, ish shef i xhandarmërisë në anën e Gjakovës, i cili gjykohej për pushkatimin e tre personave, me arsyen: "U pushkatuan ngase u konstatua se ishin ata që, në Drenoc sollën lajmin e Bajram Currit dhe të tjerëve nga Curraj dhe Krasniqa se nuk duhet t'i dorëzojnë armët, sepse ata me ndihmën e Austrisë

---

[6] Po aty, f. 29.

[7] Nr. 64, Janar 1995, f. 20.

së shpejti do të zbresin nga Malësia me 30.000 shqiparë dhe do ta bashkojnë anën e Gjakovës me shtetin e lirë shqiptar. Kjo pati ndikimin e vet, kështu që në tri fshatrat: Drenoc, Carrabreg dhe Prilep u ruajtën 610 pushkë, për të cilat ishte pranuar se ekzistonin. Këto pushkë janë ruajtur deri më sot, ndoshta me ndonjë përjashtim të vogël. Të gjithë i konsideroja si kryengritës dhe tradhtar të shtetit dhe si të tillë i ndëshkova me vdekje."8

Po ashtu, duke u bazuar në procesverbalin më 13 gusht 1913, në pyetje u morë Marko Kusovaci-ish shef i përkohshëm i policisë në Pejë, lidhur me vrasjet e kryera mbi myslimanët e anës së Pejës dhe të Gjakovës: "Me çfarë misioni jeni dërguar para disa muajve së këtejmi në nahinë e Gjakovës?

U dërgova për të mbledhur armët në nahinë e Gjakovës, sepse sado që disa nëpunës tanë shkuan atje dhe mblodhën armët dyshohej se kishe ende armë të fshehura, gjë që edhe u vërtetua. Shkova në fshatrat e atjeshme, ku të tjerët para meje kishin mbledhë armët dhe më siguronin se ato fshatra kishin dorëzuar të gjitha armët që kishin, prandaj në ato fshatra nuk guxohej të prekej askush. Mirëpo, në ato fshatra gjeta një mori armësh të fshehura. Atje mblodha 1000 copë pushkë të gjata mauzer dhe martina, shumë revolver, mes të cilëve kishte edhe prej sermi. Të gjitha armët u dërguan në Drejtoratin Krahinor, kurse zotit Pllamenac iu referua mbi sigurimet e përmendura dhe pos tjerash e akuzova Gavro Protiqin, komandant i atëhershëm i trupës ushtarake në Deçan dhe kapiten i tanishëm i rrethit në Pejë, për dhënien e sigurimeve të atilla. Kërkova që ai të akuzohet para gjykatës për tradhti shteti, por nuk u bë asgjë. Për sigurimet e zëna ngojë është bërë me dije zoti Pllamenac dhe këtë e kanë të njohur Ivan Çukiq, kapiten i atëhershëm në Gjakovë, dhe Sava Meme, shef i atëhershëm i xhandarmërisë në Gjakovë.

Ç'mjete dhe mënyra keni përdorur gjatë mbledhjes së këtyre armëve?
Zakonisht i tuboja krerët e fshatit dhe urdhëroja t'i sjellin tek unë të gjithë meshkujt nga 12-70 vjeç dhe, kur bëheshin të gjithë tubë, regjistroja emrat e kryefamiljarëve, dhe numrin e meshkujve. Pastaj u shpjegoja se ç' mirëqenie dhe liri do të gëzojnë nën pushtetitn e Mbretit tonë, duke u përmendur mëshirën e Mbretit që të mos fajësohen ata, të cilët i dorëzojnë armët dëri më 25 janar të këtij viti, por ata që nuk e bëjnë këtë deri atëherë, do të konsiderohen si kryengritës dhe do të ndëshkohen. U theksoja se dihet që ata kanë ende armë, kërkoja të më sjellin një person që do të më sjell armën deri në afat, duke dhënë fjalën se nuk do ta gjejë asgjë dhe këtë fjalë e mbajta. Ata që u kallëzuan se kishin armë dhe nuk e dorëzuan, i torturova deri sa e pranuan dhe treguan armën dhe atëherë i dërgoja në Gjakovë për hetime. Qëlloi rasti që p.sh. në vendin Batushë urdhërova

[8] Nr. 65, shkurt 1995, f. 16.

vrasjen e hoxhës së atjeshëm që thoshte me këmbëngulje se s'kishte armë, kurse ai u denoncua se ku e kishte fshehë, kështuqë urdhërova ta sjellë dhe të vritet para popullit.

A ka pasur vrasje tjera nga ana juaj dhe organeve varëse?

Po, nëntogeri Velimir Novoviq, i cili sipas urdhërit tim i shpiente në Gjakovë batushasit dhe junikasit, do të thotë ata që e kishin pranuar me dajak se kishin armë, siç më raportoi, i kishte vrarë disa ngase kishin provuar të iknin. Nuk e di sa u vranë gjithësejt, por në kohë i referova prefektit krahinor."[9]

Si përfundim, tendencat për të konvertuar dhunshëm popullsinë shqiptare sidomos në Pejë dhe Gjakovë kishin dështuar, për më shumë ishin jo-efektive, pasi që siç dëshmon Mitropoliti i Pejës Gavrillo Dozhiq në një letër të dërguar Marshallit të Cetinës, edhe ata që më parë kryqëzoheshin, e që është fjala për katolikët shqiptarë para pushtimit malazez, gjatë administrimit malazez nuk kryqëzohen më, ngaqë nuk donin të solidarizoheshin me konvertimin e dhunshëm. Ndërsa, zhgënjimi i administratës pushtuese malazeze i dëshmuar edhe në dokumentet e ofruara nga autori ishte edhe më i madhë kur myslimanët e konvertuar në ortodoks, ktheheshin në fenë katolike. Si rrjedhojë, një numër i madhë i popullsisë shqiptare u shpërngulën në Shqipëri dhe Turqi ose dolën kaçakë dhe vazhduan rezistencën.

[9] Nr. 65, shkurt 1995, f. 17.

Dr. Ylber DYLI, Msc. Gerhard JAHAJ

IDENTITETI ETNO-KULTUROR I RAJONIT ANA MALIT

Abstrakt

Kombet që u shpërndanë janë produkt i lëvizjes së kufijve në rrethana të caktuara historike nga vendimmarrjet e shteteve të fuqishme. Këto lëvizje sollën që shtetet amëtare të kufizohen me popullsi dhe territore të tyre autoktone. Vendin e konflikteve dhe të ndasive, sot e kanë zënë politikat e bashkëpunimeve ndër kufitare në kuadër të globalizmit dhe marëdhënieve integruese të fqinjësisë së mirë.

Shteti shqiptar bën pjesë tek grupet e shteteve, kufijtë e së cilës kufizohen me truall dhe popullsi etnike shqiptare. Rajoni Ana e Malit përfaqëson një pjesë të hapësirës ndër kufitare autoktone të ndarë ndërmjet dy shteteve fqinje Shqipëri-Mali i Zi.

Rajoni i Anës së Malit dallohet për veçoritë gjeografike dhe të trashigimisë të kultures materiale dhe historike. Vlerësimi i këtij identiteti lehtëson rregullimin e marëdhënieve të dëmtuara ndër etnike të së kaluarës. Sot, ky identitet lehtëson dhe i paraprin politikave integruese në Bashkimin Europian të vendeve të Ballkanit perëndimor.

Vlerësimi dhe analiza e identitetit etno-gjeografik i rajonit Ana Malit, do të shërbejë si urë lidhëse në marëdhëniet ndër shtetërore dhe në sigurimin e mirëqënies së përbashkët të komunitetit të këtij rajoni.

Fjalë kyçe : Identitet, hapësira ndërkufitare, integrim, rajon, bashkëpunim.

Hyrje

Kombet që u shpërndanë janë produkt i lëvizjes së kufijve në rrethana të caktuara historike.Këto lëvizje më së shumti u ndërmorrën në shekujt 19-20. Produkti i këtyre lëvizjeve, solli prezencën e pakicave etnike, që u bënë burim konfliktesh nërshtetërore.Ne te shumten e rasteve ndaj ketyre pakicave u ndoqën politika represioni,spastrimet etnike dhe dëbimet.Minoritetet si pjesë e politikave

kombëtare sot përbëjnë dy grupe me të drejta të ndryshme, pakicat autoktone dhe emigrantët.

Rrethanat historike të mësipërme përcaktuan ndarjen e padrejtë të kufijve të kombit shqiptar, nga fuqitë e medha.Rajoni Ana e Malit është një ndër hapësirat shqiptare që u coptua nga vendimet e 22 marsit 1913 nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër.

Rajoni Ana e Malit kufizohet në veri me malin e Taraboshit, në perëndim me lumin Megjyreç, në lindje me lumin Buna, në jug me liqenin e Shasit dhe ze një sipërfaqe prej 159,610 km2. Në hapësirën e Malit të Zi gjendet një sipërfaqe prej 103,76 km2 e këtij rajoni, ku janë vendosur 20 vendbanime, ndërsa në Republikën e Shqipërisë 55,85 km2 dhe shtrihen 11 vendbanime.

Materialet dhe metodat

Për përpunimin dhe prezantimin e këtij punimi janë shqyrtuar burime arkivore, historike të pasura , manuale statistikore me të dhëna në funksion të objektit të punimit.
Materiali i siguruar ka mundësuar posedimin e metodave krahasuese dhe analizuese duke përmbushur qëllimin e punimit të artikullit.

Rezultati

Coptimi i kombit shqiptar ishte rezultat i vendimmarrjeve të fuqive të mëdha, të cilat nuk e njihnin realitetin shqiptar, plotësonin orekset e kundërshtarëve dhe aleatëve të tyre. Siç do të shprehej Durham ”*Gladstone,që nuk i kishte vizituar kurrë këto krahina, mendonte që të gjithë muslimanët ishin turq, ndërsa të gjithe kristianët e Ballkanit engjëj, prandaj në mënyre të pameshirshme ngulte këmbë në dorëzimin e shqiptarëve të pafat te armiku më i keq i tyre.(*Durham 2009:67)
Aneksimi i tokave shqiptare në favor të shteteve fqinje të konsoliduara u hapte rrugë politikave shtetërore të kolonizimit dhe spastrimit etnik. Princi Nikolla theksonte: ”*Me vendosjen e malazezëve prej Mozhuri e deri te Buna,tërë pellgun e Ulqinit e malazezojnë”.*

Me vendosjen e malazezëve zhduket tipi shqiptar i kësaj ane.Qëllimi nuk ishte thjesht aneksim,bashkëjetesë mes popujve , por kolonizimi *“ duke vendosur ketu 4-5 mijë famijle malazeze me ane të hapjes së shkollave…Kur të realizohet ky projekt atëherë ky rajon i bukur dhe i pasur do të jetë krejtësisht dhe përgjithmonë i Malit të Zi*”.(Draga 2001:16)
Format asimiluese që u përdorën ndaj shqiptarëve

Rrugët dhe mënyrat e realizimit të këtij qëllimi ishin nga më të ndryshmet.

Reforma agrare që u ndërrmor ishte krejtësisht ndaj shqiptarëve, të cilëve ju konfiskua prona duke ju dhënë popullsisë malazeze.

Me humbjen e të drejtës mbi tokën, shqiptarëve ju ndalua e drejta për të jetuar në tokat e tyre shekullore, duke i dëbuar me dhunë siç ishte rasti i banorëve te Malit të Brisë në vitet 1912-1914.Pavarësisht nga konventa mbi reciprocitetin e vitit 1927 popullsia shqiptare e dëbuar me forcë e humbi të drejtën mbi pronën. (Markiqi 2000:91)

Diskriminimi ekonomik ishte një rrugë tjetër për asimilimin dhe spastrimin etnik.Për shkak të këtij fenomeni vendbanimet e banuara nga shqiptarë u preken më së shumti nga emigrimi. Në vitin 2011 në bazë të regjistrimit të popullsisë rezultojnë 155 banorë më pak se në vitin e largët 1948 ose 3%.

Hapja e shkollave joamtare dhe ndalimi i shkollimit të femijëve shqiptarë në gjuhën amtare.Kjo politikë ishte mjaft e egër veçanërisht në periudhën 1918-1941.(Berisha 2000,174-175)

Rastet e deformimeve të toponimeve janë te shumta. P.sh Mali i Brisë toponimi tipik shqiptar I formuar nga fjala"Mal" dhe "Brinje" në hartën gjeografike është shënuar "Brisko Gora" ndërsa toponimi Millë shkruhej Mide (Draga,1997:26,28)

Krahas deformimit të toponimeve ishte dhe ndryshimi rrënjësor siç është rasti i vendbanimit Katërkollë i cili u pagëzua me emrin "Vladimir"(Draga 1997,68).

E njëjta politikë u ndoq edhe patonimet ,të cilat morën trajtë me prapashtesë sllave "viq" "iq" P.sh Kaca-Kaciq,Gjeko-Gjekoviq etj.

Vetëm në qershor të vitit 1992 , parlamenti i Malit të Zi miratoi ligjin "Emri personal", i cili është në favor të barazisë së gjuhëve dhe shkrimeve në gjuhën amtare.

Politikat asimiluese ndaj popullsisë shqiptare nuk dhane rezultatet e pritura nga caqet shoviniste malazeze përgjatë një shekulli.

Në regjistrimin e vitit 2011 në vetëdeklarimin për etninë janë deklaruar shqiptarë ne Anen e Malit 4830 banorë ose 96.5% ndërsa 2.5% malazezë,pjesa tjeter etni të tjera.

Në deklarimin sipas gjuhes 4827 banorë ose 96.4% flasin shqip.

Trashëgimia etno-kulturore

Rajoni Ana e Malit dallohet për veçori e trashëgimi të kulturës materiale,shoqërore, shpirtërore dhe artistike.

Të jetuarit si fqinj me malazezët,lëvizjet e popullsisë,përzierja e tyre solli që në mënyrë të diktuar apo të pavullnetshme në mbartjen e veçorive etno-

kulturore edhe tek malazezët.

Malazezët kanë qenë më tepër të shtënguar ndaj zakoneve shqiptare sesa atyre serbo-kroate.Ato kanë marrë dhe janë bërë pjesë e tyre:besa ,fjala e dhënë,martesa në bark,qitje me pushkë në dasëm,mitologjia se çdo shtëpi ka gjarpërin e vet si ogur i mirë që nuk duhet vrarë",zakone që sdo mend i kanë marrë nga shqiptarët.(Çapaliku,Dibra,Rama 2005:17)

Besa ka qenë nje ndër virtytet karakteristike të shoqërisë shqiptare.Ky virtyt është transmetuar dhe identifikuar me identitetin kombëtar në fjalët e urta te anamalasve"Kush është bërë burrë e ska burrni vyn ndër shqiptari","Kush e la shoqin në rrezik e ndjek marrja nat e dit"(Mustaqi,2006:258-264)

Një mitologji e lënë e gjallë dhe me tipare shpirtërore dëshmohet në pelegrinazhet në male e vendosja e banjerit në majat e larta"(Tirta,2000:264).Ky ritual vazhdon sot e kësaj dite në pranverë.

Pasurimi i fondit të kulturës popullore përbën edhe arkitektura e mullinjve të drithit ku gjenden rreth 40 të tillë në Millë dhe Kravar"(Draga,1994:181)

Fondi i kulturës janë ninullat,me anë të të cilave u shprehin ëndrrat,shpresat,dëshirat dhe urimet e pambarimta për vogëlushët e tyre "O.o ti më flej në djep të drurit,o,o je mu bash i pari i katundit.(Instituti i kulturës popullore 1982:12)

Ceremonia e dasmës është e ndërthurur edhe me atë pagane duke treguar përputhje me kulturën komplekse të paraardhësve ilir.Kulti I gjarprit është i pranishëm si simbol magjik që u reziston me sukses të gjitha magjive që kanosin nusen nga syri i keq"(Nika,2000:276).

Elemente të tjerë që lidhen me ceremonialin e dasmës janë sjellja tri herë e nuses në shtëpinë e dhendrit,akti i thyerjes së pasqyrës etj. Kënget e dasmës janë të shumta dhe objekt i tyre është bukuria e nuses dhe e dhëndrit.Rituali i matesës tek popullsia anamalase ka bartur vlera të veçanta kombëtare, nëpërmjet kostumeve popullore tradicionale dhe flamuri kombëtar që ka shoqëruar gjithmonë dasmorët.

Veshjet popullore janë fondi më i rëndësishëm i kulturës anamalase. Pëlhurat prej liri,mëndafshi dhe pambuku janë tradicionale.Ana e Malit ka patur traditë edhe nxjerrjen dhe përpunimin e mëndafshit.

Veshjet tradicionale janë :"Kemishat e gjata për përdorim të përditshëm të bëra me pëlhurë prej liri e pambuku(Onuzi,2000:271)

Veshja si simbol kombëtar është ruajtur deri në ditët tona. Vajzat anamalase pajisen edhe sot me kostum popullor në ditën e dasmës, duke ruajtur simbolin dhe identitetin kombëtar.

Konkluzione

Vlerësimi I trashëgimisë etno-kulturore të shqiptarëve në tërësi jashtë kufijjve dhe anamalasve në veçanti si object studimi në të cilin është ky artikull arrin në përfundimin se është ruajtur e gjallë tradita, kultura dhe zakonet shqiptare. Zhvillimet e reja të shteteve respective Shqipëri dhe Mal i Zi në kuadër të politikave të fqinjësisë së mirë por edhe të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga aspiratat për integrimin në bashkimin europian mundësojnë lëvrimin dhe glorifikimin e identitetit etno-kulturor të popujve brenda një shteti.

Rajoni Ana e Malit si hapësire ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi si dhe ekzistenca ndërmjet dy qëndrave ekonomike dhe kulturore Shkodër-Ulqin merr një vlerësim dhe trajtim të veçantë në aspektin e lëvrimit të vlerave etno-kultutore.Hapja re doganës së përbashkët shqiptare-malazeze Sukobin-Muriqan më 18 qershor të vitit 2009 ka vendosur rajonin Ana e Malit në një pozitë të favorshme atraktive për vlerat etno-kulturore.

Vlerësimi I trashëgimisë historike, intensifikimi i shkëmbimeve kulturore do të kontribojë në forcimin e identitetit të rajonit.Modelet e këtij bashkëpunimi janë present në hapësirat ndërkufitare të BE-së dhe implementimi I tyre nga organet drejtuese qëndrore dhe lokale shqiptaro-malazeze do të zhdukte barrierën ekzistuese, duke sjellë që në vend të urrejtjes mes popujve të zinte vend nevoja për bashkëpunim, zhvillim dhe prosperitet të përbashkët.

Mendjet e ndritura dhe largpamëse parashikojnë një gjë të tillë që në momentin kur kufijtë u ndanë padrejtësisht. Xhorxh William në fillim të shekullit të kaluar ngrinte zërin dhe theksonte: “Do të vijë dita kur diplomacia e zezë me rrënjë në epokat e mesjetës që i quant ë gjithë kombet armiq për vdekje, të bëhet copa-copa dhe të zëvëndësohet me ndjenjën e simpatisë dhe te vllazërisë mes njerzve dhe ne të zgjohemi dhe të kuptojmë se mbarësia e një populli nuk do të thotë doemos fatkeqësia e tjetrit, që sllavët , gjermanët ,anglezët ,turqit apo shqiptarët të jenë sa më të bekuar nga zoti dhe të gezohen për përparimet dhe lumturinë e njëri-tjetrit”.

Biblografi

- Berisha , P, “*Shkollat dhe arsimi i shqiptarëve në territorin e sotëm te Ulqinit gjatë motmoteve*” Ulqini në rrjedhat e kohës, Art klub,Ulqin, 2000
- Draga , N, “ *Gjurmë gjepografike*” ,Art klub,Ulqin, 1997
- Draga , N ,”*Shqiptarët në Mal të Zi*” , Art klub,Ulqin, 1994
- Draga , N ,”*Shpalime gjeografike* ”, Art klub,Ulqin, 2001
- Durham ,E , “*Për fiset ,ligjet e zakonet e ballkanasve* “,Arbëria,Tiranë

2009.
- Markiqi ,L,"*Kufijtë , Shtetësia ,Dypronësia , Ndërlidhësia dhe pasojat*", Ulqini në rrjedhat e kohës, Art klub,Ulqin, 2000
- Çapaliku, A.Dibra,M ,Rama,Sh. "*Paralele folklorike ndërkufitare*" Camaj-Pipa,Shkodër 2005.
- Montenegro census 2011
- Mustaqi,A, "*Visare shqiptare,Fjalë të urta*"Argeta-LMG,Tiranë 2006
- Nika,M ,"*Gjurmë lashtësie në dasmën e Anës së Malit-Ulqin*" Ulqini në rrjedhat e kohës, Art klub,Ulqin, 2000
- Onuzi,A, "*Disa konsiderata për veshjet popullore të Anës së Malit* ", Ulqini në rrjedhat e kohës, Art klub,Ulqin, 2000
- Tirta,M, "*Ulqini në traditën e tij të hershme* ",Ulqini në rrjedhat e kohës, Art klub,Ulqin, 2000
- Instititi i kulturës popullore -1982
- Williams ,Xh" *Shqiptarët*" Argeta- LMG Nëntor 2003

Abstract

Nations that were dispersed are the product of border movement in certain historical circumstances by decisions of powerful states. These movements brought about bordering of the native states in population and their indigenous territories. The place of the conflicts and divisions, is occupied today by the cross-border the cooperation policies within the globalization and integration relations of good neighborliness.

The Albanian State is part of the groups of the states, whose borders are limited by land and ethnic Albanian population. Ana e Malit region represents a cross-border indigenous space divided between two neighboring countries Albania and Montenegro.

Ana e Malit is distinguished for geographical features and the heritage of the cultural and historical material. Evaluation of this arrangement facilitates the adjustment of the damaged inter-ethnic relations in the past. Today, this identity precedes and facilitates the integration policies in the European Union of the Western Balkans countries.

The evaluation and analysis of ethno-geographical identity of Ana e Malit region, will serve as a bridge in relations among the states, and also as and insurance for the welfare of the community in this region.

Keywords: Identity, cross border, integration, region, cooperation.

PHD c Rexhep SUMA

IDENTITETI NGA PERSPEKTIVA ISLAME

Identiteti luan rol kyç në komunikimin ndërkulturorë dhe ndëridentitetar duke shërbyer si urë lidhëse midis kulturës dhe komunikimit.

Të flasësh për krizën e identitetit islam aspak nuk është e lehtë pasiqë më të ndërlidhen një sërë faktorësh që pashmangshëm influencohet nga njëri tjetri. Nevojitet që një sërë analizash të zhvillohet me mënyrën e paraqitjes së kësaj krize tek masa rinore islame. Natyrisht se çdo vend i ka specifikat e veta por marrë tërësisht ka rryma të ndryshme që prore veprojnë dhe kanë mision apo objektiv shkatërrimin e identitetit të të rinjve musliman qoftë nga aspekti intelektual, kulturorë, zhvillimor etj. Këta të rinj jetojnë në vendlindje e disa të tjerë jetojnë vendeve të ndryshme të botës larg nga vatani, familja e rrethi shoqërorë që faktikisht edhe më shumë luhat apo thellon krizën e identitetit.
Nisur nga kjo pikëpamje vitet pas Luftës së ftohtë qenë dëshmitare të fillimit të ndryshimeve të befasishme në formimin dhe shtrirjen e identitetin e popujve e të simboleve të këtyre identiteteve. Politika globale nisi të riformësohej duke iu përshtatur vijave kulturore.

Themelimi përsëpari i vetëdijes së identitetit, hapësirës dhe kohës në kornizën e përvojës historike dhe të të vërtetave në veprim, është kushti *sine qua non, i ekzistencës brenda historisë dhe mundësisë për të kontribuar në përvojën e njerëzimit. Është e pamundur të shpëtosh nga pasiviteti gjersa mendësia strategjike të mos jetë mbështetur në një pretendim ekzistencial… Ndërsa popujt të cilët rrënojnë vetëdijen e tyre të identitetit duke përjetuar një fraksion radikal në mendësinë strategjike, e vënë në rrezik ekzistencën e tyre historike, popujt të cilët e ngrijnë këtë mundësi duke e parë si mjet përjashtues ndaj popujve të tjerë, shkëputen nga vetëdija njerëzore e përbashkët dhe përjashtohen vetë.*

Fjalë kyçe: Identitet, thirrje islame, kulturë komunikim kulturash,riformësim

Konfuzioni global

Sa ka kuptim të flitet për identitetin tonë kur vendi ynë sot nga njëra anë është i kryqëzuar mes procesit botërorë të globalizimit dhe, nga ana tjetër **, k**onfuzionit total në të dalluarit e asaj religjiozes nga ajo e

politikës ditore…. E tërë barra e afshit ekzistencialist rreth rritjes, përkujdesjes dhe ruajtjes së identitetit personal, individual dhe komunitar në kontekst të rryma**ve** globalizuese të së sotmes qenësisht përthyhet nëpër bashkërenditjen e religjiozisht të pamatshmes brenda së cilës, për shkak të roleve krejtësisht të ndryshuara dhe afrimit të së dukshmes dhe të matshmes gjeniut religjioz ndërsa të pamatshmes dhe transcendentes gjeniut politik në ne, u krijua një konfuzion i plotë që drejtpërdrejtë ndikon mbi cilësinë e jetës shpirtërore dhe fizike të popujve dhe qytetarëve në vendin tonë.1 Gjatë konsultimeve me fjalorët e ndryshëm hasim se fjala Identitet (lat. Identitas- njëjtësi , ang.identity ka kuptime të ndryshme, vetia e të qenët identik, i *njëjtë, i barabartë, i përputhjes, njësimit të ndonjë gjësendi, procesi, personi etj . me vetveten; ajo që është konstante dhe identike në ndonjë gjësend (çdo gjë që është identike me vetveten; çdo gjë që është ajo që është), koncepti (koncepti i caktuar është ai që është), personi (identiteti i personit), populli, (identiteti kombëtar) etj.; identiteti shprehet me fjalën "është", psh. Sokrati është filozof" ose "Parisi është kryeqytet i Francës"; në shembullin e parë "është" ka të bëje me predikacionin kurse në shembullin e dytë "është" ka kuptimin "është i njëjtë sikur". Identiteti shprehet edhe me shenjën "=" ose "=-". Identiteti abstrakt, i cili e përjashton ndryshimin, dallimin, është parimi fundamental i logjikës formale, sipas së cilës "A është A" "Non-A" është "Non-A" dhe nuk mund të të jetë A-ja Non-A dhe Non-A-ja. Hegeli u ngrit kundër këtij identiteti formalo- logjik si parim që është diskreditуar nga arsyeja dhe mendja e shëndoshë.*

Bota islame, duket se ka një konsensus të përgjithshëm

Konfliktet mund të lindin kur ka ndryshime të mprehta midis asaj që ne mendojmë se jemi dhe asaj që mendojnë të tjerët rreth nesh. Si arrijmë të kuptojmë kush jemi? Cilat janë karakteristikat e identitetit? Parasegjithash Identiteti është kryesisht koncepti ynë mbi veten, ai që ne mendojmë se jemi si person. Identitet krijohen përmes komunikimit dhe zhvillohet jo lehtësisht, por me hopa të vrullshm gjatë një periudhe të gjatë kohore. Më tej ne kemi vetëm një identitet, por një grup identitetesh, të cilët ndikohen nga shoqëria dhe janë dinamike. Mënyra se si zhvillohen identitetet, varet nga formimi kulturor dhe fetar.

Shumë shkencëtarë dhe politikanë socialë kanë një tendencë ta paraqesin islamin si një element të pakompromentueshëm përkundrejt konsensusit të përgjithshëm të komunitetit global . Konluzioni i mëposhtëm i Fukajamës është

[1] Dr.Ismail Bardhi . Kriza e Teologjisë muslimane shqiptare. Logos-A. Shkup, 2009, f. 243.

një shembull i mirë e kësaj qasjeje: ”Por, tani jashtë botës islame, duket se ka një konsensus të përgjithshëm që pranon kërkesën për një demokraci liberale që të jetë forma më racionale e qeverisjes, që është shteti, i cili realizon më së shumti, si dëshirën racionale ashtu edh e njohjen racionale “. (Fukajama 1992:211-12).

Shtjellimi i konceptit të identitetit përbënë një problematik strukturore, pasi ai paraqet dallimin dhe vijën ndarëse mes grupeve por identiteti në të njëjtën kohë është një strehë e nevojshme për identitetin e margjinalizuar ose të përjashtuar, duke vënë përpara një identitet që ndjen perceptimet e kërcënimit, rrethimin e frustrimit dhe kështu më pastaj përforcon unin dhe konform saj pason edhe reagimin në raport me e identitetet tjera në njërën anë dhe në anën tjetër paraqet përpjekje për të vendosur tabilitet.

Megjithatë, stabiliteti i rriten përmasat e identitetit dhe dobësohet kur identiteti është i kufizuar.

Megjithatë, ne vërejmë qartë se rajoni ynë është i mbushur me identitete të pjesshme kapur dhe nën-identitetet e llogarisë më të plotë, veçanërisht në rrethinat ku dominimi i identiteteve fisnore dhe sektare identitetit sektare në kurriz të identitetit të global islam. Në kuadrin e marrëdhënieve metë tjerët disa janë munduar që imazhin mbi islamit ta deformojnë duke e paraqitur atë mjaftë agresiv, luftues, armiqësor e lokal duke shfrytëzuar pozitën ekonomike mjaftë të brishtë ose të dobët të vendeve islame. Kjo dobësi është për shkak të dobësisë sonë ne jemi në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore dhe intelektuale, por assesi në formësimin apo qëndrimin e islamit në raport me identitetin.

Sa i përket identitetit kulturor (*cultural identity) si term i historisë së kulturës dhe dinamikës kulturore kupton vetëdijen e përfaqësuesve të një grupi, e cila lind dhe zhvillohet historikisht në varësi të kritereve që ai grup i vë në raportet me grupet e tjera shoqërore.*

Mënyrë kategorizimi në vijën e “ne”- “ata” bazuar në dallimet kulturore të njerëzve dhe grupeve shoqërore. Për të kuptuar problemin e identitetit kulturor është e domosdoshme të studiohet funksioni i identifikuesit, gjegjësisht marrëdhënia mes identitetit dhe identifikuesit që më shpesh kanë të bëjnë me gjuhën, besimin, traditat, artin, dhe në përgjithësi faktet që e përbëjnë një sistem vleror.

Sipas Erving Goffman-it identiteti kulturor u mundëson grupeve shoqërore që në kontaktet mes vete të vetëpërcaktohen, t’i përcaktojnë grupet e tjera dhe të marrin qëndrim lidhur me to. Teoricieni amerikan S.Huntigton pohon se është identiteti kulturorë - e jo ideologjitë politike ose ndarjet ekonomike- faktori përkufizues i çintegrimit shoqërorë dhe konflikteve në epokën e pas Luftës

së Ftohtë (Siljanovska, 2007: 27-28; Atanasov, 2003:13)[2]
Mund të gjejmë një përdorim të jashtëzakonshëm veçantie të imagjinuar në idenë e klasifikimit të thjeshtë që shërben si bazë intelektuale e tezës së famshme të "përplasjes së qytetërimeve" e përkrahur së fundmi sidomos për shkak të botimit të librit të Samjuel Hantingtonit *"Përplasja e qytetërimeve dhe rikrijimi i rendit të ri botërorë". Vështirësia e kësaj qasjeje nis me kategorizimin unik, shumë më parë se të jetë shtruar çështja e përplasjes. Në fakt, teza e një përplasje qytetërimesh bashkohet me gjithëpushtetin e një kategorizimi unik të zhvilluar në kufijtë e qytetërimeve të mëdha, që gjenden të lidhura drejtpërdrejtë në vijat ndarëse ndërmjet besimeve të cilave autori u kushton një vëmendje të veçantë. Hantingtoni ballafaqon qytetërimin perëndimor me "qytetërimin islamik", "qytetërimin hindu", "qytetërimin budist" e kështu me radhë. Përballjet e supozuara të bazuara në ndryshimet fetare përfshihen në nocionin e ndërtuar fort të një ndarjeje rrënjësore mbizotëruese.*

Diversiteti i sjelljes kulturore njerëzore

Sipas sociologut të njohur Anthony Giddens çdo kulturë përmban modele unike të sjelljes që u duken të huaja njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore.

Në diversitetin e sjelljes kulturore njerëzore ka disa tipare të përbashkëta. Ato tipare gjenden pothuaj në të gjitha shoqëritë, quhen *universale kulturore. Nuk* ka kulturë të njohur që të mos ketë *një gjuhë* komplekse nga ana gramatikore. Të gjitha kulturat kanë formë karakteristike të sistemit familjar në të cilin ekzistojnë vlera dhe norma të shoqëruara me kujdesin për fëmijët. Institucioni i *martesës* është një universal kulturor, poashtu sic janë *ritualet fetare* ose *të drejtat e pronësisë*. Të gjitha kulturat kanë forma që *ndalojnë incestin*, pra marrëdhëniet seksuale midis njerëzve me lidhje të afërta farefisnore si , për shembull. Babai e vajza, nëna dhe djali, vëllai e motra. Antropologët kanë veçuar edhe shumë universale të tjera kulturore, duke përfshirë ekzistencën e artit, vallëzimin, zbukurimin trupor, lojërave, dhënies së dhuratave,, shakave dhe rregullave të higjienës (Murdock, 1945).
Megjithatë , për shkak të variacioneve të shumta brenda çdo kategorie universalesh, ndoshta numri i tyre është më i vogël sesa mund të duket nga lista e lartpërmendur.[3]

---

[2] Ali Pajaziti, Fjalor i Sociologjisë, Logos-A, Shkup. f.253,Shkup.2009.

[3] Anthony Giddenc, Sociologjia, Cabej, 2004 Tiranë.f.50-51.

Identiteti fetar është një dimension i rëndësishëm i identiteteve të shumë njerëzve, si dhe një burim i zakonshëm i konfliktit ndërkulturorë. Shpesh, identiteti fetar ngatërrohet me identitetin racial/ etnik që do të thotë se mund të jetë problematike ta trajtosh identitetin fetar thjesht në lidhje me përkatësinë ndaj një feje të caktuar.

Komunikimi ndërkulturor midis grupeve fetare, mund të jetë gjithashtu problematik. Dallimet fetare kanë qenë në themel të konflikteve nga Lindja e Mesme në Irlandën e Veriut, në Indi/ Pakistan, në Bosnje-Hercegovinë. Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konflikti fetar ka detyruar mormonët të emigronin nga Nju Jorku në Ohaio dhe Illionis dhe më pas në Utah. Çdo kush duhet të jetë i lirë ta praktikojë fenë e vet, por konflikti mund të rezultojë nga imponimi i besimeve të një feje tek të tjerët, të cilët mund të mos ndajnë ato besime. Në vitin 2003, gjykatësi i Gjykatës së lartë të Alabamës, Roy Moore, u gjet në shkelje të ligjit të ndarjes së kishës nga shteti, për refuzimin ndaj heqjes së monumentit të Dhjetë Urdhërimeve nga ndërtesa e Gjykatës së Lartë të Alabamës.[4]

Islami nuk dikton një formë të veçantë identiteti kulturor. Për këtë ka arsye doktrinale dhe historike. Mungesa e një autoriteti qendror fetar,apo udhëheqësi, në traditën islame i del para autoritarizmit si model I diskutimit të çështjeve fetare në sferën publike. Kjo është provuar nga shumësia e shkollave besimore-juridike, si dhe nga dallimet e njohura të mendimit mes tyre.[5]

Koncepti islam mbi identitetin

Koncepti mbi identitetin në filozofinë islame kuptohet mjaft qartë dhe ndërtohet mbi themele shumë parimore mbi fjalët e Allahut xh.sh. ***"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e Allahu është i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.[6]***

Pra në këtë ajet Kur'anor apeli (thirrja) është e drejtuar në adresë të tërë njerëzimit dhe nuk ndalet apo kufizohet vetëm një popull, fisë, vend, rajon apo kontinent. Pra apelon dhe iu drejtohet të gjitha identiteteve pa i veçuar asnj***ë*** prej tyre. Kuptohet ***se në ajetin Kur'anor Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre,*** hyjnë

[4] Hyrje në Komunikimin ndërkulturorë, Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama, Uet Press, 2010 F.121-122. Tiranë.

[5] Ibrahim Kalin. Islami, arsyeja dhe bota moderne. Logos –A, Shkup, 2012 f.263.

[6] El Huxhuratë, 13.

*t*ë gjitha identitetet globale, të gjithë janë krijesa të Allahut xh.sh., pa Të, s'do të kishte fillim as mbarim kjo botë e as identitet e as njerëzim. Manifestimi i vullnetit të Allahut xh.sh. është në fjalën **"*Ju bëmë*"** e pastaj vazhdon ...***popuj e fise*** me gjithë këtë këtë diversitet të madh prej njeriut kërkohet apo e ka obligim që të *"njihen mes vete"*. Njohja mes vete arrihet kur identitetet marrin njohur të bollshme me njëra tjetrën qoftë mes fisesh apo popujsh.

Njohja dallon nga dija e thjesht

Njohja presupozon ekzistencën e besimit të mirë, si për të identifikuar tjetrin dhe duke i dhënë atij mundësinë për të marrë njohuri përkitazi me identitetin tuaj. Kriteri i krijimit nga Krijuesi i të gjithëve është devotshmëria dhe devotshmëria është frika nga Zoti, që do të thotë të bësh mirë dhe për të shmangësh të keqen, për vetën dhe për popullin tend, qoftë kjo buron nga identiteti yt apo identitetet tjetër.

"Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon. Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe frikë e dhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shi e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë.(Er-Rrum, 23-24).

Ajeti i lartshënuar mjaft qartë sqaron se shumësia e gjuhëve dhe ngjyrave është krijim i Zotit, sepse popujt dhe fiset, me gjuhë (gjuhë) dhe ngjyra të ndryshme në kontinente të ndryshme. Nëse pluralizmi është vullneti i Tij dhe të gjitha përpjekjet për të përjashtuar identitetet e tjera është çështja është e kundërt të vullnetit të Allahut fuqiplotë.

*Dhe në një tjetër ajet Kur'anor thotë:**Betohem në ditën e kijametit; Betohem në shpirtin që është shumë qortues! A mendon njeriu se nuk do t'i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t'ia tubojmë! Duke qenë se Ne jemi të zotët t'ia rikrijojmë si kanë qenë edhe majat e gishtave të tij! (El Kijame, 1-4).***

*Fuqia e Allahut në krijimtari është e pakufishme ku Allahu ka fuqinë që të krijoj dhe rikrijoj edhe majat e gishtërinjve të secilit njeri në këtë univers me diversitet pa marrë parasysh shumëllojshmërinë e popujve ,identiteteve , ngjyrave feve etj. **Çdo njëri i krijuar ka veçorit e tij në gjenetikë si në gjurmët e gishtërinjve, syve** dhe gjithashtu aftësinë unike. Çfarë mund të nxirret nëpërmjet këtij ajeti Kur'anor gjithmonë nga perspektiva e identitetit Islam?*

Së pari: Ekzistenca e identiteteve të ndryshme është e natyrshme që Allahu xh.sh., e bëri të tillë.

Së dyti: Islami beson në diversitetin dhe pluralizmin qoftë ajo në rrafshin grupor apo Individual.

Së treti: Qëllimi i këtij diversiteti është individualizmi dhe çdo shkrirje e individit në kuadër të proceseve globale ku si pasojë vie deri tek shfuqizimi i këtij individualizmi kjo aspak nuk përkon me normat e islamit pasiqë po bëhet shfuqizimi i shenjave (gjurmëve) të secilit.

Nga kjo qartësohet se identiteti në Islam ofron zgjidhje të problemeve në kuadër të kontekstin të identitetit. Pranimi (njohja) e karakteristikave të të tjerëve (grupeve)-identitetit të të tjerëve- duhet të jetë gjendje të natyrshme kështu që kjo vie deri tek njohja e tjetrit në kontekstin e identitetit të grupit dhe kjo gjithashtu jep veçantinë individuale, ku ne pranojmë tjetrin dhe diferenca e identitetit bëhet edhe më e gjerë dhe më të ndër-kombëtare të identitetit global që mund të përmbajnë të gjitha identitetet në rrafshin kombëtar.

Kurse në raportin në marrëdhënie me tjetrin është vlera e tolerancës njohjes dhe ky edhe është qëndrim i rrugës së islamit.

Kjo është rruga e drejtë për të analizuar dhe studiuar gjendjen tonë dhe për të diskutuar arsyet për dobësinë tonë dhe elemente të tjera të pushtetit për të kapërcyer boshllëqet dhe të mësojnë gjithçka që është në avantazhin tonë për të mbrojtur identitetit tonë me dije, sjellje, art, kulturë dhe kontributet tona në progresin e njerëzimit për njohjen e tjetrit

Kjo është rruga e vetme e stabilitetit identitar

Çështja e identitetit mbetet një çështje qendrore dhe shqetësim për të gjithë njerëzit, sepse çdo grup apo komb i mungon identitetin veçantë e pozitës së jetesës dhe për të vazhdimisht mundohet ta ruaj atë. Identiteti është mbrojtës personal që ruan personalitetin e secilit dhe çdo shoqërie dhe mos vlerësimi apo asimilimi i tij bëhet kopjues i pavlerë dhe i pavëmendshëm. Poashtu njeri ka lidhje shumë të forta me bindjen e individit dhe fuqisë intelektuale, dhe që këtej përcaktohen karakteristikat dhe personalitetit të njeriut duke bërë atë individ me peshë shoqërore dhe jep vlerë jetës së njeriut.

Identiteti mund të përkufizohet si arritje apo njohje e njeriut ndaj vetvetes së tij nga aspekti i mendimit, kulturës dhe mënyrën e jetës. Apo është një grup përshkrimet dhe sjelljet që e dallojnë nga një person tjetër. Ashtu sikur individi ka një identitet ashtu edhe shoqëria apo komuniteti ka identitetin saj. Nga ky këndvështrim ekzistojnë shoqëri islame,shoqëri laike, krishtere, komuniste e kapitaliste. Dhe secili ka avantazhet e veta,vlerat dhe parimet e veçanta.

Kur identiteti i individit përputhet me identitetin e shoqërisë atëherë në shoqëri krijohet një harmoni reciproke dhe respekt i ndërsjellë ku në atë vend mbizotëron siguria, qetësia dhe secili individ ndjen se është i çmuar në mesin e shoqërisë. Në rastin e kundërt kur identitetet kundërshtojnë, përplasen apo bien në konflikt me njëra tjetrën atëherë pashmangshëm si pasojë e saj lind kriza që shpien

në konflikt. Nga këtu, mund të kuptojm se hadithi i e të Dërguarit a.s. "Me të vërtetë Islami filloi si i huaj dhe do të kthehet i huaj ashtu siç edhe filloi, ndërsa Tuba është për të huajt."" (Muslimi).

Dijetari Ibën Bazi kur është pyetur për kuptimin e këtij hadithi: Islami filloi si i huaj ashtu siç ishte gjendja e tij në Meke dhe në Medine para hixhretit, ku nuk e njihte atë (islami) dhe nuk e praktikonte vetëm se një pjesë e vogël prej njerëzve. Pastaj ai u përhap dhe njerëzit filluan të hynin grupe-grupe në të (në fenë Islame) dhe ai triumfoi bindësh mbi të gjitha fetë e tjera. Mirëpo, ai përsëri do të kthehet i huaj në kohën e fundit ashtu edhe siç filloi, e nuk e njohin me një dije të vërtetë vetëm se një pakicë prej njerëzve dhe nuk e praktikon këtë Fe (islamin) në formën e tij të ligjëruar vetëm se pak prej njerëzve, e ata janë **El Gurabau** – të huajt. Ndërsa plotësimi i hadithi është fjala e tij a.s.: "Ndërsa Tuba është për të huajt."(Muslimi) të tjera transmetim përveç atij të Muslimit thuhet: "I thanë: O i Dërguari i Allahut, kush janë ata? Tha: "Janë ata të cilët përmirësojnë kur njerëzit prishin." Po ashtu në një transmetim tjetër thuhet: "Janë ata të cilët përmisojnë çfarë prishin njerëzit prej sunetit tim." (*Mexhmu'u Fetava Ibën Bazi vëll. XXV*). Ky identitet është miratuar nga vetë individi që në të ndjen krenari dhe qëndron besnik ndaj tij dhe mbi të përcaktohet karakteri dhe sjellja e njeriut kurse për shoqërinë , identiteti, është kala (mbrojtje) që gjend shpëtim në të dhe eventualisht nëse humb lidhjen me identitet atëherë kemi një shthurje dhe shkapërderdhje të vlerave të tij. Vlerat e identitetit janë elemente që rreth tyre tubohen ummeti islam nga çfarëdo pëllëmbë e tokës nga unifikimi i akides (besimit).Identitetit islam në fakt d.m.th t'i përkasësh mësimeve Kur'anore dhe profetike me të cilat Allahu xh.sh e ka plotësuar dhuntitë e Tij me të duke bërë që ky ummet të jetë ummeti mesatar dhe umet më i miri që ndonjëherë është shfaqur në fytyrën e tokës.

Në qoftë se ata besuan ashtu siç besuat ju ata vërtetë kanë gjetur rrugën e drejtë, e nëse refuzojnë, atëherë ata janë kundërshtarë (opozitë), po ty (Muhamed) kundër tyre do të mjaftojë Allahu. Ai është dëgjuesi, *i dijshmi. (kjo fe jona është) Ngjyrosje e Allahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se Allahu? Ne vetëm atë e adhurojmë.(* El Bekare,137-138).

Veçoritë identitetit islam

Shfaqja e rinisë islame në peizazhin perëndimor ka prodhuar një qëndrim të ri dhe problematik. Larg prej vendeve të tyre të origjinës, si myslimanë në një vend jomusliman, për më tepër në një vend të industrializuar, këta adoleshentë, studentë dhe të moshuar, shprehin dëshirë të fortë për të qenë musliman dhe nevojën e thellë për përgjigje dhe rregulla të kthjellëta dhe gjegjëse islame. Për

shkak të sfondit të tyre- nuk kanë marrë arsim fetar zyrtar e as flasin arabishten ata kanë formuar bindjen se nuk munden që t'i kontribuojë përpunimit të identitetit musliman në Evropë, duke menduar se gabimisht se përgjigjja e vetme e përshtatshme është ajo ilegale dhe se vetëm *fikhu* mundet t'i zgjedhë të gjitha problemet e tyre.[7]

1.Është identitet besimi (akides)

Nënë këtë veçori hyn çdo musliman nga do qoftë ai, çfarëdo lloj pamje, gjuhe etj. Muslimanët kanë tipare që i dallojnë nga të tjerët që të gjithë hyjnë nën një kulm, në një besim.
Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua. Po ata e ndanë çështjen e fesë dhe u përçanë mes vete (u ndanë në grupe: monoteistë, politeistë, jehudi, të krishterë, zjarrëputist etj.), mirëpo, që të gjithë do të vijnë te Ne.(El Enbija, 92-93).

2.Është e domosdoshme për çdo musliman

Nga identiti islam nuk i lejohet asnjë muslimani të ik prej tij apo ta përçmoj atë, sepse respekti dhe ruajtja e tij janë obligim i secilit.
*Thuaj (Muhamed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuruar tjetër pos Tij; Ai jep jet*ë dhe Ai jep vdekje, pra besoni *Allahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqnie rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën*. (El A'rafë , 158).

3.Dallueshmëria nga të tjerat

Ky dallim i jep forcë dhe vazhdueshmëri çdo populli që të mbijetojë dhe konservon kulturën dhe ideologjinë e tyre në mënyrë që mos të shkrihen në të tjerë. Për këtë shkak kjo veçori ka përfshirë të gjitha poret e jetës duke filluar që nga besimi (akideja)

"*Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!*" (El Kafirun,6*)*.

Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë! Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur! (El Fatiha, 5-7).

[7] Tarik Ramadan. Të jesh mysliman evropian, Logos-A, Shkup, 2011. f.172.

Po nëse ata të përgënjeshtruan ty, thuaj: "Mua më takon (shpërblimi nga) vepra juaj, ju nuk përgjigjeni për atë që bëj unë, e as për atë që bëni ju. Ka prej tyre që të dëgjojnë (kur lexon, por formalisht). A mund të bësh të shurdhëtin të dëgjojë, edhe kur ata nuk kuptojnë?.(Junus, 41-42)...

*4.***Identiteti përfshinë tërë aspektet dhe sferat e te jetës së myslimanit**

Identiteti i muslimanit është i plotë, ka shenja të precizuara që kthjelltëson objektivat, detyrat e obligimeve dhe synimet në jetë.
Thuaj: "Namazi im, kurbani im dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)! Thuaj: "A të kërkojë Zot pos Allahut, e Ai është Zot i çdo sendi (ekzistues) dhe dëmi i secilit person është kundër vetes. Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit. Mandej, kthimi juaj është te All-llahu; e Ai ju njohton për atë që përçaheshit.(El En'am, 162-164).

5. **Burim i krenarisë dhe dinjitetit**

Thotë Allahu xh.sh në Kur'an:*Ne u plotësuam pastaj premtimin, i shpëtuam ata dhe kë dëshiruam Ne, ndërsa ata që kaluan çdo kufi, i zhdukëm. A nuk e kuptoni se Ne ua shpallëm librin në të cilin gjendet krenaria juaj?(El Enbija, 9-10).*
Poashtu në një ajet tjetër Kur'anor thotë: *Ata janë që u thonë (vendasve të Medinës): "Mos u jepni atyre që janë me të dërguarin e Allahut (muhaxhirëve), ashtu që të shpërndahen!. Po, te Allahu janë pasuritë (depot) e qiejve e të tokës, por hipokritët nuk janë duke kuptuar. Ata thonë: "Nëse do të kthehemi (prej gjuhës me beni Mustalikët) në Medine, ai më i forti pa tjetër prej aty ka për ta përzënë atë më të dobëtin!" (ashtu thanë) Ndërsa e tërë krenaria i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë. (El Munafikunë,7-8).*
Në një vend tjetër thotë *: Kush e dëshiron krenarinë (le ta dijë) e tërë krenaria i takon Allahut (pra le të kërkojë prej Tij), te Ai ngritet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon. E ata që përgatitin dredhira të këqia, për ata është një dënim i rëndë dhe dredhia e tyre është e zhdukur.(Fatir,10).*
Omeri r.a. thotë:"Ne jemi një popull që Allahu na ka nderuar me islam, pra nëse kërkojmë nderë në diç tjetër, Allahu do të na poshtëroj me të".

6. Lidhje e ngushtë mes myslimanëve
Identiteti islam arrin që të vendos lidhje stabile dhe të qëndrueshme duke theksuar

se muslimanët janë si një trup. Allahu në lidhje me këtë thotë**: "***S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kinie frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti)".(El Huxhuratë, 10).*
Po ashtu në një vend tjetër thotë: " *Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e Allahut, e mos u përçani! Përkujtomini nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehenemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur.(Ali Imran,103).*

O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë.(El Huxhuratë,11).

*"*Muslimanët janë si një trup*,në rast se një pjesë e turpit ndien dhimbje, atëherë i tërë trupi e ndjen këtë dhimbje"(Mutefekum alejhi).*

Kur shfaqen identitetet?

Identitetet shfaqen atëherë kur mesazhet e komunikimit, shkëmbehen midis personave, ato negociohen, bashkëkrijohen, përforcohen dhe sfidohen nëpërmjet komunikimit.. Kjo do të thotë se paraqitja e identiteteve tona nuk është një proces i thjeshtë. Identitetet e ndryshme evitohen në varësi të faktit se me cilin individ komunikojmë dhe rreth çfarë diskutojmë.

Forca e identiteteve kulturore

Pra, duke njohur burime të rëndësishme kulturore të rezistencës ndaj pushtetit të globalizimit shkon një rrugë të gjatë drejt gjetjes këtë fuqi në perspektivë. Identiteti kulturor nuk ka gjasa të të jetë pre e lehtë e globalizimit. Kjo vie për shkak se identiteti nuk është në fakt i brishtë komunal, apo ves psikik, por një dimension i konsiderueshëm i institucionalizuar. Veçanërisht në formën dominante e identitetit kombëtar, ajo është produkt i ndërtimit të qëllimshëm kulturore dhe mirëmbajtjen nëpërmjet dy rregullatorëve: institucionet socializuese dhe shtetit. Por vini re se asnjëra prej këtyre problemeve nuk përputhet me skenar të përgjithshëm të shkatërrimit i identiteteve nga globalizimi. Përkundrazi, ata dëshmojnë për një përforcim të rëndësia e pozicioneve të identitetit në përgjithësi prodhuar

nga globalizimi. Është kjo përhapja e identitetit që shkakton probleme për hegjemoninë e kombit-shtet gjatë saj

Identitetin, një koncept i cili me siguri qëndron në zemër të bashkëkohores tonë dhe imagjinatës kulturore. Kjo në fakt nuk është, e vështirë të hasësh në literaturën por mendoj se mbetet pjell e analizës dhe konceptit për të gjetur pozicione të cilat kontestojnë historinë e identitetit si viktimë e globalizimi që kemi cekur më lartë. Për të marrë vetëm një shembull, Manuel Castells i ka kushtuar një vëllim të tërë analizën e tij të njohur të "epoka e informacionit" të duke pohuar se "Bota jonë dhe jetët tona janë duke u formuar nga tendencat konfliktuoze të Globalizimit dhe identitetit. Sipas tij, opozita kryesore për fuqinë e globalizimit qëndron në "valën e gjerë të shprehjeve të fuqishme të identitetit kolektiv se globalizimi sfidë. . . në emër të singularitetit kulturor dhe të kontrollit të njerëzve mbi jetën e tyre dhe mjedisin '(Castells,1997: 2). Larg nga të qenit lule e brishtë se identitetit globale shkel, identiteti është parë këtu si pushtet I ngritjes së kulturës lokale që oferta (megjithëse multi-formë, çorganizuar dhe ndonjëherë politikisht reaksionare) rezistencës të forcës centrifugale e globalizimit kapitalist. Rritja dramatike e lëvizjeve shoqërore të bazuara rreth pozicioneve të identitetit (gjinia, seksualiteti, feja etnia, kombësia) mund të regjistroheni me lehtësi.

Konflikti identitar

Çdo popull apo komunitet ka arritur të jetë i vetëdijshëm se çështja e identitetit është dhe përbënë një çështje qendrore, dhe nëse nuk vendoset një mekanizëm që ruan këtë identitet ,ai në mënyrë të pashmangshme ekzistojnë mundësitë që të shkrihet në kulturën dhe identitetet e të tjerëve, dhe së andejmi do të zvogëlojë karakteristikat e veta ku do të mbetet "një asgjë"

Armiqtë e ummetit islam kurrë nuk do të pushojnë së vepruari që ta zbehin këtë identitet dhe islamit, kulturën e besimit, por planifikojnë pa rreshtuar që të na zbrabsin nga feja islame. Ja se ç'thotë Allahu xh.sh., në Kur'an: *Të pyesin për luftën në muajin e shenjtë, thuaj: "Lufta në te është e madhe (mëkat i madh), por pengimi nga rruga e Allahut, mosbesimi ndaj Tij, pengimi nga xhamia e shenjtë (Qabja) dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë mëkate edhe më të mëdha te Allahu. E fitneja është edhe më e madhe se mbytja. Ata do t'u luftojnë juve vazhdimisht për t'ju zbrapsur, nëse munden, nga feja juaj. E kush zbrapset prej jush nga feja e tij dhe vdes si pabesimtar, ata i kanë zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm.(El Bekare, 217).*

Poashtu thotë: "*As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri që të pasosh fenë e tyre. Thuaju: "Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë.*

E nëse pasiqë të ka ardhur ty e vërteta shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu.(El Bekare, 120).
"Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni sikurse nuk besuan vetë dhe bëheni të njëjtë. Mos zini miq prej tyre derisa ata të shpërngulen (si ju) për hir të Allahut, e nëse refuzojnë, atëherë kudo që t'i gjeni, kapni dhe mbytni dhe prej tyre mos zini as mik as ndihmës".(En-Nisaë, 89).
Shumë ithtarë të librit (jehudi, krishterë), edhe pasiqë iu është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë, pra ju lini dhe largohuni prej tyre derisa Allahu ta sjellë urdhrin e vet. Allahu ka mundësi për çdo send.(El Bekare, 109).

Rezyme

Të flasësh për krizën e identitetit islam aspak nuk është e lehtë pasiqë më të ndërlidhen një sërë faktorësh që pashmangshëm influencohet nga njëri tjetri. Nevojitet që një sërë analizash të zhvillohet me mënyrën e paraqitjes së kësaj krize tek masa rinore islame. Natyrisht se çdo vend i ka specifikat e veta por marrë tërësisht ka rryma të ndryshme që prore veprojnë dhe kanë mision apo objektiv shkatërrimin e identitetit të të rinjve musliman qoftë nga aspekti intelektual, kulturorë, zhvillimor etj. Këta të rinj jetojnë në vendlindje e disa të tjerë jetojnë vendeve të ndryshme të botës larg nga vatani , familja e rrethi shoqërorë që faktikisht edhe më shumë luhat apo thellon krizën e identitetit.
Kriza që ka përfshirë botën islame në përgjithësi është kryesisht një krizë e prototipit intelektual nga elita udhëheqëse, të cilët drejtuan dhe i dhanë formë evolucionit kulturor në botën muslimane përmes një strukture unike edukative. Transformimi i imponuar qytetërimor që zuri vend në botë muslimane pas procesit të perendimizimit, synoi të formonte një elitë të re intelektualësh përmes vendosjes së një rregullimi institucional, I cili do të drejtojë dhe justifikojë këtë transformim qytetrimorë.
Por është fakt që qysh nga fillimi, ashtu siç shprehet edhe Graham E. Fuller në librin e tij "Islami politik e ardhmja e tij", Islami doli me një ide të guximshme dhe përparimtare: lidhjet e fisit të gjakut nuk përbëjnë një bazë të shëndoshë për krijimin e shteteve, qeverisjes ose politikës. Islami kërkoi ta tejkalojë etnicitetin, në emër të një ideali universal të barazisë, brenda suazës së besimit fetar. Shumëkush mund të argumentonte se Islami akoma sot po lufton mbeturinat e mendësisë fisnore, e cila e pengon jo pak qeverisjen e mirë në pjesën më të madhe të botës muslimane, sot. *Umetit është vizioni.*

Emirjana FILI

ILUMINIZMI EVROPIAN NE PASHALLEKUN E JANINES

Përmendim se jeta kulturore e qytetit të Janinës është shumë më e vjetër se me ardhjen e Aliut si qeveritar i Janinës. Por nga ana tjetër thuhet se ndër novacionet më befasuese të Aliut, ishte investimi për të nxitur dhe përhapur arsimin dhe kulturën. Rëndësia që i dha Aliu, zgjerimit të horizontit politik dhe intelektual, fryma perëndimore që solli në qytet si një moderator që frymezoi iluminizmin evropian brënda vetë perandorisë Osmane.[1]

Shumë autorë në përshkrimet dhe në të dhënat ekonomike apo shoqërore që japin për këtë qytet, mundohen të nxjerrin fakte, të cilat në shumicën e rasteve janë impresionuese, tepër positive dhe që i ngrenë lart vlerat e Janinës dhe historikut të saj.[2]

Gjatë kohës ku sundoi Aliu, në Janinë lulëzoi industria e vogël dhe tregëtia. Kur më 1809 britanikët morën kontrollin e ishujve jonianë, u zhvillua së tepërmi dhe tregëtia e drurit. Një udhëtar britanik, raporton se pambuku si dhe copat me lesh, nga Thesalia kalonin në Janinë për t'u eksportuar në Itali dhe Gjermani.[3]

Pozita e favorshme e Janinës për prodhimin apo edhe për importimin e mallrave, tokat pjellore të Thesalisë, numri i madh i dhenve, të gjitha këto kushtëzonin një zhvillim të mëtejshëm të këtij pashallëku dhe për mirëqenien ekonomike të popullit. Është e pranueshme se jo pa qëllim Aliu "e vuri në shënjestër" këtë qytet të rëndësishëm por sipas studiuesve është i pamohueshëm se Ali Pashë Tepelena ndihmoi në një lulëzim akoma më të fuqishëm të ekonomisë së Janinës. Popullsia nën hegjemoninë e tij përllogaritej nga 1.5 në 2 milion banorë. Brënda territoreve të këtij pashallëku përfshiheshin qytete të Janinës më rreth 60 000 banorë, Arta me 10 000 , Gjirokastra me 12 000 , Delvina me 8 000, Elbasani me 6 000 , me 4 500 banorë Berati, Manastiri me 15 000. Ohri me 6 000 etj [4]

[1] Vasili Panajotopulos, *Arxio Ali Pasa, Tomas D, Instituto Neo Elenikon Sopudhon, Athinë 2009*, f 113

[2] Trifoni Evangelidhes, *Istoria Ali pasa tou Tepelenli, satrapo tes Epirou, Athens: 1895, 68*

[3] Taqis Kandhilloros, Ali Tepelenli, Athinë: 1968, 132.

[4] Irakli Koçollari: *Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës, Onufri ,*

Përgjithësisht popullsia ishte greqishtfolëse, megjithatë në Janinë Aliu nuk udhëhoqi sipas parimit gjuhësor por sipas parimit ligjor. Edhe për sa i përket besimit dominues në Janinë, ajo ishte e krishtere ortodokse, por pavarsisht nga kjo cilësi, asnjëherë nuk u mor për bazë qeverisje vendi. Vetë Aliu ishte bektashi, ai asnjëherë nuk tregonte interes për besimin fetar.[5]

Përkatësia fetare nuk përbënte pengesën kryesore për një bashkëjetesë normale midis myslimanëve dhe të krishterëve. Në shumë raste ata filluan dhe të lidhni krushqi. Politika që ndoqi Ali Pashë Tepelena dhe që ndryshoi botëkuptimin e shqiptarëve që banonin në pashallëkun e tij, lidhur me fenë kishte si qëllim çlirimin nga konceptet e vjetëruara fetare dhe rritjen e mëtejshme të ndjenjave kombëtare mbi ato fetare. [6]

Pashai nuk ecte, ai vraponte drejt qëllimit të tij duke treguar një interesim të veçantë për botën politike dhe sociale të Evropës Perëndimore. Përpjekje të mëdha ai bëri dhe për të përvetësuar fjalorin politik si dhe emblemat e tjera të qytetërimit evropian. Një material interesant na vjen edhe nga kancelaritë austro-hungareze, më sakt nga princi Meternich, i cili në kujtimet e tij shprehet për Aliun : " *Ali Pasha , me dergoi ne vitin 1820, nje njeri te beses dhe nepermjet tij me lutej ti dergoja nje keshilltar per ti hartuar nje konstitucion.*[7] (kushtetute *)*
Çdo gje tek ai ishte përshkruar me nje stil unik, ashtu siç e përmend edhe Fleming në veprën e saj : " *veshja, sjellja e tij dhe dekori i shtëpive, mobilimi dhe zbukurimi elegant i tyre ishin menaxhuar me shumë kujdes, me qëllim që ta paraqisnin në terma fort të posaçme përpara publikut evropian"* [8]

Në oborrin si dhe në zyrat e kancelarisë së tij, në Janinë, ai mbantë përherë pranë vetës këshilltarë vendas dhe të huaj. Por nuk ishin as të pakët këshilltarët e huaj, ardhur anë e kënd evropës, ku shumica prej tyre ishin franceze dhe italianë. Falë një sërë letërnjoftimësh, kontrata, dokumente, jetëshkrime dhe përshkrime nga jeta në Pashallëkun e Janinës, flasin për formimin ë tyre intelektual dhe shumë dimensional në fushën ushtarake, administrative, politike e kulturore.

Liku , si dhe shumë vizitorë të tjerë evropianë në Pashallëkun e Aliut, kanë vënë re se në fund të shekullit XVII , *" një pjesë e madhe e burrave shqiptare, flisnin shqip, greqisht dhe të paktën një gjuhë evropiane dhe se pothuajse të gjithë shqiptarët e oborrit të tij, kishin shërbyër edhe jashtë Shqipërisë.* [9]

Tiranë 2016, f 27

5 Georgios Gatos*, Istoria tou Ianinon, Athina: 1965, 48.*

6 Aristidh Kola , *Arvanitët : Toena, Tiranë 2008, f 115*

7 Memories du prince Metternich, Paris : 1881 Volumi III f 536

8 Katherinë Fleming , *Bonapardi Mysliman: Dituria , Tiranë 2003, f 90*

9 William Martin Leake,*An historica loutline of the Greek revolution : London 1826, f. 88.*

Në këtë përqasje të madhe kulturore dhe ekonomike , në zotërimet e Aliut nuk duhet lënë pa përmendur edhe një element shumë i rëndësishëm siç është gjuha. Padyshim që gjuha shqipe ishte një tipar përcaktues në identitetin nacional të Ali Pashës dhe të gjithë shqiptarëve. Pavarsisht influencave të mëdha evropiane dhe kontakteve me perëndimin, gjuha shqipe ju shërbeu shqiptarëve si një tipar i rëndësishëm dhe dallues i identittetit të tyre kombëtar. Sipas studiuesve Aliu përdorte për të shkruar në gjuhën e letrave, greqishten dhimotiko.[10] *Por përdorimi i greqishtes nuk e bënte atë as grek dhe as ortodoks, ashtu si statusi i tij i emëruar i osmanëve nuk e bënte atë aspak osman* [11]

Gjatë kohës së zotërimit të Pashallëkut të Janinë, Ali Pasha shfaqet si reformator i parë në trevat e sunduara nga perandoria osmane, që në mënyrë institucionale, pas shumë shekujsh kthen vëmendjen për rilindjen dhe shkollimin e popujve të këtyre anëve. Ai nxiti zhvillimin e arsimit me bindjen e plotë se ishte nevojë e parë dhe domosdoshme përgatitja e një brezi që do drejtonte atë shtet nën kompetencat e një shoqërie të zhvilluar. Mbështeti dy shkollat e Kozma Ballaurit dhe Athanas Psalidhos dhe në porositë e tij u hartuan programe për përgatitjen e mësuesve dhe administratorëve, duke ushqyer rininë më me zell për dije dhe kulturë, nën vëmendjen e veçantë të tij. Ali Pasha i ka kushtuar rëndësi arsimit në Janinë, por gjithashtu ai jepte çdo vit 1200 grosh për mirëmbajtjen dhe funksionimin e shkollës së Artës. Gjatë kohës që administronte Aliu, u zhvilluan shkollat, u nderuan njerëzit me kulturë, u pritën si mysafirë, shkencëtarë dhe vizitorë të huaj. Meritë e padiskutueshme e Ali Pashës dhe e qëndrimeve të tij, ishte hapja e gjimnazit "Zosimeja" në Janinë. Fatkeqësisht në asnjë vend më parë nuk është përmendur për vezirin e Janinës kjo vepër unikale, që pati kontribute të veçanta për arsimin dhe kulturën ekonomike të këtyre viseve.[12] Vend në të cilin u rritën dhe u arsimuan me dhjetra rilindas shqiptare, si vëllezërit Frashëri, Vreto, Qiriazi të cilët dolën nga dyert e kësaj shkolle. Në këtë qytet ishin dy shkolla, ku merrnin pjesë jo vetëm djemtë e qytetit por edhe shumë djem nga qytetet e tjera. Aliu e lejonte inteligjencën e oborrit të tij , të diskutonte lirisht nëpër sallone probleme fetare, letrare, artistike, historike, shkencore. Ai lejoi në 1814, shfaqje publike në formën e një teatri, duke u bërë kështu sundimtari i parë në Perandorinë Osmane që futi këtë lloj edukimi të tillë. Edhe për ndëtimet që u bënë në kohën e Ali Pashës në Janinë, flet histografia greke por edhe ajo e huaj. Për këtë Zotos shkruan se në asnjë kohë tjetër të mëparshme

---

[10] Katherinë Fleming , *Bonapardi Mysliman: Dituria , Tiranë 2003, f 96*

[11] Po aty .

[12] Kostas Paparigopulos, *Istoria tu Eleniki Etnus, Athinë 1932 f 210*

nuk u realizuan aq shumë vepra publike sesa në kohën e Aliut, as rrugë nuk u hapën më parë sesa në kohën e tij, arterie me vlera të mëdha, stacione ushtarake, ura dhe vepra të tjera me karakter hidroteknik që i shërbyen zhvillimit të bujqësisë, vepra industriale dhe objekte të tjera që nxitën dhe i shërbyen zejtarisë.[13] Në kohën e Aliut, moçalet dhe kënetat në veri të Artës, u thanë në mbikëqyrjen e inxhinierëve evropian me qëllim që të rritej sipërfaqja prodhuese në rajon. U hapën klube çaji dhe bujtina përgjatë rrugëve më të rëndësishme të komunikacionit dhe u shtrua me kalldrëm rruga më e rëndësishme nga Janina për në Prevezë, përgjatë bregdetit Jonian. Më 1804, përgjatë rrugës nga Janina në Trikallë kishte hane në rreth çdo një orë rrugë. Aliu i bëri rrugët më të sigurta duke forcuar urat ekzistuese dhe duke ndërtuar të reja.[14] Ai ndërmori punime të shumta vaditëse dhe drenazh dhe dërgoi specialistët e tij deri në Liverpul për të përfituar nga përvoja e re e bujqësisë angleze.

Pra ky pasha, që një pjesë të mirë të jetës së tij kishte luftuar në mënyrë të pamëshirshme kundër kusarëve të tmerrshëm, që ishte përballur me shumë plane apo intriga të egra, e njihte mirë edhe vlerën e kulturës dhe të arsimit që kishte lidhje me fatet e popujve dhe sidomos me popullin e atyre trojeve. Ai e vlerësoi civilizimin perëndimor dhe nxiti zhvillimin e kulturës në këto vende me mjerime mesjetare,[15] të cilat ishin të mbushura plot me plaçkitës dhe kriminelë dhe ku mbizotëronte ende fryma obskurantiste turke.

Aliu ishte një nga ,moderatorët e parë në Perandorinë Osmane,[16] që me fizionominë e tij të shkëlqyer, tërhoqi vëmendjen dhe emocionoi gjithë Ballkanin plot 40 vjet me radhë. Një reformator i një rrangu të tillë ndërkombëtar, ishte një gjenialitet i vërtetë. Të gjithë lëvizjet e tij i bëri në kohën e duhur, me mencuri dhe dinakëri , me dinamikë dhe civilizim, me kurajo dhe këmbëngulje.

Por të gjitha këto që thamë më lart do të doja ti përmbledhja me një pjeses të intervistës së gazetarit danez, Petër Olaf Bronsted, i cili i mahnitur nga vizita në sarajet e Janinës shkrunte në një gazetë në Kopenhagen : " *Këtë njëri të jashtëzakonshëm njerzit e kanë parë në versionet e tyre dhe sipas interesave të tyre. Por unë e kam prezantuar atë në një pozicion tjetër, sinqerisht në një mënyrë*

---

[13] Dhimitris Zotos, *I dhiqeosini is to kratos tou Ali Pasa,* Athinë: 1938, 139-140

[14] *Ali Pashë Tepelena, vëll i I,* Enciklopedia e Madhe Greke, Tiranë: përkthim nga A.I.H, AIII-258,18.

[15] Vasili Panajotopulos, *Arxio Ali Pasa, Tomas D, Instituto Neo Elenikon Sopudhon, Athinë 2009*, f 118

[16] Po aty f 120

të paanshme"[17] Dhe pasi ishte mahnitur nga biseda me Aliun , për kulturën, zgjuarsinë, mikpritjen dhe deri tek njohuritë e tij shumë dimensionale në lidhje me vullkanet e Vezuvit dhe Etnës, ky gazetar shkruante *" Aliu është si njëri nga këta vullkanë, që kanë njëqind efekte dhe pasoja por që nuk dinë të derdhin vetëm flakë e zjarr, Zoti i krijoi që pranë tyre të ndërtohen edhe kopshte të mahnitshme e të lulëzuara dhe me një bimësi të gjelbëruar, pikërisht pranë dallgëve të llavës përvëluese" [18]*

[17] Peter Olaf Bronsted, *Interwiews with Ali Pasha of Janina, the Danish institute at Athens: Athina 199, f 77*

[18] Po aty

Elida BOSHNJAKU, MMK,Elona BOSHNJAKU, MSC

IMPLIKIMET EKOTURIZMIT NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Abstrakt

Eko-turizmi është turizmi i cili ka në fokus kryesor eksperiencën turistike që nxit të kuptuarit, vlerësimin dhe ruajtjen mjedisore dhe kulturore. Ky punim analizon impaktet mjedisore të industrisë turistike e cila implikon ofruesit e shërbimeve dhe vizitorët të cilët ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në zonat ku zhvillohet eksperienca turistike. Përsa i përket impakteve, është e rëndësishme që impaktet pozitive të tejkalojnë impaktet negative. Ofruesit e shërbimit operojnë në sektorët e transportit (automjetet, autobusët, anijet, linjat ajrore), strehimi, restorantet, aktivitetet argëtuese etj. Të gjithë këta sektorë punojnë fort për të krijuar eksperiencën më të mirë turistike. Nga ana tjetër, vizitorët paguajnë për eksperiencën e tyre turistike. Gjatë vizitës së tyre, ata ndikojnë destinacionin. Është thelbësore promovimi i eko-turizmit për shijimin dhe vlerësimin e natyrës, dhe të pasurit e një impakti të ulët negativ nga ana e vizitorëve. Organizmat publike dhe OJF-të përpiqen shumë për të zhvilluar eko-turizmin në destinacionet turistike.

Fjalë kyçe – ekoturizëm, impakt mjedisor, ofruesit e shërbimeve, vizitorë.

Ecotourism implications on sustainable development

Abstract

Eco-tourism is that type of tourism with a primary focus on tourist experience that fosters environmental and cultural understanding, appreciation and conservation. The paper analyzes the environmental impacts of tourism industry which implies service providers and visitors who impact positively and negatively to the areas where tourist experience is developed. Regarding impacts, it is important that positive impact pass over the negative ones. Service providers operate in the sectors of transportation (e.g., automobiles, buses, ships, airlines), lodging, restaurants, recreational activities etc. All these sectors work hard to create the best tourist experience. On the other hand, visitors pay for their

tourist experience. During their visit they impact the destination. It is crucial the promotion of eco-tourism in order to enjoy and appreciate the nature and having low negative visitor impact. Public bodies and NGOs strive a lot to develop ecotourism in tourist destinations.

Keywords – ecotourism, environmental impact, service providers, visitors.

INTRODUCTION.

Ecotourism is known as nature based tourism. It offers environmentally responsible tourism experience enjoying nature and promoting conservation. This type of tourism contributes to active involvement of community and tourists. Natural areas are visited from many tourists every year. That's why these areas are very sensitive. In order to guarantee the integrity of ecosystems and local cultures is needed appropriate planning and management. These two components are crucial for conservation.

If planned and managed right way, ecotourism can benefits to the community and visitors concerning economic, social and cultural impacts. A good promotional and educative strategy are also important for successful and qualitative tourism. There are various definitions about ecotourism ranging from general to specific ones.

General definition: Ecotourism is a sub-component of the field of sustainable tourism.

Specific definitions:

"Ecotourism is ecologically sustainable tourism that fosters environmental and cultural understanding, appreciation and conservation." Ecotourism Association of Australia 1991

Ecotourism is responsible travel to natural areas that conserves the environment, sustains the well-being of the local people, and involves interpretation and education" (TIES, 2015).

As above mentioned, ecotourism brings a lot of benefits, known as positive effects. But on the other hand, brings negative effects which consist in ecosystem degradation, depletion of natural resouces, pollution and waste. Awareness strategies and interpretation are important to generate the right tourist experience.

ECOTOURISM TYPES

Alternative tourism has been introduced since the early nineties. It is considered

as a sustainable alternative different by the so-called Mass tourism.
Mass tourism, has been proved to be uncontrolled and to damage on the environmental and the socio-cultural aspects visited areas. Mass tourism happens for example to areas where hotel resorts are built. 'Sea, Sun and Sand' is the typical form of mass tourism.
In contrast, alternative tourism has contributed to sustainable tourism development aiming a high quality of experience. Alternative tourism is typical for developing countries and is related to a wide range of tourist activities such as rural, adventure, cultural and historical, sports (such as hiking, mountaineering, caving), and other forms of tourism not consisting to mass tourism. Sustainable tourism is also known as soft tourism as denotes a mutual cultural understanding between the community and visitors, caring of the environment. Visitors who experience soft tourism use same accomodation and transport facilities as the natives and do not accept substantial tourist facilities harmful to the environment (Smith & Eadington, 1992). Moreover alternative tourism raise awareness concerning the impacts of tourism in terms of benefits and costs and counters any negative impact.

ECOTOURISM PRINCIPLES

Ecotourism principles are uniting conservation, community and sustainable travel.
Uniting conservation while interacting with the nature. Interaction is the key element of ecoutourism. Types of interaction involve hiking, diving, cycling, or other types of physical interaction with nature.
Community interaction with people are considered essential for the tourist experience especially for tourist experience without a guide. Visitors appreciate interacting with the local people as they are treated as special guests.
Sustainable travel is responsible travel that refers mostly to the businesses which offer travel opportunities, rather than visitors. Responsible travel targets natural areas that conserve the environment, sustain the well-being of the local people, and involve interpretation and education.
More specifically ecotourism should take into consideration:

- Minimizing activities impacts.
- Promoting environmental and cultural awareness and respect.
- Providing positive experiences for both visitors and community.
- Providing revenues for conservation and management of natural and

protected areas.

- Generating financial benefits for the community and businesses important for empowerment.
- Delivering enriched visitor experience that raise sensitivity to host countries through promoting understanding, respecting and appreciation of nature and culture.

ECOTOURISM CHARACTERISTICS

Above principles of ecotourism are similar to the general characteristics of ecotourism as defined by UNEP and WTO

- causing low negative visitor impact by being responsible for the area
- involving respect and appreciation to the biodiversity and culture of the natural areas;
- offering education and interpretation during tourist experience; consisting of ecotours of small groups of people and produced by local small sbusinesses;
- providing employment and economic benefits for the local community;
- promoting conservation of the host places

ECOTOURISM ACTORS

Ecotourism involve the following actors:

- Visitors
- Community
- Businesses (that offer travel, accommodation, food and tours)
- Governmental bodies
- NGO-s

Visitors are crucial for tourism development. Without them tourism would not happen. They promote and generate tourism. But their performance impacts the quality and sensitivity of the visited area.

Community is a very important actor. Its involvement and activism in tourism bring benefits to them and environment as well and improves the quality of the tourism.

Businesses exist to fulfill visitors expectation and help the community. Local people find employment opportunities to local and foreign companies operating in tourism field in the destination.

Governmental bodies work to develop tourism and resolve conflicts. State

strategies help to improve ecotourism, sustainability, improve accessibility, promotion, investment, planning and management. The initiatives of government for ecotourism are usefuld when discussed among state authorities, business and communities and when visitors analysis is made.

ECOTOURISM ACTIVITIES

Tourists travel to discover and learn about natural areas. Ecotourism activites include visits to natural areas, ecological studies, historical and cultural visits related to natural areas and other activities such as fishing, hunting, birdwatching, hiking, trekking, cycling, camping, picnic etc.

Natural areas rich of flora and fauna attract the interes of visitors for scientific purpose, or recreational reasons. Part of this experience are often interpretation on local culture and tradition. Special attention have protected areas which are in the targeted destinations of visitors. In these areas limited and controlled activites are held.

Ecotourism incorporate a lot of nature based activities related to habitat and species as mentioned above fishing, hunting, birdwatching.

Cultural activities consist typically in cultural assets and events held (e.g festivals, fairs, environmental days).

ENVIRONMENTAL IMPACTS OF ECOTOURISM

Tourism is a highly complex activity that bring a lot of environmental impacts divided into major categories; positive and negative ones.

A lot is done toward politics and strategies and science to preserve and protect environment through ecotourism. Scientific research studies ecotourism and contributes the understanding of how the environment is effected.

The positive impacts are:

- increase in conservation awareness to the local people, visitors, and all other actors.
- conservation and preservation of natural (land and water resources) and cultural
- increase in water, air qualities
- increase in abundance and diversity of flora and fauna

Negative impacts include to impacts to the natural resources. “The planet’s natural resources are consumed or contaminated by its human population.

Human survival needs drinkable water, breathable air and usable biological diversity. Natural ecosystems are the world's primary reservoirs for each of these" (Buckley, 2008, p.5).
The negative impacts are:

- decrease in abundance and diversity of flora and fauna
- decrease in the aesthetics of the areas
- destruction of ecosystem
- noise pollution
- soil erosion
- decrease in water resources in terms of quality and quantity

Soils

- Soil removal and erosion also occurs.

Flora and fauna

- Transportation may have direct negative impacts on flora removal, animal disturbance

Water

- Increased demands for water.
- Disposal of sewage or litter in water resources such as lakes, river, sea
- Release of oil and fuel from transport (automobile, bus, plane, train, ship).

Air

- Pollution caused by motorised transportation.

Wildlife

- Hunting and fishing may change wildlife population.
- Also visitors may disturb species when seeing them.

Other

- Environmental disturbance: noise, visual or harassing behaviour.

CONCLUSIONS

Ecotourism is known as nature based tourism that gives positive impact on ecosystem and biodiversity. It provides promotion, and protection in terms of

preservation and conservation aim for natural and cultural resources brining financial benefits for the community. Activities should be effectively managed in order to guarantee a quality tourism experience. Nowadays alternative tourism is targeted as sub-component of ecotourism in contrast of mass tourism which has been proved to bring damages to the environment. All actors of ecotourism such as visitors, community, businesses, governmental bodies and NGO-s have respective roles to responsible for the tourist experience. The tourist experience related to various activities offered in the area e.g. fishing, hunting, birdwatching, hiking, trekking, cycling, camping, picnic etc bring the enviromental impacts consisting into positive and negative ones. The focal point is that positive impacts overpass the negative impacts. All actors work hard to reach such objectives and it is important to mention that a lot has been done toward this issue.

RECOMMENDATIONS

Taking into consideration research finding are givee the following recommendations:

- Raise awareness to the actors on the area visited values
- Promote conservation and sustainable use of resources
- Reduce overconsumption and waste
- Organize environmental day activities
- Organize tours in small groups
- Limit visits to the area
- Involve all actors in policy making and the planning
- Offer accurate information about the geography of the area and biodiversity to the visitors
- Capacity building of tour operators

REFERENCES

- Wall, G. (1997). Is Ecotourism Sustainable? Tourism Management.
- Wearing, S., & Neil, J. (1999). Ecotourism: Impacts, Potentials and Possibilities. Oxford ; Boston : Butterworth-Heinemann.
- Wight, P. A. (1993). Sustainable Ecotourism: Balancing Economic,
- Environmental and Social Goals Within an Ethical Framework. The Journal of Tourism Studies.

http://www.ecotourism.org/book/ecotourism-definition
https://www.nature.org/greenliving/what-is-ecotourism.xml
https://environment.yale.edu/publication-series/documents/downloads/0-9/99gaymans.pdf
https://www.ukessays.com/essays/tourism/alternative-tourism-and-ecotourism-tourism-essay.php
http://thescipub.com/abstract/10.3844/jssp.2011.557.564
http://www.usa-journals.com/wp-content/uploads/2014/03/Vishwanatha_Vol24.pdf
http://canidoit.org/negative-and-positive-effects-of-ecotourism
https://www.ecotourism.org.au/
http://vidasilvestre.org.uy/wp-content/uploads/2012/08/Ecotourism-bibliography_TIE

Msc. Kosovar ALIJA, Msc. Artan RESHANI

TRASHËGIMA KULTURORE NË LUG TË BARANIT

Në Rrafshin e Dukagjinit, janë tri lokacione të njohura me emërtimin *lugu*, Lugu i Leshanit, Lugu i Drinit dhe Lugu i Baranit, ”ky i fundit përbehet nga 15 fshatra të cilat shtrihen rrëzë Bistricës së Deçanit, si dhe përgjatë kodrave e shpateve të kësaj lugine. Pra fillon me fshatin Kryshec në perëndim për t’u kufizuar me Drinin e Bardhë në lindje, në veri me Lugun e Leshanit dhe në jug sërish kufizohet me Bistricën e Deçanit”[1]. Kështu, Lugu i Baranit zë pjesën qendrore të Rrafshit të Dukagjinit. Po ashtu edhe relievi i kësaj zone, karakterizohet me dimra të ashpër dhe me verë të nxehtë. Duke qenë se kjo zonë shtrihet përgjatë lumenjve, toka është mjaft pjellore, dhe e ujitshme. Bbanorët e saj janë marrë historikisht me bujqësi e blegtori, pemëtari vreshtari, bletari, zejtari etj, dhe pikërisht kjo pozitë e favorshme gjeografike ka bërë të mundur që t’i dallojë ata jo vetëm në rrafshin lokal, por edhe më gjerë.

Dokumentet e para që përmendin Lugun e Baranit, janë mjaft të vjetra, *“dhe datojnë që nga gjysma e parë e shek, XIV, këto dokumente quhen ”krisobula” me të cilat sundimtarët e ndryshëm të dinastisë së Nemanjiqëve u dhuronin manastireve fshatra, pasuri e privilegje të tjera mbi fshatarët e këtyre anëve”*[2]. Siç potencuam më lartë, dokumentet janë të vjetra, Lugu i Baranit duhet te ketë qenë një vendbanim më i hershëm se periudha e dinastisë Nemanjiqe, e burimet lëndore dhe dokumentet e ndryshme të kësaj periudhe mungojnë. Para disa vitesh arkeologet janë marrë me këtë lokalitet, dhe janë gjetur vegla të periudhës neolitike, çka dëshmon për një lokalitet të lashtë. Gjithashtu, kemi defterët turke qe janë statistika mbi numrin e popullsisë, si dhe numrin e njerëzve të aftë për luftë, kryefamiljarëve, dhe shumën e detyrimeve që i detyroheshin shtetit ose spahiut.

Ashtu si në secilin vend edhe infrastruktura ka qenë e njëjtë, si ne mbarë Rrafshin e Dukagjinit, dhe në vende të tjera. Vlen të theksohet se edhe shtëpitë e banimit ishin kryesisht komponim i gurit dhe drurit, duke qenë se këta banorë njihnin teknikat e përpunimit të gurit, pastaj edhe sot në mbarë

[1] Mark Krasniqi , Lugu i Baranit . Akademia e shkencave dhe arteve të Kosovës, Prishtinë.1984

[2] Mark Krasniqi , Lugu i Baranit . Akademia e shkencave dhe arteve të Kosovës, Prishtinë.1984

Rrafshin e Dukagjinit vërehen këto ndërtime që janë një atraksion në vete, tipike autoktone shqiptare. Zakonisht vërehen kulla dykatëshe, por nuk mungonin edhe ato trekatëshe, të mbuluara kryesisht me rrasa guri. Këto kulla nuk ndryshonin shumë nga njëra tjetra në mbarë Lugun e Baranit. Kështu, kati i parë shërbente si ahur për bagëtitë, nga edhe ishin shkallët për tu ngjitur në kullë, në katin e dytë ishte një paradhomë që quhej *divahane*, dhe pastaj ishte oda e madhe e kullës me dritare të vogla *(frëngji)*. Në kohët e më vona, këto dritare u ndërtuan në mënyrë harkore, të skalitura në gur, edhe pullazi ishte i drunjtë, dhe në ballë të vendit ishte oxhaku. Zakonisht anash kishte dollapët, që mbaheshin pijet e gjësendet tjera që servireshin në kullë. Dyshemeja shtrohej me cerga, dhe mbi të qilimi i punuar nga femrat tona, dhe në ballë të odës shtrohej sixhadeja, e rreth saj shtrohej postiqe (ose postaki), ndërkaq divahaneja shërbente për gjerat e tjera që hynin në kullë sofrat, batanijet e jorganët për mysafirët. Kjo, gjatë verës ishte një dhomë e freskët, shfrytëzohej si dhomë ndeje e pushimi. Krahas kullës ishte edhe një ndërtese tjetër afër ose edhe ngjitur me kullën, quhej shtëpia e grave, ku ishin dhomat e gjumit, dhoma e ndejës, dhoma e bulmetit etj. Varësisht oborri rrethohej me mur guri, e më shpesh me gardh, si sistem mbrojtës. Në Lugun e Baranit këto ndërtime ishin krejtësisht të ngjashme, përkundër përkatësisë fetare, myslimane e katolike dhe ndërtime të tilla ishin në secilin fshat të kësaj ane.

Objekt tjetër i veçantë, mbetet edhe Mulliri i Nepoles, i ndërtuar sipas banorëve në vitet 1800, nga *Osman Agë Nepolja*, dhe ka qenë i vetmi në Lug të Baranit, dhe ka pasur rëndësi të jashtëzakonshme. Objektet shkollore, përkatësisht edukative në Lugun e Baranit janë të shumta, mungojnë të dhënat e themelimit të tyre, por sipas të dhënave gojore ato kanë filluar të funksionojnë, që në kohërat e fundit të mbeturinave turke, e në disa pjesë edhe pas dhe të motivuara me rilindjen kombëtare. Shumë nga to janë aktive dhe sot, roli i tyre ka qenë vendimtar në përgatitjen e brezave të ardhme, duke nxjerrë personalitete të shquara të shumë sferave jetësore. Në fillim operuan nëpër objekte të kultit mejtepe, xhami e kisha dhe vetëm pas shumë kohëve filluan funksionin e tyre të ndara nga objektet fetare.

Objektet e kultit, në Lug të Baranit nuk janë të rralla, si formë e aplikimit të religjionit në secilin nga fshatrat përbërës të tij. Edhe pse këto objekte janë relativisht të reja, asnjëherë nuk kanë qenë në kundërshtim me njëra tjetrën edhe pse dallonin nga njëra tjetra. Këtu si rrallëherë, këto objekte kanë pasur një bashkëpunim të shkëlqyer mes vetes, bile gjatë ndërtimit të tyre janë ndihmuar e përkrahur pa rezervë ndërmjet veti, duke bërë çmos të ruhej ekzistenca dhe tradita, dhe në këtë aspekt kanë qenë shumë liberale duke mosluftuar traditat e ritet pagane, ose besimet e vjetra jo monoteiste. Famullia e Gllogjanit, daton

shumë herët në relacionet papnore më 1895 dhe figuron si filialë e famullisë së Pejës, prej 1897 deri me 1919, ndërkaq kisha u ndërtua pas vrasjes së At Luigj Palajt. Pra kisha e Gllogjanit u ndërtua me 1914, pas shumë vështirësish nga pushtuesit serbo malazezë, dhe punimet i ndaluan shumë herë përgjatë një periudhe të gjatë kohore.

Kjo kishë, ashtu si edhe mejtepi i Kosuriqit, pastaj xhamia e Baranit, dhe objekte të tjera fetare, luajtën një rol të madh në mësimin e shkrim leximit. Pra janë përdorur edhe si objekte arsimore-edukative. Pastaj prania e klerit religjioz në këto anë, ka ndihmuar shumë edhe për afrimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes vete, mirëkuptimit e të unitetit edhe pse përbërja religjioze e këtyre fshatrave duhet të ketë qenë e njëjtë para shumë kohësh. Këtë e vërteton fakti që njihen njerëz me po të njëjtin mbiemër ose edhe të ndryshëm, por që janë kushërinj ndërmjet veti, edhe pse me përkatësi të ndryshme fetare, "dhe elementi i sotëm katolik dëshmohet se për të ruajtur përkatësinë fetare nga pushtuesit turq e të tjerë, kanë kaluar edhe në faza *kriptokatolicizmi*, ose *laramanizmi*"[3].

Kultura shpirtërore e këtyre banorëve, nuk dallon nga pjesët e tjera të Rrafshit te Dukagjinit, ose edhe trevave tjera kosovare. Këto deri vone ishin nën ndikimin e sistemit patriarkal, sistem ky që në rrjedhën e globalizmit është tjetërsuar dhe ka përmasa të tjera më moderne. Sot nuk mund ta quajmë shoqëri madje as *konservative,* pavarësisht modernizmit rrënjët e një kulture të lashtë akoma janë prezentë, si forma jete, veshjet, festat, rastet mortore e gazmore, besimet e besëtytnitë etj. Si shembull, fejesa ishte e ngjashme si në pjesë tjera të Rrafshit te Dukagjinit dhe nuk ishte ndonjë ceremoni e posaçme. Zakonisht shkuesi (ose mesiti) ishte ndonjë kushëri ose i afërm që njihte të dyja palët, i cili ishte kontaktuesi mes dy familjeve, zakonisht për shkues preferohej daja i vajzës, ngase mundësia për të marrë fjalë nuseje ishte më e madhe, Zakonisht, fejesën e bënte kryefamiljari i cili me pas kishe marrë pëlqimin e prindërve te vajzës, e të meshkujve tjerë të shtëpisë. Fejesa përcillej me dhurata simbolike, që dëshmonin lidhjen e miqësisë.

Në Lugu i Baranit, dasma zhvillohej sipas traditave shqiptare. Në shtëpinë e nuses organizohej nata e *kanagjeqit* me këngë shpotitëse të shoqeve dhe me lot të nuses, kurse në shtëpinë e dhëndrit mblidheshin dasmorët në mëngjes, ditën e dasmës. Deri në fillim të viteve 1900, nusja merrej të enjten, vetëm nëse dhëndëri ishte vejan, atëherë dasma bëhej të hënën. Rreth mesit të shekullit të kaluar, dasma organizohej vetëm të dielave dhe shumë rrallë edhe të mërkurave, ndërsa në vitet e fundit organizimi ka ndryshuar. Organizmi i dasmës, deri në

[3] Shan Zefi, Islamizimi i Shqiptarëve Gjatë Shekujve. Shtëpia botuese Drita , Prizren, 2000, f, 97

fillim të vitit 1900 bëhej në shtëpi, ku mblidheshin gratë dhe ndanin punët. Disa gra, zgjidheshin dhe shkonin për të marrë nusen. Ato quheshin gratë e kerrit. Me to shkonte edhe djali i kerrit, së bashku me ta edhe një numër i caktuar krushqish. Ata duhet të shkonin para dite për të marrë nusen, ku i prisnin miqtë në një mënyrë madhështore. Meshkujt i pritnin dasmorët në odë të burrave, ndërsa gratë në shtëpi. Kur vinin krushqit, i ati i nuses i dorëzonte atit të djalit ose vëllait të djalit vajzën e tij dhe i thoshte *"ia pashi hajrin"*. Me këtë rast, nusja dhe gratë mikpritëse qanin me zë. Nusja në atë kohë, në mungesë të automjeteve, merrej me kuaj ose me qerre. Në shtëpinë e dhëndrit, po sa hynte nusja, te dera duhej të bënte "divan" (temena) dhe ishte e veshur në veshje kombëtare e me vonë në "allafrënga", kurse nusja tani vishet me vello të bardhë. Dasma zgjaste 3 ditë.

Lindja e fëmijëve është qëllimi kryesor i martesës. Në kohën kur në fshat, jeta ishte e sistemit patriarkal, qëllimi kryesor ishte që sa më shumë meshkujt të kishte një çift, sepse kështu do të forcohej familja dhe fisi, dhe kështu ata do të kishin gjendjen më të mirë ekonomike dhe në situata të rreziqeve, ata do të ishin më të fortë. Lindja e djalit po ashtu, si fejesa lajmërohej me të shtëna armësh, sepse familjes po i shtohej edhe një punëtor, edhe një pushkë. Për lindjen e djalit familja, pas pagëzimit që e bënte në kishë, organizonte gosti për familjarët dhe të afërmit. Ndërsa lindja e vajzës nuk pritej edhe aq mirë, nuk kishte të shtëna dhe nuk kishte gosti për familjarët dhe të afërmit. Vdekja parashikohej në mënyra të ndryshme të traditës e besëtytnive popullore. Nëse mbi kulm të shtëpisë këndonte qyqja, besohej që atë vit dikush do të vdiste nga ajo familje, ose edhe kur qeni ulërinte, ishte po ashtu një ogur i keq. Populli ynë, ka shumë forma të tilla të besimit, të trashëguara qysh nga koha ilirike, forma që lajmëronin rastet e gëzimit apo pikëllimit. Vdekja, lajmërohej me kukama të grave të shtëpisë, pastaj lajmëroheshin njerëzit e afërm, fqinjët dhe fisi. Këta vinin te familja ta ndihmonin, angazhohen persona të cilët do të bënin lajmërimin e njerëzve të tjerë me të largët, për rastin mortor, pra ata çonin "fjalë" mik pas miku deri te miku më i largët. Të rinjtë e fshatit shkojnë te varret për të hapur varrin, dhe atyre nuk u thuhet "*puna e mbarë*" as "*a u lodhët*" po "*Zoti ua baftë sevap*". Gratë qajnë dhe kukasin, ndërsa burrat jo. Këto tradita vazhdojnë edhe sot.

Veshja është thuajse e njëjtë me mbarë veshjen në Lugun e Baranit dhe në Rrafshin e Dukagjini në përgjithësi. Populli shqiptar shquhej për veshjen e tij të larmishme, e cila nuk ka ndryshuar, ani pse tash nuk përdoret. Sot përdoren veshje të thjeshta dhe në hap me kohën. Siç përshkruhet edhe në librin e akademik Mark Krasniqit "Lugu i Baranit", veshja e burrave, deri pas Luftës së Dytë Botërore ishte veshje me tirq të zhgunit të bardhë, me gajtanë të zinj, shokë rreth brezit, mitan basme me mëngë të gjata dhe xhaketë përmbi ngjyrë kafe, kësulë,

opinga dhe plis të bardhë. Tirqit kanë qenë shumë të ngushtë, sidomos në fund të këmbëve. Ndërsa veshja e grave dallonte për ato të moshuarat dhe për ato të rejat. Të moshuarat vishnin një këmishë të gjatë dhe të bardhë, dy pështjellakë, përpara më i gjatë e më i gjerë se sa ai prapa. Në kokë mbanin lidhëse e maramë, çorape të gjata, opinga të lëkurës së lopëve të punuar me penj të pambukut dhe gëzof nga delja. Gratë vishnin jelekë ose mitanë të zbukuruar me gajtanë dhe të qëndisur bukur. Nuset stoliseshin me ari dhe bizhuteri të ndryshme, ndërsa vajzat e rritura nuk mbanin bizhuteri, nuk përdornin lidhës e marame. Herë-herë përdornin një shami në kokë, të lidhur poshtë mjekrës. Fëmijët visheshin në mënyrë shumë të thjeshtë, një këmishë, një mitan ose jelek dhe një parë pantallona. Meshkujt tirq, ndërsa vajzat një pështjellës deri të këmbët[4].

Këto veshje pas Luftës së Dytë Botërorë dita-ditës kanë filluar të zhduken. Sot rrallë sheh edhe nga të moshuarit as nga të rinjtë të veshur me këto rroba. E vetmja rrobë që është trashëguar edhe sot, është plisi i bardhë, të cilin e vënë zakonisht vetëm të moshuarit. Festat pos karakterit fetar bartin në vete edhe një kulturë të vjetër, dhe një trashëgimi e bartur deri në ditët tona.

Lugu i Baranit me përkatësi fetare myslimane e katolike, ka ditur të bashkëjetojë jashtëzakonisht mirë, me pikëpamje vërtetë vëllazërore. Pra si festat e *Bajramit* pastaj edhe *Pashkët e Krishtlindjet* festoheshin ndërmjet veti, nuk do të hynim mënyrës së festimit për shkak të karakterit më shumë religjioz, por fokusin do të donim ta përqendronim me shumë tek *Krishtlindjet* pasi aty banorët e kësaj ane kanë bartur një traditë pagane të kohëve ilirike, ose mund të jetë edhe pellazge siç mendojnë disa studiues. Pastaj edhe festën e Shën Gjergjit që si festë me rite pagane, festohet e shënjohet nga të dy përkatësitë fetare aktuale. Të ndalemi tek *Krishtlindjet* ose *Nata e Buzmit,* siç quhet ndryshe. ”Buzmi bëhet me rituale, që janë të një prejardhjeje të lashtë; kryesisht lidhen me fuqinë e diellit, përkatësisht shënojnë solsticin dimëror të diellit, që mposht errësirën dhe bën të ngadhënjejë drita. Si shumica e festave, edhe ajo e buzmit lidhej ngushtë me dëshirën për prodhim të mbarë e të bollshëm. Të gjitha ritet e kësaj feste pagane kanë pasur karakter të theksuar bujqësor e blegtoral, çka tregon edhe për drejtimet kryesore ekonomike të popullit tonë në të kaluarën. Ato janë karakteristike për atë shkallë të zhvillimit të shoqërisë, kur natyra dhe dukuritë e saj kishin pushtet të fortë mbi të gjitha veprimtaritë e njeriut. Si të tilla, ato kanë rëndësi për studimin e psikologjisë dhe botëkuptimit të kësaj shoqërie”[5].

---

[4] Adrian Kamberi , Lulja e Pejës. Monografi për Gllogjanin e Pejës Doreshkrim ende i pabotuar , 2013

[5] Fahri Xharra , Dushku pellazg dhe Nata e Buzmit. Bot, me 07-01-2015 http://shqiperiaebashkuar.info/2015/01/dushku-pellazg-dhe-nata-e-buzmit/

Krishtlindjet, apo *Kërshëndellat* siç quheshin në kohët më të vjetra, janë bartëse direkt të riteve ilire të trashëguara brez pas brezi deri në kohët tona. E veçanta e kësaj kremteje është *Nata e Lume* ose *Nata e Buzmit*, që veçohet edhe për mënyrën sesi kremtohet. Mënyrat e ritit dallojnë nga vendi në vend. Vigjilja e kësaj feste, është data e 24 dhjetorit, ku një mashkull shtëpie i pret *buzmat*, që duhet të jenë drunj të rinj, e që nuk duhet të priten në malin e të zotit të shtëpisë, duhet të jenë dru bungu, qarri e arre, pra tri lloje të drunjve të ndryshëm ose dy lloj të drunjve. Këta drunj, priten dhe lihen në një vend të fshehtë, në shenjë nderi e respekti. Po ashtu zonja e shtëpisë gatuan kungullorë (pite me kungull, dhe me arra), zien grurin e vende-vende edhe fasule. Nata e Buzmit nuk përcillet me konsumimin e mishit, konsumohet peshku. Natën e Buzmit edhe bagëtitë ushqehen më shumë se zakonisht.

Shën Gjergji, edhe kjo festë ka gjenealogji ilire, dhe është përcjellë brez pas brezi deri në ditët tona. Duke qenë me prejardhje ilire, edhe mënyra e festës dallon nga vendi në vend. Festimi i kësaj feste bëhet edhe nga qarqe të ndryshme kristiane dhe jokristiane, është dita e luleve, e ngrohjes së motit, e çeljes së pemëve, e kalimit të dimrit dhe e shënimit të verës.

Një ditë para mblidhen, degëza shelgjesh, lule molle, ftonjsh, dhe vendosen nën jastëk, hyrje të shtëpive, në dritare. Rreth magjes ku gatuhej buka, në hambarët e drithit, në ahur të bagëtive, pastaj merren dhe hithrat dhe me të prekën fëmijët dhe pjesëtarët e shtëpisë. Po ashtu edhe vendi i bagëtive, për të mbarë e për bereqet. Të nesërmen, lahen fëmijët dhe aty ku lahen në korita zakonisht vendosen lule. Edhe bagëtive u kushtohej rëndësi, ditën e Shën Gjergjit përgatitej një ushqim erëmirë me barishte të ndryshme, shavar, amon, rozmarinë e egër, kripë, hudhër, miell misri etj, kjo përbërje përzihej dhe iu vihej para bagëtive, për të ecur mbarë, për t'u shtuar, dhe për të dhenë edhe qumësht më shumë. Për Shën Gjergj përgatitej përshesh misri me qumësht, për darkë gatuhej pite ose fli.

Si përfundim Lugu i Baranit një territor mahnitës, ngërthen në vete një trashëgimi të larmishme e të bartur edhe sot. Me një traditë të pasur e madhështore nga të parët tanë ilirët, këto akte i tejkaluan edhe barbaritë pushtuese që nga romakët, bizantinët, turqit, e të tjerë, ku vetëdija shqiptare edhe pse e fortë u përball me frymën e egër të pushtuesve. Mbijetesa e tyre edhe pse shumë e rëndë, megjithatë arriti të mbijetojë, madje e kemi cekur me lartë se për të ruajtur traditën praktikuan edhe *laramanizmin,* ose edhe u tjetërsuan për të marrë benefitet tjera nën sundimtarë të huaj.

Ndryshimet politike e shoqërore në mbarë botën shqiptare në fillimin e mijëvjeçarit të ri, sikur patën një revolucion të përgjithshëm, prandaj edhe

ndryshimi i këtyre fakteve sikur sjelli një hapje më të madhe drejt botës perëndimore. Afrimi me këtë qytetërim u bë më i afërt se kurrë. Rol të madh në përmirësimin e jetës sonë, trajtimin e elementeve të ndryshme sociale, ekonomike e shëndetësore, politike etj. morën një trajtesë të re e botëkuptim të ri, falë mërgatës sonë të madhe e të jashtëzakonshme. Edhe në Lug të Baranit, nuk mund të ndodhë ndryshe, pos si në pjesët e tjera të mbarë Kosovës. Gjatë kësaj trajtese mbi trashëgiminë kulturore, jemi munduar të vejmë në pah ato elemente që karakterizojnë e vërtetojnë të kaluarën tonë, format e jetës. Një trajtesë e një natyre të tillë sigurisht se s'mund ta përfshijë tërë kompleksitetin e trashëgimisë së larmishme të kulturës tonë.

BIBLIOGRAFIA

- Krasniqi, Mark. Lugu i Baranit (1984) Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Zefi, Shan. Islamizimi i shqiptareve gjatë shekujve (2000) Drita. Prizren.
- Kamberi, Adrian. Lulja e Pejës (2013) Monografi për Gllogjanin e Pejës dorëshkrim ende i pabotuar.
- Xharra, Fahri. Dushku pellazg dhe Nata e Buzmit. Bot,me 07-01-2015

http://shqiperiaebashkuar.info/2015/01/dushku-pellazg-dhe-nata-e-buzmit/
https://www.google.com/search?q=veshje+e+dukagjinit&safe=active&espv=2&biw=1280&bih=620&site=webhp&tbm=isch&imgil=7PMqu_-HeM5AAM%253A%253B0jn1lAu6OloXTM%253Bhttp%25253A%25252F%25252Fwww.yllpress.com%25252F8290%25252F-veshje-tradicionale-shqiptare-ne-zvicer.html&source=iu&pf=m&fir=7PMqu_-HeM5AAM%253A%252C0jn1lAu6OloXTM%252C_&usg=__nVYWMCRxR0fOVO

PhD Alfred HALILAJ

"KAFJA" DHE KOMUNIKIMI KOMPLEKS.

Abstrakt

Ndër shqiptarët vendi ku gëlon më shumë diskutim dhe komunikim janë kafenetë. Prej së shkuarës dhe ndikimeve orientale trashëgojmë këtë formë mediumi mjaft interesant që edhe në ditët e sotme praktikohet rëndom. *"Kafja turke"* që vjen si percaktor prej periudhës së perandorisë otomane ishte pa dyshim edhe qerasja më me vlerë në *"odat e miqve"* në kulturën tradicionale shqiptare. Respekti maksimal i bëhej mikut kur kafja i servirej me ceremonialet që e shoqërojnë kafen.

"Hajde ulemi për një kafe" thuhet kur palët duan të zgjidhin një mosmarreveshje. Kur tjetri nuk ka pranuar të ulet për kafe mesazhi është se ai nuk pranon të ketë një zgjidhje për konfliktin apo çështjen që diskutohet. "A ja pijmë kafen kësaj pune?" pyetet kur një çështje shkon drejt zgjidhjes. Dërgimi i një pakoje kafe si dhuratë simbolizon marrjen pjesë në mërzinë apo dhimbjen e tjetrit. Gëzimi dhe hidhërimi shoqërohen me kafe.

Kafja si një insitut i veçantë i bashkëngjitet edhe shumë insituteve të tjera të kulturës së pashkruar siç është besa apo mikpritja. Përthyerja që merr në ditët tona *kultura e kafes* do të jetë objekt hulumtimi gjatë kësaj kumtese. Pedagogjia që kafja realizon për mësimin e kulturës është e veçantë. Rruga e zgjidhjes së mos-marrëveshjeve apo e marrëveshjeve kalon përmes kafes.

Pas viteve '90 në Shqipëri në kushtet e *mungesës* së zbatimit të ligjeve dhe autoritetit të institucioneve shtetërore, qytetarët kanë përdorur si ndërmjetës hapësirat normative kulturore për të vetërregulluar raportet sociale. Çështjet e pronës dhe të trashëgimisë, shitblerja e tokës, lëvizja e popullsisë, konfliktet midis palëve, dhe gjithë kozmologjia e jetës i puthitet një botëkuptimi që rrotullohet rreth kafes.

Edhe mediat kur duan të bëjnë ftesa për ndjekjen e emisioneve të ndryshme fusin fjalën *kafe* në titullin e emisioneve.

Duke përdorur kontaktet e drejtpërdrejta me njerëzit në terren, si dhe duke realizuar anketa dhe pyetësorë mbi rëndësinë e kafes në jetën e tyre, do të tentojmë të sjellim në këtë kumtesë "kulturën e kafes" në Shqipëri.

Fjalë kyçe: kulturë kafeje , media, komunikim, kod kulturorë, unifikim kulturor, paragjykim, realitet kulturor.

"Coffee" and complex communication.

Abstract

Among the Albanians, the country where the most swarms discussion and communication are cafes. From the past and the oriental influences we inherit this very interesting medial form that is practiced today. The "turkish coffee" that came as an emperor from the Ottoman Empire era was undoubtedly the most valuable gift in the "chatter of friends" in the traditional Albanian culture. The utmost respectability became a friend when coffee served with ceremonies accompanying coffee.

"Come sit for a coffee" is said when the parties want to resolve a dispute. When the other has refused to sit for coffee the message is that he refuses to have a solution to the conflict or issue being discussed. "Do you have coffee for this job?" Is asked when an issue goes to the solution. Sending a coffee pack as a gift symbolizes taking part in the other's boredom or pain. Joy and sorrow are accompanied by coffee.

Coffee as a special institution is attached to many other institutions of unwritten culture such as belief or hospitality. The refraction that is taking in our day the coffee culture will be the subject of research during this press release. The pedagogy that coffee provides for learning the culture is unique. The way of resolving non-agreements or agreements goes through coffee.

After the 90s in Albania in the absence of the implementation of the laws and authority of state institutions, citizens used as mediators normative cultural spaces to self-regulate social relations. Property and heritage issues, land sales, population movement, conflicts between the parties, and the whole cosmology of life admixtures a worldview that revolves around coffee.

Even the media when they want to make invitations to watch various shows put the word *coffee* in the title of the shows.

By using direct contact with people on the ground, and by conducting surveys and questionnaires on the importance of coffee in their lives, we will try to bring this "cafe culture" message to Albania.

Keywords: coffee culture, media, communication, cultural code, cultural unification, bias, cultural reality.

Kafeneja është vendi më publik në të cilin njerëzit performojnë. Është vendi i bisedës me veten por edhe me të tjerët.

Njeri variant për shpjegimin e fjalës kafe e lidh atë me fjalën arabe *"kahwa"* e cila kaloi në fjalën turke "kahve" dhe nëpërmjet një tkurrje progresive mori kuptimin në shqip me fjalën *"kafe"*. Ky variant kundërshtohet nga ata që e mbështesin prejardhjen e termit kafe nga emri i rajonit Kaffa, në Etiopinë jug-perëndimore, pasi është vendi ku kjo bimë rritet masivisht në mënyrë spontane, Kafja si produkt mendohet se e ka origjinën në shekullin e XI në Etiopi. Ajo sot kosiderohet si një kafe bimore e kultivuar në mbi 70 vende të botës, kryesisht në rajonet ekuatoriale të Amerikës, Azisë Juglindore dhe Indisë.[1] Kafja bën pjesë në grupin e tretë të drogave të lehta dhe njihet për efektet e saj terapeutike, megjithë studimet që tentojnë të shquajnë më qartë efektet reale të saj. Ka studime që evidentojnë më shumë efektet dhe varësinë psikologjike të kafes se sa efektin real fizik.

Kultura e kafes daton në shekullin e XIV, ndërsa ato që quheshin *"shtëpi kafe"* ishin vendet ku krijohej një klimë e këndshme për t'u mbledhur artistët, intelektualët dhe njerëzit e dijes. Këto ambjente ishin vatra të diskutimeve letrare, filozofike dhe politike në qytetet kryesore perëndimore si Londra dhe Parisi.
"Kafja turke", prej së cilës edhe shoqëria jonë është ndikuar për shkak të perandorisë otomane, në fakt nuk prodhohej në Turqi por në Jemen. Në vitin 1530 u hap kafeneja e parë në Damask, ndërsa në Stamboll kafeneja e parë u hap më 1475 nga tregtarë që vinin nga Damasku dhe Halepi. Kafeneja e parë është hapur në Kostandinopojë në vitin 1640 dhe më pas ka fituar në shoqërinë turke një rol shumë të rëndësishëm social edhe për ngjarje të tilla si martesat dhe vdekjet por edhe në përditshmërinë e jetës së njerëzve. *"Kafja turke"* që nga viti 2013 është në listën e trashëgimisë kulturore të UNESKO-së.

Kafeneja e parë në Evropë u shfaq në Venedik, si rezultat i marrëdhënieve ndërmjet Republikës Venedikut dhe Osmanëve. Në vitin 1615, lokali i parë i kafes u hap në Venecia të Italisë. Nga ky bar nisi dhe kultura e pirjes së kafes. Kafeneja e parë në Angli u ngrit në Oksford më 1650 nga një hebre me emrin Jakob në një ndërtesë, e cila tani njihet me emrin *"The Grand Cafe"*. Pas vitit 1675 në të gjithë Anglinë u ngritën më shumë se 3000 kafene.

Ne France me 1689 Prokop Kuto hapi *"Kafe Prokop"*. Kjo kafene ekziston edhe sot dhe ka qenë një nga vendtakimet e njerëzve të shquar të Iluminizmit Francez në Paris, si: Volteri, Ruso dhe Denis Didero, të cilët e frekuentuan atë dhe diskutohet të ketë qenë vend-lindja e Enciklopedisë së tyre,

---

[1] - http://radio-7.net/roli-i-heshtur-social-i-kafes/

enciklopedia e parë moderne.[2]
Amerika e ka pasur kafenenë e parë në Boston 1676. Kafeja, çaji dhe birra shpesh janë shërbyer së bashku në të njëjtën ndërtesë, e cila ka shërbyer njëkohësisht, edhe si kafene, edhe si tavernë; një e tillë ka qenë *"Dragoi Jeshil"* në Boston.
Sipas publicistit të njohur Daut Dauti shqiptarët janë evropianët e parë që e kanë shijuar dhe adaptuar kafenë si pije kombëtare.[3] Ai gjithashtu argumenton edhe kontributin e dhënë nga shqiptari nga Tuzi Pashk Rosi i regjistruar si Pasqua Rosee i cili së bashku me partnerin e tij të biznesit William Oldys do të hapin kafen e parë luksoze në Londër sipas modelit që ekzistonte në Stamboll.
Evlija Çelebiu, i cili ka vizituar Kosovën dhe Shqipërinë e epërme në vitet 1660 dhe 1662 ndërsa Shqipërinë e jugut në vitin 1670, thekson se në hanet, bujtinat dhe parqet e shumta, ndër të tjera, salltanati kryesor ishte servirja dhe pirja e kafes. Në këtë kohë popujt Evropianë nuk e kishin bërë kafen si pjesë të ritualit të tyre.
Në vitet '20 të shekullit të kaluar edhe në Shqipëri filloi tradita e *hapjes së kafeneve* kryesisht në qytetet kryesore si Shkodra me të famshmen *"Kafja e madhe"* apo Tirana me *"Kafe Flora"*. Modelet e tyre ishin të ngjashme me *shtëpitë e kafeve* në Londër apo Paris si dhe të ideuara (sidomos "Kafja e madhe") sipas modeleve më të përparuara të kohës. Këtu elitat intelektuale rrihnin mendimet, njerëzit e zakonshmën qetësoheshin, të huajt që vizitonin vendin identifikonin Shqipërine e re, fshatarët e dëshmonin si një ngjarje vizitën në këto kafene.
Duke u kthyer në kulturën tradicionale shqiptare lehtësisht verifikohet ***kafja*** si një insitutut i fortë etik në sendërtimin e raporteve sociale. Vendimarrjet e prodhuara pas pirjes së një kafe kanë karakter juridik dhe të pathyeshëm nga palët. *"Pirja e kafes"* konsiderohet si mbyllje me sukses e një konflikti, mbarimi e një pune apo zgjidhja e një problemi të caktuar. Kur kjo ndodhte nuk kishte më nevojë të vihej në pyejtje çka kishte ndodhur veçse depozitohej në kujtesën kolektive si një çështje e zgjidhur dhe e mbyllur. Kjo etikë e lartë juridike është përdorur dhe vazhdon të përdoret për çështje të rëndësishme të jetës së shqiptarëve si ndarja e pronës dhe pasurisë, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve apo dhe marrëveshjet që përcaktojnë rregullat për funksionimin e shoqërisë në të ardhmen.
Pa asnjë dyshim që kafja dhe mënyra e servirjes së saj kanë marrë vëmendje të veçantë duke e shoqëruar me ceremoniale të ndryshme që përkthehen në kode dhe simbolika komunikimi. Nga intervista me informatorin A.B 68 vjeç nga fshati Bushtricë i Kukësit dhe banor në zonën e Kamzës në Tiranë tregohet kjo histori: *"Pas vitit 1990 n'katun tonë u ba nji dasëm. N'odë t'burrave ku priteshin*

[2]- http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2537

[3]- http://www.javanews.al/historia-e-kafes-si-u-shpernda-nga-shqiptaret-ne-evrope/

njerëzit për vizita shërbehej në mënyrë kolektive. Dhoma ishte e shtrume me shilte në dy anët dhe kafexhiu që shërbente ja jepte atij që ishte në krye të dhomës filxhanat dhe ibrikin me kafe. Burrat e ulur ja transmetojshin njani-tjetrit kafen. Kur i erdhi rradha një djali të ri rreth 25 vjeç, ai që ishte në krah, ja dha kafen poshtë gjunit. Kjo ishte shumë e rëndë. Por ai dashke me i thanë se ti nuk je i zoti se nuk ja ke marrë gjakun babës. Djali u ngrit në kambë e iku. E kritikun boll në dhomë atë që e bani por për nji pare. Mbas 5 vjetsh ai vrau në mes të Tiranës vllanë e atij që i kishte vra babën".

Foto 1

Mënyra e servirjes së kafes kur dikush nuk kishte marrë gjakun e familjarit të afërt

Historia e mësipërme tregon një rast që implikon rëndësinë e madhe që ka ceremoniali në servirjen e kafes. Ky lloj diferencimi i dhënies së kafes poshtë gjurit i kujtonte djalit se ai nuk e meritonte t'i jepej kafja si gjithë të tjerët pasi nuk kishte marrë hak sipas të drejtës kanunore. Kjo kafe bëhet shkak për një vrasje të mëvonshme. Kjo mënyrë komunikimi e kodifikuar dhe komplekse për dikë që nuk e njeh rëndësinë që ka servirja e kafes mund të duket absurditet. Përkthimi i këtij mesazhi të fortë në një qëndrim pothuaj të imponuar social tregon peshën reale që ka ceremoniali. Bronislaw Malinowski në librin *"Krimi dhe doket në shoqërinë e egër"* flet për *"kotësinë"* e ceremonialeve të Trobriandasve në lidhje me shkëmbimin e ushqimit por forca detyruese dhe obliguese e tyre ishte

e jashtëzakonshme[4] .

Dhënia e kafes ka pasur rëndësi për të dëshmuar edhe tipare të tjera të shqiptarëve. Kur dikujt jepej kafe kur hynte si mik apo si mysafir në shtëpinë e dikujt, me këtë dëshmohej se familja përkatëse kishte një nivel të mirë ekonomik dhe që diferencohej prej të tjerëve. Vlen të theksohet fakti se ishte mjaft e vështirë të sigurohej kafja si produkt qoftë për koston e lartë por edhe për faktin se mungonte në treg. Ndaj dhënia e kafes merrte vlerë të madhe në prezantimin e familjes. Vlerësimin e kafes e kam përjetuar personalisht në një prej ekspeditave në zonën e Kamzës, në periferi të Tiranës, gjatë punës etnografike. Trokita në shtëpinë e S.L nga Dibra që ishte rreth 75 vjeç. Menjëherë nusja e djalit të tij më serviri kafen turke. Duke u përpjekur të verifikoj çdo detaj dhe gjithnjë i fokusuar tek biseda, kafen e kisha konsumuar deri në gjysëm, mirëpo unë kafen nuk e pi dot pa ujë. Në këtë moment i kërkoj zonjës një gotë ujë. Reagimi i informatorit, të zotit të shtëpisë, u shoqërua me një marrje fryme të thellë dhe me shpejtimin e numërimit të tespinjve që mbante në dorë. Pas një heshtjeje të shkurtër ai kthehet nga unë duke më parë në sy dhe më thotë: *"Or profesor, ma cove dam qet kafe"*. U shtanga dhe me shumë droje po reflektoja për ndonjë gabim që mund të kisha bërë gjatë bisedës. E pyeta se çfarë kisha bërë dhe i kërkova falje se prej padijes edhe mund ta kisha fyer. Ai e vazhdon arsyetimin: *"Profesor, kur pihet kafja nuk pihet ujë se ja humb shijen dhe vlerën kafes"*.

Nga ana tjetër duhet thënë se jo për çdo person që shkonte për vizitë servirej kafja. Kishte shumë rëndësi statusi i personit që shkonte në shtëpi. Një miku, një mysafiri të rëndësishëm, një burri të njohur për vlerat e tij, një njeriu që vinte nga larg apo nga një zonë tjetër i servirej kafja me gjithë ceremonialin që i shkon përshtat prezantimit të respektit maksimal qe i bëhet atij që po viziton shtëpinë përkatëse. Pra, kafja tregon statusin e familjes por tregon edhe statusin e mysafirit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i dhënies së kafes është lidhja e drejtpërdrejtë e saj me dy vlera shumë të rëndësishme të kulturës shqiptare: mikpritja dhe besa. Siç e dëshmuam më lart, në mënyrë të shkurtër pasi shembujt dhe jeta që kafja bën në shoqëri nuk reduktohen dot në kufijtë e kësaj konference, dhënia e kafes merr valencë të madhe për të dëshmuar vlerësimin maksimal ndaj mikut. Megjithatë duhet të dëshmojmë një kuptim më të gjerë që ka ofrimi i kafes pasi dhënia e saj shpesh është një simbolikë. Kafja mund të jetë edhe një drekë, mund të jetë edhe sofër e mbushur me gatimet më të mira. *"Bukë e kryp me zemër të bardhë"*- thuhet ndër shqiptarët. Simbolikisht dhënia e saj dëshmon për

[4] -Malinowski, Bronislaw, "Krimi dhe doket në shoqërinë e egër", Ceneus, Prishtinë 2013, fq 52-56.

bujarinë dhe mikpritjen e veçantë që i bëhet mikut. Nga ana tjetër pirja e kafes me dikë është menjëherë një kapërcim cilësor në raportet që krijohen. Ai fiton besnikërinë e pakushtëzuar dhe merr bekimin e një miqësie që për asnjë arsye nuk e hedh poshtë. Në kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet: *"Per mik të mirë duhet **kafja**, rakçensurimia e buka e shtrueme me ndo'i send mâ teper"*, apo *"Per mik zemret duhet duhâni, **kafja e ambel**, rakija e bukë e mish"*.
Kur kafja pihet, miqësia prihet, dora shrihet e besa ngrihet!
Gëzimi dhe hidhërimi shoqërohen me kafe.

"Hajde ulemi për një kafe" thuhet kur palët duan të zgjidhin një mosmarreveshje. Kur tjetri nuk ka pranuar të ulet për kafe mesazhi është se ai nuk pranon të ketë një zgjidhje për konfliktin apo çështjen që diskutohet. *"A ja pijmë kafen kësaj pune?"* pyetet kur një çështje shkon drejt zgjidhjes.

Kur një pune *"i pihet kafja"* ajo ka formën e normës juridike, ligjit. Kafja pihet në raste gëzimesh si: në fejesa (piheshin dy kafe nëse dikush kishte shkuar për të kërkuar dorën e dikujt, një në fillim si mirësëardhje dhe një nëse kërkesa miratohej, duke u shoqëruar me fjalët "për hajër na qoftë, veje xhezven në zjarm"), martesa apo festa të ndryshme. Në rastin fejesës apo martesës në kafe lihen edhe sasia e lekëve që ai që ka shkuar për urim mendon të lejë si dhuratë. Ky lloj shkëmbimi i dhuratës, parave, me kafe është simbol i vlerësimit për personin dhe familjen që ka gëzimin. E njejta gjë ndodh në rastin e vdekjes apo në rast të fatkeqësive të ndryshme. Dëgjohen në zhargon: *"kafja e fundit"* e cila pihet kur dikush vdes, *"kafe për kryeshnosh"* kur dikush përkujtohet pas vdekjes në përvjetor. *"Kafja e ithët"*(pa sheqer ose me pak) dëshmon për dhimbjen që ka familja për të vdekurin. Kjo lloj kafe ofrohet përgjithësisht kur i vdekuri është në moshë të re. Për secilin rast pirja e kafes shoqërohet me urimet (në rastet e gëzimeve) apo me shprehjet ngushëlluese (në rastet e fatkeqësive). Dërgimi i një pakoje kafe si dhuratë simbolizon marrjen pjesë në mërzinë apo dhimbjen e tjetrit.

Për faljen e gjakut pihej kafja si përfundim i një gjakmarrje, në prani të gjithë njerëzve që janë përfshirë në këtë ndërmjetësim, ngrihet filxhani i kafesë dhe para se të pihet ai që fal gjakun shprehet: *"falë të qoftë gjaku"*. Pasi kjo të ndodhte nuk mund të diskutohet më rikthimi i gjakmarrjes për ato dy familje. Me atë kafe arrihet marrëveshja përfundimtare, vendoset paqja midis palëve, ndërtohet një raport i ri social mbi baza të respektit reciprok.

Në rast se ndodh që njëra palë thyen rregullin, marrëveshjen apo paqen e vendosur atëherë pala tjetër ka të drejtë të reagojë, duke përdorur edhe shprehjen: *"kësaj pune i është pi një herë kafja"*.

Pedagogjia që kafja realizon për mësimin e kulturës është e veçantë.

Rregullat e konsumit të saj janë busulla e ndërtimit të raporteve sociale. Duke qenë kështu, në kulturën kanunore dhe në mungesë të shtetit, *"pirja e kafes"* nuk ishte thjesht një akt por legjitimonte vendimarrjet e njerëzve.
Përthyerja që merr në ditët tona *kultura e kafes* në kushtet e një shteti të dobët duhet parë si reflektim i kohës së mungesës së shtetit. Kultura institucionale shtetërore në këto vite tranzicioni demokratik, që më së shumti është vazhdim i tranzicionit antikomunist, është zëvëndësuar me kulturën e kafes. Ndodh rëndom që informaliteti i kafes sendërton dhe paravendos vendimarrjen formale institucionale. Në kafene pregatiten marrëveshje që më pas kthehen në politika institucionale. Mund të kundërshtohet kjo duke thënë se ndoshta në kafe fitohet një lirshmëri dhe mund të nxirren ide të vlefshme. Mendoj se kjo kulturë thjesht bëhet shkak për korrupsionin e vazhdueshëm, duke i kthyer kafet nga vende të diskutimit intelektual, siç ishin në të shkuarën në vendet e zhvilluara, në vende të aplikimit të korrupsionit institucional.

Pas viteve '90 Shqipëria figuron e renditur si vendi i dytë në botë për numrin e lartë të bar-kafeve pas Spanjës e cila ka 587 kafene për 100 mijë banorë. Shqipëria rezulton ka 473 bar-kafe për 100 mijë banorë, ndërkohë që në pjesën më të madhe kanë më pak se 200 bar-kafe për 100 mijë banorë, sipas statistikave globale. Kjo statistikë mund të marrë interpretime të ndryshme por krahas ta tjerave që nuk duhen anashkaluar (papunësia, varfëria apo dhe mungesa e kulturës së punës) një faktor më rëndësi është edhe tradita e krijuar në shoqëri për konsumin e kafes.

Kafja e mëngjesit është një ritual që i zgjon njerëzit nga gjumi, është energjia pozitive që marrin për të përballuar ditën. Kjo kafe përgjithësisht për ata që janë në punë është një *"kafe e shpejtë"* që nuk e përmbush funksionin e plotë pasi nuk ju jep kohë në dispozicion për ta shijuar qetësisht atë. Një kafe quhet e plotë kur koha është e mjaftueshme për bisedë, kur merret me nge dhe kur secili që ndodhet në tavolinë mundet me e shprehë mendimin e vet.

Duhet theksuar se kafenetë janë kryesisht një fenomen urban, siç edhe sqaruam më lart ato janë hapur më së pari në qytetet kryesore. Megjithatë duhet thënë se tashmë edhe në fshatra kafenetë janë të zakonshme. Në kafenetë e sotme shpesh mund të behët opinion publik pasi idetë rrihen çlirët e pa pengesa. Diskutimet në kafene rrokin çdo fushë të jetës dhe pa asnjë kufizim mund të flitet për jetën private, politikën, artin dhe kulturën etj. Kafenetë sigurojnë *"intimet"* dhe një hapësirë që përmbush kriteret e komunikimin vetvetor dhe ndërpersonal. Mund të shijosh vetminë dhe të reflektosh me veten ashtu siç mund të konsumosh biseda e të ndash moment me njeriun e dashur, mund të ndash biseda me miq pa rregulla që kufizojnë tematikën. Kafenetë sot garantojnë

barazinë e njerëzve (përtej rasteve specifike) pasi në to mund të ulen pa asnjë paragjykim kushdo, pavarësisht statusit që ka dhe shërbehet njësoj. Ka edhe një grupim tjetër njerëzish që e përdorin kafen si një mënyrë për ta kaluar kohën në mungesë të angazhimeve të tjera.

Kafja është grishëse dhe një ftesë që nuk refuzohet lehtë ndër shqiptarët. Kjo reflektohet edhe në media dhe në programe të ndryshme televizive që e përdorin kafen në titujt e emisioneve të ndryshme. Kjo kulturë e përgjithshme e kafes është futur tashmë në të gjitha llojet e tregjeve dhe po shfrytëzohet ne funksion të rritjes së biznesit.

Përfundime

- Kultura e kafes fillon në shekullin e XIV-të dhe vjen si ndikim prej vendeve të lindjes.
- Në Evropë dhe SHBA kultura e kafes lidhet me shfrytëzimin e tyre për realizimin e diskutimeve letrare, politike dhe intelektuale.
- Në Shqipëri kjo kulturë vjen prej ndikimit të perëndorisë otomane.
- Shqiptarët e kanë bërë kafen pjesë të ritualeve të rendësishme jetësore dhe e kanë përdorur atë si një insitut të veçantë.
- Kafja luan një rol të rëndësishëm dhe implikon një komunikim kompleks me kode dhe mesazhe që dëshmojnë qëndrime të ndryshme njerëzore.
- Sot kafenetë në Shqipëri kanë një përhapje të lartë dhe janë vende ku kunsumohet më së shumti diskutim dhe komunikim.

Referencat:

- **Libra**

Arsim Canolli, “Premisa Antropologjike”.
Bronislaw Malinowski, “Krimi dhe doket në shoqërinë e egër”.
Ernest Koliqi, “Hija e maleve”.
Kanuni i Lekë Dukagjinit.
Mark Tirta, “Etnologjia e shqiptarëve”
Nebi Bardhoshi, “Gurt e kufinit”.

- **Artikuj dhe adresa**

http://radio-7.net/roli-i-heshtur-social-i-kafes/
http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2537
http://www.javanews.al/historia-e-kafes-si-u-shpernda-nga-shqiptaret-ne-evrope/

Dr. Besim MORINA

KISHA KATOLIKE NË TIVAR GJATË SHEKULLIT XIII-XV DHE ROLI I SAJ NË RUAJTJEN E LIDHJE-VE ME SELINË E SHËNJTË

Në shekullin XIII, Zeta ndodhej nen pushtimin Rasian, duke i hapur rrugën tendencës bizantine për shtrirjen e kishës së lindjes. Dokumentet e kohës na dëshmojnë se Zeta ishte pushtuar. Kisha e Rashës, duke pasur përkrahjen e sundimtarëve, synonte që ortodoksizmi, të imponohej dhe ta zëvendësojë kishën ortodokse të Konstantinopojës. Kështu, Arqipeshkvia e Tivarit dhe në përgjithësi Kisha Katolike në Diokle- Zete, do të humbë jo vetëm privilegjet në territorin e Zetës, por edhe statusin e fesë shtetërore, e cila ishte veçanërisht e rëndësishme në mesjetë.

Si kundërpërgjigjeje, Tivari merr rolin e ruajtjes së katolicizmit, përballë ortodoksizmit. Me perkrahjën e Vatikanit, arqipeshkvia e Tivarit mori titullin "archiepiscopus Sclavinensis", në vitin 1256.

Kisha e krishterë, në shekujt XIV dhe XV në Zetë, zhvillohet në kushte tejet specifike dhe të rënda. Vendet te cilat ishin nën vartësinë e Argjipeshkvisë së Tivarit, para pushtimit osman ishin thjeshtë te krishtera, u mbajtën gjithmonë besnike dhe te lidhura me Kishën e Romës. Pushtimi osman, paraqet fundin e shumë kishave katolike në territorin e Zetës, aty ku katolicizmi kishte një vazh-dimësi qe nga periudha paleokristiane.

The Catholic Church in Tivar during the 13th-15th century and its role in preserving tieswith the Holy See

In the thirteenth century, Zeta was under the Rasian occupation, paving the way for Byzantine tendency for the extension of the east church. Time records prove to us that Zeta was conquered. Rasha's Church, having the support of the rulers, sought to impose Orthodoxy, and to replace the Orthodox Church of Constantinople. Thus, the Archbishopric of Tivar, and in general the Catholic Church in Diocletics, will lose not only the privileges in Zeta's territory, but also the state religion status, which was particularly important in the Middle Ages.

In response, Tivari takes on the role of preserving Catholicism in the face of Orthodoxy. With the support of the Vatican, the Archbishopric of Tivari received the title "archiepiscopus Sclavinensis" in 1256.

The Christian Church develops under very specific and severe conditions in Zeta in the 14th and 15th centuries. The places under the dependency of Tivar's Archbishopric, which were merely Christian before the Ottoman conquest, were always held faithful and connected to the Church of Rome. The Ottoman invasion represents the end of many Catholic churches in the territory of Zeta, where Catholicism had a continuity since the Paleochristian period.

Kisha katolike në Tivar gjatë shekullit XIII-XV dhe roli i saj në ruajtjen e lidhjeve me Selinë e Shenjtë

Në shekullin XIII, Zeta ndodhej nen pushtimin Rasian, duke i hapur rrugën tendencës bizantine[1] për shtrirjen e kishës së lindjes. Se ne te vërtetë Zeta ishte pushtuar na dëshmojnë edhe dokumentet e kohës.[2] Ne te njëjtën situatë u gjind edhe qyteti i Tivarit, i cili në vitin 1183 u pushtua dhe shkatërrua nga sundimtari i Rashës, Stefan Nemanja (1168 – 1196).[3]

Gjatë kohës se sundimit të Vukanit, kisha katolike ne Zetë aktivitetin e vet e zhvilloi pa pengesa. Megjithatë, edhe pse nuk mundi të evitonte konfliktet dhe problemet e organizimit kishtar dhe të disiplinës, Vukani bëri qe kjo kishë te mos rrezikohej si nga pushteti civil ashtu edhe nga kishat e tjera. Vukani, mbante korrespondenca me Papën e Romës dhe Mbretërinë Hungareze.[4] Mirëpo, kjo gjendje filloi te ndryshoi ne shekullin XIII. Politika e kishës rasiane, synonte që ortodoksizmi, sidomos pas vitit 1219, të imponohej dhe ta zëvendësojë kishën ortodokse të Konstantinopojës. Kështu, me themelimin e Kishës Ortodokse Rasiane në vitin 1219, Arqipeshkvia e Tivarit dhe në përgjithësi Kisha Katolike në Diokle- Zete, do të humbë jo vetëm privilegjet në territorin e Zetës, por edhe statusin e fesë shtetërore, e cila ishte veçanërisht e rëndësishme në mesjetë. Kisha Katolike, në fazën e pushtimit të Zetës, doli se ishte kundër synimeve shtetërore të nemanjidëve,[5] dhe kjo duhej te ishte edhe një arsye me tepër për ta luftuar.

---

1 Sh. Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, f. 50-51.

2 *Живот Стевана Немање од Свети Сава*, Старе српске биографије, Београд, 1924, f. 3-4.

3 L. Čoralić, *Barani u Mlecima-Povijest jedne hrvatske iseljeničke zajednice*, Zagreb, 2006, f. 27- 28.

4 *Историја Црне Горе,* књига друга, од почетка XII до краја XV вијека*,* Титоград, 1970, f. 23.

5 В.Ћоровић, *Историја Југославије*, Београд, 1933, f. 148.

Themelimi i peshkopatës ortodokse në Zetë, nga Shën Sava, qe kishte qendrën në grykën e Kotorrit, pra në territoret që më parë kishin qenë nën autoritetin vetëm të kishës Dioklesë në krye me Arqipeshkvinë e Tivarit, do ta dëmtojë rëndë ekzistencën e Kishës Katolike në këtë mbretëri,[6] duke pasur parasysh faktin se zgjerimi i kishës ortodokse bëhej duke tkurrur kishën katolike, tkurrje kjo e cila kishte mbështetjen e plotë te shtet.

Si kundërpërgjigjeje, kisha katolike u deshtë te ndermarrë masat për ruajtjën e grigjës dhe rendit te sajë. Tani, me ndihmën e rregulltarëve te dy urdhërave, të Françeskanëve dhe të Domenikanëve, kisha fillojë të pastrohej nga herezitë e shumta të asaj kohe. Veprimtarinë e tyre, këta rregulltarë e shtrinë në Dalmaci, Bosnje, Malin e Zi të sotem, Rashë dhe në Shqipërinë e sotme Veriore.[7] Kjo, është pra koha kur Tivari merr rolin e ruajtjes së katolicizmit, përballë ortodoksizmit. Nga një letër e Papa Gregorit IX, që i kishte dërguar më 1236 udhëheqësit të Domenikanëve të provincës romane, ku thuhej; Do të dërgonte fretër të Urdhërit të vet, inkvestora, në kryedioçezën e Tivarit, merret vesh se aty gjendeshin edhe disa rregulltarë që tash vonë kanë kaluar në atë krahinë.[8]

Koha tregoi se emërimi, i diplomatit të madh, misionarit, dhe një nga njerëzit me të besuar të zyrës së Papës, Gjonit (1182-1252), për arqipeshkëv të Tivarit[9] ishte një vendim shumë i qëlluar dhe me se i nevojshëm për kohën. Gjoni, ishte emëruar nga Papa Inocenti IV, në vitin 1248,[10] me një përvojë të gjatë dhe te suksesshme nëpër botë, sidomos kundër mongolëve.[11]

Me pranimin e detyrës, Gjoni i mori masat për te penguar rrymat e ortodoksizmit si rasiane ashtu dhe bizantine, me synimet që të shpëtonte fenë katolike nga rreziku që po i kërcënohej. Për te arritur këtë, i nevojitët një punë e jashtëzakonshme, por falë angazhimit, arriti qe më sukses të zgjidhë përfundimisht kontekstin me Raguzën. Një vit pasi ishte ulur në fronin e argjipeshkvit të Tivarit, më 1249 vendos ta konvokoj Kuvendin kishtar krahinor, në te cilin, do të debatohen të gjitha çështjet qe janë ne te mirën e zhvillimit te më tejmë të mitropolisë Duklano-Tivarase.[12] Lidhur me zgjidhjen e problemeve me Raguzën, Gjoni me sukses mbrojti te drejtat e Kishës se tij në fillim të vitit

[6] M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*: *(njihova simbioza u srednjem veku)*, Beograd, 1925, f. 91.

[7] M. Sirdani, *Të venduemët e Françeskanve*, në: Hylli i Dritës, Nr.1-2, Shkodër, 1940, f. 68.

[8] Ivan Marković, *Dukljanska-Barska metropolia*, Zagreb, 1902, f. 98.

[9] *Monumenta Montenegrina*, *VII*, Podgorica, 2001, f. 30.

[10] M. Sirdani, *Të Venduentë e Françskanve*, f. 69.

[11] С. Станојевић, *Борба за самосталност католичке цркве у немањићској држави*, (V. 13, СКА), Београд, 1912, f. 155.

[12] I. Marković, *Dukljansko-barska metropolija*, Zagreb, 1902, f. 99.

1252 në procesin e Perugjias. Me pas Gjoni ishte kapur nga autoritetet e Raguzës, të cilët edhe e burgosën, për lirin e te cilit është dashur te paguhej. Menjëherë pas lirimit, vazhdoi përpjekjet për të mbrojtur të drejtat e arqipeshkvisë së vet, duke vërtetuar se "prej kohësh së vjetër në tërë Dalmacinë ekzistonin vetëm dy arqipeshkvi, Solini (Solona) dhe Dioklea; në vend të Solonës ishte Spliti dhe në vend të Dioklesë ishte Tivari, kështu që ipeshkvi i Raguzës të qëndronte nën arqipeshkvin e Splitit".[13] Fundi i pretendimeve raguziane mbi kishat sufragane te Tivarit është vulosur ne takimin e Napolit më 1255,[14] tani edhe formalisht Raguza duhej te tërhiqej nga kjo pjesë.[15] Sikur, shihet se përkundër presionit ne te cilin ndodhej kisha katolike ne Zetë, krerëve te kishës ju deshtë te merreshin për një kohë te gjatë edhe me përpjekjen për tu shkëputur nga Raguza, përpjekje kjo e cila dha rezultatin përfundimtar ne favor të Tivarit më 3 shkurt të vitit 1255 në procesin e Napolit.[16] Mjerisht, luftërat e kishës së Raguzës e të Tivarit rreth epërsisë ishin të pranishme gjatë tërë mesjetës, edhe më vonë.

Ngjashëm me kuvendin që ishte mbajtur më herët, gjysmë shekulli më parë, Tivari ruajti një numër të madh të kompetencave kishtare (dispozitat nuk janë ruajtur), vetëm në formë fragmentare. Për t'i dhënë një rëndësi më të madhe Sinodit, me nismën e argjipeshkvit, Gjonit, Kuria Romake ratifikon dispozitat e sinodit rajonal të Tivarit, duke hedhur anatemën mbi të gjithë ata njerëz të kishës dhe të shenjtërisë të cilët nuk deshën t'u bindeshin vendimeve të Kuvendit.[17]

Me përkrahjen e Selisë se Shenjtë si dhe punës se pamohueshme të Gjonit, arqipeshkvia e Tivarit mori titullin "archiepiscopus Sclavinensis", në vitin 1256,[18] pastaj kishte sufraganët vartës: Ulqinin, Budven, Shasin, Shkodrën, Drishtin, Pultin e Madh, Pultin e Vogël, Sapën, Danjën, Lezhën dhe Arbërinë e Prizrenin.[19]

Kur flitet për disiplinën dhe kompetencat e klerikëve,[20] si dhe emërtimet nga ana e Selisë së Shenjtë, mund te kuptojmë edhe për rolin pozitivë që kishin luajtur Françeskanët, në përballjen me vështirësitë e krijuara për ruajtjen e katoli-

[13] M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, f. 90.

[14] A. Theiner, *Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia,* (Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis), tomus primus, 1198-1549, Romae 1863, f. 104.

[15] M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, f. 90.

[16] D. Farlato, *Illyricum Sacrum* VII, Spalato,1910, f. 43.

[17] I. Marković, *Dukljansko-barska metropolija*, f. 100.

[18] *Illyricum Sacrum* VII, f. 85.

[19] Z. Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren-Zagreb, 1998, f. 166.

[20] *Acta et diplomata Albania mediae aetatis illustrantia*, college Tholloczy, L.- Jiriček, C. –Sufflay, E., vol.I, Tiranë-Prishtinë, 2002, 163.

cizmit në këtë trevë.[21]

Në një letër të Papa Inoçentit IV, i cili më 12 prill të vitit 1253 u shkruante sufraganëve të kishës së Tivarit dhe me këtë rast u urdhëronte që të pranojnë me respekt të obligueshëm Gufridin nga rendi i vëllezërve të vegjël, të cilin ua kishte caktuar si argjipeshkëv Selia e Shenjtë, dhe se ndaj tij me plotë dëshirë të jenë të dëgjueshëm. Ne të vërtetë në këtë letër nuk përmenden emrat se cilët ishin këta sufraganë të argjipeshkvisë së Tivarit në atë kohë.[22] Kjo letër tregon edhe interesimin e vazhdueshëm nga ana e papatit për këto treva.

Presioni fetar në Diokle ishte zbutur rreth tri dekada (1280-1307), kjo gjendje ishte e lidhur me mbretëreshën Helenë, gruan e mbretit rasian Uroshi I.[23] Në viset ku përmendet si sundimtare, konkretisht në Diokle, Rashë dhe Arbëri, ne dokumente te kohës nuk flitet për dëme dhe shkatërrime, sikur kishin vepruar sundimtarët e më hershëm rasian. Në vitin 1283 mbretëresha Helena e ka siguruar furnizimin me bukë te qytetit të Tivarit nga kushëriri i saj në Italinë jugore.[24]

Sipas dokumenteve, ne vitin 1284 kemi një mosmarrëveshje ne mes të Tivarit dhe Kotorrit ne lidhje me juridiksionin kishtar mbi kishat katolike në Kosovën e sotme.[25] Gjatë, kësaj periudhe ishte normale qe kishat te shprehnin aspiratat e tyre ne lidhje me shtrirjen sa me të gjerë, duke shtrirë ndikimin si dhe duke u munduar për te mbledhur te ardhurat qe i takonin kishës. Por, kjo luftë ne mes te kishave për dominim, mbarte me vete pasojat tek besimtarët.

Në vitin 1288 Helena, kishte ngritur në periferi te Tivarit një abaci (kuvend) për fretërit françeskan, kushtuar Shën Françeskut, duke i dhuruar atij të gjitha gjërat e nevojshme.[26] Gjithashtu, Kisha e Shën Merisë te kepi i Ratacit, në rrethin e Tivarit,[27] qe përmendet ne letrat e papëve: Klementi V (1305-1314),[28] Klementi VI (1342-1352),[29] Inocenti VI (1352-1362),[30] Urbani V (1378-1389),[31]

---

[21] M. Sirdani, *Vepra atdhetare e Françeskanve në Shqipëri*, në: Hylli i Dritës, Shkodër, dhjetor, 1940, XIX, Vjeti XVI, nr. 1-2, f. 557.

[22] G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj, 1986, f. 116.

[23] Arhiepiskop Danilo, *Život kraljeva i arhiepiskopa srpskih*, Beograd, 1935, f. 45-58.

[24] Gj. Dabaj, *Shestani II*, Ulqin 2004, f.183.

[25] *Acta Albaniae* I, 489- 490.

[26] *Illyricum Sacrum* VII, 57-59.

[27] *Acta Albaniae,* I, 510.

[28] *Illyricum Sacrum* VII, 59.

[29] *Acta Albaniae* II, 22.

[30] *Acta Albaniae* II, 101.

[31] *Acta Albaniae* II, 228.

Bonifaci XI (1389-1404),[32] që ka qenë një vendshtegtim i rëndësishëm për besimtarët katolikë, gëzonte një simpati tek mbretëresha Helena (1288) si dhe i biri i saj Uroshi II (1303),[33] ku edhe i kishin dhuruar disa fshatra në territorin e Spicës.[34]

Personalitetin e mbretëreshës, papët e Romës e vlerësonin.[35] Në një letër të papa Nikollës IV, të 20 marsit 1291, papa kishte angazhuar atë që ta ftonte edhe mbretin e Bullgarisë "Georgius imperator Bulgarorum" në kishën katolike.[36] Gjatë gjithë jetës se sajë, Helena udhëhoqi me një maturi te rrallë, duke vlerësuar mjaftë mirë rrethanat politike qe ndërlidheshin me ndikimin e madh fetar.

Fillimi i ndryshimit te orientimit fetar, në Zetë mund te themi se është gjysma e parë e shek. XIII. Por, duhet shtuar se ndryshimi i strukturës fetare nga katolike në ortodoksë në rajonet bregdetare të shtetit të Zetës nuk ishte i menjëhershëm, por i ngadaltë,[37] dhe lirishtë mund te themi se e njëjta gjendje ishte edhe ne viset në brendësi të Zetës.

Në postin e arqipeshkvit të Tivarit më 1301, u zgjodh Marin Zare (1291-1307),[38] të cilit në vitin 1303, papa Benedikti i XI, ia dha te drejtën qe ti emërojë dhe ti ndërroi udhëheqësit e kishave të cilët gjendeshin nën mbretërinë e Rashës.[39] Po këtë ditë Benedikti XI, i dërgon edhe letrën e dytë, argjipeshkvit Martinit "Ad audientiam nostram", në të cilën i urdhëron qe ti përmirësojë dhe ti përtërijë personat dhe rregulltarët kishtarë të cilët, duke u larguar nga çdo disiplinë, binin nën ndikime te ndryshme të këqija të jetës se pahijshme. Territori të cilin Papa ia besoi argjipeshkvit të Tivarit, përfshinte: Pultin, Kanavin, Durrësin, Kotorrin, Ulqinin, Shasin, Shkodrën, Drishtin dhe Tivarin.[40]

Një pasqyrë të gjendjes se kishës dhe besimtarëve katolik, në mënyrë shumë koncize e përshkruan që në fillim të shek. XIV një udhëtar, në një Përshkrim të Evropës Lindore më 1308, hartuar nga një autorë anonim dhe i publikuar në vitin 1916 nga studiuesi polak Oligierd Górka. Ky autorë përveç

[32] *Acta Albaniae* II, 458.

[33] *Acta Albaniae,* I, 547.

[34] M. Šufflay, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, në: Illyrisch – Al banische Forschungen, I. Band, München und Leipcig, 1916, f. 276.

[35] K. Jireček, *Geschichte der Serben,* I Band, Gotha, 1911, f. 325-328.

[36] A. Theiner, *Vetera monumenta Historica Hungariam sacram illustrantia,* Romae, 1859 I, 606, 607.

[37] М. Ивановић, *О хришћанској цркви у Црној Гори*: од IV- XX вијека, Подгорица, 2001, f. 118.

[38] М. Пурковић, *Авињонске папе и српске земље*, Пожаревац, 1934, f. 18.

[39] G. Gjini, v. c., f. 93.

[40] *Acta Albaniae*, I, 163.

tjerash shkruan se: "skizmatikët (banorët ortodoks) në këtë mbretëri dhe vetë mbreti janë skizmatikë të pafe dhe prandaj këta i ndjekin së tepërmi katolikët e përmendur dhe jashtëzakonisht shumë i shkatërrojnë dhe i plaçkitin kishat e tyre, i sulmojnë prelatët, i marrin robër dhe bëjnë shumë vepra të tjera të liga...". Në mënyrë të veçantë për Stefan Uroshin II Millutinin, shkruan: "Ky i ndjek dhe i urrente për së tepërmi katolikët, mirëpo për shkak të frikës nga sundimtari Karl, ky po përpiqet të japë ndonjë farë shenje të nënshtrimit të krishterë përpara Kishës së Romës..." dhe më tej vazhdon: "Mirëpo, në të vërtetë e gjithë kjo është vetëm një rrenë sepse ky nuk do të përmbushë asgjë nga premtimet e tij, përpos në qoftë se dikush ia shtie këtij ndonjë frikë të madhe".[41]

Ne vitin 1307, mbreti Millutin i ishte drejtuar Papa Klementit V, se ai vetë dhe populli i mbretërisë së tij do ta pranonin ritin katolik.[42] Si përgjigjeje ndaj kërkesës se Milutinit, njoftohemi nga letra e Papës i cili i kishte kërkuar nder te tjera: "Se kishat katolike që janë në mbretërinë tënde e të cilat janë zaptuar prej teje, do të ishte mirë t'i lirosh dhe ti do të duhej të veproje që ato të jenë plotësisht të lira..."[43] Me ndryshimin e rrethanave politike, Milutini filloi haptas t'i njekë katolikët në vendin e pushtuar prej tij, në Rashë e ndaloi ritin latin, por jo edhe ne Zetë.[44]

Në Zetë edhe me tutje do të vazhdoi gjendje e rënduar për kishën katolike, sidomos në kohën e Stefan Dushanit (1331-1355). Ku masat e ndërmarra nga ana e Dushanit i kalonin ato të paraardhësve të tij. Si rezultat i këtyre masave brutale në jetën fetare dhe politike, kemi edhe revoltë të fisnikërisë dhe klerit. Kjo kryengritje qe u udhëhoq nga fisniku Dhimiter Suma,[45] shërbeu edhe si shkak për ringjalljen e Planeve të Perëndimit për një kryqëzatë anti-rasiane.[46] Arqipeshkvi i Tivarit, Adae në atë kohë ishte në Avinjon,[47] kështu që ata nuk mund të kenë qenë inkurajuar direkt prej tij.

Në vitin 1347, Papa Klementi VI e merr një relacion nga ipeshkvi i Shkodrës, Marku (ish dekan i Tivarit) ku nderë te tjera njoftohet: "car Dushani, i frymëzuar nga Fryma e Shenjtë,[48] dëshironte të pranonte fenë katolike. Por ne

[41] Gj. Berisha, *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shekujve XI-XV,* Prishtinë, 2015, f. 250.

[42] *Acta Albaniae* I, 174.

[43] A. Theiner, *Monumenta Slavorum* I, 127-130.

[44] I. Marković, *Dukljansko-barska metropolija*, f. 111.

[45] K. Jireček, *Geschichte der Serben* I, f. 371.

[46] И. Божић, *Албанија и Арбанаси у XIII, XIV и XV веку*, ГС, CCCXXXVII, Београд, 1983, f. 37.

[47] M. Šufflay, "*Kirchenzustände*", f. 214.

[48] K. Jirecek, *Geschichte der Serben* I, f. 407.

të vërtetë, faktori kryesor i cili e shtyu Dushanin për këtë veprim, ishte rreziku osman.[49] Papa e përkrahu këtë synim të Dushanit.[50]

Pas një viti (1350) të shpalljes së kodit të Dushanit, Legati i papës kërkonte nga princërit katolikë, që të tregojë për aq sa është e mundur, kujdesin dhe t'i mbrojnë të krishterët nga Dushani.[51]

Me vonë, Dushani i dërgoi një letër në vitit 1354 papa Inoçent VI, në të cilën deklaronte se është i gatshëm ta pranojë papën si kryeepror të krishterimit.[52] Më 29 gusht 1354, papa i kishte kthyer përgjigje letrës se Dushanit, që është për tu theksuar se nuk ishte përfillur fare titulli i perandorit, ashtu siç e kishte shpallur vetën Dushani, dhe marrësi i letrës është quajtur vetëm si "rex Rassie".[53]

Një rol te rëndësishëm ne ruajtjen dhe forcimin e katolicizmit, ruajtjen e lidhjeve me Selinë e Shenjtë, ne këto treva ka luajtur edhe themelimi i shkollave e studimeve nga misionarët e urdhrit dominikan, kryesisht rreth bregdetit Adriatik.[54] Një shkollë te tillë ne qytetin e Tivarit e gjejmë nga gjysma e dytë e shekullit XIV. Ne këto shkolla mësimet mund ti vijonin si klerikët ashtu edhe laikët.[55]

Arqipeshkvi i Tivarit, Guillelmus Adea-Brocardus (1324-1341), ne vitin 1332 në veprën e tij në gjuhën latine: *Directorium ad passagium facenda as terram sanctam*, thekson praninë e dy popujve siç janë arbrit dhe latinët, që i përkasin kishës romake, shkruan se latinët kanë gjashtë qytete me peshkopët e tyre: së pari arqipeshkvi i Tivarit; pastaj ata të Kotorrit, Ulqinit, Shasit, Shkodrës dhe Drishtit, te banuar vetëm nga latinët.[56] Po ne këtë vepër ky autor na ka sjellë edhe një të dhënë shumë te rëndësishme, ku kemi njoftimin e parë për përdorimin e gjuhës shqipe në vitin 1332.[57]

Sipas medievalistit të mirënjohur kroat, Milan Šufflay, ne bregdetin Adriatik, konkretisht në atë dalmatin deri ne shekullin XIII nuk ka mundur te dëgjohet emri serb. Rrethanat politike te cilat u krijuan sollën ndryshime ne

[49] I. Marković, *Slaveni i pape*, II, Zagreb, 1904, f. 344-345.

[50] *Acta Albaniae*, II, 29.

[51] М. Пурковић, *Авињонске папе и српске земље*, f. 51.

[52] P.Xhufi, "*Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe*", në: E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990, f. 107.

[53] Gj. Berisha, *Arbërorët ndermjet kishës* ..., f. 259.

[54] S. Krasiç, *Filozofija i filozofijska učilišta hrvatskih dominikanaca od XIII do XIX*, f. 46. (hrcak.srce.hr/file /121711)

[55] J. Drançolli, *Universiteti i Durrësit* (shek. XIV), në: BFF, Prishtinë, nr. XXIII/1993, f. 100-101.

[56] R. Ushaku, *Ulqini: në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin, 2010, f. 22.

[57] Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 27.

këto zona. Pas depërtimit te kishës ortodokse ne Zetën katolike, kisha ortodokse e shtynë kishën katolike, duke depërtuar edhe ne bregdetin dalmatin dhe kjo ndodh në shekullin XIV. Duhet cekur se deri në këtë kohë katolicizmi ishte fe absolute në zonën e Dalmacisë.[58] Ndërsa ne fillim te shekullit XV, në Zetë feja ortodokse është fe shtetërore krahas fesë katolike.[59]

Zgjerimi i principatës se Balshajve,[60] në shekullin XIV përfshiu edhe qytetin e Tivarit.[61] Balshajt, misionet delikate diplomatike brenda dhe jashtë vendit, u kishin besuar udhëheqësve kishtar të Tivarit, Shkodrës dhe Drishtit.[62] Ne aspektin kishtar pjesa me e madhe e territoreve qe ishin nën zotëronin e tyre, ishin te lidhura me kishën katolike, dhe kjo periudhë është një periudhë e rikthimit te shpresës për kishën katolike.

Balshajt, më 29 janar të vitit 1369, në Shkodër, pranuan fenë katolike,[63] duke e vënë secili prej tyre vulën ne procesverbal.[64] Gjergji II Balsha, në një letër që e kishte marrë nga Papa Bonifaci IX, shihet se pasi që kishte marrë bekimin nga ai, ishte këshilluar që ta ngritë flamurin e kishës romake në luftë kundër paganëve dhe armiqve tjerë të fesë së krishterë, si dhe kundër atyre feudalëve që janë në kolaboracion me osmanët.[65] Duhet shtuar se Balshajt edhe pas konvertimit ne katolikë vazhduan te kenë marrëdhënie te mira me kishën ortodokse. Ne fakt, tradita e respektimit te ndërsjellët te kishave në Zetë nuk ishte diçka e re.

Edhe gjatë shekullit XV Argjipeshkvia e Tivarit, vazhdoi te mbante titullin "Primas Serbie" dhe Metropolisë me sufraganët: Ulqini, Budva, Shasi, Shkodra, Drishti, Pulti i madh dhe Pulti i Vogël, Prizreni, Svaçi, Sappa, Danja, Balesiumi dhe Lezha.[66] Selia e Shenjtë i kishte shtuar këtë titull arqipeshkvit të Tivarit në shek. XV, në mënyrë që të krijojë një rezistencë të organizuar kundër islamizmit në territorin e Ballkanit të sotëm.

Për dallim nga paraardhësit e tij, Gjergji II Balsha dhe pasardhësi i tij Balsha III, i kishin ngushtuar gjithashtu të drejtat e kishës katolike, në favor të asaj ortodokse. Në këtë rast Balsha III, i ndikuar edhe nga nëna e tij, ai i

---

58 M. Šufflay, *Hrvatski aristokrat duha*, Zagreb, 1998, f. 189.

59 S. Resulbegu, *Nga Ulciniumi deri në Ulqini*, Ulqin, 1998, f. 61.

60 S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 21-22.

61 A. Buda, *Studime historike*, Prishtinë, 2006, f. 133.

62 *Historia e popullit shqiptar* I, Tiranë, 2002, f. 337.

63 A. Theiner, *Monumenta Slavorum* I, 362.

64 G. Gjini, v. c., f. 98.

65 I. Božić, *Nemirno Pomorje u XV veku*, Beograd, 1979, f. 200.

66 M. Šufflay, *Illyrisch-albanische Forschungen* I, f. 218.

përkrahte ortodoksinë dhe u binte në qafë arqipeshkvit të Tivarit.[67] Duhet shtuar se ne rrethanat e krijuara politike, në periudhën e fundit te sundimit të dinastisë Balsha, përkatësisht në kohën e Balshës III, kjo familje ishte rikthyer përsëri ne ritin ortodoks.[68]

Pas vdekjes së Gjergjit të II Strazimir Balshës, venedikasit pushtuan Tivarin.[69] Sa i përket gjendjes se kishës katolike nën sundimin venedikas, është e kuptueshme se politika veneciane në përballje me elementin ortodoks ishte mjaft e dobët. Republika e Venedikut, duke qenë një republike tregtare, qëllimi i saj ishte që të arrijë barazinë në qeverisje dhe respekt për bindjet e tyre, sa për të mos krijuar armiq. Por, nuk duhet harruar se ndërhyrjet e venedikaseve tek papa për te caktuar njerëzit e tyre ne krye te institucione kishtare katolike nuk ishin te rralla.

Gjatë shekujve XIV dhe XV, qëndrimi i Romës ne lidhje me marrjen e Zetës nga venedikasit, të paktën deri në rënien e Balshajve, nuk ishte shumë i qartë, megjithatë kleri katolik në Zetë dhe Arbëri pati ndikim në ngritjen e sundimit venedikas,[70] sidomos në kohën e paraqitjes se rrezikut nga pushtimi osman.[71]

Ne fund duhet theksuar se për kah pikëpamja fetare, e cila ishte një ndër faktorët më të fortë të jetës publike në periudhën mesjetare, vendet te cilat ishin nën vartësinë e Argjipeshkvisë së Tivarit, para pushtimit osman ishin thjeshtë te krishtera, u mbajtën gjithmonë besnik dhe te lidhur me Kishën e Romës.[72] Pushtimi osman, paraqet fundin e shumë kishave katolike në territorin e Zetës, aty ku katolicizmi kishte një vazhdimësi qe nga periudha paleokristiane.[73]

---

[67] G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum III*, Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1180.

[68] G. Gelchich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi*; studi storici documentati, Spalato: Tip. Sociale Spalatina G. Laghi, 1899, f. 260.

[69] L. Čoralić, *Iz prošlosti istočnoga Jadrana – tragom iseljenika iz grada Ulcinja u Mlecima*, Hrvatski institut za povijest, Opatička 10, Zagreb, 2004, f. 2, (www. hrcak.srce.hr/file/44091).

[70] M. Šufflay, "*Kirchenzustände*", f. 280.

[71] *Acta Albaniae Veneta* II, 530.

[72] P. F. Cordignano, S. L, *Breve Memoria de li discerdenti de nostra casa Musachi*, në: Revista Leka, nr.3 Shkodër, 1930, f.76.

[73] N. Ukgjini, *Vështrim i shkurtër historic mbi zhvillimin e katolicizmit në Ulqin gjatë shekujve*, në: Simpoziumi shkencor Ulqini ne rrjedhat e kohës, (26-27 maj 2000), Ulqin, 2000, f. 78.

Olda CICO

EKONOMIA GLOBALE DHE TREGJET FINANCIARE NË 2016.

Hyrje

Ky punim është një përpjekje për të kuptuar dhe diskutuar për faktorët që ndikojnë zhvillimin dhe rritjen e industrisë së sigurimeve. Është vërejtur se industria e sigurimeve në Shqipëri ka pasur një rritje të vogël për shkak të faktorëve të ndryshëm. Penetrimi dhe densiteti i sigurimit të përgjithshëm në Shqipëri është shumë i ulët krahasuar me vendet e tjera në zhvillim. Kjo tezë vlerëson ndikimin e faktorëve ekonomik dhe demografik në primet e kompanive të sigurimit. Një regresion me një panel dinamik të dhënash aplikohet për studimin e zhvillimit të sektorit të sigurimeve në vendin tonë për periudhën 2006-2016. Rezultatet nxjerrin në pah se faktorët ekonomik dhe demografik ndikojnë në sektorin e sigurimeve. Rritja ekonomike, normat e interesit dhe urbanizimi ndikojnë zhvillimin dhe rritjen e PRIM-it.

Gjithashu, studimi lë hapësira për kontribute të tjera në literaturën akademike duke përfshirë një panel më të zgjeruar të dhënash dhe variablash që shjegojnë rritjen e sektorit të sigurimeve.

Abstract

This paper is an attempt to understand and discuss about the factors affecting the development and growth of insurance industries. It is observed that the insurance industry has got a slow growth in Albania due to different factors. Albanian'n general insurance penetration and density is very low as compared to other developing countries. This thesis estimates the impactof economic and demographic factors in gross written premiums of insurers. A regression with a dinamic panel data is applied for studying the development of insurance sector in our country during period 2006-2016. The results highlight that economic and demographic factors effect insurance sector. Economic growth, interest rate and urbanisation effect the development and the growth of PRIM.

Moreover, this study leaves space for other contributions in academic literature including a broader panel data and variables that explain the growth of

insurance sector.

Ekonomia globale u rrit në mënyrë të moderuar në 2016 me një GDP deri në 2.5%.1 Normat e interesit mbetën të ulëta në Europë dhe Japoni, ndërsa në SHBA vazhdoi shtrengimi gradual monetar në fund të vitit. Primet e shkruara të sigurimeve në total rezultuan me 3.1% në terma real në 2016, një rritje kjo më e vogel se rritja prej 4.3% në 2015.2 Ngadalsimi u shkaktua nga rritja mjaft e vogel tek tregjet e zhvilluara. Rritja e fuqishme e primit në Kinë i ndihmoi tregjet në zhvillim të cilat edhe ato ishin në proçes ngadalsimi. Në zonën Euro, rritja ekonomike pati tendencë rënie në 1.7% në 2016 nga 1.9% në 2015, pavarësisht mbështetjes nga normat e ulëta të interesit, çmimi i ulët i naftës dhe një euro relativisht të dobët. Normat e ulëta të interesit vazhduan ta sfidonin sektorin e sigurimeve në 2016, veçanërisht në Europë dhe Japoni. Pasiguria politike, uljet e vazhdueshme të parashikimeve të rritjes ekonomike dhe rritja e inflacionit shoqëruan tregjet financiare në 2016.

Gjatë 20 viteve të fundit ka pasur ndryshime dramatike në shërbimet financiare të ofruara nga sektori i sigurimeve. Sigurimi përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiarë dhe gjithashtu të ekonomisë në tërësi. Kompanitë e sigurimeve kanë rritur llojet e shërbimeve që ofrojnë duke u bërë tërheqës dhe të besueshëm për klientët. Plakja e popullsisë gjithashtu kontribuon në këtë trend. Ndryshimi financiar mes njerëzve që punojnë dhe popullsisë në pension do duhet të manaxhohet nga shoqëria në të ardhmen.

Rritja globale e primit ra në 3.1% në 2016, kryesisht si pasojë e rritjes së dobët në tregjet e zhvilluara. Primi i sigurimit të jetës në botë u rrit me 2.5% në 2016, e nxitur nga rritja e shpejtë në tregjet në zhvillim. Ndërsa në tregjet e zhvilluara rritja e primit të sigurimit të jetës ishte e miksuar. Në kushtet e e përballjes me rrijte të moderuar të primit dhe normave të ulëta të interesit, siguruesit e jetës po vuajnë nga ana e përfitueshmërisë dhe pozicionit kapitalit.

Solvency II (SII) prezantuar në Europë në 2016, ishte një ndryshim rregullatori mjaft domethënës për siguruesit. SII synonte vlersimin ekonomik të aseteve të siguruesit dhe detyrimeve me qëllim që të njihte koston e plotë të kapitalit të kërkuar për të mbështetur bizneset.

---

[1] Swiss Re Institute *sigma No 3/2017*

[2] Swiss Re Institute

Tabela 1. Rritja e primit sipas tregjeve në 2016

	Jetës	Jo-jetës	Total
Tregjet e zhvilluara	- 0.5%	2.3%	0.7%
Tregjet në zhvillim	17%	9.6%	14%
Në botë	**2.5%**	**3.7%**	**3.1%**

Burimi: *Swiss Re Institute, 2017*

Primi i sigurimit të jo-jetës në botë ra në 3.7% në 2016, nga 4.2% në 2015 por më e lartë se mesatarja e 10 viteve. Në tregjet e zhvilluara primi i jo-jetës ra në 2.3% në 2016 krahasuar me 3.3% në vitin 2015. Ndërsa në tregjet në zhvillim, primi i jo-jetës u rrit në 9.6% në 2016 e cila ishte mbi mesataren e 10 viteve prej 8.3%.

Në vitin 2016, bota u përball me 327 ngjarje fatkeqsie, në termat sigma, nga të cilat 191 ishin katastrofa natyrore dhe pjesa tjetër të shkaktuara nga njeriu. Humbjet ekonomike të shkaktuara nga gjitha fatkeqsitë përllogariten në 175 bilion USD në 2016. Humbja më e madhe ishte ne Azi nga tërmeti në Ishullin Kyushu në Japoni. Nga të gjitha, sektori i sigurimeve mbuloi 46 bilion USD të humbjeve nga katastrofat natyrale dhe 8 bilion nga fatkeqsitë e shkaktuara nga njeriu në 2016. Diferenca prej 121 bilion USD midis totalit dhe humbjeve të siguruara tregon boshllekun e madh të mbrojtjes globale ndaj ngjarjeve katastrofike.

Figura 2. Humbjet nga katastrofat dhe mbulimet nga siguruesit



Burimi: *sigma 2/2017*, Swiss Re Institute

Tregjet e zhvilluara

Në tregjet e zhvilluara të Europës, kryesisht vendet e Europës Përendimore primi i sigurimit të jetës pati ngecje në 2016. Vendet si Franca, Gjermania, Italia patën rënie të volumit të sigurimit të jetës. Zvicra shënoi rënien më të madhe prej 5.6% në terma real të primit të jetës krahasuar me vendet e tjera për shkak të dobësimit në pensione. Vendet Nordike, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar patën rritje të primit të jetës. Perspektiva afat shkurtër për sigurimin e jetës në Europën Perendimore duket e zymtë. Kjo varet edhe nga aftësia e kompanive të sigurimit për të adoptuar burimet e biznesit me normën e ulët të interesit.

Ndërsa, sigurimi i jo-jetës në Europën Perëndimore u rrit me 2.8%. Gjermania, Franca, Mbretëria e Bashkuar, vendet Nordike shënuan rritje, por edhe Spanja e Portugalia primet e jo-jetës reaguan pozitivisht. Në Greqi , primet u rriten për herë të parë pas tkurrjes kumulative prej 35% që nga viti 2010.3

Tregjet në zhvillim

Ashtu si në tregjet e zhvilluara të Europës, edhe në tregjet në zhvillim primi i jetës pati rënie gjatë vitit 2016, rënie e cila vazhdon për të katërtin vit rresht. Polonia si tregu më i madh në rajon shënoi rënie të primit të jetës prej 16%, e ndjekur më pas nga Republika Çeke, Slovakia, Hungaria etj. Edhe pse me norma të ulëta të interesit, kompanitë e sigurimit të jetës vazhdojnë të vuajnë nga shitjet e paqëndrueshme për shkak të inflacionit të lartë që i bën presion të ardhurave reale të familjeve, dhe luftojnë të bindin konsumatorët për vlerat e tyre të propozuara. Rusia u bë tregu i dytë më i madh në rajon ngaqë normat e interesit mbeten në nivele tërheqëse rimëkëmbjes ekonomike pas rritjes së çmimit të naftës.

Në vitin 2016, sigurimi i jo-jetës pati rritje në vendet në zhvillim të Europës e ndihmuar nga rritja ekonomike dhe tregu i punës. Polonia vazhdon të zgjerojë tregun e sigurimeve të jo-jetës me 19% 2016, Hungaria me 13%, Slovakia 9.1% etj.4

Përfundime dhe rekomandime

Sektori i sigurimeve luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe financiar dhe mund të ndikojë stabilitetin fianciar. Gjatë viteve të fundit tregu i sigurimeve në Shqipëri ka njohur një trend rritës por krahasuar me vendet e

[3] Swiss Re Institute *sigma No 3/2017.*

[4] EIOPA, Insurance Europe.

tjera të Europës dhe të Rajonit, rritja ka qenë mjaft e ulët. Objektivi i këtij punimi është shqyrtimi i impaktit të përcaktuesve makroekonomikë në kompanitë e sigurimeve.

Për të arritur objektivin, ne kemi përzgjedhur variabla potencialisht ndikues në zhvillimin e sektorit të sigurimeve. Kjo bazuar në hulumtimin e literaturës dhe studimeve me të njëjten temë nga autorë dhe studius të ndryshëm. Pastaj kemi mbledhur të dhëna në seri kohore mbi baza 3-mujore për periudhën që donim të studionim (2006-2016). Të dhënat u përpunuan në model regresioni, me test korrelograme si testi i përshtatshëm për të dhënat tona në seri kohore, dhe me test cointegration për të përftuar korrelimin e variablave dhe rezultatet e studimit.

Rezultatet tona tregojnë lidhje pozitive mes primit të sigurimit dhe GDP. Ndikimin më të madh mbi zhvilimin e sektorit të sigurimit në vendin e tonë e kanë GDP dhe INT noma e interesit. Urbanizimi ka një efekt pozitiv tek populli ynë për të njohur menaxhimin e riskut dhe si të mbrohen nga ngjarjet që shkaktojnë humbje për ato, duke i shtyrë drejt kërkesave për sigurim. Gjatë rritjes së papunësisë nuk ka pasur rënie të kërkesës se Shqipëtarëve për produktet e sigurimit. Gjetjet në regresion theksojnë efekt të paqartë të papunësisë mbi primin e sigurimit për shkak të rezultatit të ndryshëm nga pritshmëria. Niveli inflacionit në nivele të ulëta ka nxitur zhvillimin e sektorit të sigurimeve dhe kërkesat për sigurim jete ose jo-jete.

Rezultati i testit rastësor Granger tregon që rritja Granger e GDP-së shkakton rritje të PRIM-it, por edhe rritja Granger e PRIM-it shkakton rritje të GDP-së në vend Probabilitetet janë më të vogla se 5 % niveli domethënies.

Rezultatet bazohen në faktin se rritjet e tregjeve të sigurimit dhe zhvillimit ekonomik ecin me ritëm të ngjashëm. Sektori i sigurimit në vend ka potencial për tu rritur por nuk ka kapacitetin për të lehtësuar efektivisht rritjen ekonomike në vend.

Referenca

- Arena, M. (2006): "Does insurance market activity promote economic growth? Country study for industrial and developing countries". *Policy Research Working Paper Series* 4098, The World Bank.
- Beck, T. & I. Webb (2003): "Economic, demographic, and institutional determinants of life insurance consumption across countries". *The World Bank Economic Review* 17(1) : pp. 51-88.

- Browne, M., Chung, J. W., & Frees, W. (2000). International property-liability insurance consumption. *The Journal of Risk and Insurance, 67,* 73-90.
- Bianchi. T., G. Ebner, R. Korher, & E. UBL (2011): "The Austrian Insurance Industry in CESEE: Risk and Opportunities from a Financial Stability Point of View" *Financial Stability Report* (22): fq 88-106.
- Bundo Sh. & Lito G. *"Teoria dhe praktika e sigurimeve"* Tetor 2014
- Christophersen, C., & P. Jakubik (2014): "Insurance and the Macroeconomic Environment". EIOPA *Financia Stability Report* – Thematic Articles 1.
- Curak M., Loncar S., Poposki K. (2009), " Insurance Sector Development and Economic Growth in Transition Countries", International Research Journal of Finance and Economics – Issue 34 , 2009.
- Dragos L. S. (2014) " Life and non-life insurance demand: the different effects of influence factors in emerging countries from Europe and Asia", *Economic Research*
- Esho, N., Kirievsky, A., Ward, D., & Zurbruegg, R. (2004). Law and determinants of proper-casuality insurance. *The Journal of Risk and Insurance*,71, 265-283.
- Kugler. M. & R. Ofoghi (2005): "Does insurance promote economic growth? Evidence from UK" *MMF Research Group Conference 2005 8.*

Av. Eljon HILA

KONCEPTI I "PËRGJEGJËSISË" PER ADMINISTRATORËT E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS LEGJISLACIONIT TREGTAR (2008-2015) TE PËRAFUAR ME DIREKTIVAT E BE-SË.

Abstrakt

Gjatë vitit 2008, ne kuader te reformave ligjore ne perqasje me legjislacionin e vendeve te Bashkimit Europian, ne Republiken e Shqiperise u implementua një reformë ligjore-administrative në fushën e të drejtës tregtare, e cila kishte për qëllim krijimin e lehtësive për bizneset në disa aspekte. Kjo reformë bëri të mundur kalimin e veprimtarisë se regjistrimit të subjekteve tregtare nga procedimet gjyqësore në ato pranë sporteleve të organeve të administratës publike. Ky fakt solli një zhvillim pozitiv në fushen tregtare, pasi lehtësoi bizneset nga bara procedurale që reflektohej jo vetëm në kosto të larta procedurale, por edhe në koston kohore që kërkonte procedura për rregjistrimin e shoqërive tregtare pranë gjykatës.

Por, pervec këtyre lehtësive procedurale qe solli reforma ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo riformuloi konceptin e pergjegjesise ligjore në lëndë civile dhe penale për administratorët e shoqërive tregtare. Reforma ligjore në këtë prizëm u thellua edhe më shumë përmes miratimit të ligjit "Për disa ndryshime..." Nr. 129/2014, ku detajohen rastet e përgjegjësisë për shpëblimit të dëmeve eventuale prej tyre si dhe disa çështje me rëndësi për shoqëritë tregtare që lidhen me përfaqësimin, kapitalet, prishjen dhe likujdimin, etj.

Fjale kyçe: Shoqëri Tregtare, Administrator, Përgjegjësi civile/penale, Dëmshpërblim, Reforme ligjore.

Hyrje

Fryma e ndryshimeve politike në vend si dhe mundësia e sipërmarrjes dhe tregut të lirë sipas parimit të kërkesës dhe ofertës, reflektoi domosdoshmërinë e një reforme ligjore në fushën e së drejtës tregtare në vend. Kësisoj, me qëllim që të vendosej një rend i ri ekonomik dhe të zbatohej kalimi nga një sistem me

ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, në mbështetje të neneve 10,11,12,12 dhe 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 " Për dispozitat kryesore kushtetuese"[1] u miratua nga Kuvendi Popullor ligji nr. 7512, datë 10.08.1991 i cili në objektin tij parashikonte: "*Në Republikën e Shqipërisë sanksionohen dhe mbrohen prova private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t`u punësuar privatizimi i pronës shtetërore dhe gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë*."[2]

Pikërisht, dispozitat kryesore kushtetuese të miratuara në vitin 1991 si dhe parashkimi në preambul dhe në objektin e ligjit 7512, mundësuan krijimin e ambientit të përshtatshëm ligjor për krijimin dhe zhvillimin e sipërmarrjes së lirë, në format e parashikuara mirënjohura të ushtrimit të tregtisë në gjith vendet me ekonomi tregu të lirë dhe të pakontroluar nga shteti. Është me rëndësi të përmendim që ky ligj, edhe pse nuk kishte për qëllim shterimin e parashikimeve të së drejtës tregtare, vendosi shinat dhe hapi rrugën për krijimin e një baze ligjore të përshtatshme dhe të përngjashme me vendet e industrializuara e me historik të konsoliduar në fushën e tregtisë së lirë. Risi politike por që synonte përthithjen dhe zhvillimin e potencialit ekonomik në vend, ishte edhe fakti që ky ligj lejonte krijimin e subjekteve tregtar (banka, shoqëri tregtare, etj) me kapital të huaj si dhe mundësinë e ushtrimit të aktiviteve tregtare nga subjekte të huaja, mundësi kjo që ishte e pamundur gjatë sistemit monist në vend, ku ekonomia ishte e kontrolluar nga shteti dhe sipërmarja private ishte e ndaluar dhe aktivitetet ekonomike në vend zhvilloheshin përmes shoqërive shtetërore.

Ligji nr. 7512, datë 10.08.1991 "Për shoqëritë tregtare" parashikonte krijimin e subjekteve tregtar privat, vendas dhe të huaj, në këto forma organizimi juridik: 1- shoqëritë kolektive; 2- shoqëritë komandite; 3- shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar; dhe 4- shoqëritë anonime. Në këtë kuptim, llojshmëria e organizimeve ligjore të shoqërive tregtare u përngjasonte atyre të vendeve të zhvilluara, dhe përgjithësisht legjislacioni tregtar u miratua duke mbajtur në konsideratë legjislacionin francez, i cili ishte ndër më të zhvilluarit e kohës. Miratimi i ligjit 7512, datë 10.08.1991, u pasua edhe nga miratimi i ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", si dhe nga ligji 7667, datë 23.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare" në të cilin parashikoheshin mënyrat e

[1] Ligji nr.7491 date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese".

[2] Ligji nr. 7512, date 10.08.1991 "Per shoqerite tregtare".

rregjistrimit të subjekteve tregtare dhe mbajtja e këtij rregjistri nga Gjykata e Tiranës.

Në vitin 2007-2008 u ndërmor një tjetër reformë në legjislacionin tregtar, i cili u finalizuar së pari me ligjin 9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit"; ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe një sërë VKM-sh të cilat në tërrësinë e tyre synonin lehtësimin e formësimit dhe rregjistrimit të shoqërive tregtare në aspekt të procedurës që duhej ndjekur për regjistrimin, lehtësimin në aspektin e kostos financiare për regjistrimin e tregtarëve si dhe lehtësimin në aspektin kohor të këtyre procedurave. Konkretisht, ligji 9723 "Për QKR" mund të konsiderohet një përmbysje e praktikave administrative për krijimin, regjistrimin dhe mbajtjen e rekordeve të shoqërive tregtare, veprimtari kjo që zhvendosej nga procedimi gjyqësor në procedim administrativ, fakt që i dha një zhvillim të mëtejshëm marrëdhënieve tregtare në vend duke e bërë Shqipërinë tashmë një atraksion biznesi për ekonomitë e huaja.

Si rezultat i këtyre reformave, "në vitin 2008, Shqipëria u shpall nga Banka Botërore një nga dhjetë ekonomitë më reformatore në botë për klimën e biznesit. Një paketë masash që përfshinte thjeshtimin e procedurave tatimore, lehtësimin e hapjes së një biznesi dhe rritjen e mbrojtjes ndaj investitorëve përmirësuan renditjen e Shqipërisë nga vendi i 135 në atë të 86-in brenda një viti të vetëm."[3] Aktualisht, si rezultat i reformave ligjore dhe administrative të legjislacionit tregtar në tërësi, specifikisht edhe si rezultat i reformave të tjera në fushën e tatim-taksave, luftës kundër korupsionit, etj., bëri që Shqipëria të renditet ndër vendet e përshtatshme për të bërë biznes, duke mbajtur në vitin 2014 vendin e 68 nga 189 ekonomi globale me një progres të dukshëm nga viti në vit.[4]

1. Figura dhe funksionet e administratorit te shoqerive tregtare

Referuar ligjit 9901 / 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëritë tregtare të formësuara si person juridik përfaqesohen në marrëdhënie me të tretët, me organet administrative dhe ato gjyqësore përmes "Përfaqësuesve Ligjor" apo, sic njihet rëndom, nga Administratorët e tyre. Përgjithësisht, në rastet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ato zotërohen nga ortaku i tyre i cili luan funksionet e të dy orgavene te shoqerise si Ortaku vendimarrës dhe Administratorit drejtues. Por, janë të shumta shoqeritë tregtare të cilat në ekzekutim të politikave tregtare dhe administrimin e tyre kanë persona të cilët nuk janë ortak, por janë persona

[3] Gazeta Shqip http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/24/te-besh-biznes-ne-shqiperi-e-veshtire/

[4] World Bank Group http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/albania

të cilët mandatin drejtues të shoqërisë në cilësinë e Administratorit e marrin nga asambleja e ortakeve.

Figura e Administratorit të shoqërisë tregtare parashikohet qartësisht në nenin 12 të ligjit 9901 / 2008 ku thuhet se: "*Shoqëritë tregtare përfaqësohen sipas rregullave të përcaktuara nga ky ligj dhe dispozitave të statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor*." Pra, nga sa më sipër, vërehet se Administratori është personi që kryen përfaqësimin tregtar dhe institucional të shoqërisë tregtare me efekte të ligjshme dhe të detyrueshme për shoqërinë. Figura e Administratori është e një rëndësie të vecantë për ekzistencen e shoqërise, jo vetëm si një kërkese ligjore, por edhe per mirëfunksionimin e saj ne veprimet tregtare. Për këtë arsye legjislatori ka parashikuar një sërë urdhërimesh dhe detyrimesh ne ngarkim të tij, me qëllimin e vetem: Funksionimin e shoqërisë tregtare sipas kërkesave të një ekonomie kompetitive përmes zbatimit te ligjit dhe konkurences së ndershme.

Për këtë qëllim, në ligjin tregtar dhe ligje të tjera, janë parashikuar disa masa disiplinuese per veprimtarinë e Administratorëve, thyerja e të cilave passjellë pergjegjësi personale per ata. Konkretisht, nga analizimi i legjislacionit në tërrësi, vërejmë se kjo përgjegjësi ndahet ne disa fusha: Përgjegjësi sipas ligjit penal; Përgjegjësi sipas legjislacionit civil dhe Përgjegjësi sipas legjislacionit administrative.

1. Përgjegjësia juridiko-civile e Administratorit sipas ligjit tregtar Nr. 9901/ 2008

Ashtu siç sqarojmë me sipër, ligji tregtar ka për qëllim që të rregullojë mbarëvajtjen e veprimtarisë tregtare te kompanive tregtare. Për këtë qëllim, ky ligj parashikon përgjegjësine juridike të administratorëve si një mjet jo vetëm edukues dhe sensibilizues, por edhe si një mjet për të garantuar respektimin e ligjit nga Administratorët përmes forces zbatuese të tij.

Kështu, në nenin 16 të ligjit 9901 / 2008 parashikohet se: "1. Individi, i cili gezon cilesine e ortakut, aksionarit apo perfaqesuesit te ortakut ose aksionarit, te administratorit apo te anetarit te keshillit te administrimit te shoqerise tregtare, i cili, me veprimet apo mos veprimet e tij, i siguron vetes apo te treteve nje perfitim ekonomik te padrejte, apo i shkakton nje te treti pakesimin e pasurise me dashje, eshte pergjegjes personalisht ndaj te treteve, perfshi autoritetet publike, me pasurine e tij, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise kur: a) ka abuzuar me formen dhe/ose pergjegjesine e kufizuar qe ofron shoqeria tregtare; ose b) ka trajtuar pasurite e shoqerise tregtare sikur te ishin pasurite e tij/te saj personale; ose c) ne castin kur ka marre dijeni apo duhet te kishte marre dijeni qe shoqeria nuk ka erson te mjaftueshem per te permbushur detyrimet ndaj paleve te treta,

nuk mori masat e nevojshme, te perfshira ne kompetencat e tij/te saj, sipas ketij ligji, per te mos lejuar qe, ne varesi te rrethanave, shoqeria te vazhdonte ushtrimin e veprimtarise tregtare, dhe/ose marrjen persiper te detyrimeve te reja ndaj paleve te treta, perfshire autoritetet publike.

Ne rastet e parashikuara ne piken 1, te ketij neni, pergjegjesia personale per detyrimet e shoqerise kufizohet deri ne vlerat e percaktuara ne vijim: a) ne rastin e parashikuar ne shkronjen "a", te pikes 1, te ketij neni, deri ne vleren e pergjithshme te detyrimeve te papaguara te shoqerise; ose b) ne rastin e parashikuar ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, per detyrimet e papaguara te shoqerise, deri ne vleren e tregut te pasurise apo pasurive te shoqerise tregtare, te cilat i ka trajtuar erso ishin pasurite e tij/te saj personale; ose c) ne rastin e parashikuar ne shkronjen "c", te pikes 1, te ketij neni, deri ne vleren e pergjithshme te detyrimeve te papaguara te shoqerise, te cilat kane lindur pas marrjes dijeni per gjendjen e parashikuar sipas shkronjes "c", te pikes 1, te ketij neni. 3. Nese nje apo me shume nga shkeljet e siperpermendura kryhen se bashku nga me shume se nje prej personave te permendur ne piken 1, te ketij neni, atehere keta persona pergjigjen ne menyre solidare ndaj te treteve, perfshi autoritetet publike. 4. erson ii percaktuar sipas pikes 1, te ketij neni, mban pergjegjesi personale ndaj paleve te treta, perfshi autoritetet publike, vetem nese kryerja e shkeljeve te percaktuara ne kete nen vertetohet me vendim gjyqesor te formes se prere. 5. erson ii percaktuar sipas pikes 1, te ketij neni, nuk mban pergjegjesi personale ndaj paleve te treta, te cilat, ne momentin e marrjes persiper te detyrimit nga shoqeria, kishin dijeni per shkeljet e percaktuara ne kete nen apo, ne baze te rrethanave te qarta, nuk mund te mos kishin dijeni per to. 6. Padia ndaj personave te percaktuar sipas pikes 1, te ketij neni, duhet te ngrihet brenda 3 vjeteve nga data e kryerjes se shkeljes.".[5]

2. Përgjegjësi juridiko-penale e Administratorit sipas Kodit Penal

Për shkak të rëndësisë së posacme që shoqërite tregtare kanë ne ekonominë e vendit, qarkullimin e të mirave dhe shërbimeve, punësimin dhe kontributin në të ardhurat shtëtërore përmes taksave dhe tatimeve, legjislatori i ka dhënë një rendesi shumë të madhe mbarevajtjes se punës ne kompanite tregtare, te cilat ne kuptimin praktik janë thjeshte "krijesa ligjore" që veprojnë, ushtrojnë aktivitt tregtar dhe realizojne qarkullim monetar, fiskal, mallrash dhe sherbimesh vetëm dhe eksluzivisht permes administratorëve të tyre. Për këtë qëllim, figura e Administratorëve ka një rendesi të posacme edhe për të drejtën penale.

Kështu, në nenin 164 te Kodit Penal parashikohet se: "Shpërdorimi i

[5] Neni 16 i ligjit 9901 / 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar me ligjin 129/2014.

kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet." Përmes kësaj dispozite, legjislatori ka patur për qellim mbrojtjen e pasurisë ose veprimtarisë tregtare të shoqërise edhe nga Administratori i saj. Dy format kryesore permes te cilave Aministratorët mund të dëmtojnë shoqërinë që ata drejtojnë janë: 1- Nxjerrja e perfitimeve personalisht; ose 2- Favorizimi i një shoqërie tjetër ku ata kanë interesa.

Vlen te theksohet që kjo dispozite penale duhet të analizohet vecanerisht nen optiken e nenit 13 dhe 14 të ligjit 9901/2008 ku paraqiten rastet e konfliktit të interesave dhe ndalimeve ligjore për administratorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si dhe nën optikën e parimit te besnikërisë kundrejt shoqërisë dhe bashkëpuntorëve tregtar.

Gjithashtu, përvec sa më sipër, Administratoret kanë përgjegjësi penale edhe per korrupsionin e ushtruar prej tyre gjatë drejtimit të kompanise tregtare sipas nenit 164/b të Kodit Penal. Konkretisht në këtë dispozitë parashikohet se: "Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet." Sic shihet më sipër, kjo veper penale kryhet përmes kërkimit a marrjes se cdo lloj përfitimi të parregullt ose premtimit për të përfituar në menyrë të parregullt përmes kryerjes ose moskryerjes se veprimeve ne kundërshtim me detyrën e tij si administrator.

3. Përgjegjësi e Administratorit sipas Ligjit "Për kundravajtjet administrative në Republikën e Shqipërisë"

Zbatimi i ligjit është një detyrë qytetare, e cila më së pari është obligim moral i cdokujt në shoqëritë demokratike ku ligji sundon në mënyrë të barabartë mbi të gjithë subjektet e vendit. Kjo vlen edhe për shoqeritë tregtare, të cilat detyrohen te zbatojnë ligjin përgjatë veprimtarisë së tyre tregtare. Kështu, në sferen e së drejtës administrative, shoqeritë tregtare, sipas fushës se veprimit/prodhimit dhe tregtimit, duhet të zbatojnë legjislacionin specifik që prek, rregullon dhe normon aktivitetin e tyre. Kështu, zbatimi i legjislacionit tatimor është nje detyrim qe rendon mbi të gjitha shoqerite tregtare pa kufizim. Po ashtu, për shoqeritë prodhuese, zbatimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konsumatorit, ligjit për kushtet sanitare, etj., eshte detyrim që rendon gjithashtu mbi ato kompani, veprimtaria e të cilave mund te ndose ambientin, mund te

demtojë konsumatorin, mund te demtoje financat publike përmes shmangies se detyrimeve tatimore.

Për të garantuar respektimin dhe zbatimin e legjislacionit administrativ ne tërrësi, është ne fuqi edhe ligji per kundravajtjet administrative, i cili ka per objekt të tij përcaktimin e rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të organeve të administratës publike, që vendosin dënime administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative.[6]

Parimi bazë është që cdo subjekt ka përgjegjësi individuale për shkeljen e ligjit. Por në rastin e shoqërive tregtare situate paraqitet pak më ndryshe per arsye se shoqëritë tregtare janë "krijesa ligjore" që veprojne përmes përfaqësimit nga administratorët e tyre. Për këtë arsye, veprimet apo mosveprimet e shoqërive tregtre janë në thelb shfaqe e vullnetit të administratoreve si qënie njerëzore. Ndaj edhe kundravajtja administrative që ato kryejne është në thelb një veprim I dktuar nga vullneti njerëzor I administratorit të tyre.

Per këtë arsye, në nenin 39 të ligjit 10279 / 2010 parashikohet se: "Nëse administratori i personit juridik nuk shlyen apo nuk pranon që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, të shlyejë gjobat administrative, të nxjerra për llogari të personit juridik që ai përfaqëson, ai bëhet personalisht përgjegjës për shlyerjen e detyrimit."

Ky parashikim ligjor është i diskutueshem për faktin që bie ndesh me parimin bazë kushtetues të pergjegjësisë personale përballë penalizimeve nga organet ligjzbatuese. Por nga ana tjetër, gjithmone vullneti i shoqërisë tregtare qëndron brenda vullnetit të administratorit të saj, ndaj edhe cështja e përmbushjes se detyrimeve që rrjedhin nga penalizimet nuk mund të jete ndryshe. Për këtë qëllim legjislatori ka parashikuar qe këto detyrime të trasferohen tek administratoret e kompanive në rastet kur ata nuk marrin masa për të shlyer këto gjoba.

4. **Konkluzione**

Figura dhe funksionet e administratoreve të kompanive tregtare jane shumë komplekse dhe përfshijnë jo vetem drejtimin e tregtise, por edhe disa veprimtari ligjore që kanë për qëllim mbrojtjen e kompanise tregtare nga veprimet e Administratorit sikundër mund të jenë dëmtimi i pasurise se saj nga Administratori; vjedhja e pasurise nga Administratori; dëmtimi i tregtisë përmes favorizimit të paligjshëm një kompanie tjetët ku Administratori ka interesa; shkelja e besnikërisë; konfliktet e interesave; korrupsioni pasiv, etj.

[6] Ligji Nr. 10279 / 2010 "Per kundravajtjet administrative ne RSH"

Me qëllim garantimin se Administratoret do të veprojnë në perputhje me ligjin, ka bërë që legjislatori të ngrejë në nivelin e vepres penale disa veprime te dëmshme te tyre kundrejt shoqerise tregtare, personave të trete si dhe akte të tjera korruptive te cilat në thelb të tyre nuk vijnë në pajtim me qellim pse kompanite tregtare themelohen dhe ekzistojne. Kështu ndërgjegjësimi i Administratorëve do të jetë me i madh ne zbatimin e ligjit tregtar dhe administrativ.

Vlen të theksohet që legjislacioni tregtar si dhe ai dytësor në fushën e se drejtës tregtre është i përafruar me legjislacionin e BE-së dhe ka patur për shembull vendet më të zhvilluara Europiane si Franca, Anglia, Gjermania e Italia.

Bibliografi:

- Ligji Nr. 10279 / 2010 "Per kundravajtjet administrative ne RSH";
- Ligji Nr. 9901 / 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar me ligjin 129/2014;

World Bank Group http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/albania

Gazeta Shqip http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/24/te-besh-biznes-ne-shqiperi-e-veshtire/

- Kodi Civili Republikës së Shqipërise
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Dr. Danja HOBDARI

AUTORËSIA SI TRASHËGIMI: DERI KU MBROHET PËRMES LIGJIT TË RI

Abstrakt

Në vitin 2016 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri për të drejtat e autorit dhe të tjera të drejta të lidhura me to. Me anë të këtij ligji u tentua të ndiqeshin zhvillimet tejet të shpejta të rrugëve të komunikimit dhe të përftimit vetjak e kolektiv të veprës origjinale. Rezultati më i rëndësishëm i këtij ligji qe zbutja e konfliktit midis autorësisë dhe teknologjisë. Ndërkaq ky ligj ka lënë shumë shtigje. Çështjet më problematike janë ato që kanë të bëjnë me raportin midis veprës origjinale dhe veprës së përshtatur; me raportin midis autorit dhe përgatitësit; me raportin midis autorit dhe botuesit; me raportin midis veprës autoriale dhe veprës së divulguar mbi bazën e saj; me shtigjet që mbeten hapur për manipulim të dhënash e burimesh dhe së fundi me tjetërsimin e autorësisë.

Authorship as a legacy:

How is protected by the law on intellectual property

Abstract

In 2016, the Albanian Parliament approved a new law on the intellectual property and other rights related to it. With this law, the legislator tented to follow the rapid development of communication sciences with the protection of intellectual work, personal or collective one. The most important feedback of this law was smoothing the conflict between authorship and technology. Even though, the new law on the intellectual property has still some problems in its formulation. The most problematic issues are related to the relation between the original work and the adapted one; the relation between the author and the curator; the relation between the author and the editor; and other cases which let the possibility to manipulate data and resources, or alienate the meaning of authorship.

Me Ligjin nr. 35, 2016, *Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to* (më tej: Ligji nr. 35/2016) Kuvendi i Shqipërisë hodhi një hap shumë të rëndësishëm për të rregulluar juridikisht dhe për të marrë në mbrojtje një prej të drejtave më të rrezikuara të njeriut, të drejtën për mbrojtjen e autorësisë së veprës origjinale në shkencë, letërsi e art; përgjithësisht të drejtat që lidhen me pronësinë intelektuale dhe trashëgiminë shpirtërore, si dhe të përfitimeve që rrjedhin ligjërisht prej tyre.

Ky hap u hodh në një kohë kur autorësia, jo vetëm në përmbajtje, por edhe formalisht, gjendej në një voluntarizëm të pajustifikueshëm, që pati çuar në kushtet e një *samizdat*-i të përgjithshëm: pothuajse e gjithë letërsia, artistike e shkencore, botohej me mundësitë buxhetore të autorëve ose të miqve të tyre.

Ligji nr. 35/2016 mori përsipër jo vetëm të krijojë një status të mbrojtur të autorësisë, por dhe ta përafrojë atë plotësisht apo pjesërisht me standardet e njohura europiane, ta eurokodifikojë atë, duke pasur si referencë direktivat e Parlamentit Europian dhe Këshillit, që fitojnë zbatueshmëri në çdo vend përmes pranimit vullnetar të tyre. Kjo theksohet qysh në hyrje të ligjit dhe konsiderohet një prej sukseseve të tij[7].

---

[1]Sipas ligjvënësit shqiptar, ky ligj është mbështetur në: 1. Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura, e amenduar, Celex: 32006L0116; bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 372, datë 27.12.2006; 2. Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 prill 2004, Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, Celex: 32004L0048; bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 157, datë 30.4.2004; 3. Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit, Celex: 32001L0029, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 167, datë 22.6.2001; 4. Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2001, Mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre origjinale të artit, Celex: 32001L0084, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 272, datë 13.10.2001; 5. Direktivën 96/9/ KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, Celex: 31996L0009, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 77, datë 27.3.1996; 6. Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike, Celex: 32009L0024, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 111, datë 5.5.2009; 7. Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, Mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale, Celex: 32006L0115, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 376, datë 27.12.2006. Gjithashtu ligjvënësi saktëson që në hyrje se ligji është përafruar pjesërisht me: 1. Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllore, Celex: 31993L0083, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 248, datë 6.10.1993; 2.

Duke mos u ndalur gjatë në aspektet progresive, një prej të cilëve është njohja e së drejtës së autorit të një vepre origjinale për negociime për vlerësimin e veprës së tij, pa përjashtuan nocionin e ri të autorësisë kolektive; aspekte që kanë sjellë një marrëdhënie të re midis autorit, botuesit, publikuesit e lexuesit; përgjithësisht *në marrëdhënien trekëndore autor-botues-lexues*, në vijim do të ndalemi në disa çështje që ngjajnë të pagjidhura përfundimisht në pikëpamje të parimeve të përgjithshme të së drejtës, ose që përmbajnë hapësira të ngushta për kuptime që nuk pajtohen me *karakterin univok* të ligjërimit juridik.

Dy janë arsyet, sipas mendimit tonë, që mund të kenë çuar në hapësirat e dyshimta midis të ligjshmes dhe të paligjshmes në mbrojtjen e autorësisë: **1.** Përshtatja formale e tekstit prej direktivave europiane, ndonjëherë mbështetur në përkthime të pasigurta, që i qendrojnë besnik fjalës, jo frymës; **2.** Mosnjohja e diferencave jo të vogla midis realiteteve juridike në Shqipëri e në BE. Këtu e kemi fjalën para së gjithash për ato garanci që në mjediset europiane ia jep autorësisë deontologjia e krijimit artistik e shkencor dhe që nuk kanë nevojë për mbrojtje të shqiptuar në ligj[8]. Këto dallime e bëjnë të detyrueshme që në ligjin shqiptar të mos ketë të drejta të mbrojtura me nënkuptim, për shkaqe të etikës profesionale dhe të skrupujve morale, dhe as lejime të nënkuptuara, që mund të konsiderohen jashtë objektit të mbrojtjes.

Duke qenë një ligj ku për herë të parë sistemohet një hierarki e autorësive, prej asaj origjinale deri tek veprat që rrjedhin prej tyre, në mënyrë të ligjshme e të ndaluar; si dhe duke qenë se ligjvënësi e ka shpallur si ambicie të vetën kodifikimin europian të aktit, ka qenë e domosodshme që në hyrje ligji të përmbante *Përkufizimin e termave* që përdoren për *kërkuesit shkencorë*. Zgjidhja më e përshtatshme do të kishte qenë referimi në përkufizimin e njohur ***Frascati***, që është i njohur ndërkombëtarisht si më poshtë:

Kërkues shkencorë janë autorë profesionistë të përfshirë në konceptimin dhe krijimin e dijeve të reja, produkteve, proceseve, metodave dhe sistemeve dhe në menaxhimin e projekteve lidhur me to. Kjo përfshin çdo veprimtari të lidhur me "kërkimin bazë", "kërkimin strategjik", kërkimin e aplikuar, zhvillimin eksperimental dhe "transferimin e njohurive", duke përfshirë kapacitetet inovatore, këshilluese e mbikëqyrëse, si dhe ato të mësimdhënies, menaxhimin e

Direktivën 2014/26/ BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi-territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm, Celex: 32014L0026, bot. në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 84, datë 20.3.2014.

[2] Krhs për shembull Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, miratuar si deontologji e kërkimit shkencor nga All European Academies (ALLEA), Berlin 2017.

njohurive dhe të drejtat mbi pronësinë intelektuale, shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit a të gazetarisë shkencore[9].

Në mungesë të një përkufizimi për kërkuesin shkencor dhe të drejtat e tij, rezulton që *e drejta e autorit në shkencë dhe në kërkimin shkencor të jetë e renditet pasi janë mbaruar të gjitha format e autorësisë*. Dhe kjo shpreh qendrim e nënvlerësim. Në ligj nuk ka asnjë nen që të zotojë ligjërisht autoritetin shtetëror për inkurajimin e autorësisë për veprën shkencore, e cila, krahasimisht me të gjitha format e tjera të autorësisë (letërsi, art, spektakël, performancë etj.), është jashtë tregut dhe në të gjitha vendet e rajonit subvencionohet. Kjo rrezikon të sjellë dyshime në vetë hierarkinë e të drejtave që premtonte ligji.

Në Ligjin 35/2016, me të drejtë, krahas autorësisë së rendit të parë, autorësisë së veprës origjinale, është parashkruar edhe *statusi i veprës së prejardhur*[10], duke nënkuptuar me to përshtatjet, riprodhimet, ilustrimet. Vepër e prejardhur konsiderohet produkti intelektual i mbështetur *në një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë*. Vepra e prejardhur është një dukuri ekzistuese prej shumë e shumë kohësh në Shqipëri. Mjafton të përmendim vetëm faktin se e gjithë letërsia arbëreshe e shekullit të romantizmit dhe më herët, përgjatë gjithë shekullit XX, është njohur e lexuar nga dhjetëra breza nxënësish vetëm si *vepër e prejardhur*, në formën e *përshtatjeve*, disa herë përshtatje edhe me 3-4 variante. Në Tiranë, vetëm pas 180 vjetësh qëkur ishin botuar për herë të parë, poemat e De Radës u botuan ashtu siç i kishte shkruar autori.

Mund të thuhet se *vepra e prejardhur* i ka zënë vendin *veprës origjinale*. Edhe pas botimit në arbërishten e De Radës, poemat e tij vetëm studiuesit i lexojnë në burim. Përshtatjet kanë zëvendësuar *autorësinë e rendit të parë* edhe për autorë më të hershëm e më të vonshëm. Kjo do të thotë se *përkufizimi juridik i autorësisë së shkallës së dytë* ka qenë domosdoshmëri për të njohur një realitet juridik të trashëguar dhe është bërë mirë që ligji i ka dhënë një zgjidhje çështjes. Por mënyra si është bërë ky përkufizim le ende shtigje të hapura që interpretuesi i ligjit, *t'i barazojë në status veprat e prejardhura me veprat e autorësisë së shkallës së parë*. Kjo duhet të ketë qenë arsyeja pse ligjvënësi, përkundër *kara-*

[3] *Manuale sulla misura delle attività scientifiche e tecniche - Manuale di Frascati, OSCE.*

[4] Në nenin 9, pika 1, thuhet: Veprat e prejardhura janë krijime intelektuale, që realizohen duke u bazuar në një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, si përkthimet, përshtatjet, aranzhimet muzikore, ilustrimet, dokumentarët, riprodhimet artistike, faqet e internetit me të dhëna statike ose ndërvepruese, si dhe ndryshime të tjera të krijimeve/veprave letrare, shkencore ose artistike origjinale që mund të transformohen, të rimodelohen ose të përshtaten, dhe të cilat mbrohen si krijime/vepra origjinale në mënyrë të pavarur nga të drejtat e autorit të krijimit origjinal.

kterit pozitivist të së drejtës së sotme, ka qenë i detyruar të paralajmërojë menjëherë se *parashikimi më sipër nuk mund të interpretohet në dëm të të drejtave të autorit të veprës, e cila është përshtatur*[11]. Ky përkufizim që gjendet në këtë nen mund të thellojë një përvojë të keqe në traditën e botimeve në Shqipëri.

Rreziku i barazimit të një vepre të prejardhur me veprën origjinale, mund të çojë edhe në një shfrytëzim të autorësisë së veprës shkencore. Një shkencëtari mund t'i duhet një jetë e tërë për të shkruar një monografi për Skënderbeun apo për Mesjetën, kurse një admiruesi të historisë dhe vullnetari të shkencës i mjafton një vit për të bërë një përshtatje që u drejtohet lexuesve të mesëm apo për të bërë një divulgim (popullarizim) të veprës shkencore. Ky barazim do të dëmtonte autorësinë e parë, siç do ta dëmtonte edhe një vepër e prejardhur edhe në ndonjë formë tjetër, p. sh., në formën e ekranizimit apo të skenarizimit prej letërsisë. Dihet se konsumi masiv i një vepre artistike, apo dhe shkencore, është shumë më intensive dhe më i përftueshëm sesa ai individual, përmes leximit. Mjafton të përmendim, për shembull, një fakt të thjeshtë: Sa njerëz e kanë lexuar librin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe sa e kanë parë në ekran apo në teatër. Vetëm përmes kinemasë kjo vepër ka dy realizime, një në Shqipëri e një ndërkombëtar, pa numëruar më së paku edhe gjashtë dramatizime, brenda dhe jashtë shtetit shqiptar, për nevojat e repertorit të teatrit, disa herë edhe duke e dëmtuar rëndë tekstin autorial, duke e deformuar në mënyrë flagrante, duke e tjetërsuar jo vetëm stilistikisht por edhe në fytyrën e karaktereve.

Prej krahasimit të tekstit autorial të romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, me tekstin e dramatizuar për vënien në skenë në teatrin e Prishtinës, të Gjakovës, të Shkupit dhe në qytete të tjera, mund të shihet se deri në ç'përfundim çon ky fenomen. *Skripti* i shfaqjes është një dëshmi shumë e rëndësishme për të kuptuar se sa të dhunshme kanë qenë ndërhyrjet, sigurisht për shkak të censurës, ndërhyrje që *e kanë dekontekstualizuar konfliktin*, e kanë shkëputur ngjarjen nga realiteti i Shqipërisë dhe ai i Kosovës, madje *e kanë jugosllavizuar atë*, duke zëvendësuar gjeneralin fashist dhe ushtrinë e tij të vdekur me një gjeneral nazist, që kërkon ushtrinë e vet në *tjetërkund*. Ky *tjetërkund*, që nënkuptohet si ish-Jugosllavia e periudhës së luftës antifashiste, në fakt është *pjesë e tjetërsimit të tekstit të autorit*[12]. Nga ky krahasim lexuesi kupton se ç'do të thotë mbrojtje e tekstit të shkrimtarit si autor parësor prej përdorimit të tekstit, për të mos e kthyer *kund*-in në *tjetërkund* dhe që vetë *teksti i autorit të mos tradhtohet në leximin prej tjetrit*.

Sido që, në formulimin përfundimtar, pas këshillimit me institucionet

[5] Po aty.

[6] Donard Hasani, Vepra e dramatizuar: midis letërsisë dhe teatrit, bot. Naimi,Tiranë 2015, f. 100.

që kanë lidhje të drejtpërdrejta me autorësinë dhe të drejtën e autorit, ligjit i janë bërë disa përmirësime, kryesisht në formën e ndalimeve, që nuk janë në pajtim me drejtësinë pozitiviste, mbeten ende hapësira të ngushta që *vepra me autorësi të prejardhur të shfaqet e mbifavorizuar*.

I njëjti shqetësim është për parashikimet ku barazohet autorësia e parë me *përgatitësin*. Autorësia që i mbivendoset një vepre origjinale dhe i bartet përgatitësit të saj, kryesisht për rastet e përmbledhjeve të artikujve dhe studimeve shumautorëshe; gjithaq sa dhe statusi i një kuratori të një ekspozite të arteve figurative (pikturë, fotografi, dokumente, objekte të kulturës materiale), detyrimisht duhej të parashihej në ligj. Dhe kjo është një arritje. Por *karakteri univok i ligjërimit juridik* do të kërkonte që kuratori apo përkujdesësi, të cilët *punojnë me vepra të gatshme të të tjerëve*, qartësisht të dalloheshin në të drejta intelektuale dhe me karakter përfitimi prej autorësisë së shkallës së parë[13]. Veç të tjerash, përkufizimi me një nen më vete i termit *përmbledhje*, me një përshkrim të detajuar analitik të të drejtave të autorëve të parë dhe të atyre që realizojnë përmbledhjen, pa një përkufizim gjithaq të qartë e analitik për monografinë, me ekuivokun e vet, formalisht krijon problem pabarazie midis vetë nënllojeve të kërkimit shkencor, në dëm të formës më të qendrueshme të tij, si monografia[14]. Prishje e *hierarkisë së të drejtave të autorit* vërehet edhe në mënyrën si përkufizohet *statusi i veprës së porositur* dhe i të drejtave të autorit (në kuptimin e tyre të dyfishtë, si të drejta intelektuale dhe si të drejta përfitimi). Në kushtet e një shoqërie që ende mund të quhet *post-totalitare*, që e kanë njohur ndëshkimin agjitativ që vjen prej *veprës së porositur*, dmth *të parapaguar* (nga lat. *pro-pago,*

[7] Termi monografi, me të cilin në ligjërimin akademik-universitar kuptohet një arritje parësore nnë kërkimin shkencor, që zgjidh një problem dhe krijon fushë studimore, në Ligjin 35/2016 përmendet vetëm një here, në nenin 7, pika h, si vijon: Krijimet shkencore me shkrim ose me gojë, siç mund të jenë prezantimet, monografitë, deduksionet, disertacionet, studimet, leksionet universitare, librat shkollorë, projektet dhe dokumentacioni shkencor.

[8] Neni 67: 1. Në një kontratë porosie, përveçse kur parashikohet ndryshe, të drejtat pasurore i përkasin autorit të veprës. Autori merr përsipër të krijojë një vepër të caktuar me të drejta autori dhe të dorëzojë një kopje të kësaj vepre tek porositësi i veprës, ndërsa ky i fundit merr përsipër t'i paguajë autorit një shpërblim sipas kontratës; 2. Në kontratën e porosisë për krijimin e një vepre me të drejta autori duhet të specifikohen, gjithashtu, karakteristikat, elementet, afati kohor për dorëzimin e veprës dhe afati kohor për pranimin e veprës; 3. Porositësi i veprës ka të drejtë të zgjidhë kontratën në qoftë se vepra nuk i plotëson kushtet e caktuara në kontratë. Nëse kontrata zgjidhet sipas kësaj pike, çdo shumë e mbledhur nga autori do të jetë e kthyeshme. Nëse puna përgatitore është bërë me qëllim të krijimit të një vepre, sipas kontratës së porosisë, autori ka të drejtë në shlyerjen e çdo shpenzimi të bërë.

parapaguaj; propaganda, i parapaguar), edhe për arsye të konotacionit emocional që ka marrë përcaktimi *i/e porositur*, ligji duhej të bënte një dallim më të qartë midis *veprës së porositur, qëllimit të saj, shkaqeve të garantimit me pagesë*, me qëllim që vepra e përgatitur *me vullnet të lirë*, në konkurrencë, e pagarantuar në treg, të mos rezultojë e përdalluar. Edhe nga pikëpamja së drejtës së pashkruar, thjesht etike, ky barazim nuk jep mundësi për mirëkuptim. *Vepra e parapaguar është vepra e propagandës*[15]. Gjithnjë sipas të njëjtit koncept, termi i përdorur në ligj *autor punëmarrës* është i dyshimtë.

Për të njëjtat arsye, formulimet e nenit 22, në të cilin autorit i parashkruhet *e drejta për të hequr dorë nga autorësia*, që është një e drejtë e trashëgueshme dhe e padelegueshme, ngjajnë të refuzueshme, së paku në pikëpamje të pajtimit të së drejtës juridike me atë morale. Në rrethanat që përjetojnë shqiptarët e periudhës post-ideokratike, mbushur me pseudonime dhe gjithfarë debatesh, *me burim moskryerjen e lustracionit*, edhe e drejta e anonimësisë dhe ajo e *pseudonimit* do të kishte qenë më mirë të përkufizoheshin ndryshe, si e drejtë për *heteronim*[16].

Dihet se fjala me ngarkesë emocionale, qoftë pejorative, qoftë eufemizuese, nuk është e pëlqyeshme për ligjërimin juridik. Në përdorimin e përditshëm termi *pseudonim* nënkupton bashkëpunëtorin e shërbimit të fshehtë politik në periudhën para vitit 1990. Kurse termi *heteronim* është asnjanës dhe do të ishte në vendin e duhur në këtë rast. Se sa hutim dhe anarki ka sjellë në opinionet shqiptare përdorimi i termit *pseudonim letrar*, me kuptimin e pseudonimit të njeriut që ka bashkëpunuar me policinë e fshehtë politike, mjafton të sjellim ndërmend se çfarë u shkrua për heteronimin Gent Arbana të Ismail Kadaresë gjatë vitit 2017[17].

[9] Krhs. neni 22, pika 2. Përdoruesit e një vepre, e cila mbrohet në kuptim të këtij ligji, janë të detyruar të shkruajnë dhe të përmendin emrin e autorit në çdo kopje ose përdorim të veprës, me përjashtim të rasteve kur autori deklaron në formë të shkruar se heq dorë nga e drejta për t'iu përmendur autorësia, në përputhje me natyrën e veprës dhe përdorimin e saj; po aty, pika 4: Autori ka të drejtë të vendosë se në emrin e kujt do të paraqitet vepra e tij te publiku, si dhe të drejtën që të mbetet anonim ose me pseudonimin e zgjedhur prej tij.

[10] Shih: Fatos Lubonja, Ja pseudonimi i Ismail Kadaresë në diktaturë, në Shqiptarja, 22 shtator 2017; idem, Ju tregoj pseudonimin e Kadaresë në diktaturë, në Shekulli, 22 shtator 2017; gjithashtu: Demaliaj polemikë me Dervishin dhe Loloçin: Mësohuni me lirinë, jo si pronarë dosjesh, por … në Dita, 23 gusht 2017.

[11] Neni 81, pika 1: Lejohet të bëhen shkurtime, citime të fragmenteve ose të pjesëve të një vepre të së drejtës së autorit, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, e cila është botuar ose është vënë në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme, për të riprodhuar, botuar, përcjellë në publik, për qëllime të kërkimit shkencor, mësimdhënies, studimeve kritike, ilustrimit, argumentimit, referimit

Në dëm të autorësisë është dhe *legjitimimi i së drejtës së shkurtimit, paradoksalisht bashkërenditur me atë të citimit* (si e drejtë dhe jo si detyrim) për një vepër krijuese, pa pëlqimin e autorit ose të bartësit të së drejtës së autorit[18]. Po aq absurd është parashikimi që, në rast të shkatërrimit të dorëshkrimit të pabotuar në duart e botuesit për shkaqe madhore autorit *nuk i njihet asnjë e drejtë dëmshpërblimi*[19]*,* kur ligji duhej të parashihte detyrimin e botuesit për kopjen e sigurisë (*security copy*, *backup copy*) dhe mbrojtjen e pakushtëzuar të së drejtës së origjinalit të autorit.

Rastet kur *të drejtat e botuesit janë parashikuar me karakter prevalues ndaj atyre të autorit* e lënë në pikëpyetje autorësinë dhe origjinalitetin[20]. Absurdi thellohet edhe më tej, kur *botuesit i njihet e drejta e shpërblimit*, ashtu sikurse dhe autorit, ndërkohë që ligji duhej të ishte shprehur qartë *për dallimin thelbësor të veprimtarisë botuese si shërbim tregu dhe së drejtës së autorit si e drejtë shpërblimi*. Për më tepër që ligji e ka përjashtua konceptin relativizues që gjendet në të gjitha konventat ndërkombëtare, sipas të cilave teorikisht *autori mbetet gjithnjë i pashpërblyer sipas meritës*, prandaj përftesat financiare të tij quhen thjesht *honorare* (*honorarium*), shpërblim nderi.

Këto dhe detaje të tjera do të ishte me vend të merreshin në konsideratë në rastin e një amendimi të Ligjit 35/2016.

Bibliografi

1. Ligji nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to".
2. Direktivat e Parlamentit Europian dhe Këshillit.
3. *Kodi europian i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*, *All European Academies* (ALLEA), Berlin 2017.
4. *Manuale sulla misura delle attività scientifiche e tecniche - Manuale di*

ose rishikimit, me kusht që një përdorim i tillë të jetë në përputhje me praktikën e drejtë dhe në masën e kërkuar për qëllimin konkret që kërkohet të arrihet.

[18] Neni 62, pika 1: Nëse një dorëshkrim ose një material tjetër origjinal i veprës shkatërrohet pas dorëzimit të tij te botuesi, për shkak të një force madhore, autori ka të drejtën e shpërblimit, e cila do të paguhej për autorin vetëm nëse vepra do të ishte botuar.

[19] Neni 61: Botuesi është i detyruar të lejojë autorin të bëjë ndryshime në çdo botim të ri, me kusht që këto ndryshime të mos rrisin ndjeshëm shpenzimet e botimit dhe të mos ndryshojnë, në mënyrë të dukshme, karakterin e veprës.

[20] Neni 118: Botuesit kanë të drejtën e tyre për shpërblim të arsyeshëm për çdo riprodhim të botimeve të tyre me shkrim për përdorim personal privat ose përdorim tjetër personal, në mënyrë të barabartë me të drejtën e autorit për shpërblim, sipas parashikimit në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

Frascati, OSCE.
5. Donard Hasani, *Vepra e dramatizuar: midis letërsisë dhe teatrit*, bot. *Naimi*, Tiranë 2015
6. Fatos Lubonja, *Ja pseudonimi i Ismail Kadaresë në diktaturë*, në *Shqiptarja*, 22 shtator 2017;
7. Fatos Lubonja, *Ju tregoj pseudonimin e Kadaresë në diktaturë*, në *Shekulli*, 22 shtator 2017;
8. *Demaliaj polemikë me Dervishin dhe Loloçin: Mësohuni me lirinë, jo si pronarë dosjesh, por …* në *Dita*, 23 gusht 2017.

Dr. Eriona VADINAJ, Msc. Drilona LULI

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI ZHVILLIMIN E SISTEMIT FISKAL NË SHQIPËRI

Abstrakti

Pas rënies së sistemeve komuniste në shtetet ballkanike në rrethana mjaft specifike, filloi procesi i reformimit të sistemeve fiskale në kuadër të tranzicionit ekonomiko-shoqëror. Në vendin tonë ky reformin është ende në proces dhe duke u ballafaquar me sfida të shumta, të udhëhequra nga aspirimi per të qenë sa më afër standardeve europiane.

Ndryshimet e shumta që pësoi vendi ynë si ato politike, sociale dhe ekonomike, krijuan nevojën imediate të rishikimit të menjëhershëm të politikave buxhetore dhe fiskale, ku aktet e para ligjore për vendosjen e sistemit tatimor e kanë fillesën e tyre në vitin 1991, periudhë që përkon me hartimin e legjislacionit tatimor në vend. Aktualisht, legjislacioni tatimor përbëhet nga një paketë ligjesh, rregulloresh, udhëzimesh si dhe marrëveshjesh tatimore në lidhje me taksat dhe tatimet, për mënyrën dhe procedurat e vendosjes së këtyre taksave dhe tatimeve, nivelin e tyre, procedurat e vlerësimit dhe mbledhjes së detyrimeve tatimore, si dhe format dhe metodat e kontrollit tatimor. E thënë ndryshe, Shqipëria operon sipas sistemit "code law", që nënkupton një vend ku standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar për efekte fisku janë të rregulluara me ligj.

Fjalët kyçe: reformë, ndryshime, legjislacion tatimor, rregulla tatimore, tatimpagues.

A GENERAL OVERVIEW OF THE DEVELOPMENT OF THE FISCAL SYSTEM IN ALBANIA

Abstract

The purpose of this paper is to give a short description of the development of the fiscal system operating in Albania and its legal framework.

After the collapse of the communist systems in Balkan, in very specific circumstances, the reforming process of the fiscal system started to be put into practice. In our country, this reform is still in process and is been facing with many challenges, inspired and leaded by the aspiration to be closer to European standards.

Our country has been faced with many changes, such as political, social and economic changes, enforced by the immediate need to revise the fiscal and budget policies. The first legal acts for establishing the tax system have their beginnings in 1991, a period that coincides with the drafting of tax legislation. Actually, tax legislation consists of a set of laws, regulations, guidelines, tax arrangements regarding taxes, duties and procedures for setting and collecting such taxes. Shortly, Albania operates under the "code law" system, which implies a place where accounting standards and financial reporting for fiscal effects are regulated by law.

***Keywords**: reform, changes, fiscal regulation, fiscal system, taxpayers*

1.1 Zhvillimet e sistemit tatimor në Shqipëri

Pas rënies së sistemeve komuniste në shtetet ballkanike në rrethana mjaft specifike, filloi procesi i reformimit të sistemeve fiskale në kuadër të tranzicionit ekonomiko-shoqëror. Në vendin tonë ky reformin është ende në proces dhe duke u ballafaquar me sfida të shumta që kërkojnë patjetër efiçence dhe efektivitet të lartë, të udhëhequr nga aspirimi per të qenë sa më afër standardeve europiane.
Gjatë dy dekadave të fundit, vendi ynë ka pësuar ndryshime të mëdha. Ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike krijuan nevojën imediate të rishikimit të menjëhershëm të politikave buxhetore dhe fiskale. Patjetër që edhe sistemi ynë fiskal është bërë pjesë e ketyre ndryshimeve, gjë e cila ka dhënë impaktin e vet edhe në raportimin e njësive ekonomike.
Vështirësitë drejt reformimit të sistemit tatimor ishin të shumta, kjo për disa arsye[1]:

- Gjendja e ekonomisë dhe e financave ishte në krizë të thellë, gjatë periudhës 1991-1992, kjo edhe si rezultat i një mungese totale të kuadrit ligjor rregullues në fushën ekonomike
- Psikologjia e kultivuar për vite me rradhë se Shqipëria ishte i vetmi vend në botë pa taksa dhe tatime.
- Mungesa e njohurive apo të një formimi të caktuar.

[1] Mateli, A., 2013. "*Sistemi Tatimor në Shqipëri*".

Në Shqipëri, aktet e para ligjore për vendosjen e sistemit tatimor fillesën e tyre e kanë në vitin 1991, periudhë që përkon me hartimin e legjislacionit tatimor në vend, i cili u konkretizua me shpalljen në janar të vitit 1992 dhe më pas me nxjerrjen e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" më 14 korrik 1992. Pra konturimi i legjislacionit fiskal dhe përcaktimi i llojit, bazës së taksueshme dhe tarifave tatimore, i përkasin fundit të vitit 1991 dhe fillimit të 1992. Parlamenti, në janar 1992, miratoi një paketë ligjore tatimore, e cila krijoi bazën e nevojshme ligjore në fushën e tatimeve dhe taksave. Legjislacioni tatimor, i cili filloi të zbatohej në vitin 1992, mund të konsiderohet si themeli i sistemit tatimor modern[2].

Në këtë periudhë krahas tatimeve të tilla si akcizat, tatimi mbi qarkullimin, tatimi mbi fitimin dhe mbi biznesin e vogël, filloi dhe implementimi i tatimit mbi të ardhurat personale(TAP), kryesisht nga pagat. Nisur nga mungesa e përvojës në hartimin e legjislacionit fiskal, ligjet e hartuara në këtë periudhë ishin të thjeshtë dhe jo të komplikuar.

Fillimisht u hartuan këto ligje:

1. Ligji mbi fitimin i miratuar në janar 1992, përmirësuar në mars 1993, në të cilin u implementua për herë të parë sistemi proporcional i vjeljes së tatimeve, që teorikisht dhe praktikisht njihet se synon nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së lirë ekonomike dhe private[3].
2. Ligji për tatimin mbi qarkullimin si tatim i tërthortë njëfazor, që u zbatua për produktin e gatshëm që hidhej në qarkullim të lirë civil brenda vendit. Ky ligj i paraprinte TVSH (tatimit mbi vlerën shtuar).
3. Ligji për Investimet e Huaja, miratuar në nëntor të vitit 1993, i cili trajtonte në mënyrë të barabartë investitorët të huaj dhe vendas[4].

Sipas Mateli (2013) dhe Ngjela (2015), në mënyrë të përmbledhur, për të dhënë një pamje sa më konçize të ndryshimeve në legjislacionin tatimor që kanë ndodhur në Shqipëri prej më shumë se dy dekadash, reformat fiskale mund të grupohen në gjashtë periudha:

1. ***Periudha 1991-1993:*** fillimet e sistemit tatimor, hartimi dhe miratimi i paketës fiskale dhe futja e instrumenteve të ekonomisë së tregut në ekonominë e vendit. Karakteristikë për vitet e para të kësaj periudhe ishte mungesa e politikave tatimore dhe sistemit tatimor, mungesa që duheshin kapërcyer me synim zgjerimin e sektorit privat dhe nxitjen e reformës tatimore.

Në mënyrë të përmbledhur karakteristikat e kësaj periudhe paraq-

[2] Koli, R., Hilmia, S., 1996, "*Shkenca mbi Financat dhe e Drejta Financiare"*, pp 18.

[3] Ligji nr.7677, datë 03.03.1993, "*Për Tatimin mbi të Ardhurat në RSH*".

[4] Ligji, Nr.7594, datë: 04.08.1992, *"Për investimet e huaja"*.

iten si më poshtë[5]:

- Mungesë e legjislacionit tatimor.
- Mungesë e specializimit në administratën tatimore.
- Mungesë e proçedurave të shkruara të punës për t'u ndjekur nga punonjësit e administratës tatimore.
- Përmbushja e objektivit të mbledhjes së të ardhurave tatimore pa një bazë të dhënash.
- Ekziston një ekonomi e konsiderueshme "jo formale".
- Llogaritja e të ardhurave dhe vendosja e tatimit bëhet nga punonjësit e tatimeve dhe ka pak interes për zbatimin e sistemit të vetllogaritjes së tatimit.
- Mungesë kontrolli për parandalimin e korrupsionit.
- Bashkëpunimi ndërmjet administratës tatimore dhe organeve të tjera shtetërore i ulët.
- Mungesë edukimi dhe ndihme për tatimpaguesin.
- Mungesë trajnimi.

2. ***Periudha 1994-1996:*** implementimi i legjislacionit tatimor dhe vendosja e tatimeve dhe taksave. Karakteristikat e kësaj periudhe paraqiten shkurtimisht si mëposhtë[6]:
   - Ruajtje e tipareve të sistemit tatimor të viteve 1991-1993.
   - Riorganizimi organeve tatimore dhe impelementimi i funksioneve të reja.
   - Ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin tatimor.
   - Rritje e numrit të subjekteve të regjistruara.
   - Rritje e barrës tatimore.
   - Falje e detyrimeve të papaguara.
3. ***Periudha 1997-1998***: stabilizimi i të ardhurave tatimore me objektiv frenimin e rënies së tyre, kapërcimin e krizës ekonomike dhe financiare të krijuar nga firmat piramidale në vitin 1997.
4. ***Periudha 1999-2001***: konsolidimi i sistemit tatimor dhe të ardhurave tatimore, të cilat ranë ndjeshëm pas ngjarjeve të vitit 1997. Paketa ligjore që zbatoi shteti shqiptar gjatë këtyre viteve, në thelb dhe përmbajtje përmirësoi sistemin tatimor të mëparshëm, duke aplikuar elementë të sistemit tatimor modern dhe metoda të reja në fushën e tatimeve dhe taksave[7]. Paketa lig-

[5] Angjeli, A., 2007. "*Ditari Tranzicionit Ekonomik"*, botuar nga "Instituti për Reforma dhe Zhvillim", pp.265.

[6] Preçi Z., 1999. "*Probleme të rritjes ekonomike në Shqipëri",* QSHKE, pp. 120.

[7] Kajsia B., 2014. "*A Discourse Analysis of Corruption, Instituiting Neoliberalizm*

jore u konceptua duke ruajtur sistemin e mëparshëm tatimor që mbështetej në themelin e dy grupeve të rëndësishme të tatimeve; tatimet indirekte dhe tatimet direkte.

Kjo periudhë karakterizohet nga:

- Hartimi i një legjislacioni tatimor modern me ndihmën e asistencës së huaj.
- Futje e elementëve të rinj në taksim si tatimi mbi vlerën e shtuar, akciza, tatimi mbi të ardhurat, tatim fitimi etj.
- Rritje e efektivitetit të administratës tatimore.
- Përmirësime të administrimit të tatimeve.
- Qëndrueshmëri dhe rritje e të ardhurave publike.

5. ***Periudha 2002-2006:*** krijimi i klimës makroekonomike për zhvillim dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet përmirësimit të marrëdhënieve me biznesin dhe rritjen e shërbimit të administratës tatimore ndaj tatimpaguesve dhe publikut.

   Me asistencë të PriceWaterhouese-Coopers u hartua dhe miratua ligji Nr.8976, datë 12.02.2002 "Për akcizat". Ndryshimet që ndodhen në sistemin tatimor, falë ndihmës dhe asistencës së huaj, i dhanë një pamje më të plotë dhe të re legjislacionit fiskal duke krijuar lehtësi më të mëdha për investimeve në vend dhe biznesit në tërësi.
6. ***Periudha 2007-2015***, ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit tatimor duke synuar:
   - Reduktimin e korrupsionit nëpërmjet futjes së deklarimit elektronik.
   - Ngritjen e strukturës antikorrupsion.
   - Rritjes së informacionit dhe ndihmës teknike për tatimpaguesit, duke përmirësuar klimën me biznesin në Shqipëri.

1.2 Legjislacioni tatimor dhe nevoja për raportim

Shqipëria operon sipas sistemit "code law", që nënkupton një vend ku standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar për efekte fisku janë të rregulluara me ligj. Legjislacioni tatimor përbëhet nga një paketë ligjesh, rregulloresh, udhëzimesh si dhe marrëveshjesh tatimore në lidhje me taksat dhe tatimet, për mënyrën dhe procedurat e vendosjes së këtyre taksave dhe tatimeve, nivelin e tyre, procedurat e vlerësimit dhe mbledhjes së detyrimeve tatimore, si dhe format dhe metodat e kontrollit tatimor.

Legjislacioni tatimor përmban rregulla, se si duhet të realizohet raportimit financiar për efekt fisku, të cilat janë të zbatueshme si nga njësitë ekonomike

Against Corruption in Albania 1998-2005", South East Europian Study, Ashgate Publishing, pp. 159.

ashtu edhe nga organet tatimore. Më poshtë listohen disa prej tyre:

- ***Ligji nr.7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet",* i ndryshuar,** në të cilin përcaktoheshin rregullat bazë dhe detyrimet që do zbatoheshin nga njësitë ekonomike. Ky ligj paraqiste mënyrën e dokumentimit dhe mbajtjes së llogarive për efekt të tatimit mbi qarkullimin, tatimin mbi biznesin e vogël dhe tatime tjetra.
- ***Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",*** si edhe Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar, kanë për qëllim rregullimin e proçedurave për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe paraqitjen e parimeve të organizimit të funksionimit të administratës tatimore. Në seksionin I të kreut VI të këtij ligji, përcaktohen detyrimet për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive *për qëllime tatimore*. Ndërsa në seksionin III të kreutVI të këtij ligji thuhet që të gjitha njësitë ekonomike duhet *të mbajnë kontabilitetin në perputhje me dispozitat e Ligjit nr.9228,* datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me aktet e nxjerra në zbatim të tij.
  Udhëzimi synon:

  - Unifikimin dhe vendosjen e standarteve bashkëkohore për të garantuar konkurrencë të ndershme.
  - Trajtim të barabartë e të paanshëm.
  - Transparencë në zbatimin korrekt dhe në menyrë uniforme të procedurave dhe rregullave të vendosura, duke ruajtur njëkohesisht ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve dhe të administratës tatimore.

Rregullat dhe procedurat e administrimit tatimor të vendosura në këtë Udhëzim synojne qartësimin e kuptimit të dispozitave të ligjit *për të garantuar një zbatim korrekt dhe uniform të tyre,* për të siguruar administrimin e tatimeve dhe taksave me një kosto sa më të ulët për administratën tatimore dhe për tatimpaguesin, *nëpërmjet nxitjes së vetë-vleresimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit,* nëpërmjet *edukimit të tatimpaguesve* dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme të bazuara në analizën e riskut.

- ***Ligji nr.8438, datë* 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar***
  Me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.
  Objekt i tatimit mbi të ardhurat janë të ardhurat personale të individëve, fitimi i personave fizikë e juridikë subjekte të këtij Ligji, si dhe të ardhurat

për të cilat mbahet tatimi në burim. Në këtë ligj përcaktohet shpenzimet e njohura dhe të panjohura për efekt të llogaritjes së tatim fitimit dhe në nenin 22 trajtohet amortizmi dhe normat përkatëse sipas kategorive të aktiveve të AAM dhe AAJM.

Duhet vënë theksi te neni 19 i këtij ligji ku thuhet: "fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin ***"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".***

Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin tatimor kanë sjellur konfuzion te tatimpaguesit. Ndërsa mungesa e informacionit, apo marrja me vonesë e tij ka sjellë jo vetëm problemin e mosrespektimit të legjislacionit nga ana e bizneseve, por edhe probleme në marrëdhëniet jokorrekte midis bizneseve dhe punonjësve të administratës tatimore, duke favorizuar mundësitë për mitmarrje dhe korrupsion. Bizneset me të drejtë mendojnë se ndryshimet në legjislacionin fiskal duhet të jenë jo të shpeshta dhe sektorit privat ato duhet t'i bëhen të njohura në kohën e duhur. Çdo ndryshim në legjislacionin fiskal duhet të realizohet nëpërmjet konsultimeve me grupet e interesit.

1.3 Konkluzione

1. Sistemi tatimor në Shqipëri ka njohur një zhvillim shumë të madh gjatë viteve të fundit, kjo edhe si rezultat i ndryshimeve e shumta që ka pësuar vendi ynë si ato politike, sociale dhe ekonomike, të cilat krijuan nevojën imediate të rishikimit të menjëhershëm të politikave buxhetore dhe fiskale
2. Aspirimi per të qenë sa më afër standardeve europiane, ka dhënë impaktin e vet edhe në rregullimin e sistemit fiskal konform rregullave dhe standardeve bashkëkohore, duke patur si qëllim transparencën, konkurrencën e ndershmë dhe trajtimin e barabartë dhe të paanshëm të tatimpaguesve.
3. Shqipëria operon sipas sistemit "code laë", që nënkupton një vend ku standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar për efekte fisku janë të rregulluara me ligj.
4. Legjislacioni tatimor në Shqipëri përmban rregulla se si duhet të realizohet raportimit financiar për efekt fisku, të cilat janë të zbatueshme si nga njësitë ekonomike ashtu edhe nga organet tatimore.
5. Legjislacioni tatimor duhet të jetë i thjeshtë, efektive dhe homogjen, në përputhje me nevojat e tatimpaguesve dhe që të sigurojë stabilitet në terma afatgjatë.

Bibliografia

1. Aisbitt, S., (2002): "*Tax and accounting rules: some recent developments"*. European Business Review, Vol. 14: 92-97.
2. Ayers, B., Jiang, X., Laplante, S., (2009): "*Taxable income as a performance measure: the effects of tax planning and earnings quality"*. Contemporary Accounting Research, Vol 26: 15-54.
3. Angjeli, A., (2007): "*Ditari Tranzicionit Ekonomik"*. Botuar nga "Instituti për Reforma dhe Zhvillim", pp.265, Tiranë.
4. Cuzdriorean, D. (2010): "*The relationship between accounting and taxation: A brief international literature review"*. Analele Universită□ii din Oradea, Vol 1: 496-502
5. Cuzdriorean-Vladu D., Albu N.C., Fekete Sz., (2011): "*A longitudinal analysis regarding the evolution of profit tax regulations in Romania - an empirical view"*. Annals of the University of Oradea, Economic Science Series, Vol 20(1): 594-601
6. Fekete Sz., Cuzdriorean, D., Albu, C. and Albu, N. (2011): "*Is indeed SMEs accounting influenced by taxation? Some empirical evidence from Romania"*. Paper presented to the 5th AAC Conference, 21-23 September.
7. Kajsia B., (2014): "*A Discourse Analysis of Corruption, Instituiting Neoliberalizm against Corruption in Albania 1998-2005"*. South East Europian Study, Ashgate Publishing, pp. 159.
8. Koli, R., Hilmia, S., (1996): "*Shkenca mbi Financat dhe e Drejta Financiare"*. Tiranë
9. Lamb, M., Lymer, A., (1999): "Taxation Research in an Accounting Context: Future Prospects and Interdisciplinary Perspectives",The European Accounting Review, Vol 8(4): 749-776.
10. Mateli, A., (2013): "*Sistemi tatimor në Shqipëri"*. PhD Dissertacion, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2013.
11. Preçi, Z., (1999): "*Probleme të rritjes ekonomike në Shqipëri"*. QSHKE, pp. 120, Tiranë.
12. Qurku, R., (2013): "*Shoq*ëritë shqiptare përballë raportimit realitetit të dubluar financiar dhe fiskal". PhD Dissertacion, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014.

Dr. KLEMENTINA NGJEÇI, Dr. BLERTA AVDIA

TRASHËGIMIA KULTURORE NË KURRIKULËN E GJIMNAZIT

Abstrakt

Në kushtet rritjes së shpejtë të proçeseve globalizuese në botë lind nevoja e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore si vlerë identifikuese të diversitetit të popujve.

Në artikull trajtohet rëndësia e trashëgimisë kulturore në kurrikulën e gjimnazit si domosdoshmëri jo vetëm e njohjes së nxënësve me vlerat e saj, por si detyrë e përgjegjësi për konservimin e trashëgimisë kulturore materiale e shpirtërore ndër breza.

Që nga viti 2010 trashëgimia kulturore u bë pjesë e kurrikulës së gjimnazit si lëndë me zgjedhje të detyruar, por pas ndryshimeve që pësoi kurrikula e gjimnazit ne vitin 2014 trashëgimia kulturore ngeli në kuadrin e modulit lëndor.

Ky artikull mbyllet me konkluzione në lidhje me rëndësinë që ka trashegimia kulturore në edukimi, madje që ne cikle më të hershme se gjimnazi.

Fjalë kyçe: trashëgimi kulturore, kurrikul e gjimnazit, kurrikul me zgjedhje, trashegimi materiale, trashëgimi shpirtërore etj

I. Kuptimi i trashegimisë kulturore dhe vlerat e saj

Origjina e konceptit trashëgimi lidhet me themelimin e organizatës së UNESCO-s. Ky koncept i kushtohet njohjes dhe popullarizimit të vlerave më të spikatura të krijuara nga natyra dhe njerzimi ndër vite duke lidhur në një te vetme vlerat natyrore dhe humane. Trashëgimia kulturore është vlere e krijuar nga shoqeria njerzore ndër shekuj e percjellë ndër breza me rendësi ndërkombëtare e kombëtare etj. Trashëgimia kulturore është e përbërë nga vlera materiale dhe shpirtërore.

Trashëgimia kulturore materiale është e përbërë nga monumentet, grupet e ndërtesave dhe sitet. Sipas konventes se UNESCO-s " Për trashëgiminë

kulturore"[1] monumentet janë të gjitha veprat e arkitekturës, veprat e arteve pamore, objektet arkeologjike, mbishkrimet, vendbanimet e shpellave, që sherbejnë si vlera universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës. Grup ndërtesash, janë grup ndërtimesh ose ndërtime të përveçme të cilat për shkak të arkitekturës, homogjenitetit të tyre janë të një vlere të jashtzakonshme universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës. Stitet janë të gjitha ato vepra të njeriut ose frytet e përbashkëta në mënyrë të ndërthurur të punës së njeriut dhe natyrës dhe zona që përfshijnë parqet arkeologjike të cilatë kanë vlera universale në këndvështrim të historisë,
artit dhe shkencës.
Trashëgimia kulturore materiale përbëhet nga;

a. Trashëgimia kulturore materiale e paluajtshme,
b. Trashëgimia kulturore materiale e luajtshme[2].

Në trashëgiminë kulturore materiale të paluajtshme bëjnë pjesë ndërtime me vlera arkitekturore, objekte banimi, kulti apo inxhinirike si dhe hapësira e sheshe publike. Në to përfshihen monumente të veçanta apo në grup në gjendje të plotë apo rrënoja dhe që dalin në pah si rrjedhojë e gjurmimeve dhe gërmimeve arkeologjike. Pjesë e trashegimisë kulturore materiale janë vepra të veçanta apo ansamble urbane, rurale, historike, arkitekturore ose etnologjike.
Në trashëgiminë kulturore materiale të luajtëshme bëjnë pjesë objekte funksioni dhe stabiliteti i të cilave nuk lidhet me në një vend të caktuar në hapësirë, por integriteti i tyre ruhet dhe pas zhvendosjes në vende të tjera nga ai i origjinës. Në to bëjnë pjesë objekte të levizshme arkitektonike, objekte arkelogjike, krijime artistike të të gjitha llojeve, arkiva, dorshkrime dhe botime me vlera të veçanta historike, koleksione numuzmatike, filatelike e të artit, vegla pune të përdorimit të përditshëm me vlera te veçanta artizanale, etnografike dhe historike të vëna në mbrojtje shtetërore.
Trashëgimia kulturore shpirtërore (jo materiale) i përket botës shpirtërore e tillë si; përdorimi i gjuhës, krijimtaria gojore, traditat, zakonet, besimet, njohuritë, mardhëniet njerzore, preceptimet për botën, folklori vokal, koreografik apo instrumental etj. Trashëgimia kulturore shpirtërore është pjesë e formimit tonë të brendshëm si pjestar të një shoqërie të caktuar, të qëndrimit që mbajmë dhe preceptimit të botës fizike.

[1] Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore UNESCO 1972

[2] Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore UNESCO 1972

II. Trashëgimia kulturore në vendin tonë dhe legjislacioni për mbrojtjen e saj

Shqipëria dallohet për larmishmërinë e vlerave të trashëgimisë kulturore me rëndesi unikale, kombëtare, rajonale etj.
Në vendin tonë trashëgimia kulturore materiale përfaqësohet nga;

- monumentet arkeologjike
- monumentet historike
- monumentet arkitekturore
- monumentet artistike
- monumente fetare
- monumente etnografike me rëndësi kombëtare dhe jo vetëm.

Trashëgimia kulturore shpirtërore në vendin tonë përfaqësohet nga përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare, ruajtja e folklorit gojor, të shkruar ose të regjistruar, folklorin vocal, koreografik dhe atë instrumental, zakone dhe doke tradicionale, besime dhe bestytni të traditës si dhe zejet e ndryshme tradicionale.
Në larmishmërinë e vlerave të trashëgimisë kulturore në vendin tonë krahas objekteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi kombëtare dallohen dhe prania e monumenteve kulturore me rëndësi ndërkombëtarë që mbrohen nga UNESCO dhe konventa për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore të cilën e ka ratifikuar dhe Shqipëria.
Monumentet kulturore që kanë rendësi universale dhe mbrohen nga UNESCO në Shqipëri janë[3];

- Parku kombëtar i Butrintit (pasuri kulturore e njerzimit) që nga viti 1992 është pjesë e listës botërore të trashëgimisë dhe përfaqëson një ansambël monumental me vlera arkeologjike, arkitektonike dhe artistike që ndërthuren me një bukuri të florës dhe faunës.
- Qyteti muze i Gjirokastrës (pasuri kulturore e njerzimit) që nga viti 2005 është pjesë e listës së trashëgimisë botërore si një sit unikal me vlera të spikatura historike dhe kulturore në fushën e trashëgimisë kulturore të paluajtëshme.
- Qyteti muze i Beratit (pasuri kulturore e njerzimit) u bë pjesë e listës botërore të trashëgimisë në vitin 2008 ka ngjashmëri nga pikpamja arkitekturore me qytetin muze të Gjirokastrës dhe pranimi i tij quhet "pranim në seri".

3 IZHA. Program I modulit lëndor Trashëgimia kulturore. Tiranë 2014

- "Iso-polifonia popullore shqiptare" që nga viti 2005 bën pjesë në listën e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerzimit" dhe përqafëson një dukuri të jashtëzakonshme të konceptuarit dhe komunikimit njerëzor.
- Kodikët e Berati janë libra me përmbajtje fetare të shkruar në përgamenë dhe në Shqipëri janë Kodiku i artë dhe i purpurt të shkruar në gjuhen greke me shkronja të vogla të kuqe dhe të arta dhe përmbajnë pjesë nga ungjijtë, që nga viti 2005 janë "Kujtesë e botës" dhe mbrohen nga UNESCO.

Por duhet theksuar se për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është e domosdoshme mbështetja ligjore dhe institucionale. Ligji aktual "Për trashëgiminë kulturore " është ligji 9048 i vitit 2003 i ndryshuar në vitin 2006 dhe 2008 është më i pranuari dhe gjithëpërfshirës. Ndër institucionet kombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë Ministria e kulturës, insituti i monumenteve të kulturës, insituti i arkeologjisë, insituti i kulturës popullore, qendra kombëtare e inventarizimit të pasurive kulturore dhe shkolla.

III. Trashëgimia kulturore në programet e gjimnazit

Trashëgimia kulturore përmes bukurisë dhe vlerave të spikatura historike, monumenteve të rëndësishme përfshijnë edukimin me nje kulturë qytetare ndërevropiane dhe ndikon në krijimin e përsonalitetit si qytetarë të botës. Krahas të tjerash edukimi përmes trashëgimisë forcon ndjenjën e identitetit kulturor në rritjen e rrespektit dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, integrimin e saj në jetën bashkëkohore të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Nisur nga ky këndvështrim u pa e nevojshme edukimi përmes trashëgimisë, që nga viti 2007 trashëgimia kulturore është pjesë e kurrikulës së gjimnazit fillimisht në kuadër të lendës së gjeografisë. Aty një kapitull i veçantë i kushtohej trashëgimisë kulturore me konceptin e trashëgimisë dhe vlerat ndërkombëtare e kombëtare që bartë ajo dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për vlerat e trashëgimisë.

Ndryshimet që pësoi kurrikula në vitin 2010 trashëgimia kulturore tashmë zhvillohej si kurrikulë me zgjedhje në klasën e 10 lëndë e veçantë "Trashëgimia jonë kulturore" dhe në klasën e 11 "Trashëgimia kulturore evropiane". Përmes studimit të trashëgimisë synohej aftësimi i nxënësve jo vetëm për njohjen e aspekteve teorike të trashëgimisë por dhe të aktivizojë nxënësit në veprimtari praktike për evidentimin e vlerave të trashëgimisë dhe mbrojtjen e këtyre vlerave. Tashmë me kurrikulen e re të gjimnazit (viti2014) trashëgimia kulturore zhvillohet në kuadër të modulit lëndor dhe synon aftësimin i nxënësve në njohjen

dhe përvetësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të krijuara në shekuj nga populli ynë dhe popujt e tjerë të botës. Zhvillimi i modulit ndihmon fuqimisht formimin dhe edukimin qytetar të brezit të ri, i cili duhet të njohë, të respektojë, mbrojë dhe të pasurojë vazhdimisht vlerat më të spikatura të kulturës së vendit të tij dhe të vendeve të tjera në botë.

Përfundime

Edukimi përmes trashëgimisë kulturorë është si një risi në programet e lëndëve shoqërore duke shërbyer për thellimin e njohurive në gjithë spektrin e fushës së trashëgimisë kulturore (materiale dhe shpirtërore), veçoritë e tyre dhe do ndërlidhë teorinë dhe vlerat e saj me konkrektizimin në praktikë dhe në raport me turizmin, mjedisin dhe edukimin ligjor për konservimin e saj.
Trashëgimia na mëson gjithashtu se jeta moderne nuk mund të jetë kontraditë me të shkuarën por ndërlidhja e trashëgimisë kulturoe të re dhe e vjetër urbane e qyteteve është një nga më të pasurat e trashëgimisë kulturore.
Edukimi përmes trashëgimisë kulturore synon jo vetëm të ndërgjegjësojë nxënësit për vlerat që bart por dhe të promovojnë vlerat e trashëgëmisë, e mira do ishtë që trashëgimia kulturore si lëndë të bëhej pjesë e programeve më të hershme se gjimnazi.

Burimet e shfrytëzuara

1. Konventa për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe njerzore, UNESCO 1972
2. IZHA. Programi lëndore për trashëgiminë kulturore, Tiranë 2010
3. IZHA. Programi i modulit lëndor për trashëgiminë kulturore, Tiranë 2014
4. Ligji 9048 “Për trashëgiminë kulturore”, Tiranë 2003
5. https://en.unesco.org/
6. IZHA. Udhëzim për kurrikulën e gjimnazit, Tiranë 2010

Mr.sc. Riza FAZLIU

VËSHTRIM MBI RRUGËT MESJETARE TË KOSOVËS LINDORE

Anamorava përfshin pjesë të luginës dhe skajet malore të maleve të Karadakut në anën e djathtë dhe malet e Zhegocit në anën e majtë. Anamorava përbëhet prej tri fushave, të Vitisë, të Dardanës (Kamenicës) si dhe të Gjilanit, si qendër e Anamoravës. Territori i Kosovës (ku edhe bën pjesë Anamorava) ishte boshti kryesor i kryqëzimit të rrugëve që gravitonin nga veriu në jug dhe nga perëndimi në lindje. Rrjetin rrugor e përmbajnë hapësirat e caktuara për lëvizjen e njerëzve apo mjeteve të ndryshme që lidhen në pikat gjegjëse.

Rrugët e vjetra romake në territorin e Anamoravës, kishin në aspektin organizativ dhe teknik organizim ushtarak, ku gjurmëve të këtyre rrugëve nuk iu shmangën tregtarët edhe gjatë shekujve të Mesjetës. Rrjeti i rrugëve kishte shtrirje, varësisht nevojave strategjike të eksploatimit. Në Mesjetë, rrjeti rrugor zhvillohej përmes organizimit tregtar në pikat e caktuara. Interesimi i tregtarëve të jashtëm sidomos të Raguzës, Venedikut dhe Kotorrit për territorin e Kosovës, sidomos të Anamoravës, ishte shumë i madh, ashtu që nuk zgjidheshin rrugë e mjete me qëllim të shfrytëzimit të pasurive të kësaj zone.

Rrjeti i rrugëve dytësore në Regjionin e Anamoravës gjatë Mesjetës

Meqë rrugët kryesore nuk kalonin nëpër vendbanime të Anamoravës, u shtrua nevoja dhe kërkesa e tregtarëve për një linjë më të shkurtër, kështu që nëpër vargmalet e Karadakut dhe Gollakut si dhe rrafshin e Anamoravës filluan të shtrihen disa rrugë dytësore me karakter tregtar.

Ky rrjet rrugësh paraqitet më tepër në shekujt XIII dhe XIV, në kohën kur në këtë regjion ishte e zhvilluar shumë xehetaria, si në Novobërdë,1 Janjevë4dhe në disa vendbanime tjera. Ndërtimi dhe përmirësimi i këtyre rrugëve ishte i domosdoshëm dhe i leverdishëm, sepse intensivisht shfrytëzohej pasuria nëntokësore e kësaj ane. Rrugë të këtilla filluan të shtrihen nëpër malet e Karadakut dhe Gollakut me qëllim të shkurtimit dhe rrugëtimit më të sigurt të mallrave tregtare.

[1]Tatomir Vukanovic. *Srbi na Kosovu* (Vranje, 1986), p. 142.

Rruga e Moravës së Binçës ishte një shkurtesë që lidhte Ulpianën me Shkupin përmes Karadakut të Shkupit. Kjo përmendet edhe në Kristobulën e Shën Arkangjelit të Prizrenit, ku në këtë rrugë kalonin edhe sasët.5 Në shkencën e Antropografisë kjo rrugë është përshkruar edhe më në detaje dhe si e tillë është shpallur si rrugë e Shkupit, e cila ndahej nga rruga e Ferizajt dhe Gjilanit në fshatin Radivojcë dhe pastaj në Viti, Binçë, Kurbeliq, Bilaq, Relan, Çukarkë, Brezë, Orizare, Hasanbeg dhe kalonte në Shkup6 meqë Shkupi ishte qendër e njohur tregtare në Ballkan.

*Rruga Prishtinë për Gjilan***,** kryqëzohej me të gjitha rrugët që kalonin përmes këtij vendbanimi.7 që shpinte nëpër vendbanimin Mramor dhe vazhdonte rrjedhës së lumit Bresalc deri në Gjilan dhe përshkonte Luginën e lumit Morava drejt për në Vrajë.

Rrugë Gjilanit për në Prishtinë, fillonte nga Gjilani, vazhdonte në vendbanimet Zhegoc, Sllovijë, Dobrotin, Graqanicë dhe kryqëzohej me Prishtinën.8

Rruga e cila shpinte prej Gjilanit për në Ferizaj ishte rrugë e drejtë pa lakesa ku kësaj rruge i bashkoheshin edhe rrugët lokale të vendbanimeve gjatë vazhdimit deri në Ferizaj.9

Rruga e Shkupit, sipas të dhënave, duhej të ketë filluar nga fshati Radivojcë, i cili shtrihet në kilometrin e dhjetë të rrugës mjaft frekuentuese regjionale Gjilan-Ferizaj dhe lidhte këto dy vendbanime me një pikë horizontale.

Që në fillimin e kësaj rruge paraprakisht u bashkoheshin edhe disa rrugë të rendit të dytë nga fshatrat përreth për të kaluar në anën tjetër të lumit Morava. Rruga kalonte në fshatin Binçë, në një gjatësi prej rreth pesë kilometrash nga Radivojci. Deri në këtë fshat rruga ishte e rrafshët, kurse prej këndej nëpër luginë është rrugë malore afër burimit të Moravës së Binçës, duke u shtrirë pingul për në fshatin Kurbeliq,10fshat i cili gjendet në malet e Karadakut. Rruga nga fshati Binçë drejt Kurbliqit është shkëmbore, si dhe rezistente nga dëmtimet e ujërave të paktë. Gjerësia e kësaj rruge ishte rreth tri metra kurse vende vende edhe dy metra. Nga Binça ndahej edhe një rrugë tjetër e cila pas disa kilometrash përsëri bashkohej në Kuqevishtë me këtë rrugë. Në Kurbeliq bashkohen me disa rrugica të vendbanimeve rrëzë Karadakut si ajo e Beguncës, Kopilaqës dhe Tanishecit.

---

[5] M.Blagojevic, *Zemljoradnja u srednjovekovnoj Srbiji* (Beograd, 1973), pp. 172-173.

[6] Ibid.

[7] Ibid.

[8] Ibid.

[9] Vukanoviç, op.cit., p.142.; Blagojevic,op.cit.,p.172.

[10] Blagojevic,op.cit.,p.172.

Kjo ishte rrugë e mundimshme ku edhe tani mund të vërehen diku kalldrëmet. Rruga e vendbanimit Kurbeliq përmes Kuqevishtës, vazhdonte për në Shkup, ndërsa një krah i kësaj rruge nga Kurbeliqi ndahej për në Bilaq, Leran, Çukarkë, Llojan, Sllupçan, Lipkovë, Alizare, Hasan-Beg, dhe vazhdonte për në Shkup.11

Rruga Prizren-Kostandinopojë me rëndësi tregtare në Ballkan kalonte në qendër të Anamoravës nëpër Gjilan. Rruga fillonte nga Prizreni vazhdonte nëpër Suha Rekë e Caralevë dhe depërtonte në Prishtinë. Pas Prishtinës vazhdonte në Graçanicë, dikur punishte zejtare12pranë Janjevës dhe me lokalitet zejtar që përmendej që nga fillimi i shekullit XIV.13 Pastaj rruga vazhdonte për Novobërdë, vendbanim i shekullit XIV 14dhe pritej në Gjilan (diku nga mesi i shekullit XIV). Duke vazhduar drejt lindjes kjo rrugë hynte në Maqedoni në lumin e Golema Rjekës afër Kumanovës dhe kështu vazhdonte në thellësi të Ballkanit Jugor deri në Kostandinopojë (Stamboll).

Rruga e Vrajës apo e Moravës ishte e tipit ushtarak e më vonë edhe tregtar. Mund të ketë ekzistuar që nga koha Romake dhe po në atë periudhë kohore me siguri ishte shfrytëzuar si rrugë tregtare. Fatin e një rrugë të tillë e pati edhe gjatë periudhës mesjetare, sepse përmes saj është zhvilluar një aktivitet tregtar mesjetar. Rruga fillonte nga Graçanica e Prishtinës, vazhdonte për në qytetin mesjetar Novobërdë dhe shpinte drejt Vrajës.15 Kësaj rruge i bashkëngjiteshin edhe shumë rrugë lokale duke kaluar nëpër fshatra malore dhe shpinte drejt vendbanimit Përlepnicë, prej nga lëshohej në vendbanimin Ropotovë, e që prej aty në drejtim të lumit Morava vazhdonte drejt grykës së vendbanimeve Konçul, e pastaj në Lluçan dhe Bujanoc dhe merrte drejtimin e Vrajës.16
Ishte rrugë me karakter tregtar sepse përmes sajë zhvillohej tregti mjaft e madhe. Gjatësia e kësaj rruge prej Graçanicës deri në Vrajë ishte aty rreth njëqind kilometra.

Rruga Gjilan për Kumanovë, niste nga Gjilani duke lidhur shumë fshatra të tjera dhe vazhdonte nëpër fshatrat: Pasjan, Zhegër, dhe nëpër malet e Karadakut për në Kumanovë, kurse një krah i sajë ndahej në dalje të Gjilanit për në Preshevë, kalonte vendbanimet Pasjan, Muqibabë, Stanec dhe zbriste në

---

11 Vukanovic, op.cit., p.142.; Blagojevic,op.cit.,p.172.

12 A. Boue. *Recueil d'itineraires dans la Turquie*, I (Wienne,1854), p. 348.

13 M. Gashi, N.Ukaj. *Kosova* (Prishtinë,1970), p. 32.

14 Ibid. p. 35.

15 Ibid.p. 174

16 K. N. Kostic, *Trgovacki centri i drumovi po srpskoj zemlji u srednjem i novom Veku* (Beograd,1899), pp.208-219.

Preshevë, Tërnavë, Miratoc, Llojan, duke u bashkuar me rrugën e Shkupit dhe duke vazhduar për në Kumanovë.17 Kjo rrugë tregtare lidhte qytetin shqiptar Kumanovën në Maqedoni me qendrën e Anomoravës. Rruga në fjalë në disa vende ishte e punuar me gur, sidomos nëpër ato vende të rrafshëta ku vështirë ishte të kalohej gjatë stinëve të vjeshtës dhe dimrit si dhe në pranverën e hareshme.

Rruga Gjilan për Prishtinë, epiqendër të gërshetimit të rrugëve lokale kishte Gjilanin, kurse nga Gjilani rrjeti rrugës fillonte dhe ndahej në dy krahë. Njëri krah niste nga vendbanimi Koretishtë kurse krahu tjetër, nga Pasjani. Pika e bashkimit të këtyre dy krahëve të rrugës ishte afër vendbanimit Bresalc, pastaj vazhdonte nëpër vendbanimet Parallovë, Llabjan, Mramor dhe arrinte në Prishtinë. Kjo rrugë nga Gjilani vazhdonte edhe në një krah për në Ferizaj18, si një rrugë e tipit fushor.

Rruga e Konçulit ishte rrugë që ndahej në fshatin Konçul nga drejtimi i rrugës së Vrajës që shkonte drejt Moravës. Ndarja e rrugës në fshatin Konçul vazhdonte nëpër vendbanimet përreth, si Ropotovë, Kormjan në drejtim të Vrajës dhe nëpër pjesë malore në drejtim të lumit Kriva Rekë.19

Rruga e Gjilanit për në Novobërdë që fillonte nga Gjilani në vendbanimin Stanishor, kalonte në Makresh dhe lidhej me Bostanin ku kësaj rruge i bashkoheshin edhe disa rrugë tjera lokale dhe përfundonte në Novobërdë. Ishte rrugë mjaft e kalueshme me kalimtarët sepse lidhte shumë vendbanime përreth, në anën tjetër lidhte edhe qytetin mesjetar.

Rruga e Gjilanit për në Ferizaj, vazhdonte në vendbanimet Livoq të Poshtëm (mes fshatit Cërnicë, rruga e kooperativës) dhe shpinte për në Vrapçiq, Devajë, Radivojcë, Zhiti, Qifllëk, Tërpezë, Pozharan dhe vazhdonte në drejtim të Ramjanit për në Ferizaj.20

Rruga e Novobërdës për në Nish ***(Naisus)*** kalonte nëpër vendbanimet e Gollapit, si Tuxhec, Zhujë, Lisockë, Velegllavë dhe shpinte në Leskoc, për të përfunduar në Nish. Kjo rrugë në Malësinë e Gollapit kishte karakter ekonomik, kulturor dhe fetar që me vete sillte kultura të fushave të ndryshme.21Në anën tjetër, me shkatërrimin e Novobërdës më 1446, ushtria osmane kaloi nëpër këtë rrugë (Novobërdë-Nish) duke djegur të gjitha fshatrat e besimit të krishterë të Gollapit dhe duke rrënuar të gjitha kishat e fshatrave Tërstenë, Desivojcë,

---

17 Ibid.

18 Vukanovic, op.cit., p.142.

19 Dimitrijevic, op.cit., p.175.

20 Intervistë me: Isa Gashi, banor i vjetër i qytetit të Gjilanit dhe projektues i qytetit (14.04.2000).

21 Hysen Kqiku, *Monografia për Velegllavën* (Gjilan,2011), p.36.

Velegllavë, Lisockë, Gjyrishec, Tugjec si dhe disa fshatrave tjera.22

Rruga e Velegllavës me Laçiqin në vendin e quajtur Udha e Kerreve vazhdonte më tutje për në Huruglicë, Samakovë dhe Lipovicë (fshatra dikur shqiptare, tani në Serbi).23 Rruga e Janjevës fillonte nga vendbanimi Bresalc dhe vazhdonte nëpër vendbanimin Llabjan kurse në Brus lidhej me Janjevën 24, pastaj një pjesë e rrugës vazhdonte për në vendbanimet Mramor, Matiqan e depërtonte në Prishtinë.

Rruga që fillonte nga Gjilani për në Cërnicë, kalonte mes dy fshatrave të Livoqit të Poshtëm dhe të Epërm, shkonte për në Cërnicë përmes fshatit afër ish-kooperativës bujqësore dhe kalonte nëpër fshatrat Vrapçiq, Devajë, Radivojcë, Zhiti, Qifllëk, Ballancë, Tërpezë dhe futej në Pozharan, duke u lidhur me rrugën Gjilan–Ferizaj.25

Ruga e Bresalcit nëpërmjet një vije të saj, bashkohej me rrugën e Prishtinës dhe me linja tjera vazhdonte nga Bresalci, Strazha e Koretisha duke arritur në Gjilan dhe për të vazhduar që t'i bashkohej kryqëzimit të rrugëve tjera në qendër të Anamoravës.26

Rruga e Pozheranit që njihet si ,,Rruga e Mbretit", pikënisjen e kishte nga qendra e Pozheranit, në drejtim të Sllatinës së Poshtme, dhe nën Sllatinë shkonte drejt fshatit Beguncë, pastaj futej në Stagovë, vazhdonte rreth lumit Nerodimka, futej në Kaçanik dhe vazhdonte për në Shkup. Rruga tjetër quhej "*Sokaku i Zajmit*", e cila shkonte drejt Moravës, dilte në fshatin Mogillë dhe vazhdonte drejt fshatrave tjera. "Sokaku i Zajmit" apo "Rruga e Zajmit" sipas gojëdhënës, quhej kështu, sepse Zaim Begu e kishte hapur, i cili, në dy anët e kësaj rruge i kishte tokat e veta, dhe, kjo rrugë i shërbente këtij beu, por edhe banorëve të tjerë të Pozharanit dhe fshatrave të tjera. Edhe sot kjo rrugë mban po këtë emër.

Rruga e Gjilanit nëpër Pogragjë shkonte në Dobrosin, Konçul e Bujanoc dhe lidhej me Vrajën, kurse një krah i kësaj rruge ndahej në Pogragjë dhe kalonte nëpër fshatrat e Karadakut, Sllubicë, Magjere e Gosponicë, duke depërtuar në rrafshin e Preshevës. Kjo rrugë ishte malore dhe e vështirë për kalim, mirëpo ishte më e sigurt për tregti.27

---

22 Ibid.

23 Ibid. p.37.

24 Intervistë me: Adem Bllaca, lindur në fshatin Cërnicë (14.04.2000).

25 Ibid.

26 Intervistë: Emrush Syla, mësimdhënës dhe banor i fshatit Bresalc (15.06.2000).

27 Intervistë: Emrush Qamili, nga gojëdhënat e trashëguara brez pas brezi të mbledhura në v.1953 (01.11.2016).

Bibliografia e shfrytëzuar dhe konsultuar:

- Bejko Sadik, [2006].Qytetërime të mëdha, Tiranë.
- Blagojevic,M., [1973]. Zemljoradnja u srednjovekovnoj Srbiji, Beograd.
- Cërabregu Muharrem, [1977]. Kosova në hartat e vjetra, Prishtinë.
- Çershkov Emil, [1973].Romakët në Kosovë dhe Municipiumi DD te Soçanica, Prishtinë.
- Dimitrijevic S., [1958...]. Dubrovacki karavani u juznoj Srbiji u XVII veku.
- Drançolli Jahja, [1986].Raguzanët në Kosovë prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455.
- Kosova dikur e sot, [1973].Grup autorësh, Beograd.
- Osmani Jusuf, [2004].Vendbanimet e Kosovës 6- Gjilani, Prishtinë.
- Osmani Jusuf, [2004].Vendbanimet e Kosovës 13 Dardana dhe Artana, Prishtinë.
- Osmani Jusuf, [2005].Vendbanimet e Kosovës 8-Mitrovica, Zveqani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku.
- Përzhita Luan, Kemajl Luci, Gëzim Hoxha, Adem Bunguri, Fatmir Peja dhe Tomor Kastrati, [2006].Harta Arkeologjike e Kosovës I, Tiranë 2006.
- Pulaha Selami, [1984].Populllsia shqiptare Kosovës gjatë shekujve XV-XVI, Tiranë.
- Rizaj Skender, [2006].Falsifikimet e historiografisë serbe, Prishtinë.
- Shukriu Edi, [2004].Kosova Antike, MASHT, Prishtinë.
- Tërrnava Muhamet, [2000].Studime për mesjetën, Pejë.
- Kostic, K. N. [1899].Trgovacki centri i drumovi po srpskoj zemlji u srednjem i novom veku, Beograd.IZHA.

Ma. Sadat AGUSHI

VËZHGIME TOPONIMIKE NË FSHATRAT RAHOVICË DHE RAINCË TË PRESHEVËS

Studimet toponimike të një vendi apo krahine kanë një peshë të madhe pasi që nëpërmjet tyre mund të bëhen edhe hulumtime të tjera historike, dialektologjike, etnologjike e gjuhësore. Fusha e toponimisë në rajonin e Preshevës nuk është trajtuar sa duhet, për të mos thënë fare, në përjashtim disa studiuesve të cilët kanë bërë kërkime aty-këtu duke përfshirë Bujanocin dhe Medvegjën.

Katundet Rahovicë dhe Raincë vështruar nga aspekti kohor, kanë një histori të lashtë banimi dhe për këtë arsye ishte e nevojshmë që t'i nxjerrim në dritë disa toponime, të cilat i kemi vjelë gjatë hulumtimit nëpër terren. Më poshtë, në pika të shkurtëra, do të paraqesim shtrirjen gjeografike të vendbanimeve dhe historikun e tyre.

Rahovica është fshati më i madh i komunës së Preshevës dhe i banuar kryesisht me shqiptarë. Ajo shtrihet dy kilometra në veri të Preshevës, në të dyja anët regjionale Miratoc-Lluçan. Afërsia gjeografike me Preshevën ka bërë që me kalimin e kohës në aspektin fizionomik të bashkohet në jug me Preshevën, duke u bërë pjesë e kontinuumit urbano-rural të saj, ndërsa vazhdon të zgjerohet në drejtim të veriut, në të dyja anët e rrugës Preshevë-Raincë (Ejupi, Islami 2015:508). Vendbanimi i Rahovicës është i ngritur në gërmadhat e një vendbanimi të vjetër antik të periudhës së bronzit dhe për këtë dëshmon prezenca e oppidumit dardan *"Kacipupi"*, i cili ndodhet mbi fshat, në daljen e lumit të Rahovicës në fushën e Preshevës, pastaj gërmadhat e vendbanimit romak, kishës dhe manastirit (po aty). Oikonimi është dygjuhësh, pra kemi *Orahovica* nga sllav *orah-arrë* e sufiksi *icë* dhe *Rahovicë*. Emrit mund t'iu ketë bërë ndonjë ndërrim tingujsh nga administrata serbe, pra nga *Hora* në *Raho*, tingulli epentetik ***v*** dhe prapashtesa *icë* .Me metatezë të anësoreve *"r,l"* na del edhe emri i fshatit *Leran*, pra nga shqipja *Leran* në serbishte *Reljan*.

Rainca është fshati i tretë më i madh i komunës së Preshevës, pas Miratocit. Në veri përkufizohet me fshatin Letovicë të Bujanocit, në lindje me Samolicën e Bujanocit, në jug me Corroticën e Preshevës dhe në perëndim me Garën e Preshevës (Fazliu, Salihu 2015:7). Largësia e saj me Preshevën është 12 km. Sipas shënimeve historike, fshati është mjaft i vjetër dhe i banuar nga fise ilire.

Nga bisedat që i kam pasur me pleq të Raincës, dëshmojnë se fshati më herët është quajtur *Biganoc.* Kështu ndërmjet maleve (kodrave) kalon lumi pasi që edhe vet fshati është në mes tyre.

Në këto rrethana sipas etimologjisë, emri mund të mendohet një lidhje afërie e *bigë-s* me emrin e qytetit ilir *Bigeste*, formim me *este* si te *Tergeste, Ateste* (Çabej, 1986:227). Pra, kemi *bi-ga* një *n* të ndërmjetme dhe prapashtesën sllave *ovac/oc-Bi-ga-n-oc*. Sipas analizës që jep Çabej rreth prejardhjes së emrit (Bigeste), ne mund të përfundojmë se fshati në fjalë është një vazhdimësi e trashëgimisë iliro-shqiptare. Ky vend është me toponim dygjuhësh dhe me trajtë e formë krejt të ndryshme. Nuk jemi ndalur tek analiza e emrit të tanishëm pasi që mendohet se është me prejardhje nga sllav. *Rai-parajsë* dhe sufiksi *ince,* pra *Rajince-Raincë.* Në trevën tonë shumë onoma (emra fshatrash dhe të tjerë) edhe pse me prejardhje shqipe si *Miratoc, Bukuroc, Bukoc* për shkak të ndikimit të administratës serbe, u është prapavënë sufiksi i lartëpërmendur.

Veçoritë leksikore

Toponimet e Rahovicës dhe Raincës janë ermërtime njëgjymtyrëshe, dygjymtyrëshe e më pak trigjymtyrëshe me prejardhje shqipe dhe me elemente sllave e turke. Në këtë punim do të zbërthehen vetëm disa prej tyre e të tjerat do të shënohen ashtu siç janë vjelë në terren. Për t'u analizuar toponimet e kësaj ane, duhet ndjekur disa rregulla paraprake. Sipas prof. Rexhep Ismajlit, toponimia e Serbisë Jugore dhe e Maqedonisë Veriore kur të studiohet duhet të kihen parasysh disa elemente: elementi iliro-dardan, latino-romak, bizantin, shqiptar, sllav dhe turk (Ismajli, 1970:262). Pra, duke u bazuar në dëshmitë historike nënkuptojmë se një pjesë e pushtuesve në këto vende, lanë gjurmë të thella edhe në toponimi, pra edhe në fushën e gjuhësisë para se gjithash.

Toponimi, gjegjësisht hidronimi PËRRUE-PËRRONI ka një përhapje të gjerë në këto fshatra sidomos në Raincë. Ky emër ashtu si edhe në tërë rrethinën e Preshevës shqiptohet pa diftongun *ue*, pra kemi: *prrū-prrōni*. P.sh.: *Prroni Kshës, Prroni Kajës, Prroni Markit, Prroni Fellë, Prroni Mexhinës, Prroni Gugutit, Prroni Garës, Prroni Bicit, Prroni Trupit, Prroni Manastirit* (Rahovicë). Ndërsa, në Raincë kemi regjistruar: *Prroni Vogël, Prroni Thive, Prroni Thonave, Prroni Çeshmës, Prroni Zabelit, Prroni Keç, Prroni Krojvetftoft, Prroni Koçakit, Prroni Gurvegatë, Prroni Fellë, Prroni Ahit, Prroni Kuklit, Prroni Veselit, Prroni Shoshajës, Prroni Veselit, Prroni Raincës, Prroni Gurve, Prroni Bërçecës, Prroni Qershijës, Prroni Alimatës* etj. Me këtë emër në bashkëvajtje dalin edhe emra fitonimesh, antroponimesh, oronimesh e ojkonimesh.

Po në këtë fshat (në Raincë) ndeshim toponimin *Drumi*, i shprehur si

togfjalësh, me të cilën emërtohet rruga si: *Drumi Rimit* sepse lidh rrugën automobilistike rajonale. Për këtë fjalë Çabej thotë se është një trajtë vertikale e DHROM-it nga gr. e re □pɒmos, pra kemi DRUM m. "rrugë, udhë" (Çabej, 1976:145). Nga pikëpamja e fjalëformimit, toponimet e këtyre dy fshatrave na dalin si në vijim: **toponime të parme**: *Doda, Lajthia, Gjereni, Morrizi, Izvori, Mexhinja, Trdha, Llagëmi, Vaçka, Bunga, Kashkalla, Marshalla, Kalldërmja* (Rahovicë). Në Raincë kemi: *Bllata, Buxhaku, Shkoza* etj.;
toponime të prejardhura: *Selishte* nga *sel-ishte, Gurishte-gur-ishte, Shavarina-shavar-in-a, Magjereshtina- magjar/magar-e-shtin-a, Humishte-hum-ishte, Çardak-çar-d-ak, Cungel-cung-el, Zagelka- zag-el-ka* (Rahovicë) dhe në Raincë: *Sharraxhit- sharr-a-xhit, Tatarka- tatar-ka* etj.;
toponime kompozitore: Në Rahovicë: *Kacipupi, Fushëmadhe, Gurudan,* ndërsa në Raincë: *Ndërosoja, Isbegu* etj.

Në këto fshatra më së shumti dalin toponime togfjalëshash*,* ndaj në Rahovicë kemi: *Lugi Qyreçit, Gurë me kryç, Lak Tmadh, Shullani Therrave, Pylli Bicit, Tuma Bukocit, Arët e Tashës Zabeli Aliajve, Fusha Dukës, Prroni Manastirit, Lluga Shkaft, Bregi Malit, Te Vidhi, Te Krekza* etj., ndërkaq në Raincë: *Livadhet e Bungës, Kodra Bungës, Buzallëki Golit* (me gjasë nga buz-a-llëk dhe Gol-llagap)*, Lugi Thatë, Çeshmja Shehit, Kolibja Polakit, Uji Kuç, Reka Drangojve, Osoja Vogël, Gjereni Poshtër, Gjereni Epër, Rrezja Arve Tnalta, Vorrët e Shkive, Lugi Verdhë, Prroni Gurve Tgatë, Dy Vorrët Çift, Vorrët e Demë Kocit* etj.

Në rajonin e Preshevës, përgjithësisht, nyja "i" nuk përdoret kur emri është në numrin njëjës, ndërsa ndeshet kur toponimet dalin në numrin shumës. Togfjalëshat toponimikë na dalin me emra në rasën gjinore dhe me mbiemra cilësorë. Si toponime më të vjetra në fshatin Rahovicë janë: *Kacipupi, Dubreca, Përzhari, Kashkalla, Zagelka* e në Raincë: *Ara Albulenës, Kroni Çerkinit, Ara Sofikës dhe Biganoci*.

Nga fusha e antroponimisë ruhen edhe sot e kësaj dite emra vetjakë, të cilët dëshmojnë dhe flasin bindshëm për vazhdimësinë e antroponimisë iliro-shqiptare si: *Dashnor, Dashnim ilir.Dasius, Dasimus; Bardh, Bardhyl, Bardhok nga ilir.Bardus, Barduli, Bardyllis; Malë, Malush ilir. Malenum, Dimalum* (Çabej, 1976:28).

Patronimet

Gjurmë lashtësie në këto anë, përveç oronimeve, ojkonimeve e mikrotoponimeve, paraqesin edhe patronimet apo emrat familjarë, të cilët dalin me sufiksat **aj, t**. Nuk kemi hasur që ndonjëri prej tyre të përshtatet sipas natyrës

së serbishtes duke ua prapavënë prapashtesën **iq-viq**. Në Rahovicë kemi katër familje kryesore, apo lagje të cilat marrin sufiksin **aj**:

Myrtaj- është një lagje (mëhallë), një patronim me bazën e antroponimit oriental *Myrteza, Murtez.*

Haxhiaj- sipas informatorëve i pari i kësaj familjeje kishte shkuar në Haxhillëk dhe pas kryerjes së obligimeve kthehet në shtëpi dhe të tjerët kishin filluar ta thërrasin *Haxhija* e më vonë edhe tërë familjen *Haxhiaj-t.*

Sejdaj- po ashtu një familje që na kujton antroponimin *Sejdë-a, Sejdi*.

Durçaj- quhet kështu një familje, e cila gjendet në hyrje të qytetit të Preshevës, pra në fund të fshatit. Emri i lagjes (familjes) rrjedh nga një trajtë dhe formë e vjetër e shqipes dhe se etimologjia është mbase e vështirë për t'u përcaktuar. Forma e parë *"du"* mund të jetë një analogji e numërorit *"dy"* që e nxjerrim nga *"duqe"* si dy trasta a hejbe të lidhura çift dhe sufiksi *"ça"* që ka kuptim cilësie dhe që përdoret vetëm në shumës (po aty). R-ja, me sa duket, është futur për lehtësim shqiptimi edhe pse dëgjohet shumë pak ose fare hiç gjatë shqiptimit. Ka disa antroponime që dalin me sufiksin në fjalë edhe në disa fshatra të Preshevës si b.f. *Dullça, Dinça,* etj. Patronimi *Dukt* është më e vjetri në Rahovicë që në të shumtën e rasteve del në shumës. Rrënja kryesore e këtij emri është *duk* dhe prapashtesa *t*. Rreth prejardhjes së këtij emri kanë folë shumë studiues, ndër ta edhe albanologu e historiani kroat Milan Šuflaj. Ai i referohet emrit *Dukat* dhe mendon se emri *Dukla* e ka marrë emrin sipas mbretit ilir *Dioklecian* dhe në veri në trevën e vjetër të *Dokleatëve* ilirë ekzistonte provinca *Dokleal, Dukla*, e cila nën ndikimin e rrëfimeve mbi perandorin *Dioklecian* u quajt *Diokletija* (Shufflay, Millan, 1968:44-46). Mendojmë se ky emër në Rahovicë del me sufiksin *t* dhe jo me *at* për shkak të shqiptimit të ngulitur prej kohësh. Ndaj edhe sot dëgjojmë shprehjet: *po shkoj te dukt, po vjen Duka*. Patronimi *Dukt* ka ardhur nga oikonimi *Dukat* i Shqipërisë. Kjo familje vjen nga Shipëria.

Shumë familje të këtij fshati janë me prejardhje nga viset e Shqipërisë dhe pas ardhjes në këtë vend, ata inkuadrohen dhe pranohen brenda familjeve të lartëpërmendura. Emrat e familjeve të tjera të cilat dalin në shumës, kanë sufiksin **t**: *Beqir-t, Haxhidik-t, Latif-t, Saqip-t, Maç-t, Ym-aj-t Mat, Çot, Ajdin-t, Alidin-t, Belul-t, Putur-t, Hashan-t, Alimak-t, Korb-t* (nga zoonimi Korb), *Salihim-t, Duk-t, Anadoll-t, Krum-t, Ip-t, Haxhibrahim-t, Avd-a-t, Haxhimus-t, Bull-aj-t,* (nga buall-i, pra kemi monoftingim nga ua-u) *Çit-ak-t, Kish-aj-t, Dër-sh-lak-t, Burr-uk-t* nga (burrë), pra me sufiksin *uk* është formuar mbiemri, në këtë rast patronimi Burruk, nga burrë.

Në Raincë, patronimet na dalin me sufiksa të ndryshëm. Familjet e para në këtë fshat janë:

Shark-t –ku banorë të parë kanë qenë vëllezërit Mustafa dhe Hasani. Etimologjia e emrit lidhet me zoonimin *Shark* ku burrat janë veshur trashë me gunë prej leshi delesh.
Mehaj-t- është një familje apo lagjeje, një patronim me bazën e antroponimit oriental *Mehmet*.
Ukaj-t- është një patronim i disa familjeve dhe vjen nga antroponimi *Ukë-a*. Ky është një emër mjaft i vjetër i protoshqipes.
Hutaj-t- ky emër ka dalë nga zoonimi *hut (hutini),* siç del edhe patronimi *Korbt* nga *korbi* në fshatin Rahovicë.
Sylësef-aj- një patronim kompozite nga antroponimet *Sy(u)lejmani* dhe *Sefedini;*
Tabak-t- e kanë marrë emrin nga një lloj ene në të cilën vendosen pijet apo diçka tjetër.
Nga kjo familje kanë dalë *Nallban-t* apo (Mbathtarët) dhe *Latif-t.*
Bakan-t- lagje mjaft e madhe në Raincë. Etimologjia e kësaj fjalë vjen turqishtja dhe ka kuptimin *ministër.*
Dobrosha- patronim me prejardhje sllave (nga serbishtja *dobro-i mirë* dhe sufiksi *"osh"* që ka më shumë kuptim pejorativ dhe prapashtesa *a* e shumësit.
Asllan-t- patronim që ka dalë nga zoonimi, i shprehur figurativisht me kuptimin *luan*
Gara-līt- patronim i ardhur nga ojkonimi *Gare* dhe sufiksi turk *li.*
Limonzek-t- familje nga antraponimet *Limon-i* dhe *Zekirjaja*
Ban-ush-t- emër familjeje që me gjasë ka dalë nga një shkurtim i emrit *Shaban-Ban* dhe prapashtesa përkdhelëse *ush* dhe sufiksi i shumësit *t*.
Kasovit- familje që ka dalë nga lagjja e *Mehajve*. Baza e këtij patronimi është nga antroponimi *Kasë-a* apo *Kasëm-i +ovit*.
Rexhaj-t- patronim që ka dalë nga antroponimi oriental *Rexhep*.
Çuk-t- sipas Fjalorit të gjuhës shqipe, kjo fjalë ka kuptimin: **çuk-u** m.sh. **–ë(t)** bised. 1. mëz: del si çuku para pelës (fig) flet pa iu mbajtur radhës sipas moshës. 2. kërriç, pulisht: çuku i gomarit. •*fem* **çukëz,-a** sh. **–a(t)**; **çuk,-u** m. sh. **–a(t)** strofull: çuk lepuri (Fjalori i gjuhës shqipe, 2006:164). Sipas shpjegimit që jep Fjalori rreth fjalës, mendoj se ky patronim ka një kuptim pejorativ, kryesisht me kuptim figurativ.

Përfundime

Toponimet kanë një rëndësi të veçantë në fushën e gjuhësisë sepse duke i emërtuar vendet, ato sjellin dëshmi për historinë e gjuhës. Në bazë të studimit të bërë, mund të përfundojmë se toponimia e fshtrave Rahovicë dhe Raincë të Preshevës është mjaft e pasur, në të cilat janë ruajtur oronime, patronime,

antroponime e hidronime me emërtime shqipe, herë-herë edhe me përzierje të elementeve sllave e turke.

Edhe pse fshatrat në fjalë janë me prejardhje sllave, toponimet e nxjerra nga terreni dëshmojnë se këto vende janë mjaft të lashta dhe se emërtimet e tyre janë vazhdimësi e autoktonisë iliro-shqiptare. Këto të dhëna që i kam paraqitur nuk mund të thuhet se është shqyrtuar në mënyrë shteruese së studiuari toponimia e këtyre fshatrave pasi që ka ende për të bërë punë rreth etimologjisë së disa toponimeve. Mendoj se ky punim ka sjellë diçka të re sidomos për disa pika kyçe që nuk janë trajtuar deri më tani.

Toponimet *Kacipupi, Dubreca, Përzhari, Kashkalla, Zagelka* në Rahovicë, gjihashtu edhe toponimet togfjalëshash *Kroni Çerkinit, Ara Sofikës* në Raincë, por edhe disa të tjera, nuk janë analizuar etimologjikisht. Andaj, në studimet tona të radhës gjithsesi do t'i kushtohet një kujdes pasi që kanë një rëndësi të veçantë për këto anë.

Bibliografia

1. Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore I.* Prishtinë.
2. Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore III.* Prishtinë.
3. Çabej, Eqrem (1986). *Studime gjuhësore VIII.* Prishtinë.
4. Ejupi, Arsim - Islami, Hivzi (2015). *Populllsia dhe vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës (Gjendja dhe rrjedhat bashkëkohore)*. ASHAK. Prishtinë.
5. Fazliu, Vebi- Salihu, Xhemaledin (2015). *Rainca-Vendbanim i vjetër dardan-shqiptar në rajonin e Preshevës.* Gjilan.
6. Ismajli, Rexhep (1970). *Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni të Veriut*. Gjurmime albanologjike. Prishtinë.
7. Shufflay, Millan (1968). *Serbët dhe shqiptarët.* Prishtinë.

Vait NIKAJ

RUAJTJA DHE AVANCIMI I IDENTITETIT FETAR

A b s t a k t i

Kjo kumtesë është një fragment i një studimi më të zgjeruar edhe më përmbajtësor që i dedikohet ruajtjes dhe avansimit të identitetit fetar, gjithësesi duke përfshirë edhe atë etnik në periudha të ndryshme shoqërore dhe historike të njësisë urbane dhe rurale të Ulqinit, për të integruar edhe Krajën në këtë kampus.

Rrethanat politike, ekonomike dhe ushtarake janë reflektuar në forma shpesh, ireale të përcaktimit të vërtetë fetar, gjuhësor dhe kombëtar. Përgatitjet arsimore kanë qenë në nivelin më të ulët, ose ka dominuar analfabeti total.

Fillimi i shekullit XXI, e ka ndryshuar rrënjësisht gjendjen ekzistuese. Në kohët e sotme shqiptarët e besimit islam, apo të krishterë e kanë më lehtë për ta ruajtur dhe avansuar identitetin e tyre fetar. Veprojnë institucione fetare brenda shtetit të Malit të Zi, por të interesuarit gezojnë mundësinë që të ndjekin edhe përgatitje superiore në vendet fqinje të rajonit.

Botimet e shumta të literaturës fetare, projektet e ndryshme hulumtuese –shkencore, në veçanti në Ulqin, rrjedhimisht i kontribuojnë thellimit të ruajtjes dhe avansimit të identitetit të qëndrueshëm fetar. Natyrisht se në këtë atmosferë të raporteve sociale, politike, shpikjet e teknologjisë së re, sfidat ekonomike dhe psikologjike, mund të motivojnë veprime radikale me pasoja të padëshiruara individuale dhe kolektive. Mbetet detyrë parësore e udhëheqësve fetarë që të veprojnë drejt e në kohën e duhur të edukimit të mirëfilltë që ruan edhe afirmon vlerat e identitetit fetar.

Islamizmi i popullatës së Ulqinit, Anës së Malit dhe Krajës

Besimi në fuqitë e mbinatyrshme, të cilat i prijnë fatit të njeriut, në hyjnitë sekrete dhe të gjithfuqishme prej mëshirës së të cilëve varet lindja dhe vdekja, sëmundjet dhe shëndeti, moti i thatë që shkakton urinë dhe shiun që sjell mirëqenie, gjahu i mirë ose i dobët, besimi në fuqinë e disa objekteve që të kthejnë shikimet e këqia, ose qëllimet e këqia të armiqëve, kanë lënë shumë dëshmi që i gjejnë arkeologët... [1]

[1] Stipçeviq Aleksandër, Ilirët ,Rilindja, 1980,Prishtinë

Ulqinin (1571), Anën e Malit dhe Krajën, turqit e okupuan atëherë kur e okupuan edhe Shkodrën (1479) ndoshta edhe diçka më parë. Deri në vitin 1490, çdo qytet edhe katund dhe fushë në luginën e Liqenit të Shkodrës, kanë qenë nën sovranitetin turk. Një konfirmim të këtillë e konfirmojnë kadastret e vitit 1485 dhe 1580 të regjistruar nga administratorët turq. Popullsia e këtyre viseve nuk u islamizua menjëherë, por gati pas dy shekujve. [2]

Me depërtimin e osmanëve në Ulqin për popullatën e këtij nënqielli fillon një etapë e re krejtësisht tjetër e kulturës,e arsimit, dhe e qytetërimit.Për treqind vjet të plota këtu do të dominojë të themi si mënyra e mendimit, e shkrimit,dhe e sjelljes që janë gati identike me ato që zhvilloheshin në mjediset tjera shqiptare nën administrimin osman.[3]

Intelektuali, pedagogu dhe studiuesi nga Ana e Malit përtej kufirit Mali i Zi- Shqipëri, Ruzhdi Poda pohon se Besimi islam është fe që përfaqëson pjesën më të madhe të banorëve anamalasve ndër këto 3-4 shekujt e fundit. Mosvizimi i këtij besimi është frut i predikimit human, që lehtëson çdo besimtar të ecë në rrugën e islamit...Rrënjosjes së islamizmit në zemrat e anamalasve dhe përsosjes së virtyteve më të mira njerëzore, u kanë shërbyer në rrjedhë të kohës 9 xhami dhe rreth 60 intelektualë anamalas, në detyrat e imamit, teologut, hafizit, mullait, vaizit.[4]

Bashkësia islame e Ulqinit, në bashkëpunim me Meshihatin e Bashkësisë islame të Malit të Zi, por edhe me sektorin civil, ka realizuar një mori projektesh, si ligjërata fetare, simpoziume, botime të librave fetarë, ndërtime dhe rindërtime të xhamive në qytetin e Ulqinit dhe në mjediset rurale të kësaj komune.[5]

Një botim i Amzës malazeze (Crna Gora i osmanlijsko doba, 2017) që ka për autorë 3 studiues nga Tivari, në parathënien e përmbledhjes së kumtesave të një simpoziumi ndër të tjera thuhet se *„pa i njohur mirë raportet e Malit të Zi me Perandorinë osmane në një periudhë prej 400 vjetësh nuk ka mundësi të kuptohet mënyra e formësimit të vetëkuptimit shtetëror dhe kombëtar të popullit malazez,ndërtimi politik dhe kulturor i identitetit të tij“*.

Në këtë frymë, Imam Muhamed B. Sytari, myfti i zonës së Shkodrës, me rastin e Simpoziumit shkencor kushtuar 160- vjetorit të lindjes së H.A.Riza Ulqinakut, mbajtur në Ulqin në vitin 2015, ndër të tjera tha se *„periudha e errët e komunizmit,që ishte shembëll tipik i një kryqëzate të egër ndaj islamit dhe*

---

[2] Shaqir Ismaili “Bojku”,Art Club,Ulqin,2011

[3] Nail Draga, ”Shqiptarët në Mal të Zi”

[4] Ruzhdi Poda, Rozafat,2007,Shkodër

[5] Imam Muhamed M. Sytari, Thirrja islame ne Mevludin e Hafiz Ali Riza Ulqinakut, MBI- 2015 ,Ulqin

mysalimanëve në Shqipëri,për një periudhë gati gjysmëshekullore e, sidomos, nga viti 1997,kur feja u ndalua me ligj deri në vitin 1990,kur u rihapen dyert e lirisë së besimit,bëri të pamundurën që të shkëputste me të gjitha format e mundshme lidhjen e myslimanëve me fenë e tyre.[6]

Studiuesi i zhvillimeve ballkanike,profesor në Universitetin Lousvile, 2015,Justin McCarthy, në studimin e tij voluminoz "Vdekje dhe dëbim",spastrimi etnik i myslimanëve osman,1821- 1922" ,shkruan se evropianët e cilsuan nënshtrimin e Europës Osmane si një e drejtë e shumicave të krishtera për vetëqeverisje. Por, kjo nuk është aspak e vërtetë : myslimanët në vitin 1912 ishin grupi më i madh në Europën Osmane - shqiptarët në Perëndim kurse turqit në Lindje.

Trashëgimia kulturore dhe konvertimet e shqiptarëve

Konvertimi i shqiptarëve, sa në katolikë, sa në ortodoksë për të përfunduar në myslimanë, në veçanti si rezultat e pushtimit të gjatë serb, nga viti 1108 deri në vitin 1250, kur ndërtohen kisha dhe manastire të shumta ortodokse. Përballë kësaj, kisha katolike erdhi duke u forcuar me ndikimin e vet mbi popullsinë shqiptare, duke nxitur shqiptarët që të konvertohen në katolikë. Në këtë mënyrë shqiptarët ortodoksë mbeten pakicë, [7]por pas kanë lënë objekte të shumta sakrale në Anë të Malit, Krajë e Liqenin e Shkodrës etj. Me të cilat vazhdimisht provokojnë shqiptarët e besimit islam. Si ilustrim vlen të kisha ortodokse serbe – maketë në majën e malit të Rumisë, e ndërtuar në mënyrë arbitrare në majën e këtij mali ku nuk njeh historia të ketë regjistruar se ka pasur objekt të tillë.

Popullata e Krajës e dominuar nga besimi islam, me mbi 1 mijë nënshkrime në formë peticioni i janë drejtuar Komunës së Tivarit edhe institucioneve shtetërore. Edhe pse është reaguar edhe në Kuvendin e Malit të Zi nga kuvendarët shqiptarë, kjo kishë vazhdon të jetë aty.

Mërgimtari nga Ftjani, Hajredin Muja SHBA, këtë objekt në një vepër publicistike e quan "Kisha e sherrit" , duke shtruar pyetjen se a u vendos vërtet në themelet e kishës së vjetër? Kush e kishte ndërtuar atë? Cilat janë dëshmitë ndër shekuj se aty ka pasur kishë?

Pas vitit 1990 , Kisha ortodokse serbe ka provokuar me ikonografinë në gërmadhat në Kala të Ulqinit, në Shas, në Krajë. Nuk kemi njohuri se janë regjistruar masa ndeshkuese administrative apo financiare ndaj autorëve të këtyre veprave antidemokratike. Të gjitha këto rrethana kanë sjellë vështirësi

[6] Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", 1998

[7] Hajredin Muja,"Kisha e sherrit", Logos, Shkup, 2014.

për ruajtjen dhe avansimin e identitetit fetar dhe kombëtar te shqiptarët e besimit islam në Ulqin,Tivar, Anë të Malit dhe Krajë.

Përveç subjektit politik shqiptar, kishën në Rumi kanë kërkuar ta heqin edhe liberalët malazias, Kisha autoqefale malazeze, por jo edhe ndonjë subjekt tjetër politik apo të shoqërisë civile.

Shaqir Ismaili nga katundi Bojk, i cili shumë vite ka qenë imam në Podgoricë edhe zyrtar i lartë në Bashkësinë islame të Malit të Zi, në veprën e cituar "Bojku", pasi Lluka u bë mysliman, pasardhësit e tij, në shenjë respekti ndaj Llukës, i cili përvetësoi mbiemrin Llukaliq ,malli dhe krejt pasuria në këto troje "ka qenë është edhe sot e kësaj dite e jona". Ishujt, kishat dhe manastiret, të cilat i kemi ruajtur me shekuj, gjithashtu janë pasuri e këtij xhemati dhe xhemateve tjera që i kanë trashëguar nga të parët. Për fat të keq, në ujëdhesa dhunshëm kanë hyrë uzurpues të Kishes ortodokse edhe komuniteti shqiptar i besimit islam nuk ka mbështetje institucionale për të mbrojtur trashëgiminë e vet kulturo-fetare.

Përfundim

Sistemi pluralist ka shënuar ndryshime edhe në aspektin e çështjes fetare. Derisa në monizëm, identiteti fetar është karakterizuar me kushtëzime dhe ndeshkime, në kohët e sotme përseri shoqërohet me dimensione tjera, të cilat edhe nuk kanë të bëjnë me ruajtjen dhe avansimin e identitetit fetar.

Jemi dëshmitarë se në emër të këtyre parimeve, shfaqen individë apo grupacione të interesit, të cilët thirren në premisat e identiteti fetar, por në të shumtën e rasteve, viktimizohen edhe vlerat fetare i shndërrojnë në biznes ose devijime të papranueshme për komunitetin.

Në Ulqin dhe në zonat e tij rurale, nuk vërehen tendenca të kësaj natyre. Por mund të ketë dallime mes brezash ose mungesë të edukimit të duhur dhe informacioneve të nevojshme për të përceptuar drejtë përkatësinë fetare përballë asaj kombëtare.

Këto luhatje apo edhe huti, duhet të jenë në qendër të vemendjes së institucioneve fetare dhe klerikëve për të transmetuar mirë e qartë nocionet përkatësi fetare dhe kombëtare, si dhe kultivimin e dretjë dhe pa paragjykime të tyre.

Në Malin e Zi me aktin më të lartë juridik të këtij shteti, Kushtetutë, ekziston kombësia myslimane edhe ky fakt vë në dilemë edhe në raste të ndryshme edhe shqiptarët e besimit islam me vetëdije të paqëndrueshme se cilës përkatësi fetare dhe kombëtare i takojnë.

MBI Ulqin, në bashkëpunim me Meshihatin e Bashkësisë islame

të Malit të Zi, por edhe me sektorin civil, ka realizuar një mori projektesh, si ligjërata fetare, simpoziume, botime të librave fetarë, ndërtime dhe rindërtime të xhamive në qytetin e Ulqinit dhe në mjediset rurale të kësaj komune dhe jo vetëm. Për ta ruajtur e kultivuar këto marrëdhënie duhet të vazhdojë e thellojë këto raporte, por edhe me media për të ruajtur e avansuar identitetin e mirëfilltë fetar e kombëtar.

Porosia antologjike dhe historike e Hafiz Ali Riza Ulqinakut, është një monument i gjallë që bashkëdyzohet me ruajtjen dhe avansimin e identitetit fetar dhe kombëtar shqiptar:

..."Arnautçe bana, kast mej ba bejan,
Shqip, n gjuh ton fajde let jet për avam..."

Një personalitet nga Kraja që ka lënë trashëgimi të rëndësishme kulturore të përmasave të mëdha fetare dhe kombëtare, pa mëdyshje është shejh Tahir Kanaqi.

Dom Frano Markiqi, një klerik i ritit katolik nga Kllezna,Ulqin, ndër të tjera citon kronistë të kohës se "Tahir Kanaqi ishte përhapës i arsimit shqip në masën e fshatarëve të zonës (Krajës). Ai solli në fshat një abetare shqipe në vitin 1929 me anë të së cilës mësuan disa të rinj. Gjithashtu edhe në mejtep, krahas mësimeve të fesë, jepte orë mësimore në gjuhën shqipe, për kulturën dhe gjuhën amtare".

Bibliografia

1. Stipçeviq Aleksandër,Ilirët,Rilindja,1980,Prishtinë
2. Shaqir Ismaili "Bojku",Art Club,Ulqin,2011
3. Nail Draga,"Shqiptarčt nč Mal tč Zi"
3. Ali Llunji,160- vjetori i lindjes së Hafiz Ali Riza Ulqinakut, MI BI- 2015 Ulqin,
4. Ruzhdi Poda,Rozafat,2007,Shkodër
5. Imam Muhamed M. Sytari,Thirrja islame ne Mevludin e H.A.R.Ulqinakut, MBI- 2015 ,Ulqin
6. Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet",1998
7. Hajredin Muja,"Kisha e sherrit",Logos,Shkup, 2014.
8. Mevludi Sherif,KBI të MZ,Titograd,1975.
9. "Jeta dhe veprimtaria e sheh Tahir Kanaqit ,,, OJQ „Harmonia",2014 Ulqin

Florimont GOJANI

STRUKTURA DHE RENDI I GJYMTYRËVE NË PROZËN E MIGJENIT DHE STANDARDI I SAJ GJUHËSOR

Abstakti:

Në modelin e strukturës së rendit të gjymtyrëve në veprën e Migjenit, ndiqet një model i caktuar, që buron nga modelet e gjuhës përkatëse në të cilën shkruan autori. Punimi i kësaj teme është një përfshirje për çështje të ndryshme të shqipes standarde të botuara e të pabotuara për standardizimin e normës sintaksore.

Struktura gramatikore e Migjenit është përshkruar nëpër studime të ndryshme. Duke u nisur nga çështjet e shtruara në kumtesën tonë nuk gjejmë një zgjidhje të plotë e përfundimtare, mirëpo ato presin të zgjidhen gradualisht. Ky punim është mbështetur në një material nga vepra e Migjenit. Për ndonjë çështje të veçantë është përdorur gramatika e krijuar nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, sepse influencën për të zhvilluar gjuhën Migjeni e ka ndërtuar mbi bazën e logjikës, për të arritur efekte të një standardi në rendin e gjymtyrëve në prozën e tij.

Fjalët Kyçe: rendi i gjymtyrëve, Migjeni, standardi, proza, sintaksa e Migjenit

Hyrje

Migjeni shkroi në të folmën e Shkodrës, me karaktersitikat e saj. Ai e pasuroi gjuhën e tij me fjalë e shprehje të krahinave përreth e ndonjëherë edhe të krahinave më të largëta. Ndonjë influencë të rrallë dialektore të jugut gjejmë edhe te Migjeni. Ai kishte vështirësi për të shkruar gjuhën shqipe kur u kthye nga Manastiri, mirëpo ai ia mori dorën shumë shpejtë dhe filloi të shkrojë një gjuhë të bukur e të pasur popullore. Migjeni të metat e tij në gjuhë i kishte në trajta disaherë ngushtësisht dialektore të tij dhe në ortografinë e lëkundëshme.

Përmbledhje

Elementi kryesor, një ndër rregullat elementare të sintaksës është përshtatja e gjymtyrëve kallëzuesit me kryefjalën dhe përcaktorit me fjalën e përcaktuar. Dihet se kallëzuesi duhet të përshtatet me kryefjalën në numër dhe në vetë[8], ku kallëzuesi vihet në po atë numër në po atë vetë, që është edhe kryefjala[9]. Te proza e Migjenit, si akt i të folurit, e kishte në shprehje edhe aktin e të menduarit, prandaj në realizimin e tij, akti i komunikimit nëpërmjet prozës së tij ka analogji dhe me aktin e të menduarit.

Gogoli i ka hapë shalët nga njena anë e kontinentit në tjetër[10].

Subjektin që e mendon Migjeni, ekziston në një moment të caktuar të kohës reale në përgjithësi; p.sh kallëzuesi është në numrin njëjës dhe në vetën e tretë ***i ka hapë shalët***, sepse edhe kryefjala ***gogoli*** është në numrin njëjës dhe në vetën e tretë. "Rendi i pjesvet të fjalis âsht i drejtë, kur rrin subjekti para verbit në mënyrë skâjore. Ky rend i drejtë i kryegjymtyrvet shkon sidomos ndër fjali, ku kalxohet a diftohet ndonji gjâ (fjali diftore)". Me këtë ndërtim fjalie qëndron Migjeni në atë, se e tashmja, realiteti dhe e kaluara është progresiv. Një vlerësim që nuk mbështetet vetëm në idetë, apo pikëpamjet, por në tërë strukturën e rendit të gjymtyrëve në fjali, meqë në letërsi mendimet nuk venerohen veçmas si në filozofi, por të gërshetuara në strukturën sintaksore.

Tufani i tmerrshëm nuk fryni as nga një anë e horizontit, dhe as nga qiella, por duel nga zemra e dheut[11].

Mbiemrat ***i tmerrshëm***, ***e horizontit***, ***e dheut***, marrin gjinin, marrin dhe rasën e fjalëve ***tufan***, ***anë***, ***zemra***, që cilësojnë. Zbatohen drejt rregullat e përshtatjes në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar.

Mirëpo shkrimi dialektor i Migjenit, të qëllon të ndalësh në ndonjë fjali, sepse të vret veshin ose nuk e kupton se çfarë ka shprehur autori. Prandaj në atë kohë letërsia ishte dialektore, sikundër në fonetikë, në morfologji edhe në leksik.

Struktura dhe rendi i gjymtyrëve në fjali varet nga arsyeja gramatikore që ka përdorur Migjeni për arsyeje stilistike. Sepse, vendi i

---

8 ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 414

9 Ilia Dilo Sheperi, Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e toskënishtes), Vlorë, 1972, f. 143

10 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 96

11 Migjeni, vep. e cit. f. 91

gjymtyrëve të fjalisë përcaktohet nga faktorë të ndryshëm: kryesisht nga gjymtyrëzimi aktual, nga arsyet stilistike dhe, më rrallë nga funksioni i tyre sintaksor[12]. Shpeshherë Migjeni në prozën e tij e përmbys rendin e zakonshëm të gjymtyrëve në fjali. Arsyeja e posaçme, tingulli i fjalëve që e bëjnë pikënisjen e thënies, mund të jetë edhe i palëvizshëm e të ketë vlerë gramatikore. Migjeni krijon një standard fjalësh, duke e ndërtuar fillimin e tyre me një fjalë më të theksueshme, të cilën e vë në krye të fjalive. Ka raste kur edhe ia jep rëndësinë më të madhe, ndryshon strukturën e rendit të gjymtyrëve, prish lidhjen midis fjalive dhe e bën fjalinë të pakuptueshme[13].

Në prak të kasollës del një plakë, tue i mbyllë sytë përgjysmë nga se drita e ditës pranverore asht në kulëm të shkëlqimit dhe e verbon[14].

Në strukturën e fjalisë shohim që autori vë në fillim të fjalisë fjalët që përcaktojnë gjendjen emocionale, ndenjat e tij.

- Me fal ndoj send, të dhashtë Zoti shëndet...[15]

Në sintaksën e Migjenit gjejmë liri përsa i përket rënditjes së fjalëve në fjali, kriter[16] ky që fjalët mund të lëvizin brenda tyre. Kjo na jep të kuptojmë se në prozën e Migjenit kishte karakter spontan e here të vetëdijshëm, por gjithsesi jo kurdoherë sipas kriterit të rednit të drejtë[17].

Proza e Migjenit është shprehëse për të treguar se sa rëndësi ka struktura e gjymtyrëve në fjali, dhe atëherë kur gjymtyrët dalin, jo me rendritjen sipas lidhjes së tyre kuptimore, por sipas funksionit gramatikor, kur, me ndihmën e tij, përcaktohen funskionet e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë[18].

Idhujt pa krena! Në varrimin e tyne kumonët kanë për të plasë së ranit, minarët kanë për ta kthye korrizin së faluni dhe zhrecve do t`u këputen telat e fytit së kënduemit[19].

---

12 ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 415

13 ASHSH, po aty

14 Migjeni, vep. e cit. f. 90

15 Migjeni ,vep. e cit. f.86

16 Thoma Dhima, Gjuha shqipe Sintaksa, Tiranë, 2005, f.23

17 Justin Rrota, Sintaksi i shqipes, Shkodër, 2005, f. 56

18 ASHSH, po aty.

19 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 103

Kështu Migjeni përmes fjalëve, "***për ta kthye korrizin, kanë pë të plasë së ranit***" ndonëse jo me vend, mirëpo përdoren edhe për të treguar mënyrën ose mjetin me anën e të cilit kryhet një veprim. Arsyet emocionale janë te Migjeni, kur fjalët i vë në fillim të fjalisë, madje edhe të periudhave, ato që shprehin mallkimet, dhe i caktojnë fjalës vendin e parë[20].

Një çështje me peshë në strukturën e gjymtyrëve te Migjeni është edhe korrelacioni i trajtave kohore të kallëzuesit, përshtatjes së saj me gjymtyrët e tjera, që i japin kuptime dhe funksione sintaksore brenda fjalisë.

Qershija dhe malsorja janë randue nga frytet e veta e natyra kënaqet dhe qeshet[21].

Në këtë fjali kur kryefjala vihet në fillim pastaj kallëzuesi dhe gjymtyrët e tjera, kemi të bëjmë me lidhjen e fjalëve me një rend rreptësisht të caktuar. Në fjalinë dëftore te Migjeni zakonisht kemi rendin më të zakonshëm kryefjalë + kallëzues + gjymtyrë të dyta[22], Migjeni shpreh forcën emocionale për lexuesin,

Politika asht një kameleon, i cili – dihet – simbas vendit ku gjendet merr dhe ngjyrën[23].

me të cilën Migjeni forcën e shprehjes të e tregon nëpërmjet kallëzuesit.

Kryefjala te Migjeni është problematike, që realizohet me forma të ndryshme të fjalive të shtjelluara, ku nëpërmjet saj Migjeni tregon organizimin e fjalisë së përbërë. Strukturën që ka Migjeni, zbulohen elemente pozotive që janë në pajtim me zhvillimin e strukturës së brendshme gjuhësore të shqipes; ku na dalin interferencat midis gjuhës letrare dhe asaj dialektore, për të cilën edhe jemi duke diskutuar. Shpeshherë vendin e gjymtyrëve në fjali e përcaktojnë, përveç kuptimit dhe arsyeja tjetër e shprehjes së autorit. Në rëndin e gjymtyrëve te proza e Migjenit kemi jo shpeshherë shkelje të normës letrare në përgjithësi, por edhe të këtyre ligjëve, veçanërisht në sintaksë. Mjaft të ndërlikuar e kemi edhe përshtatjen kohore të kallëzuesit, mos përdorimi i trajtës së shkurtër të përemrit vetor që e përsërit kundrinorin, e që qëndron përpara foljes[24].

---

[20] Stefan Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, f. 27

[21] Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 89

[22] ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 125

[23] Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 88

[24] Mahir Domi, Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa, Prishtinë, 1971, f. 95

*Rrin malsorja në prak të kasolles dhe në fytyrë të zbetë të sajën **i** skuqen buzët mu si qershijat në degëz*[25].
Të gjithë eksperimentet e bamë deri sot, vetëm që shpejtuen kalbbsinën e kufomës[26].

Por, falemi Perëndisë![27]

Edhe në periudha me fjali të varur qëllimore, kryefjalore, kundrinore, ka shamgie nga norma letrare në përshtatje të gjymtyrëve, dhe në kohë me foljen-kallësues në mënyrën lidhore (kur kemi kallëzues të përbërë foljor)[28].

Praktik ashtu siç e ka dhanë natyra, në fund-fundit, njeriu dijti me zgjedhë[29].

Në periudhën me fjali të varur kryefjalore që Migjeni përdor nuk u përgjigjet natyrës së foljes së fjalisë drejtuese, prej së cilës varet, por duke u mbështetur në korrelacionin e vërtetë të tyre nga mënyra se si mendohet ndërtimi i tyre[30]. Fjalia kryefjalore, të varur nga po ajo folje ta kenë kallëzuesin në mënyrë të ndryshm, here në dëftore, here në lidhore.

Ata që kishin lindur para se t'u shembeshin idhujt dhe i panë me syt e vet në bukurinë e tyne ceremonijale, ata tash rrënkojnë, pshertijnë për kohën e idhujvet të vjetër, dhe tue vdekun shpresojnë se këta idhujt do t'i shpetojnë[31].

Në këtë strukturë sintaksore përdorimi i trajtave të kohëve të kallëzuesit foljor në mënyrën lidhore mund të përcaktohet nga koha e kallëzuesit foljor në fjalinë kryesore[32]. Po ashtu, së strukturën sintaksore paraqitet kallëzuesi i fjalisë kryesore në një nga kohët e dëftorës, ndërsa ai i fjalisë së varur vihet në kohë të mënyrës lidhore; por mund të ndodh edhe e kundërta të mos kenë përshtatje kohësh.

Në strukturën e rendit të gjymtyrëve në prozën e Migjenit zakonisht fjalia kryesore shprehet me trajtat e kohëve të së shkuarës. Po ashtu, në përgjithësi

---

25 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 89

26 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 83

27 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 69

28 ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f.183; Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Prishtinë, 2013, f. 205

29 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 69

30 Stefan Prifti, vep. e cit. f. 259

31 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 91

32 Mahir Domi, Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa, Prishtinë, 1971, f. 118

përdoret e tashmja e lidhorës, tregohet veprimi që kryhet ne çastin e ligjërimit ose që pritet të kryhet[33]. Strukturën e gjymtyrëve që Migjeni ka kushtëzohet nga kuptimi kohor i kallëzuesit të fjalisë kryesore, si pikë referimi simbas kontekstit që ka treguesin kohor të rrethanës, situates etj. Ndonjëherë treguesit e lidhjes në renditjen e gjymtyrëve, si në fjalinë kryesore dhe në atë të varur, ose të fjalisë me fjalinë tjetër janë elemente të ndryshme leksikore. Përdorimin e gjerë e kanë disa ndajfolje (kështu, ashtu).[34]

Q'ashtu njeriu i a luejti lojën… kujt?... vehtes! vehtes! – bërtet morali prej mërgimit[35].

Mirëpo ka raste kur kryefjala shprehet me një emër përmbledhës, si njerëzia, folja vihet në shumës[36].

Njerzija humbi kryet ose njerzija humbasin kryet…[37]

Kjo lidhje e brendisë që shprehet, shënon një objektiv që duhet të arrihet, përkatësisht brendia e fjalisë, e ndertuar me lidhore, jepet si diçka joreale, si diçka e dëshiruar, e supozuar etj.

Edhe struktura e formave të pashtjelluara që Migjeni përdor, si format e paskajores: ***me jetue, me qenë*** që kanë raportin e maskohesisë në lidhje me kuptimin kohor të kallëzuesit të thjeshtë foljor. Kjo tregon arsyen që Migjeni ka në strukturën e rënditjes së gjymtyrëve në fjali ku vihet kuptimi modal i domosdoshmërisë, i vullnetit, i urdhërit etj., që kushtëzohet jo vetëm nga kuptmi leksikor i rënditjes së gjymtyrëve në fjalinë kryesore, por edhe mënyra e të menduarit të përmbajtes së fjalisë së varur. Mos përshtatje të kallëzuesit me vetën e kryefjalës, po ashtu nga format kohore në përgjithësi, si në shembullin:

Kalimtarët mendojshin se djali deshti t'i vjedhi prej xhepit ndonj gja zotnis, e se ky për këto arësye i ra[38].

Ngatërrimet i shohim në disa shembuj dhe nuk besoj që Migjeni i ka përdorur

---

33 Ilia Dilo Sheperi, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f.75

34 Mahir Domi, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, f. 42

35 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 70

36 Rami Memushaj, Shqipja standard, Tiranë, 2008, f.103

37 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 71

38 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 74

për ndonjë qëllim të caktuar stilistikor. Simbas, shqipes standarde[39]kallëzuesi i fjalisë kryesore është në të tashmen, në të ardhmen dhe në të kryerën e mënyrës dëftore, kurse ajo e periudhës me fjali të varur (që lidhet me lidhëza ftilluese), vihet në kohën e tashme. Kur folja kallëzues e fjalisë kryesore është në njërën nga kohët e tjera të së shkuarës të mënyrës dëftore, folja – kallëzues e fjalisë së varur zakonisht vihet në të pakryerën[40]. Këto tipe ndërtimesh sintaksore në prozën e Migjenit paraqesin veprimin e rrjedhjes së ligjërimit, ku në shqipen standarde paraqesin normë. Kurse struktura sintaksore në periudhë, përdorimi i së pakryerës së lidhorës sa herë na paraqitet në përfundimin e veprimit në standardin e shqipes paraqet normë[41].

Por kur padreja filloi t'u kërcenohej atyrne që vjedhin, dhe n'atë mënyrë e preku n'itimitetiet lypsin, ky u çue, duel jashtë…[42]

Të marrim shembullin ku s'ka përshtatje kohore të kallëzuesit në strukturën sintaksore në rënditjen e gjymtyrëve në periudhë.[43]

Partija e shtetit X nuk dinte ç'të bajë dhe si t'a vendosi çashtjen e krizës…[44]

Kjo dukuri është e shpeshtë edhe në gjuhën e folur, në disa romane, në gazetë në gjuhën e radiotelevizionit, për fat të keq, ku përdoren stile të ndryshme.[45]

Struktura dhe rendi i gjymtyrëve në prozën e Migjenit sipas standardit që kanë varen nga arsye gramatikore dhe stilistike[46]. Për të krijuar efektet e dëshiruara Migjeni ka përmbysur rendin e zakonshëm të gjymtyrëve në fjali. Për të përforcuar bukurinë e shprehjes së mendimit, ndihmon në raste të caktuara edhe ndryshimi i rendit të zakonshëm të fjalëve që kthehet në një mjet shprehës mjaft efektiv[47]. Në ato raste kur kemi shtrembërime në strukture të rënditjes së gjymtyrëve, ndoshta nuk sjellin ndonjë vështirësi në kuptimin e rrjedhshmërisë së fjalisë. Dihet se qartësia e mendimit disaherë varet nga vendi që zë lidhëza në fjali. Gjatë rasteve të analizës së strukturës në disa proza të Migjenit, ku kishim disa shprehje

39 Rami Memushaj, Shqipja standard, Tiranë, 2008, f.106

40 Rami Memushaj, po aty.

41 ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 507

42 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 83

43 Stefan Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, f. 59

44 Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963, f. 76

45 Stefan Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, f. 59

46 Thoma Dhima, Gjuha shqipe Sintaksa, Tiranë, 2005, f.30

47 Thoma Dhima, po aty.

rregullash në përshtatje që ishin të ndryshme dhe krijoheshin rrethana të tilla që i favorizojnë këto gabime. Këtu na krijohet pyetja: ***Ç'duhet të marrim parasysh në përshtatjen e gjymtyrëve në prozën e Migjenit, formën gramatikore apo kuptimin stilistik***?

Përfundimi

Mund të nxjerrim shembuj të shumtë nga ajo pak prozë e Migjenit, përdorimi i kallëzuesit, renditja e gjymtyrëve në periudhën me bashkërendtije dhe në periudhën me nënrënditje' që nuk është në pajtim me normën e standardit. Ndodh që në ligjërimin e shkruar dhe më shumë në të folur të përdoren, pa qenë e nevojshme, ndërtimet e huaja[48]. Po ashtu, rendin e gjymtyrëve në fjali më tepër kujdes duhet treguar në përkthime. Për këtë arsye edhe mendimet e thjeshta shpeshherë kuptohen me vështirësi.

Bibliografia:

- ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002
- Ilia Dilo Sheperi, Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e toskënishtes), Vlorë, 1972
- Justin Rrota, Sintaksi i shqipes, Shkodër, 2005
- Mahir Domi, Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa, Prishtinë, 1971
- Mahir Domi, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971
- Migjeni, Poezi e prozë, Prishtinë, 1963
- Rami Memushaj, Shqipja standard, Tiranë, 2008
- Stefan Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971
- Thoma Dhima, Gjuha shqipe Sintaksa, Tiranë, 2005
- Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Prishtinë, 2013

[48] Rami Memushaj, Shqipja standard, Tiranë, 2008, f.107

Shefqet Dinaj

TRASHËGIMIA TRADICIONALE ME VLERA MUZEALE NË SKIVJAN TË GJAKOVËS

Parathënie

Objekt trajtimi në këtë studim është trashëgimia tradicionale përkatësisht arkitektura e objekteve shqiptare të banimit e në theks të veçantë historiku i rrënimit të ndërtimtarisë tradicionale me vlera muzeale në Skivjan.

Në fillim do të japim një pasqyrë të shkurtër të veprave artistike, monumenteve në territorin e Skivjanit të sotëm që nga antikiteti i hershëm e deri në ditët e sotme.

Në këtë studim do të fokusohem në objektet e banimit që nga shtëpitë e vjetra të ndërtuara nga druri dhe dërrasa e drurit të bungut (shek. XVII-XVIII), shtëpitë e qerpiçit, shtëpitë e gurit e deri te kulla si banesë ose si fortesë. Do të shquhen vlerat e larta materiale e shpirtërore të shqiptarëve të Skivjanit ne veçanti e të Kosovës e më gjerë në përgjithësi.

Këto objekte tradicionale kanë vlera të larta muzeale të cilat janë indikatori më i mirë që flet dhe tregon në mënyrë shumë të fuqishme identitetin dhe etnitetin e kombit shqiptar.

Ndërtimtaria tradicionale e Skivjanit u realizua në periudhë të gjatë historike. Në bazë të gjetjeve arkeologjike të cilat i disponojmë dhe në bazë të dëshmive të tjera që priten të verifikohen në një të ardhme të shkurtër, ky lokalitet banohej nga fisi ilir i dardanëve si paraardhës i banorëve të sotëm shqiptar. Për shkak të rrethanave historiko-shoqërore dhe aktiviteteve natyrore ky lokalitet u rrënua disa herë, por gjithë herë mbeten themele të forta të mos zhdukjes të identitet kombëtar.

Një fat i keq e ndoqi edhe për gjatë shek. XX, veçanërisht kullën shqiptare e cila kohë pas kohe u plaçkit u rrënua pjesërisht, u ndryshua arkitektura në pjesë të ndryshme të mureve të saj, u dogj, u rrënua nga pushtuesi dhe sunduesi serbo-sllav. Nga shumë kulla të Skivjanit ngelën vetëm mbetje (skelete) të mureve të tyre të cilat u rrënuan dhe po rrënohen edhe sot nga pronarët e tyre me qëllim që të evidentohet më e keqja, ndonjë tragjedi familjare nga shembja e tyre.

Për realizimin e këtij studimi do të bazohem në literaturën bazë dhe në hulumtimet e mia në lokalitetin Skivjan nga vitet e ’80-ta e deri më sot.

Qëllimi im është prezantimi i objekteve, shtëpive, kullave të Skivjanit para dhe pas shkatërrimeve gjenocidale të kësaj trashëgimie kulturore nga sundues të ndryshëm e veçanërisht nga barbarët serbë në 100 vitet e fundit nga luftërat ballkanike e deri në vitin 1999 kur përfundoi lufta e fundit e popullin shqiptar të Kosovës e udhëhequr nga UÇK. Po ashtu mëtoj të ndikoj në vetëdijësimin e qytetarëve për ruajtjen, mbrojtjen dhe restaurimin e këtyre objekteve të mbetura të trashëgimisë kulturore me vlera të larta muzeale dhe kombëtare.

Kjo pasuri nuk i takon vetëm banorëve të Skivjanit por ka vlera të mirëfillta edhe për thesarin kulturor botëror.

Jam i vetëdijshëm se ky punim do të jetë vetëm një hap drejt prezantimit, studimit dhe kundër rrënimit të ndërtimtarisë tradicionale me vlera muzeale në Skivjan. Shpresoj që në të ardhmen do të gjejë mbështetje nga Drejtoria e Kulturës dhe institucionet e tjera relevante në thellimin e hulumtimeve, aktivizimit të grupeve arkeologjike, konsultimin e literaturës në biblioteka dhe arkiva të ndryshëm jashtë shtetit të Kosovës me qëllim që të vije deri te hulumtimi më i thelluar dhe më i mirëfilltë për lokalitetin Skivjan.

Historik i shkurtër i Skivjanit

"Skivjani shtrihet në fushë në të dy anët e rrugës Gjakovë-Pejë, 4-5 km në veri të Gjakovës. Është vendbanim i tipit të grumbulluar"[1]
Sipas të dhënave kadastrale ky vendbanim shtrihet në sipërfaqe prej 860 ha, 72 ari, 48 m.

Familjet e vëllazëritë të cilat jetojnë sot në Skivjan janë: Hadri, Tolaj (Dinaj, Tahiraj), Nezaj, Jakupaj, Vilaj, Metaj, Shoshët, Mazrekët (Selimaj), Stojkët, Hulaj, Gjokaj, Mirakaj, Koliqaj (Ibrahimaj), Haxhisalitë (Islamaj), Bushatët, Hasanaj, Rragomi, Gjihollët (Gjikollët), Malushët, Avdiajt, Alimusaj (Musaj), Malushaj, Nimonaj, Shehu, Hoti, Mehmetaj, Ademaj, Ukshinmiftarët (Bajramajt), Thaqët, Kasumajt, Rrustemajt, etj.

Meqë ky lokalitet është shumë i lashtë ka një mikrotoponi shumë karaktarestike: Lumi Krena, Zabeli i Hadrit, Ballabani, Gurinat, Rrethi i Berberit, Piskota, Kungullarja, Livadhi i Madh, Rrethi i Dobrunës, Livadhi i Bajramit, Livadhi i Canës, Rezinat, Sustanket, Zhllagat, Dumanet, Orizet, Livadhet e Epra, Sejishtat, Rrethori, Lugu i Zepçit, Lugu i Bajramit, Kroni i Hadrit te Tyrbja, Kroni i Asllan Beqës, Kroni i Haxhisalihëve, Kroni i Zallinave, Kroni i Muhaxherit, Tyrbja e Dervish Brahës, Varret e Macurëve, Lugu i Arave të Thata, Bunari i Xhamisë, Shtogina etj.

[1] Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës- Gjakova 14, Shkrola, Prishtinë 2005, 237.

Sipas traditës, thënies së popullit është vendbanim shumë i vjetër, më i vjetër se Gjakova. Thuhet se në qendër të fshatit ekzistonte një vendbanim romak ku edhe sot shihen themelet e ndërtesave.[2]

Tjegullat e paraqitura në fig. 1 janë gjetje arkeologjike të cilat i takojnë kësaj periudhe. Një gjë të tillë e argumentojnë edhe shumë eksponate tjera arkeologjike që janë gjetur në Skivjan.

Fig. 1. Tjegulla të periudhës romake të gjetura në Skivjan në vitin 2005.

I një rëndësi të veçantë është ujësjellësi i gjetur në fshatin Dujakë në arën e quajtur Mrize, në veri të Skivjanit, i cili mendohet se është furnizuar me ujë nga burimi "Kroni i Mylkut" në fshatin Hereq[3] dhe ka vazhduar deri në lokalitetin mesjetar Skivjan fig. 2

Fig.2 Gypa ujësjellësi nga balta e pjekur, Dujakë

[2] Po aty, 238

[3] Kroni I Mylkit- Gjendej në fshatin Hereqë. Me ardhjen e kolonëve sllavë u ndryshua edhe emërtimi - toponomia nga "Kroni i Mylkit" (pasurisë, bereqetit etj) në "Kroni i Mujkut"- toponim i cili gjendet në regjistrat kadastral të Gjakovës.

"Thuhet se në këtë vend ishin Varret e Macurëve, dhe mendohet se Macurët ishin një prej popullsisë ilire".[4] Këtë e dëshmon edhe gjetja e Mokrave Ilire (gurë mulliri për bluarjen e drithit të cilat vërtiteshin me dorë), fig. 3 e që është një thesar për kulturën dhe trashëgiminë tonë shqiptare.

Fig.3 Gurë mulliri (Mokra ilire) Skivjan

"Po ashtu flitej se këtu ishte një vendbanim më i madh se Gjakova. Fshatarët këtu kanë gjetur poçeri të ndryshme"[5]. Për këtë shih fig. 4. "Gurë dhe pllaka me mbishkrime"[6] fig. 5. Gjithashtu kemi të dhëna se në Skivjan " janë farkuar monedha ndërsa në lokalitetin Kallavaj është shkrirë edhe kallaji".[7]

Fig.4. Poçeri, Skivja

[4] Jusuf Osmani, vep.cit. 338

[5] Po aty, 238

[6] Po aty, 238

[7] A. Djogovic, Onomastika Djakovice i okolnih sela, Onomatoloski prilozi, VIII, Beograd 1987, 283 dhe J. Osmani, vep.cit. 238.

Fig. 5. Epitaf, Skivjan

Fig.6. Tulla të gjetura te xhamia e Skivjanit

Sipas një burimi, vendbanimi shumë i madh i periudhës antike ka ekzistuar në vendin e quajtur Lugu i Arave të Thata tek Skivjani.[8]

Në lokalitetin Skivjan gjerë me tani janë gjetur shumë gjurmë arkeologjike të kulturës materiale, si p.sh. "në perëndim të fshatit, mbi lumin Krena, në shumë vende si: te xhamia, te Ura e Epërme, te Gurina etj. janë gjetur monedha ilire, tjegulla, gurthemele, tulla etj.[9] Fig. 6

"Në lokalitetin e sotëm të xhamisë ishte kisha shqiptare, me gurët e së cilës banorët vendës, pas përqafimit të islamizimit e ndërtuan xhaminë (e cila u rindërtua në vitin 1988) fig. 7. Thuhet se është zbuluar një guri shumë i vjetër i periudhës romake, me shkrim dhe numra romak- DCXIII, thuhet i vitit 613?"[10]

"Në dokumente të shkruara përmendet më 1020 me emrin DEASKONRISON, SEACOUMITZON".[11]

Pastaj me emrin Livjani përmendet në vitin 1330 në krisobulën e Deçanit[12]. Në defterin kadastral turk të vitit 1485 ishin të regjistruar me emrin Slojani me 50 shtëpi, 23 beqar e 5 të veja.[13] "Ky Slivlani që nga vitet e shtatëdhjeta të shek. XVI kultivonte orizin[14], me ç'rast edhe ekziston toponimi "Orize" në Skivjan.

---

[8] Toponomia e Gjakovës me rrethinë, Gjakovë 2003, punimi i prof. Edi Shukriut, Trashëgimia arkeologjike… 45-49 dhe J. Osmani, vep.cit. 238

[9] J. Osmani, vep.cit. 238 dhe dëshmi të qytetarëve të Skivjanit

[10] Po aty, 213- sipas shënimeve të marrura gjatë vizitës së fshatit më 11.11.2001, nga Hazir dhe Fadil Selimaj dhënë dr. J. Osmanit.

[11] I. Jastrebov, Stara Serbija, ff.15-41; S. Gashi, Fjalor… Dr. J. Osmani, vep.cit. 238

[12] St. Novakoviç, zakonski spomenci srpski zemalja srednjega veka, Beograd 1912 dhe J. Osmani, vep.cit. 238

[13] Defteri i Regjistrit të Sangjakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë 1947, Nr. 462

[14] J. Osmani, vep.cit. 238

"Me emrin SKIFIANI është i regjistruar si vendbanim në një hartë austriake të vitit 1689".[15]



Fig.7. Skivjan, Xhamia e rindërtuar 1988

Në aktin e arqipeshkv Pjetër karagjiqit të vitit 1725 shkruan se në qytetin e Gjakovës misionar apostolik është don Gjon Gjoni dhe misioni i tij përfshinë edhe fshatin Scipsciani 1 shtëpi më 4 anëtarë besimtarë të krishterë.[16] Në dokumentet kishtare të Kishës së Zymit që janë ruajtur që nga viti 1842 është i regjistruar ky vendbanim.[17]

Pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit më 1878, disa familje (muhaxhere) vendosen në fshatin Skivjan.[18]

"Me emrin Eskifjan është i regjistruar si vendbanim në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të viteve 1893 (1311h), 1896 (1314 h) dhe 1900 (1318 h)".[19]

Për toponiminë e Gjakovës është po ashtu karakteristike proteza e i-së dhe e-së para bashkëtingëlloreve spirante: Eskifjan< Skivjan.[20]

Toponimi Eskifjan si emër i vendbanimit të sotëm Skivjanit gjendet i shkruar në epitafin (gurin e varrit) të gjetur në thellësi të tokës në oborrin e xhamisë së Skivjanit në vitin 1988 nga kryeplaku i xhamisë Malë Asllan Dinaj,

[15] Po aty, 238

[16] Frok Zefi, Arqipeshkvnia Shkup-Prizren në shek. XVIII- Osijek 2001, 131 dhe J. Osmani, vep.cit. 238.

[17] J. Osmani, vep.cit. 239

[18] Sabit Uka, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve muhaxhirë në Kosovë- 1878-1912, libri 3, pjesa e dytë, f. 287 dhe J. Osmani, vep.cit. 239

[19] J.Osmani, vep.cit.239

[20] Toponomia e Gjakovës me rrethinë, Gjakovë 2003,punimi i Abdullah Konushevcit, Toponimet e Gjakovës, f.206 dhe f.208.

Misin Emin Nezaj, Shaban Shoshi, Haxhi Hyseni, Bajram Gjiholli etj. dhe Mulla Ali Elezi (hoxhë nga Gjakova). Meqë ishte i këputur në pjesën e poshtme, aty ku duhet të jetë viti, mendoj se daton nga viti 1834 (1251 h). Fig.8. Ky objekt prej guri është i shkruar në gjuhën osmane me alfabet arab.

Fig.8 Skivjan, Epitaf me emrin Eskifjan, 1988

"Lidhur me monumentet arkeologjike, A.J. Evans zë n'gojë dy sosh epigrafike të karakterit sepulkral, ku në njërin ka hasur në fshatin Gjegjan, që si duket fjala është për fshatin Gegjë, për të cilën nga vendësit është informuar se është nxjerrë nga Drini tek Ura e Fshejtë, ndërsa tjetri është gjetur në fshatin Skivjan, për të cilin ka mësuar nga Jastrebovi, por që nuk ka mundur ta shohë, kështu që ky monument ka mbetur anonim".[21]

Tani e posedoi edhe një pllakë prej gurit të bardhë, në të cilin është i gdhendur një numër katër shifrorë apo ndonjë shkrim tjetër që për momentin është i pa deshifruar e që duhet duket kështu: Fig.9.

Fig.9. Skivjan, Objekt- guri i padëshifruar

[21] Toponomia e Gjakovës, vep.cit. punimi i Dr, Exhlale Dobruna - Salihu, të dhënat arkeologjike- toponomike për trevën e Gjakovës, f.55.

Studiuesi Mehmet Halimi në punimin me titull: Tipet e fjalëformimit të emërvendeve në rrethinën e Gjakovës e më gjerë, në kuadër të emërvendeve që mbarojnë me prapashtesën shqipe- AN: - SKIVJAN[22]- vë edhe Skivjanin.

Dr. Sabit Ukaj toponimin Skivjan nuk e rangon në asnjërën nga veçoritë gjuhësore si shqipe, turko-osmane e as sllave. Ky toponim kërkon studim të veçantë.[23]

Prof.dr. Ruzhdi Pllana në studimin: Disa çështje të oronomisë dhe të Hidronomisë të rrethinave të Gjakovës përmend Dervishollin (430m) lartësi mbi detare (Oronim), Proni i Malit- rrjedhë ujore- (Hidronim) dhe Skivjan (afërsia).[24]

Që nga viti 1928 këtu u kolonizuan 27 familje nga Serbia, Mali i Zi dhe Bosna e Hercegovina, numri i tyre në vitin 1941 u rrit në 40 shtëpi.[25]

Arkitektura e vjetër e banimit në Skivjan

Ndër objektet më të vjetra të Skivjanit ishte objekti i ndërtuar me material prej gurit e gëlqeres i cili gjendej në qendër të vendbanimit Skivjan. Ky objekt monumental mendohej se ishte kishë shumë e lashtë i cili u ndryshua dhe u kthye në faltore të besimit islam (në xhami) menjëherë pas vërshimit të trupave osmane në Kosovë.

Flitej se lëndët e drurit për ndërtimin e pullazit u morën në pyllin e dendur në territorin e Gjakovës së sotme. Në rrahun e pyllit, aty ku u prenë këto lëndë drunore u vendos familja e Jak Vulës, e cila thuhej se është familja e parë e qytetit të sotëm të Gjakovës.

Në murin e Xhamisë ishte një pllakë prej gurit e cila kishte të shkruar numrin 613 me numra romak DCXIII?

Xhamia e Skivjanit u kall në vitin 1952 nga sistemi i kohës, të cilës iu qit kulmi (pullazi) i ri nga banorët vendas. Mejtepi i saj shërbeu si shkollë.

U rrënua në vitin 1987 për tu rindërtuar, me ç'rast humbi shumë nga vlerat e arkitekturës tradicionale me vlera muzeale. Fig.10.

---

[22] Toponomia e Gjakovës..vep.cit. punimi i Dr Mehmet Halimit- Tipet e fjalëformimit të emërvendeve në rrethinën e Gjakovës, f.129

[23] Po aty, punim i dr Sabit Ukës- Përkime Onamastike të regjionit të Prokuples dhe atij të Gjakovës dhe disa veçori të Gjakovës me rrethinë, f.195.

[24] Po aty, punim i dr Ruzhdi Pllanës- Disa çështje të Oronomisë dhe të Hidronomisë, f.123, f.195

[25] Milovan Obradovic, Agrarna reforma I kolonizacija na Kosovu (1918-1941), ff.322-333 dhe J. Osmani, vep.cit. 239

Fig.10. Skivjan, Xhamia e rindërtuar në vitin 1988.

"Ndërtimtarinë kosovare e pasurojnë edhe objektet e arkitekturës fshatare të banimit të tipave dhe të varianteve të ndryshme që u ndërtuan gjatë periudhës osmane".[26] Meqë ne Skivjan nuk kanë mbetur objekte nga shekujt XV, XVI, XVII, objektet e më vonshme janë përcjellje të skemave kompozicionale të ndërtimeve të mëparshme të realizuar nga mjeshtër vendorë.

Ndërtimet e arkitekturës në Skivjan ishin nga më të ndryshmet. Në vazhdim po japim tipat e ndërtimit nga më të thjeshtat dhe më të vjetrat deri te ato më të ndërlikuarat:

Shtëpitë prej druri

Ishin objekte banimi, të ndërtuara nga lënda drunore. Nga skema kompozicionale ishin objekte përdhese. Të gjitha shtyllat dhe muret ishin nga bungu i gdhendur mjeshtërisht me sopat nga mjeshtër vendorë. Nga këto shtëpi të bukura me vlera muzeale kanë ngelur vetëm disa ekzemplar të dërrasës nga shtëpia e Zymer Sadrisë (Dinaj). fig.1

Fig.11. Skivjan, Dërrasa mbetje nga shtëpia e Zymer Sadrisë, - Dinaj

[26] Fejaz Drançolli, Rrënimi i kullës shqiptare, Prishtinë 2004, 59

Shtëpitë prej qerpiçi

Ishin objekte të ndërtuara nga qerpiçi i tharë në diell. "Këto ndërtime të arkitekturës ishin nga ato më të thjeshtat deri te tipi i çardakut".[27]

"Kjo vepër arkitekturale paraqet një variant të tipit me tremë të hapur. Ndërtimi përherë është në kat. Sipër përdheses apo hajatit prezantohet një galeri e hapur që njihet me emrin çardak. Çardaku me arkadat e saj shquhet me komponim dinamik. Ky dinamizëm përfitohet nga lëvizja e volumenëve të kateve ku kati i parë del mbi përdhesë duke ndikuar në efektin piktoresk të objektit".[28] Këto objekte dekorohen me shtylla dhe elemente prej druri. Dekorimet bëheshin edhe në divanhanet dhe Odat e burrave me shiklla në tavane, me rafte dhe dollap prej druri.

Fig.12. Skivjan, kullë prej qerpiçi e Sadri Fetahut (Selim Fetahut)

Nga këta ekzemplar të trashëgimisë kulturore me vlera muzeale kanë mbetur vetëm disa sosh si: Kulla e Sadri Fetahut, Shtëpia e Deli Bajramit (pjesërisht dhe shtëpia e Tahir Metës (gjysma) sepse pjesa tjetër u rrënua në vitin 2008 nga pasardhësit për shkak të mos sigurisë nga dëmtimet e bëra më parë.

Shtëpitë prej gurit

Në Skivjan është i njohur edhe një tip i arkitekturës fshatare. Fjala është për ekzemplarët e shtëpive të ndërtura prej gurit dhe lidhjes me llaç të gëlqeres së shuar. Këto objekte kanë shërbyer për banim dhe vendosjen e kafshëve në disa prej tyre.

---

[27] Fejaz Drançolli, Kulla shqiptare, Prishtinë 2001, 59

[28] Fejaz Drançolli, Rrënimi i kullës shqiptare, Prishtinë 2004, 59

Fig.13. Skivjan, Themelet e shtëpisë së Avdyl Hasanit - Dinaj

Fig. 14. Skivjan, Shtëpia e Adem Halilit-Alimusaj (Halil Alimusaj e rrënuar në vitin 2015)

Fig.15. Skivjan, muri i shtëpisë së Zeqë Athemit-djathtas

Fig.16. Skivjan, Shtëpia e Tahir Gjinit- Mirakaj

Pjesa dërmuese e këtyre shtëpive të bukura shqiptare janë rrënuar si pasojë e rindërtimeve, ose shkatërrimeve të ndryshme nga soldateska serbe. Kjo do të jetë një humbje e madhe për trashëgiminë tonë kulturore me vlera muzeale.

Kullat e Skivjanit- Historiku

Skivjani i takon vendbanimit fushor, andaj sigurimi i materialeve (gurëve) për ndërtimin e kullave sigurohej me mjaft vështirësi duke u bartur me qerre të drurit me tërheqje nga kafshët si Qe (kije), e më vonë kuaj, nga vende të largëta si Suka e Hereqit, Batusha, Poberxha e vende të tjera të komunës së Deçanit.

Kullat e Skivjanit ishin objekte banimi të ndërtuara me mund nga mjeshtër dibran me arkitekturë shqiptare.

Ato ishin dy dhe trekatëshe (sipas njësimit në popull). Vendbanimi ishte

i tipit të shpërndarë, andaj në Skivjan ekzistonin 13 kulla të bukura, të cilat u ballafaquan me vështirësi të natyrave të ndryshme nga armiq të brendshëm dhe të jashtëm.

Kullat e mbijetuara (ende të pa rrënuara)

Kulla e Jakupajve (Asmon Jakupit)

U ndërtua në vitin 1901 njëkohësisht me kullën e Metë Brahimit nga mjeshtër dibranë. Fig.27.

Fig.27. Skivjan, Kulla e Asmon Jakupit-Jakupaj

Kulla e Asmon Jakupit për nga planimetria arkitekturore është më dimensione me të mëdha se kullat tjera ekzistuese të Skivjanit. Ajo posedon dy bartës kapriatë mbi të cilat rëndojnë katet e sipërme.

Në vitet 1944-1945 për rreth gjashtë muaj qëndroi Brigada e Bukelit në këtë kullë dhe në kullat e Mustaf Metës, Metë Brahimit, Bajram Hadrit etj.

Në vitet 1950-1953 pronarët e saj detyrohen t'i prishin dritaret dhe nevojtoren dhe t'i kthejnë dritaret në kënddrejta me arsyetim të higjienës dhe ndriçimit. E vërteta qëndron se regjimi komunist në pushtet dhe sistemi ideologjik dëshironin t'ia ndryshonin arkitekturën tradicionale shqiptare duke i eliminuar harqet mbi dritare dhe frëngjitë. fig.28.

Fig.28. Skivjan, kthimi i dritareve në formë kënddrejtë

Kjo kullë posedon dyshekllëkun prej gurit të dalur nga muri perimetral.

Kulla ka katin përdhes në të cilën gjendet ahuri, pastaj kati i mesëm i cili lidhet me shkallë dhe hyrje nga oborri dhe nga jashtë (shkallët e burrave), në të cilën gjendet shtëpia e zjarrit dhe tri dhoma të fjetjes të ndara me dërrasa dhe baltë e gëlqerosur dhe kati i lartë i përbërë nga divanhanja, galeria, bagja dhe Oda e burrave e pajisur me Oxhak të dekoruar prej guri të gdhendur, dollapëve prej druri për vendosjen e kafes e gjësendeve tjera. Tavani i Odës është me shiklla të drurit të ahut.

Aktualisht në këtë kullë madhështore të kulturës sonë tradicionale jeton pasardhësi Ibër Hasan Jakupaj me familje. Fig.29

Fig.29. Skivjan, Kulla e Jakupajve (Haxhi Ibër Jakupaj)

Kulla e Fetahajve (Sadri Fetahut)

Karakteristikë e veçantë e kësaj kulle është se themeli i saj është i ndërtuar prej gurit me lidhje të llaqit gëlqeror ndërsa të tri katet janë të ndërtuara me material tullë qerpiçi, gjë që është i vetmi ekzemplar i kësaj natyre në Skivjan. fig.30

Aktualisht shfrytëzohet pjesërisht nga Selim Shaban Fetahaj me familje.

Fig.30. Skivjan, Kulla e Fetahajve

Kullat e rrënuara para luftës së fundit 1998-99

Në këtë kategorizim do të trajtohen pesë kulla shqiptare të banorëve të Skivjanit të cilat fatkeqësisht nuk ekzistojnë më, por vetëm ruhen kujtimet për to.

Kjo është një humbje e madhe për kulturën dhe trashëgiminë tonë arkitekturore tradicionale me vlera muzeale.

Kulla e Ali Musëve (Shaban Sadikut)

U ndërtua rreth vitit 1902. Kulla kishte arkitekturë tradicionale tri katëshe. Gurët e qosheve të mureve, gjysmëharqet dhe dyshekllëku ishte i ndërtuar me gurë e rrasa guri të kuq të cilët nxirreshin në bjeshkët e Botushës.

Digjet nga turqit për herë të parë me arsyetim se një mashkull i shtëpisë i quajtur Niman Musa, gjoja është duke luftuar në Karadak të Malit të Zi kundër Mbretit të Turqisë. Nga kjo djegie shkatërrohet komplet kulmi dhe druri i tërë kullës.

Pas renovimit detyrohen t'i ndryshojnë dritaret, t'i kthejnë në kënddrejta, gjëja për ndriçim më të mirë dhe ta mbyllin nevojtoren.

Kulla lidhej me shkallë të jashtme prej guri.

Në katin përdhes ishte ahuri, në katin e mesëm ishte shtëpia e zjarrit, tri dhoma të fjetjes dhe në katin e sipërm divanhanja, galeria dhe oda e burrave.

U shkatërrua përfundimisht në vitin 1975 nga familjarët për shkaqe mos sigurie!.

Nga i njëjti material u rindërtuan disa shtëpi banimi të familjeve të Shaban Alive-Avdiaj.

Kulla e Hadrit (Sadik Ramadanit)

Ishte ndër kullat e vjetra të Skivjanit, me arkitekturë tradicionale tri katëshe. Dyshekllëku ishte prej gurit i dalur nga muri perimetral. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kur hyri Partia Komuniste rreth vitit '45 në këtë kullë vendosen kolonizatorët Spasoje Çepiçi dhe Milloja të cilët qëndruan rreth dy vite.

Kulla e Sadikëve u rrënua rreth 40 vite më parë nga Azem Hadri.

Kulla e Selimajve (Metë Brahimit)

Sipas pohimit të Metë Brahimit i lindur në vitin 1888 në Skivjan, kulla u ndërtua nga babai i tij Brahim Selimi me mjeshtër dibran në vitin 1901. Atëbotë Metë Brahimi ishte 13 vjeçar.

Kulla kishte arkitekturë tradicionale tri katëshe e ngjashme me kullën e Asmon Jakupit, për të cilën folëm më parë.

Në kohë të Austrisë (1914), prishen dritaret nga granatimi me predha të minahedhësve (predhëhedhësve).

Në vitet 1944-45 për afro gjashtë muaj qëndruan ushtarët e të ashtuquajturës Brigada e Bukelit.

Në vitet 1950-53 detyrohen t'i prishin dritaret dhe t'i kthejnë në kënddrejta. Po ashtu detyrohen ta mbyllin nevojtoren.

Dyshekllëku ishte prej guri i dalur nga muri perimetral.

Lidhja bëhej me shkallë prej druri nga jashtë dhe brenda.

Oxhaku i odës së burrave ishte me qemer prej guri.

U rrënua nga familjarët në vitin 1984. Mbi themelet e saj u ndërtua shtëpia e re ekzistuese.Fig.30.

Fig.31. Skivjan, Themeli i kullës së Metë Brahimit- Selimaj

Kulla e Nezajve (Bajram Nezës)

Kulla filloi të ndërtohet në vitin 1889 dhe përfundoi në vitin 1892. Kulla kishte një arkitekturë të veçantë nga kullat tjera të Skivjanit. Ajo i kishte tre katë e gjysmë me karollhane ose vend vrojtim.

Kryefamiljari ishte Bajram Neza i cili e ndërtoi kullën me mjeshtër dibran. (I ndërtoi tri kulla, në Shipshan, në Tropojë dhe në Skivjan).

Gjatë marshimit të Xhavit Pashës me ushtri nëpër Skivjan ai ndalet te xhamia e Skivjanit dhe e pyet Bajram Nezën:

"Kush ka më rëndësi për ty Bajram, Vatani apo Feja"?

Bajram Neza i përgjigjet pashait: "Pa vatan nuk ka as fe".

Si pasojë e kësaj përgjigjeje, pashai jep urdhër që kulla të mbushet me duej të tallës së misrit dhe t'i vihet zjarri. Digjet në kohë të hyrrjetit.

Në periudhën e të ashtuquajturës "Serbia e parë"- në kullë vendoset me

dhunë malazezi i quajtur Pera së bashku me gruan e tij dhe një vajzë. Ai qëndroi rreth tri vite në katin e mesëm të kullës ku i vendosi kafshët e tij (dhitë dhe derrat), ndërsa vetë qëndronte në Odë të burrave në katin e sipërm. Ahuri në katin përdhes dhe divanhanja ishin në shfrytëzim të familjes Nezaj.

Pas tri viteve, në lojë e sipër Pera rroket shtatazi (partazunas) me të riun Asman Hadri në afërsi të xhamisë (pas hedhjes së gurapeshit), të cilin e rrëzoi për tokë Asmoni, me ç'rast Pera plagoset nga revolja e tij, nga plaga e marr vdesë. Pas këtij rasti fatkob, gruaja e tij me vajzën largohet nga kulla.

Për nga ndërtimi arkitekturor, kulla kishte karakteristika të veçanta nga kullat e tjera të Skivjanit. I kishte tri parë shkallë për lidhje me katet e tjera. Një parë shkallë fillonin në ahur, vazhdonin në katin e mesëm e në të lartin. Shkallët e jashtme fillonin prej oborrit e vazhdonin deri në katin e tretë në odë të burrave nga ana e jashtme e kullës (rast i veçantë). Kurse në anën e kundërt të oborrit ishin shkallët për lidhje me katin e dytë për dhomat e fjetjes dhe shtëpinë e zjarrit.

Po ashtu e veçantë në këtë kullë ishte karrollhanja (vendvrojtimi), "që ishin zakonisht elemente ndërtimi- arkitekturore tipike mbrojtëse të disa kullave, si banesa të fortifikuara në Rrafshin e Dukagjinit, në Drenicë dhe më gjerë në territoret shqiptare".

Në mes të murit të shkallëve të jashtme ishte bunkeri për armatim, të cilin e zbuloi UDB-ja në vitin 1956. U morr pushkamitralozi , manxerrja e gjatë dhe pushka me dylbi, me ç'rast u arrestuan i biri i Bajram Nezës- Mala (dënohet me dy vjet burg dhe gjobë) dhe nipi i tij Hysen Neza i cili dënohet me gjashtë muaj burg.

Përkundër presioneve për ndryshimin e dritareve dhe heqjen e nevojtores, Mal Neza nuk pranoi një gjë të tillë.

Fig.32. Skivjan, pjesë muri rrethues i kullës së Bajram Nezës

Dyshekllëku ishte prej guri i dalur nga muri perimetral. Oxhaku prej guri

të gdhendur. Tavani i odës së burrave ishte me shiklla prej ahu. Dera e drurit të bungut të trashë rreth 10 cm., mbyllej me shul nga ana e brendshme.

Nga viti 1949-53, Azem Sylë Tahiraj dhe Hysen Rexhep Jakupaj mbajtën mësim për zhdukjen e analfabetizmit tek gratë e fshatit.

U rrënua në vitin 1993 nga trashëgimtari i saj Afrim Nezaj. Në vend të kullës ndërtohen ndërtime të reja.Fig.32.

Kulla e Hulajve (Sylë Avdylit)

Kjo kullë ishte dy katëshe (sipas njësimit në popull). Në katin përdhes ishte ahuri ndërsa në katin e sipërm gjendej Oda e burrave dhe divanhanja.

Kati përdhes ishte ndërtuar prej gurit me lidhje llaqi me gëlqërë, ndërsa kati i sipërm ishte me tulla njëshe të pjekura.

Kulla u rrënua në vitet e ’90-ta nga familjarët.

Nga kjo kullë ka ngelur një gjysmëhark guri i cili gjendej mbi derën e ahurit të kafshëve. fig.33

Fig.33. Skivjan, Gjysmëhark guri i kullës së hulajve

Kullat e rrënuara gjatë luftës së fundit 1998-1999

Lufta e fundit shqiptaro- serbe e viteve 1998-1999 solli dëme të mëdha, pasojat e së cilës u manifestuan në të gjitha fushat, segmentet dhe problematikën e shoqërisë kosovare. Pësoi industria, ekonomia, arsimi, shkenca, kultura dhe arti.

Edhe kullat shqiptare të Skivjanit u dëmtuan, u grabitën në masë e madje njëra nga ato u djeg tërësisht.

Kulla e Ukshinit Miftarit-

E kishte një fat të tillë. fig.34. Ajo u rrënua gjatë zhvillimeve të luftimeve në mes forcave serbe dhe atyre shqiptare në vitin 1999.

Kulla kishte arkitekturë tradicionale shqiptare, tri katëshe, dysheklléku ishte me mur guri i dalur në dy balle nga muri perimetral. Fig.35.

Fig.34. Skivjan, Kulla e Ukshin Miftarit e rrënuar gjatë luftës së fundit 1999

Fig.35. Skivjan, Dysheklléku i kullës së Ukshin Miftarit

Në këtë kullë për shumë vite jetoi familja serbe e Radomir Llabanit (deri në vitin 1999), e cila ndryshoi shumë në arkitekturën e jashtme dhe të brendshme të kullës si mbyllja e dritareve në formë harkore dhe hapja e dritareve tjera në formë kënddrejta. fig.36, me qëllim të tjetërsimit të vlerave arkitektonike shqiptare.

Fig.36. Skivjan, Mbyllja e dritares në formë harkore

Kjo kullë e bukur shqiptare edhe sot asaj dite gjendet nën mëshirën e fatit dhe rrezikohet të zhduket tërësisht. Fig. 37, 38,39.

Fig.37, 38, 39, Skivjan, Rrënimi i kullës së Ukshin Miftarit

Rrënimi i kullave pas luftës së fundit 1998-1999

Në kohën në të cilën po jetojmë një numër i madh i kullave si pasuri kosovare u janë përshtatur nevojave te jetës moderne. Në një veprim të tillë ndikoi edhe mos interesimi ose mosnjohja e vlerave të larta, si dhe e rëndësisë së këtyre kullave që kanë për trashëgiminë dhe historinë e shqiptarëve.

"Mund të themi se në këtë mënyrë, pronarët e këtyre objekteve arkitekturore shkëpusin, duke mos qenë të vetëdijshëm, pjesët më jetike dhe më origjinale të trashëgimisë shqiptare dhe të vlerave arkitekturore në Kosovë".

Një fat të tillë të rrënimit e kishin edhe pesë kulla mjaft të bukura të Skivjanit për të cilat do të flasim në vijim.

Kulla e Gjonës- (Selim Hadrit)

Sipas rrëfimit të Rrustem Asmon Hadrit (të parë), i cili vdiq në vitin 1939 në moshën 112 vjeçare, kulla në fjalë u ndërtua kur Rrustemi ishte 4 vjeç, dhe pas një llogaritje të thjeshtë del se kulla u ndërtua rreth vitit 1831. fig.40.

Fig.40. Skivjan, Kulla e Gjonës (Selim Hadrit). Para rrënimit

Në periudhën e mbretërisë SKS në kullë u vendosën familje serbe të cilat jetuan rreth 4-5 vite.

Në vitet '40-ta, Oda e burrave ndahet në mes të tri familjeve malazeze: (Stoja Millosheviç,..?....?). Pas ardhjes së Partisë Komuniste në pushtet, koloni malazez dëshironte ta martonte vajzën e tij Stoja me të riun Asmon Rrustemin- të lidhë krushqi, një gjë të tillë e refuzoi Asmoni, sepse nuk dëshironte ta përziej gjakun me pushtuesin.

Në vitin 1951-52 u detyruan t'i prishin dritaret, t'ia ndryshojnë stilin e vjetër, t'i heqin qemerët dhe t'i kthejnë në formën kënddrejt dhe ta heqin nevojtoren. fig.41.

Fig.41. Skivjan, Ndryshimi i dritareve të kullës

Kulla kishte arkitekturë tradicionale shqiptare, me mure prej guri me trashësi prej 80 cm. Dyshekllëku ishte prej guri i dalur nga muri perimetral. fig.42.

Fig.42. Skivjan, Dyshekllëku prej guri

Kulla ishte tri katëshe, në përdhes ishte ahuri, i cili lidhej me shkallë druri me katin e mesëm ku gjendej shtëpia e zjarrit dhe tri dhoma të fjetjes, dhe në katin e sipërm ishte Oda e burrave e dekoruar me raftie dhe dollap prej druri të punuar me kujdes nga mjeshtër shqiptarë. Tavani ishte nga shikllat e ahut dhe në ballë të odës ishte oxhaku i dekoruar nga guri i gdhendur. Në divanhane ishte galeria e dyshekllëkut.

Lidhja nga jashtë bëhej më shkallë të gurit të cilat ishin të shtruara me rrasa të kuqe nga Batusha.

Tjegullat u ndërruan në vitin 1960.

Kjo kullë e bukur, fatëkeqësisht u rrënua më 19 shtator të vitit 2008 nga

trashëgimtari Lush Selim Hadri. Fig.43.

Fig.43. Skivjan, Kulla gjatë rrënimit 19.09.2008

Fig. 44. Skivjan, guri qemerë-mbetje nga kulla

Nga kjo kullë tani ruhen vetëm kujtimet dhe disa mbetje të materialit prej gurit. fig.44. Në vend të saj u ndërtua një shtëpi e re nga Bujar Lush Hadri.

Kulla e Gjokajve (Sadri Hajdarit)

Kjo kullë u ndërtua rreth 140 vjetë më parë nga Rrustem Hajdari me vëllezër. Kishte një arkitekturë tradicionale trekatëshe. Qoshet e mureve të kullës dhe dyshekllëku ishin të gdhendura me mjeshtri nga mjeshtër dibranë. Gurët ishin të kuq, u bartën nga Batusha me qerre të drunjta dhe Qe (kije). Nuk është djegur asnjëherë.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, oda e burrave për më shumë se një vit u shfrytëzua si objekt shkolle, ku mësimin vijonin rreth 40 nxënës.

Në vitet e pesëdhjeta, u detyruan ta heqin derën e katit të mesëm dhe nevojtoren e kullës.

Edhe përkundër insistimit të pushtetarit serb Mirk Iliqi, që të ndryshojë formën e dritareve, Fazli Rrustemi kundërshtoi dhe për këtë u mbajt në burg në Gjakovë për disa muaj.

Kishte dyshekllëk prej gurit të kuq të dalur në murin perimetral (Dyshekllëku është në ballë të kullës).

Në odë të burrave ekzistonte oxhaku prej guri të gdhendur me një simbol të theksuar në formë ylli.

Shkallët e jashtme ishin të shtruara me rrasa të gurit. Në vitet e ’80-ta iu shtuan shkallët për lidhje nga oborri drejt në katin e tretë, për odë të burrave.

Meqë kulla në fjalë ishte afër shtëpisë dy katëshe të pjesës tjetër të familjes, konkretisht të shtëpisë së Din Salihut, ishte e lidhur me urë druri.

Ky ekzemplar i papërsëritshëm i ndërtimtarisë tradicionale shqiptare me vlera të mirëfillta kombëtare e muzeale u rrënua nga Halim Fazli Gjokaj në tetor të vitit 1999. Nga kjo kullë ka mbetur vetëm një mur nga ana e pasme e saj. fig.45, 46, 47.

Fig.45. Skivjan, Rrënimi i kullës së Gjokajve

Fig.46. Skivjan, Muri i brendshëm i kullës

Fig.47. Skivjan, Mbetje të kullës së rrënuar-1999

Kulla e Metajve (Metë Brahimit)

Kjo kullë u ndërtua rreth 3 vjet para hyrjetit nga pronari i saj Metë Brahimi me mjeshtër dibranë. I takon variantit të katërt të ndërtimit të kullave me murin e gurtë të dyshekllëkut që nuk del nga muri perimetral. fig.19.

Fig.19. Skivjan, Kulla e Metë Brahimit- Metaj

Ekspeditës së Xhavit Pashës e cila u ndërmor në vitin 1909 për të shkatërruar kullat shqiptare nuk i shpëtoi as kjo kullë e bukur. Ajo u granatua me predha të artilerisë (gjyle topash) nga Suka e Hereqit me ç'rast u dëmtuan dy ballëra të mureve, pjesa veriore dhe ajo perëndimore e kullës.

Në kohën e Islihatit janë mbajtur mbledhje.

Kulla kishte arkitekturë tradicionale trekatëshe. Lidhja me katet bëhet me shkallë të drurit nga ana e brendshme dhe ajo e jashtme.

Në përdhesë ishte ahuri, i cili ka qenë me qemerë e që mbyllet me shul prej druri.

Kati i parë përbëhej prej tri dhomave të fjetjes dhe shtëpia e zjarrit.

Kati i sipërm- divanhanja me dyshekllak (galeri) prej druri, Oda e miqve e pajisur me oxhak me qemer guri, dollap prej druri dhe shiklla.

Tjegullat u ndërruan në vitin 1977. Dera e murit rrethues është mbyllur. fig.20.

Pjesërisht u shfrytëzua nga pronari Bajram (Haxhi) Metaj. U rrënua nga pronaret në vitin 2016.

Fig.20. Skivjan, Kulla e Metajve

Kulla e Aliajve (Brahim Sadikut)

Kulla ishte e feudalit Mustaf Këpuska. Meqë në të kishte vendosur një familje çipçi të besimit të krishterë, pas një kohe kjo familje refuzoi të largohet nga kulla. Fig.21

Fig.21. Skivjan, Kulla e Aliajve-Brahim Sadikut

Brahim Sadiku u lind në vitin 1903 në Batushë. Në vitin 1904 familja e tij u vendos në Skivjan. Meqë nuk kishte strehim dhe ishte e fortë nga (meshkujt e shtëpisë), Mustafë Këpuska ia dhuroi kullën kësaj familje vetëm e vetëm që ta largojë çipçiun e mëparshëm, gjë që ndodhi.

Në vitin 1945, në kullë u vendosën policia e kohës dhe qëndruan rreth një vit.

Në vitin 1946, kulla u kthye në shkollë shqipe ku gjysma e nxënësve mësonin në këtë kullë e gjysma tjetër në kullën e Sadik Ramadanit.

Mësues ishte Mehmet Kushumliu, i cili banoi në divanhane në vitet 1946-1947 bashkë me gruan e tij dhe të birin.

Fig.22. Skivjan, Muri i gurtë i dyshekllëkut

Fig.23. Skivjan, Ndryshimi i dritareve

Kulla kishte arkitekturë tradicionale tri katëshe me dyshekllak prej guri të dalur nga muri perimetral. Fig.22.

Në vitin 1951-52 pronari detyrohet ta mbyll nevojtoren dhe t'i rritë dritaret me arsyetim të higjienës dhe ndriçimit. E vërteta qëndron se regjimi komunist në pushtet dhe sistemi ideologjik dëshironin t'ia ndryshonin arkitekturën tradicionale shqiptare duke i eliminuar harqet mbi dritare dhe frengjitë. fig.23.

Kulmi u përmirësua dhe iu ndërruan tjegullat në vitin 1976.

Pronar i kësaj ishte Rexhep (Brahim) Alijaj dhe ishte jashtë funksionit për banim.

Kulla e Vilajve (Ali Zenelit)

Sipas rrëfimit të plakut dhe gjyshit Ali Zeneli, kulla u ndërtua rreth vitit 1850 nga mjeshtër dibranë ndër të cilët më i dalluari ishte "usta" (mjeshtër) Sadiku. Kullën e ndërtoi Zenel Hasani.

Nga pamje e jashtme, Kulla kishte dy dyer me qemer harkorë dhë të punuara prej dërrasës së bungut me trashësi rreth 10 cm. Kulla ishte tre katëshe me diametër 10x8 m. dhe me kulm në formë piramidale katër ujëra. Në mbikulm ishin dy oxhak që tymonin vazhdimisht. fig.24.

Fig.24. Skivjan, Kulla e Vilajve- Ali Zenelit

Kulla kishte arkitekturë tradicionale tre katëshe. Përdhesa shërbente për vendosjen e bagëtive. Lidhja me katin e mesëm bëhej përmes shkallëve të drurit fig.25. Aty gjendej shtëpia e zjarrit me oxhak dhe tri dhoma për fjetje.

Në katin e sipërm ishte divanhanja me dyshekllëk dhe Oda e miqve (burrave) me të gjitha karakteristikat specifike. Në vitet '50 u vendos familja e Bajram Rrustem Thaqit për një kohë të caktuar si pasojë e mos pasjes vend strehimi.

Pronarët e kësaj kulle u detyruan t'i ndryshojnë dhe t'i zmadhojnë dritaret duke marrë formë kënd drejtë. Kjo ndodhi në kohën e Rankoviqit. "Me zmadhimin e këtyre dritareve, ato humbën nga origjinaliteti dhe karakteri i vet i

mëparshëm. Në këtë kohë, edhe frëngjitë në shumë kulla u mbyllën me qëllim që qëndresa shqiptare ndaj turqve të jetë më e vogël". Fig.26.

Fig.25. Skivjan, Shkallët e drurit për lidhje me katin e mesëm

fig.26. Skivjan, Ndryshimi i dritareve

Aktualisht në këtë kullë jetonin pasardhësit Hasan e Lan Vilaj me familje.

Përfundim

Skivjani si pjesë e territorit etnik shqiptar është i banuar që nga kohët-periudhat parahistorike. Këtë e them duke u bazuar në gjetjet arkeologjike që janë prezente në këtë vendbanim të lashtë.

Në trashëgiminë e këtij territori shihet qartë vazhdimësia e kulturës ilirо-dardane. Gjurmët e mbetura tragojnë nivelin e lartë të punës së mjeshtërve dhe artistëve paraardhës. Në krijimtarinë autoktone kanë ndikuar edhe kulturat tjera të vendeve fqinjë si helene, romake, bizantine, osmane etj. Të cilat morën dhe dhanë në kulturën tonë por gjithmonë ndikoi kultura tradicionale vendore.

"Në thesarin e lashtë dhe me vlera të larta të historisë së kulturës dhe artit shqiptar bëjnë pjesë edhe realizimet arkitekturore, përkatësisht kullat si ndërtime në kuadër apo jashtë kuadrit të sistemeve urbano-fortifikuese iliro-shqiptare, kompleksеve ruralo- arkitekturale, urbano-arkitekturale ose të veçuara si kulla banesa në veçanti. Në kulla si banesa a fortesa familjare, disa elemente mund të ndiqen në mënyrën vëjimore që nga antikiteti e deri në dekadën e parë të shek. XX".

Kulla shqiptare në Skivjan e zëvendësoi banesën e tipit të çardakut, vazhdoi të ndërtohet gjatë shek. XIX e deri në fillim të shek. XX. Kulla shërbeu si objekt banimi në rend të parë, por nëpërmjet objektit dhe elementeve të saj mbrojtëse siç ishin frëngjitë, karrollhanja si kullë vrojtuese në kalatë mesjetare,

mureve të gjera dhe të forta prej gurit etj., ruajti integritetin individual, familjar e kombëtar nga armiqtë e ndryshëm që nuk ishin të paktë.

Kulla ishte në shënjestër të Osmanlinjve, Mretërisë SKS, periudhës së kolonizimit me kolonë serbë e malazez, dhe pas Luftës së Dytë Botërore kishin forma të ndryshme të rrënimit dhe të degradimit.

Një shkatërrim i paparë i kullës u bë edhe gjatë luftës së fundit në mes forcave serbe dhe atyre shqiptare në vitet 1998-1999.

Është për të ardhur keq se një pjesë e qytetarëve të zhgënjyer nga institucionet për mbrojtjen e monumenteve, filluan t'i shkatërrojnë edhe ato pak kulla të cilat mbijetuan. "Trashëgimia paraqet 'skeletin dhe gjuhën' e popullit shqiptar".Andaj mos e dëmto atë sepse dëmton vetveten!

I. Burimet

Të papublikuara

- Dinaj, Shefqet, Materiali, ditari nga hulumtimi në teren brenda viteve 1984-2017
- Intervista me qytetarët Lush Hadri, Sylë Tahiraj, Bajram Metaj, Hysen Metaj, Rexhep Alijaj, Lan Vilaj, Hazir Selimaj, Rexhep Musaj, Asmon Nezaj, Halim Gjokaj, Isa Dinaj, Skivjan.

Burimet arkivore të botuara

- Defteri i Regjistrit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë 1974 i përgatitur nga Selami Pulaha

I. Literatura

- Drançolli, Fejaz, Kulla Shqiptare, Prishtinë 2001
- Drançolli, Fejaz, Rrënimi i kullës shqiptare, Prishtinë 2004
- Detailbeschreibung des saxhak Plevle und des Vilajets Kosovo
- Djogoviç, A. Onomastika Djakovice i okolnih sela, Onomatoloski prilozi VIII, Beograd 1987
- Jastrebov, I. Stara Serbija; Gashi, S. Fjalor
- Novakoviç, St, Zakonski spomenci serbskih zemalja srednjega veka, Beograd 1912.
- Obradoviç, Milovan, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941_

- Osmani, Jusuf, Vendbanimet e Kosovës- Gjakova 14, Shkrola, Prishtinë 2005
- Toponomia e Gjakovës me rrethinë, Gjakovë 2003
- Uka, Sabit, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve muhaxhirë në Kosovë, 1878-1912, Libri 3 pjesa e dytë.
- Zefi, Frrok, Arqipeshkvnija Shkup- Prizren në shek. XVIII, Osijek 2001
- Dinaj, Shefqet. Vështrime Historiografike shek.XIX-XX, LHK Ali Hadri, Prishtinë 2009
- Dinaj, Shefqet. SKIVJANI- historiku dhe trashëgimia kulturore, LHK "Ali Hadri", Prishtinë, 2010.

Fridrik DULAJ

LLOJET E FJALIVE NË GAZETËN "KOHA DITORE"

Abstrakt

Synimi i këtij punimi është të vërejmë se cili lloj i fjalive përdoret më së shumti në këtë artikull. Ndonëse përkufizimi i fjalisë mund të bëhet në dy rrafshe themelore si kompetencë dhe si performancë, këtu do të përkufizohet si njësi themelore tekstore dhe do të kundrohet nga rrafshi i forms së tyre, nga rrafshi i kotekstit dhe kontekstit.

Ky hulumtim është mbështetur në një artikull të gazetës "Koha Ditore" ndërsa si pikë reference ka "Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe" të Bardh Rugovës dhe Linditë Sejdiu-Rugova (Prishtinë, 2015)

Fjalët celësa: gramatikë teksti, tip teksti, kategorizim i tekstit

Hyrje

Sipas gramatikës së tekstit llojet e fjalive i ndajmë në:

• Idioma tekstore ***përshkruese*** janë fjalitë që regjistrojnë fenomene a dukuri nëpërmjet foljes jam apo ndonjë folje tjetër në të tashmen apo në të shkuarën, dhe të shoqëruar nga një rrethanor i vendit:

Deputetët në Kuvendin e Kosovës ishin pozicionuar kundër mundësisë që një serb të ngjitet lart në hirearkinë e AKI.

• Idioma tekstore ***rrëfyese*** janë fjalitë që kujtojnë veprime nëpërmjet aspektit jo të vazhdueshëm të një foljeje që shpreh veprim apo ndryshim në të shkuarën, të shoqëruar nga rrethanorë të kohës dhe të vendit:

Protesta më e madhe është mbajtur këtë fillimjavë në Prishtinë.

• Idioma tekstore ***ekspozitore (shpjeguese)*** mund të zbërthehet në dy lloje të fjalive:

- në fjali që shprehin sintetizim
- fjali që identifikojnë fenomene nëpërmjet foljes jam apo foljeve në të tashmen të shoqëruara me një plotës emëror, dhe në fjalitë që shprehin zbërthim analitik dhe kanë të bëjnë me fenomene a dukuri të caktuara nëpërmjet foljes kam dhe të foljeve tjera tjera të gjendjes në të tashmen, të shoqëruara nga një plotës emëror.

• Idioma tekstore ***argumentuese*** përbëhet nga fjali që i atribuohen cilësisë

përmes foljes jam apo ndonjë folleje tjetër të gjendjes në të tashmen të shoqëruara nga negacioni dhe të plotësuara kryesisht me një mbiemër: *Nadin është i paqëndrueshëm.*

• Idioma tekstore ***udhëzuese (instruktive)*** karakterizohet nga fjali që kërkojnë veprim e që paraqiten në mënyrë urdhërore ose të shoqëruara me modalitet deontik nëpërmjet foljes modale duhet. *Shko në shtëpi! Duhet të vish menjëherë! Duhet ta heqësh pallton e lagur.*

Fjalitë mund të klasifikohen edhe në bazë të kotekstit të tyre në fjali themelore dhe në fjali të fragmentuara ose të pjesërishme.

Fjalitë e tilla mund të jenë emfatike (të theksuara) dhe joemfatike (të patheksuara). (Rugova, 2015 :129)

• Përshkrimi është një tip i komunikimit tekstor, gjatë të cilit dërguesi pak a shumë në mënyrë përzgjedhëse i trajton fenomenet faktike në hapësirë. Ky tip tekstesh merret me procesin e të vërejturit në hapësirë dhe mund të klasifikohet më tutje në dy grupe: përshkrimi impresionistik dhe përshkrimi teknik . Shërben për të përshkruar njerëz, veprime, gjendje, objekte të ndryshme, por edhe procese, duke përdorur mjete gjuhësore që ndihmojnë krijimin e një pamjeje të qartë në mendjen e lexuesit . Fjalët zgjidhen me kujdes për të vënë në dukje tipare dhe hollësi të veçanta të asaj që përshkruhet.

P.sh

- Burime të gazetës kanë thënë se Jabllanoviqi mund të shkarkohet qysh para takimit mes kyeministrave Isa Mustafa e Aleksander Vuciq, që pritej të zhvillohet në fillim të shkurtit.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.1)

- WikiLeaks i ka dërguar një letër ose thënë më mirë një pyetje kryesisht të bordit drejtues, Eric Schmidt, në të cilin e pyet se pse Google ia ka dorëzuar e-mailat e gazetarëve të WikiLeaks FBI-së në mars të vitit 2012.

(*Koha Ditore, 31 janar 2015, f.35)*

• Narracioni (tipi tregues, ose rrëfyes) është një tip i komunikimit tekstor, gjatë të cilit dërguesi pak a shumë në mënyrë përzgjedhëse trajton fenomene faktike dhe/ose konceptuale në kohë. Ky tip tekstesh merret me procesin e të vërejturit në kohë . Pra, me këtë tip shkrimi tregohet një ngjarje a një histori dhe ndryshimi me një përshkrim të thjeshtë qëndron te dimensioni i kohës. Tipi i të shkruarit tregues ose narracioni ndryshon nga të shkruarit përshkrues, sepse ka edhe rrethanor(ë) të kohës (në struktura të ndryshme). Pra, mund të konsiderohet tekst referencial me zhvillim kohor.

Janë dy lloje të narracionit: ai subjektiv dhe ai objektiv. Shembulli i sipërm është një narracion subjektiv, sepse përshkohet me zgjedhje dhe theksime subjektive.

Regjistron veprime dhe ngjarje nga këndvështrimi i përshtypjeve subjektive në aspektin kohë.Shkruhet kryesisht në vetën e parë.Nuk përjashtohet as mundësia (në letërsi) e vetës së tretë. Baza tematike e tekstit shënjohet nga fjali që regjistrojnë veprime brenda sekuencës. Tipi shpjegues ka format e veta, të cilat përcaktohen në bazë të këndvështrimit (subjektiv dhe objektiv). Në kuadër të shkrimit narrativ subjektiv bën pjesë tregimi, në të cilin dërguesi rrëfen nga këndvështrimi i përzgjedhjeve dhe i theksimeve subjektive .Raporti, një formë e shkrimit narrativ objektiv, ndërkaq, është një formë që shkruhet kryesisht në vetën e tretë dhe përdoret stil neutral, me shprehje kryesisht formale dhe teknike. *P.sh*

- Protesta më e madhe është mbajtur këtë fundjavë në Prishtinë.
(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.1)
- Dy sektorë të rëndësishëm të Kosovës, shëndetësia dhe arsimi, kanë mbajtur të premten grevë njëditore në shenjë pakënaqësie me Qeverinë e Kosovës e cila nuk po e zbaton Kontratën kolektive që e ka nënshkruar në prill të vitit të kaluar. Greva është mbajtur në shumicën e shkollave fillore, të mesme por edhe në nivelin universitar, ndërsa në shëndetësi ka punuar vetëm sektori emergjent.
(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.2)
- Chrisi takon Tayan në një lokal. Ata ia hedhin shikimet rinore njëri-tjetrit. Filmi rrëshqet qysh ndodh shpesh, në një dialog klishe.
Ajo i thotë se SEAL-i është arrogant, ngucakeq, egoist, që ia ha mendja se mund të rrejë dhe të mashtrojë, të bëjë cfarë dreqi duan.
Kurrë nuk dal me një SEAL.
Pse thoni se si tepër e kam veten në qejf, pyeti Kyle. Do të vdisja për atdheun tim..
(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.30)
- Le të harrojmë përkohësisht devizën e stërnjohur të fizikës se ne jetojmë në një botë tredimensionale. Sepse pianistja për të cilën do të flitet këtu ndonëse po ashtu koekziston në tre dimensione, vetëm njëri prej tyre është tredimensional, dhe vetëm në të ajo është tredimensionale. Tredimensionali i njeriut është i determinuar nga tredimensionaliteti i botës në të cilën ai është hedhur.
(Koha Ditor, 31 janar 2015, f.31)

• Shpjegimi është një tip i komunikimit tekstor, gjatë të cilit dërguesi i paraqet ose elementet përbërëse, ose konstruktin mendor të një dukurie1 . Dërguesi shpjegon se si elementet përbërëse ndërlidhen në një tërësi të kuptimtë. Tipi i shkrimit shpjegues (i quajtur ndryshe edhe ekspozitor ose parashtrues) shpjegon natyrën, rrethimin, përdorimin, origjinën, qëllimin, gjendjen, procesin e asaj për të cilën shkruhet. Definicioni, përmbledhja, interpretimi i tekstit – janë tekste shpjeguese dhe mund të jenë analitike dhe sintetike. Në kuadër të këtij tipi bëjnë

pjesë edhe disa letra zyrtare, broshurat e ndryshme turistike.

P.sh

- Problemi i vetëm është se flokët e sapogjeneruar nga qelizat burimore rriten në një model rastësor.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f. 37)

- Metoda është një arritje e madhe kundrejt metodave të tanishme që mbështeten në transplantimin e folikulave ekzistuese të flokëve nga një pjesë e kokës në tjetrën.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f. 37)

- Windows 10 build 9926 tani është në dispozicion për download, kështu që të gjithë mund të shohin se cfarë risisë dëshiron të sjellë Microsofti në versionin e ri të këtij sistemi operativ.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.36)

- Keqpërdorimi i gjuhës, shpërfillja e skajshme dhe banale është për disa njerëz, mënyra më e përsosur për t'i lënë rrugë të lirë marrëzisë.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.29)

• Argumenti – është një tip i komunikimit tekstor, gjatë të cilit dërguesi propozon marrëdhënie ndërmjet koncepteve të fenomeneve të ndryshme. Ai propozimet e veta i bën në kundërshtim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me propozimet e tjera që janë bërë për një problem të caktuar. Është një tip që lidhet me procesin e gjykimit për zgjidhjen e një problemi . Pra, ka për qëllim të japë një mendim duke i përballur qëndrimet për dhe kundër një dukurie për ta shprehur qëndrimin e tij. I quajtur ndryshe edhe shkrim bindës , ky tip shkrimi synon mbështetjen në argumente. Ky tip tekstesh ndahet në dy gjini: koment dhe argument shkencor. I pari është subjektiv, ndërsa i dyti është objektiv. Qoftë në rastin e parë, qoftë në atë të dytin, shkrimi nis me përkufizimin e problemit: nxjerrjen në pah të çështjes se si një fakt i caktuar do të mund të klasifikohej në raport me konceptet kundërshtuese . Në shkrimet e gazetave, nga këto dy gjini, përdoret komenti.

Më i zakonshëm është shkrimi argumentues që nis me tezën, vazhdon me gjendjen faktike (sfondin), sjell përfundimin dhe, në fund, jep një propozim për zgjidhjen e problemit. Në argumentin shkencor, në koment, dërguesi i bart gjykimet nga konceptet përkatëse të ngjarjeve, të objekteve dhe të ideve në sistemet e mendimit dhe të dijes, në mënyrë që rezultatet të mund të vërtetohen si të sakta ose të paktën si hipoteza të pranueshme . Në një koment, stili neutral i idiomës argumentuese të tekstit, modifikohet nga stili joformal, ironik, miratues, jomiratues dhe bindës . Nëpërmjet komenteve dërguesi përpiqet që ta bindë marrësin për një gjë të caktuar, duke i propozuar zgjidhje të problemit. Werlich3 komentet i ndan në dy grupe: të shkurtrat dhe të gjatat. Në kuadrin e të shkurtrave

hyjnë kolumnet, komentet dhe vështrimet në gazeta.Të gjatat bëjnë pjesë në ato që Werlich i quan "leading article" (artikuj kryesorë ose kryeartikuj).Në këto komente të zgjeruara (një editorial), dërguesi ka mundësi që t'i elaborojë tezat kryesore që i mbështet.Është një deklaratë bindëse e qëndrimeve që konsiderohen si përfaqësuese të një gazete në tërësi. Rëndom shkrimet e këtilla gjatë dizajnit grafik të gazetës kanë më shumë hapësirë dhe janë të veçuara ashtu që të bien më shumë në sy4 .Ka disa mënyra se si organizohet një shkrim argumentues koment. Gati se në të gjitha rastet shkrimi nis me "thesis statement" (tezën e parashtruar). Më tutje mund të vazhdojë me qëndrimin e kundërshtuar (nga autori), nxjerrjen e tezës së re, faktet që e mbrojnë tezën e re (të autorit) dhe shkrimi përfundon me përmbylljen.

P.sh

- Deputetët të Kuvendit të Kosovës janë pozicionuar kundër mundësisë që një serb të ngjitet lart në hirerarkinë Agjencisë Kosovare të Intelegjencës (AKI).

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.1)

• Instruksionet janë tipa të komunikimit tekstor gjatë të cilit dërguesi tregon ose urdhëron për diçka që duhet bërë. Ai e shfrytëzon komunikimin gjuhësor për të planifikuar sjelljet e ardhshme të vetes ose të të tjerëve. Ka të bëjë me procesin e planifikimit.

P.sh

- Do të duhej të bënit një bisedë shumë serioze me të dashurin tuaj dhe të gjeni një zgjidhje.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.39)

- Do t'ju duhet pak kohë për të marrë këtë vendim të rëndësishëm.

(Koha Ditore, 31 janar 2015, f.39)

Rezultetet e punimit:

Në këtë artikull dominon lloji i fjalive rrëfyese dmth pjesa më e madhe e shkrimeve në artikullin e gazetës Koha Ditore të datës 31 janar 2015, janë rrëfyes, pjesa tjetër e teksteve është përshkrues, ndërsa më pak ka tekste argumentuese, shpjeguese dhe ato udhëzuese apo (instruktive) që gjinden në këtë artikull sidomos në rubrikën e Horoskopit.

Të dhënat e nxjerra tregojnë se rrëfimi është karakteristikë për shumicën e gazetarëve.

• Lloji më i shpeshtë i raportit është i ashtuquajturi rrëfim gazetaresk (raporti me lajm ose sic e quajmë për ekonomi të shprehjes, raporti).

Bazuar në të dhënat e shtypit anglo-amerikan, qëllimi i lajmit është që t'ia mundësojë marrësit të krijojë një opinion të pavarur për faktet dhe ngjarjet pa qenë i ndikuar nga botëkuptimet e gazetarit. (Rugova, 2009 :54)

Përfundimi

Përqindja e madhe e përdorimit të teksteve narrative rrëfimore, shkruesit paraqesin veprimet nga këndvështrimi subjektiv dhe i regjistrojn këto veprime dhe ngjarje nga këndvështrimi i përshtypjeve subjektive në kohë.Faktori kohë luan rol qenësor në përcaktimin e formës së tij tekstore. Por, jo domosdoshmërisht një paragraf është vetëm narrativ, ai jo rrallë kombinohet me formën deskriptive (përshkruese) të tekstit.Teksti rrëfimor mbetet rrëfimor dhe pikërisht kohët e foljeve në tekst e përcaktojnë një gjë të tillë, për secilin tekst.

Biblografia

1. Rugova & Sejdiu-Rugova , (2015), Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe, Trembelat, Prishtinë.
2. Rugova, B. (2009), Gjuha e gazetave, KOHA, Prishtinë.
3. Ismajli, R. (1974), Shenjë e ide, Rilindja, Prishtinë.
4. Ismajli, R. (1974), Shumësia e tekstit, Rilindja, Prishtinë.

Eljana BRAHJA

ADOLESHENTËT DHE KUJDESI NDAJ LIBRIT SI PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE

Abstrakt

Në studimet sociologjike të kohëve të fundit argumentohet se librit si një pjesë e trashëgimisë kulturore, po i kushtohet gjithnjë e më pak vëmendje nga adoleshëntët e shkollave të mesme. Prirjet e adoleshentëve ndaj përdorimit të teksteve apo informacioneve digjitale po sjellin ndryshime në procesin e mësimdhënies, nxënies, ndryshime në marrëdhëniet mes grupit të bashkëmoshatarëve, anëtarëve të familjes, etj.

Në këtë artikull argumentohet rëndësia e përcjelljes së librit brez pas brezi duke e parë atë si një kusht të domosdoshëm për zhvillimin e procesit edukativ.

Qëllimi i studimit është përcaktimi i rolit që ka libri në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Pyetja kërkimore e ngritur në këtë studim është: Çfarë rëndësie ka libri për adoleshentët e sotëm? Metoda kërkimore e përdorur në këtë hulumtim është metoda kërkimore sasiore. Instrumenti që do të shërbejë për mbledhjen e të dhënave është anketa. 352 nxënës të shkollës së mesme "Sandër Prosi" përbëjnë popullatën e këtij studimi. Kampioni i përzgjedhur në mënyrë rastësore janë 150 nxënës përkatësisht nga klasa e 10,11, dhe 12-të.

Ky artikull përmbyllet duke spjeguar rëndësinë që brezat i kanë kushtuar librit ndër vite. Në të argumentohet se faktorët kryesorë që kanë zbehur kujdesin ndaj librit si pjesë të trashëgimisë kulturore janë globalizimi, digjitalizimi, etj.

Fjalë kyçe: adoleshentë, teksti shkollor, libër digjital, proces edukativ, globalizim.

TEENAGERS AND CARE TO BOOKS AS A PART OF CULTURAL HERITAGE

Abstract

In recent sociological studies it is argued that high school's teenagers are paying lesser attention to the book as a part of cultural heritage. Teenager's tendencies towards usage of digital information are bringing changes in the

teaching and learning process, changes in peer group relationships, family members, etc.

This article argues the importance of inheriting the book generation after generation, seeing it as a necessary condition for the development of the educational process.

The purpose of the study is to determine the role that the book has in the teaching and learning process. The research question raised in this study is: What is the importance of the book for today's teenagers? The research method used is the quantitative one. The tool that will serve to collect data is the questionnaire. 352 high school students of "Sandër Prosi" make up the population of this study. The randomly selected sample is 150 students, respectively from the 10th, 11th, and 12th grades.

This article concludes explaining the importance that generations have dedicated to the book over years. It is argued that the main factors that have faded the book's attention as part of the cultural heritage are globalization, digitalization, etc.

Key words: teenagers, school textbook, digital book, educational process, globalization.

1. **Hyrje**

Libri është një vepër shkencore, mësimore dhe letrare. Çdo libër ka një subjekt të caktuar. Ai mund të transmetojë informacione për një nga fushat e dijes e të artit, ose trajton çështje të caktuara të rëndësishme për kohën kur është shkruar. Si pjesë e trashëgimisë kulturore duke u trashëguar brez pas brezi dhe duke përfshirë një krijimtari të gjithanshme, libri luan një rol të rëndësishëm në disa fusha të zhvillimit shoqëror. Ai ndikon në art, letërsi, shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore (Kostallari, 1984: 618).

Studimet e deri më tanishme argumentojnë se libri ndikon në tërësinë e njohurive, shprehive të sjelljes dhe të edukatës që përvetëson një njeri në shkollë ose në jetë. Vëmendja ndaj librit nuk duhet të shkëputet asnjëherë, sepse ai është i një rëndësie të veçantë për shoqërinë. Trashëgimi i tij përcjell gjithçka përparimtare që është krijuar nga të parët tanë në fushën e kulturës, të artit, të shkencës etj., që është trajtuar e pasuruar brez pas brezi. Duke e përdorur dhe zhvilluar më tej, ne mund të trashëgojmë shumë vlera për shoqërinë njerëzore. Vlerat si edukative-arsimore, gjuhësore, kulturore, kombëtare, fetare e të tjera, përvetësohen nëpërmjet leximit të librit. Ne jetojmë në një shoqëri dhe njohja e vlerave të të parëve tanë është e rëndësishme sepse kështu ne mund të njohim

jo vetëm të shkuarën, por të ndërtojmë marrëdhënie me një bazë të shëndoshë edhe për të ardhmen. Siç shprehet edhe sociologu Tushi, ne në shoqëri nuk jemi të vetëm. Individët duhet të bashkëveprojnë me grupin duke vendosur një eikulibër midis shoqërisë dhe njeriut, grupit social dhe individit si "objekt social" (Tushi, 2009:323-330). Vendosja e eikulibrave do të na ndihmojë për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Leximi i librit e ndihmon individin në shpjegimin e universit si dhe na ofron mundësinë për të qenë kreativ. Duke formuar vetëdijen e njerëzve dhe ngritur lartë shoqërinë njerëzore, libri ndikon në kulturën dhe edukimin e brezave (Shala: http://www.foltash.com/libri-mjet-i-vecante-per-shprehjen-e-kultures-njerezor/). Ai na pajis me mjetin për të njohur veten, shoqërinë, historinë, etj., duke na lejuar të shprehemi dhe të transmetojmë element të kulturës tonë brez pas brezi.

Nga vëzhgimet empirike rezulton se adoleshentët nuk po i kushtojnë librit rëndësinë e duhur. Shumë prej studiuesëve e kanë trajtuar librin si element të domosdoshëm për thellimin e njohurive dhe e kanë ruarjtur atë për shumë vite me radhë duke e trashëguar nga brezi në brez.

Por, çfarë po ndodh me librin sot? Libra të hedhur vend e pa vend, kopertina apo faqe të tëra të grisura e të flakura tej, nxënës të cilët paraqiten në shkollë pa libra, po kurrësesi pa celularë, janë gjithnjë të pranishëm në mjediset arsimore.

Rëndësia e këtij studimi është që të shpjegojë se çfarë po ndodh me librin sot dhe se sa i rëndësishëm është ai për adoleshentët e shkollave të mesme. Shumë prej studimeve theksojnë rëndësinë që ka përdorimi i librit, por shumë pak prej tyre tregojnë çfarë rëndësie ka libri për adoleshentët e sotëm. Nëpërmjet këtij hulumtimi synohet të arrihen objektivat:

- Vlerësimi i shkallës së marrëdhënies që kanë adoleshentët me librin.
- Indentifikimi i shpeshtësisë së përdorimit të bibliotekave.
- Rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e realitetit.

Për një shoqëri e rëndësishme është evidentimi i problemit që kanë individët duke shqyrtuar nevojat e tyre në mjedisin real ku ata jetojnë. Vetëm kështu mund të arrihet në shkaqet e para të problemit dhe të ofrohen rekomandime të cilat do të sjellin përmirësime të situatave konkrete.

Problemet sociale dhe pasojat që ato shkaktojnë kanë qenë dhe janë pjesë e çdo shoqërie, në të vërtetë ideja e e problemeve sociale dhe e ndërhyrjeve që duhen të realizohen nuk është edhe aq e vjetër (Rubington, & Weinberg, 1995). Sipas Rubington dhe Weinberg, ne bashkëjetojmë në mënyrë të vazhdueshme me problemet. Duke mos i pranuar si të tilla ne nuk bëjmë asgjë për të ndryshuar

situatën. E rëndësishme është që problemet të pranohen dhe të ofrohen rekomandime për shmangien e tyre.

Në këto situata, i domosdoshëm është roli i sociologut i cili përpiqet të analizojë shkaqet. Një fenomen social mund të ketë disa shkaqe të cilat mund të jenë të dukshme ose të pa dukshme. Për këtë çështje Emil Dyrkeim, ndër të tjera ka shkruar se hapi i parë i sociologut duhet të jetë definimi i sendeve me të cilat do të merret, në mënyrë që të dijë edhe vetë se për çfarë është fjala (Dyrkeim, 1984:71). Prandaj, edhe ky studim është mbështetur te adoleshentët, dhe kujdesi që ata kanë ndaj librit, duke i parë adoleshentët si e ardhmja e vendit. Duke njohur të shkuarën nëpërmjet librave apo dokumentacioneve zyrtare e jozyrtare, dhe të tashmen nëpërmjet studimeve sociologjike, mund të ofrohen mundësi për përmirësim të gjendjes reale.

Në qendër të këtij hulumtimi janë adoleshentët e shkollës së mesme "Sandër Prosi". Ata i përkasin kryesisht moshës 16-18 vjec dhe janë në stadin e zhvillimit të adoleshencës. Duke iu referuar studimeve rreth adoleshencës, ajo perceptohet si një periudhë e transformimit biologjik, psikologjik dhe social ekonomik. Gjatë adoleshencës së mesme individi karakterizohet nga shpërthimet e pakontrolluara emocionale, nga interesi për riprodhimin, nga ndjesia se tani janë më të rritur, më të zgjuar dhe mund të marrin vendime vetë, por edhe mundësia për të gabuar është gjithnjë e më e madhe (Çelçima, 2017:99). Duke qenë pjesë e shoqërisë, në mënyrë direkte apo indirekte ne jemi të prekur nga pasojat negative që mund të shkaktojnë vendimet e tyre për të braktisur librin fizik dhe përdorimin e kompjuterit.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra deri më tani për nxitjen e adoleshentëve në leximin e librave (organizimi i panaireve të librit, nxitja e nxënësve nga mësuesit e lëndës së letërsisë, dita ndërkombëtare e librit, etj.), indiferenca e adoleshentëve ndaj librit është e kudondodhur dhe përpiqet të fitojë terren sapo ti krijohet mundësia. Prandaj, ne si studiues duhet të jemi gjithnjë të gatshëm për të shmangur këtë indiferencë dhe çdo problem tjetër të mundshëm nëpërmjet studimit të problemeve sociale. Ekzistenca e një fondi të dhënash do të ndihmojë në hartimin e politikave sociale të cilat do ti vijnë në ndihmë jo vetëm forcimit të pozitës së librit në sytë e adoleshentëve, por edhe vetë shoqërisë.

2. Shqyrtim i literaturës

2.1 Rëndësia e leximit të librit për adoleshntët

Të dhënat e INSTAT (1 Janar 2016) për popullsinë në Shqipëri sipas grupmoshës, tregojnë se grupmosha 15-19 vjeç, krahasuar me grupmoshat e tjera, përbën numrin më të lartë të popullsisë, 233.519 meshkuj dhe femra. Ndërsa në

1 Janar 2017, kjo grupmoshë edhe pse është në rënie, sërisht mban vlera të larta 220.937 meshkuj dhe femra (INSTAT: 2017). Duke qenë se individët e moshës 15-19 vjeç përbëjnë grupmoshën me numrin më të lartë të popullsisë krahasuar me grupmoshat e tjera, mendoj se është një arsye e rëndësishme që në fokus të këtij kërkimi të jenë adoleshntët e shkollave të mesme.

Studiuesit theksojnë se të lexuarit e librave ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin mendor të adoleshentëve. Libri është ai që nxit imagjinatën e lexuesve duke e bërë atë gjithnjë e më shumë kreative. Pesha që zotëron leximi i librit në krijimin e një mendimi aktiv, është shumë herë më e madhe se sa rëndësia që adoleshentët i kushtojnë atij. Nga një studim i bërë nga Shoqata e Botuesve në rreth 2500 individë, rezulton se adoleshentët lexojnë librat që bëjnë zhurmë dhe që janë në të njohur për shoqërinë; lexueset më të shumta janë femrat; rreth 15% e shqiptarëve nuk kanë asnjë libër në shtëpi etj. (Anketim i realizuar nga Shoqata e Botuesëve). Po të njëjtën çështje nënvizojnë edhe Leland, Lewison dhe Harste, sipas të cilëve vlen të theksohet se adoleshentët lexojnë librat që janë më të njohur prej bashkëmoshatarëve. Sipas adoleshentëve, librat ndryshojnë në kuptimin se sa i lehtë apo i vështirë është leximi i tyre (Leland, Lewison dhe Harste, 2013).

E rëndësishme është që adoleshentët të nxiten të lexojnë libra me tematika nga më të larmishme. Siç pohojnë Carter dhe Russell, ne jetojmë në një botë ku përgjigjet e shpejta dhe aftësia për të menduar logjikisht po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme (Carter dhe Russell, 2006). Aftësi të tilla mund të zotërohen në qoftë se jemi lexues të rregullt të librit. Sipas tyre, nevoja për të kultivuar morinë e aftësive njerëzore, përcakton edhe rëndësinë e lëximit të librit për adoleshentët. Librat ofrojnë praktika të vlefshme për ata që duan të mbajnë trurin e tyre të shkathët si në lojë ashtu edhe në biznes.

Nga studimet rezulton se disa nga efektet pozitive të të lexuarit janë:

- Çlodhja dhe qetësia.
- Na informon.
- Leximi i librit na ndihmon në aktivizimin e mendjes.
- Kur lexojmë jemi larg nga shqetësimet e përditshme.
- Leximi i librit na ndihmon të bëjmë gjumë më të qetë.
- Leximi i librit nga fëmijëria deri në moshën e rritur, është meritë për mirëqënien e trurit në pleqëri.
- Stimulon imagjinatën tonë.
- Ndikon në pasurimin e fjalorit (Disa këshilla përse të lexosh libra është e rëndësishme, http://www.cityneës.al/2015/04/disa-keshilla-pse-te-lexosh-libra-eshte-e-rendesishme/1)

2.2 Përdorimi i teksteve digjitale

Të jetuarit në një botë globale dhe të ndodhurit përballë një fluksi informacioni nuk do të thotë domosdoshmërisht se të gjithë individët e kanë përthithur informacionin e marrë. Në shumë prej rasteve leximi mbetet kërkesa kryesore për marrjen e një sasie të madhe informacioni. Pavarësisht këtij fakti, kriza e leximit duket se po përfshin gjithnjë e më tepër adoleshëntët e sotëm. Ata janë gjithnjë e më shumë të varur prej rrjeteve kompjuterike edhe përse në mënyrë të vazhdueshme hartohen strategji për leximin, ndërmerren nisma për ruajtjen dhe shtimin e numrit të lexuesëve, duke nxitur interesin e adoleshentëve ndaj librit.

Përveç aspekteve pozitive teknologjia ka ndikuar edhe negativisht në raportin e njeriut me librin. Shumë njerëz kanë harruar se si është të kalosh kohën duke lexuar një libër. Megjithatë, studimet evidentojnë edhe shumë nga të mirat që vijnë si rezultat i të lexuarit të librit fizik apo digjital (Pse duhet të lexojmë libra?, http://www.botasot.info/shendetesia/546272/pse-duhet-te-lexojme-libra/). Sipas Ars Poetica, Librat digjital vendosin referenca të cilat iu referohen librave të tjerë. Informacioni në rrjet lejon që këto informacione të jenë të arritshme, gjithnjë nëse janë të disponueshme në rrjet. Gjithashtu, fenomeni i interaktivitetit është një nga arritjet e mëdha të sistemit të informacionit digjital. Dialogu mes lexuesit dhe tekstit ofrohet në çdo moment (Poetica, 2008). Tekstet interaktive ofrojnë përgjigje në funksion të pyetjeve tona. Kjo është një ndër përparësitë e shumta të përdorimit të librit digjital krahasuar me librin e shtypur.

2.3 Faktorët që ndikojnë në leximin e librit

Me gjithë përparimet e dukshme që ka pasur krijimtaria shqiptare, jo vetëm leximi i librit artistik, por edhe ai i librit shkollor, nuk kanë rezultuar shumë të suksesshme. Të dhënat tregojnë se ka një sërë faktorësh që ndikojnë në mosleximin e librit nga adoleshentët.

Leximi i librit nga adoleshentët është kushtëzuar nga faktorë të shumtë mjedisor, social, kulturorë etj. Por jo vetëm, sepse ndikimi i nivelit ekonomik dhe i nivelit të arsimit, përbëjnë dy faktorë shumë të rëndësishëm të cilët lënë pashmangshmërisht gjurmët e tyre te adoleshentët.

Leximi i librit nga adoleshentët është i një rëndësie të veçantë, por për autorët, redaktorët, prindërit, mësuesit dhe bibliotekarët ky grup lexuesish nuk është shumë i madh si rezultat i përballjes me një sërë problemesh. Adoleshentët ndodhen ndërjmet teksteve që janë shumë të vjetra ose tepër të reja për sytë e tyre (Aronson, 2001). E nevojshme është që adoleshentëve t'u ofrohet një krijimtari në përputhje me moshën e tyre.

Sipas Hunt & Hampton, shumë prej adoleshentëve u mungon informacioni rreth teksteve të reja të botuara kohët e fundit. Njohja e adoleshentëve me

literaturën e kohëve të fundit ndikon në krijimin e marrëdhënieve pozitive me bashkëmoshatarë të tjerë të cilët janë duke lexuar të njëjtin libër (Hunt & Hampton, 1992).

Ndër faktorët e tjerë si më ndikues janë: përdorimi lojërave kompjuterike, qëndrimet me orë të tëra me grupin e bashkëmoshatarëve, përdorimi i celularit etj., të cilët reduktojnë kohën që mund ti kushtohej librit shkollor apo artistik. Rrjetet kumpjuterike luajnë një rol të dyfishtë. Nga njëra anë ato na shërbejnë të marrim informacione të larmishme për librat, informacione për botimet e reja dhe shkëmbim opinionesh, ndërsa nga ana tjetër ato pengojnë adoleshentët në leximin e librave.

3. Metodologjia e studimit

Për realizimin e këtij hulumtimi, 352 nxënësit e shkollës së mesme publike "Sandër Prosi" përbëjnë popullatën e studimit. Nga kjo popullatë është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme kampioni i përbërë nga 150 nxënës. Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave është anketa. Anketa përbëhet nga pyetje të mbyllura ku secila prej tyre ka alernativat e parashikuar nga ana e studiuesit. Në krahasim me përdorimin e pyetjeve të hapura, nga studiuesit është parë më me prioritet përdorimi i pyetjeve të mbyllura me qëllim për të mbajtur adoleshentët të fokusuar në çështjen që do të studiohet. Kjo do të na ndihmojë në shpjegimin e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, anketat me pyetje të mbyllura përpunohen më lehtësisht në mënyrë statistikore duke mos lejuar ngjyrimet emocionale të studiuesit. Nëpërmjet pyetjeve të mbyllura studiuesi mund të mbledhi një informacion shumë të gjerë. Ato krijojnë mundësinë për të krahasuar mendimet e përgjigjedhënësve (Yuan, 2016:33).

Të dhënat kryesore për realizimin e këtij hulumtimi janë mbledhur nga plotësimi i 150 anketave nga nxënës që ndodheshin në mënyrë të rastësishme në klasat e 10,11 dhe 12-ta. Një burim shumë i rëndësishëm të dhënash kanë qenë edhe bisedat e lira me mësuesit si dhe me drejtoren e shkollës. Secila prej teknikave të përdorura për marrjen e mostrave të qëllimshme apo të rastësishme, ka dhënë kontibut të vlefshëm në pasurimin e fondit të të dhënave për të kuptuar rëndësinë që adoleshentët i kushtojnë librit. Kombinimimi teknikave për mbledhjen e të dhënave kanë shmangur pothuajse çdo paragjykim të mundshëm nga ana e studiuesit dhe qëndron gjithnjë e më shumë pranë gjetjes së shkaqeve që theksojnë indiferencën e adoleshentëve ndaj librit.

Shkallët e Likertit janë përdorur gjerësisht në anketën e këtij studimi sepse siç i cilëson edhe vetë krijuesi i tyre Rensis Likert, ato janë një nga mënyrat më të besueshme për të matur mendimet, perceptimet dhe sjelljet (Likert, 1932).

Vlen të theksohet se përfundimet e këtij hulumtimi nuk mund të përgjithësohen, por mund të sjellin disa tregues të besueshëm për leximin dhe zakonet e lexuesëve adoleshentë. Që të dhënat të përgjithësohen është e nevojshme që hulumtimi të shtrihet në një një numër më të madh të anketuarish dhe të ketë një shtrirje më të gjerë.

4. Analiza e të dhënave dhe diskutime

Mbështetur në të dhënat empirike, por edhe në përpunimin statistikor të të dhënave të mbledhura nga anketa, nxirret në pah rëndësia që adoleshentët i kushtojnë leximit të librit. Pyetjet e drejtuara të anketuarëve kanë si qëllim të zbulojnë kujdesin që adoleshentët kanë për librin dhe trashëgiminë e tij brez pas brezi.

Kur të anketuarëve u drejtohet pyetja: A ju pëlqen të lexoni libra? 64 nxënës ose 43% e tyre shprehen se u pëlqen shumë të lexojnë libra, 48 nxënës ose 32% e tyre zgjedhin alternativën disi, 25 nxënësve u pëlqen pak të lexojnë libra dhe 13 prej tyre nuk kanë interes ndaj leximit të librit.



Ndërsa kur pyeten se sa libra lexojnë në vit, 71 nxënës shprehen se lexojnë 1 deri në 2 libra në vit. Kjo tregon se ka në mospërputhshmëri ndërmjet asaj që adoleshentët shprehin. Nga njëra ana ata shprehen se u pëlqen të lexojnë libra, e nga ana tjetër lexojnë shumë pak. Niveli i ulët i kuptueshmërisë dhe mendimi jo aktiv që adoleshentët kanë nga të moslexuarit na çon në nivele të tilla pëergjigjesh

dhe në nevoja të domosdoshme për ndërhyrje.



Nga përpunimi i të dhënave rezulton se koha më e rëndësishme për ta është koha që kalojnë me kompjuterin. Mendja dhe truri i tyre rezulton të jetë i fokusuar në lojërat online.



Këto të dhëna tregojnë se në raport me familjen, përdorimi i kompjuterit ofron më shumë kënaqësi te adoleshentët. Të dhëna të tilla mund të shërbejnë si një

shtysë për zhvillimin e hulumtimeve të tjera të cilat kanë në qendër marrëdhëniet interaktive ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Të dhënat e anketës tregojnë se teksti i shkruar po zëvendësohet nga lojërat kompjuterike, nga leximi i tekstit online etj. Nxitja e përdorimit të tekstit të shkruar duhet të vijë si një detyrë e mbarë shoqërisë. Shoqëria njerëzore nuk duhet shëndërruar në një shoqëri mekanike, por të vazhdojmë të jemi një shoqëri që përshkohet nga lidhjet e drejtëpërdrejta, nga emocionet dhe nga trashëgimi i kulturës brez pas brezi.

5.Konkluzione dhe rekomandime

Përpjekjet për të edukuar adoleshentët dhe konsoliduar zakonin e leximit të librit të shkruar janë gjithnjë të vazhdueshme. Rezultatet mund të jenë të menjëhershme, por mund të jenë edhe të zgjatura në kohë, megjithatë strategjitë që i vijnë në ndihmë zgjidhjes së problemeve asnjëherë nuk duhet të mungojnë. Hulumtimi i sociologut rreth problemeve sociale duhet të jetë nga këndvështrime të ndryshme. Siç thekson edhe Branko Merxhani, që të bëhet një punë me mend, dhe jo për një ditë e as për një mot, duhet studiuar jeta shqiptare në të gjitha format dhe dukjet e saj (Merxhani, 2003:382-384).

Të dhënat e këtij hulumtimi tregojnë se duhen ndërmarrë disa masa paraprake me qëllim që të tërheqim adoleshentët drejt leximit të librit. Ajo çfarë rekomandoj në një situatë të tillë është se prindërit dhe mësuesit duhet të inkurajojnë fëmijët drejt leximit.

Prindërit, shkollat, shtëpitë botuese dhe bibliotekat nuk duhet të rreshtin asnjëherë së promovuari librin, si atë artistik edhe atë shkollor. Çdo libër i lexuar është një gjurmë në edukatën e fëmijës së tyre. Kështu ne mund të krijomë qytetarin e denjë për shoqërinë.

Mësuesit në shkolla duhet të jenë më kërkues ndaj nxënësve. Dalja e një liste librash të cilët sugjerohen nga mësuesi në fillim dhe në fund të çdo viti shkollor do të ishte një strategji efektive e cila mund të tërheq më shumë lexues në bibliotekën e shkollës apo atë kombëtare.

Libri është ai i cili hap dyert e lexuesëve për të ardhmen.

Literaturë kryesore

- Aronson, Marc. *Exploding the Myyths: The truth about teenagers and reading*, Scarecroë Press.
- Carter, Philip & Russell, Ken. 2006. *Increase your brain poëer*. Ëiley India.
- City Neës. 2015. *Disa këshilla përse të lexosh libra është e rëndësishme*, http://ëëë.cityneës.al/2015/04/disa-keshilla-pse-te-lexosh-libra-eshte-e-rendesishme/1.
- Çelçima, Denis. 2017. *Adolescents and the challenges in their motivation*. European Journal of Social Sciences Education and Research. Vol.9. Nr. 2.: 99.
- Dyrkeim, Emile: *Rregulla të metodës sociologjike*, Shtëpia Botuese: Rilindja, Prishtinë, 1984
- Hunt, M. Gladys & Hampton, Barbara. 1992. *Read for your life: Turning teens into readers*. Zondervan Publishing House.
- INSTAT, 2016, Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2016, Marrë nga http://ëëë.instat.gov.al/media/ 322938/pop_1_janar_2016.pdf
- Kostallari, A., Thomaj, J. dhe Samara, M. 1984. *Fjalor i shqipes së sotme.* Akademia e Shkencave Të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë: 618.
- Leland, Christine; Leëison, Mitzi & Harste, Jerome. 2013. *Teaching Children's literature*. Routlege, New York and London.
- Likert, R. 1932. *A technique for the measurement of attitudes*. Archives of Psychology, Vol 22, No.140: 55.
- Merxhani, Branko. 2003. Vepra. Plejad.: 382-384.
- Poetica, Ars. 2008. *Ars Poetica* Nr.13. https://books.google.al/books?id=HxbxBQAAQBAJ &printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false
- Rubington, E., & Ëeinberg, M. S. 1995. *The study of social problems: Seven perspectives* (7th ed.). Neë York, Oxford University Press.
- Shala, Besart, Libri, mjet i veçantë për shprehjen e kulturës njerëzore, Editorial: Fol Tash, http://ëëë.foltash.com/libri-mjet-i-vecante-per-shprehjen-e-kultures-njerezor/
- Shëndetësia, 2016. Pse duhet të lexojmë libra, http://ëëë.botasot.info/shendetesia/546272/pse-duhet-te-lexojme-libra/

- Tushi, Gëzim. 2009. *Sfidat e Qytetërimit. Probleme sociologjike të njeriut, shoqërisë dhe qytetërimit shqiptar,* Shtëpia Botuese EMAL. :323 -351.
- Yuan, Chiristopher. 2016. Giving a voice to the voiceless. Ëipf & Stock. :32.

Driton TIKU, Ajet LECI

KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE SHQIPTARE GJATË LUFTËS NË KOSOVË 1998-99”

ABSTRAKT

Ky punim ka për qellim të analizojë rolin dhe kontributin e shoqërisë civile shqiptare gjatë historisë për Kosovën e sidomos në luftën e fundit 1998-99. Kosova prej Konferencës së Londrës 1912-13 u nda nga trungu shqiptar dhe ra nën sundimin serb. Përpjekjet e shqiptarëve në Kosovë dhe jashtë saj për pavarësi gati afër një shekull ishin të pandalshme, qoftë më protesta, demonstrata, rezistencë të armatosur, ngase dhuna dhe brutaliteti serb ndaj shqiptarëve në Kosovë kishte arritur kulmin. Në këtë kontest kontributi i shoqërisë civile shqiptare sipas pozicionit të tyre si më protesta, deklarata, afishe etj, ishte tepër i lartë në dobi te shqiptarëve të Kosovës, e në veçanti në luftën e fundit.

Duhet theksuar së Shoqëria civile shqiptare ishte promotor i pakontestueshem për kontributin në realizimin e aspiratave te shqiptarëve ku vlen te theksohen disa prej tyre si shoqata atdhetare Çamëria, labëria, Kolonja etj.

Fjalët kyçe*:* Shqipëria, Kosova, Shoqëria, Lufta

Abstract

The aim of this thesis is to analyze the role and contribution of Albanian civil society during history for Kosovo and especially in the last war 1998-99. Kosovo from the London Conference 1912-13 was separated from the Albanian trunk and fell under Serbian rule. The efforts of Albanians in Kosovo and abroad for independence almost a century ago were unstoppable, as well as protests, demonstrations, and armed resistance, as Serbian violence and brutality against Kosovo Albanians culminated. In this context, the contribution of the Albanian civil society according to their position as protests, declarations, posters etc was too high for the benefit of Kosovo Albanians, especially in the last war.

It should be emphasized that Albanian civil society was an indisputable promoter for contributing to the realization of the aspirations of Albanians, where

it is worth mentioning some of them as patriotic associations Çamëria, labëria, Kolonja etc.

Key words: Albania, Kosovo, Society, War

Shteti i Shqipërisë dhe Kosova deri në vitin 1998

Shteti i Shqipërisë u pajtohua "de jure" së Kosova të mos jetë pjesë e Shqipërisë dihet edhe historikisht qysh nga zhvleftësimi i vendimeve të Bujanit, pastaj më rezolutën e Prizrenit, e cila do të vijë pas vendosjes së gjendjes ushtarake në Kosovë e sidomos në Drenicë si quhej me termin "shpërthimin e kundërrevolucionit në Drenicë" ku duhet theksuar si rasti i parë aradhet partizane shqiptare dhe jugosllave se bashku kundër të ashtuquajturës pastrim të territorit kundër përkrahësve gjerman ku u vranë mijëra shqiptar të Kosovës në mënyrën më brutale. Pra duke parë këtu rrethana Shqipëria jo vetëm që nuk do të kërkojë diç më shumë për Kosovë se sa të këtë statutin e provincës nën Serbinë[1]. Por duhet theksuar rolin e Shqipërisë pas viteve 60-ta kur prishen marrëdhëniet e Shqipërisë më Bashkimin Sovjetik ku më vonë do të largohet edhe nga Pakti i Varshavës edhe pse do të lidhet më Kinën politika e shtetit të Shqipërisë do të kthehet nga Kosova në mbështetje të saj e sidomos gjatë protestave studentore 1968 pastaj 1981 ku në tribuna të Kongresit të tretë të PPSH-së do të mbështesë demonstratat e Kosovës duke zënë në gojë statusin e republikës së Kosovës si një zgjidhje e drejtë ku duhet cekur këtë të fundit vitin 1981 ku jugosllavët akuzuan drejtpërdrejt Shqipërinë për demonstratat e vitit në fjalë duke u akuzuar profesorët e Shqipërisë që ligjëronin në Universitetin e Prishtinës duke i quajtur si irredentist.[2] Po ashtu më ardhjen në pushtet si president i Shqipërisë Sali Berisha, fillimisht u mundua të bëhej zë i Perëndimit për pavarësinë e Kosovës, në disa raste, mirëpo u përball më kërcënimet perëndimore për izolim.[3]Për rolin e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe kanë qenë konsultat e para në vitet 90-ta ama në një mënyrë të fshehur por për shkak rënies së komunizmit në Shqipëri dhe fitores së demokracisë nuk kemi ndonjë rezultat konkret për shkak të problemeve politike gjithashtu edhe atyre piramidale të vitit 1997 dhe rrëzimi i qeverisë ku kthesën e cila ishte vendimtare për sukseset e UÇK-së. Qeveria socialiste e Fatos Nanos erdhi në pushtet në vitin 1997, përmes zgjedhjeve që i mbikëqyren ndërkombëtarët, pas rënies së qeverisë së Berishës në kohën e skemës Piramidale. Mbështetja e Perëndimit për rindërtimin e shtetit të Shqipërisë u bë prioritet

[1] Jusuf Buxhovi, Kthesa Historike 2, shteti paralel dhe rezistenca e armatosur, Prishtinë 2009, fq. 111

[2] Po aty, fq. 112-114

[3] Henry H Perrit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Rrëfim prej brenda për një kryengritje, Prishinë 2008, fq. 186

për shkak të gjendjes shumë të rëndë qe e kishte katandisur skema piramidale dhe kjo ndikoi duke e lënë në plan të dytë avancimin e nacionalizmit shqiptar në Kosovë. Në ndihmë të UÇK-së ishte udhëheqësi i sigurimit të Shqipërisë Fatos Klosi duke ndihmuar UÇK-në në mënyra të ndryshme.[4]Pas protestave të ndryshme që ndodhen në shumë shtete të Evropës në veçanti ndaj masakrës në Drenicë menjëherë veproi edhe diplomacia shqiptare me një kërkesë të veçantë kundër gjenocidit dhe terrorit serb ndaj popullsisë civile shqiptare ku shumica prej të vrarëve ishin gra, fëmijë dhe pleq. Diplomacia shqiptare e në veçanti ministria e jashtme dërgoi një letër kryetarit të këshillit të sigurimit duke dënuar gjenocidin serb gjithashtu kërkoi që menjëherë të mblidhet Këshilli i Sigurimit për të diskutuar rreth ngjarjeve në Kosovë e në veçanti ato në Drenicë. Menjëherë filluan reagimet e shtetit serb dhe aleatit të saj të vjetër Rusisë duke e cilësuar se gjithë problemi sipas tyre është te separatistët dhe terroristët shqiptar por kishte edhe përkrahës e në veçanti SHBA dhe BE duke e cilësuar të shfrenuar dhunën e Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe duke kërkuar menjëherë ndaljen e dhunës dhe fillimi i zgjidhjes së krizës.[5]Pra shteti shqiptar beri shumë përpjekje në forma ndryshme për te ndihmuar e në veqanti te ndërkombetarizoj çështjen shqiptare në Kosovë si me protesta, kumtesa etj, për zgjedhjen e problemit një her e përgjithmonë.

Roli i SHBA-ve ndaj Luftës në Kosovë 1998-99

Në tetor 1998 pas një ultimatumi të NATO-së, kryetari i atëhershëm i RFJ Millosheviq pajtohet për tërheqjen e pjesshme të forcave ushtarake të Serbisë nga Kosova dhe vendosja e në terren të një misioni verifikues të OSBE-së prej 2.000 personave të paarmatosur.[6] Msymjet e njëpasnjëshme të ushtrisë së okupatorit, apo ofensivat të pareshtura mbi forcat çlirimtare për një kohë duket sikur të kishin një marrëveshje të heshtur dhe të pa shkruar dhe atë në një trekëndësh te çuditshëm dhe simptomatik. Serbia në veprimet e saja nuk pengohej vetëm vështrohej. Një pjesë e faktorit politik kosovar shumë nuk trazohej thënë me thjesht u eksperimentua me UÇK-në. Është apo nuk është e mundur të zhdukej një gjë e tillë ishte e pamundur të ndodhte pa zhdukur tërë një popull atëherë ndërroi dhe gjuha e komunikimit edhe pesha e faktorizimit[7]. Ndërkombëtaret në veçanti amerikanët dhe të tjerët po kërkonin kontakte në kreun udhëheqës të shtabit

[4] Henry H Perrit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Rrëfim prej brenda për një kryengritje, Prishinë 2008, fq. 187

[5] Paskal Milo, Ditari i një ministri të jashtem, Konflikti i Kosovës, Tiranë 2009 fq. 35

[6] Masakra e Reçakut krim kunder njerzimit, Grup autoresh, Shtime 2004, fq 15-84

[7] Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2007, fq 316

të përgjithshëm, të UÇK-së, me drejtorinë politike, programuese dhe orientuese ideore dhe politike të luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. Lëvizja çlirimtare është faktor themelor i ndërkombëtarizimit te çështjes së Kosovës i imponimit te saj si çështje politike e gjeopolitike. Si rezultat i këtij ndërkombëtarizimit erdhi stadi i organizimit të një konference ndërkombëtare me nisjen dhe mbikëqyrjen e SHBA-ve, nën përkujdesjen e grupit të kontaktit dhe bashkë kryesimin e ministrave të punëve të jashtme të Britanisë së Madhe dhe Francës. Për të bërë ketë konferencë u bënë shumë kontakte dhe bisedime paraprake me delegacione të ndryshme, nga vendet e ndryshme që kishin edhe pikëpamje të ndryshme. Puna më madhe dhe me shumë këmbëngulësi që bërë nga përfaqësuesit diplomatik të SHBA-ve, nën udhëheqjen e ambasadorit të atëhershëm amerikan në ish Republikën e Maqedonisë, z. Kristofer Hill.[8]Të parët ishin amerikanët që kuptuan se UÇK-ja ishin tani një faktor i rëndësishëm në teren dhe nuk duhet tejkaluar, por ata theksonin se vështirë mund të gjendet një zgjidhje po nëse nuk merr pjesë edhe UÇK-ja në bisedime në mes Beogradit dhe Prishtinës. Filluan takimet e diplomateve amerikan me përfaqësues të UÇK-së në Drenicë duke u takuar me ta dhe duke shprehur interesim që edhe UÇK-ja të hyjnë në procesin e bisedimeve. Gjithashtu duhet theksuar edhe deklaratën e Departamentit të Shtetit Amerikan përmes zëdhënësit të saj James Rubin se amerikanët as nuk e kishin konsideruar dhe as e konsideronin UÇK-në si terroriste.[9] Po ashtu lobi shqiptar në Amerikë me anë te protestave, letrave duke ju dërguar senatorëve amerikan po bënë bujë në Amerikë për Kosovën ku çështja po merr hov në arenen ndërkombëtare.

Kontributi i shoqërisë civile shqiptare ndaj Kosovës 1998-99

Ambasadori austriak dhe njëherësh edhe i dërguari special i Bashkimit Evropian Wolfgang Petrich, kishte përpunuar një projekt propozim, të emëruar nga Grupi i Kontaktit, i cili përmbante elemente nga marrëveshja Holbrooke-Milosheviq, disa formulime nga deklaratat e delegacionit negociator shqiptar si dhe qëndrimet e Grupit të Kontaktit[10]. Mbi bazat e këtij dokumenti dhe të atij që ishte paraqitur ambasadori amerikan Kristofer Hill, në fillim të dhjetorit parashihej të vazhdonin negociata për Kosovën[11].

Për Konferencën e Rambujes model u morën negociatat e Dejtonit, por ajo nuk ishte Dejton[12]. Delegacioni shqiptar kishte paralajmëruar pjesëmarrjen e

[8] Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2007, fq 317

[9] Paskal Milo, Ditari i një ministri të jashtëm, Konflikti i Kosovës, Tiranë 2009 fq. 74

[10] Petrich. W. Kasser.K. Pichler. R. Kosova Mythen daten fakten (Kosova-mite, data, fakte), Klagenfurt/Wien 1998, fq.264.

[11] Marc Weller, Shtetësia e kontestuar …. fq. 417.

[12] Halil Katana, “Tri Dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës, shtëpia botuese “Argenta-IMG”,

tij, ndoshta, sepse nuk kishte zgjidhje tjetër, sepse mospjesëmarrja do të mund të nënkuptonte humbjen e mbështetjes ndërkombëtare për Kosovën. Kurse delegacioni serb ishte i gatshëm të merrte pjesë, vetëm se protestoi kundër pjesëmarrjes së përfaqësueseve të UÇK-së ndërkaq çdo gjë ishte e gatshme më 6 shkurt, pra bisedimet mund të fillonin.

Gjatë zhvillimit të negociatave delegacioni serb nuk largohej nga qëndrimi i vet, se nuk do të lejoj trupa të huaja ushtarake në "tokën e vet" sipas tyre.

Delegacioni serb mendonte se me këso sjelljesh do të bënte që konferenca do të mbyllej pa ndonjë rezultat, kurse në mundësinë e sulmeve ushtarake ky delegacion aspak nuk besonte. Negociatat nuk shkonin ashtu siç shpresohej, sepse pala serbe nuk largohej nga taktika e vet e zvarritjes[13] dhe kjo bëri që ambasadori Hill të shkoj në Beograd me 16 shkurt 1999 për të ia bërë Millosheviqit[14] të qartë se çfarë pasojash mund të kishte një qëndrim i tillë për vendin e vet, por ky takim nuk dha rezultat. Më 18 shkurt 1999 të dy palëve i′u prezantua teksti përfundimtar[15]i cili u refuzua nga të dy palët. Politika amerikane ishte e shqetësuar nga refuzimi i marrëveshjes nga palët e sidomos nga ajo shqiptare. Ambasadori Hill kërkonte nga pala shqiptare që të jenë të arsyeshëm dhe të kenë parasysh angazhimin dhe investimet amerikane.[16]

Bisedimet u ndërprenë[17] për disa ditë të cilat i shfrytëzuan negociatorët për të bërë presion mbi delegacionin serb, por pa sukses.

Në anën tjetër Bashkësia Ndërkombëtare në të njëjtën kohë përgatiste terrenin për legjitimitetin e një intervenimi të mundshëm ushtarak, si plan B[18]. Sllobodan Milosheviçi kishte vendosur "çrrënjosjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", rikrijimin e balancës etnike në Kosovë në baza të përhershme, si dhe

Tiranë 2002, fq.15.

13 Për më shumë shiko Marc Weller, Shtetësia e Kontestuar.... fq.431

14 Sipas Tim Judah, në veprën Kosova – luftë dhe hakmarrje,"Milosheviqi kishte vendosur të luante me fatin, ndërsa askush nuk e besonte këtë tërësishtë, botues „Koha Print", Prishtinë 2002, fq. 227

15 Jakup Krasniqi, Kthesa e Madhe Ushtria.... fq. 201

16 Konferenca ishte organizuar nga i ashtuquajturi Grup i Kontaktit, ku morën pjesë delegacioni shqiptar ne krye me Hashim Thaçin, ai serbo-jugosllav dhe pala ndërkombëtare, Petrich. W. Kasser.K. Pichler. R. Kosova.... fq. 295.

17 Konferenca e Rambujes synonte : 1. Arritjen e një marrëveshjeje juridike dhe politike për zgjidhjen politike të krizës në Kosovë , duke përcaktuar një zgjidhje kalimtare që parashihte vendosjen e Kosovës nën mbrojtjen e NATO-ës ; 2. Të mundësonte një vetadministrim të përkohshëm për Kosovën në periudhën trevjeçare dhe 3. Të hapte mundësin e zhvillimit të një procesi politik për përcaktimin e statusit final për Kosovën. Arsim Bajrami, E drejta e Kosovës.... fq.70-71.

18 Bajram Kosumi, Fondi personal

nxitjen e një krize humanitare destabilizuese, e cila do të preokuponte bashkësinë ndërkombëtare dhe do ta përçante rajonin[19]. Më 15 mars delegacioni i Kosovës u pajtua për nënshkrimin e marrëveshjes ndërsa delegacioni serb refuzoi marrëveshjen[20]. Më 18 mars 1999 në ora 18.30 në Pallatin Ndërkombëtar të konferencave u zhvillua ceremonia me ç′rast[21] delegacioni i Kosovës[22] e nënshkroi marrëveshjen e Rambuj[23] ndërsa ofensivat e ushtrisë dhe paramilitarëve serb në këtë periudhë intensifikoheshin gjithnjë e më shumë, konferenca i ndërpreu punimet. Çlirimi i Kosovës u arrit pas luftës, pas masakrës në familjen Jashari dhe shumë familje të tjera shqiptare në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
Kontribut te veçante kanë dhënë edhe shoqatat shqiptare më qendër në Shqipëri ku ne do ti cekim disa prej tyre më radhë.

Njëra prej tyre ka qënë Shoqata Kulturore Atdhetare "Labëria" njëra ndër krahinat më me zë të Shqipërisë, ku kjo shoqatë i dërgon një telegram Grupit të Kontaktit në Rambuje Paris-Francë.

Kjo shoqatë thekson mbështetjen e fortë që jep për delegacionin shqiptar të Kosovës për vendosjen e armëpushimit, për tërheqjen e forcave ushtarake serbe nga Kosova dhe të drejtën demokratike e të ligjshme të shqiptarëve për vetëvendosje. Gjithashtu në emër të Shoqatës kryetari i saj Halil Qëndro përshëndet edhe faktorin ndërkombëtar, për të vendosur trupat e NATO-së në Kosovë që të garantojë zgjidhjen paqësore në Kosovë.
Po ashtu kjo shoqatë përshëndet edhe Grupin e Kontaktit duke shpresuar se do të plotësoje kërkesat legjitime të popullit të Kosovës.[24]

Duhet theksuar edhe Shoqatën Patriotike-Kulturore "Kolonja", ku i dërgon një letër në emër të mijëra anëtarëve të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë e vlerëson historike detyrën që keni marrë përsipër: Mbrojtjen e Çështjes së madhe për pavarësinë e lirinë e Kosovës Martire. Ne, si i gjithë kombi shqiptar këto ditë historike jemi në çdo moment me ju. Ora e Kosovës po bie. Për padrejtësitë që kanë bërë shekujt e ka fjalën sot drejtësia që duhet të shpaloset në Rambuje. Kjo

---

19 Bajram Kosumi, Fondi personal.

20 Po aty

21 Po aty

22 Po aty

23 Driton Tiku dhe Kujtim Milaku, Rezistenca e armatosur faktorë kyç në sensibilizimin ndërkombetar të çështjes së Kosovës, Third International Conference "Interdiciplinary Studies" Tiranë, 2016 fq; 374-76

24 Bajram Kosumi, Fondi Personal

letër është bërë më datën 16. 02. 1999.[25]

Gjithashtu Shoqata tjera më rëndësi është edhe peticioni dërguar nga asociacioni i politikës për të drejtat ndaj dhunës së grave dërguar Robin COOK dhe Hubert WENDRIE. Aty theksohet për padrejtësitë që populli serb bënë ndaj shqiptareve dhe kërkohet për pavarësinë e Kosovës gjithashtu të ndalet dhuna e menjëhershme ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare në Kosovë dhe në fund aty theksohet për shpresën që ka kjo organizatë për ndihmë Kosovës në këto qaste shumë të vështira. Ky peticion ishte bërë nga sekretarja e asociacionet Mimoza Dajçi, zëvendës kryesuese Jolanda Tafmizi dhe kryesuesja Marie Medicina.

Po ashtu duhet cekur edhe Shoqërinë e mirënjohur Politike Atdhetare "Çamëria" që dërgoi një telegram komisionit shqiptar të Kosovës në konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje-Francë.

Aty theksohet "Të nderuar anëtarë të komisionit shqiptar në Rambuje, në konferencën ndërkombëtare për Kosovën, Ju përgëzojmë dhe ju urojmë për qëndrimin tuaj dinjitoz në mbrojtje të pavarësisë së Kosovës. Jemi me ju, që përfaqësoni vullnetin e dy milion shqiptarëve në Kosovë për pavarësi. E drejta është më ju, edhe me Kosovën. Jemi populli më i vjetër i Evropës, jemi autokton. Jemi për drejtësi, kërkojmë drejtësi dhe do të luftojmë të gjithë së bashku për drejtësi." Më në fund përmbyllet telegrami me shprehjen "Jemi me ju, jemi me Kosovën e Pavarur." Telegramin e shkroi kryetari i saj Hilmi Saqe Tiranë, më 15.02. 1999.

Një peticion tjetër e njëjta shoqëri ja dërgon Z. Robin Kuk dhe Z. Hubert Vendrie bashkëkryetarë të konferencës ndërkombëtare për Kosovën, Rambuje-Francë.

Aty citohet "Ne anëtarët e SHOQERISË POLITIKE ATDHETARE "ÇAMERIA", që përfaqësojmë 200 mijë qytetar shqiptar të Çamërisë të shpërngulur me dhunë nga shovinistet grek në vitin 1944-1945 nga trojet tona autoktone në Çamëri, ju drejtohemi juve shumë të nderuar përfaqësues të kombeve të qytetëruar dhe human, që të gjykoni dhe të vendosni në vend padrejtësitë e viteve 1912-1913, që më shumë se gjyma e kombit shqiptar u lanë nën robëri të shteteve fqinje grabitqar....Jemi ne , që kemi vuajtur tmerret e këtyre padrejtësive, që ju lutemi dhe ju kërkojmë që mos të përsëritet tragjedia Çame në Kosovë. Vendosni drejtësinë duke i dhënë Kosovës pavarësinë... Pranoni shkëlqesi nderimet tona më të sinqerta nga Kryetari Hilmi Saqe."

Po ashtu Konferencës së Paqes në Paris-Rambuje për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Kosovë i vegojnë edhe njerëz të profesioneve të ndryshme që jetojnë

---

[25] Bajram Kosumi, Fondi Personal

,

në Francë por ka pas edhe njerëz të tjerë që kanë shkuar për të marr pjesë në këtë manifestim gjithë popullor.

Në këtë peticion theksohet si vijon "Mijëra e mijëra shqiptare kemi ardhur sot për të manifestuar edhe një herë vendosmërinë tonë në përkrahje të delegacionit shqiptarë në Konferencën e Paqes në Paris dhe për të dëshmuar gjithashtu përkushtimin mbarë shqiptar për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare.... Ju të nderuar zotërinj e keni në dorë sot të zgjidhni drejtë dhe përfundimisht çështjen tonë shqiptare, ju e keni në dorë të ndreqni fajet dhe gabimet historike që janë bërë ndaj popullit tonë. Që nga dita e copëtimit të tokave shqiptare dhe e lënies së nenës Kosovë në duart e serbomëdhenjve mijëra e dhjetëra mijëra shqiptar janë vrarë nga pushtuesit, qindra mijëra janë burgosur, nuk ka fshat, shtëpi apo familje që nuk është përndjekur. Ne jemi më ju. Ne jemi për opsionin e vetëm liri e pavarësi për Kosovën. Nënshkruani vetëm këtë opsion dhe populli do të ju pres si bijtë e tij të devotshëm. Mos u lëkundni nga presionet...Deri në fund për Kosovën e lirë dhe të pavarur! Nga manifestimi mbarë popullor në Rambuje-Paris. 13 shkurt 1999."

Gjithashtu edhe një memorandum Konferencës dhe ambasadorëve ja dërgojnë edhe "Dëshmoret e 4 shkurtit" Tirana-Albanie në gjuhën frënge kryetari i saj Pirro Dodbiba.

Po ashtu duhet theksuar letrën që ka dërguar ish-presidenti i Shqipërisë Delegacionit shqiptar në Rambuje citojmë "Te dashur vëllezër kam qenë pranë jush gjithë këto ditë. Kam ndjekur nga afër veprimtarinë tuaj shumë të përgjegjshme në Konferencën e Rambujës, mund t ju them së ashtu si gjithë shqiptaret jam entuziazmuar më kohezionin dhe profesionalizmin qe keni treguar për të arritur maksimumin e mundshëm për një zgjidhje që vazhdimisht është projektuar si kalimtare dhe që ne nuk duhet të sakrifikonim. Niveli i lartë dhe përgjegjshmëria juaj e ka rritur më tej besimin e shqiptarëve në vendimet që do të nënshkruani. E kuptojmë barrën e madhe që keni marrë mbi sipër: I kuptojmë të gjitha vështirësitë tuaja por kemi besim të plotë së do ta dilni mban më mençuri dhe kthjelltësi. Të gjithë së bashku kuptojmë gjithashtu rëndësinë e këtij momenti historik për çështjen e Kosovës dhe çështjen shqiptare". Po ashtu vazhdon letra e presidentit "Për çështjen e Kosovës, po aq e rëndësishme sa qëndresa burrërore e shqiptarëve është mbështetje ndërkombëtare i vazhdimit të kësaj mbështetje deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Prania e forcave të NATO-së në Kosovë ka qenë dhe mbetet elementi thelbësor i të gjithë qëndrimeve tona. Kjo prani na siguron për evoluimin e mbarë të të gjitha opsioneve te mëtejshme në Kosovë që do të finalizohet, sipas deklaratës së Sekretares Amerikane të Shtetit Madelein Albright më një mbledhje ndërkombëtare për Kosovën, bazë e së cilës

do të jetë vullneti i shprehur i popullit shqiptar, opinioni i autoriteteve me peshë, përpjekjet e çdo pale lidhur më implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe Akti Final i Helsinkit Ju përshëndes përzemërsisht-Juaji REXHEP MEJDANI."
Po ashtu për takimet në fjalë që i cekim më lartë në intervistën që kam bërë më Paskal Milon thotë së këmbëngulës dhe rol shumë të madh në Konferencë kanë mbajt drejtuesit e UÇK-së dhe ata janë njerëzit që e sollën Kosovën në Rambuje. Duhet theksuar edhe intervistën time më Bujar Dugollin që përfaqsonin levizjën studentore në Kosovë ku thekson rolin e Thaçit në konferencë e në veçanti takimin e tij si përfaqësues i organizatës studentore me Adem Demaçin për zbutjen e qëndrimit të tij rreth konferencës ku sipas këtij të fundit s'pajtohet për shkak së Konferenca për Kosovë po mbahet në Francë dhe siç dihet historikisht Franca më herët ka qenë e lidhur ngushtë më aleatet e saj serb kundër shqiptarëve, ku tash ka ndryshuar qëndrimin e saj.

Përfundimi

Shoqëria civile në shumë aspekte ndihmoj shqiptaret e Kosovës për ndalimin e luftes dhe zgjedhjen e konfliktit si me protesta, telegrame etj. Pra, ishte mbeshtetje morale me te gjitha mundesitë e saj. Kontributi i shoqatave te ndryshme shqiptare si ajo Çamëria, Kolonja Laberia etj ishte shtytese e vullnetit te përfaqsusve politik shqiptar te Kosoves në Rambuje për zgjidhje paqësore te konfliktit.

Duhet cekur së lufta nuk është mjeti më i mirë për të zgjidhur problemet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet veti. Shumicën e rasteve tregojnë së në luftë nuk ka fitimtarë. Por edhe ai që e shkakton luftën në të shumtën e rasteve është humbës. Pas çdo lufte ka një shkatërrim të pa parë në shumë aspekte. Situata e pas çdo lufte kërkon rivendosjen e ekuilibrave, në mënyrë të tillë që të mos lejohet përsëritja e dhunës dhe e vrasjes.

Burimet dhe Literatura

I.Burime te Botuara dhe te Pabotuara
Kosumi, Bajram, Fondi personal, dokumente
II. Literatura

1. Albright, Madeleine, Zonja Sekretare (Autobiografi), shtëpia botuese "Dudaj" Tiranë, përktheu Engjëllushe Shqarri,2004;
2. Bajrami, Arsim, E drejta e Kosovës në Tranzicion, (E drejta Kushtetuese, Libri II) , Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002;

3. Buja, Ramë, Konferenca e Rambujesë, Prishtinë, 2006;
4. Buja, Ramë, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, "Grafoprint", Prishtinë, 2007;
5. Buxhovi, Jusuf, Kthesa Historike 2, shteti paralel dhe rezistenca e armatosur, Prishtinë, 2009;
6. Clark, K. Wesley, Të bësh luftë moderne (Bosnja, Kosova dhe ardhmënia e luftërave), Prishtinë, 2003;
7. Judah,Tim, Kosova- luftë dhe hakmarrje " Koha Print", Prishtinë, 2002;
8. Katana, Halil, Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës, shtëpia botuese "Argenta " Tiranë, 2002;
9. Krasniqi, Jakup, Kthesa e Madhe -Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Prishtinë, 2006;
10. Masakra e reçakut krim kundër njerëzimit, Grup Autoresh, Shtime, 2004;
11. Meier, Viktor, Fundi i Jugosllavisë goditja në Kosovë, shqipëroi-përktheu Elton Lelo, "Iliria" 2006;
12. Mertus, A. Julie, Legjitimiteti i përdorimit të forcës në Kosovë; marrëdhëniet etnike&ndërkombëtare, volumi 15, 2001;
13. Milo, Paskal, Ditari i një ministri të jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001, Toena, Tiranë, 2009;
14. Milo, Paskal, Kosova nga Rambujeja në Pavarësi 1997-2008,(intervista) "Toena", Tiranë,2009;
15. MoisiuPetriç, Volfgang, Rruga e gjatë në luftë, botues "Koha", Prishtinë, 2002;
16. Petrich, W. Kasser.K. Pichler. R. Kosova Mythen daten fakten, Klagenfurt/ Wien, 1998;
17. Perrit, Henry, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Rrëfim prej brenda për një kryengritje, Prishinë, 2008;
18. Qosja,Rexhep,[1999],Paqja e Pergjakshme-Konferenca ndërkombëtare për Kosoven-Rambuje 6-23 shkurt 1999-Paris 14-19 mars 1999, Tiranë;
19. Ru M, Kosova: një zhvillim ekonomik i ngadalshëm dhe i pamjaftueshëm, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990;
20. Tahiri, Edita, Konferenca e Rambujes-Procesi Negociator dhe Dokumentet, "Dukagjini", Pejë, 2001;
21. Tiku, Driton, Ekonomia e Kosovës 1974-81, Revista "Reforma"(Nr.4/2016) Gjilan,2016:
22. Tiku, Driton dhe Millaku Kujtim, Rezistenca e armatosur faktorë kyç në sensibilizimin ndërkombetar të çështjes së Kosovës, Third International Conference "Interdiciplinary Studies" Tiranë, 2016;

23. Verli, Marenglen, Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate, "Botimpex", Tiranë, 2007;
24. Verli, M, Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990 Tiranë, 2000;
25. Weller, Marc, Shtetësia e Kontestuar (administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi), titulli i origjinalit (Contested Statehood: The International Administration of Kosovo′s Struggle for Indepedence), "Koha", Prishtinë, përktheu nga origjinali anglisht Flaka Surroi, 2009;

Dr. Shkëlqim SIRIKA

MIGRIMET HUMANE, PROBLEMATIKAT E PROCESEVE URBANIZUESE NË NIVEL LOKAL

RAST STUDIMI: HAPËSRIA PERIURBANE PASKUQAN.

Abstract

After 1990 in Albania, demographic developments were accompanied by a controlled movement of population, in a massive movement from mountainous areas(northeastern and southeastern areas)towards the city and possible territories of an informality. In the framework of this move, the Administration Unit of Paskuqan returned to one of the centers with the largest influx of population migration. This is due to its geographic conditions near the city of Tirana and an agricultural area (formerly "Gjergj Dimitrov") with free land to become an urban area.

Paskuqan ,as an area newly built by the incoming population , which plays an important determinant role in socio-economic and environmental development with local and regional effects in the country, faces as many problems in urbanization process. Under these conditions and within the framework of policies of sustainable development it is a necessary to introduce new development approaches for informal and in particular with suburban areas, which can provide more effective solutions with faster balancing and integration effects.

Key words*:* Suburban area, migration, sustainable development.

1. Hyrje

Migrimi është një nga dukuritë tipike që ka shoqëruar gjithë historinë e zhvillimit të popullsisë shqiptare. Për shkak të prapambetjes ekonomike dhe kushteve të vështira natyrore të shumë zonave malore shqiptarët kanë qenë gjithmonë në kërkim të zonave më të mira të banimit brenda vendit.

Në Shqipëri, pas një periudhe gati gjysëm shekulli, u vërejt me fillimin e vitit 1991 e në vazhdim një fluks mjaft i madh të migrimit të brendshëm të popullsisë. Ky proces migrues përfshiu dhe zonën tonë të studimit Njësinë

Administrative të Paskuqanit. Shumë banorë u shpërngulën nga zonat malore verilindore, kryesisht Dibër dhe Kukës duke u vendosur në ish- tokat bujqësore të ndërrmarrjes " Gjergj Dimitrov". Kjo lëvizje migruese u shoqërua me një fluks masiv duke çuar në rritjen e shpejtë të popullsisë deri në mbipopullim të Paskuqanit. Ritmi i lartë i shtimit të popullsisë si rezultat i shpërnguljes së popullsisë nga zonat malore drejt kësaj zone si një shprehje e dëshirës dhe vendosmërisë së individit për të dalë mbi vështirësitë, me vështrimin e projektuar drejt një jete më të mirë për vete dhe familjen e tij nga njëra anë u shoqërua nga probleme sociale dhe mjedisore nga ana tjetër.

2. Migrimi në hapësirën periurbane Paskuqan dhe ecuria e popullimit.

Njësia Administrative Paskuqan ka një pozicion tepër të favorshëm gjeografik, sipas rajonizimit fiziko-gjeografik të territorit të Shqipërisë bën pjesë në zonën qëndrore të ultësirës perëndimore të Republikës së Shqipërisë. Kufizohet në veri nga Njësia Administrative Zall-Herr dhe Bashkinë Kamëz, në jug dhe perëndim me Bashkinë Tiranë, në lindje me njësin administrative Dajt. Relievi është kodrinoro-fushor, ku dominojnë kodrat me një lartësi mesatare rreth 265 m mbi nivelin e detit dhe me toka pjellore. Afërsia me qytetin e Tiranës vetëm 2.5 km nga qendra e tij, relievi i përshtatshëm, kushtet e mira klimaterike dhe tregu i lire i tokës në fillimet e vendosjes së popullsisë përbëjnë që kjo njësi administrative të ketë një fuqi thithëse migruese për banorët e zonave malore.

Deri në vitin 1985 Paskuqani numëronte vetëm 897 banorë me një rritje deri në 1720 banorë në vitin 1990. Që nga viti 1991 zhvillimet demografike kanë kaluar në disa etapa si rezultat i shtesës mekanike. Mbas vitit 1991 rrjedhojë e migrimit të brendshëm nga zonat malore verilindore kemi një rritje drastike të popullsisë, rritje që mund të konsiderohet një bum demografik. Mesatarisht rritja mekanike deri në vitin 2010 ka qenë afërsisht 1800 banorë në vit. Ky faktorë ka ndikuar në shtimin natyror të numrit të popullsisë. Shtesa mesatare e popullsisë këto 18 vitet e fundit është 150 banorë në muaj. Numri i të ardhurve nga viti 1990 dhe deri më sot është 39 mijë banorë. Sot në 12 fshatrat që përfshin kjo njësi banojnë 40500 banorë. Përsa i përket strukturës moshore grupmosha 0-18 vjeç përbën rreth 35 % të popullsisë tregues i cili tregon vitalitettë kësaj popullsie.

Tabela1: Ecuria e popullsisë

Nr	Viti	Popullsia
1	1985	897
2	1990	1720
3	1992	4350
4	1998	19301
5	2005	31952
6	2016	40500

Burimi: *Zyra e planifikimit urban Paskuqan*



Harta 1*: Parashikimi i investimeve në Paskuqan*

Grafikiku 1: *Ecuria e popullsisë në Paskuqan*



Dominimi i popullsisë së re në moshë është rrjedhojë e faktit se shumica e familjeve migruese janë familje të reja.

1. **Faktorët që ndikuan në lëvizjen migratore dhe efektet rajonale**

Zhvillimet demokratike në vend në vitet 90-të, çoi në lëvizjen e lirë të popullsisë. Në zonat verilindore gjatë periudhës komuniste popullsia ishte rritur në përpjestim jo të drejtë kundrejt potencialeve natyrore që ofronin këto territore. Kushtet e vështira të jetesës në zonat malore, mbyllja e shumë aktiviteteve industriale, mundësitë e pakta të punësimit, aktiviteti bujqësor jo efektiv, gjendja e vështirë infrastrukturore (rrugët, shkollat, spitalet etj) ishin disa nga faktorët që detyruan popullsinë e këtyre zonave të migrojnë drejt zonave periurbane të kryeqytetit. *Pse Paskuqani u bë një nga hapësirat pritëse të këtij migrimi*? Ndër faktorët tërheqës përmendim:

- Paskuqani ka një pozicion tepër të favorshëm në lidhje me zhvillimet e reja të pas v.90-të si dhe tendencat në rritje të zhvillimit të Rajonit të Tiranës.
- Njësi administrative me problem jot ë shumta të pronësisë mbi token dhe tregu i lire i saj.
- Njësi administrative me tendenca të rritjes së shërbimeve (transportit, arsimit dhe shëndetësisë)

- Mundësia për legalizim të banesave si një zone informale në ndërtim rishtaz.

- Njësi administrative me potenciale për rritje të mëtejshme të komuniteteve rurale dhe me planifikim në zhvillim me shumëllojshmëri instrumentesh të zbatueshëm për një integrim të qëndrueshëm
- Tërheqja nga të afërmit e larguar
- Shtrirja gjeografike ngjitur me Bashkinë e Tiranës
- Mundësi për punësim, lehtësia për të gjetur punë

Siç e theksuam më sipër familjet që kanë migruar në Paskuqan kanë ardhur kryesisht nga zonat very-verilindore të Shqipërisë. Më konkretisht nga zona e Dibrës 34%, nga Kukësi 39% dhe të tjerë nga Burreli, Tropoja por dhe nga Korça dhe Gramshi.

4. **Problemet sociale, ekonomike dhe mjedisore të mbipopullimit**

Fluksi i migrimit të popullsisë në këtë hapësirë urbane nuk u shoqërua në raport të drejtë me zhvillimet urbane. Përqëndrimi i lartë i popullsisë në këtë hapësirë në një kohë shumë të shkurtër ishte përtej kapacitetit dhe aftësisë së pushtetit vendor dhe qëndror për ta përballuar këtë dyndje. Dyndja e madhe u shoqërua me rritje të shpejtë të ndërtimeve dhe në veçantë të banesave në menyrë kautike (të shpeshta e te parregulta). Përqindja e zënies së territorit me ndërtime është i lartë por jo të zhvilluar në kate të larta.U zunë toka buke dhe vendi u

Figura 1. Pamje nga Paskuqani (Sh.Sirika)

betonizua duke zhdukur sipërfaqe të gjelbërta dhe dëmtuar biodiversitetin. Probleme u shfaqen në furnizimin meujë të pijshëm, shkarkim të ujrave të ndotura dhe mbetjeve urbane dhe furnizimit me energji elektrike. Deri vonë mbetjet urbane shkarkoheshin në lumin e Tiranës.

Gjithashtu vendosja e popullsisë së ardhur u shoqërua me problem sociale si hasje vështirësie në bashkëjetesën e banorëve të karakterizuara nga kultura të ndryshme. Linden problemet e punësimit, shkollimit dhe kujdesit shëndetësor që nuk sigurohej në fillimet e këtij migrimi.

5. Tendencat e urbanizimit dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm

Vitet e fundit ka një tendencë në dukje për krijimin e zonave të urbanizuara dhe kjo është më e dukshme gjatë rrugës kryesore (Rruga Demokracia) që përshkon këtë njësi administrative. Këto zona përbëjnë thelbin e krijimit të vizionit të ri urbanizues,dhe krijimit të një platform territorial të mirëplanifikuar. Fuqia punëtore ka tendenca të një rritje të shpejtë duke mbajtur të qëndrueshme gjendjen e papunësisë.

Përmirësime të ndjeshme vihen re në infrastrukturë si:

Furnizimi me energji elektrike: Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti kryesor nacional, janë prerë lidhjet e jashtëligjshme dhe janë bërë investime në linja 20 KV dhe ngritjen e kabinave të reja elektrike për çdo lagje.

Furnizimi me ujë të pijshëm: Rritja e kërkesës për ujë të pijshëm si rezultat i shtimit të popullsisë dhe rritjes së standardit dhe cilësisë së jetesës është shoqëruar me problem në furnizimin e popullsisë. Për përmirësimin e këtij shërbimi janë kryer investime në ujësjellës të rinj (janë ndërtuar 5 depo uji) për të rritur furnizimin me ujë gjatë 24 orëve.

Kalalizimet e ujërave të zeza: Një nga problematikat më të mëdha sociale dhe mjedisore të zonës në fillimet e fluksit migrues ishtemungesa e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza. Rrteh 70% e popullsisë bëjnë shkarkimet e nevojave jetike në gropa septike dhe me rrjete shumë primitive duke shfrytëzuar pjerrësinë e detyruar të tërrenit drejt përrenjve dhe lumit të Tiranës duke shkaktuar ndotje mjedisore.Vetëm 30% e popullsisë është përfshirë në rrjetin inxhenerik të mirëfilltë të shkarkimeve të ujërave të përdorura. Dy vitet e fundit është disiplinuar grumbullimi i mbetjeve urbane me mjete të standardizuara, por duhet theksuar që mungojnë kontinierët në brendësi të lagjeve.

Rrjeti rrugor dhe transporti publik: Njësia përshkohet nga një rrjet rrugor me një gjatësi lineare 94.51 km prej të cilave vetëm 30 km janë të shtruara me asphalt. Për përmisimin e mëtejshëm infrastrukturor e rëndësishme është zgjerimi i tri urave që e lidhin me Tiranën dhe shtimi i tyre.Në territorin e Paskuqanit janë në

shërbim dy linja urbane që e lidhin me Tiranën.

Shërbimi arsimor: Përsa i përket institucioneve arsimore publike aktualisht numërohen 6 shkolla 9- vjeçare dhe 2 gjimnaze, te cilat janë kryesisht në gjendje të mirë.

***Figura 2**: Investimet në infrastrukturën rrugore (Sh.Sirika)*

Shpërndarja e institucioneve arsimore referuar përqëndrimit të popullsisë nuk është i drejtë.

Shërbimi shëndetësor: Të gjithë banorët aktualisht janë të përfshirë në marrjen e shërbimit shëndetësor, përmirësimi i këtij shërbimi është i dukshëm me ndërtimin e 5 qendrave shëndetësore dhe 1 poliklinike të specialiteteve.

Ndërtimet si ato të karakterit banesë dhe ato të karakterit biznes po shkojnë drejt legalizimit ku theksojmë që 25% janë 1-2 kate, 42% 2-3 kate, 25 %, 3-4 kate dhe 8% mbi 4 kate.

Vizioni i Ri Urbanizues: Aktualisht Paskuqani karakterizohet nga një planifikim urban I varfër. Tendenca është që kjo njësi do të zhvillohet si një territor urban i arritshmë që ofron mekanizma tërheqës dhe zona rekreative (Parku i Liqenit të Paskuqanit), larg zhurmës dhe jetës frenetike të kryeqytetit. Rrugët kryesore po vijonë të jenë me pemë dhe trotuare, me tabela sinjalizues dhe ndriçim. Intergrimit nga një zone informale në një njësi uniforme e ndërlidhur fort do të konsilidohet me krijimin e qendrave të fragmentuara urbane, suburbane dhe zona e gjelbërt.

***Figura 3**: Kompleks sportive në Paskuqan (Sh.Sirika)*

Pika e fortë drejt zhvillimit urban të Paskuqanit është lidhja e mirë me Bashkinë Tiranë, për vetë formën e shtrirjes gjatësore duke marrë mbi territorin e saj dhe zgjatimin e Bulëvardit të Ri " Zogut i Parë" deri në liqenin artificial. Gjithashtu me rëndësi do jetë ndërtimi i Unazës së Madhe përgjatë lumit të Tiranës që do shërbejë si një zgjidhje definitive të trafikut. Nga pikëpamja strategjike rol të rëndësishëm do luajë përfundimi i rrugës interurbane të Arbrit që përshkon këtë njësi në anën veriore.

***Figura 4**: Plani i zhvilimit urban Paskuqan (Burimi: Zura e planifikimit Paskuqan)6.*

6. **Përfundime**

- Njësia Administrative Paskuqan është një nga zonat më të prekura të Shqipërisë nga migrimi i brendshëm i popullsisë pas vitit 1990 duke u kthyer në një hapësirë informale me tendecë urbanizimi.
- Shtimi i popullsisë për dy dekadat e fundit në raport me kapacitetin mbajtës është në raport jot ë drejtë.
- Mbipopullimi i kësaj hapësire u shoqërua me probleme serioze, sociale-ekonomike dhe mjedisore.
- Investimet dhe zhvillimet vitet e fundit po japin shpresë për një kthim nga një zonë informale në një zonë me planifikim të rregullt urban.
- Infrastruktura rrugore ka përmirësime të ndjeshmVitet e fundit ofrohet shërbimi i transportit public urban me dy linja.
- Shërbimi arsimor dhe shëndetësor ka një shpërndarje të barabartë bazuar në përqëndrimin e popullsisë.
- Është vënë në kontroll të plotë sektori i ndërtimit dhe po nxitet shtrirja e tyre në hapsira m ëpak të populluara.
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës vihet re në krijimin e qendrave sociale dhe hapjen e qendrave tregtare, shtimin e hapësirave publike.

Referenca:

1. Sirika.S., Doka. Dh. “Braktisja e zonale malore nëpërmjet migrimit të shqiptarëve dhe efektet e këtij procesi për zhvillimin e ardhshëm të tyre”
2. Zyra e planifikimit dhe kontrollit të shërbimit urban Paskuqan.

Yllka R.IMERI

INTONACIONI NË DEBATET POLITIKE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

Abstrakti

Synimi i këtij punimi është studimi i ngritjes, uljesdhe forcës së zërit, si edhe mënyra e shqiptimit dhe theksimit të fjalëve, kur synojmë që të shprehim sa më mirë ndjenjat e qëndrimin tonë dhe të ndikojmë te dëgjuesi. Në këtë punim trajtojmë tone të ndryshme të zërit gjatë emisioneve të ndryshme politike.
Hulumtimi ynë bazohet në emisione politike të cilat i kemi korpus të hulumtimit, emisionin "Opinion" që zhvillohet në Shqipëri, dhe disa debate politike që ishin nëpër kanalet televizive të Kosovës.Intonacioni i jep tjetër kuptim fjalëve dhe fjalive, për këtë arsyeje studimi ynë ngrit në pah disa çështje rreth intonacionit. Intonacioni është tipar i rëndësishëm dhe tipar i pandarë gjuhës, formohet nga ndërveprimi i dukurive fonetike, si ndryshimi i lartësisë së tonit themelor që përftohet nga ndryshimi i pandërprerë i tendosjes së tejzave të zërit gjatë të folurit, ndryshimi i forcës së zërit, i shpejtësisë, ku të gjitha këto dukuri i hasim në emisione politike.

Rolin e Intonacionit e shohim gjatë të folurit dhe shohim se Intonacioni shpreh një numër të madh kuptimesh e nuancash kuptimore.Intonacioni shpesh here pëson modifikime edhe në varësi nga shprehja e emocioneve që ka individi, ku emocionet politike i shohim si më të shpërthyrea, ku ato na japin një intonacion më të lartë. Matjen e Intonacionit të mysafirëve në emisionet për debate politike e kemi bë me programin PRAAT i cili na dha rezultate kryesisht të mjaftueshme.
Fjalët kyçe: Intonacion, debat, emision, Praat, krahasim.

Hyrje

Në debatet politike në Kosovë bashkëbiseduesit përdorin fjali të ndryshme për ta marrë fjalën.Mjeti gjuhësor kryesor që e bën dallimin ndërmjet këtyre fjalive është intonacioni.Intonacioni i ndryshëm bën që të dallohet një fjali dëftore nga një fjali pyetëse. Fjalitë në bazë të kumtimit, të përmbajtjes, të funksionit ndahen në tre tipa: fjali dëftore, fjali nxitëse e dëshirore dhe fjali pyetëse (Gramatika e gjuhës shqipe 2002:117). Fjalitë që i përdorin më së shpeshti folësit për mirësjelleje në një debat në Kosovë, janë fjalitë nxitëse dhe pyetëse. Fjalitë nxitëse shprehin një kërkesë të folësit për realizimin ose mosrealizimin

e diçkaje në formë urdhëri, propozimi, këshille, lutje etj (2002:131). Në bazë të llojit të kërkesës, intonacioni merr melodi të ndryshme (ibid).Fjalitë pyetëse përdoren për të pyetur për diçka që nuk e di ose për të vërtetuar një fakt.Rastet kur fjalia e ka vetëm formën e një fjalie pyetëse, por ajo shtrohet vetëm për të pohur ose mohuar një fakt janë fjali pyetëse retorike. Te këto fjali intonacioni është elementi kryesor, e veçanërsiht te fjalitë pa fjalë pyetëse. Pra, e njëjta fjali pyetëse mund ta ketë përbërjen e njëjtë me një fjali dëftore ose ndonjë tjetër dhe t'i dallojë vetëm intonacioni.

Këtyre fjalive që përmendëm u mbishtrohen disa elemente jovijore, të cilat kanë funksione gjuhësore, siç janë intonacioni, theksi etj. Pamë që roli i intonacionit ishte shumë i rëndësishëm te fjalitë pyetëse dhe elementi kryesor që i dallon ato. Në këtë punim do të shohim se cilat nga mjetet gjuhësore i përdorin më shumë folësit në debate politike në Kosovë për mirësjellje, duke i krahasur me debatet politike në Shqipëri.

Metodologjia e kërkimit të këtij punimi u mbështet në shqyrtimin sinkronik dhe diakronik të shqipes duke ndjekur dy emisionet politike, duke i analizuar me programin Praat, dhe duke përdorur metodën krahasuese – përshkruese për dy dialektet (apo ideolektet që i shfaqnin emetuesit tek marrësit). Studimi fonologjik nuk mund të jetë i plotë, nëse fonemat nuk shihen edhe nga pikëpamja sintagmatike. (Memushaj, 2009: 217-221).Qëllimi i fonetikanëve ishte jo vetëm studimi i tingujve, por i gjithë mjeteve tingullore në shfaqjet dhe funksionet e tyre, si edhe lidhja midis formës tingullore dhe shkrimit të gjuhës (Dodi, 2004: 286-287). Më 1983, Dodi dhe Gjinari paraqesin në Insitutin e Gjuhësisë tekstin "Fonetika e gjuhës shqipe", me disa ndryshime teksti ribotohet më 2005, nga Dodi, ku klasifikimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve bëhet më vete. Një klasifikim tjetër të bashkëtingëlloreve e gjejmë te teksti i dialektologjisë botuar nga J. Gjinari (1989). Autori përqas sistemet fonetike dialektore dhe jep inventarin e bashkëtingëlloreve të shqipes së njësuar. Në tekstin "Fonetika e shqipes standarde" (2004), B. Beci sjell klasifikimin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve sipas tipareve të tyre nyjëtimore.

Nëpërmjet analizës krahasuese të dy sistemeve fonologjike, të shqipes të folur në Kosovë, dhe shqipes së folur në Shqipëri, modeleve të të menduarit të sjelljes së shqiptarëve, në këtë studim shtjellohen përpjekjet, mënyrat dhe efektet e interferencës gjuhësorese në përvetësimin e gjuhës.

Intonacioni i fjalive në emisionin "Debat" të Kosovës

Në Kosovë në një debat politik, kur folësit kërkojnë ta marrin fjalën, përdoren tridhjetë e nëntë fjali. Tipat e këtyre fjalive u takojnëdy grupeve

kryesore: fjalive pyetëse dhe fjalive nxitëse. Fjali pyetëse përdoren shtatë, gjashtë me pjesëzën pyetëse *a* dhe një pa fjalë pyetëse. Nga gjashtë fjali pyetëse që përdoren me pjesëzën pyetëse *a*, pesë prej tyre intonacionin e kanë ngjitës-zbritës dhe vetëm një e ka ngjitës**.** Fjalitë që janë përdorur me pjesëzën pyetëse a janë:

1. A po m'len me t'trëgu une ty sa e keqe jeni ju ?(ngjitës-zbritës);
2.*A bon m'u, a bon m'u ndëgju?*(zbritës-ngjitës).;
3. *A ta ndërprej debatin apo po vazhdojmë me debat ?*(ngjitës-zbritës);
4. *A po do me ta lon me fol deri n'fund?*(ngjitës-zbritës);
5.*A bon me m'leju ty me të tregu qe s'osht e vërtet?* (ngjitës-zbritës).
6. *A bon veç ni minut?*(ngjitës-zbritës).

Ngjitja e intonacionit bëhet në pjesëzën pyetëse *a*dhe shkon duke zbritur. Në figurën 1 jepet intonacioni i fjalisë pyetëse me pjesëzën pyetëse *a*.

Fig. 1.Intonacioni i fjalisë pyetëse me pjesëzën pyetëse a.



1. ***A bon me m'leju ty me të tregu qe s'osht e vërtet?***

Fjalia pyetëse pa fjalë pyetëse ishte: *Vetëm pak ju lutem, n'qofse ka mundsi me m'leju?*. Në këtë fjali intonacioni është zbritës-ngjitës .Në figurën 2 jepet intonacioni i fjalisë pyetëse pa fjalë pyetëse.

Fig 2. Intonacioni i fjalisë pyetëse pa fjalë pyetëse.



2.Vetëm pak ju lutem, n'qofse ka mundsi me m'leju?

Pra, edhe pse mund të bëhet një përgjithësim i lakores së intonacionit të fjalive pyetëse për të gjitha gjuhët, që është intonacioni ngjitës, prapë secila gjuhë i ka mjetet e veta me të cilat e realizon pyetjen, pa qenë e nevojshme për shfrytëzimin e lakores ngjitëse të intonacionit domosdoshmërisht. Edhe brenda varieteteve të së njejtës gjuhë ka dallime të lakores së intonacionit për të formuluar frazën pyetëse.

Pjesa tjetër e debatit bëhet me fjali nxitëse kryesisht. Këto fjali përbëjnë edhe pjesën më madhe të debatit, me tridhjetë e dy fjali. Nga këto, nëntëmbëdhjetë fjali e kanë intonacionin ngjitës-zbritës dhe trembëdhjetë e kanë zbritës-ngjitës. Fjalitë nxitëse që u përdorën janë:

1.*Ju lutem veç ta përfundoj qeta edhe t'ja jepi kuptimin!*(ngjitës-zbritës);
2.*Ju lutem shumë m'i manipulu!*(ngjitës-zbritës);
3.*Po t'lutem ni moment ta përfundoj une!*(ngjitës-zbritës);
4.*T'lutem shumë, asni nen!*(ngjitës-zbritës);
5.*Prit ni moment!*(ngjitës-zbritës);
6.*Edhe pesë sekonda!*(zbritës-ngjitës);
7. *O zotni vazhdo!* (ngjitës-zbritës);
8.*Se ma morët prapë kohën.*(ngjitës-zbritës);
9.*Prit nihere!*(ngjitës-zbritës);
10.*M'falni ju lutem!*);(ngjitës-zbritës);
11.*Ju lutem keni konsiderata!* (zbritës-ngjitës);

12. *T'lutem mos ma lsho debatin n'ket nivel!*(ngjitës-zbritës);
13. *Edhe t'lutem kur flas, mos ndërhy, mos ndërhy, mos ndërhy zotni*!(ngjitës-zbritës);
14. *Ju lutem bre!* (ngjitës-zbritës);
15.*Vetëm pak, vetëm pak!*(zbritës-ngjitës);
16.*Vetëm pak, vetëm pak, vetëm pak, vetëm pak!*(zbritës-ngjitës);
17.*T'lutem dëgjom nuk du me komentue!*(ngjitës-zbritës);
18.*Vetëm pak!*(zbritës-ngjitës);
19.*Vetëm pak, vetëm pak, jo jo jo jo*!(zbritës-ngjitës);
20.*Diskuto, por mos ma zhvendos temën!*(zbritës-ngjitës);
21.*Le ta mbaron fjalën.*(zbritës-ngjitës);
22.*Le ta mbaron.*(zbritës-ngjitës);
23.*Veç edhe qeta!*(zbritës-ngjitës);
24.*Ju lutem, ju lutem!* (zbritës-ngjitës);
25.*T'lutem shumë!*(ngjitës-zbritës);
26.*S'po keni bre mirkuptim, ni zonjë e kemi n'studio!*(ngjitës-zbritës);
27.*Prit ni sekondë, prit ni moment!*(ngjitës-zbritës);
28.*Nuk është e ndershmë, ni moment!*(ngjitës-zbritës);
29.*T'lutem shumë, t'lutem shumë!*(zbritës-ngjitës);
30.*Lem mor burr t'kallxoj çfarë rregullash!*(ngjitës-zbritës);
31.*O zotni!*(zbritës-ngjitës);
32. *T'lutem shumë, t'lutem shumë!*(ngjitës-zbritës).

Lakorja melodike e intonacionit shkon duke u ngjitur në pjesën ku përdoret mënyra urdhërore, pasthirrmat *o, bre* dhe në pjesën kur përdoren fjalë për mirësjellje: *Ju lutem! Më falni!*. Në figurën 3 është dhënë intonacioni që dominon te fjalitë nxitëse.



Fig. 3. Intonacioni i fjalisë nxitëse

3. Ju lutem bre!

Pra, lakorja melodike e intonacionit në këtë debat, në shumicën e rasteve, është ngjitës-zbritës.

Intonacioni i fjalive në emisionin "Opinion" të Shqipërisë

Edhe në Shqipëri fjalitë u takojnë ose fjalive pyetëse ose nxitëse.Këtu përdoren nëntë fjali pyetëse, gjashtë me fjalë pyetëse dhe tri pa fjalë pyetëse. Nga fjalitë pyetëse me fjalë pyetëse, pesë prej tyre shqiptohen me intonacion ngjitës-zbritës dhe një me intonacion zbritës-ngjitës: 1.*A mund ta mbaroj unë tashi?*(zbritës-ngjitës);
2 *A mund të mbaroj unë tashi, t'lutem?*(ngjitës-zbritës);
3.*A do m'lësh t'mbaroj?*(ngjitës-zbritës);
4.*A mund të flasim për gjëra më serioze?*(ngjitës-zbritës);
5.*A m'pyte?*(ngjitës-zbritës);
6.*Sa kohë kam?* (ngjitës-zbritës)
Ngjitja e lakores melodike fillon me pjesëzën *a*, përemrin pyetës *sa*dhe shkon duke rënë. Figura 4 paraqet intonacionin e fjalisë pyetëse me fjalë pyetëse.



Fig. 4.Intonacioni i fjalisë pyetëse me fjalë pyetëse.

4. A mund ta mbaroj unë tashi, t'lutem?

Fjalitë pyetëse pa pjesëz ose përemër pyetës ishin:

1. *Do pytjet po/jo?*(zbritës-ngjitës);

2.*Ti mban përgjegjësi?*(zbritës-ngjitës);

4.*Do përgjigjen? (*ngjitës-zbritës).

Intonacioni i tyre është zbritës-ngjitës dhe një shembull i tyre paraqitet në figurën 5.



Fig.5. Intonacioni i fjalisë pyetëse pa fjalë pyetëse.

5. Do pytjet po/jo?

Pjesa tjetër më e madhe u takonte fjalive nxitëse me dyzet fjali, prej të cilave njëzet e dy e kishin intonacionin ngjitës-zbritës dhe tetëmbëdhjetë zbritës-ngjitës:

1. *Dëgjo, m'lër ta mbaroj!*(zbritës-ngjitës);
2.*M'lër t'mbaroj mo!*(ngjitës-zbritës);
3.*Më dëgjo me vëmëndje, mos më ndërprit!*(zbritës-ngjitës);
4.*Po m'lër mo ta mbaroj tashi!*(zbritës-ngjitës);
5.*Më fal, më fal, m'fal, m'fal, m'fal,m'fal!* (zbritës-ngjitës);
6.*Po mos më ndërprit njëqind herë, më lër t'mbaroj!*(zbritës-ngjitës);
7.*Më lër ta shpjegoj pse, po t' lutem të mos gënjesh!*(ngjitës-zbritës);
8. Mirë*, po m'lër t'mbaroj!*(ngjitës-zbritës);
9.*Tashi më lër!*(zbritës-ngjitës);
10.*M'fal, m'fal* (ngjitës-zbritës);
11.*Po më lër ta mbaroj pra!*(ngjitës-zbritës);
12.*Po më lër mo ta them!* (ngjitës-zbritës);
13.*Nji minut mo ta mbaroj!*(ngjitës-zbritës);
14.*Po të lutem tani.*(zbritës-ngjitës);
15.*Mos bëj më!*(ngjitës-zbritës);
16.*Nji minut pra!*(ngjitës-zbritës);
17.*M'fal, m'fal!* (ngjitës-zbritës);

18.*Nji minut mo, nji minut!* (ngjitës-zbritës);
19.*Nji minut ta mbaroj, tani mo ësht çudi e madhe!*(ngjitës-zbritës);
20.*Zotri, m'lër t'mbaroj!*(ngjitës-zbritës);
21.*Po m'lër mo t'përgjigjem!*(zbritës-ngjitës);
22.*Mos m'ndërprit!*(ngjitës-zbritës);
23.*Tashim'lër t'mbaroj unë.*(ngjitës-zbritës);
24.*Tashi t'lutem të mbaroj!* (ngjitës-zbritës);
25.*Nuk ju lë t'm'ndërpritni!*(zbritës-ngjitës);
26.*Nji minut mo, nji minut, nji minut, nji minut Fevzi, nji minut!*(ngjitës-zbritës);
27.*Po dëgjo mor ti zotri!* (zbritës-ngjitës);
28.*Tani m'lër t'mbaroj, m' lër t'mbaroj, më lër t'mbaroj!*(zbritës-ngjitës);
29.*Më lër t'mbaroj, mos gënje!*(zbritës-ngjitës);
30.*Po të lutëm shumë se është e turpshme!*(ngjitës-zbritës);
31.*Nji minut mo, nji minut, nji minut!*(zbritës-ngjitës);
32.*Mos më ndërprit njëqind herë1*(ngjitës-zbritës);
33. *Dëgjo, dëgjo!*(zbritës-ngjitës);
34.*Po më lër t'flas* !(zbritës-ngjitës);
35.*Nji minut m'shiko ktu, m'shiko!*(zbritës-ngjitës);
36.*Dëgjo, dëgjo!*(ngjitës-zbritës);
37.*T'lutem, që t'jemi serioz!* (zbritës-ngjitës);
38.*M'fal ta mbaroj mo!*(ngjitës-zbritës);
39.*T'lutem shumë Fevzi, m'lër t'mbaroj!*(zbritës-ngjitës);
40.*M'fal mo ta mbaro!j* (ngjitës-zbritës).

Figura 6 paraqet një shembull të fjalive nxitëse me intonacionin ngjitës-zbritës.



Fig.6. Intonacioni i fjalisë nxitëse.

6. Po më lër mo ta them!

Ngjitja e lakores bëhet te pjesëza pyetëse *a,* përemri pyetës *sa,* te pasthirrma *mo*dhe te mënyra urdhërore. Përdoren dymbëdhjetë fjalë të mirësjelljes si *të lutem, m'fal* etj.

Rezultatet e hulumtimit

• Njëzet e katër fraza e kishin intonacionin ngjitës-zbritës dhe pesëmbëdhjetë zbritës-ngjitës në emisionet politike në kanalet e Kosovës. Ky tip mbizotëronte në të dy llojet e fjalive që janë përdorur. Ngjitja e lakores melodike bëhej në pjesëzën pyetëse *a,* në pasthirrmat *o,bre,* në fjalët e mirësjelljes *Ju lutem!, Më falni! etj*. Në debatin e Kosovës përdoren rreth pesëmbëdhjetë fjalë të tilla.

• Intonacioni ngjitës-zbritës mbizotëron edhe në debatin e emisionit Opinjon të Shqipërisë me njëzet e tetë fjali.

• Punimi është realizuar me programin Praat, dhe skemat e nxjerrura nga analiza na japin rezultate, nga regjistrimi i zërit në Praat.

Përfundime

Intonacioni i zërit ka rëndësi si formë komunikimi joverbal, si përfundim i gjithë kësaj shohim se intonacioni që ne kemi bë në këtë punim nuk ka nevojë për shikim verbal, sepse mund të kuptohet vetëm me dëgjim. Intonacioni i duhur i jep jetë fjalimit, ndikon në ndjenjat dhe i motivon të tjerët, rëndësi të madhe ka edhe theksi,kur përdor theksin logjik e ndihmon auditorin ta kuptojë atë që thua. Ndërsa, kur përdoret siç duhet larminë në volum, ritëm dhe ton, fjalimi mund të jetë shumë më i këndshëm për t'u dëgjuar.
Intonacioni është më shumë tipar i thënies se sa tipar i fjalisë, prandaj peshën kryesore në punimin tonë do ta mbajë interpretimi i fjalive pyetëse.

Bibliografia

1. Beci, B., Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore. Tiranë, 1995
2. Briscoe, R. E., Individualism, Externalism and Idiolectical Meaning. United States , 2006
3. Çabej, E. Studime gjuhësore, Prishtinë, 1975
4. Çerkezi, E., & Billa, E., Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare. Korçë, 2013
5. Dod, A, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004
6. Gjinari, J. Përqasja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik.Tiranë, 1984

7. Gjinari, J., Marrëdhëniet e sotme të dialektikave me gjuhën letrare, Tiranë, 2011
8. Gjinari, J., & Shkurtaj, Gj., Dialektologjia, Tiranë. 2003
9. Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002

Samire Bllaca-BALAJ

OPINIONI I MËSIMDHËNËSVE MBI NDIKIMIN E FAMILJES DHE FAKTORËVE FAMILJARË PËR SJELLJE TË DHUNSHME NË SHKOLLË

Abstrakti

Shkolla, kultura dhe mjedisi shkollor mund të rrethohen nga situata të dhunshme që i bëjnë dëm komuntitetit në përgjithësi duke e parë nxënësit si palën që mund të ndahet si më i dëmtuari si psicikisht ashtu edhe fizikisht. Dhuna si dukuri çdo herë sa vjen e shtohet në nivelin lokal, kombëtar ndoshta edhe btëror. Të gjeturat e hulumtimeve të mëhershme tregojnë për situatën e brishtë të sigurisë në shkollat e Prishtinës. Për më tepër, raporti i planit të veprimit (2014) për hartimin e 'Platformës për Siguri në Shkolla 2015-2018", ofron të dhëna të detajuara për situatën e sigurisë në shkollat Prishtinës të cilat rezultate që janë të vlefshme për hartimin e platformës për siguri në shkollat e kryeqytetit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është eksplorimi i faktorëve familjarë që mund të rrisin sjelljet e dhunshme tek nxënësit adoleshentë dhe krahasimi i sjelljeve të nxënësve në zonat rurale-urbane.

Në hulumtim janë përdorur tre pyetësorë, në pjesën e parë janë paraqitur të dhënat demografike, kurse dy pjesët e tjera të pyetësorit është kërkuar që nxënësit, prindërit si dhe mësimdhënësit të përgjigjen në pohimet e ofruara në shkallën Likert por edhe të përcaktojnë pohimin që prezanton qëndrimin e tyre. Seksioni i dytë i pyetësorit është shfrytëzuar dhe përfshin: Opinionin mbi shkaktarët e dhunës, e autores Mimoza Shahini (2013).

Konsistenca e Brendshme me vlerat e fituara Cronbach alfa (α) ishte për pyetjet e pyetësorit për mësimdhënës (.681) gjë që tregojnë se pyetësori mund të konsiderohet mjaft të besueshëm në vlerësimin e dhunës dhe ndikimet tek nxënësit në shkollë.

Fjalë kyçe: Dhunë, faktorë, familje, nxënës, sjellje e dhunshme.

1.Hyrje

Shkolla me trupën e saj përveç detyrave edukative-arsimore ka për qëllim ti përgatisë nxënësit me vlera demokratike dhe të tolerancës sepse misioni i saj

është që shoqëria të ndryshoj krahas ndryshimeve që bën ajo. Kohëve të fundit sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkolla kanë marrë përhapje kombëtare por edhe vëmendje ndërkombëtare. Shkolla është institucion që e siguron zhvillimin e shoqërisë por në këto mjedise edukative-arsimore, sjelljet e dhunshme në mes të nxënësve kanë filluar të bëhen mjaft shqetësuese për shoqërinë kosovare. Studime nga shumë vende në të gjitha rajonet e botës vënë në dukje se 80 deri në 98 % e fëmijëve vuajnë ndëshkimin fizik në shtëpitë e tyre, prej nga një e treta ose më shumë përjetojnë ndëshkime fizike të rënda, që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve të ndryshme (Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri 2007:9).

Dhuna në shkollë përfshinë cfarëdo sjellje e cila ka për qëllim të dëmtojë një person, fizikisht, emocionalisht apo edhe pasurinë e tij shkollore. Meqë edukimi i fëmijëve fillon në familje dhe si vazhdimësi ata në të njejtën kohë janë pjestar të lagjes, komunitetit shkollor, thënë në nivelin më të gjerë edhe shoqërisë në përgjithësi.

Duhet vënë theks të vecantë mbi rolin e familjes në edukimin e fëmijës për sjellje sociale, sepse faktorët që ndikojnë në formimin e fëmijëve, prindërit konsiderohen faktori i parë.

2.Parashtrimi i problemit

Dhuna në shkollë dhe sjelljet e dhunshme në shkollë janë brengë për familjën, stafin e mësimdhënësve, nxënësit si dhe tërë shoqërinë.

Rezultatet e hulumtimeve të shumta, të cilat në dekadën e fundit janë bërë nga institucionet me sektorë të ndryshëm dhe nga organizatat jo-qeveritare, tregojnë një trend në rritje të dhunës në familje, dhe sidomos dhunë mes fëmijëve dhe të rinjve të moshës së njëjtë, ku rezultatet e tilla tregojnë se dhuna edhe në mesin e nxënësve në shkollë tregon shanse për rritje.

Për ta trajtuar më mirë problematikën e sjelljeve të dhunshme të nxënësve ndihet e nevojshme të identifikohen faktorët që shkaktojnë shanse për shfaqje të sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë.

Në bazë të statistikave, nga hulumtimi i kryer në shkolla (2007), fëmijët të cilët marrin pjesë në kacafytje, kanë më shumë gjasa që në ardhmen të bëhen kriminel. Shumë fëmijë që shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë zakonisht janë të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi ose diku tjetër.

(http://ëëë.fiq-fci.org/repository/docs/siguria_ne_shkolla_shqip.pdf,parë13 mars 2015). Atmosfera që mbretëron në shtëpi mund të ndikoj në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme tek të rinjtë. Atmosfera në familje dhe marrëdhëniet në mes të anëtarëve të familjes janë faktorë stabiliteti që e ndihmojnë zhvillimin e fëmijës për sjellje sociale në rrethin ku jeton.

Sipas hulumtimit të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore të dhënat raportojnë se ushtrohet dhunë në familje dhe se meshkujt janë ata që ushtrojnë më shumë dhunë, në shumicën e rasteve, femrat janë viktima.

Përvetësimi i modelit të sjelljes së dhunshme përbën kështu njërën nga pasojat e dukshme të efektit psikik të dhunës së të rriturve. Të rriturit vënë re se sjelljet e dhunshme të fëmijëve të tyre janë shumë të ngjashme me sjelljet e dhunshme që ata vetë kanë përdorur ndaj tyre. "Modelimi psikik i të dhunuarve rezulton i ngjashëm me modelin psikik të dhunuesve të tyre. Pasoja e modelimit psikik agresiv nuk është një pasojë që vjen menjëherë pas një përdorimi të caktuar dhune. Ajo më shumë se kaq është një rezultante e shumë akteve të përdorimit të dhunës dhe kësisoj ajo përbën një pasojë të ngulitur fort në psikikën e fëmijës (Tamo& Karaj, 2006).

3.Metodologjia

Hulumtimi është kuantitativ dhe ka shfrytëzuar të dhënat sasiore të fituara nga pyetësori për identifikimin e faktorëve që nxënësin shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë.

Instrumenti

Pyetësori për mësimdhënës ka përmbajtur gjithsej 4 variabla që kanë prezantuar karakteristikat e grupit të mostrës sonë, dhe 40 variabla (items) përmes të cilave janë mbledhur perceptimet e mësimdhënësve mbi ndikimin e familjes në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave të teta dhe të nënta.
Me 40 variablat u zhvillua analiza faktoriale eksploruese sipas metodës së Komponentëve Kryesore dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX [meqenëse të dhënat tona janë intervale]. Vlerat e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy = .567; dhe Bartlett's Test of Sphericity Sig= .000), na treguan që analiza faktoriale është valide dhe eksploruese.

Përmes procedurës faktoriale variablat manifeste janë kondensuar dhe si rrjedhim janë fituar 10 faktorë latentë. Në varësi të variablave që kanë përbërë secilin faktor, 10 faktorët/komponentët janë emëruar si:

- Ballafaqimi me situata të dhunshme
- Mbikëqyrja e dobët e familjes
- Prezenca e dhunës në familje
- Gjendja ekonomike e familjes
- Lojërat e dhunshme dhe interneti

Analiza e të dhënave

Duke pasur parasysh që tema e punimit është e lidhur drejtpërdrejtë me familjen dhe ndikimin e saj në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit e klasave

të teta dhe nënta, në analizat e mëtejme janë përfshirë vetëm faktorët të cilët na mundësojnë që të trajtojmë këtë temë më tej. Këta faktorë janë:

1. Ballafaqimi me situata të dhunshme
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes
3. Prezenca e dhunës në familje
4. Gjendja ekonomike e familjes
5. Lojërat e dhunshme dhe interneti

Tabelat në vazhdim paraqesin vlerat e mesatares aritmetike dhe të devijimit standard për secilin faktor sipas karakteristikave të prindërve pjesëmarrës në hulumtim.

Tabela 61- *Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Gjinisë– Pyetësori për Mësimdhënës,* paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas gjinisë. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike gjininë femërore dhe në me pak në atë të gjinisë mashkullore .Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 61

Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Gjinisë – Pyetësori për Mësimdhënës

Faktorët	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
	MA (SD)	*MA (SD)*	*MA (SD)*
Ballafaqimi me situata të dhunshme	2.58 (0.64)	2.53 (0.51)	2.56 (0.59)
[redacted]	2.51 (0.58)	2.68 (0.66)	2.57 (0.61)
[redacted]	2.59 (0.57)	2.39 (0.49)	2.53 (0.55)
[redacted]	2.42 (0.66)	2.58 (0.50)	2.47 (0.61)

	2.55 (0.55)	2.39 (0.64)	2.50 (0.58)

Tabela 62

Dallimet e Faktorëve tek Mësimdhënësit sipas Gjinisë

Faktorët	Gjinia	Mean Rank	Mann-Ëhitney U	Sig.
Ballafaqimi me situata të dhunshme	M	52.89	1269.000	.324
	F	58.35		
Mbikëqyrja e dobët e familjes	M	62.00	1197.000	.140
	F	53.68		
Prezenca e dhunës në familje	M	50.01	1159.500	.084
	F	59.83		
Gjendja ekonomike e familjes	M	60.39	1258.000	.303
	F	54.50		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	M	51.83	1228.500	.214
	F	58.90		

Siç shihet nga tabela, dallimet nuk janë të vlefshme statistikisht. Të gjithë faktorët nuk kanë treguar ndryshime të vlefshme statistikore.

Tabela 63- *Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Vendbanimit– Pyetësori për Mësimdhënës,* paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas vendbanimit. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera të përafërta të mesatares aritmetike si për nxënësit nga fshati ashtu edhe nga qyteti . Nëse i referohemi faktorëve, ata kanë treguar vlera të përafërta ndërmjet tyre.

Tabela 63

Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Vendit – Pyetësori për Mësimdhënës

Faktorët	Vendi	
	Qytet	Fshat
	MA (SD)	*MA (SD)*
[redacted]	2.50 (0.65)	2.68 (0.47)
	2.61 (0.59)	2.50 (0.65)
	2.49 (0.55)	2.61 (0.55)
	2.47 (0.62)	2.47 (0.60)
	2.51 (0.53)	2.47 (0.69)

Tabela 64

Dallimet e Faktorëve tek Mësimdhënësit që jetojnë në Fshat dhe Qytet

Faktorët	Vendbanimi	Mean Rank	Mann-Ëhitney U	Fig.
Ballafaqimi me situata të dhunshme	Fshat	60.81	1228.000	.248
	Qytet	54.37		
Mbikëqyrja e dobët e familjes	Fshat	53.47	1275.500	.426
	Qytet	57.99		
Prezenca e dhunës në familje	Fshat	61.66	1196.500	.178
	Qytet	53.95		
Gjendja ekonomike e familjes	Fshat	56.97	1370.000	.903
	Qytet	56.27		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	Fshat	58.24	1323.000	.649
	Qytet	55.64		

Siç shihet nga tabela, faktorët nuk treguan dallime të vlefshme statistikisht në

faktorët e përcaktuar .

Tabela 65-*Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Arsimimit– Pyetësori për Mësimdhënës,* paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas opinionit të mësimdhënësve. Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për mësimdhënësit me nivel arsimimi të Shkollës së Lartë Pedagogjike.

Tabela 65

Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Nivelit të Arsimimit – Pyetësori për Mësimdhënës

Faktorët	ShLP		Fakultet		Master	
	MA	*SD*	*MA*	*SD*	*MA*	*SD*
Ballafaqimi me situata të dhunshme	2.70	0.56	2.59	0.57	2.17	0.72
Mbikëqyrja e dobët e familjes	2.65	0.49	2.59	0.62	2.25	0.75
Prezenca e dhunës në familje	2.70	0.56	2.54	0.55	2.17	0.39
Gjendja ekonomike e familjes	2.39	0.66	2.50	0.58	2.42	0.79
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.39	0.58	2.54	0.55	2.42	0.79

Meqenëse në grupin tonë të mësimdhënësve, vetëm një prej tyre është me nivel të arsimimit Doktoraturë, të dhënat e tij nuk janë paraqitur më lart. Po ashtu, në mënyrë që të zhvillohet testi post hoc Tukey HSD, duhet që një grup ti ketë të paktën dy raste. Për këtë arsye, niveli i arsimimit – doktoraturë, nuk është përfshirë as në analizat e mëtejme.
Tabela 66.

Dallimet sipas Nivelit të Arsimimit të Mësimdhënësve

Faktorët	Niveli i Arsimimit	Mean Rank	Chi-Square (df 2)	Sig.
Ballafaqimi me situata të dhunshme	ShLP	62.39	6.208	.045
	Fakultet	56.83		
	Magjistraturë	38.50		
Mbikëqyrja e dobët e familjes	ShLP	59.41	2.836	.242
	Fakultet	56.95		
	Magjistraturë	43.42		
Prezenca e dhunës në familje	ShLP	64.43	7.505	.023
	Fakultet	56.45		
	Magjistraturë	37.00		
Gjendja ekonomike e familjes	ShLP	52.61	.425	.809
	Fakultet	57.03		
	Magjistraturë	56.00		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	ShLP	50.43	1.216	.544
	Fakultet	57.82		
	Magjistraturë	55.17		

Rezultatet nga analiza Kruskall-Ëallis të paraqitura në tabelën e mësipërme, tregojnë që për faktorin 'Ballafaqimi me situata të dhunshme' ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të mësimdhënësve (p =.045). Po ashtu, kjo analizë ka nxjerrë vlera të rëndësisë statistikore edhe për faktorin Prezenca e dhunës në familje (p=.023). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht për të dy faktorët, vetëm në grupin e mësimdhënësve me SHLP me mësimdhënësit me Magjistraturë.

Tabela 67- *Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Moshës– Pyetësori për Mësimdhënës,*paraqet vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për faktorët që ndikojnë në sjelljet e dhunshme tek nxënësit sipas opinionit të mësimdhënësve . Siç shihet nga tabela, shumica e faktorëve kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike për mësimdhënësit e grup moshës 41-52 vjeç .

Tabela 67

Mesatarja dhe Devijimi Standard për faktorët Ndikues sipas Moshës – Pyetësori për Mësimdhënës

Faktorët	23 – 40 vjeç		41 – 52 vjeç		53 – 64 vjeç	
	MA	*SD*	*MA*	*SD*	*MA*	*SD*
Ballafaqimi me situata të dhunshme	2.57	0.61	2.62	0.59	2.52	0.60
Mbikëqyrja e dobët e familjes	2.49	0.64	2.67	0.66	2.63	0.54
Prezenca e dhunës në familje	2.63	0.60	2.43	0.51	2.45	0.50
Gjendja ekonomike e familjes	2.45	0.61	2.52	0.60	2.48	0.64
Lojërat e dhunshme dhe interneti	2.45	0.64	2.71	0.46	2.45	0.55

Tabela 68

Dallimet sipas Moshës së Mësimdhënësve

Faktorët	Mosha (në vite)	Mean Rank	Chi-Square (df 2)	Sig.
Ballafaqimi me situata të dhunshme	23-40	56.99	.460	.794
	41-52	59.31		
	53-64	54.40		
Mbikëqyrja e dobët e familjes	23-40	53.59	1.167	.558
	41-52	61.02		
	53-64	57.84		
Prezenca e dhunës në familje	23-40	61.14	2.506	.286
	41-52	51.86		
	53-64	53.03		
Gjendja ekonomike e familjes	23-40	55.24	.238	.888
	41-52	58.76		
	53-64	56.93		
Lojërat e dhunshme dhe interneti	23-40	54.82	3.391	.184
	41-52	66.71		
	53-64	53.28		

Siç shihet nga tabela, dallimet sipas moshës së mësimdhënësve nuk treguan ndryshime të vlefshme statistikisht në faktorët e përcaktuar.

4.Diskutimi

Sipas statistikave në Kosovë dhe UNICEF 2013/2014 krahasuar me gratë dhe vajzat e rajonit dhe nëpër botë del që në Kosovë femrat kanë tolerancë mjaft të lartë ndaj dhunës fizike, duke lënë pas në mënyrë mjaftë të ndjeshme Malin e Zi dhe Serbinë. Ky realitet flet për një gjendje që regjioni qëndron më mirë në krahasim me Kosovën ku papunësia është shumë e madhe. Për pjesëmarrësit është parë e rëndësishme që të merren edhe opinione nga mësimdhënësit rreth faktorëve familjarë ngase edhe këta në mënyrë të tërthortë japin opinionin e tyre ngase janë familjarë.

Edhe për pjesëmarrësit mësimdhënës në hulumtim, në përputhje me pyetjen kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit, për gjininë, moshën dhe vendbanimin u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e fituara përmes testit *chi*-square, treguan që ka dallime të vlefshme statistikore ndërmjet mësimdhënësve femra dhe meshkuj [$\chi 2(1)=11.571$, p =.000],si edhe për nivelin e shkollimit [$\chi 2(3)=114.643$, p =.000], dhe vendbanimin [$\chi 2(1)=11.571$, p =.000].

Rezultatet nga analiza Kruskall-Ëallis të paraqitura, tregojnë që për faktorin 'Ballafaqimi me situata të dhunshme' ekzistojnë dallime të vlefshme statistikore në nëngrupet që prezantojnë nivelin e arsimimit të mësimdhënësve (p =.045). Po ashtu, kjo analizë ka nxjerrë vlera të rëndësisë statistikore edhe për faktorin Prezenca e dhunës në familje (p=.023). Për të përcaktuar se cilët prej grupeve dallojnë statistikisht mes tyre, u zhvillua analiza post hoc Tukey HSD, rezultatet e së cilës treguan që dallimet janë të vlefshme statistikisht për të dy faktorët, vetëm në grupin e mësimdhënësve me SHLP me mësimdhënësit me Magjistraturë. Në të dy faktorët shihet se situatat e dhunshme dhe dhuna në familje mund të jenë shkaktarë të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme nga analiza e opinionit të mësimdhënësve. Rezultatet nuk treguan dallime statistikore në mësimdhënës; Perceptimet në lidhje me gjininë e tyre, ndërkohë që ka dallime në perceptimet e tyre në varësi të nivelit akademik, vetëm dy nga faktorët familjarë që kontribuojnë në sjelljen e dhunshme të fëmijëve. Rezultatet e tilla përcaktojnë nevojën për studime më të thella dhe më të thella.

Studimi i kryer në Maqedoni 2008/2009 tregon se fëmijët përjetojnë dhunë nga njerëzit më të rritur e që edhe ky studim mbi gjendjen ne shkollat fillore e sheh dhunën dhe modelet e dhunës në familje si shkaktarë të mundshëm të shfaqjes së sjelljeve të dhunshme. Nëse analizojmë këta faktorë në kontekstin e vendit tonë edhe këtu flitet se dhuna dhe ushtrues të dhunës janë njerëzit e afërt,

ku djemtë janë më të rrezikuar nga dhuna fizike, kurse vajzat nga keqpërdorimi verbal (MAShT-UNICEF, 2009-2018). Dallimet rezultojnë se janë statistikisht të rëndësishme në mes të mësimdhënësve me Shkollë të Lartë Pedagogjike dhe Magjistraturë. Për sa i përket shkallëve të shkollimit është e rëndësishme të theksohet se niveli i shkollimit sa më i lartë që të jetë njohuritë dhe shanset e edukimit për sjellje sociale janë më të mundshme dhe të mira. Sipas Zaplluzha (2016), gjetjet treguan se opinioni i mësimdhënësve në raportimin e faktorëve që ishin dhuna në familje dhe familja e çorganizuar shihen si shkaktarë të cilët ishin vlerësuar për të shpjeguar sjelljet e dhunshme e që këto gjetje janë në harmoni me të dhënat e punimit tonë.

Rezultatet e ofruara nga ky studim janë në përputhje me shumë hulumtime të tjera të zhvilluara në vende të ndryshme, përkundër disa të tjerëve që edhe nuk janë në përputhje me të dhënat e dala nga ato hulumtime. Rezultatet e hulumtimit tonë mund të jenë të një rëndësie të madhe mbi bazën shkencore ngase ato rezultate flasin për ndikimin e faktorëve familjarë mbi edukimin e fëmijëve dhe rëndësinë e familjes për sjellje sociale të fëmijëve. Studimet e kryera nga OBSH tregojnë mbi gjendjen reale nëpër vende të ndryshme të botës për dhunën dhe keqtrajtimin e fëmijëve në familje, e që një gjendje të tillë e tregojnë edhe të dhënat tona nga rajoni që kanë kryer shumë organizata në nivel regjioni mbi dhunën që ushtrohet ndaj fëmijëve. Studimi i OBSH-së mbi dhunën ndaj fëmijëve raporton statistika me vlera të larta të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve në botë.

Instituti Kombëtar i Drejtësisë në Shtetet e Bashkuara ka konstatuar se një fëmijë që është abuzuar në fëmijëri ka më shumë gjasa për 53% se një fëmijë normal të arrestohet si Hulumtimi i kryer nga Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të fëmijëve (2003), raportuan 11% e fëmijëve kishin pasur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin familjar; 4. Kjo tregon se në familje ende si mjet edukimi përdoren forma të dhunës fizike ndaj fëmijëve derisa vlerat e dala tregojnë sinjifikancën për këtë si faktorë i rëndësishëm. Sipas teorisë së dhunës në familje, familja shihet si një arenë ku sjellja e dhunshme mësohet dhe transmetohet nëpër breza, raste në të cilat ka cikle dhune brenda familjeve (INSTAT, 2013:61).

Sipas WHO (2001) është raportuar se 10-50% e grave raportuan se kanë përjetuar dhunë fizike nga partnerët e tyre e që këto gjetje përkojnë edhe me të dhënat në regjion siç është Raporti nga INSTAT ”Dhuna në familje në Shqipëri” (2013), ku gjetjet tregojnë se 57.7 e grave shqiptare kanë raportuar se janë dhunuar fizikisht dhe se në zonat rurale dhuna ishte më e theksuar. Nga hulumtimi Siguria në Shkolla (2007) i kryer në Prishtinë dolën të dhëna që janë në harmoni me gjetjet e punimit tonë po në të njëjtin qytet vetëm se

hulumtimi ynë është edhe krahasimtar rural-urban. Këto të dhëna të dala nga ky hulumtim tregojnë se faktorët familjarë dhe atmosfera ku fëmija edukohet mund të ndikoj në sjelljen e fëmijës e që shumë fëmijë që shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë janë të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi. Mbështetur në rezultatet e fituara nga analizat e zhvilluara mund ti japim përgjigje pyetjes sonë kërkimore se faktorët familjarë dhe familja ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek adoleshentët. Në literaturën e gjerë, gjejmë se edhe faktorët e tjerë tregojnë shanse për ndikim në sjelljet e nxënësve adoleshentë por që në fokus të temës sonë janë faktorët familjarë . Andaj rezultatet e hulumtimit tonë janë në harmoni me një mori studimesh të cekura më lartë ose edhe ato në nivel të vendit siç është Manuali për Parandalimin e Dukurive të dhunshme nga MASHT (2013), që tregojnë të dhëna se fëmijët që janë rritur si dëshmitarë të dhunës në familje kanë mundësi të bëhen adoleshentë të dhunshëm.

Nëse i referohemi edhe hulumtimeve të tjera në vend mbi faktorët familjarë dhe rëndësinë e tyre në ndikimin e sjelljeve të fëmijës në shkollë, po ashtu UNICEF (2007), raporton të dhëna të dala nga terreni se atmosfera në shtëpi, marrëdhëniet në mes të anëtarëve në familje, mbikëqyrja e dobët e fëmijëve, dënimet e rënda ndaj fëmijës, konfliktet në mes të prindërve në fëmijërinë e hershme, niveli i ulët i besueshmërisë në mes të fëmijës dhe prindit si dhe faktori socio-ekonomik u treguan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të fëmijëve. Nëse i referohemi studimeve të vendeve që na rrethojnë edhe ato flasin për një gjendje të përafërt të faktorëve familjarë dhe dhunës në familje, thënë më me detaje pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit në dy deri tri dekadat e fundit kanë kaluar nëpër situata politike të rënda duke përfshirë luftëra dhe tranzicione të shpejta e që të gjitha këto bëjnë që edhe shkalla e ekonomisë mund të mbetet e ulët e cila ndikon në krijimin e marrëdhënieve të shëndosha në familje ose edhe ulje të dhunës në përgjithësi në shoqëri. Zuna (2008), potencon se fëmijët kur të rriten modelojnë format e tyre të edukimit në fëmijëri, gjë që mund të bëhen abuzues në të ardhmen.

Sipas Zaplluzha (2016), gjetjet treguan se opinioni ishte i përbashkët midis nxënësve dhe mësimdhënësve në raportimin e faktorëve që ishin dhuna në familje dhe familja e çorganizuar që shihen si shkaktarë të cilët ishin vlerësuar për të shpjeguar sjelljet e dhunshme.

OBSH raporton në mesin e fëmijëve rreth një e treta e fëmijëve raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike, ku meshkujt kanë dy ose tre herë më shumë gjasa sesa femrat që kanë qenë të dhunshëm. Se a modelojnë fëmijët nga prindërit në përputhje me këtë është edhe hulumtimi në Amerikë (2000) e që tregon se adoleshentët priren të jenë depresiv nga imitimi i modeleve siç janë prindërit dhe

familja.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore raporton se meshkujt janë ata që ushtrojnë më shumë dhunë. Në kontekst ndërkombëtar dhe vendor jepen hipoteza dhe tregojnë shumë gjetje nga hulumtimet se gjinia mashkullore ushtron më shumë dhunë fizike nga gjinia femërore (Myers, 2003) Stela Karaj (2014) gjeti në hulumtimin e saj që doli me rezultate se djemtë përfshihen më shumë se vajzat në sjellje devijante në klasë.

Raporti nga KIPRED (2013), thekson se ka një tendencë më të madhe të ushtrimit të dhunës ndaj gjinisë mashkullore ku si rrjedhojë gjinia mashkullore janë tri herë më shumë objekti dhunës sesa gjinia femërore, ku i njëjti studim tregon se vajzat në këtë moshë për shkak të edukimit ende patriarkal në familje janë më të tërhequra dhe më të prirura për të respektuar rregullat dhe përgjegjësitë shkollore andaj ndaj tyre merren më pak veprime represive.

Sipas Giddens dallimet në mes të meshkujve dhe femrave për sa i përket dallimeve gjinore të përfshirë në rastet e dhunës, gjinia femërore është në shkallë më të vogël sesa gjinia mashkullore (Giddens, 2007:146).

"Studimet e Campbellit dhe të Carlenit tregojnë se dhuna nuk është ekskluzivisht karakteristikë e kriminalitetit të meshkujve, por që gratë janë shumë më pak të prirura se burrat për të marrë pjesë në krimin e dhunshëm."(Giddens 2007:148).Sipas Anika Ëoolfook (2011), shumë hulumtime tregojnë se qëndrimi gjatë në internet krijon mundësi për lojëra të dhunshme e që fëmijët edhe modelojnë apo frymëzohen emocionalisht për skena asociale dhe këto lojëra të dhunshme mund të rrisin shanset për shfaqje të sjelljeve të dhunshme.Po ashtu variablat e familjes duke përfshirë cilësinë e marrëdhënieve fëmijë-prind, aftësitë prindërore si dhe komunikimin e raportuan edhe gjetjet e dala nga studimi i kryer në Britaninë e Madhe, i cili është kryer me adoleshentë 10-16 vjeç, e që këto të dhëna rezultuan në adoleshencë të dhunshme ngase këta fëmijë kishin përjetuar dhunë në familje dhe 59% e tyre kishin kryer vepra të dhunshme më vonë.

Gjetjet tregojnë se në kulturën tonë ende përdoren format e ndëshkimit e kjo është në harmoni pothuajse me të gjitha hulumtimet sepse disiplinimi i fëmijëve bëhet në forma të ashpra e sipas Dorina Çorri (Kacollja, 2015), gjetjet e saj raportuan se 8.0% e të anketuarve kanë deklaruar se prindërit mendojnë që dhuna ka ndikim edukativ në edukimin e fëmijëve. Kurse se a është i rëndësishëm mënyra se si komunikojmë dhe prindërimi të dhënat nga ky hulumtim (Kacollja, 2015) tregojnë se 9.5% e të anketuarve përjetojnë dhunë në familje për shkak të mosbindjes së tyre nda prindërve.

Shkalla e lartë e papunësisë është shkaku kryesor që ndikon në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme të nxënësve në shkollë ,e që edhe statistikat në Kosove

dhe USAID (2007), raportojnë se dhuna në familje vjen nga faktori ekonomik që deklaron gjetjet Fondacioni i Iniciativës Qytetare.
Pothuajse të gjithë faktorët edhe të lart përshkruar që dolën nga hulumtimi kanë një përputhje të dhënash se fëmijët që abuzohen shihen si faktorë që edhe ata të bëhen të dhunshëm sepse ata modelojnë modele të sjelljes abuzive (Kosta, 2007).

5.Literatura

1. Dragoti, Edmond, (2005) *Adoleshenti*, Tiranë
2. MASHT"Strategjia për shkollat promovuese të shëndëtit në Kosovë"2009-2018
3. MASHT, (2014) *Doracak Për Parandalimin e Dukurive Negative në Shkolla të Mesme të Larta*, Prishtinë.
4. Myers, David.,G (2003) *Socialpsikologjia*, Eugen, Tiranë.
5. Karaj, Stela, (2014) *Konstruksionet sociologjike të sjelljes devijante të nxënësve në klasë dhe ndikimi i saj në stresin professional të mësuesve, Universiteti i Tiranës*, Tiranë.
6. Qendra Kosovare për Studime Gjinore, (2012) *Prania e dhunës në marrdhëniet e adoloshentëve*.
7. Salihu, Labinot, *Dokument Veprimi për dhunën dhe sigurinë në shkollat publike të Komunës së Prishtinës 2015-2018*,Usaid.
8. Tamo, Adem, (2007) *Këshillimi dhe Psikoterapia*, Pegi, Tiranë.
9. Tamo, A & Karaj, TH. (2005). *Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri.* Tirane: Qendra e zhvillimeve humane.
10. Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën (2013), Shqipëri.
11.Woolfolk,Anita,(2011)*Psikologjiedukimi*,QendrapërArsimDemokratik,Tiranë
12,Zaplluzha, Sh, (2016) *Viktimizimi i adoloshentëve dhe shkaqet e pasigurisë tek nxënësit e shkollave të mesme në Prizren sipas raportimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve-UET*, Tiranë.
13. Zuna, A. (2008). *Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike.* Prishtinë: "Libri shkollor". Prishtinë.

Dr. Etjona HOXHA

KUJTESË/TRADITA, SI ELEMENTE THELBËSORE E FORMËSUESE TË POETIKËS SË MARTIN CAMAJT

Në qoftë se në Librat e shenjtë shënohet "Në fillim ishte "Fjala"… (Bibla, Gjoni 1 "Fjala" identifikon Zotin), për Martin Camajn në fillim dhe në fund mbetet ***gjaku***. Dhe brenda gjakut-shpirt të Martin Camajt gjallon bota e pasur shqiptare.

Fëmijëria e kaluar në Dukagjin do të linte gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e Camajt. Për poetin do të rezultonte e pamundur mospërjetësimi në varg i gjithçkaje që tek ai "flinte" e që do të zgjohej dhe shndërrohej shumë shpejt në pjesë të kujtesës kolektive.

Poeti e fiksoi si *të pavdekshme* fëmijërinë e tij me një arsye të vetme, pasi bota shqiptare është e mbrujtur me gjendje, situata, dukuri e figura të cilat meritojnë "të marrin frymë" përjetë. E, në këtë rast, ky atribut i vishet tekstit letrar. Siç edhe vetë poeti ka theksuar në letërkëmbimet që ka patur, poezia e tij, mund të gjykohet dhe të vlerësohet në kontekstin shqiptar dhe jo jashtë tij.

Studiuesi Ymer Çiraku ka konstatuar se poezia e Martin Camajt ngrihet mbi tri kultura:

E para → Mendësia e shqiptarit të mirëfilltë, me traditat, kulturën, ndjeshmërinë që poeti i ka fituar përmes kontakteve me Temalin (vendlindjen) e tij.

E dyta → Mendësia e shqiptarit të distancuar, i cili që nga largësia, që nga izolimi i drejtuar mundohet të ndërtojë rreth vetes një vatër imagjinare e disi mjegullore, duke e përjetuar atë sa më reale.

E treta →Lidhja e tij me poezinë botërore e posaçërisht me atë bashkëkohore.[1]

Të gjitha këto frymëzuan dhe sendërtuan poetikën e Martin Camajt, poetikë e cila më së shumti do të shestohet mbi elementin *kujtesë*. *Kujtesa* në poezinë e Martin Camajt është konceptuar si element kreativ e, në këtë kontekst, ajo do të sjellë në krijimtarinë letrare të poetit, fëmijërinë e tij në Dukagjinin e bukur, burimin e pasur e gjenerues mitologjik, legjendat e dëgjuara qysh në vegjëli nga më të vjetrit etj. Do të shohim të gjallojë në vargun camaian një botë e pasur mitike në drithijet e së cilës do të hasim në kontrast me njëri-tjetrin një korb dhe një pëllumb, një gjarpër të gdhendur në një shkop "biblik" e një gjarpër mbrojtës të vatrës së mbushur me prush e hi të djegur; simbole të fuqishme etnike, si ai i lisit që lëshon një hije të rëndë mbi tokë, figura e ujkut, e bjeshkës, e

[1] Ymer Çiraku, *Bota poetike e Martin Camaj*, Albas, Tiranë 2003.

vërrinit. Kështu poeti ynë i jep jetë e njëkohshëm ndërton mrekullisht "arkaizmin estetik" apo thënë ndryshe "vjetërimin e tejskajshëm të kohës".

I ndikuar nga tradita folklorike, në pozinë e tij ai "rrëfen" për një botë qysh në gjenezën e saj, për një botë që s`vdes kurrë.

Martin Camaj e njeh shumë mirë traditën e shkrimit letrar shqip, zotëron po aq mirë gjithë format e poezisë së pasur gojore, me legjendat, gojëdhënat e botën mitike. I gjithë ky informacion ruhet i purifikuar në elementin *kujtesë* të Camajt. Gjithë shtresësimet kuptimore të mbartura në *kujtesën* e tij përcjellin tek receptuesi një lloj atmosfere estetike, ku kodi informativ përpunohet prej kodit estetik.

Por si formësohet ky kod estetik?

Në veprën e Martin Camajt kodi estetik përpunon burimin mitologjik (përfshirë këtu gjithë elementet folklorike që poeti ka huazuar nga poezia e traditës gojore), sipas parametrave bashkëkohore të prirjeve letrare të kohës. Poeti ynë ndihet i vetëdijshëm për traditën tonë letrare, me po të njëjtën forcë që ndihet i vetëdijshëm edhe për kërkesat letrare e cila po "ndillte" nje tjetër kohë. Në këtë pikë, ai do të dijë të orientohet nga ato shkolla apo tendenca të cilat ishin më afër "nuhatjes" së tij poetike.

Brenda këtij kuadri autori do të bëjë pjesë të poetikës së tij, krahas traditës së shkrimit letrar shqip, edhe larminë e formave moderne të kohës, që dukeshin të ishin mbizotëruese në periudhën e tij të shkrimeve. Flasim këtu për elemente dhe procedime poetike, të tilla që ndeshen dendur në poezinë hermetike italiane dhe në vargun symbolist francez. Vargu i Martin Camajt do të marë jetë dhe do të zhvillonte identitetin e vet kulturor mes traditës gojore, letërsisë së kultivuar shqiptare dhe poezisë bashkëkohore moderne evropiane.

POETIKA E CAMAJT

TRADITË

Canaj merr nga tradita shprehjen poetike të poezisë popullore, elemente dhe figura mitike, sekuenca narrative të gojëdhënave dhe legjendave.

Njeh autorët dhe veprat e letërsisë së kultivuar shqiptare që tek ai vijnë në formën e "remineshencës" vetem pa elementin "harresë"

RISI

Përqendrimi i vështrimit në kode tematike të veçanta (çështje të ekzistencës dhe qenësisë së individit të cilin e shohim të endet i vetmuar përgjate rrugëtimit mes jetës dhe vdekjes). Nga ana formale shkatërrohet vargu tradicional për të ndërtuar një të ri, sintetik, të ekonomizuar. Procedimi analogjik, prurja e elementeve mitik fitojnë "territor" të konsiderueshëm në procedimet e tij poetike.

MODERNIA CAMAIANE

2. *Përgjatë një tipologjie tematike.*

Le të përpiqemi që përgjatë këtij "vështrimi" kritik modest, fjala "hero" të jetë përjashtuese. E në këtë kontekst ta lexojmë ***veprën-jetë*** të Camajt pa heronj, por me një protagonist të vetëm, *njeriun*.

Është pranuar tashmë që periudha e parë e krijimtarisë letrare të Martin Camajt përfshin, një periudhë kohore prej vitit 1953 dhe shkon deri në fund të vitit 1960.

Përgjatë kësaj periudhe panë dritën e botimit për herë të parë në Kosovë përmbledhjet e para poetike të Camajt, si "Kânga e Vërrinit" dhe "Një fyell ndër male". Kryesisht boshti tematik dhe motivor i këtyre botimeve do të orientohet kah temave që lidhen me dheun e tij të lindjes dhe çasteve të jetuara atje, momente që poetit shqiptar nuk do t`i fshiheshin kurrë nga kujtesa. Disa nga motivet më të spikatura të fillimit të kësaj periudhe janë: jeta në katund, në Dukagjin, personazhi i bujkut, bariut, hapësira gjeografike brenda Malësisë (mali, kroi, katundi).[2]

Në këto botime Camaj ndihet të jetë tejet i lidhur me poezinë e traditës, përfshi këtu dhe traditën folklorike shqiptare. Vargu i lirë i përdorur prej tij vjen si një risi në poezinë e Camajt, i cili alternohet shumë bukur me vargun e mirëstrukturuar të traditës. Janë dy vëllime poetike në të cilat mbipeshon elementi modern i poezisë së traditës, por në të njëjtën kohë këto vargje marrin, trajtën e fillesës së gjithçkaje, që Martin Camaj nuhaste që do të vinte më pas. Gjatë një letërkëmbimi me Kudret Velçën ai do të shprehej: "Deri në 1967 kam qenë në kërkesë të stilit tim definitiv. Kjo periudhë ishte e lidhun mjaft me traditën".
Dhe me të vërtetë, një erë e re ndryshimesh do të vinte shumë shpejt. Nga vëllimet poetike ku mbizotëronte në mënyrë të veçantë vargu me karakter të theksuar narrativ e stil tregimtar, përshkrues do të vijnë botimet e vëllimeve poetike "Legjenda" dhe "Lirika mes dy moteve". Tek "Legjenda" tematika në mënyrë të veçantë do të merret ***nga bota e madhe intriguese mitike***. Kështu elemente të tilla mitike e simbole si *lumi* (në mënyrë të veçantë poeti thekson Drinin)*, zjarri, vatra, fyelli, korbi*, gjallërojnë vargun e Camajt duke qënë në sinkroni të plotë me njëri-tjetrin gjithë kohën. Legjenda e gojëdhanat popullore shqiptare do të kthehen në simbole e metafora të një rëndësie të veçantë për receptimin e vërtetë të këtyre vargjeve.

Përmendim tituj të tillë si "Mjellma e Nusja", "Burri e lumi", "Vrasja e vetmitarit", "Grueja e Skanderbegu", "Vada", "Hija e Gjergj Kastriotit" titujt e të cilave më së shumti vijnë në formën e klisheve të traditës sonë gojore popullore. Këto modele i shërbejnë poetit për të kaluar nga konkretja tek abstraktja, nga tradita tek modernia duke sendërtuar kështu një botë poetike universale.

[2] Ymer Çiraku, *Bota poetike e Martin Camaj*, Albas, Tiranë 2003.

Rruga e gjatë e konsolidimit të një poezie me prirje të theksuar moderne sapo kishte nisur. Përmbledhja "Lirika mes dy moteve" është një vëllim intrigues qysh në titulli e saj. Elementi mitik dhe motivet që lidhen me vendlindjen fitojnë karakter universal. "Arkaizmi estetik", si tipar i poezisë së Camajt, vihet në funksion të ndërtimit të shumëkohësisë duke i veshur shtresës kuptimore të vargut tiparin modern. P.sh:"Tingujt e parë", "Zanat apo orët", "Dashnorët e malit" etj.
Tema qëndrore në këto vargje është tema e qenësisë, e ekzistencës së individit me *pse-të* ekzistenciale mbi krye përgjatë rrugëtimit jetësor të tij mes jetës, vetmisë dhe ankthit prej vdekjes. Duke mos i dhënë një trajtë, e formë konkrete këtij individi, receptuesi arrin të konturojë gjithë botën panoramike të gjithëkohësisë. Motivi i vetmisë dhe frika prej mëkatit ciklik primordial mund të vërehen lehtësisht në ilustrimin e mëposhtëm.

Ndërkaq përgjatë këtij rrugëtimi jo-të paqtë "subjekti letrar" camaian, ndien trysninë dhe frymën rrënqethëse e mistike të vdekjes, tek "Pesha ndoshta dhe vdekja". **Ai** ndihet i lodhur…

Por hera-herës ndihet edhe një frymë optimizmi, e shprehur kjo e fundit konkretisht në ndonjë nga poezitë e tij, përmendim "Stina e re në luginë". Duke qëndruar më tepër tek një motiv, që në këtë vëllim merr përmasa të konsiderueshme, siç është motivi erotik, ai i dashurisë. Shohim të gëlojë mes traditës dhe risisë sendërtimi modern i këtij motivi, prurje e Martin Camajt në poezinë shqipe.

Të gjitha poezitë, që mbartin këtë motiv duken të jenë organizuar nga një varg i thjeshtë për t`u receptuar, vërehet gjithashtu një organizimin tradicional i vargut, të rimuar e të strukturuar. Në këtë mënyrë shtresa kuptimore dhe mesazhi përcillen lehtësisht për tek lexuesi: "Deshta nji vajzë", "Kanga në mjesdite", "Zadja te kroni".

Sado që kjo poezi, përgjithësisht vjen e lehtë në perceptim, ajo është e konceptuar brenda një "liste" elementesh simbolikë e mitikë, të cilat fitojnë konkretësi, të parë brenda kontekstit shqiptar.

Të bën përshtypje përdorimi i kontrastit, ndërtuar mbi bazën e të kundërtave në varg. Poeti synon të pasqyrojë përmes këtyre binomëve antonimikë, ekzistencën e të kundërtave të përhershme në jetë, të vogla a të mëdha qofshin, të parëndësishme e të rëndësishme. Mund të përmendim elemente të tilla si: bora/zjarri; bora/dielli; korbi/pëllumbi; flutura e bardhë/lule e zezë etj.

Gjithë poezitë e këtij vëllimi janë aq afër traditës, shpesh po aq edhe larg saj (duke iu referuar organizimit strukturor). Shohim të mbipeshojnë, më së shumti, elemente strukturore moderne.
Vargjet dhe strofat në përgjithësi janë të kursyera. Përmendim "Mes shëngjergjave",

“Anza”, “Fleta e gjethit”.

Madje qëllimshmëria e përdorimit të elementeve të marrë nga mitologjia dhe ngritja e tyre në nivel abstragues konsiston në universalizmin e shtresës kuptimore të vargut duke kaluar kështu nga konkretja tek e përgjithshmja. Evidentimi i tipareve të tilla, përforcon idenë se poezia e Martin Camajt, po orientohej dhe konsolidohej përfundimisht, kah modernitetit.

Poetika e Martin Camajt është konceptuar si një ndërthurje e elementeve të letërsisë sonë gojore dhe asaj të traditës; e, më konkretisht, Camaj merr shprehjen poetike të poezisë popullore, elemente dhe figura mitike, sekuenca narrative të gojëdhënave dhe legjendave, njeh autorët dhe veprat e letërsisë së kultivuar shqiptare, të cilat vijnë tek ai në formën e *remineshencës*, vetëm pa elementin *harresë*. Këta elemente Camaj i ndërthurr me tipare krejt të reja e gati të panjohura në letërsinë shqiptare. Konkretisht, ai e përqëndron vështrimin në kode tematike të veçanta (çështje të ekzistencës dhe qenësisë së individit).

Nga ana formale ai shkatërron vargun tradicional për të ndërtuar një të ri, sintetik, të ekonomizuar. Procedimi analogjik, prurja e elementeve mitike fitojnë “territor” të konsiderueshëm në procedimet e tij poetike. Alternimi i këtyre tipareve sjell konceptimin dhe sendërtimin e një poetike krejtësisht të veçantë e të re për letërsinë shqiptare.

Boshti tematik e motivor i përmbledhjeve të Martin Camajt orientohet kah temave që lidhen me dheun e tij të lindjes dhe çasteve të jetuara atje, momente që poetit shqiptar nuk do t`i fshiheshin kurrë nga kujtesa.

Temë e rëndësishme evargjeve të tij mbetet tema e qenësisë, e ekzistencës së individit me *pse-të* ekzistenciale mbi krye përgjatë rrugëtimit jetësor të tij mes jetës, vetmisë dhe ankthit prej vdekjes. *Njeriu* përbën temën themelore në këto vargje, të cilin, ngado e kurdoherë, e shohim të ravgojë brenda një qarku ciklik përditshmërie e përjetësie njëkohësisht.

Ph.D. Oltsen GRIPSHI

NATYRA PËRMES SOCIALIZMIT REAL TË ZEF SHOSHIT

Nature through the real socialism os Zef Shoshi

Abstract

The creation of the artist, Shoshi, it was really conceived and grew under the influence of the painting of Socialist Realism, but that is worth only for that time. In the painting of landscape is difficult to make distinctive differences between the first and second period of the painter. The way this artist has treated the nature even during the influence of the ideology of the time, highlights dexterity and impressive strokes invoices. The nature of the landscape treated after the 90s remains always realistic for its content, but is expressed with a rich color through a variety of shades of color and with a penetrating timbre light that can capture the air, the atmosphere and the colors of the canvas the moment he feels in nature.

All this is summed up in the synthesis of Zef Shoshi's painting. A synthesis as a conclusion of a natural passage within itself in search of mastery, within a journey that led to progress and an identifiable artistic maturity.

Research Methods: Comparative Analysis.

***Key words**: Analysis, comparisons, aesthetics, visual communication, landscape, painting.*

"...Në rrënjët e frymëzimeve të tij më të thella është fakti folklorik, i cili sjell traditën e pikturës Bizantine për nga linjat dhe për nga karakteristika thelbësore e dypërmasores në paraqitjen e saj. Marrëdhënia mes Shoshit dhe historisë (historia e artit në plan të parë, por edhe historia e kulturës dhe e qytetërimit) në një vend të veçuar sikurse është Shqipëria nga rrymat e shumta të artit perëndimor, bëhet më vonë një mënyrë për të dalë nga vetvetja, por gjithësesi

pa e tradhëtuar atë..." apo *"Ai është plotësisht i ndërgjegjshëm, kjo gjë është mbase elementi thelbësorë i poetikës së tij, që në kuptimin e artit do të thotë diçka më shujmë se riprodhimi i realitetit, d.m.th që transmeton tek ai që sheh veprën e artit një mesazh, që ndryshe nga të gjithë komunikimet është i një natyre krejtësisht emocionale"* B. Rosada1.

Mbështetur në këto dy fraza të shkruara nga filologu italian Bruno Rosada mbi pikturën e artistit Zef Shoshi, natyrshëm krijimtaria e këtij piktori shndrinë nuanca kuptimplota brenda llojit. Brenda një kohe dhe fryme të caktuar në historiografinë e artit pamor shqiptar. Nuanca brenda llojit! Po, nuanca të cilat piktorit Zef Shoshi i japin shkëlqimin e veçantë për ta evidentuar në mesin e gjithë atyre piktorëve që kultivuan pikturën e tyre gjatë periudhës së Realizmit Socialist në Shqipëri. Realizmit Socialist jo vetëm si përjetim pikërisht social-politik, por dhe si ndjesi në paraqitjen estetike dhe përmbajtësore në krijimtarinë e tij [...].

Ashtu si në krijimatrinë e piktorit Foto Stamo edhe në pikturën e Zef Shoshit gjurmët e ndikimit të artit totalitar ndjehen dhe janë lehtësisht të prekshme, ndonëse piktori Shoshi ka tentuar që në pikturën e tij të krijojë një alkimi disi të veçantë mes asaj çfarë ai ndjenë (botës së tij të brendshme) dhe asaj çfarë ai sheh (realiteti si një ekzistencë të pandrushueshme)... dhe kjo vendos në lëvizje një proces të ndërlikuar, aq sa përmes një litri të padukshëm përthithen dhe përcillen energji të mëdha plot elektricitet! Proces i ndërlikuar, sepse piktori Shoshi frymëzimin e ushqen, duke vëzhguar natyrën, hapi i parë i këtij procesi. Përpunohet nëpërmjet perceptimit në brendësi të shqisave të tij, ja ku u hodh edhe hapi dytë, si dhe nxjerrja përsëri jasht e gjithçkaje, por këtë herë të veshur me ndjenjat dhe nën mantelin poetik plot ngjyra të artistit si hapi i tretë përmbyllës të këtij procesi të ndërlikuar. Një përjetim individual gati-gati i ndërlikuar, sepse të tria hapat ku artisti fillimisht tundohet, më pas joshet në ekstazë* aq sa gjithçka syri i tij percepton dhe filtron imazhe të ndryshme për t'i përpunuar në përkthimin e tyre në një realitet tjetër, realitetin e artistit.., por për ta përmbyllur të gjithë këtë përjetim, sigurisht që atij i nevoitet një diçka. Një diçka, e cila shpirtëzon hapin e parë dhe të dytë ku bashkë me hapin e tretë dhe të fundit mishërojnë pikërisht një postulat* të përligjur nga ndjenjat dhe emocionet, që artisti arrinë të konkretizojë në atë çfarë ne shohim dhe ndjenjmë nëpërmjet imazhit përfundimtar, i cili kodifikon qenien e vetë artistit.

---

[1] Zeqo, M. *Arti i Zef Shoshit,* Delta Print, Tiranë, 2010, f. 9.

* *Ekstazë* – Një fjalë që rrjedh nga greqishtja e lashtë *έκσταση*[grc]-*ex-stasis*-të qenurit jasht, duke iu referuar një gjendjeje të caktuar psikologjike me një lartësim mistik, hyjnor të mendjes, e cila është e perceptueshme si diçka e jashtme, e shkëputur nga trupi i njeriut pikërisht për këtë arsye vjen edhe etimologjia e kuptimit nga fjala greke... pra, tregon një gjendje nga ku njeriu "del jashtë vetes". Në antikitet një gjendje e tillë mendore ishte e konsideruar si menifestimi hyjnor tek njeriu... ndërsa në filozofinë moderne të 1800-s për të kuptuar ekstazën si gjendje na ndihmojnë si vepra *Kritik der Urteilskraft*[de] (Kritika e Gjykimit) e Immanuel Kant-it, si idealizmi i Johann Gottlieb Fichte-tit dhe Friedrich Schelling-ut. Kant ekstazën e lidh me gjykimin estetik me ndjenjën universale të Absolutes ku arsyeja nuk është më e penguar nga aktiviteti i njohjes, por e lirë në formimin e lidhjeve të veta jashtë dhe përtej trupit. Kurse për Fichte dhe Schelling me intuitën intelektuale tek ekstaza shihnin një aktivitet të pafund me të cilën Zoti krijon botën... ku njeriu mund të ri-jetojë nëpërmjet ekstazës artistike (e cila është manifestimi më i prekshëm i Absolutes), një manifestim ku aspekti aktiv dhe pasiv, vetëdija dhe pavetëdija e mendjes nuk janë më në konflikt mes tyre, por shkrihen në një sintezë harmonike të bashkësisë kozmike me Natyrën.

Për artistin Shoshi në këndvështrimin logjik *"arti është një mimesis*, jo thjeshtë në kuptimin Aristotelian, jo thjeshtë pasqyrim, por një krijim i realitetit për ta plotësuar dhe rivalizuar realitetin, për të bërë një kujtesë të re pamore të ngjarjeve, figurave dhe natyrës që përbënin një kujtesë fillestare"*2. Fillestare si vetë qenia njerëzore e sapo fomësuar, e cila në kapërcimin e shekujve u shoqërua nga artet, piktura si alfabeti me të cilën njeriu komunikoi ndjenjat e tij [...].

Mimesis si mënyra për të paraqitur realitetin e realitetit, një realiteti, që sipas Aristotelit origjinën e kishte në konceptimin platonik, i cili mbështetej në doktrinën e Pitagorës. Doktrinë, e cila i konsideronte ndjenjat e qenies njerëzore aq të ndjeshme saqë përngjanin si kopje të cilat riprodhonin me shumë besnikëri dhe vërtetësi numrat e përjetshëm (*numerus aeternus*[la]*)3. Në të vërtetë Platoni në teoritë e tij mbi *mimesis* preferon më shume të flasë për *metessi** pjesëmarrjen në brendësi të gjërave dhe ideve, duke dashur kështu të deklamojë pricipin e racionales në ndërtimin hyjnor të botës…

Platoni *mimesis-in* e shpjegon nëpërmjet një shembulli të thjesht kur thotë sesa tipologji *mimesis* kemi nëse i referohemi për shembull idesë së natyrës, e cila është realiteti i vërtetë objektiv; natyra e ndërtuar nga Zoti, që e modelon atë në mbi themelet e një modeli ideal dhe si përfundim natyra se si e pikturon piktori nëpërmjet perceptimit të tij imagjinar. Proces ky që përfshinë në vetvete tri hapa: një Zot, që ndërton idenë-natyrë, një Zot Demiurg*, i cili si një artizan prodhon gjënë natyrë mbi modelin e idesë dhe në fund një piktor-interpretues

në rastin konkret si piktori Zef Shoshi, i cili bënë pikërisht atë, interpretimin pa iu referuar në mënyrë imituese idesë-natyrë. Natyra si model i ndërtuar nga "Zoti", por natyra si një këndvështrim personal, si një perceptim kulturor apo si një përjetim emocionesh dhe ndjenjash.

Peizazhet e Zef Shoshit apo piktura e tij në tërësi duket sikur gjejnë përshtatshmëri simetrike tek *mimesis*-i artistik në librin II dhe III të veprës *"Republika"* të Platonit, sepse ai shkruan se artizani duhet të imitoi objekte që ndodhen në natyrë, filozofët duhet të angazhohen për një mirëqenie të gjendjes psiko-shpirtërore, ndërsa piktori dhe skulptori nuk prodhojnë objekte të nevojshme për jetesën, por thjesht ata materializojnë ndjenjën dhe si të atillë kthehen në edukatorë të së bukurës për njerëzimin.

---

[2] Zeqo, M. *Arti i Zef Shoshit*, Delta Print, Tiranë, 2010, f. 6.

[3] Peretto, L. *San Tommaso d'Aquino: Commento alla Metafisica di Aristotele e testo integrale di Aristotele,* vëll. I, libri 1-4, Edizioni Studio Domenicano, Bologna, 2004, f. 293.

* *Mimesis* – Ky term rrjedh nga greqishtja e lashtë *μίμησις*[grc]-imitim, riprodhim. Për latinët përdorimi i këtij termi kishte të bënte me *"Comoedia est imitatio vitae, speculum consuetudinis, imago veritatis"* (Komedia është imitimi i jetës, pasqyra ekostumeve dhe imazhi i realitetit). Në shekullin e XX disa nga autorët më në zë kanë shkruar vepra të rëndësishme mbi principet e imitimit si: Erich Auerbach me veprën e tij botuar në vitin 1946 në gjuhën gjermane të emërtuar *"Mimesis: eine Geschichte des abendländischen Realismus, als Ausdruck der Wandlungen der Selbstanschauung der Menschen"*[de] (Historia e realizmit perëndimorë, si shprehi e ndryshimeve e perceptimit të realitetit nga ana e njerëzve), Rudolf Arnheim, Nelson Goodman dhe Ernst Gombrich me veprat e tyre mbi *mimesis* në artet figurative.

* *Numerus aeternus [la]* – Shën Toma i Akuinos (San Tommaso d'Aquino) në kreun XXXII dhe XXXIV të verpës së tij të shkruar rreth viteve 1258-1264 në gjuhën latine të emërtuar *"Liber de Veritate Catholicae Fidei contra errores infidelium"*[la] (Libri i së vërtetës të besimtarëve katolikë kundër gabimeve të pafeve), thekson se numrat e përjetshëm janë të lidhur ngushtë me arsyen e të gjithë atyre që mbështesin përjetësinë e botës, duke nisur nga Zoti si shkaku i vetëm në krijimin e krijesave. Sepse krijesat janë të përjetshme, duke parë që ata kanë një marrëdhënie të drejpërdrejt me Zotin dhe të pavarura nga koha dhe ndryshimet në imitimin e tyre.

* *Metessi* – Ky term rrjedh nga greqishtja e lashtë *μέθεξις*[grc]-*metheksis*-

pjesëmarrje, komunikim, që rëndësinë e vërtetë filozofike e përfton në mendësinë platonike. Problemi i *metessi* është i lidhur historikisht me Akademinë e Aristotelit, gjatë viteve të fundit të pjekurisë së Platonit. Pyetja që shtronte gjithmonë Aristoteli ishte: nëse bota e ideve dhe ajo empirike kundërshtojnë – të qenurit dhe mos të qenurit – çfarë kuptimi ka të ngreshë idenë si shkak i realitetit në dukje? Nuk do të ishte më koherent përfundimi që ekziston vetëm bota e ideve, duke e përmbyllur botën e gjërave në një iluzion? Pra, në një mënyrë *metessi* deklamon pricipin e racionales në ndërtimin hyjnor të botës…

* *Demiurg* – Është një figurë filozofike dhe në njëkohësisht mitologjike. Në aspektin figurativ demiurgu, i cili rrjedh nga greqishtja e lashtë me bashkimin e dy fjalëve *δήμιος*[grc]-*demios*-i popullit dhe *ἔργον*[grc]-*ergon*-punëtor = *δημιουργός*[grc]-*demiurgos*-punëtor publik apo artizan (krijues) është një qenie hyjnore i prirur dhe i aftë për të krijuar gjithçka. Një figurë, e cila për herë të parë u përshkrua nga Platoni në veprën e tij *Τίμαιος*[grc] *"Timeo"* të shkruar në gjuhën greke të lashtë rreth vitit 360 p.e.s.

Në këtë mbarështim të mprehtësisë filozofike të Platonit, përballë tyre shtrohet problemi nëse mund t'i konsiderojmë si pjesë të gjendjes Ideale të të krijuarit?!

Po, sepse kur shoh me kujdes mënyrën se si Shoshi e portretizon natyrën, filloj të kuptoj të gjithë këtë fill psiko-filozofik të Platonit. Zef Shoshi vizaton, hedh masat e mëdha të ngjyrave dhe modelon natyrën me një gjuhë sa realiste aq dhe interpretuese vetjake. Një gjuhe të brendshme si rrjedhojë pikërisht të materializimit të ndjenjave të tij sikurse e pohon edhe Platoni. Pra, një pikturë, e cila pavarësisht e kultivuar dhe rritur nën trysninë e një sistemi, si ai komunist në Shqipëri, mbeti gjithmonë në kërkim të së vërtetës. Të vërtetës së ndjenjës në pasqyrimin e të vërtetës së brendshme, e të vërtetës si ndjenjë, duke i dhënë jetë asaj nëpërmjet ngjyrës dhe stilizimit. Të gjitha këto elementë të gërshetuar bashkë nxjerrin në pah vlerën e vlerësimit metafizik dhe njoseologjik që Shoshi i bënë natyrës në peizazhet dhe subjektet e tjera që krijon. Fakt ky, i cili e shpurdh ndërgjegjen e vetë artistit në ekstremin hollësive dhe skrupolozitetin në interpretimin e reales ideale (të asaj çfarë ai ndjenë) sesa reales fizike (të pranishme tek vetë natyra si gjendje shumë dimensionale) [...].

Për t'iu përgjigjur Platonit, Aristoteli e mendon disi ndryshem. Ai nuk bashkohet me gjykimin e kushtëzuar platonik të imitimit, por e vlerëson piktorin si identitet dhe imitimin e koncepton si një teknikë (nga greqishtja e lashtë *τέχνη*[grc]-*tekne*), duke e zbërthyer konceptin "art" në kuptimin e "teknikës", "aftësisë" dhe "dijes për të bërë", e cila sado që frymëzohet apo nxitet nga diçka reale (në rastin konkret nga natyra për piktorin Zef Shoshi), gjithësesi ajo në paraqitjen përfundimtare buron dhe ka shpirtin e artistit krijues. Sipas Aristotelit imitimi ka

tri nivele të ndryshme se si ne mund t'i perceptojmë: 1. O i imitojmë gjërat ashtu siç janë, 2. O i imitojmë ashtu siç kanë të ngjarë të jenë dhe 3. O i imitojmë siç duhet të jenë4.

Të tria këto nivele të ndryshme perceptimi ndaj *mimessi*-t janë në këndvështrimin tim pjesë përbërëse organike në peizazhin e piktorit Zef Shoshi. Jo më kot tentova pak më sipër të sjell në një dialektikë krahasuese nocione, konceptime dhe perceptime mes dy boshteve universale të filozofisë dhe krijimtarisë estetiko-stilistike të artistit Shoshi. Dialektikë krahasuese, e cila hulumton në zanafillë dhe më ndihmon se si mund ta lexoj veprën e këtij artisti. Zef Shoshi në të vërtetë duhet theksuar që në krijimtarinë e tij artistike ka trajtuar gjerësisht gjininë e portretit dhe të kompozimit, por tek peizazhi duket qart sipas analizës time, zhvlerësimi që ai i bëri tërësisht diktimeve dhe trysnisë së ideologjisë së regjimit komunist (periudhë kjo ku dhe është shtrirë një pjesë e konsiderueshme e krijimtarisë së tij) nëpërmjet të ashtuquajturën *"Kritikës së Gjykimit" (Kritik der Urteilskraft*[de]**)*5.

Kritikë ku koncepti i *mimessi*-t në "artin e bukur" apo në "bukurinë e artit" nuk ka rregulla dhe si i atillë piktori Shoshi, në një gërshetim mes sintezës së imagjinatës dhe intelektit prej artisti, i cili pikërisht këtë sintezë të imagjinatës e ushtron nëpërmjet teknikës (pra, ashtu siç na e shpjegojë edhe Aristoteli më sipër), arrinë të pikturojë as më pak dhe as më shumë atë, spontanen dhe rregullat e pashkruara, për të cilën ky artist mbart një lirizëm krijues absolut. Forca spontane dhe rregullat e pashkruara, që vendosin në lëvizje ndjenjat ku intelekti është i pranishëm në çdo penelatë, por jo më si kufizim racional siç ndodh në fushën e njohjes, sesa si aftësi për të pikturuar e realizuar peizazhin natyrshëm sipas shijeve dhe perceptimeve të tija estetike.

---

[4] Paduano, G. *Aristotele: Poetica,* Laterza, Bari, 1998, f. 44.

[5] Pareyson, L. *Estetica dell'idealismo tedesco: Kant e Schiller*, Ugo Mursia Editore srl, Milano, 2005, f. 201.

***** *Kritik der Urteilskraft [de] – "Kritika e Gjykimit"* është një vepër e shkruar në gjuhën gjermane dhe botuar në vitin 1790 nga filozofi iluminist gjerman Immanuel Kant. Filozofi në brendësi të kësaj vepre trajton një analizë kritike mbi gjykimin estetik, i cili parapriu temave dhe ideve të Romanticizmit dhe Idealizmit evropian të shekullit XVIII.

Ciceroni në përballje me *mimessi*-n shprehesh kështu në verpën e tij *De re publica*[la] se:
[la]

"Comoedia est imitatio vitae, speculum consuetudinis, imago veritatis."
[sq]
"Komedia është imitimi i jetës, pasqyra e kostumeve dhe imazhi i realitetit."

– Në ecuri të kësaj idee zhvillohet e gjithë veprimtaria artistike e piktorit. Veprimtari, e cila *de facto*[la] ndahet në dy periudha ajo e pikturës së kultivuar gjatë regjimit totalitar, e cila la gjurmë të prekshme dhe pashmangshme në krijimtarinë e tij, si dhe periudha e dytë ajo pas vitit 1990 ku piktura e tij u pasurua në koloritin e plot dhe hapjen drejt horizonteve të reja [...].
Le ta nisim duke u kthyer disi prapa në kohë. Në kohën kur piktori Zef Shoshi ishte i përqendruar (padyshim nën ndikimin e frymës së pikturës së Realizmit Socialist) në trajtimin e temave ku në qendër ishte "Njeriu i Ri". Fshataret kooperativiste do të karakterizonin personalitetin e tij artistik në këtë periudhë6.

Mbi të gjitha prania e gruas kooperativiste, e fortë, punëtore dhe e palodhur do t'i vishnin veprave të piktorit Shoshi nuancat e optimizmit, si për të dëshmuar ndjenjë e ngazëllimit ndaj jetës së re që kishte nisur shoqërinë shqiptare. Karakteristika këto të cilat përshtateshin më së miri me psikologjinë sociale jo vetëm të gruas shqiptare, por edhe të burrave, që sipas propagandës ideologjike Marksiste-Leniniste ato ndjeheshin të lumtur e të lirë.

Zef Shoshi ishte ndër artistët e parë, i cili e trajtojë si një *corpus*[la] të plotë mendësinë ideologjike të regjimit të Partisë së Punës ku temat e reja të huazuara nga "fshati socialist" dhe pasqyrimi i "industrializimit" të Shqipërisë ishin boshti krijues në veprat e tij. Një identitet artistik ku subjektet e pikturuara përçohen tek publiku me një gjuhë të thjeshtëzuar dekorative me ngjyra të pastra. Përqëndrimi i piktorit Shoshi në paraqitjen e këtyre temave shpesh herë vijnë si realiste dhe herë vijnë si imagjinare (të shkëputura nga konteksti realo-historiko-antropologjik), duke i bërë që në brendësi të tyre të ndjehet një llojë realitetit empirik *horror vacui*[la]. Një realitet empirik që për latinët me shprehjen *natura abhorret a vacuo*[la] (natyra shmang boshllëkun), i ka rrënjët në teorinë filozofike të Aristotelit7.

Gjithësesi edhe gjatë periudhës së Realizmit Socialist, në krijimtarinë e Zef Shoshit nuk mungojnë peizazhet të cilat në vështrimin tim mbeten si dritaret e vetme nga ku ai arrinë të marrë frymë lirshëm. Peizazhi ***"Himara e vjetër, gjiri i Spilesë"***, **bojë vaji mbi kanavacë**, **1970**, **27 x 20 cm**, **Koleksion privat**, **Vlorë**, **Shqipëri (fig. 1)** është një tablo ku evidentohet më së miri mjetëria e këtij artisti.

E gjithë vepra është e pikturuar me shumë finesë dhe atmosferë mbresëlënëse. Artisti në këtë tablo ka përdorur prerjen kompozicionale në horizontale, element që e ka ndihmuar atë të prarqesë një kënd shikimi sa më të gjerë. Vepra, sikurse e tregon edhe emërtimi është e realizuar në gjirin e Spilesë në fshatin e Himarës. Piktori Shoshi nëpërmjet këtij peizazhi ngjanë si të këtë "mbërthyer" në befasi ndriçimin e hënës, i cili shkëlqen magjishëm mbi sipërfaqen e valëzuar të detit ngjyrë blu të shuar prag muzgu. E gjithë pamja është e përfshirë nën ethet e misterit, të një vetmie buzëdetit melankolik. Kompozimi përpos prerjes në horizontale, në brendësi është i ndërtuar në tri plane njëra mbi tjetrën ku në planin e parë theksohet më shumë dhe me hollësi larmia tonale e ngjyrës jeshile të përzier diku me okër e diku me kafe dhe modelimi me shumë plastikë në diferencimin e vëllimeve.

---

[6] Kuqali, A. *Historia e artit shqiptar II,* Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1988, f. 148-149.

[7] Cartesio, R. *Meditazioni metafisiche*, Armando Editore, Roma, 2003, f. 24.

Plani i parë barazpeshon harmonishëm të gjithë peizazhin, që zhvillohet në horizont. Sepse nëse në planin e dytë ku është i pikturuar i qetë e i fjetur deti dhe në planin e tretë përballë është e pikturuar kodra e Himarës nën tonalitet e një bluje të ftohtë, të sheshtë pa shumë thyerje vëllimesh, gati-gati e lënë patrazuar, duke u shkrirë paqësisht larg në horizontin ngjyrë hiri mat. Në planin e parë sado që piktori Shoshi e mbanë mjeshtërisht brenda simbiozës së përgjithshme tonale, gjithësesi në të ndjehet dhe perceptohen më mirë format në vizatimin e rivierës ranore në grih të ngrohtë, shkurreve tipike mesdhetare që trupëzohen në njësh me rërën, vëllimet e pemës në të djathtë të tablos me variacione të larmishme të së gjelbërtës, si dhe cepi i një shtëpie bashkë me avllinë e saj, që thyejnë monotoninë e pamjes, duke e pasuruar ende më tepër peizazhin në tërësi.

Gjendja e krijuar në përçimin me vërtetësi të një çasti nga ana e piktorit, të ndjell brenda vetes një llojë përhumbjeje në prag të mistikes. Përhumbje, e cila ngjall meditim, nxit lirinë e subkoshiencës dhe sjell në mendje ekzotizmin e peizazheve të piktorit francez Henri Rousseau.

Peizazhe të tjera të cilat i përkasin krijimtarisë së këtij artisti në periudhën e pikturës së Realizmit Socialist janë edhe ***"Diga e Fierzës"***, **bojë vaji mbi karton**, **1979**, **43 x 46 cm**, **Koleksioni i Familjes Shoshi**, **Tiranë**, **Shqipëri (fig. 2)**, ***"Hidrocentrali i Fierzës"***, **bojë vaji mbi karton**, **1979**, **46 x 63 cm**, **nr. Inv. 2553, Galeria Kombëtare e Arteve**, **Tiranë**, **Shqipëri (fig. 3)** dhe ***"Peizazh industrial"***, **bojë vaji mbi karton**, **1973**, **20 x 27 cm**, **Collezione Carlo Gribaudo**, **Torino**, **Itali (fig. 4)**. Punime ku vërehet

ndikimi dhe fryma e vetë mënyrës të të pikturuarit nën mbikëqyrjen e udhëzimeve të kohës. Udhëzime të cilat kërkonin me nguk nxjerrjen në pah të veprimtarisë së partisë, e cila ndërtonte veprat e para industriale për rimëkëmbjen e Shqipërisë socialiste. Në të tria peizazhet në qendër të kompozimit është vendosur pikërisht skena e punës. Puna si thelbi i përmbajtjes së mendësisë socialiste ku ta "ndërtojmë Shqipërinë me duart tona", ndoshta duket thjesht si një slogan, por në të vërtetë ishte kryefjala e regjimit totalitar komunist. Një sistemi, i cili ngurtësoi lirinë e imagjinatës dhe bukurinë e ngjyrave të shpirtit të çdo artisti asokohe të cilët kufizoheshin në interpretimin e natyrës, duke mos dalë nga rregullat dhe stereotipet e ideologjisë Marksiste-Leniniste.

Gjithësesi në të tria këto peizazhe përpos vendosjes në qendër të subjektit, që në dy tablot e para ***"Diga e Fierzës"*** dhe ***"Hidrocentrali i Fierzës"*** ngjashmëria është shumë e përafërt ku artisti Shoshi na paraqet si një dërshmi të gjalllë të kohës ndërtimin e Digës së Fierzës në vitin 1979. Ndërsa në veprën tjetër ai na pasqyron një tjetër pamje me në qendër një kantier pune, duke e izoluar plotësisht nga prania e njeriut brenda tij. Kompozimi në dy tablot e realizuara në Fierzë është i plot dhe jo fragmentar, në to piktori ka arritur të materializoi çdo element si pjesë e pamjes në natyrë ku nëpërmjet aplikimit të perspektivës qendrore përçon tek ai që i shikon ndjenjë e trepërmasores. Një iluzion nga ku të duket sikur je përballë një realiteti të prekshëm për së gjalli, sikur je aty brenda, duke shijuar në largësi çdo gjë që është duke ndodhur përreth.

Në tablon ***"Peizazh industrial"*** ajo çfarë shfaqet është një pamje disi në largësi nga kantieri dhe i vendosur nga aspekti kompozicional i thjesht, pa shumë plane dhe thyerje të larmishme vëllimesh. Peizazhi në këtë vepër ndahet horizontalisht në dy pjesë; në atë të planit të parë, me një gropë të madhe dhe makineritë e kantierit të pikturuara me vlerat tonale të ngjyrave të ngrohta në okër të përzier me rozë dhe të kafta në të kuqe, përveç pjesës së blertë të barit. Ndërsa në planin e dytë është pikturuar faqa e një mali me penelata të shkathta diku pak pastoze e diku pak të lëngshme, nën gamën e ngjyrave të ftohta të buls në viloë me disa tonalitete të jeshiles në kafe, i cili shkrihet thuajse plotësisht me të njëjtat tone që është pikturuar edhe qielli.

Dallimi mes dy peizazheve të realizuara në Fierzë qëndron se tek tabloja e emërtuar ***"Diga e Fierzës"*** në ndryshim nga ***"Hidrocentrali i Fierzës"***, që në thelb është po i njëjti subjekt qëndron në afrimin më pranë syrit, zmadhohet më tepër dhe si rrjedhojë këndi i shikimit ngushtohet. Ndërsa në tablon e emërtuar ***"Hidrocentrali i Fierzës"*** këndi i shikimit zgjerohet, syri depërton më në thellësi, pasurohet me praninë e figurës së punëtorëve ku një grupi prej tri puntorësh në ecje ndodhet në planin e parë dhe tetë të tjerëve të cilët të gjithë sëbashku janë

duke shkuar drejt Digës. Në këtë tablo pamja shfaqet më madhështore, më e larmishme në elementë të cilët ndihmojnë të gjithë kompozimin për të qenë sa më gjithëpërfshirës. Përpos pranisë së punëtorëve, në këtë vepër



Fig. 1

Fig. 2

Fig. 3

Fig. 4

peizazhi përplotësohet edhe nga dy rrugë gjarpëruese anash maleve, që rrethojnë vetë Digën e Fierzës, si dhe një urë, e cila është lehtësisht e lexueshme në planin e parë, që lidh jo vetëm dy anët e maleve, por edhe vetë dy pjesët e kompozimit. Në të dyja tablot teknika e përdorur nga artisti Shoshi është ajo e bojrave të vajit. Teknikë, e cila i ka mundësuar atij të modelojë vëllimet me penelata të imta e të zhdërvjellta, të arrijë të përsosë e të kapë tonet reale të një realiteti real dhe me to të pikturojë sfumaturat në pjesën e sipërme në majat e maleve, duke përçuar te ne iluzionin e një përhumbjeje të shikimit në një horizont të largët.

Këto tri peizazhe jo pakuptim i solla në vëmendje, sepse janë një copëz e njërës prej anëve të medaljes së pikturës së Zef Shoshit. Janë peizazhe të realizuara gjatë viteve ’70 të konsideruar nga unë si periudha e parë e artistit. Konsideratë kjo ndaj krijimtarisë së tij, e cila sikurse e citova edhe pak më sipër ndahet në dy momente shumë domethënëse për vetë artistin si krijues, por edhe në studimin e pikturës së tij në kontekstik historiko-stilistik për historiografinë e artit pamor shqiptar. Ndarje kjo në dy periudha ku e para përkon me vitet fill pas studimeve të larta në Institutin e Lartë të Arteve siç njihej asokohe (sot Universiteti i Arteve) në vitin 1962 deri në vitin 1990. Periudha e dytë, padyshim mund të konsiderohet ajo pas vitit 1990 e deri më tani, duke parë që artisti Shoshi është ende gjallë dhe krijon dita-ditës vepra të reja (identifikuese për stilin dhe trajtimin që i bënë subjekteve të ndryshme në pikturën e tij).

Përfundime

E gjithë kjo përmblidhet në sintezën e pikturës së Zef Shoshit. Një sintezë si përfundim i një kalimi të natyrshëm brenda vetes në kërkim të mjeshtërisë, brenda një rrugëtimi, i cili e udhëhoqi drejt përparimit dhe një pjekurie artistike

të identifikueshme.

Krijimtaria e artistit Shoshi vërtetë u ngjiz dhe u rrit nën ndikimin e frymës së pikturës së Realizmit Socialist, por kjo vlen pikërisht vetëm për atë kohë, që unë e klasifikoj si periudha e parë në krijimtarin e tij. Ndërsa piktura apo gjinia e peizazhit e trajtuar pas viteve ’90 mbetet gjithmonë realiste për nga përmbajtja, por shprehet me një kolorit të pasur nëpërmjet një shumëllojshmërie nuancash ngjyrash dhe me një timbrikë drite të mprehtë depërtuese, e cila arrinë të mbërthej mbi kanavacë ajrin, atmosferën dhe ngjyrat e atij çasti që ndjehet në natyrë.

Literatura

1. Cartesio, R. *Meditazioni metafisiche*, Armando Editore, Roma, 2003, f. 24.
2. Kuqali, A. *Historia e artit shqiptar II,* Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1988, f. 148-149.
3. Paduano, G. *Aristotele: Poetica,* Laterza, Bari, 1998, f. 44.
4. Pareyson, L. *Estetica dell’idealismo tedesco: Kant e Schiller*, Ugo Mursia Editore srl, Milano, 2005, f. 201.
5. Peretto, L. *San Tommaso d’Aquino: Commento alla Metafisica di Aristotele e testo integrale di Aristotele,* vëll. I, libri 1-4, Edizioni Studio Domenicano, Bologna, 2004, f. 293.
6. Zeqo, M. *Arti i Zef Shoshit*, Delta Print, Tiranë, 2010, f. 6.
7. Zeqo, M. *Arti i Zef Shoshit,* Delta Print, Tiranë, 2010, f. 9.